Shefki Ollomani

LEKA I MADH
(Aleksandri i Maqedonisë)

/rrënjët e vërteta/

Editor
Azam Dauti

Shefki Ollomani

LEKA I MADH

(Aleksandri i Maqedonisë)

/rrënjët e vërteta/

Botim i dytë i plotësuar

Shkupi

Shkup, 2O15

DY FJALË PËR LEXUESIT

Ky libër është me përmbajtje historiko-publicistike dhe me karakter patriotik-politik-kombëtar, që vehet në shërbim të zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare në Gadishullin Ilirik (Ballkan). N***uk është punim shkencor i historisë***, si ato që dalin nga pena e studiuesve të historisë me tituj shkencorë: Prof., Mr., Dr. apo Akademik, sepse unë nuk jam profesor apo studiues i historisë, prandaj edhe nuk kam përdorur gjithmonë ***fusnota*** gjatë hartimit të tij, por, natyrisht, kam paraqitur të gjithë literaturën/bibliografinë ndihmëse për përgatitjen dhe shkrimin e këtij libri.

Ky është një libër i përmbledhjeve të mia, nga artikuj dhe fragmente të autorëvë të tjerë, që kanë shkruar për Lekën e madh. Prandaj, të gjitha meritat u takojnë autorëve: Moikom Zeqo, Arben Llalla, Luan Malltezi, Rrahim Veliu, Filip Boga, Fatbardha Demi, Adnan Abrashi, Nezir Myrta, Nebi Dervishi, Salih Mehmeti, Ilir Cenollari, Agron Luka, Valon Kurtishi, Fahri Xharra etj. Njëkohësisht, kërkoj falje, që nuk i kam shënuar fusnotat në artikujt apo fragmentet e tyre, sepse përzgjedhja ime, është bërë kryekëput, nga dëshira ime individuale (e jo profesionale e shkencore) për të demaskuar historitë e të tjerëve, që vrapojnë në përvetësimin e Lekës së Madh si hero i tyre.

Ky libër është, si të thuash, shkollor/edukativ për mësimin e një pjese të historisë sonë kombëtare nga ana e nxënësve, të rinjve, studentëve dhe lexuesve të tjerë, dashamirë të historisë.

Është një libër i shkruar nga dora dhe pena e një poeti, publicisti, veprimtari kombëtar dhe luftëtari idealist për bashkimin kombëtar të Shqipërisë Etnike.

Është një libër që rrëfen për Lekën e Madh të Maqedonisë, i cili gjatë gjithë jetës së tij të shkurtër, por të bujshme, luftoi, punoi e veproi për bashkimin e Trojeve Pellazgo-Ilire. Luftoi për çlirimin e Pellazgjisë: Maqedonisë, Thrakisë, Epirit dhe gjithë Ilirisë nga fiset barbare përreth, nga perandoritë e huaja pushtuese, si dhe luftoi për çlirimin e popujve të tjerë të Azisë dhe Afrikës nga sundimet e huaja.

Është një libër/përmendore për Lekën e Madh pellazgo-ilir, nga fisi i maqedonëve të lashtë, i cili gjithë jetën, zgjuarësinë dhe forcën e tij luftarake e komanduese ia kushtoi çlirimit, mbrojtjes dhe bashkimit të Pellazgjisë e Ilirisë në një Perandori të vetme, të fuqishme dhe të civilizuar.

Është libër që ka për qëllim t'u mësojë shqiptarëve historinë e lashtë pellazgo-ilire, si dhe të vërtetën historike dhe etnike për birin e tyre trim, të urtë e legjendar, Aleksandrin - Lekën e Madh.

Është libër që ka për qëllim edhe botës t'i tregojë se kombi shqiptar është aq i lashtë, aq civilizues, saqë ka lindur e ka rritur një komandant e strateg ushtarak, një mbret, perandor e luftëtar të përmasave botërore e mbinjerëzore, si Aleksandri i Maqedonisë pellazgo-ilire – Leka i Madh.

Është një libër, me anë të të cilit ne, pasardhësit, nip-stërnipërit e Lekës së Madh – shqiptarët, bëjmë gjënë më të vogël: **I dalim zot Lekës së Madh**, e ripranojmë dhe e fusim në gjirin e popullit të vet, nga i cili lindi, nga i cili u burrërua dhe për lirinë e të cilit luftoi tërë jetën e tij.

Ky është një libër ***nderimi dhe falenderimi*** për birin e madh të kombit shqiptar, është një *Mirënjohje* për **kryekomandantin** e komandantëve, për **perandorin** e perandorëve, për **kryetrimin** e trimave, për **legjandarin** e legjendarëve, për **të madhin** e të mëdhenjve, për më të **famshmin** e të famshmëve të njerëzimit, për pellazgo– iliro–shqiptarin e pavdekshëm – Lekën e Madh të Maqedonisë.

Autori

Suedi, qershor 2014

I. MAQEDONËT DHE MAQEDONIA ANTIKE

1.Shfaqja dhe mbretërimi i maqedonëve në Pellazgjinë Jugore

Maqedonia për shkak të relievit gjeografik, njësoj sikurse trojet tjera ilire, nuk eci njëkohësisht me zhvillimin e Helladës. Masivi i Bermionit, i cili shtrihet me drejtim nga veriu drejt jugut, ndante Maqedoninë e Sipërme nga ajo e Poshtme.

Maqedonia e sipërme, me ndryshim të madh në lartësi, ishte e përshtatshme për rritjen e bagëtisë, ndërsa Maqedonia bregdetare me fushat pjellore, që ujiten nga lumi Aksios (Vardari) dhe lumi Haliakmona (Bistrica), i ishin kushtuar bujqësisë. Vendi nuk kishte limane të përshtatshme. Kështu që banorët e saj më të vjetër ishin barinj dhe bujq. Mbretërit e Maqedonisë nga shekulli VII p.e.r. kishin ardhur nga tokat e Ilirisë Jugperëndimore dhe e mbanin veten për pasardhës të trimit pellazg, Herakliut, që mori këtë emër për shkak se Hera (Hyjneshë e Erës) i punoi një rreng për t'ia humbur pushtetin mbretëror që do të mund t'i takonte. Meqenëse helenët për shkak të pozitës së mirë gjeografike arritën një shkallë të lartë zhvillimi ekonomiko-kulturor, ata edhe vunë dorë mbi lojërat olimpike (lojëra tradicionale pellazge) dhe nuk lejonin maqedonët dhe fiset tjera ilire e trakase që të merrnin pjesë. Kështu, kur stëgjyshi i Lekës së Madh, Leka i Parë, shkoi për të marrë pjesë në lojërat olimpike, helenët nuk deshën t'a pranonin me të vetmen arsye se nuk qe helen. Nga shekulli VII e VI shkolla thesalo-maqedone në artin e skulpturës paraqet stil të njëjtë me artin e qyteteve dorike.

Maqedonët adhuronin Diellin, që vërtetohet nga disa simbole të njohura të arkeologëve, si "Dielli i Vergjinës". Kulti i Diellit është tipik për racën pellazgjike. Fundja, kishin të njëjtat doke e zakone me ilirët tjerë.

Leka i Parë, (Aleksandri I, 498-454 ose 495-450), ishte ai që bashkoi Maqedoninë e Sipërme me të Poshtmen. Ai iu kushtua organizimit të shtetit dhe të ushtrisë së tij. Krahas me trupën e

kalorësisë së eterëve (shqipen e sotme: Etërve, baballarëve), që e përbënin fisnikët, organizoi edhe trupën e pezeterëve, që e formonin bujq të lirë dhe që rezultoi në këmbësorinë e ushtrisë maqedone. Do të duhej të përmendnim se Kuvendi i Ushtrisë kishte qysh në kohët e mëparshme të drejta të caktuara, p.sh. të aktualizonte ngjitjen në fron të mbretit të ri dhe të gjykonte veprime që drejtoheshin kundër shtetit. Më 496 p.e.r. Leka i Parë mori pjesë në lojërat olimpike, ku u shqua në garën e vrapimit.

Mbret tjetër i Maqedonisë ishte Arkelau (413-399) që u mor me organizimin e brendshëm dhe me zhvillimin kulturor të vendit. Ai bëri ndryshime në qeverisje dhe, për të zhvilluar tregtinë, e zhvendosi kryeqytetin nga Egesi në Pellë, në liqenin e së cilës arrinin anijet nga lumi Ludina. Që atëherë Egesi mbeti vend fetar dhe vend varrimi i mbretërve të Maqedonisë. Arkelau dëshironte shoqërimin me artistë e filozofë.

Pas vdekjes së Arkelaut, Maqedonia kaloi një periudhë trazirash për shkak të luftërave për fron mes pretendentëve gjer më 359, kur pushtetin e mori Filipi i Dytë. Fillimisht qeverisi si tutor i nipit të tij, Amynta. Mbret u shpall me siguri më 356. Në këtë kohë rrethanat ishin kritike. Filipi e ndjente rrezikun e Persisë, dhe njëkohësisht e urrente shumë këtë perandori. Filipi riorganizoi këmbësorinë, krijoi falangën e famshme maqedone dhe pajisi ushtrinë me mjete të përshtatshme për rrethim: katapulta (për lëshim shigjetash), deshë (trarë me majë metalike për të shpuar dyert e kështjellave) dhe kulla rrethuese. Organizoi një ushtri të qëndrueshme me shërbim të detyrueshëm. me marshime të vazhdueshme, ushtrime dhe lojëra betejash, frymëzoi disiplinë, moral dhe unitet, që kishin ndikim edhe në popull.

Paralelisht mendoi dhe për zhvillimin kulturor dhe ekonomik të Maqedonisë. Ndërtoi qytete dhe vendosi ligje. Pezeterët, që rekrutoheshin nga popullësia e qyteteve, dëshmojnë zhvillimin ekonomik të Maqedonisë (Stefani i Bizantit përmend 70 qytete maqedone, ndërsa gërmimet arkeologjike vërtetojnë ekzistencën e tyre që nga shek. VI p.e.r.).

Për të siguruar sundimin e tij në minierat e arit të Pageonit, më 357 Filipi pushtoi Amfipolin dhe më 356 pushtoi Pidnën dhe Potidean. Ndërkohë, me rebelimin e aleatëve të Athinës, kishte shpërthyer Lufta e Aleancës (358-355), e cila solli shkrirjen e Aleancës II të Athinës. Lufta e Aleancës i dha guxim Filipit të shtrinte sundimin e tij në Helladë, sepse tregonte se grindjet e helenëve nuk kishin të sosur. Por, pas kësaj shpërtheu edhe një luftë tjetër civile mes helenëve. Kur Kuvendi i Amfiktionit në Delf dënoi fokeasit, sepse kishin lëruar kopshte të orakullit të Delfit, ata plaçkitën thesaret e tij. Tebanët, lokrët, thesalët, kërkuan ndihmën e Filipit kundër fokeasve.

Ushtria maqedone përparoi gjer në Termopile, por iu shmang përplasjes me athinasit, të cilët ishin rreshtuar atje. Më 348 Filipi pushtoi Olintin dhe e shkatërroi, ndërsa lufta e shenjtë vazhdonte, athinasit dërguan në Pellë një delegacion nën kryesinë e Filokratit, ku merrnin pjesë Demosteni dhe Eskini. U nënshkrua atëherë Paqja e Filokratit (346), kundërshtarët u morën vesh të mbanin gjithë vendet që zotëronin gjer atëherë. Por Filipi nguli këmbë që nga marrëveshja të përjashtoheshin fokeasit. Kështu marshoi në Fokidë, ku thirri Mbledhjen e Amfiktionit. Atëherë u vendos:

1. Të rrafshoheshin qytet fokease,

2. Fokeasit të paguanin gjobën prej 50 talantash derisa të shlyhej vlera e thesareve të grabitura në Delf,

3. T'i jepeshin Filipit dy votat e fokeasve në Kuvendin e Amfiktionit,

4. T'i jepej Filipit kryesia e Lojërave Pitike.

Me pretekstin për të ndëshkuar lokrët që ishin akuzuar se kishin lëruar kopshtet e orakullit të Delfit, Filipi arriti në Elatia. Athinasit dhe Tebanët bënë aleancë me epërsinë e këtyre të fundit. Pas pak kohësh në Keronia 32 mijë maqedonë përballonin 30 mijë athinas, tebanë dhe aleatë të tyre. Në këtë betejë u shqua Aleksandri i Madh, në krye të kalorësisë maqedone, në moshën 18 vjeç. Këtu Aleksandri shfarosi falangën tebane. Pas kësaj fitoreje Filipi mbajti një kuvend në Korinth më 337, ku thirri të gjithë prijësit e helenëve, të cilët e njohën për prijës dhe

hegjemon mbi ta. Mirëpo, një vit më vonë në teatrin e Egonit u realizua vrasja e tij, e organizuar nga helenët, pikërisht gjatë përgatitjeve të maqedonëve për fushatën kundër Azisë (336). Aleksandri vijoi veprat e të parëve për të zhvilluar e zgjeruar shtetin dhe për të sunduar helenët e bezdisshëm. Aleksandri pasoi të atin në moshën 20-vjeçare. Në fillim i mposhti pretenduesit e fronit, pastaj përparoi me ushtri në Korinth, ku thirri të gjithë prijësit e helenëve me përjashtim të Spartës dhe u shpall sundues i tyre. Pas një kohe tebanët ngritën krye. Me një shpejtësi të pabesueshme u kthye në Tebë, mbyti revoltën dhe rrafshoi tërë qytetin, përveç Kadmeas, faltoreve dhe shtëpisë së Pindarit, për shkak se ky i fundit i kishte thurur një himn fitores së Lekës së Parë në Olimpia. Pas kësaj detyroi përfaqësuesit e qyteteve që t'a shpallin "komandant të përgjithshëm".

Kështu, pasi vendosi sundimin e plotë mbi fiset helene të rrebeluara, filloi të përgatitet që t'i pushtojë barbarët aziatikë - persianët.

2. Etnia – origjina e maqedonëve antikë

Shpeshherë në historiografinë botërore shtrohet pyetja: Kush ishin maqedonët e lashtë? Kësaj çështjeje të ndjeshme më mirë i përgjigjet historiani e studjuesi kroat, Dr. Petar Lisiçar, i cili thotë: ***"Maqedonët e lashtë janë popull i ri indoevropian, i cili është formuar nga grupe etnike ilire dhe pjesërisht nga grupe thrake dhe më pak helene, rreth shek. VII p.e.s., të cilët e kanë formuar shtetin e tyre në një shtrirje territoriale: në veri të Thesalisë, rrethë lumit Haliakmona (Bistrica e sotme) në rrafshin e Gjirit të Termejit (Selanikut)***".

Sa i përket gjuhës së tyre, më së miri e dëshmon studiuesi amerikan, Xhorxh Uiliams, kur shkruan se: ***"Gjuha amtare e Aleksandrit të Madh që pushtoi botën, ka qenë gjuha shqipe".***

Maqedonët e lashtë nuk përmenden në poemat e Homerit. Dëshminë më të vjetër të emrit maqedon e gjejmë në shënimet mitologjike të Hesiodit, se ***"Maqedoni është biri i Zeusit dhe***

Heroinës Thyije". Helaniku thotë se, ***"Maqedoni është djaë i Eolit"***. Emrin **Maqedoni** i pari e përmend Herodoti. Ndërsa Homeri përmend disa fise pellazge që jetonin në Maqedoni, mes tyre edhe peonët, të cilët morën pjesë në luftën e Trojës, të udhëhequr nga prijësi i tyre, Pirekmi. Sipas Herodotit, dorët, që jetonin rrëzë malit Pind, dikur janë quajtur maqedonë. Nuk është e parëndësishme ajo që tregon Herodoti mbi vëllezërit Temenidë, të cilët në fillim kanë ardhur nga Arga në Iliri, e mandej në Maqedoni dhe atë falë rrethanave fatlume dhe të mira e kanë themeluar shtetin e tyre - **Maqedoni**.

Maqedonët besonin se i pari i fisit të tyre ishte Makedoni, nga i cili u emëruan. Në gjuhën e atëhershme ilire, përkatësisht në dialektin e bukur dorik, kjo fjalë kishte kuptimin **"i madh".** Pra, maqedonët ishin të mëdhenj, shtatlartë. Legjenda thotë se Makedoni ishte nip i Lykaonit dhe i Pellazgut, njeriut të parë në tokat ilire, njeriut që mbiu nga toka.

Herodoti ka shkruar se Maqedonia, ashtu si vendet tjera përreth, banohej nga pellazgët. Ai e quan Maqedoninë Pellazgji dhe Olimpin e konsideron si qendrën, kërthizën e pellazgëve. Në tekset e tij bën fjalë për një lidhje të ngushtë mes maqedonëve dhe dorëve. Herodoti shkruan se dorët rrjedhin nga maqedonët, se e lanë Maqedoninë dhe shkuan drejt jugut, në fillim u vendosën në rrethinat e Thesalisë, pastaj shkuan në Gadishullin e Moresë (Peloponezi i sotëm). Të tjerët mendojnë të kundërtën, se maqedonët rrjedhin nga dorët. Se ekzistonte një lidhje e ngushtë mes maqedonëve dhe dorëve, na e thonë legjendat maqedone, që i gjejmë në versione të ndryshme.

Njëri version na thotë se mbreti i parë i maqedonëve ishte Karani, i biri i mbretit të Argut, Timenit. Timeni bashkë me Kresfontin dhe Aristodimon ishin tre prijësit e dorëve, që nga rrethinat e Thesalisë kaluan në Moré, ku vendosën pushtetin. Meseninë e mori Kresfonti, Spartën e mori Aristodimo, ndërsa Argun e mori Timeni.

Pasi vdiq Timeni, të bijtë u grindën për fronin. Fedoni ia doli të marrë fronin për vete, ndërsa Karani vendosi të ikte larg të gjente një vend tjetër për të sunduar, por më parë shkoi të

konsultohej me orakullin e Delfit. ”Mbretërinë tënde ta ngresh atje ku të shohësh të prehet një kope dhish”, i tha Pitia.

Pas shumë ditësh udhëtimi arriti në një vend të bleruar, ku pa një kope dhish. Shokëve të tij u tha: ”Do të qëndrojmë këtu”. Aty ngritën qytetin që e emëruan Eges (Edhës), nga fjala ilire EG që do të thotë ”Edh” - i vogli i dhisë (vëreni rotacionin nga G në DH, i zakonshëm për gjuhën ilire). Ky vend është po kjo Vergina e sotme, ku gjatë gërmimeve arkeologjike është zbuluar kultura e lashtë maqedone.

Mbretërit maqedonë besonin që të gjithë se rridhnin nga dorët. Pasi që dorët, sipas legjendës, rridhnin nga Herakliu (Herkulesi), edhe maqedonët adhuronin Herakliun si stërgjyshin e tyre dhe kishin ngritur faltore të shumta për nder të tij.

Historia na bën me dije se Mbretërinë Maqedone e themeloi Perdika I, i cili mbretëroi rreth viteve 700 p.e.r. Sipas një legjende, Perdika erdhi nga Iliria me dy vëllezërit e tij, Eropin dhe Gauanin. U vendosën në Maqedoninë Perëndimore dhe u bënë barinj të kopeve të mbretit të Lebajës. Një natë mbreti pa në ëndërr se Perdika po i merr fronin, ndaj vendosi që t'i vriste tre vëllezërit. Perdika me vëllezër një ditë ishin duke kullotur kopetë. Papritmas panë nga larg kalorësit që kishte dërguar mbreti për t' i vrarë. Ata dyshuan në ta, prandaj ikën. Nga prapa u vinin shigjetat që i hidhnin kalorësit. Pas një ikjeje të gjatë arritën te një lumë, ku u hodhën për të shpëtuar dhe dolën në anën tjetër. Pak kohë pas tyre erdhën edhe kalorësit që u futën në lumin e cekët për të dalë matanë. Por një rrymë e vrullshme e ujit ra sipër tyre dhe i mbyti. Më vonë Perdika gjeti mjaft shokë, u bë i pasur, u kthye dhe e mundi mbretin e Lebajës, duke ia marrë fronin.

Sipas një versioni tjetër, Perdika, themeluesi i shtëpisë mbretërore të Maqedonisë, ishte më i vogli i tre vëllezërve, të cilët nga toka e Ilirisë kishin shkuar në Lebaia dhe ishin marrë në shërbim si barinj prej mbretit të vëndit. Kur mbretëresha gatuante bukët, kishte vënë ré se kurdoherë buka e Perdikës bymehej dy herë më shumë nga bukët e tjera. Ia tregon këtë gjë mbretit dhe ky, i trembur prej këtij farë paralajmërimi, i dëbon të

tre vëllezërit. Ata kërkojnë rrogën që u qe caktuar, por mbreti nuk ua jep. Ai ua tregon këtyre diellin, që n'atë çast po hynte në shtëpi nga një birë e pullazit dhe u thotë: "Kjo është rroga që ju meritoni". Atëherë Perdika përgjigjet: "Edhe ne e pranojmë", dhe me një thikë që kishte me vehte, shkroi mbi tokë rrethin e diellit. Pastaj hyri tri herë brenda këtij dielli të vizatuar përdhé dhe u largua bashkë me dy vllezërit. Vepra me karakter magjik dha përfundimin e pritur, sepse Perdika kur pushtoi të gjithë Maqedhoninë, u bë edhe zot i Lebaias.

"Mbretëria e Maqedonisë, - shkruajnë Paurson dhe Cayx, - ***ia detyron origjinën e saj një kolonie pellazgësh të dëbuar nga Hestiotida (krahinë në Thesali – Argosi i lashtë) prej kadmenëve, rreth vitit 1302 p.e.s. Ata u vendosën në Pind nën emrin maqedonas dhe u shtrinë deri në Ematia".***

Pra, Maqedonët antikë ishin me etni pellazge, ashtu siç ishin edhe trakët, epirotët, etruskët, trojanët, mikenasit, ilirët…, etj. Të gjitha këto fise e popuj kishin të njëjtën rrënjë, etni, gjuhë, kulturë dhe të njëjtin gjak **– ishin pellazgë.**

Mbretëria e parë e Maqedonisë u formua rreth vitit 796 para erës sonë (p.e.s.), e drejtuar nga mbreti Karan.

Në sytë e grekëve maqedonasit nuk ishin grekë. Demosteni (filozof grek) i cilësonte ata si ***"barbarë",*** domethënë ***të huaj*** dhe poashtu përpara tij, Homeri, na rrëfen se maqedonët rendën në ndihmë të Trojës së rrethuar nga grekët. Pra, vëllezërit pellazgë maqedonë shkuan në ndihmë të vëllezërve pellazgë trojanë, për t'i mbrojtur nga barbarët e vërtetë – grekët.

Nga ana e tij, Justini siguron se maqedonët ishin pellazgë, kurse Straboni shkruan se ata kishin të njëjtën veshje, flisnin të njëjtën gjuhë, kishin të njëjtat zakone me epirotët. E, kush ishin epirotët e Pirros, nuk ka nevojë të komentohet, sepse dihet e pranohet shkencërisht se ata ishin një fis(popull pellazgo-ilir). Kur Kuint-Kyrs, historian latin i shek. I p. e. s.), ka përshkruar një komplot ushtarak ku ishin përfshirë edhe gjeneralët maqedonë, Parmenioni e Filota, shkruan se maqedonët nuk flisnin greqisht dhe se, për t' u marrë vesh, ishte i nevojshëm një përkthyes.

Mbretërit e Maqedonisë nga shekulli VII p. e. s. kishin ardhur nga tokat e Ilirisë Perëndimore dhe e mbanin veten për pasardhës të trimit pellazg, Herakliut (Herkulit), që mori këtë emër për shkak se Hera (Hyjneshë e erës) i punoi një rreng për t'ia humbur pushtetin mbretëror që do të mund t'i takonte. Meqenëse helenët për shkak të pozitës së mirë gjeografike arritën një shkallë të lartë zhvillimi ekonomik-kulturor, ata edhe vunë dorë mbi Lojërat Olimpike (lojëra tradicionale pellazge) dhe nuk lejonin maqedonët dhe fiset tjera ilire e trakase të merrnin pjesë. Kështu, kur stërgjyshi i Lekës së Madh, Leka i Parë, shkoi për të marrë pjesë në Lojërat Olimpike, helenët nuk deshën ta pranonin me të vetmen arsye, se nuk qe helen (grek). Nga shekulli VII dhe VI shkolla thesalo-maqedone në artin e skulpturës paraqet stil të njëjtë me artin e qyteteve dorike.

Maqedonët adhuronin diellin, që vërtetohet nga disa simbole të njohura nga arkeologët, si "Dielli i Vergjinës". Kulti i diellit është tipik për racën pellazgjike. Fundja, kishin të njëjtat doke e zakone me ilirët e tjerë.

Artur Vajgal në librin e tij "**Aleksandri i Madh**" Tiranë 2002, faqe 3, shkruan: ***"Sipas një legjende, thuhet se nga fundi i shekullit VIII p. e. s., në atë kënd të Ilirisë së lashtë, ku tani gjendet kufiri midis Bullgarisë, Greqisë dhe Shqipërisë, jetonin tre vëllezër temenidë: Gauani, Eropi e Perdika. Ata pretendonin se kishin prejardhje nga heroi i Argosit, Temeni, i cili ishte biri i Aristomakut, i Kleodemit, i Hylosit, i Herakliut të fuqishëm ose i Herkulit, siç e thërrisnin romakët. Pra, bir i perëndisë më të lartë, Zeusit. Thuhet se këta tre vëllezër kishin ardhur nga Argosi, që është në bregun lindor të Peleponezit. Përderisa edhe në këtë pjesë të Ilirisë gjendej një vend i quajtur Argos, emër që në gjuhën pellazgo-maqedone do të thotë "fushë", ka mundësi që lidhja me Argosin e Peloponezit t'i përkasë një faze më të hershme të historisë së familjes".***

***

Disa studiues tendenciozë e të njëanshëm mendojnë se maqedonët e lashtë kanë qenë grekë, të cilët për shkak të izolimit

të tyre në aspektin kulturor ngelën pas grekëve, që shtriheshin më në jug. Disa të tjerë janë të mendimit se maqedonët antikë janë një përzierje e fiseve ilire dhe helene (greke). Mirëpo, e vërteta historike thotë se maqedonët e lashtë nuk kanë qenë grekë ose helenë. Sa e sa herë vet historianët, politikanët, filozofët dhe sundimtarët helenë e kanë pohuar dhe pranuar se maqedonët e lashtë dhe bashkë me ta edhe ilirët e trakasit kanë qenë johelenë (grekë) me etni dhe që kanë folur një gjuhë krejtësisht tjetër, një gjuhë "barbare", të huaj dhe të ndryshme nga gjuha e tyre. Në FILIPIKET e oratorit të famshëm grek, Demosten, dëgjojmë shpeshherë fjalën "barbar", e cila në greqishten e vjetër është sinonim me kuptimin "i huaj". Kjo fjalë kundër maqedonëve është përdorur dy herë nga ana e historianit grek, Tukididi, si fjalë që ka dalur nga goja e Bresidës në kohën e Luftës së Peloponezit 421-404 p. e. s.

Profesor Otto Müller shkruan: ***"Mbretërit e këtyre tri provincave: Epir, Iliri dhe Maqedoni, vishnin rroba të njëjta dhe ishin lidhur me krushqi e me gjini përherë në mes tyre. Kështu gjyshja e Aleksandërit të Madh ishte ilire dhe e ëma Olimpia prej Epiri nga dera e Pirros".***

Në librin **"Historia e Aleksandërit të Madh"** të historianit romak, Kurt Rufi, në mes të tjerash gjejmë të dhëna shumë interesante për studimin e periudhës së Lekës së Madh, ku ndër të tjera, mësojmë se ***"Gjuhën e Aleksandërit dhe ushtarëve të tij nuk e merrnin vesh".***

Ndërkaq, Straboni në një vend tjetër thotë: "***Si përherë ende edhe sot, Maqedoninë në një pjesë të Thesalisë e mbajnë barbarët, si molosët, thesprotët dhe të tjerë***". Kurse, historiani Dion Kasi thotë se ***"Vendi që quhet sot Maqedoni, ish i banuar prej barbarëve: "Ilirë dhe Bardhë".***

Studiuesja Barbara Jelavich do të shprehet: ***"Rrënjët etnike të Maqedonëve së lashtë kanë qenë, sipas të gjitha gjasave, ilire, megjithëse në atë kohë shtresat e larta të shoqërisë maqedone kishin rënë nën ndikimin e kulturës greke".***

Historiani i madh i shekullit XIX, Teodor Momzen, shkruan: ***"Në viset ballkanike që në kohën romake krahinat e***

brendshme të Maqedonisë, krahas greqishtes dhe latinishtes, kanë ruajtur edhe gjuhën e popullit – ilirishten".

Aty kah mesi i shek.XIX albanologu gjerman, Hahn, formuloi këto teza:

1. Epirotët dhe maqedonët edhe në kohën e Strabonit ishin jogrekë ose barbarë.

2. Epirotët, maqedonët dhe ilirët janë farefis në mes tyre, kurse ilirishtja është gjuhë pellazgjike në kuptimin më të gjerë.

Me këto teza albanologu i famshëm gjerman, Hahn, te ilirët, si paraardhës të shqiptarëve, përfshin edhe epirotët dhe maqedonët e lashtë. Pra, të gjithë këto popuj i bën të ardhur nga pellazgët. Teza e përkatësisë së përbashkët etnike të epirotëve, ilirëve dhe maqedonëve antikë është sot një mendim i pranuar pothuajse nga të gjithë, sepse edhe ato pak dëshmi që kanë mbetur nga gjuhët e këtyre popujve flasin qartë për një ngjashmëri të tillë. Filipi II i Maqedonisë i bashkoi këto fise(popuj) në një fuqi të vetme. Në këtë mënyrë trakët, maqedonët dhe ilirët u bënë themeli i ushtrisë ngadhënjimtare të Lekës së Madh. Ambasadori amerikan, në Athinë e në Mal të Zi, Georg Fred Uiliam, në vitet 1912-14 do të shtonte se: ***"Shqipja qe gjuha amtare e Aleksandërit të Madh, që pushtoi botën dhe gjuha e Pirros së Epirit, një nga gjeneralët më të mëdhenj që përmend historia".*** Gati njëzëri janë studjues si Tarm, O.Hoffman, A.Jard, Geigand, O.Müller, P.Jougeut, H.Hirt, Edit Durham…, etj. Shprehin pikëpamjet e tyre se etnia dhe gjuha e maqedonëve të lashtë ka qenë ilire dhe ilirishte.

"Maqedonët, - shkruan Robert D'anzhei, ***- i përkisnin po asaj race si dhe vëllezërit e tyre ilirë, nuk kishin asnjë marrëdhënie me helenët, ata nuk vareshin prej tyre dhe nuk kishin ndjekur evoluimin e tyre qytetërues. Gjithashtu, helenët i quanin barbarë ose gjysmëbarbarë, sepse nuk i përkisnin racës dhe gjuhës helenike. Besimi, zakonet dhe doket e maqedonëve e tregojnë këtë më së miri, sepse kishin prejardhje ilire e jo helene".***

Helenët dhe Hellada, pra grekët e Greqia, në kohën antike kur u formua dhe u zhvillua Mbretëria e Maqedonisë në shek. X-

III p. e. s., nuk shtriheshin përtej siujdhesës së vogël të Atikës, pra, jetonin në Athinë dhe në rrethinat e saj.

Përderisa në Maqedoninë antike popullsia shumicë ishin maqedonë, ilirë e trakas, pra pellazgë, kuptohet që gjuha që flitej atje ishte iliro-pellazgjishtja, pavarësisht se njerëzit shkolloheshin në gjuhën dhe kulturën greke. Këtë e bënin jo vetëm maqedonët, por e gjithë bota antike e asaj kohe, gjë që nuk do të thotë se këta popuj ishin grekë dhe se gjuha amtare e tyre ishte greqishtja. Duhet ndarë me thikë shkollimin në një gjuhë të huaj, nga përkatësia etnike e një populli. Në atë kohë gjuha greke ka qenë gjuhë akademike dhe zyrtare në pjesën më të madhe të civilizimit mesdhetar euro-aziatik. Por, popujt e këtij regjioni nuk kishin gjuhë amtare, të përditëshme gjuhën greke, por gjuhët e tyre të veçanta etnike. E njëjta gjë është sot me gjuhën angleze. Të gjithë ata që flasin dhe shkollohen në këtë gjuhë ndërkombëtare, nuk janë anglezë.

Në Maqedoninë antike ilire aristokracia e saj shkollohej në gjuhën greke, shkruante me shkronja greke, por gjuha e përditshme popullore e tyre ishte maqedonishtja, pra ilirishtja, shqipja e sotme. Shkollimi në greqisht, përdorimi zyrtar i gjuhës e shkrimit grek nuk e bëri Filipin II, mbretin e Maqedonisë, as të birin e tij, Aleksandrin e Madh – Lekën, dhe as mbretërit tjerë maqedonas, trakas e ilirë…, që të jenë grekë.

Ata lindën e vdiqën, ishin dhe mbetën maqedonë, trakas, ilirë…, pra - pellazgë.

3. Emri i Maqedonisë

Emri Maqedoni, siç thonë historiografët grekë, vjen nga fjala "Emathja", që ka qenë emër i krahinës ku është formuar shteti i Maqedonisë antike, është fjala shqipe e "e madhe", ose nga "E Matjes", si dhe Matija ose Mati në Shqipërinë e sotme.

Etimologjia e emrit të sotëm, Maqedonia-Makedonia si toponim, emër gjeografik, në cilëndo formë linguistike të hulumtimeve që të provohet, me të gjitha gjuhët indoeuropiane, me të gjitha gramatikat historike të gjuhëve indoeuropiane, ky

emërtim – Makedonia, në formën si është sot, nuk paraqet kurrëfarë kuptimi linguistik, si një kompozitë që nuk tregon asgjë, as në kuptimin historiko-gjenetik të vet emrit, as të vet popullit, i cili sot është vetemërtuar – maqedon (makedon).

Sekreti i emërtimit të kompozitës Makedonia qëndron në tingullin e dyfishtë të shqipes – **dh**, si fillesë e rrokjes së tretë të kompozitës, e cila rrokje – **dho**, është edhe vet kuptimi i toponimit, që nuk ka mundësi fonetike të theksohet në gjuhët sllave dhe mu për atë, ka mbetur i njohur si falsifikim hisotriografik, emër pa kuptim, i papërcaktuar etimologjikisht në pikëpamje shkencore.

Fjala emër **Maqedonia** edhe në shqip është përcjellë si toponim, emër gjaografik i deformuar, që nuk përcakton emërtimin e hershëm origjinal, nga gjuha paraardhëse e shqipes, e cila konteston të gjitha format emërtuese indoeuropiane, qoftë sipas fonetikës dhe morfologjisë historike të linguistikës komparative, poashtu edhe të linguistikës gjenetike.

Etimologjia e emrit Maqedonia (Makedonia) mund të shpjegohet vetëm përmes shqipes së vjetër, e cila kompozitë në origjinal është **Makedhonia**, që lidhet me foljen e lashtë shqipe (gege) **me dho - me dhonë** (paraindoeuropiane). Pra, folja **me dhanë** (gege) dhe **për të dhënë** (toske).

Kompozita linguistike **Makedhonia** në esencën kryesore të thelbit të saj përbëhet nga tri rrokje të lashta shqipe: **ma+ke+dho**, që formon togfjalshin: **makedho(në),** ku folja e lashtë shqipe (gege) **dho – dhonë,** e theksuar përmes nazalizmit të hershëm – **o**, sikurse tek emërtimet: **so, zo, mo, nom-i, zoni, zona, dho, dhona**, **dhana, e dhana** – gege, **dhëna, e dhëna** – toske, me kuptimin – **ajo çfarë të jepet nga zoti apo nga njeriu.** Si determinim i asaj që të jepet, të dhurohet, të falet..., **dhonet** (jepet) si formë dhuntie, e dhonme, e dhanme, theksimi i zanores – o- hundore, sikur te fjala –bonme, e banme, kurse këtu shprehja shqipe -e dhanme, -e banme (gege) dhe –e dhënë, -e dhënme (toske) shqipe, janë këto shumë më të vonshme, si nazale - a-hundore dhe – e-hundore.

Kompozita origjinale **Makedhonia** përmes shpjegimit të shqipes së vjetër, zbërthehet dhe deshifrohet në këto rrokje të lashta: **ma+ke+dhon+i+a= makedhonia**, ku secila rrokje ka kuptim fonetik e morfologjiko-historik në vetvete:

Ma - trajtë e shkurtë e perëmrit pronor shqip, veta e parë – ***mue, mua;***

ke - trajtë e shkurtë ndërfoljore nga folja - ***me pasë, për të pasur;***

dhon - trajta e shkurtë e foljes së hershme shqipe (geg) – ***dhonë, dhanë;***

i - sufiksi në trajtën e pashquar të emrit si toponom – **Makedhoni;**

a - sufiksi në trajtën e shquar të emrit si toponom – **Makedhonia.**

Emërtimi **Makedhoni-a**, përbëhet prej dy trajtave të shkurtëra të perëmrave të shqipes së lashtë, si trajta vetori e pronori dialektor të gegënishtes dardane të lashtë, me kuptim mbiemror dhe duke kaluar në ndërfoljore, ku rrënja kryesore e kompozitës është folja e lashtë – **dho**, **-**dhonë, -dhona, -e dhonna, -e dhonmja -dhanë, -dhana, -e dhanmja, dhënë, -e dhëna, -e dhënmja, që theksohet me tingullin - o-hundore dhe si folje e lashtë gege, mund të zgjedhohet nëpër vetat gramatikore të vetorit të shqipes së vjetër, kështu:

Ma ke dho^në (mue), na ke dho^në (neve).

Ta kam dho^në (ty), ju ka dho^në (juve).

Ia ke dho^në (atij, asaj), ju ke dho^në (atyre-ve).

Shprehja shqipe (gege) e lashtë **– ma ke dho^në,** e cila është kuptimi i mëvonshëm **–ma ke dha^në**, (ma ke dhanë, - ma ke dhënë) e shpjegon etimologjikisht krejt fjalëformimin **Makedhonia**, në të cilën nënkuptohet shprehja në variante të ndryshme, por që vjen pikërisht nga dhuntia e natyrës, e cila i dedikohet njeriut, në shpërthime të aftësive, zotësive të dhuruara, si ato të mënçurisë, trimërisë, guximit, shkathtësisë, e dhëna e mbarësisë, që i dhurohen njeriut, si dhuntia e natyrës, ku shpjegohej përmes shprehjeve të ndryshme: **Ma ke dhonë o**

Zot...! Ma ke dhonë...diturinë, drejtësinë, guximin! – Ma ke dhonë të mbarën!...

Emërtimi i vendit, toponomi sotëm, **Maqedonia– Makedonia** është poashtu një deformim fonetik. Në këtë kemi deformimin e bashkëtingëllores **K** në **Q,** e cila sipas gjuhës latine, kjo theksohet **Q = K**, e cila është njëkohësisht deformim fonetik. Në vend të shqiptimit **Maqedonia**, duhet të thuhet **Makedhonia**, vendi **makedhon**, gjuha **makedhone**, flamuri **makedhon**, kultura **makedhone**, historia **makedhone** etj.

Simboli kombëtar makedhon i Makedhonisë illire ishte flamuri me diell me 16 rreze, i cili është përvehtësuar krejtësisht nga ky substrati i sotëm bullgaro-sllav, që veten e quajnë antishkencërisht dhe antihistorikisht: **makedon**. Kurse Dita e Flamurit makedhonas, ishte Dita e Hillit – Hillit të Dritës – Dillit – Diellit – Dita e Hillit – Dita e Illit – Dita e Yllit pikërisht, kjo dita festive kombëtare maqedonase – Illinden- ILLINDENI = illi+n+den. Këtu fjala – illi është hilli hillirian – ILLI ILLIRIAN + den = dita pra, spjegohet përmes shqipes së vjetër si – DITA E ILLIT = ILLINDITA.

Poashtu edhe te formimi i gjuhës maqedone, maqedonishtes aktuale, që në të gjitha format është terminologji e papërcaktuar shkëncërisht, e që u përpilua nga Cirili e Metodi (shek. IX. e. r.), ku vet këto dy emërtime individuale shpjegohen përmes shqipes së vjetër: CIRILLI E METHODI = ÇIRILLI E METHOTI – të cilat antroponime janë në lidhje koherente linguistike me Shkipen ilire.

CIRILLI (Ciril) = ÇIRILLI, shpjegohet me etimologji shqipe, pikërisht nga shqipja e vjetër, ku zbërthimi fonetik dhe morfologjik i emrit bëhet: cir+il=Ciril, çir+ill=Çiril, - Çirilli. Pjesa e parë e emrit, fjala, cir – çir, vjen apo rrjedh nga PIE (paraindoeuropiane) kcir= k'Çir = Çir = Çiri = Qiri, Qiriri, si preokupim morfologjik i shpjegimit të dritës, dritës së diturisë. Ndërsa pjesa e dytë e emrit: il, - ill, - illi (ylli), në kuptimin: **drita e qiriut, illi (ylli) i çirit = Çirilli** (Ylli i Qiriut).

Edhe antroponomi tjetër: METODI (Metod), kur analizohet fonetikisht në bazë të fonetikës historike, shpjegohet nga

shprehja **me(ë) thot(ë)= METHOT (Mëthoti)**, e që lidhet me rrënjen e foljes – thot(ë) – (me thot ai… më thotë, mua… Mëthoti lidhet me Thotin (Totin) pellazgjian, hartuesin, përpiluesin, krijuesin e alfabetit të hieroglifeve në Egjiptin e lashtë të faraonëve (të Farës Sonë). Nga emri iliro-shqiptar **Mëthoti** te sllavomaqedonët del emri **Metodi**, ngase ata nuk i kanë në alfabetin e tyre shkronjat: **-ë** dhe **-th**, të cilat i kanë zëvendësuar me germat: **-e** dhe **-d**.

Gjuha e vendit pellazgo-ilir me emrin **Makedhonia** ishte SKIPJA e Lekës së Madh, e Filipit II të Makedhonisë, ishte ajo gjuhë që nuk e kuptonin autorët antikë grekë e të tjerë, të cilët nga mëria dhe zilia e quanin shqipen e vjetër edhe gjuhë barbare. Akeksandri i Madh fliste një gjuhë "barbare" të huaj, të pakuptueshme për ata popuj që nuk ishin pellazgo-ilirë, sepse gjuha e Lekës së Madh dhe popullit të tij – makedhonëve, nuk ishte as greke dhe as latine. Ishte ajo shqipja e Lekës së Madh, që e përcolli atë gjatë gjithë ekspeditave të tij ushtarake në rrafshin trekontinental: Evropë–Azi–Afrikë. Leka i Madh nuk pushtoi vetëm ushtarakisht, por edhe kulturalisht antikitetin botëror të kohës. Ai themeloi e ndërtoi kështjella e qytete gjithandej ku sundoi. Ai ndërtoi edhe mrekullinë e botës, siç është Fari i Aleksandrisë në brigjet mesdhetare të qytetit me të njëjtin emër në Egjiptin e lashtë dhe të ri. Leka i Madh foli shqip tok me antikitetin, nga Iliriku dhe deri në Indi e Pakistan.

4. E vërteta mbi Maqedoninë antike
(Fragment)

(…)

Sot, kur themi Maqedoni, kuptojmë pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik(Ilirik), që formon një trekëndësh, kryet e të cilit në veri arrin deri në afërsi të Grykës së Kaçanikut dhe malet e Sharrit (Skardos), kurse baza formohet me bregun e detit Egje. Nga ana perëndimore ka Malet e Pindit, nga lindja ka lumin Mesta (Karasu), të cilit moti i thoshin Nestos dhe malet e Rodopit. Në jug fillonte nga malet e Olimpit dhe bregdeti i Selanikut. Por, para se të formohet mbretëria e Filipit II dhe

Lekës së Madh, Maqedoni i thoshin vetëm asaj cope që ndodhet midis Vardarit (Aksit), lumit të Janinës dhe kodrinave të Vodenit, Negoshit e të Karaferjes.

Tri vëllazëritë më të mëdha të Arbërisë, janë:

Iliria, Epiri dhe Maqedonia, këto tri fjalë janë shqip:

"I lirë" është mbiemër që s'ka nevojë ta shqipërojmë, se tingëllon krejt shqip.

"Epir" është fjala "E epërme". Sikur themi edhe sot: Dibra e Epërme, Reka e Epërme , Pollogu i Epërm etj.

Me dialektin toskërisht "e sipërme", po forma e vjetër duhet të ketë qenë ajo që është në gegërishte, "E epërme".

Emri Maqedoni, siç thonë historiografët grekë, vjen nga fjala "emathja", që ka qenë emër i krahinës, ku është formuar shteti i Maqedonisë antike. Fjala shqip "E madhe " ose nga "Ematje" si dhe Matja ose Mati në Shqipërinë e Mesme, mbiemrat e gjuhës shqipe kanë një karakteristikë që asnjë gjuhë europiane nuk i ka: çdo mbiemër ka një shenjë përpara, kur emri është i gjinisë femërore përdoret "e" , kur emri është i gjinisë mashkullore përdoret "i".

Arbëria e vjetër:

Pasi që emri Shqipëri është emër i ri ndaj lashtësisë së kombit tonë, për Shqipërinë e vjetër përdorim fjalën Arbëri, sepse kjo fjalë i përfshinë të gjitha viset ku kanë jetuar (banuar) gjithë vëllezërit arbërorë.

Arbëria ndahet në tri pjesë të mëdha:

1. Iliria, 2. Epiri, 3. Maqedonia.

A. ILIRIA shtrihej që nga lumi Shkumbin e arrinte gjer në Fjume (Rijeka e sotme), dhe kjo ndahej në disa pjesë:

Iliria e poshtme, Dalmacia, Peonia dhe Dardania.

Iliria e poshtme shtrihej nga Shkumbini e gjer në Kotorrin e sotëm, prej andejmi e gjer në Fjume, si edhe sot quhet Dalmaci. Që nga Qupërlia e sotme e deri në malet që u thoshin "Skardos", quhej Peoni, e që nga Drini e deri në Serbi quhej Dardani.

B. EPIRI, që quhej edhe Pellazgji, në lashtësi ndahej në:

1.Molosia, që sot formojnë malet e qarkut të Pogonit e të Kurendës.

2.Thesprotia, që është Çamëria e sotme me lumin Thiami, lumin e Kallamasë.

3. Kaonia, që përfshinë Labërinë deri në Vjosë. Bregu i Vjosës së epërme, quhej Atiantanija.

C. MAQEDONIA, nga jugu shtrihej prej maleve të Olimpit dhe nga Gjiri i Thermaik, d.m.th. nga limani i Selanikut dhe nga Halqidhiqia (Halkidikia).

Nga ana perëndimore fillonte me malet e Pindit, nga lindja malet e Rodopit dhe nga veriu malet Skarde.

Maqedonia atëherë ndahej në disa pjesë, të cilat janë këto:

1. Pieria, që shtrihej nga kufiri i Thesalisë, nga degët e Olimpit që ishin afër detit dhe vinte gjer në Haliakmonin e poshtëm (Bistrica e sotme) dhe përfshinte viset jugperëndimore të golfit Thermaik. Qytetet më me rëndësi të kësaj zone ishin, duke filluar nga veriu për në jug: Methone, Pydna, Dioni, Pempleia, Labetneon dhe Heraklion.

2. Elime, shtrihej në perëndim të Pierias dhe përfshinte bërrylin e madh të Haliakmonit të mesëm (Bistricës), në jug kishte malet që u thoshin Kambunia, në perëndim malet e Gramozit të cilëve u thoshin edhe Boion dhe ato male që u thoshin Tymphe. Qytetet më me rëndësi ishin: Aeane, Eratira dhe Elime.

3. Emathia, quhej edhe Maqedoni. Kjo zonë shtrihej nga ana e jugut kishte Haliakmonin e poshtëm, nga lindja e verilindja kishte lumin Ludia dhe nga perëndimi malet Bermion. Qytetet më të rëndësishme ishin: Edhise, Kition, Beroea.

4. Eordea, kjo zonë shtrihej në perëndim të zonës së tretë, d.m.th. e Matjes, përfshin edhe liqenin që i thoshin Begoritti. Në breg të këtij liqeni gjendej qyteti Arnissa.

5. Oresti, që formonte pjesën perëndimore, përfshinte Haliakmonin e Epërm dhe ndodhej midis maleve të Gramozit dhe vargut të Pelisterit. Qytetet më me rëndësi të kësaj zone janë: Celetron dhe Argos.

6. Bottiea, gjendej në mes lumit Aksios (Vardar) dhe Kudies. Kjo zonë shtrihej deri në Liqenin e Janinës. Qytet më me rëndësi ishin: Pella, Amidon, Kyrros, Europos, Atalante,

Gortinie, Idomen, katër qytetet e fundit ndodheshin në bregun e lumit Akcios (Vardar).

7. Lynkesti: shtrihej në lindje të maleve të Pelisterit në fushën e Manastirit e të Follorinës. Qytet më i rëndësishëm ishte Heraklea (Manastiri i sotëm).

8. Almopie: kjo zonë shtrihej midis maleve Pajkon dhe Lincestit. Dy qytetet me rëndësi ishin Apsalo dhe Orma.

9. Pellagonia, shtrihej në veri të Lyncestit.

Qytete me rëndësi ishin Stimvara, Atalkomen, Bryani dhe Stobi.

10. Mikdonia:

formonte bregun lindor të Vardarit, përreth këtij lumi përfishinte dhe golfin (gjirin) Thermaik, që në antikitet i thoshin Gjirit të Selanikut dhe zgjatej deri në Halqidiqje, ku përfshinte edhe dy liqenet, Bolbe dhe Korones.

Qytetet më me rëndësi ishin: Thesaloniqi, Therma, Apolonia, Arthusa.

11. Halqidiqia: kjo zonë përbëhej prej siujdhesës me këtë emër, e cila lidhej në tokë - vargmalet që quheshin me ermin Anthemus. Qytetet më me rëndësi ishin: Olynthi, Potida dhe Stagiri.

12. Bizalti: kjo zonë ndodhej midis lumit Strimon dhe maleve që u thoshin Bertisko. Qytetet më me rëndësi ishin: Berge, Ossa, Cedili dhe Argili.

13.Sintiku: shtrihej në veri të Bizaltit, rethuar me malet Orbel e Mesapi e Cercim Disoro. Qytetet më me rëndësi ishin Herakle dhe Garesko.

14.Odomantiku: shtrihej midis Nestros dhe Strimonit. Qytetet më me rëndësi ishin Skotussa dhe Sirio.

15.Edonidi: shtrihej midis buzës së detit Odmantikut dhe lumit Nestos. Malet e Pangjes, të të cilët nxirrej ari, përfshiheshin në këtë zonë. Kjo zonë kishte shumë koloni greke. Qytetet më me rëndësi ishin: Amfipoli, Eion, Pergama, Filipes.

Para se të arrijmë në thelbin e çështjes, për të mos e ngatërruar çështjen(tezën) pikë së pari duhet të dimë se në Maqedoni që nga kohët e vjetra ka pasur koloni greke, për të cilat

nuk ka aspak dyshim nga askush. Këto koloni janë më tepër afër detit dhe dallohen nga emrat e qyteteve menjëherë, sepse kanë ngjyrime greke. Qytetet e Maqedonisë që ndodheshin në brendësinë e këtij vendi, kanë emra që i afrohen më tepër shqipes se sa greqishtes. Së pari fillojmë nga emrat e kryeqyteteve të Maqedonisë. E para ka qenë: Evise, emër i cili është thjesht shqip dhe që i përgjigjet traditës historike sipas së cilës stërgjyshi i Filipit II dhe Aleksandri duke qenë pranë një princi ilir, u ndanë me lejen e këtij dhe, sipas dhuratës që i bëri princi duke i thënë se do t'u jepet një dhi dhe deri ku të qendronte kjo, atë tokë do t'ua falte atyre, d.m.th se fusha e dhisë u bë vendi i kryeqytetit maqedonas.

Kryeqyteti i dytë i Maqedonisë ka qenë Pela. Dhe, kjo është një fjalë shqipe që s'ka nevojë ta zbërthejmë. Disa thonë se ajo shkruhet me dy "LL", prandaj nuk rrjedh nga "Pela", por sido që të jetë gjuha shqipe, ka dhe "L"-në e trashë, pra "LL"- në. Veç kësaj, rrënja e fjalës "pelë" i afrohet më tepër rrënjës shqipe, kemi fjalën "pjell", "pjellore" dhe fjalët "pellet ", "pellon" që përdoret vetëm në Myzeqe.

Tani do t'i marrim emrat e krahinave me radhë.

ELIME: çuditërisht fjalë shqipe, se në librat klasike greke shkruhet me "y", e cila mund të këndohet edhe "Elyne, fjalë që ka formën shqipe dhe me shenjën e mbiemrit femëror "e" lyme ose lime, njëra nga të lyerat , tjetra nga të limuarit.

Edhe emri i qytetit Eane rrjedh nga fjala Anë.

Vargu i kodrinave dhe i maleve që shtrihen mbi Vodenë, Negoshë, Karaferie, quheshin që moti brigje.

Emri i vjetër i Karaferjes është shkruar Beroja, e cila në gjuhën shqipe ka kuptimin e një dhie ose dele që nuk ka pjellë.

Emri i liqenit që ndodhet në veri të maleve të Halqidiqjes , është Bolbe.

Në gjuhën shqipe, sidomos në dialektin (të folmen) e Elbasanit ka kuptimin e njollës, leqes ose gjësë së turbullt. Sipas mendimit të Louis Beloev-it, fjalët (emrat) Pellagonia dhe Argo janë shqipe.

Pellagonia vjen nga plakomia dhe Argo nga argoma. Të këtillë emra janë shumë, që kanë një karakter më shumë shqip se sa greqisht.

Shpeshherë në historiografinë botërore shtrohet pyetja: Kush ishin maqedonët e lashtë?

Kësaj çështjeje të ndieshme më së miri i përgjigjet studiuesi dhe historiani i madh kroat, Dr. Petar Lisiar, në veprën "Grci i Rimjani" (Grekët dhe Romakët), ku midis tjerash thotë:

"Maqedonët e lashtë janë popull indoevropian që janë formuar nga grupe etnike ilire dhe pjesërisht nga fise trake dhe më pak helene, rreth shekullit të VIII p. e.s. , të cilët formuan shtetin e tyre në territorin: në veri të Tesalisë rreth lumit Haliakomona (Bistrica e sotme), në prapashpinën e gjirit të Termeit (Selanikut)", ndërsa në "Historinë e popujve jugosllavë" (Historia Naroda Jugosllavije), v. I, Zagreb 1953 f. 21, lexojmë se:***" ...maqedonët e lashtë janë padyshim me prejardhje ilire ndërsa më vonë helenizohen."***

Pra, maqedonët antikë (greqisht Makedones) janë popull i ri indoeuropian, të cilët u formuan nga grupet etnike ilire dhe të tjera dhe rreth shek. VIII p. e. s themelojnë shtetin e tyre në territorin në veri të Thesalisë, rreth lumit Haliakomona dhe në prapashpinë të gjirit të Termeit.

Në veri kufizoheshin me fiset tjera ilire të linkestëve, pellagonëve dhe peonëve, në lindje arrinin deri tek lumi Struma, ndërsa në perëndim deri te malet e Pindit. Maqedonët e lashtë nuk përmenden në këngët (Epet) e Homerit në "Iliadën" as në "Odisea". Dëshminë më të vjetër letrare të emrit " maqedon " e gjejmë në shënimet mitike të Hesiodit se:

"Maqedoni është i biri i Eolit". Kjo është gojëdhënë mitike mbi lidhjet e maqedonëve me eolët grekë, ndoshta me emrin e tesalëve fqinjë.

Sipas Herodotit, dorët rrëzë Malit Pind, dikur quheshin maqedon.

Nuk është pa vlerë (rëndësi) thënia e Herodotit mbi vëllezërit Temenidë, të cilët vijnë nga Arga e vendosen në Iliri, me pas në Maqedoni dhe aty falë rrethanave momentale

themelojnë shtetin e tyre maqedonas. Sipas një legjende, thuhet se aty nga fundi i shekullit VIII p. e .s. në atë kënd të Ilirisë së lashtë, ku sot gjendet kufiri mes Bullgarisë, Greqisë dhe Shqipërisë, jetonin tre vëllezërit Temenid: Gauani, Eropi dhe Perdika. Ata pretendonin se kishin prejardhjen nga heroi i Argivit, Temeni i biri i Aristomakut, i Kleodemit, i Hylosit i Herakliut të fuqishëm ose i Herkulit, siç e thërrisnin romakët, pra biri i perëndisë më të lartë, i Zeusit.

Thuhet se tre vëllezërit kishin ardhur nga Argosi që ndodhej në bregun lindor të Peloponezit.

Përderisa edhe në këtë pjesë të Ilirisë gjendej një vend i quajtur Argos, emër që në gjuhën maqedonase d.m.th, "fushë" ka mundësi që lidhja me Argosin e Peloponezit t'i përkasë një faze më të hershme të historisë së familjes. Vëllezërit Timenidë shtegtojnë drejt lindjes në kërkim të fatit. Më në fund arritën në një vend sipër në veri të gjirit të Tesalonikit, hynë në shërbim të sundimtarit të një qyteti të vogël të quajtur Lebea, të cilit nuk mund t'i përcaktohet vendndodhja.

Sipas gojëdhënës, Gauni ruante kuajt e sundimtarit, Eropi ruante lopët dhe Perdika më i riu dhe me i zoti i të treve mbikqyrte dhitë, derrat dhe kafshët tjera të imta. Pas disa kohësh ranë në sy se kulaçi i Perdikës së hijshëm, racioni i ushqimit qe edhe më i madh se sa i shërbyesve të tjerë.

Sundimtari i fisit dyshoi për ndonjë lidhje (hatërllëk) dhe e pyeti të shoqen, e cila piqte dhe ndante bukën, se si t'a shpjegonte këtë?! Ajo iu përgjigj me gjakftohtësi se edhe asaj i kishte rënë në sy kjo dhe i dukej një mrekulli!

Kulaçi zmadhohej sa po e prekte dora magjiplote e djaloshit. Sundimtari i Lebeas u përgjigj ftohë se atij nuk i pëlqenin magjitë dhe urdhëroi djaloshin e hijshëm (Perdikën) dhe vëllezërit e tij të shporreshin që andej sa më parë.

Tre vëllezërit, thanë pothuaj se njëzëri se ishin gati të niseshin, po t'ua paguante hakun e premtuar. Në vend të përgjigjes sundimtari i fisit, duke treguar një njollë dielli që binte në tokë prej oxhakut të rrumbullakët të çatisë, u tha me ironi: "Ky është i tëri shpërblimi që meritoni"!

Merreni po ua jap!

Legjenda në vazhdim thotë se dy vëllezërit më të mëdhenj shtangën nga kjo përgjjigje e poshtër (e pa pritur), ndërsa Perdika që ishte shkaktari, e vizatoi një qark (rreth) në tokë dhe e rrethoi njollën e diellit. Pastaj i tha sundimtarit se qe i kënaqur me pagën dhe se tani e tutje ai dhe vëllezërit do t'a mbanin veten si zotrinj dhe pronarë të asaj toke brenda viseve që i përkisnin sundimtarit.

Që ta merrte në dorëzim, ai hyri brenda rrethit u këthye me fytyrë nga dielli dhe e zbuloi tri herë "parzmin".

Sundimtari i Lebeas nuk e vuri re gjestin kuptimplotë të Perdikës. Sapo të tre vëllezërit u nisën për rrugë, dikush i tregoi atij çfarë kishte ndodhur. Sundimtari menjëherë dërgoi në ndjekje të tyre, njerëzit e tij me urdhër që t'i sulmonin dhe t'i vrisnin, por pasi ata e kishin kapërcyer lumin, një stuhi që shpërtheu papritur e bëri të pamundur kalimin. Kështu, ndjekësit u detyruan që të hiqnin dorë nga ndjekja e mëtejshme.

Vëllezërit u ndalën në një breg të përmendur, i cili për shkak të trandafilave plotë erë kishte marrë emrin "Lulishtet e Midas" rrëzë Malit Bermion, ku shtrihej një rrip toke e mrekullueshme.

Këtu vëllezërve u shkoi mbarë, ata u bënë njerëzit më të rëndësishëm të bregut. Perdika u zgjodh udhëheqës i asaj treve, e cila sa vinte e zgjerohej dhe menjëherë mori në zotërim pronat e sundimtarit të Lebeas. Ka të ngjarë që Perdika u martua me të bijën e mbretit të vdekur.

Jo vetëm miti, por edhe gojëdhëna tregon se shtëpia mbretërore e Maqedonisë antike, pra dinastia e Argeadëve, e ka zanafillën te Perdika. Ka qenë i fuqishëm edhe mendimi tradicional mbi elementin grek në përbërjen etnike të maqedonëve të lashtë.

Për këtë disa studiues mendojnë se maqedonët e lashtë kanë qenë grekë, të cilët për shkak të izolimit të tyre në aspektin kulturor, ngelën pas grekëve që shtriheshin në jug.

Disa të tjerë janë të mendimit se maqedonët antikë janë një përzierje e fiseve ilire dhe helene. Paraprakisht, populli i lashtë

maqedon nuk ka qenë grek ose helen, gjë që provohet me argumentet e poshtëshënuara:

1. Në fjalimet e oratorit grek me famë Demostenit, shohim shpeshherë fjalën "barbar", e cila në greqisht është sinonim me fjalën "i huaj".

Kjo fjalë kundër maqedonëvee është përdorur dy herë nga ana e historianit grek, Tukididi, si një fjalë që ka dalur nga goja e Bresidas në kohën e luftës së Peloponezit (431-404 p.e.s.)

2. Në kohën kur persianët sulmuan Greqinë, duke kaluar prej Maqedonisë, mbreti i këtij vendi megjithëse mbeti asnjanës, neutral, i vëllai natën u dha lajmin grekëve për lëvizjen ushtarake të persianëve të Darit I. Si shpërblim kundrejt këtij shërbimi, grekët i dhanë titullin: "Philohelen", d.m.th filogrek, titull që u jepej të huajve kur i shërbenin Greqisë.

3. Grekët, sado që të kishin qeveri të ndryshme, pra polise (qytet-shtete), kishin edhe mbledhje fetare e nacionale të ndryshme, ku merrnin pjesë të gjithë grekët, por të huajt ishin të ndaluar të merrnin pjesë.

Në këtë mënyrë maqedonasit si të huaj nuk figuronin në mbledhjet panhelenike (gjithëgreke) që quhej "Amphyction". Filipi II, i ati i Lekës së Madh, me fuqinë e armëve u bë anëtar i kësaj mbledhjeje.

4. E tërë popullata që formonte kombin helen (grek) ka pasur tradita, mitologji, histori, etj,. Maqedonasit antikë të tilla gjëra nuk kanë pasur.

5. Në kohën e Aleksandrit kur dënohej ndonjë gjeneral, sipas zakonit lipsej të gjykohej para ushtrisë dhe të mbronte veten. Kur gjenerali Filota u gjykua përpara ushtrisë, deshi të fliste në dialektin e Athinës, d.m.th me dialektin atik, por Leka i Madh i tha të fliste maqedonisht.

Nga kjo merret vesh se populli i Maqedonisë, i përfaqësuar në këtë rast prej ushtrisë, ka pasur në gjuhë të veçantë dhe kësisoji gjuhën kulturale të Athinës nuk e merrnin vesh.

Atëherë, del çështja se ç ’janë maqedonasit kur nuk kanë qenë grekë? Gjeografi dhe historiani i madh grek, Straboni nga Ponti (63 p. e. s. - 20 e. s.), thotë se:

"Maqedonia formon një paralelogram, i cili zgjatet deri në Adriatik, duke marrë edhe Korfuzin brenda e duke vazhduar udhën Egnatia".

Sipas thënieve të Strabonit:

"Ndenjësit e këtyre vendeve përdorin një gjuhë, një rrobe dhe njësoj kësule".

Profesor Oto Muleri thotë:

"Mbretërit e këtyre tri provincave: Epir, Iliri dhe Maqedoni, veshnin një lloj rrobash dhe ishin lidhur me krushqi e me gjini përherë në mes tyre, kështu nunela e Aleksandrit të Madh ishte ilire dhe e ëma, Olimpia, prej Epiri nga dera e Pirros".

Historiani romak, Kurt Rufi, që jetoi dhe punoi në shekullin I të e. s., në veprën e tij ,"Historia e Aleksandrit të Madh" në 10 libra, mes tjerash gjejmë të dhëna shumë interesante për studimin e periudhës së Lekës së Madh, ku ndër të tjera mësojmë se: ***"Gjuhën e Aleksandrit ushtarët e tij helenë nuk e merrnin vesh".***

Ndërkaq, përsëri, Straboni, thotë:

"... Akoma, edhe sot Maqedoninë dhe një pjesë të Thesalisë e mbajnë barbarët, si molosë dhe thesprotë e të tjerë".

Dion Kasi (155 - 235 e.s.), histirian i madh grek i epokës së Perandorisë Romake, me veprën "Historia romake" në 80 libra, që dallohet për pasuri faktesh dhe pë pështkrimin e gjërave.

Për historinë e Ilirisë vepra e Dion Kasit ka një rëndësi të madhe, sepse në të gjejmë një mal të dhënash mbi fushatën e Pirros në Itali, mbi luftërat iliro-romake qëndresën e ilirëve kundër pushuesve romakë.

Ndër të tjera po veçojmë:

"... vetëm ky vend, që quhet Maqedoni, ish i ndenjur (banuar - n. d.) prej barbarëve: ilirë dhe bardhë".

Kronisti bizantin Halkokondili thotë:

"Këta trima, që quhen arbanë, janë popull maqedon".

Sa i përket gjuhës maqedone, Otfried Müller në veprën e tij "**Ueber die Ëohnsitz, die Abstammung und die altere Geschicht des Makedonischen Volkes"**(1825), thotë:

"Maqedonët në vend që të flasin si grekët e tjerë, shkronjave* f, h, th *u thonë* b, g, d, *ashtu si popujt barbarë, fqinjtë e maqedonasve, e sidomos ilirët".

Historia e lashtë e Maqedonisë antike është pak e njohur. Megjithatë, veprat e pakta të shkruara burimore, si edhe materialet e gjetura arkeologjike, na japin dëshmi e mundësi për të gjykuar për historinë e Maqedonisë së lashtë.

Historia e Maqedonisë antike kryesisht ndahet në dy periudha:

a. periudha legjendare, që mbështetet kryesisht në të dhënat gojore deri në vitin 500 p. e. s.,

b. periudha historike, fillimi i shek. V p. e. s., deri në vitin 148 p. e. s.

Rrënjët e popullit të lashtë maqedon zënë fill në fillim të mijëvjeçarit të parë p. e. s., por ende janë të mbuluara me misteriozitetin e parahistorisë. Për fat të mirë shumë shkrimtarë të antikitetit i kanë shënuar ose evidentuar gojëdhënat, mitet dhe legjendat, që megjithëse janë pak narrative (përshkruese), ose pak a shumë me karakter mitik (legjendar), megjithatë ato na japin të dhëna tepër me rëndësi për errësirën parahistorike maqedone.

Sipas gojëdhënës, Eponimi, udhëheqësi fisnor i maqedonëve të lashtë është Maqedoni. Për origjinën e tij, burimet ofrojnë versione me bollëk e të llojllojshme si: Heroi mitik (legjendar), themeluesi i Maqedonisë ishte bir i perëndisë së Zeusit të fuqishëm (mendimit, trurit), zotit suprem të të gjithë hyjnive dhe perëndeshës së kohës, Hronosit.

Legjenda thotë se nëna e tij ka qenë Tija, e cila ishte e bija e Denkalionit dhe Pirit. Këta të dy (Denkalioni dhe Piri), i lindën Amfiktion, Helenin dhe Magnetin.

Edhe Maqedoni ka pasur dy djemë: Pierin dhe Emat-in, heronjtë eponim të dy krahinave në Maqedoninë antike, Pieria dhe Ematia.

Sipas një legjende të dytë: Maqedoni ka qenë biri i Perëndisë së Egjyptit, Ozirisit, ndërsa për vëlla ka pasur Anubisin. Atributi karakteristik i Maqedonit ka qenë Ujku, ndërkaq i vëllai i tij Anubisi ka pasur Qenin. Ozirisi ia lëshoi pushtetin e Egjyptit Izidës, duke u nisur për pushtime të reja, i shoqëruar nga dy djemtë e tij, Maqedonin e Anubisin.

Në Thraki, Ozirisi arriti të vrasë mbretin Likurg, të cilin e zëvendësoi me të birin Makedonin, i cili u bë mbret i kësaj treve.

Vendi ku sundonte i biri i Ozirisit u quajt MAQEDONI. Sipas një legjende tjetër Maqedoni ishte njëri prej 50 bijve të mbretit Liakon, që sundonte në krahinën Arkadis (Peleponezit).

Legjenda e katërt thotë se Maqedoni ishte njëri prej bijve të Eol-it, eponim i heroit të eolëve, ndërsa vëllezër të tij ishin Pieri, Magneti, etj.

Kuptohet, se në këto raste duhet të jemi tepër të kujesshëm në orvetjet për të interpretuar gojëdhënat e legjendat e lashta, edhe pse përvoja na ka mësuar se secila prej tyre, përmban një fije shkëndije të vërtetë. Domethënia linguistike e emrit Maqedon është si vijon:

Emri Maqedoni rrjedh nga Makednos, që e hasim për herë të parë te Homeri, me kuptimin: ,,shtrat i mirë" ose ,,tridhje, i lartë ose i ngushtë". Këto fjalë e kanë të njejtën rrënjë me fjalën ,,makro" ose i lartë. Shtesa Maked - onia është sufiks me prejardhje ilire ose trako - frige, që e definon tërë emrin Maqedoni, që do të thotë "tokë e lartë".

Me një fjalë, emri Maqedoni do të thotë vend i lartë, kodrinor-malor, e cila kishte të bëjë para së gjithash në një rajon të Maqedonisë së Epërme në rajonin e Orstidës (Kosturit), prej nga nis dinastia e parë mbretërore maqedonase e argeadëve, e cila kohë pas kohe i ka zgjeruar territoret me pushtime të tjera. Në bazë të analizave paleolinguistike, madje edhe të burimeve historike, legjendave të lartshënuara, gojëdhënave dhe gërmimeve arkeologjike, studiuesit seriozë që nuk janë të paktë, që merren me gjenezën e popullit të lashtë maqedonas, kanë ardhur në disa teza.

Studiuesja, Barbara Jelavich(”Historia e Ballkanit”, vëll. I, Tiranë 1999, f. 20) do të shprehet: **”R*rënjët etnike të maqedonëve të lashtë qenë, sipas të gjitha gjasave ilire, megjithëse në atë kohë shtresa e lartë kishte rënë nën ndikimin e kulturës greke”.***

Albanologu shqiptar, prof. Eqrem Çabej („Studimet gjuhësore”, III, Tiranë 1976, f. 52), thekson:

”Prandaj në Ballkanin e vjetër më shumë se me kufi gjuhësorë, kemi të bëjmë me kufi kulturash. Duke shikuar çështjen në dritën e këtij realiteti, do të përfundojmë se krahas me dy gjuhët klasike të gadishullit u mbajtën gjallë, sidomos nëpër krahinat malore, elementi autokton edhe në shekujt e mëpastajmë”.

Këtë gjë e vëneron gjatë shek. XIX në veprën kapitale “**Historia e Romës”** (f. 185) historiani i madh, Teodor Momzeni, i cili në mes tjerash shton se: ***”Viset ballkanike që në kohën romake krahinat e brendshme të Maqedonisë, krahas greqishtes dhe latinishtes, duhet të jetë e ruajtur edhe gjuha e popullit, ilirishtja”.***

Studiuesit Todi Dhamo dhe Faik Lama, njohës dhe ekspertë të historisë së antikitetit ballkanik, në veprën “Historia e Kohës së Vjetër”, (vëll. II, Tiranë 1992, f. 128), në mes tjerash do të shprehen: ***”Popullsia e Maqedonisë që përbëhej nga fise ilire, thrakase dhe nga disa fise të afërm me grekët, banorët e Maqedonisë flisnin një gjuhë të afërt me greqishten, por megjithatë të pakuptimshme me grekët...”***

Studiuesi arbëresh nga Zara, Aleksandër Stipçeviq, në veprën “ILIRËT” (faqe 39) do të shprehet se: **”N*ë viset e brendshme jetojnë një varg fisesh, disa prej të cilëve na janë fare mirë të njohur nga burimet historike dhe epigrafike”.***

Duke shkuar nga jugu kah veriu i hasim së pari maqedonët, për karakterin etnik të të cilëve është diskutuar shumë në shkencë.

Grekët, deri në shek. VI-V p. e. s. i radhisnin në mesin e popujve barbarë.

Në vitin 1854 albanologu i famshëm gjerman, Hahn, që me të drejtë shikohet si themeluesi i shkencave albanistike, i

formulon këto teza: "**Epirotët dhe maqedonët edhe në kohën e Strabonit ishin jogrekë ose barbarë, epirotët, maqedonët dhe ilirët janë farefis në mes tyre. Ka shumë shenja që shqiptarët e maqedonët përbëjnë thelbin e fisit tireno-pellazgjik, skajet e mëtutjeshme të të cilit në Itali e në Thraki hyjnë brenda në histori, ilirishtja është gjuhë pellazgjike në një kuptim më të gjërë".**

Me këto teza albanologu gjerman, Hahn, te ilirët, si paraardhës të shqiptarëve, përfshin edhe epirotët e maqedonët e lashtë, pra të gjithë këta popuj i bën të ardhur nga pellazgët.

Teza e afërsisë së epirotëve, ilirëve dhe maqedonëve është sot një mendim i pranuar pothuajse gjithkund, sepse edhe ato pak dëshmi që kanë ngelur nga gjuhët e këtyre popujve, flasin qartë për një afërsi të tillë. (Prof. E. Çabej "Studime gjuhësore III", f. 43 - 44).

Në fillim të shek. XX Edit Durham në ,,Brenga Ballkanike" (Tiranë 1998, f. 7 - 8) do të shkruante: ***"Dihet se Gadishulli Ballkanik në krye është banuar nga fise ilire, trake e maqedonase, popuj barbarë, pra jogrekë. Ishin një mori fisesh të egra nga prijësit e tyre që duhet të kenë qenë mjaft të afërt si racë. Trajta e gjuhëve të tyre nuk njihet".***

Herodoti thotë se ***"Në qoftë se trakasit do të kishin qenë nën sundimin e një personi të vetëm ose të bashkuar me njëri - tjetrin, për mendimin tim do të ishin të pathyeshëm. Por, kjo ishte e pamundur".***

Dhe ai, Herodoti, ka plotësisht të drejtë në vlerësimin që u bën këtyre popujve. Filipi II i Maqedonisë i shkriu këto fise të egra në një fuqi të vetme, ndërsa trakët, maqedonët e ilirët u bënë themel i ushtrisë ngadhnjimtare të Aleksandrit të Madh. Ballkani është vendi ,,i perandorive të një njeriu", perandori të cilat rrojnë sa është gjallë njeriu që e kanë në krye. Vet perandoria e Aleksandrit nuk e pati jetën e gjatë, pasi vdes në vitin 323 p. e. s. Megjithëse ka kaluar një kohë e gjatë ende, është i gjallë në mesin e njerëzve, gjaku i të parëve u vlon në deje.

Besoj se tashmë nuk vehet në dyshim fakti se shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të atij populli të egër e

primitiv të Ballkanit. Aleksandri i Madh ishte maqedon dhe Olimpia, nëna e tij, ishte princeshë epirote, pra s'ka dyshim se Aleksandri ishte shqiptar. Deri këtu jemi në rregull, por gjithnjë është thënë se nga i ati kishte prejardhje greke, vërtet të largët, por që grekët e kanë pranuar.

Ambasadori amerikan, George Fred Uiliams ("The shkypetars", Tiranë 1999), në Athinë e Mal të Zi në vitet 1912-1914 do të shtonte se: ***"Në kohët prehistorike, para se poeti Homeri të këndonte për zotërat e tyre dhe heronjtë e përrallave, përpara se të shkruhej gjuha greke, rronte një popull i quajtur pellazg. Herodotus, u hedh pellazgëve historinë, e cila këto i përmend shumë më përpara se sa civilizimin e grekëve dhe se punimi i ashpër që mbulon anët e Pantenonit në Athinë, akoma quhet pellazgjik".***

Këto mure të mëdha, që ne i quajmë Cyklopean dhe për të cilat thotë profesor Pot që, qenë ndërtuar shumë përpara se të ekzistonin grekët e Homerit. Prej kësaj race të fortë prehistorike mbetën vetëm shqiptarët. Vetëm në kohët më të vona u shkoqit se pellazgët qenë ilirët e vjetër, e para degë indoevropiane, perandoria e të cilëve shtrihej që nga Azia e Vogël e deri në Adriatik e nga veriu deri nëDanub. Nga studimet e shkencëtarëve, si prof. Pot e prof. Max Miller, në gjuhën shqipe u stabilizua kjo origjinë. Këta ilirë u shpërndanë edhe në Itali, si në Toskani (Toscs, Toscans, Etruskans e në Shqipëri njihen si Toskë)... shqipja qe gjuha amtare e Aleksandrit të Madh, që zaptoi botën dhe e Pirros së Epirit, një nga gjeneralët më të mëdhenj që përmend historia. Historiani romak, Justini, bashkëkohës i perandorit August Oktavianit, në vitin 9 p. e. s. në Romë boton ,,Historia Philippicae" në 44 libra, ku në mes tjerash shënon se ***"edhe populli i Maqedonisë quhej pellazg".***

Duke shfletuar historinë e popujve ugosllavë ("Historia Naroda Jugosllavije", vëll. I, Zagreb 1953, faqe 21) në mes tjerash, veçojmë se ***"...në kohën e Aleksandrit të Madh Maqedonia përfshinte Maqedoninë e Egjeut, Thesalinë, Halkidikun, një pjesë të Epirit, një pjesë të R. P. të Maqedonisë, afërsisht deri te linja që shkonte nga liqeni i Ohrit deri te Manastiri, ku shtriheshin***

peonët, aty ndikimi grek ishte më i madh. Populli maqedon është me siguri me preardhje ilire, të cilët me të madhe me vonë u henelizua".

Mendoj, se ky studim modest për Maqedoninë e lashtë do të ishte i zbehtë nëse, nuk i shfrytezojmë të ariturat shkencore të prof. Shaban Demirajt në studimin "Prejardhja e shqiptarëve" (Tiranë, 1999), ku në mes tjerash shkruan se: ***"Por, ndërsa për grekët e vjetër dhe për gjuhën e tyre kemi të dhëna relativisht të pasura, për popujt të tjere indoevropianë të Ballkanit dhe për gjuhën e tyre në lashtësi, njohuritë tona janë shumë të pakta, për mungesë dokumentash dhe të dhënash të tjera të mjaftueshme. Prandaj, do të vihen ato të dhëna që kemi mbi ata popuj të lashtë të Ballkanit dhe mbi gjuhët e tyre. Një parashtrim qoftë edhe i përmbledhur, është i nevojshëm për të ndriçuar më mirë çështjet që do të trajtohen lidhur me stërgjyshërit e shqiptarëve dhe me gjuhën e tyre. Dhe po e nisim me fqinjët me të afërt të grekëve të vjetër dhe pikerisht me fqinjët e tyre veriorë".***

Pyetja për fqinjët veriorë të grekëve te vjetër dhe gjuhëve të tyre, paraqitet tejet e vështirë, gjithnjë për mungesë dokumentimi të mjaftueshem. Informatat që na kane aritur për ta i kemi kryesisht nga autorët e vjetër grekë e romakë. Për autorët e vjetër grekë, jo vetëm trakasit dhe ilirët, por edhe maqedonët dhe epirotët ishin "barbarë", jo grekë - Katici, 1976, faqja 100-107.

Duke u mbështetur edhe në intepretimet e atyre pak "glosave" dhe toponimeve, studiuesit janë ndarë dysh. Për disa nga këta, ata nuk kanë qenë grekë, por natyrisht kanë pasur një ndikim të fuqishëm prej fqinjëve të tyre jugorë, që kishin një kulturë shumë më të zhvilluar.

Kurse, sipas studiuesve të tjerë, ato kanë qenë fise greke, që flisnin një gjuhë dialektore disi të ndryshme nga ajo e grekëve të tjerë. Në këto rrethana duhet mbajtur një qëndrim të matur, duke u mbështetur sidomos në analizën e atyre pak elemneteve që kanë mbetur prej maqedonishtes së vjetër dhe prej gjuhës së të ashtuquajturve epirotë. Duke pasur parasysh se gjuhët indoevropiane në përgjithësi kanë qenë me afër njëra-tjetrës, sa më shumë të ngjitemi në lashtësi, e kjo vërejtje vlen edhe për

gjuhët e popujve indoevropianë, që erdhën dhe u vendosën në trevat ballkanike. Për më tepër edhe kufijtë etnikë dhe gjuhësorë në Ballkanin e lashtë nuk kanë qenë të palëvizshëm nga koha në kohë. Për maqedonët e lashtë dihet se gjatë shek. V- IV p. e. s formuan një mbretëri që arriti kulmin e madhështisë së saj me Lekën e Madh (356-323 p.e.s). Kjo mbretëri që në fillim pati kryeqendër, Aegae(Edesa) dhe më pas Pella që shtrihej në rrjedhën e poshtme të lumit Vardar (Axios), në veri të malit Olimp, në lindje të malit Gramoz dhe të liqenit të Ohrit. Në lindje ishin vendosur trakët dhe në veri fisi i peonëve, të cilët shumë studiues i mbanin për fis ilir. Por, kufijtë e mbretërisë maqedone kanë ndryshuar nga koha në kohë si rrjedhim i pushtimeve të saj. Pyetjes a kanë qenë maqedonasit e lashtë grekë apo jo, i kanë dhënë dy përgjigje te kundërta. Sipas qëndrimit të disa historianëve grekë të lashtësisë, ata ishin barbarë(pra jo grekë). Vet grekët e vjetër në përgjithësi i mbanin ata për barbarë.

Mjafton të përmendin këtu kritikat e Demostenit kundër Filipit I të Maqedonisë, të cilin ai e konsideron barbar. E njëjta pyetje është shtruar natyrisht edhe për gjuhën që flisnin maqedonët e vjetër, nëse ajo ishte një gjuhë në vete apo ishte një dialekt i greqishtes. Edhe për këtë pyetje, ashtu siç pritej përgjigjet, kanë qenë të kundërta. Sot për sot nga maqedonishtja e vjetër janë zbuluar vetëm një numër "glosash" të shkëputura, të cilat pjesërisht janë interpretuar si huazime nga greqishtja, por pjesërisht nuk janë gjegjëset e tyre në greqishte, por ndryshojnë prej tyre në trajtën fonetike, në një masë të tillë që i kalon shumë kufijtë e variacionit(lëvizjes) dialektore në greqishten e vjetër(Radosllav Katiçiq "Ancient languages of the Balkans" 1976, f. 104). Por, është vënë në dukje edhe ndonjë pikë takimi. Kështu, mbi bazën e atyre pak materialeve të disponueshme, siç shprehet prof. Shaban Demiraj, "është arritur në përfundimin që maqedonishtja e vjetër ishte një gjuhë e tipit "kentum", ashtu si greqishtja. Por, ajo ndryshonte nga greqishtja në reflektimin e bashkëtingëlloreve të aspiruara indoevropiane. Gjithashtu janë vënë re edhe ndryshime të tjera të rëndësishme, si prani e zanores "a" në maqedonishte, përkundrejt zanores "o" në

greqishte, prania e bashkëtingëllores "v" në maqedonishte, përkundrjet "p/h" në greqishte etj.

Këto ndryshime të karakterit fonetik do të dëshmonin më fortë në të mirë të mendimit të atyre dijetarëve që e konsiderojnë ose e ndajnë mendimin se gjuha maqedonishte, si gjuhë indoevropiane më vehte, që ndryshon nga greqishtja, por, natyrisht me ndikime të fuqishme të kësaj të fundit, sidomos pas epokës së Lekës së Madh. " Për të qenë edhe më konkret në çështjen që po trajtojmë, rreth gjuhës së maqedonëve të lashtë, do të ndalemi pak në kohën e Lekës së Madh, mbështetur gjithnjë në fakte burimore: Kuint Kurtusi na jep një dialog midis Lekës së Madh dhe gjeneralit të tij, Filotës, të akuzuar për tradhëti të lartë: Leka e pyet Filotën, nëse donte të mbrohej në greqisht apo maqedonisht për të qenë sa më autentik.

Po japim fragmentin që flet për këtë ngjarje: Mbreti, atëherë, duke e shikuar në sy Filotën, tha: "Do të gjykojnë maqedonasit. Unë, të pyes nëse ti do t´u flasësh atyre në gjuhën amtare".

Filota, atëherë u pergjigj: "Përveç maqedonëve, ka mjaft njerëz që, për mendimin tim, i kuptojnë mjaft leht fjalët e mia, nëse unë përdor gjuhën që ty të ka shërbyer pa ndonjë qëllim tjetër, mendoj që fjalët e mia do të bëhen të kuptueshme për shumë dëgjues".

Mbreti atëherë, tha: "Po shihni deri në ç´pikë ka mbërritur përbuzja e Filotës për gjuhën tonë amtare? Padyshim është i vetmi që nuk denjon ta mësojë atë, por, që ai të flasë ashtu siç i pëlqen, duhet që ju të thoni se zakonet tona dhe gjuha jonë i shkaktojnë atij të njejtën neveri".

Kjo bisedë midis Aleksandrit (Lekës) të Madh dhe Filotës zbulon qëndrimin antipatriotik të Filotës, që përbuz zakonet dhe gjuhën maqedone, duke qenë vet maqedon. Filota detyrohet nga vet Aleksandri të rrëfehet (pronocohet) publikisht.

G. J. Hahni thotë me të drejtë: ***"A do t`i binte ndërmend ndonjë gjenerali gjerman që në raste analoge t´i bënte pyetje të akuzuarit, nëse për mbrojtjen e tij do të zgjedhte dialektin e gjermanishtes në vendet e ulëta, apo gjuhë letrare?"***

Pra, shihet qartë se *gjuha maqedone nuk ishte një dialekt i gjuhës greke i vështirë për tu kuptuar, por rrënjësisht i ndryshëm prej gjuhës greke.*

Në një moment tjetër një oficer maqedon i quajtur Bolon, trim e fshatarak, akuzon gjeneralin Filota për atë se: **"gjithnjë tallet me maqedonasit harbutë, duke i thirrur me emra nënçmues frigjanë e pafllagonas".** Ai, Fillota, nuk i pranonte ata duke qenë vet maqedonas qysh në lindje, nuk pranonte as t`i dëgjonte e as të fliste me ta. Ata i takonte vetëm në ato raste, kur maqedonët shoqëroheshin me një përkthyes". Ky fragment tregon qartë se Fillota e kishte harruar gjuhën amtare (maqedonishte) edhe në komunikimin e tij me maqedonët, që nuk flisnin greqisht, përdorte përkthyes. Ndërkaq, Plutarku, historiani, filozofi dhe moralisti i shquar dhe njeriu më i ditur i kohës së tij, (46 - 120 e.s.), autor i shumë veprave, e në veçanti i "Vitae Paralele" (biografitë paralele) në "Jeta e Aleksandrit", 51, 4, shkruan se ***"Aleksandri në zënkën që ndodhi në Marakanda me gjeneralin dhe mikun e tij, Klitin, që përfundoi me vdekjen e këtij të fundit, thirri në maqedonisht rojet e tij".***

Por, i njëjti autor te "Biografia e Eumenit" 14, 5, pohon se ***"Maqedonët e Aleksandrit, që luftonin në atë kohë nën urdhërat e Eumenit, gjatë luftës civile që zhvillohej në mes atij dhe Antigonit", nderuan në maqedonishte gjeneralin e tyre".*** U përkujtojmë historianëve grekë, po edhe atyre sllavomaqedonas, që nderimi bëhej duke përdorur fjalë që tregojnë stime, respekt, veneracion dhe në këtë rast (është fjala për Eumemin), "ato fjalë u thanë në gjuhën maqedonase". Këtë e dëshmon prof. Sherif Delvina në veprën, "E vërteta mbi Epirin", faq. 138 - 139, botuar në "Rilindja", 19 mars 1994.

Në një pasazh tjetër Plutarku na tregon se ***"Ptolomenjtë nuk kanë dashur të mësojnë në gjuhën egjiptiane dhe disa prej tyre e kanë harruar gjuhën maqedone".***

Studiuesi i madh gjerman, G. J. Hahni në "Albanischen Studdien", Ëien, 1854, prononcohet se ***"Pa qenë nevoja që të marrim në ndihmë filologjinë, por vetëm korrespondencën e thjeshtë të të dhënave të marra prej kohës së lashtë, sot na***

lejohet që të nxjerrim konkluzionin se epirotët dhe maqedonët bëjnë pjesë në fisin e madh ilirian".

Dr. J. Ph. Falmerayer në "Elementi shqiptar në Greqi", Mynhen 1861, shkruan **se** ***"Maqedonasit e vjetër, fitimtarë të Athinës dhe Babilonisë, kishin farefisni gjaku dhe gjuhe me shqiptarët epirotë–ilirë".***

Më tej Falmrayer vë në dukje se ***"Në veprat e mëdha të Aleksandrit në Granik, në fushën e Arbelës, etj, helenëve nuk u takon pjesë e lavdi se sa, të themi, në ditët tona për trupat federale të Rhinit në fitoret e Napoleonit në Austrelic, Friedland dhe në Moskë. Edhe në vet kohën e Aleksandrit, maqedoni i vendit nuk mund të merrej vesh me një grek nga Peleponezi dhe Atika, pa pasur ndihmën e një përkthyesi".***

Historiani grek, Apiani (shek. I - II p. e. S.) nga Aleksandria, autor i "Historia e Romës", në 24 librat në një vend do të shprehet se: ***"Panonët ishin fis ilir, japodët, istrët, dalmatët, liburnët, dardanët, ardianët, autarianët, (me një fjalë të gjithë popujt deri në malet Karaune), përgjithësisht njiheshin si ilirë. Por, ata gjendeshin kudo në Epir, Thesali e në Maqedoni".***

Ende në Epir banonin vetëm popujt jogrekë, të cilët flisnin në gjuhën maqedone, ose e cila është e njëjtë me gjuhën ilire". Këtë e mbështet edhe studiuesi gjerman, Johan Tunmar në "Autoktonia shqiptare në studimet gjermane", Prishtinë, 1990 faq. 59, i cili shton se: ***"Ilirët dhe trakët ishin prej kohësh pupuj kryesorë të Evropës".*** Por, a ishin ata të të njejtit trung apo i përkisnin fiseve të ndryshme. Thrakët dhe Ilirët në lashtësi shiheshin si popuj me zakone të njëjta.

J. Tunman vazhdon: ***"Maqedonët dhe epirotët, të cilët herë pas here i kanë zgjeruar zotërimet e tyre mjaft në thellësi të vendit, ka shumë të ngjarë që të kenë folur të njëjtën gjuhë me ta".***

Dhe, J. Tunman ka një përparësi se në 80 vjetët para G.J Hahnit do të arrinte në të njëjtin konkluzion në idenë se: maqedonët, epirotët dhe ilirët flisnin të njëjtën gjuhë, pra ilirishten. Merita e G.J. Hahnit është se: ***"duke shfrytëzuar të dhënat e autorëve të lashtë grekë e romakë, ai arriti në***

konkluzionin se ilirët, epiriotët dhe maqedonët, si fise të afërme me njëri-tjetrin e me gjenezë të përbashkët, formonin bërthamën e trungut të popujve tireno-pellazgjik, e rrjedhimisht edhe të popullit shqiptar".

G.J. Hahni me një mal argumenesh historike, mitologjike, etnografike, gjeografike e linguistike, e dëshmon edhe përkatësinë etnike të përbashkët të maqedonëve të lashtë me ilirët dhe epirotët. G.J. Hahni, është i pari që gjeti një argument logjik me forcë të madhe bindëse nga fusha e demografisë në të mirë të autoktonisë së shqiptarëve në Kosovë dhe në trevat tjera etnike lindore.

Argumenti i tij teorik është i kësaj natyre: ***"Po të jetë që një kufi gjuhësor është i tillë se njëra gjuhë flitet në male kurse tjetra në fusha që shtrihen rreth tyre, atëherë kjo shpjegohet si pasojë e një pushtimi, kurse gjuha e parë i takon popullit që u praps në male, kurse e dyta (në fusha), atij që erdhi më vonë si pushtues".*** (J.G. Mon Hahn: "Reise von Belgrad nach Salonik" Ëien 1868,faqe 228).

Gjeografi danez, Malterbun (1758-1826), autori i njëres nga veprat gjeografike më me autoritet të shek.XIX, "Precis de la Geographie Univerzale", vëllimi i I - IV, 1810 -1829, Paris, e cila përfundoi së botuari pas vdekjes së tij, në analizën e vet mbi Gjeografinë e Strabonit, thotë: "Etolia dhe Akanania konsideroheshin nga grekët gjysmëbarbare. Për sa i përket Epirit, gjithë autorët grekë të lashtësisë e përjashtojnë nga Greqia. Ai, është përshkruar nga Straboni së bashku me Ilirinë dhe Maqedoninë. Fiset kryesore të tij ishin kaonët,thesprotët dhe molosët, Straboni e Plutarku pohojnë se: ***"Epirotët flasin një gjuhë të veçantë dhe kjo gjuhë është e njëjta me maqedonishten. Me sa duket, gjuha shqipe rrjedh prej saj".***

Edhe udhëpërshkruesi francez, Pukevili, në veprën e tij "Udhëtime në More, Konstatinopojë, në Shqipëri dhe në vende tjera të Perandorisë Osmane", gjatë viteve 1798-1801, botuar në Paris 1805, kur flet për Arkananinë dhe Etolinë, thekson se këto vende në kohën e tij quheshin Shqipëri dhe banorët e tyre quheshin shqiptarë".

Studiuesi korçar, Spiro Kondo (1862-1967), duke njohur të gjitha gjuhët e vjetra të popujve të Ballkanit dhe gjuhët moderne botërore(anglisht, frengjit, italisht, gjermanisht, greqishten e re etj), shkruan veprën kapitale "Shqiptarët dhe problemi pellazgjik", Tiranë, 1962, ku në mes tjerash thotë se": ***"Pellazgët përmenden që në eposet më të hershme të Homerit si një popull hyjnor dhe më i vjetër, si një popull drejtpërdrejt i lindur nga dheu".***

Edhe studiuesi Engjëll Sedaj në veprën "Etnonimi arbëresh-shqiptar", (Prishtinë, 1996 faqe, 18) do të prononcohet se: ***"Epirotët dhe maqedonët edhe në kohën atnike ishin jogrekë, duke u bazuar në dijetarin gjerman G.J.Hahn, epirotët, maqedonët dhe ilirët në mes tyre qëndrojnë në afërsi dhe ky mendim është i pranueshëm sot".***

Duke shfletuar punimet dhe studimet e shumta ku trajton Maqedoninë Antike, tek Prof. Dr. Reshat Nexhipi nga Manastiri, me këtë rast do të ndalemi kalimthi në një intervistë që i jep gazetës "Fakti" më datë 10.07.2000, që në mes tjerash profesori i nderuar shprehet: ***"Kalimthi të kujtoj se gjatë polemikave të mia autorëve maqedonas që pa pikën e turpit kërkojnë ta përvetësojnë Lekën e Madh, iu kam thënë se ata kanë lidhje vetëm sipas mbiemrit të tyre gjeografik, ndërkaq ne shqiptarët mburremi vetëm me përkatësinë ilire të tij, kurse grekët me atë që ai e adhuronte së tepërmi kulturën e tyre dhe mburrej që quhej grek, prandaj edhe fqinji i Jugut (Greqia, N.D) ka vënë këmbë për ndryshimin e emrit Maqedoni". Në polemikat e mia autorëve maqedonas u kam thënë se pa gjuhën dhe alfabetin shqip nuk mund të kuptojnë drejt periudhën më të vjetër të historisë, sepse ajo është e lidhur edhe me periudhat tjera, kështu që historiografia maqedonase sot i përngjet shtëpisë pa themel ".***

Edhe Prof. Dr. Skënder Rizaj në "Diaspora ilire në antike" (Prishtinë 1992) në mes tjerash do të shtojë se: ***"Gjatë fushatës së Lekës së Madh për të cilët ishin pellazge-ilire, në viset aziatike u shpërngulën edhe më shumë tribalë dhe dardanë, të cilët më parë iu nënshtruan Lekës së Madh".***

Hesiodi, poet grek që jetoi ne shek. VIII-VII p. e. s , autor i "punëve dhe dijeve", na thotë: "Dhe ajo, vajza e Deukalionit, lindi dy djem nga Zeusi- rrufehedhësi: Magneti dhe Maqedonasi, Kalorësi dhe Luftëtari, vajza e dytë e Deukaleonit, gjithashtu lindi dy djem: Grekos dhe Latinos. Me këto metafora e mite poetike na dalin vëllezër grekët dhe romakët, thënë me gjuhën e shkencës, është fund e krye absurde, sepse po të besojmë Hesiodin, atëherë maqedonët e lashtë dhe grekët dalin kushërinj. Versionet vijuese në mitologjinë greke rrjedhin nga "Tregimet artistike" të kohës historike. Në to thuhet: Deukalioni dhe Pirro e popullojnë botën në mënyrë jo shumë me të mrekullueshme dhe ndërmjetësinë e birit të tyre, Helenit, i cili u bë stërgjysh i helenëve. Me të drejtë prof. Sherif Delvina shprehet se: **"Është e udhës t´u themi historianëve grekë që origjinën e maqedonasve të mos e ndërtojnë me tregime artistike të lashtësisë, e sa për emrin Maqedoni, mund të themi dy fjalë: koha e gurit nuk njohu emra (popujsh). Emrat dolën në kohën e metaleve".**

Prof. I. Ellis, autor i veprës " Imperializmi maqedonas", pretendon se maqedonët e lashtë para se të vinin në atdheun e tyre në Maqedoni, quheshin maqedonë. Edhe arkeologu i njohur grek, Photis Patas, është i një mendjeje me prof. Ellisin, se Maqedonia e mori emrin nga maqedonët e lashtë. Ky arkeolog pohon se emri Maqedoni ishte fillimisht emër etnik dhe vetëm pastaj u kthye në një term gjeografik dhe historik.

Historianti grek, Tukitidi (460 pas dhe 404 p. e. s) në veprën "Lufta e Peleponezit", libri 4, 124, dëshmon se: "Perdika II, i biri i Aleksandrit I të Maqedonisë, gjatë ekspeditës së dytë kundër Arhabajosit, mbretit të Lynkestëve, përveç ushtrisë së tij maqedone, kishte nën urdhërat e tij edhe kontingjentet e hoplitëve të rekrutuar nga grekët, që banonin në Maqedoni. Tek Pseudo-Skilasi (gjeograf e historian grek i shek. V-IV p. e. s), gjejmë pohimet se në bregdetin maqedon ndeshim qytete maqedonase, pranë qyteteve greke (Polis, Elinidhes). Në lashtësi nuk mund të kishte koloni ose ngujime greke në bregdetin grek.

Dy shembujt e mësipërm flasin qartë se maqedonët nuk janë grekë. Legjenda e preardhjes greke të shtëpisë mbretërore maqedone është një nga shembujt me kuptimplotë të shtrirjes të filohelenizmit në Maqedoni.

E. Borza është autor i veprës "The phihellinism of Archelaus ", ku në mes tjerash shpreh mendimin se trillimi i preardhjes argive (nga Agrosi) i mbretërve të dinastisë maqedone, është krijuar para Herodotit. Ka të ngjarë që Herodoti ta ketë lexuar këtë nga shpikësi i këtij trillimi, pra nga Aleksandri I. Në librin tjetër "Deparament of history Pensylvania state University, USA", E. Borza shkruan: "Me sa duket, asnjë mbret maqedon nuk kishte marrë pjesë në Lojërat Olimpike para Filipit II. Pjesëmarja e Aleksandrit I në ato lojëra ishte thjeshtë propagandë e zhvilluar prej tij.

Burimet hisorike na bëjnë të ditur se Arkelau, nipi i Aleksandrit I, nuk merrte pjesë në lojërat olimpike panhelenike". Me siguri zotërinjtë historianë të sotëm grekë nuk mund t´i përgjigjen dot, se nuk kanë argumente. Grekët në lashtësi nuk arritën të krijojnë bindje se Arkelau rridhte nga Argivetm, prandaj ky mbret gjatë kohës së tij nuk pati kurrë të drejtë të merrte pjesë në lojërat olimpike panhelenike (gjithë greke). Për origjinën (gjenezën) e maqedonasve të lashtë edhe njëherë do t´u referohemi autorëve antikë të kohës te Filipit të II të Maqedonisë:

Demosteni (382-338 p. e. s), oratori më i madh i Greqisë antike, shkoi në Pela në cilësinë e anëtarit të delegacionit të Athinës. i përbërë prej 10 vetash. Gojëtari i dëgjuar, Demosten, ishte 38 vjeç, ndërsa Filipi II i Maqedonisë 36 vjeç. Që të dy këta politikanë ishin pothuajse moshatarë. Në gostinë e shtruar për nder të delegacionit të polisit të Athinës, nga mbreti Filipi II i Maqedonisë, oratori Demosten shpërtheu kundër mbretit me fjalët e tija jo të akrepta, por kuintesenca të së vërtetës që më vonë u shkrua nga ai, (Demosteni), jo me gjuhën nepërkë, po me vërtetësi historike. Fjalët që ju thanë mbretit Filip II dhe popullit (demosit) të Athinës në atë kohë nga Demosteni, quhen "Filipike". Deri më sot nuk është gjetur (me sa dijm) në ndonjë dokument që Filipi II t´i ketë përgënjeshtruar ato. Mund t´u

përgigjemi shovenistëve grekë në mënyrë të paanshme se: ***"Maqedonia kurrë nuk ka qene greke".***

Demosteni, ishte kundërshtar i mbretit Filipi II të Maqedonisë dhe më vonë për këto "Filipike" u detyrua të pijë helmin nga ndjekjet që iu bënë prej Filipit II, duke i dhënë fund jetës së tij në ishullin e Kalaurit pranë tempullit të Posejdonit, në vitin 338 p. e. s, pas betejës së Heronesë, ku ushtritë e bashkuara të botës greke u mundën nga "Falangat", maqedonët të Filipit II.

Dhe me të drejtë prof. Sherif Delvina thotë se:

"E vërteta e thënë prej tij për origjinën e maqedonëve nuk u zhduk me vdekjen e tij, por fitoi pavdekësinë", sepse Demosteni deklaronte:

"Filipi, jo vetëm që nuk është grek dhe asgjë s'e lidh me grekët, por është edhe një barbarist që s'është barbar nga ata që kanë emër të mire, por është një maskara maqedonas që njëherë e një kohë ata nuk i blenin as si skllevër". (Filipika , III , Faqe 119).

Filipin II të Maqedonisë kur e dërguan në Tebë disa vjet si peng, ai atje u mbingop me kulturën helenistike dhe artin ushtarak të Epaminondës, pastaj sipas historisë oborri dhe mbretërit e Maqedonisë kishin marrë që me kohë kulturën (verrnikun) helen. Prandaj bien supozimet (thëniet) që ai quhej barbar, sepse i mungonte kultura helene dhe se me bindje të plotë e themi se ai nuk ishte grek. Autorët e vjetër të lashtësisë i quanin barbarë të gjithë ata që nuk ishin greqishtfolës. Për të qenë edhe më bindës, le të dëgjojmë dhe palën promaqedonase në Athinë. Për këtë kemi zgjedhur oratorin e famshëm bashkohës, Izokratin Athinas me origjinë, që në atë kohë ishte dëshmitar entuziast i ngritjes së Filipit II , në pozitën më të privilegjuar.

Në "FILIPIKËN" 108, Izokrati pohon kështu: ***"Filipi vendosi të mbreterojë (sundojë) mbi grekët që ishin fise jo të trungut të tij"***. (Sherif Delvina "E vërteta mbi Epirin", faqe 132).

Për origjinën e Filipit II, mbretit të Maqedonise, flet edhe antropologjia. Varri i Filipit II mban të skalitur jo vetëm një simbol jogrek në kapak por edhe një skelet dhe një jogrek në sarkofag. Kafka e Filipit II ka tipare antropologjike të njëjta me

ato të trungut tonë ilir, gjë që flet për bazën etnike të përbashkët. Treguesit sefalik të tij i jep mjaft mirë forma brakikane.

Diametri tranverzal paraqet vlera të mëdha dhe është përgjegjës për brakikraninën e theksuar. Fytyra e tij është e shkurtër dhe e gjërë kameprosope. Është e udhës që antropologët grekë t´i botojnë tiparet antropologjike të këtij mbreti dhe të përpilojnë një pasqyrë krahasuese të këtij skeleti me disa seri mashkullore të kafkave të helenëve.

Prof. Sh. Delvina shton se "Jam i sigurt se, po të kryhet kjo punë, të dhënat antropologjike të Filipit II të Maqedonisë do të vulosin përfundimisht nga ana antropologjike se oratori Demosten kishte të drejtë kur thoshte me vendosmëri të papërkulur se: ***"Filipi II i Maqedonisë nuk është grek".***

Për të qenë edhe më bindës në tërë këtë studim modest kushtuar "vërtetësisë për Maqedoninë antike", do të shfrytëzojmë edhe Arture Vajgelli, i cili duke shfrytëzuar të arriturat e fundit të histografisë botërore, arrin të kompilojë (përpilojë), një monografi kushtuar Aleksandrit të Madh, që është e shqipëruar dhe e botuar në Tiranë në vitin 1993. Në mes tjerash Vajgelli thotë: ***"Maqedonët ishin një popull flokëartë dhe sykaltër, me lëkurë më të bardhë se sa grekët. Në damarët e tyre rridhte gjak nordik. Ata, kishin zbritur në jug nga viset e Danubit në kohën parahistorike kështu që ekzistone një farefisni e largët midis tyre dhe grekëve të veriut. por grekët nuk donin ta pranonin këtë farefisni, para së gjithash duke u nisur nga fakti se gjuha e maqedonëve kishte pak gjëra të përbashkëta me gjuhën e tyre. Grekët në kohën e hershme nuk shihnin ndonjë dallim midis maqedonëve, ilirëve, trakasve dhe mezëve. Që të gjithë, për grekët ishin njësoj të paqytetëruar, sepse banonin në trojet e panjohura e jashtë botës greke. Grekët i përshkruanin maqedonët pa dashur të jepnin një gjykim të prerë si një popull që i pëlqente të endej sa andej e këndej, të jetonte i ndarë në fise, të vishej me lëkurë kafshësh dhe ta kalonte kohën më të madhe, duke u përleshur për kullotat e bagëtive i mbanin për luftetarë të rrezikshëm. Ata tregonin se ai maqedon që nuk kishte vrarë ende një armik, ishte i detyruar të lidhte rreth trupit një gjalme, si***

shenjë dobësie, i vlerësonin dhe si gjuetarë të zotët e pijanecë me nam, e kishin zakon që me të filluar gostia të pinin kaq shume verë, sa që menjëherë bëheshin xurxull".

Kohë më parë në gazetën "Lajmi" të datës 25 prill 2005 prof. Dr. Asllan Selmani është prononcuar se **"Në Maqedoninë antike kanë jetuar ilirët dhe pranë tyre Trakët**".

Grekët, kanë jetuar në skajin më jugor të Ballkanit, në ishujt e Egjeut e të Mesdheut, kurse sllavomaqedonasitt e sotëm kanë ardhur nga përtejmaleve Karpate në shek. VII - VIII.

Prof. Arsllani ka plotësisht të drejtë kur gjykon se: **"Grekët nuk kanë kurrëfarë lidhje me Maqedoninë, ndaj nuk mund të kenë pretendime për emrin e saj, shqiptarët duhet të orvaten me çdo kusht të mbrojnë emrin e saj, Maqedoni. Partitë shqiptare që veprojnë në Maqedoni, në pozitë ose opozitë, duhet të angazhohen shumë më tepër për ruajtjen e emrit Maqedoni, sepse ai nuk u takon as grekëve e as sllavomaqedonasveve, por më së shumti ose eksluzivisht u takon shqiptarëve, si popull autokton dhe pasardhës i pellazgëve, gjegjësisht ilirëve".**

Në librin e historisë së popujve jugosllavë (Historia Narodne Jugosllavije, Zagreb 1953), në mes të tjerash shkruan: ***"Në kohën e Aleksandërit të Madh Mbretëria e Maqedonisë përfshinte: Maqedoninë e Egjeut, Thesalinë, Halkidiku, një pjesë të Epirit, një pjesë të R.P të Maqedonisë, afërsisht deri te linja e cila shkonte nga Liqeni i Ohrit e deri te Manastiri, ku shtriheshin peonët. Aty ndikimi grek ishte më i madh. Populli maqedon është me siguri me prejardhje ilire, të cilët me të madhe u helenizuan".***

Maqedonia për shkak të relievit gjeografik, njësoj sikurse trojet tjera ilire, nuk eci njëkohësisht me zhvillimin e Helladës. Masivi i Bermit, i cili shtrihet me drejtim nga veriu drejt jugut, ndante Maqedoninë e Sipërrme nga ajo e Poshtme.

Maqedonia e Sipërme, me ndryshim të madh në lartësi, ishte e përshtatshme për rritjen e bagëtisë, ndërsa Maqedonia e Poshtme bregdetare me fushat pjellore, që ujiten nga Vardari dhe Haliakmona, i ishin kushtuar bujqësisë. Vendi nuk kishte limane

të përshtatshme. Kështu që banorët e saj më të vjetër ishin barinj dhe bujq.

Gjeografi dhe historiani i madh grek, Straboni nga Ponti, thotë se: ***"Maqedonia formon një paralelogram, i cili zgjatet gjerë në Adriatik, duke marë edhe Korfuzin brenda e duke vazhduar udhën Egnatia. Banorët e këtyre vendeve përdorin një gjuhë, një veshje dhe një kësulë".***

Në histografinë botërore, përgjithsisht, mbretëron mendimi se maqedonët e lashtë janë popull i ri indoevropian, që janë formuar nga grupe etnike ilire dhe pjesërisht nga grupe etnike trakase, si dhe pak fise helene, të cilët rreth shek.. VII p. e. s. kanë formuar shtetin e tyre në veri të lumit Haliakmona (Bistrica e sotme), në lindje deri te lumi Struma, në perëndim deri te malet e Pindit, në veri kufizohej me fiset tjera ilire si lynkestët, pellagonët dhe pajonët. Maqedonia antike në atë botë ndahej në disa krahina, si: Pieria, Elime, Emathja, Eordea, Oresia, Botiea, Lyncestia, Almopia, Pellagania, Halkidikia, Bizalti, Sintiku, Odomantiku dhe Edonidi.

5. Dinastitë e Maqedonisë

Nga mbreti Karan deri te Aleksandri i Madh, sipas Euzebit të Çezaresë (265-340 p.e.s.), radhiten 24 mbretër të Maqedonisë. Kurse Velei Paterkuli (historian latin, 19 p. e. s. – 31 të erës sonë) numëron 17, ndërsa Justini 12 mbetër maqedonë. Maqedonia antike ekzistoi që nga viti 800 p.e.s. e gjer në vitin 146 p. e. s.. Shteti i parë maqedon u krijua në shekullin VIII ose VII p. e. s. nën udhëheqjen e Dinastisë Argeade. Mbreti i parë i maqedonëve është Perdika I. Sipas Plutarkut, themeluesi i Dinastisë mbretërore të Maqedonisë është Karani i Argosit, i cili u vetshpallë mbret në vitin 815 p. e. s., kurse sipas Herodotit, themelues i Mbretërisë së Maqedonisë është Perdika I.

Perdika I (700? - …? p.e.s.)

Perdika I rreth viteve 700 p.e.s. i bashkoi fiset e ndara pellazge në krahinën qendrore në jug të Pellazgjisë. Ky ishte njëri prej tre vëllezërve, bijve të Temenit, të cilët u arratisën nga Argosi për në Iliri, në Maqedoninë e sipërme. Ata u vendosën pranë malit Bermis dhe dalëngadalë zunë të zgjerojnë pronat e tyre, derisa vunë nën zotërim një pjesë të madhe të Maqedonisë. Dhe më pas, aty rreth vitit 700 p. e. s. Perdika I shpallet mbret i Maqedonisë. Kjo mbretëri përfshinte rrethinat e Selanikut dhe shtrihej në jug deri në Molosia ose Epir, kurse në veri, deri në Iliri. Selia e mbretit Perdika I ishte qyteti Egea në Maqedoninë Perëndimore. Pas Perdikës I fronin e zuri i biri i tij, Argausi, të cilin e pasoi poashtu i biri i tij, Filipi II, që u pasua nga i biri, Aropi, pastaj ky nga biri i tij, Alketi, dhe ky u trashëgua nga biri i tij, Aminta I, i cili u bë njëri nga mbretërit më të famshëm të Maqedonisë.

Aminta I (540 – 500 p.e.s.)

Mbreti Aminta e zgjeroi Maqedoninë duke aneksuar treva tjera përreth saj. Me zgjerimin e Maqedonisë në lindje të saj, Aminta I u konfrontua me Mbretërinë e Persisë, e cila kishte plane të zgjerimit të saj në perëndim. Mbreti persian, Kiri (546-540 p. e. s.), kishte përfshirë në perandorinë e tij qytetet pellazgo-ilire përgjatë bregut të Azisë së Vogël, kurse në vitin 513 p. e. s. Dari kaloi Hellespontin (Ngushticën e Dardaneleve) dhe pushtoi një pjesë të Trakisë.

Në kohën e mbretërimit të mbretit maqedonas, Amynta I, i vdekur në vitin 500 p. e. s., Maqedonia u pushtua nga persianët dhe iu nënshtrua aleancës me ta. Mbretërit tjerë maqedonas ishin edhe Per-+dika I, Arkelau etj., të cilët ishin vasalë të Persisë.

Aleksandri I (500-454 p. e. s.)

Pas Amintës I vendin e tij e zuri biri i tij, Aleksandri I, i cili shprehu admirim për kulturën greke me qëllim që t'i bënte për vete. Poeti i madh lirik, Pindari i Tebës, thurri poema për Aleksandrin I. Atij i dhanë titullin "Fielini" ose "Miku i

grekëve", titull i cili dëshmon qartë se Aleksandri I i Maqedonisë nuk ishte grek.

Gjatë kohës që sundonte Aleksandri I i Maqedonisë, maqedonët filluan të zgjerohen kah malet dhe regjionet Eordaia, Botiea, Pieria, Mygdonia dhe Almopia, të cilat banoheshin nga fise të ndryshme. Pavarësinë e humbur gjatë periudhës së Perandorisë Persiane nën udhëheqjen e mbretit Darius Hystaspes, Maqedonia e rifitoi nën udhëheqjen e mbretit Aleksandri I (495–450 p.e.s.).

Aleksandri I ishte ai që bashkoi Maqedoninë e Sipërme me të Poshtmen. Ai iu kushtua organizimit të shtetit dhe të ushtrisë së tij. Krahas me trupën e kalorësisë së eterëve (etërve, baballarëve), që e përbënin fisnikët, organizoi edhe trupën e pezeterëve, që e formonin bujq të lirë dhe që rezultoi në këmbësorinë e ushtrisë maqedone. Do të duhej të përmendnim se Kuvendi i Ushtrisë kishte që në kohët e mëparshme të drejta të caktuara, p.sh. të aktualizonte ngjitjen në fron të mbretit të ri dhe të gjykonte veprime që drejtoheshin kundër shtetit.

Herodoti tregon se, kur Aleksandri I shkoi të marrë pjesë në garat e Lojërave Olimpike, grekët deshën që ta përjashtonin nga garat, meqenëse nuk ishte grek, sepse ata maqedonët i konsideronin si jogrekë, si të huaj.

Gjatë luftërave greko-persiane në vitin 490 p. e. s. në maratonë (ku fituan grekët) në vitin 481 p. e. s. në Thermopile (ku fituan persët) dhe në betejën detare të Salaminës në vitin 480 p. e. s. (ku fituan grekët), mbreti i Maqedonisë mbajti qëndrim neutral dhe ndërmjetësues midis persianëve dhe grekëve. Por, më vonë, kur Aleksandri I lidhi aleancë me fiset ilire të Korinthit, marrëdhëniet maqedono-greke filluan të acarohen.

Perdika II (454-413 p. e. s.)

Vendin e Aleksandrin në fronin mbretëror të Maqedonisë e zuri biri i tij, Perdika II. Ashtu siç qëndroi neutral i ati i tij, Aleksandri I, në luftërat greko-persiane Perdika II zyrtarisht qëndroi asnjanës në Luftën e Peloponezit (Moresë) gjatë viteve 431-404 p. e. s., e cila u zhvillua midis Athinës e aleatëve të saj në

njërën anë dhe Korinthit e Spartës në anën tjetër. Mirëpo, fshehurazi Perdika II ndihmoi vazhdimisht molosët e Korinthit dhe Spartën kundër grekërve.

Arkelau (413-399 p. e. s.)

Ky mbret i Maqedonisë hypi në fron pas të atit të tij, Perdika II. Arkelua ishte një ithtar i madh i artit e letërsisë. Ai ndërtoi shumë kështjella e qytete, hapi rrugë të reja etj., dhe, si çdo mbret tjetër, mori në dorë çështjet e luftës dhe punëve tjera shtetërore. Arkelau sundoi edhe 5 vjet tjera pas Luftës së Peloponezit, ku humbëse doli Athina dhe aleatët e saj. Edhe Arkelau mbajti një qëndrim anësor ndaj kësaj lufte të gjatë.

***

Pas sundimit paqësor në Maqedoni të Aleksandrit I, Perdikës II dhe Arkelaut, Maqedoninë gjatë viteve: 399-359 p. e. s. e përfshiu një periudhë anarkie e përgjithshme me sundime të shkurtra, plot trazira gjatë sundimit të mbretërve Oresti, Eropi II (399-394 p. e. s.), Aminta II (393-369 p. e. s.), Aleksandri II (369-364 p. e. s.), Ptolemeu (366-364 p. e. s.) dhe Perdika III (364-360 p. e. s.).

Filipi II (359-336 p. e. s.)

Gjatë periudhës së gjatë të trazirave civile në Maqedoni, grekët u munduan të siguronin sundimin e tyre në këtë vend, duke e mbajtur peng për 3 vjet djalin 15-vjeçar të Amintës II, midis viteve 367-364 p. e. s. në Tebë.

Pas arratisjes së Filipit II (babait të Lekës së Madh) nga burgu grek i Tebës, ai u kthye në vendlindje, ku fillimisht qeverisi si tutor i nipit të tij, Amynta. Mbret u shpall me siguri më 356. Në këtë kohë rrethanat ishin kritike.

Mbretërit e parë të Maqedonisë i kishin selitë e tyre në Egea (Edesë ose Vodina). Por, Filipit II më i përshtatshëm i dukej Pela për kryeqytet, afër Selanikut.

Me ardhjen në fron të mbretit Filip II punët e Maqedonisë morën një drejtim të mbarë. Filipi II ndërmori disa fushata ushtarake për çlirimin dhe rimarrjen e territoreve të humbura të Maqedonisë nga grekët dhe persët.

Faza e parë e strategjisë së tij kombëtare ishte bashkimi i vet Maqedonisë. Procesi i konsolidimit të saj pati një shtrirje kohore nga viti 359 p. e. s. deri në vitin 352 p. e. s. Në perëndim dhe në veri vargmalet shërbenin si kufij natyrorë të Maqedonisë dhe kufizoheshin me farefisin e tyre në Epir, në Iliri dhe në Paoni. Në lindje lumi Strimon e kufizonte me Trakën. Ndërsa, në jug kufizohej me gadishullin e Halkidikit, ku ishin të vendosura kolonitë greke, të cilat e iritonin dhe e sfidonin pa masë Filipin II. Filipi u shqua si një udhëheqës i fuqishëm. Kjo bëri që ai të fitonte besimin e krerëve të fiseve të ndryshme ilire, duke i bashkuar nën udhëheqjen e tij të tri mbretëritë pellazge: Ilirinë, Epirin dhe Maqedoninë. Ndërsa përmes diplomacisë, dredhive dhe veprimeve ushtarake Filipi II arriti në fillim t' u shkëpuste grekëve shumë troje përgjatë bregdetit të Egjeut.

Faza e dytë e strategjisë së Filipit II ishte zgjerimi i mbretërisë, e cila zgjati nga viti 352-338 p. e. s. Tashmë Maqedonia ishte konsoliduar në të gjitha fushat dhe rasti erdhi kur në Greqi shpërthyen konfliktet rreth thesarit të plaçkitur të Tempullit të Delfit për qëllime ushtarake. Qytetarët me influencë nga Thesalia i kërkuan ndihmë Filipit II. Ky kaq priste. Në vitin 352 p. e. s. ushtria maqedone i dëboi armiqtë grekë nga Thesalia, e cila e pranoi Filipin II si udhëheqës të vet. Një vit më vonë Filipi II e shtyri kufirin lindor të Maqedonisë deri te lumi Hebri, në Trakinë Lindore. Falangën maqedone, formacion këmbësorie me 16 rreshta, që ishin të armatosura me heshta me gjatësi 6 metra, sarisa, shpatë dhe mburojë të vogël, e modeloi me kalorësi dhe këmbësori të lehtë. Në betejë synonte të çara duke lëshuar mësymje të fuqishme të kalorësisë për të goditur armikun në krah. Kjo taktikë luftarake ishte zhvillim i falangës së tërthortë, që kishte mësuar në Tebë.

Paralelisht mendoi dhe për zhvillimin kulturor dhe ekonomik të Maqedonisë, ndërtoi qytete dhe vendosi ligje.

Pezeterët, që rekrutoheshin nga popullsia e qyteteve, dëshmojnë zhvillimin ekonomik të Maqedonisë. Stefani i Bizantit përmend 70 qytete maqedone, ndërsa gërmimet arkeologjike vërtetojnë ekzistencën e tyre që nga shek. VI p. e. s.

Për të siguruar sundimin e tij në minierat e arit të Pageonit, më 357 Filipi pushtoi Amfipolin, kurse më 356 pushtoi Pidnën dhe Potidean. Ndërkohë, me rebelimin e aleatëve të Athinës kishte shpërthyer Lufta e Aleancës (358-355), që shpuri në shkrirjen e Aleancës II të Athinës. Lufta e Aleancës i dha guxim Filipit të shtrinte sundimin e tij në Helladë, sepse tregonte që grindjet e helenëve nuk kishin të sosur. Por, pas kësaj shpërtheu edhe një luftë tjetër civile mes helenëve. Kur Kuvendi i Amfiktionit në Delf dënoi fokeasit që kishin lëvruar kopshtet e orakullit të Delfit, duke plaçkitur thesaret e tij. Tebanët, lokrët e thesalët kërkuan ndihmën e Filipit kundër fokeasve.

Ushtria maqedone përparoi deri në Termopile, por iu shmang përplasjes me athinasit, të cilët ishin rreshtuar në mbështetje të foekasve. Më 348 Filipi pushtoi Olintin dhe e shkatërroi. Kurse në Betejën e Keronës Filipi mundi ushtrinë e Athinës dhe Tebës. Athinasit dhe tebanët bënë aleancë kundër ushtrisë maqedonase të komanduar nga Filipi II. Pas pak kohësh në Keronia 32 mijë maqedonë përballeshin me 30 mijë athinas, tebanë dhe aleatë të tyre. Në këtë betejë u shqua për trimëri dhe aftësi ushtarake Aleksandri i Madh, i cili komandonte kalorësinë maqedone në moshën 18 vjeçare. Këtu Aleksandri shfarosi falangën tebane. Ndërsa lufta e shenjtë vazhdonte, athinasit dërguan në Pellë (kryeqendër e Maqedonisë) një delegacion nën kryesinë e Filokratit, ku merrnin pjesë edhe Demosteni dhe Eskini. U nënshkrua atëherë Paqja e Filokratit (346). Kundërshtarët u morën vesh të mbanin gjithë vendet që zotëronin gjer atëherë. Por, Filipi nguli këmbë që nga marrëveshja të përjashtoheshin fokeasit. Kështu, marshoi në Fokidë, ku thirri Mbledhjen e Amfiktionit. Atëherë u vendos:

A) - Të rrafshoheshin qytetet fokease

B) - Fokeasit të paguanin një gjobë prej 50 talantash deri sa të shlyhej vlera e thesareve të grabitura në Delf

C) - T' i jepeshin Filipit dy votat e fokeasve në Kuvendin e Amfiktionit

D) - T'i jepej Filipit kryesia e Lojërave Olimpike

Filipi II në aleancë ushtarake me grekët filloi përgatitjen e një ekspedite të gjerë kundër persëve, por në këtë kohë ai u vra nga komplotistët helenë (viti 336 p. e. s.). Fronin e tij e zuri biri i tij, Aleksandri i Madh, i cili vazhdoi planin e babait për të sulmuar persët e Persinë dhe për të zgjeruar Mbretërinë e Maqedonisë. Filipi e ndjente rrezikun e Persisë dhe njëkohësisht e urrente shumë këtë perandori. Filipi reformoi ushtrinë, riorganizoi këmbësorinë, krijoi falangën e famshme maqedone dhe pajisi ushtrinë me mjete të përshtatshme për rrethim: katapulta (për lëshim shigjetash), deshë (trarë me majë metalike për të shpuar dyert e kështjellave) dhe kulla rrethuese. Organizoi ushtri të qëndrueshme me shërbim të detyrueshëm ushtarak, me marshime të vazhdueshme, me ushtrime dhe lojëra betejash. Në këtë mënyrë frymëzoi disiplinë, moral dhe unitet te ushtarët, që kishin ndikim edhe në popull.

Aleksandri III – Leka i Madh (356-323 p.e.s.)

Aleksandri vijoi veprat e të parëve të tij për të zhvilluar e zgjeruar shtetin dhe për të sunduar helenët e bezdisshëm. Aleksandri pasoi të atin në moshën 20-vjeçare. Në fillim i mposhti pretenduesit e fronit, pastaj përparoi me ushtri në Korinth, ku thirri të gjithë prijësit e helenëve me përjashtim të Spartës dhe u shpall sundues i tyre. Pas një kohe tebanët ngritën krye. Me një shpejtësi të pabesueshme u kthye në Tebë, mbyti revoltën dhe rrafshoi tërë qytetin, përveç Kadmeas, faltoreve dhe shtëpisë së Pindarit, për shkak se ky i fundit i kishte thurrur një himn fitores së Lekës së Parë në Olimpia. Pas kësaj detyroi përfaqësuesit e qyteteve që t'a shpallin "Komandant të Përgjithshëm". Kështu, pasi vendosi sundimin e plotë mbi barbarët helenë, filloi të përgatitet që t'i pushtojë barbarët aziatikë, persianët e Persinë. Pas përgatitjes ushtarake Aleksandri i Madh sulmoi persët dhe doli fitimtar në betejën e

Granikës (v. 334 p. e. s.) të Isos (v. 333), në betejën e Arbelës (Gaugamelës, v.331), duke depërtuar fitimtar deri në krahinën e Baktrianit dhe deri në Indi.

Aleksandri i Madh vdiq në Babiloni më 323, në moshën 32 vjeçare. Pasi që nuk la trashëgimtar madhor për fronin, gjeneralët e tij e ndanë Perandorinë e Maqedonisë, duke krijuar secili nga një Mbretëri për vete. Kështu, **Antipatri** vazhdoi administrimin e Maqedonisë dhe të Greqisë; **Lisimaku** mori Trakinë, **Antigoni** mori Azinë e Vogël; **Ptolemeu** mori Egjiptin dhe **Perdika** Azinë. Me kohë marrëdhëniet e këtyre prijësve e mbretërive u keqësuan dhe luftërat midis tyre e katandisën Perandorinë e Maqedonisë si mos më keq. Në këtë mënyrë, tri mbretëritë pellazge: Maqedonia, Epiri dhe Iliria shkuan secila në rrugën e vet.

Pas Lekës së Madh Maqedoninë e udhëhoqi mbreti Antipatri, pastaj mbreti Polisperkon. Këto dy qeverisën Maqedoninë në emër të vllait të Aleksandrit, Arridehut dhe në emër të birit të tij, Argosit apo Aleksandrit të Ri, të lindur menjëherë pas vdekjes së Lekës së Madh. Më pas hypi në fron Kasandri, pasi që vrau me pabesi Olimpinë, nënën e Aleksandrit të Madh. Pas këtij rasti Maqedonia kaloi nën qeverisjen e mbretit të Epirit, Pirros, kurse pas tij nga mbreti i Trakës, Lisimak, nga princi i dinastisë së Lagëve, Ptolome Kerani dhe të shumë komandantëve ushtarakë si: Meleagri, Antipatri, Sosteni dhe deri te mbreti i fundit maqedon, Antigon Gonati, i cili shtiu në dorë kurorën mbretërore të Maqedonisë në vitin 278, të cilën familja e tij e mbajti deri në pushtimin e Maqedonisë nga Perandoria Romake në vitin 168. Në këtë periudhë kanë sunduar: Antigoni II (279-243 p. e. s.), Demetri II (243-225 p. e. s.), Antigon Dosoni (225-220 p. e. s.), Filipi V (220-179 p. e. s.), dhe i fundit, Perseu (179-168 p. e. s.).

Nga Herakliu (Herkuli) te Aleksandri i Madh:

Herakliu
Hylli

Kleodemi
Aristomaku
Temeni
Kejsi
Maroni
Thestri
Akou
Aristodamidi
Koeni
Tirima
Karani
Perdika I
Argeu I
Filipi I (…-578)
Aeropi I (…-558)
Alketa I
Amynta I (…-498)
Aleksandri I (497-454)
Perdika II (454-413)
Arkelau (413-399)
Oresti (399-396)
Aeropi II (396-393)
Pausani (393)
Amynta II (393)
Amynta III (392-370)
Argeu II (370)
Aleksandri II (370-368)
Ptoleme Alori (368-365)
Perdika III (365.359)
Filipi II (359-336)
Aleksandri III (i Madh) (336-323)
Filipi III Arrhidau (323-317)
Aleksandri IV (317-310)
Kasandri (313-297)
Flipi IV (297)
Antipatri (297-294)
Aleksandri V (294)

Dimitri I (294-288)
Pirro (288-287)
Lisimaku (288-281)
Ptoleme Kerani (281-279)
Melagri (279)
Antipatri II (279)
Antigoni II Gonati (277-239)
Dimitri II (239-229)
Antigoni III Dosoni (229-222)
Filipi V (222-179)
Perseu (179-168)

6. Filipi II dhe Olimpia(Olimbia)

Filipi II

Filipi lindi në vitin 382 p.e.s. nga një baba maqedon dhe nënën e kishte lynkeste, e cila quhej Euridikë. Lynkestët ishin ilirë, këtë na e dëshmojnë studiuesit dhe historianët antikë Livi, Plini, Straboni, Ptolemeu etj. Ilirët lynkestë banonin përreth liqenit të Ohrit dhe kryeqytet kishin Heraklean, Manastirin e sotëm. Pra, vet Filipi ishte gjysmëmaqedonas (fis ilir) dhe gjysmëynkest (fis ilir). Pra, Filipi II ishte tërësësisht ilir. Pas vdekjes të babait, Amynta, nëna e tij, Euridika, e dërgon Filipin në Iliri te Lynkestët dhe më tej në Tebë. Mbas disa vitesh Filipi bëhet mbret i Maqedonisë, më 359 p. e. s.

Filipi u martua me iliren Olimbi dhe nga kjo martesë do të lindte Kleopatra, Kynëna dhe Aleksandri, një burrë i fort, një legjendë biblike.

Filipi me të hipur në frontin e Maqedonasve nënshtroi fisin e nënës së tij, lynkestët, të cilët kishin udhëhequr fronin e maqedonëve. Më tej Filipi i drejtoi synimet e tij për të spastruar territoret e Maqedonisë nga kolonët grekë. Ai shtiu në dorë Selanikun, Trakinë, Skithinë etj., duke zhdukur mbi 200 koloni

greke. Demosteni, i cili ishte oratori më i madh grek, i quajtur edhe mbrojtësi i grekëve kundër maqedonëve, ka thënë për Filipin, mbasi pushtoi të tërë Greqinë, në ligjëratën e tij të titulluar "FILIPIKA e Tretë", se "Filipi, jo vetëm që nuk është grek, edhe asnjë lidhje nuk ka farefisnisht me grekërit, por ai është një murtajë e ndyrë e Maqedonisë...".

Ndërsa **Straboni** shkruan: "Maqedonët janë quajtur si paionë". Dhe nga historia kemi mësuar se paionët ishin fis-popull ilir.

Sarah B. Pomeroy në veprën me titull "**Greqia antike: Një histori politike, shoqërore dhe kulturore",** shkruan: "Filip II lindi rreth vitit 382 p. e. s., djali i fundit i Amintas III dhe gruas së tij ilire, Euridikë. Pak njihet në lidhje me jetën e hershme të tij. Duke iu referuar Plutarkut, nëna e tij, Euridika, mësoi që të lexojë me qëllim edukimin e fëmijëve të saj. Cilatdo që të ishin shanset që Filipi kishte për edukim, gjithsesi përfunduan nga trazirat politike të Maqedonisë në vitin 370. Një përpjekje e pasukseshme nga vëllai i tij, Aleksandri II, që të zgjonte influencën tebane në Thesali, bëri që Filipi të kalonte vitet 369 deri 367 si një peng në Tebë. Mërgimi i tij nuk humbi më kot. Rezidenca e forcuar e Filipit në Tebë pothuajse dy vjet pas fitores së tij në Leuctra, e bëri atë fuqinë më të madhe në Greqi, i dha atij një depërtim në politikën greke dhe taktikat ushtarake që më vonë do të ishin të paçmueshme...".

David E. Jones në librin e tij "**Në tokën e Ilirisë (Shqipëria e ditëve të sotme)",** publikuar në vitin 2000, shkruan: ***"Në shtëpinë e gruas së parë të Filipit, Euridikës, jetonte një udhëheqëse pirate e quajtur Teuta, e shoqja e mbretit Agron të Ilirisë. Teuta mori në dorë drejtimin e Ilirisë pas vdekjes së të shoqit, në vitin 231 p. e. s.".***

Leslie Ëhite Hopkinson shkruan: "Një ditë në vitin 256 p. e. s. Filipi i Maqedonisë, atëherë në vitin e katërt të mbretërimit të tij, mori tre lajme të mira: gjenerali i tij, Parmenio, kishte mundur ilirët, kali i tij i racës kishte fituar në Olimpia dhe atij i kishte lindur një djalë. Nëna e djalit ishte Olimpia, një princeshë shqiptare, me bukurinë e egër të së cilës Filipi kish rënë në

dashuri sapo e pa tek kërcente vallëzimet religjioze të vendit të saj". Vitet e martesës dhe të mbretërimit në një vend gjysmë të civilizuar nuk ndikuan kurrë që Olimpia të zbutej-pasionate, hakmarrëse, entuziaste, supersticioze e errët, nëse e shohim atë, një Bakante, duke drejtuar vallëzimin mistik që ajo dashuronte, me një gjarpër të madh të zbutur të dredhur mbi të, me shoqëruesit e ngritur dhe kurorën e spërdredhur, ose një Medea duke bluar xhelozinë hakmarrëse të vrasjes së burrit fals dhe rivalit të urryer, ajo është gjithmonë barbarja, gjithmonë një forcë thelbësore e tmerrshme. Nga ajo Aleksandri trashëgoi natyrën e tij pasionale e të dëlirë, të njëjtën prirje për shpërthime, bujarinë, zemëratën e egër dhe pendimin zemërthyes, që nga ajo, gjithashtu atij i vinte tërheqja ndaj religjioneve mistike të cilat lëviznin në karakterin e tij.

(...) Krenar dhe i lënduar, princi (Aleksandri) e çoi nënën e tij të fyer mbrapsht në shtëpinë e saj shqiptare për të bluar me mend xhindosjen e tmerrshme vedkjeprurëse derisa haku i saj të ishte marrë."

Pasi Filipi e ndau Olimpinë, ajo bashkë me Aleksandrin shkoi për disa kohë të jetojë në mbretërinë e lynkestëve. Atëherë Filipi u shpalli luftë lynkestëve, por gjatë betejës ai desh u vra. Më tej Filipi kërkoi që Aleksandri të kthehej në Maqedoni, por Aleksandri këmbëngulës i vuri kusht që të kthehej edhe nëna e tij, Olimpia, dhe të respektohej si mbretëreshë. Filipi e pranoi kushtin. Ai për t' u afruar me fisin ilir të Olimpisë, kërkoi që vajza e tij, Kleopatra, të martohej me mbretin e Epirit, vëllanë e Olimpisë. Gjatë dasmës Aleksandri në bashkëpunim me nënën e tij dhanë urdhër që Filipi të vritej. Gjatë dasmës një ushtar maqedon i afrohej Filipit dhe i ngul thikën në zemër, duke e lënë te vdekur në vend atë. Me ngjitjen e Aleksandrit në fronin e maqedonëve, Olimbia e vret gruan e re të Filipit bashkë me fëmijët e saj.

Olimpia(Olimbia)

Gruaja e Filipi dhe nëna e Aleksandri të Madh, Olimpia

vinte nga visi i Ilirëve të epirotëve. Olimpia ishte stërmbesë e mbretit të mirmidonëve, Akilit, i cili u vra në luftën e Trojës. Pra, Olimpia ishte e bija e mbretit të Epirit, Neoptolemi I, i cili rridhte nga fisi i Pirro Neoptolemit, djali i Akilit.

Pirro Neoptolemi mbas luftës së Trojës u vendos në Toskëri, duke themeluar mbretërinë e Epirit. Pirro Neoptolemi është stërgjyshi i Pirros së Madh të Epirit, që luftoi deri në Romë në shekullin III përpara Krishtit.

Aleksandri I i Epirit (342 p. e. s.) është vëllai i Olimpisë, kurse Aleksandri II i Epirit është babai i Pirros. Neoptolemi I dhe Aleksandri II ishin vëllezër. Olimpia (si bijë e të parit) dhe Pirroja (si bir i të dytit) janë kushërinj të parë.

Emri i vërtetë i Olimpisë ishte **Mirtal**, pra edhe kjo një fjalë shqipe e përbërë nga MIR-DAL (në gjuhën shqipe shpesh herë shkronja T ngatërrohet me D, sikurse S me Z, etj.). Më vonë Mirtalia u quajt Olimpia. Edhe kjo fjalë rrjedh nga gjuha shqipe, siç do ta shohim më poshtë. Olimpia ishte shumë e bukur, me flokë të verdha me onde të gjata. Bukurisë së Olimpisë nuk i rezistoi Filipi, i cili la gruan e tij të parë, iliren Audata. Si duket bukuria e veçantë, zgjuarsia e Mirtalisë ka bërë që më tej ajo të thirrej me emrin madhështor Olimpi(Olimbi).

Joseph Ëard Sëain, shkruan: ***"...Nëna e Aleksandrit, Olimpia, ishte bija e një prijësi epirot që sundonte në atë që është sot Shqipëri. Ishte një grua e egër dhe e tmerrshme, që praktikonte ritet orgjiastike të lidhura me religjionet primitive, gjatë të cilave ajo u bë një profete e frymëzuar..."***

David E. Jones, shkruan: ***"Në tokën e Ilirisë (Shqipëria e ditëve të sotme), në shtëpinë e gruas së parë të Filipit, Euridikës, jetonte një udhëheqëse pirate e quajtur Teuta, e shoqja e mbretit Agron të Ilirisë. Teuta mori në dorë drejtimin e Ilirisë pas vdekjes të së shoqit, në 231 p. e. s."***

Olimbia është një emër shqiptar që përbëhet nga bashkimi i fjalëve pellazgje OLI dhe MBI. OLI do të thotë **i madh** dhe MBI, **sipër**. Emri OLIMBI është një që tregon madhështi. Lojërat më të mëdha në botë quhen Lojërat OLIMBIKE, mali më i madh në Greqi quhet Mali i OLIMBIT. Pra, emri Olimbi ka kuptimin e

madhështisë **"MBI TË GJITHË"**. Dhe vërtet a nuk janë Lojërat Olimbike aktiviteti më i madh sportiv në botë?

Sot gjuhëtarët shqiptarë e ngatërrojnë fjalën Olimbi me Olimpi. Fjala OLIMBI në greqisht shkruhet OLIMPI dhe shqiptohet OLIMBI. Shkronja MP në greqisht është B dhe në disa raste MB. Gjuhëtarët shqiptarë kanë bërë deri më sot transkriptim të fjalës greke OLIMBI, duke bërë që kjo fjalë të humbi kuptimin e saj që rrjedh nga gjuha shqipe (pellazgjike)... Gjuhëtarët tanë me dashje ose pa të kanë bërë shumë gabime në disa fjalë shqipe, duke i quajtur si fjalë të ardhura nga greqishtja, sllavishtja, latinishtja etj. Por, po të studiohet më thellë, do kuptojmë se kemi fjalë të gjuhës shqipe të përvetësuara nga gjuhët e tjera.

II. ALEKSANDRI I MADH I MAQEDONISË - LEKA

1. Fëmijëria e Lekës së Madh

Në vitin 356 në një mbrëmje korriku, në qytetin Pella të Maqedonisë, u lind një foshnjë që njëzet e dy vjet më vonë do të pushtojë Azinë dhe do të shkatërronte shtetin e pafund, të pasur dhe të plotfuqishëm të persianëve. Kjo foshnjë ishte Aleksandri i Madh. Kjo datë ka mbetur e fiksuar, sepse atë natë u dogj tempulli i njohur i perëndeshës Diana të efesianëve. Plutarku shkruante se të gjitha falltaret e Efesit, pasi vështruan rrënojat e tempullit, rendën nëpër rrugë duke thirrur: …"ky ishte sinjali i lindjes së atij që do të shkatërronte të gjithë Azinë".

I njohur ndër shqiptarët si Leka i Madh, Aleksandri ka qenë biri i mbretit Filip II i Maqedonisë dhe i gruas së tij të katërt, princeshës epirote, Olimpisë, e cila konsiderohet si njëra ndër gratë më të shquara të antikitetit. Në vitet 331-317, në kohën kur erdhi në fron një kushëri i saj, Aikidi, Olimpia u bë bashkësunduese me të në fronin e Epirit. Aleksandri trashëgoi virtytet e të dy prindërve. Ishte mesatar në shtat, me flokë kaçurrel, me sy të bukur dhe një fytyrë të qetë e serioze njëherësh. Por ajo që e karakterizonte më tepër, ishte zgjuarësia dhe trimëria. Këto dy virtyte i rrëfeu që nga mosha shumë e

vogël. Ashtu si Napoleoni, Aleksandri ishte disi i shkurtër, biond, me një çehre të kuqërremtë në fytyrë dhe, sipas historianëve, ***njërin sy e kishte të zi si nata dhe tjetrin të kaltër si qielli.*** Djalë i mbretit Filipi II i Maqedonisë dhe princeshës Myrtale (Mirtale), që pas martesës u quajt Olimpia, e bija e Neoptolemit të Epirit. Nga e ëma ishte shumë i bukur, ai kishte fituar karakter të fortë sundimtari, kurse nga Aristoteli, mësuesi i tij maqedonas, dijen dhe kulturën mbi qytetërimet e vjetra. Ai e kaloi edhe një pjesë të fëmijërisë së tij, te daja në Epir.

Aleksandri ishte frut i menjëhershëm i pasionit të zjarrtë të dashurisë së Filipit me Olimpinë dhe ndoshta i vetmi. Lufta dhe politika e larguan shpejt Filipin nga Olimpia. Aleksandri mbeti nën kujdesin e nënës gjatë viteve të fëmijërisë dhe të adoleshencës së hershme. Ai u mësua të këndonte dhe t' i binte lirës, çka do të ishin kënaqësi gjatë gjithë jetës së tij; mësoi të gjuante dhe saherë që do të ishte i lirë, ai do të gjuante arinj, luaj, zogj e dhelpra; u mësua dhe u praktikua me ritualet e mikpritjes dhe që kur ishte djalë dhjetëvjeçar e më tej, ai do të shquhej për sjelljen e mirë, me të cilën priste vizitorët në oborr; ai natyrisht u mësua të kalëronte. Kali i tij i famshëm, Bukefali, i cili do ta çonte nëpër beteja për njëzet vjet me radhë, është një nga elementet më të çuditshme të legjendës së Aleksandrit. Dhe, më në fund, pas gjithë këtyre, ai filloi edukimin zyrtar në debatin filozofik dhe në poezinë epike. Aleksandri adhuronte jashtë mase "Iliadën" dhe heroin legjendar, Akilin. Gjatë tërë jetës e ëma e drejtonte në rrugën e lavdisë së përjetshme. Olimpia i thoshte shpesh: "Ti je si Akili, i dënuar nga madhështia jote". Jeta e tij u ndërlikua kur Filipi i sapondarë nga Olimpia, bëri një djalë tjetër me gruan e re, Euridikën. Atëherë, kur froni për të nuk ishte më aq i sigurt, u largua bashkë me të ëmën në pallatin mbretëror të Epirit, ku festoi edhe martesën e dajës së tij, mbretit të Epirit, të atin e Pirros së Epirit. Më pas shkoi në Iliri për të organizuar një paraqitje të armatosur kundër të atit, që kishte ndër mend t'ia linte pushtetin djalit të tij të dytë. Pak kohë pas largimit Filipi II vritet dhe Aleksandri u shpall mbret, sepse djali i dytë ishte ende foshnje. Aleksandri ishte dymbëdhjetë vjeç, kur një mik i Filipit,

Dimarati nga Korinthi, i fali një kalë të fuqishëm, krenar dhe të pashtruar, ***Bukefalin***. Në oborrin e pallatit u grumbulluan shumë miq të mbretit dhe e admironin kalin e mrekullueshëm. Dikush prej tyre donte t'a shalonte. Por, Bukefali u egërsua, tundi këmbët e pasme dhe miku i mbretit vrapoi të largohej për të shpëtuar. Për Zojsin (Zeusin)! - i thirri atëherë Filipi Dimaratit, - kali që më fale është vërtet i shkëlqyer, por është kaq i egër, sa kam frikë se askush nuk do të mund t'a zbusë.

Një nga oficerët e mbretit shkoi këmbëngulës drejt Bukefalit, rrëmbeu frerët dhe u përpoq t'i kërcente në shpinë. Por, kali hingëlliu egër, u shkund, u ngrit përpjetë mbi këmbët e pasme dhe oficeri ua mbathi këmbëve që të shpëtonte.

Njëri pas tjetrit provuan pothuaj të tërë ta zbutnin Bukefalin. Një mund i kot. Nuk do të gjendej askush që të nënshtronte kalin krenar dhe idhnak. Dhe, atëherë panë të gjithë Aleksandrin e vogël të ngrihej nga vendi dhe të shkonte me guxim drejt kalit krenar.

- Aleksandër!, - i thirri Filipi, - Mos o bir! Kij mendjen!

Por, Aleksandri bëri përpara pa ngurrimin më të vogël dhe kapi me kurajë frerët e Bukefalit. Kishte vënë re diçka që askush nuk e kishte parë. Kali trembej duke vështruar hijen e vet, prandaj egërsohej dhe nuk linte askënd t'i afrohej. Aleksandri ktheu kryet e kalit nga dielli që të mos i binte hija përpara dhe me guxim e shkathtësi i kërceu në shpinë. Të gjithë panë me habi Bukefalin të rrinte urtë e palëvizur si qengj!

- Të lumtë! Të lumtë Aleksandër!, - shpërthyen britmat e vetvetishme triumfuese.

Filipi, mbushur me krenari për të bëmën e të birit, vrapoi pranë tij, e përqafoi i mallëngjyer, e puthi dhe i tha:

- Biri im, përpiqu të gjesh një mbretëri të madhe që të të shkojë për shtat. Maqedonia është shumë e vogël për ty! Fjalë profetike, që e ardhmja do t' i vërtetonte.

2. Edukimi i Aleksandrit

Filipi pajtoi mësuesit më të mirë për Lekën. Ky mësoi të fliste, të shkruante e te lexonte në greqisht, ashtu siç bënë edhe

shumë shqiptarë të kulturuar njëzet e dy shekuj më vonë. Mirëpo, për shkak të antipatisë së ndërsjelltë midis Filipit dhe grekëve, përgjegjësit e drejtperdrejtë për edukimin e Aleksandrit nuk ishin grekë. Dy prej tyre ishin Leonidha, një farefis i nënës së tij molose, Olimpias, dhe Lisimaku, Arkanani nga krahina e Dodonës pellazge. Më vonë Aleksandri deklaroi se Leonidha i rreptë e kishte bërë të fortë e të qëndrueshëm, duke e pajisur me dy "kuzhinierë" të shkëlqyer: një marshim gjatë natës, për të shijuar mëngjesin dhe një mëngjes të pakët, për të shijuar drekën.

Më në fund Filipi vendosi që Aleksandri të edukohet nga Aristoteli, një filozof maqedon nga qyteti Stagira, nxënës i Platonit. Filipi e solli atë në oborrin mbretëror dhe nën drejtimin e tij hapi një shkollë në Mieza, një vend i bukur pranë kryeqytetit Pella. Në atë shkollë Aleksandri dhe një grup fisnikësh të rinj maqedonë studiuan për tre vjet. Aristotelit, filozofit dhe logjicistit më të shquar të kohës së tij, Filipi i dërgoi fjalë që të vinte e t'i jepte të birit mësime në Moral, Politikë, Mjekësi dhe Filozofi ose Metafizikë. Është me interes të vihet në dukje se vet Aristoteli (384-322 p. e. s.) kishte lindur në Stagira të Maqedonisë, në lindje te Selanikut. I ati i tij kishte qenë mjek i oborrit të të atit të Filipit, mbretit Aminta II. Pra, maqedoni Aristotel ishte si në shtëpinë e vet në oborrin maqedon, deri në moshën 17-vjeçare, kur shkoi në Athinë dhe u bë student i Platonit.

Në vitin 342 p. e. s. Aristoteli u kthye në Maqedoni si tutor i Aleksandrit 13-vjeçar dhe ndejti aty 7 vjet. Ndikimi i Aristotelit gjatë këtyre viteve të formimit dëshmohet nga një letër, të cilën Aleksandri ia dërgon më vonë ish-tutorit të tij. ***"Do të doja më shumë të shquhesha në dituri, sesa në pushtet e në sundim"***. Megjithatë, Leka i Madh e identifikonte veten me heronjtë e lashtë të Homerit, i bindur se ishte një pasardhës i Herakliut (Herkulit) nga ana e babait dhe i Akilit nga ana e nënës.

Poezia epike nënkuptonte Homerin. Përshkrimi i tij për të kaluarën heroike të Greqisë në dy poemat e famshme, "Iliadën" dhe "Odisenë" do të ndikonte shumë te Aleksandri dhe do të përcaktonte drejtimin e jetës së tij. Mospërfillja e rrezikut, rendja

pas aventurës, sfidat dramatike për dyluftim, guximi i çartur edhe përpara vdekjes - këto ishin mesazhet e kanunit homerik, që e pushtuan imagjinatën e Aleksandrit qysh në fëmijëri. Veprimi i tij i parë, kur do të hynte në Azi, do të ishin flijimet që do të bënte në Trojë, nga tempulli i së cilës do të merrte parzmoren e shenjtë, që do ta mbante gjatë gjithë fushatës së tij në Lindje. Ndikimi i epikës homerike u ndërthur me ndikimin e besimeve ekstreme fetare dhe ekscentrike të nënës së tij.

Aleksandri i Madh kishte mësues filozofin e dijetarin e madh me origjinë ilire të lashtësisë, Aristotelin, në shqip: aristokrat Telin, i cili Lekës së Madh ia mësoi retorikën, letërsinë, mjekësinë dhe filozofinë. Filipi II, mbreti i Makedhonisë illire, babai i Lekës së Madh, e autorizoi dijetarin më të madh të botës antike, filozofin e madh, Aristo Telin, që t' ia mësojë, arsimojë dhe edukojë Lekën e ri. Leka i Madh, ishte nxënësi i AristoTelit. Por, në cilën gjuhë mësoi Leka i Madh (Aleksandri i Madh), pos në shkipen skolastike illire. Aristo Teli=Zoti Teli (zotëri Teli), aristo ishte titulli aristokrat, kurse Teli ishte emri i tij, si simbolizim linguistiko-filozofik: Tel – mendje tel – mendjehollë,i mençuri.

Aristoteli është një filozof i madh për botën moderne, themelues i shkollës së empirizmit. Ai shkroi libra mbi organizimin dhe rendet kushtetuese të njëqind e pesdhjetë shteteve e qytet-shteteve të ndryshme, botoi jetëshkrimet e fituesve të lojërave pitike, u angazhua në studimin e muzikës e të mjekësisë, të astronomisë, të magnetizmit dhe të optikës, shkroi traktate për Homerin, analizoi retorikën, dha mendime për anën irracionale të natyrës së njeriut, vendosi studimin e biologjisë në baza të shëndosha eksperimentale, u fut me aftësi në botën e çudtishme të bletëve dhe studioi embrionologjinë. Dihet se ai nxiti dhe plotësoi më tej interesat e mëparshme të Aleksandrit në njohjen e epikës homerike, duke shkruar një libër të veçantë për "Iliadën", të cilën Aleksandri do ta mbante përherë nën jastëk. Homeri me siguri do të ketë zënë një vend të veçantë në programin e shkollës së Miezës. Aristoteli, gjithashtu shkroi për nxënësit e vet mjaft pamflete për qeverisjen e shtetit dhe të

kolonive dhe u dha atyre mësime në disiplinat e gjeometrisë, të retorikës, të estetikës, si dhe në artin e argumentimit.

Aleksandri mbyllur për katër vjet të tëra në një pallat preriferik, tok me mjaft moshatarë, bij gjeneralësh dhe fisnikësh të Maqedonisë, mori nga mësuesi i madh njohuri të pafundme, që më pas i vlenë shumë. Se sa respekt dhe dashuri ndjente Aleksandri për Arsitotelin, na e shfaqin fjalët e mëposhtme, të cilat mbetën në histori:

"Jetën ia kam borxh tim eti, dhe se si të jetoj mësuesit tim".

Në këto vite kur edukohej Aleksandri, u zgjuan dhe ambiciet e tij, ëndrra e madhe për të zmadhuar Maqedoninë. Dhe një ditë, kur mori vesh se i ati kishte fituar dhe një betejë tjetër, tha me ankim: "Im atë do të mund gjithë armiqtë tanë dhe nuk do të mbetet asnjë që ta mund unë".

3. Burrërimi i Aleksandrit

Aleksandri i Madh në moshën 20-vjeçare bëhet mbret i Maqedonisë. Ngutej të luftonte dhe të fitonte! Dhe ja ku iu shfaq rasti në të gjashtëmbëdhjetë vjetët e tij. Kishte mbaruar studimet pranë Aristotelit, kur Filipi iku për një fushatë të madhe në Propontidë dhe e la pas si mëkëmbës, mbret të shtetit maqedon. Krerët e medëve, një fisi të Trakës, kur morën vesh se Filipi gjendej larg nga Maqedonia, gjetën rastin të ngrinin krye. Aleksandri, në krye të ushtrisë që kishte mbetur në Pellë, marshoi drejt tyre për të qetësuar gjendjen dhe fitoi betejën.

Një rast i dytë i madh iu paraqit Aleksandrit dy vjet më pas. Athinasit dhe aleatët e tyre, tebanët, vendosën t'u rezistonin planeve të Filipit për të pushtuar Helladën dhe në vitin 338 ushtria e tyre priste ushtrinë maqedone në Keronë. Atje u bë ndeshja e madhe dhe historike e dy ushtrive. Filipi i besoi djalit të tij tetëmbëdhjetë vjeçar t'u printe 2000 kalorësve. Aleksandri luftoi trimërisht, duke përballuar batalionin e tebanëve. Tebanët qëndruan me ngulm sulmeve të tërbuara të kalorësisë maqedone të drejtuar nga Aleksandri, gjersa ranë të gjithë të vdekur. Në atë betejë kishte marrë pjesë edhe athinasi Demosten, oratori më i

madh i Helladës, i cili urrente me fanatizëm maqedonët. U detyrua të flakte mburojën dhe heshtën dhe t'ua mbathte këmbëve që të shpëtonte.

Fitorja e maqedonëve ishte e madhe dhe historike. Tani asnjë forcë nuk do të mund t'u kundërvihej që të pushtonin helenët. Pas betejës Filipi dha urdhër të grumbullonin athinasit e vdekur dhe t'i digjnin.

Kaluan edhe dy vjet prej se Maqedonia vendosi pushtetin mbi Helenët (grekët). Ishte njëzet vjeç Aleksandri, kur një pasdite mbreti Filip kremtonte dasmën e së bijës Kleopatër në një stadium, kur një maqedon i quajtur Pausania, i paguar nga helenët, ia afrua Filipit dhe i nguli një thikë në zemër.

Maqedonia humbi një mbret të madh. Se Filipi ishte vërtetë një mbret i madh, politikan i zgjuar, gjeneral i shkëlqyer, kishte arritur të pushtonte dhe të shpartallonte armiqtë helenë dhe përgatitej për fushatën kundër Persisë. Mbret në moshën njëzet vjeçe u bë Aleksandri. Pothuaj ende djalë, mori në duar fatin e Maqedonisë Ilire. Ishte vera e vitit 336 p. e. r.

Ishte vetëm 20 vjeç dhe në zemër kishte një lakmi të pamasë për pushtet dhe famë. Aleksandri, i edukuar nga filozofi Aristotel, u ushtrua në armë dhe politikë të përgjithshme nga i ati, me një inteligjencë dhe energji të paparë krijoi një perandori botërore. Sapo hipi në fron, ai rikonfirmon të drejtat që gëzonte më parë i ati, Komandant Suprem i ushtrisë. Kështu që ai kërkon t' u demonstrojë menjëherë popujve të nënshtruar se vdekja e babait të tij, Filip II, nuk e kishte dobësuar forcën e Maqedonisë.

Shtypi pa mëshirë një rebelim në Tebë, banorët e së cilës i shiti si skllevër. Pastaj iu desh të shtypte kryengritjet kalimtare në Iliri, që nga Piluri afër Korçës, deri në veri në Danub. Bashkëpunimi me molosët ishte i siguruar në saje të lidhjeve amësore. Mirëpo, me hypjen e tij në fron, armiku i betuar i të atit, Demosteni, formoi sërish një lidhje rivale dhe, madje i nxiti persët që të hidheshin në luftë kundër Aleksandrit, duke e quajtur atë çilimi dhe torollak.

Prandaj, Aleksandri marshoi për në Greqi. Athina e dëshpëruar dërgoi ambasadorë që të hynin në bisedime me

Aleksandrin. Demosteni ishte njëri prej tyre, mirëpo nga frika e zemërimit të mbretit, ai i braktisi të tjerët dhe u kthye në Athinë. Sidoqoftë, Aleksandri u paqësua, kurse nderi i Demostenit zuri të lëkundej. Pavarësisht nga përdorimi i kufizuar i forcës prej Aleksandrit dhe kushtet bujare të paqes, shumë nga grekët dhe veçanërisht athinasit, mbetën kundërshtarë të betuar të tij. Mirëpo, Aleksandri kërkoi dhe siguroi mbështetjen besnike të farefisit të tij në përgatitjen e fushatës kundër Persisë.

Ai u nis për në Delfi për tu këshilluar me orakullin e Apollos për fatin e fushatës aziatike, por arriti atje në një ditë të ndaluar, e cila konsiderohej e papërshtatshme për orakullin që të jepte parashikimin e saj. Mirëpo, kur ajo nuk pranoi që t' i vinte veshin lajmëtarit të tij, Aleksandri u fut vet brenda dhe e tërhoqi atë zvarrë në tempull. Rezistenca e saj qe e kotë, më në fund ajo thirri: ***"Biri im, ti je i papërballueshëm!"*** Me të dëgjuar këto fjalë, ai e lëshoi, duket se kjo ishte përgjigja e dëshiruar dhe se nuk kishte më nevojë për këshilla të mëtejshme nga perënditë.

4. Kuptimi i emrit - *ALEKSANDËR*

Emri i Aleksandrit të Madh ka padyshim disa veçori që duhen vënë re. Ky emër nuk është përdorur nga helenët para kohës së Aleksandrit, që do të thotë se ata e morën këtë emër nga ilirët. Tre personat e parë që kanë përdorë këtë emër janë, Paridi - princ i Trojës, Aleksandri i Epirit dhe i treti, Aleksandri i Madh. Asnjëri nga këta nuk ishte helen, kështu që së paku emri e ka zanafillën te dardanët. Dhe së treti, Paridi dhe Aleksandri i Madh, sipas të dhënave para se të lindnin, nënat e tyre kishin parë ëndërra që profetizonin ardhmërinë e këtyre dy heronjve dhe pjesa e dytë e emrit ngjan më së shumti me "andërr".

Ky është një emër që ia "dhuruam" gjithë botës, se edhe sot përdoret nga bota e krishterë edhe ajo islame me modifikime të ndryshme. Për zbërthimin e kuptimit të emrit ***Aleksandër*** ka disa varianta, të cilat të përbashkët kanë emrin ***Andërr***.

Fare e leht po e shqyrtojmë emrin e tij, i cili vjen nga pellazgjishtja e Homerit. Te "Iliada" Homeri thotë se mbreti

Priam (Prij + jam, Prijës jam, Jam ai që prij) kishte një vajzë me emrin Kasandra, e cila parashikonte të ardhmen dhe kur do të lindte djali, e ëma pa një ëndërr, në të cilën vajza parashikoi që ai do të shkatërronte gjithë botën në luftërat. Dhe, meqë kjo ishte një ëndërr e keqe, djalit ia vunë emrin Aleksandër. Pra, Aleksandër - **a lig andër, është ëndërr e ligë**, e keqe. Pra, emri i tij jep më qartë që ai vinte jo vetëm nga familje me prejardhje pellazge (paraardhësit e ilirëve), por edhe që emri i tij shqipërohet vetëm me shqipen e sotme dhe me asnjë gjuhë tjetër në botë, pavarësisht varianteve të ndryshme dhe pavarësisht se s'dihet se cila prej tyre është e saktë.

Etimologjikisht emri Aleksandër rrjedh nga gjuha shqipe që do të thotë: **Leka a në andër,** ose më ndryshe: **Leka është në ëndërr**, për shkak se ai kishte ëndërr pushtimin e botës. Lekë është baza e emrit Aleksandër, ndërsa Aleksandër është mbiemër i formuar nga një tog fjalësh shqipe. Më vonë, emri Aleksandër është greqizuar. Por, kurrsesi nuk i është humbur kuptimi që ka në gjuhën shqipe. Vlen të përmendet se në disa fshatra arbëreshe akoma ekziston toponimi Leksandër, që i përgjigjet mjaft mirë etimologjisë që përshkruam më sipër.

Një tjetër supozim për etimologjinë e emrit Aleksandër është: **A le si në andërr,** për shkak se nëna e tij, Myrtali (Olimbia)) shpeshherë kishte parë në ëndërr se do të sillte në këtë botë një djalë që do ta ndryshonte epokën.

***

Sipas disa studiuesve të huaj, Aleksandri i Madh quhej **Meriamun Aleksandri**. Këtë mendim studiuesit e mbështesin në një mbishkrim që është gjetur në Egjipt, ku thuhej në një citim "Meryamun setepenra Aleksandros" (Meriamuni i mbiquajtur Aleksandër). Kjo është dëshmi që tregon se emri Aleksandër është i mëvonshëm. Ose më mirë të themi që është llagap(përshkrim). Shpesh herë duhet të na punojë logjika e thjeshtë për të mësuar shumë të fshehta të njerëzve në kohën antike. Emri i pagëzimit të Aleksandrit ishte Meriamun, një emër që zbërthehet në gjuhën shqipe të dialektit gegë: MER-JAM-UN.

Sot, e gjithë popullsia shqiptare e Maqedonisë Veri-Perëndimore thonë: MER JAM UN, që në gjuhës standarde është: MIRË JAM UNË.

1. Po ta ndajmë emrin ALEKSANDËR në tre pjesë, do të lexojmë tri fjalë - A-LEKS-ANDËR, që do të thotë: **A** është fjala e sotme shqipe ËSHTË, LEKS është emri LEK dhe ANDRA është një fjalë e vjetër pellazgje që e përdorin grekët sot, dhe do të thotë BURRË. Pra, emrin ALEKSANDËR do të thotë: ***LEKA ËSHTË BURRË***. Dhe, me të vërtetë Leka ishte burrë i madh që mbeti në historinë e botës. Sot shqiptarët emrin Aleksandër e kanë në disa variante, si: ALEKS, SANDËR, LEKSANDËR, LEKË = **ALEKSANDËR**.

Shqiptarët që njihen në Itali me emrin arbëreshë dhe në Greqi me emrin arvanitas, në vend të emrit Aleksandër ata përdorin Leksandër. Duhet të dimë që në kohët e lashta njerëzit shpeshherë e humbnin emrin e pagëzimit dhe thirreshin me llagapet e tyre. Më vonë llagapet u bënë mbiemrat e familjeve.

2. Një variant tjetër mund të të jetë për zbërthimin e emrit Aleksandër dhe A-LEKS-ANDËR. Mundet që fjala ANDËR të ketë kuptimin e fjalës ËNDËRR. Pra, ***LEKA ËSHTË NË ËNDËRR***.

Ka mundësi që këtë llagap ta ketë marrë nga gjeneralët e tij kur Aleksandri deklaronte që do të pushtonte të tërë botën. Dhe, ata ndoshta mërmëritnin se LEKA ËSHTË NË ËNDËRR. Sot në Greqi ndodhet një ishull me emrin ANDRA. Gjatë një studimi të bërë në vitin 2001 për këtë ishull, është zbuluar se ky ishull banohej që në shekullin XII nga shqiptarët. Edhe sot ishulli Andra (ËNDRRA) banohet nga 90% e popullsisë që flet në familje gjuhën shqipe, pra nga shqiptarë që njihen me emrin ARVANITË. Ishulli ANDRA ka 27 fshatra shqipfolës, toponime, dhe mbiemrat e familjeve janë të kuptimit të gjuhës shqipe. Ndoshta llagapi ALEKSANDËR mundet të rrjedhi nga fjalët A + LEKA + ANDËR (A=Asht, pra: ASHT LEKA (NË) ANDËR(R).

3. Varianti i tretë i emrit Aleksandër ndoshta mund të zbërthehet në këtë formë:

A = Asht, LE = Lind, KS = Si, ANDER = Andër, që ka kuptimin: **Asht Le Si Andër**(gëgërisht) dhe **Është Lindur Si**

Ëndërr (toskërisht), do thotë se ***Meriamuni është i bukur si ëndërr, a le si andër e bukur, është lindur si një ëndërr e bukur***.

Kështu, tre variantet e kuptimit të emrit ALEKSANDËR na japin tre emra kuptimplotë:

1. A LEKA BURRË (ANDRO)=LEKA ËSHTË BURRË,

2. A LEKA NË ANDER=LEKA ËSHTË NË ËNDËRR dhe

3. A LE (K)SI ANDER=ËSHTË LINDUR SI ËNDËRR.

Cili nga këto tre variante është i vërteti? Apo, ekzistojnë dhe variante tjera?

Askush nuk mund të thotë me siguri të plotë, por që emri Aleksandër është me përmbajtje pellazgo-ilire dhe si rrjedhim i kësaj është emër shqiptar, këtë askush nuk mundet ta mohojë, as të huajt dhe as shqiptarët e luhatshëm e mendjelehtë.

5. Origjina ilire e Aleksandrit të Madh

Më lart kemi sjellë origjinat familjare të Filipit II dhe Olimpisë që vijnë nga fiset ilire. Filipi ishte djali i Euridikës, e cila vinte nga fisi ilir i Lynkestëve. Filipi ishte lindur nga një nënë ilire dhe Olimpia nënën dhe babain e kishte ilir. Pra, shkencërisht, Aleksandri i Madh është ilir (shqiptar), duke patur parasysh se logjika na shpie se nëna është ajo që përcakton babain e fëmijës. Aleksandri ishte djali i ilirit Filip, nipit të Lynkestëve dhe ilires Olimpia, bijë e fisit ilir të epirotëve.

Emri i pagëzimit të Aleksandrit ishte **Meriamun**, që zbërthehet me anë të dialektit gegë të gjuhës shqipe: **Mer+iam+un=MER-JAM-UN**. Sot shumica e popullit shqiptar në Maqedoni ende thonë: MEJR JAM UN, që në gjuhës standarde është: MIRË JAM UNË.

Aleksandri ishte mbajtës i Përkrenares Dybrirëshe të Cjapit, që e kishte traditë dhe trashëgim nga Kryeperëndia e Olimpit të pellazgëve - Zeusi. Më vonë këtë Përkrenare do ta mbante Pirro i Epirit dhe Gjergj Kastrioti-Skënderbeu.

Gjuha që u fliste Aleksandri miqve të tij ishte ilirishtja e dialektit gegë të Maqedonisë. Aleksandri greqishten e mësoi në rini nga Aristoteli.

Dijetari i lashtësisë, **Straboni** (63 p. e. s. – 19 p. e. s.) në serinë prej 17 vëllimesh, të quajtur "***Geographia***", në vëllimin VII shkruan: ***"Shqiptarët dhe maqedonët flasin të njëjtën gjuhë, kanë të njëjtat sjellje në zakonet e tyre, i presin flokët njësoj dhe kanë aq gjëra të tjera të përbashkëta, sa janë të shumtë ata që e kuptojnë Maqedoninë deri në Korfuz".***

Sir Ëilliam Ëoodthorpe Tarn i Akademisë Britanike njihet botërisht se ka shkruar veprën madhore mbi Aleksandrin (Lekën e Madh), të titulluar: **Ë. Ë. Tarn, "Alexander the Great", Beacon Press, Boston, 1966**. Në hyrjen e këtij libri shkruhet: ***"Aleksandri kishte nga babai (Filipi II) dhe e ëma e tij (Olimpia) gjak ilir, domethënë shqiptar. Filipi II thirri shqiptarin e famshëm Aristotel (384-322 p. e. s.), që kishte mësuar mënyrat e grekërve, për t'i dhënë dituri birit të tij, Lekës".***

Lou Giaffo shkruan: ***"Për të qenë të sigurt, ka pasur një numër të madh shqiptarësh që kanë hijeshuar faqet e historisë antike e moderne, por ata u kanë shërbyer kryesisht vendeve të tjera dhe këto vende i kanë përvetësuar si të tyret. Aleksandri i Madh, për shembull, ishte shqiptar puro nga ana e nënës (Olimpia ishte një princeshë epirote) dhe iu desh ta pushtonte Greqinë disa herë derisa grekët e pranuan si të vetin."***

Mary Edith Durham shkruan: "***Që nga fillimi që dimë gadishulli ishte i banuar nga trakët, maqedonët dhe ilirët, popuj të egër, jogrekë: një masë fisesh të egra të drejtuara nga prijës. Ata duket të kenë qenë ngusht afë me racë. Forma e të folurit të tyre është e panjohur. "Nëse trakët", thoshte Herodotus, "do të ishin nën qeverisjen e një individi të vetëm ose të bashkuar mes tyre, fuqia e tyre, sipas mendimit tim, do t'i bënte ata të pathyeshëm, por kjo është diçka e pamundur."***

Henry Fanshaëe Tozer shkruan: ***"Heronjtë historikë të Shqipërisë janë Aleksandri i Madh, Pirroja dhe Skënderbeu dhe në kohërat moderne, nëse është e lejueshme të përmendim një që në njëfarë mënyre ka lidhje me këta emra të mëdhen j- Ali Pashë Tepelena. E gjitha kjo është në mënyrë intersante në historinë e vendeve rreth tyre; pjesa tjetër është një seri pushtimesh të përkohshme dhe sulmesh barbare, efektet e të cilëve ishin***

kalimtare dhe nuk kanë influencuar në mënyrë të qëndrueshme as njerëzit vet e as racat fqinje. Aleksandri ishte i lidhur me Shqipërinë nëpërmjet nënës së tij, Olimpia, e cila ishte një princeshë epirote..."

George Gordon N. Byron pohon se: *"Aleksandri i Madh lindi në Pella të Maqedonisë, por afërsia e saj me Shqipërinë moderne dhe fakti që nëna e tij Olimpia i përkiste derës mbretërore të Epirit, janë një përligjje e mjaftueshme për pikëshikimin poetik ndaj tij, si të kishte lindur në Shqipëri".*

Ëadham Peacock, shkruan: *"Pak më vonë Aleksandri, mbreti i molosëve në jug të Shqipërisë, kreu një ekspeditë në Itali dhe në këtë mënyrë e vuri Romën në kontakt me brigjet e përtejme të Adriatikut. Të gjitha këto mbretëri të vogla ishin qartësisht ndarje të thjeshta të së njëjtës racë dhe ishin të lidhura ngusht me njëra-tjetrën. Motra e Aleksandrit, mbretit të molosëve, ishte nëna e Aleksandrit të Madh; burrat që marshuan në Babiloni, Persi e Indi ishin stërgjyshërit e shqiptarëve dhe Epiri e Iliria ndanë mes tyre konfuzionin që pasoi nga vdekja e pushtuesit të madh, i cili e kishte deklaruar veten si shqiptar, madje me një drejtësi të lartë. Pirro, mbreti luftëtar i Epirit, ishte padyshim një shqiptar dhe rreth 60 vjet pas vdekjes së tij, Agroni u shfaq nga pështjellimi si mbret i mbretërisë së Bardhylit dhe gjithashtu të Epirit. Si kushëriri i tij, Aleksandri i Madh, ai ishte një luftëtar i klasit të parë dhe po ashtu si ai, ai vdiq pas një dehjeje të rëndë, duke lënë një vejushë, Teutën, e cila ishte një grua me forcë të madhe karakteri."*

George Fred Ëilliams shkruan: *"Nuk është çudi nëse njerëzit që kanë studiuar gjuhën shqipe, të thonë se kjo është gjuha origjnale e Homerit dhe që grekët e morën nga poetët pellazgjikë të shumtën e këngëve të trimërive dhe ato heroike. Sa dituri e madhe e pret arkeologun kur toka Shqiptare do të hapë thesarin e historisë pellzagjike! Këta dhe shumë rrjedhime të tjera provojnë që shqiptarët sot janë mbi tokën e të parëve dhe flasin gjuhën e stërgjyshëve të tyre. Edhe përpara se dega helene të njihej në malet e Thesalisë, Shkodra, qyteti kryesor i Shqipërisë, qe pa dyshim kryeqyteti i mbretërisë madhështore të Ilirisë. Shqipja qe gjuha amtare e Aleksandrit të Madh që pushtoi botën*

dhe e Pirros së Epirit, një nga gjeneralët më të mëdhenj që përmend historia dhe përballues i fundit i ushtrive pushtuese romake."

Fletcher Pratt, shkruan: *"...grekët shpesh i mohuan atij emërtimin si grek dhe ai ishte gjithmonë i ndërgjegjshëm për gjakun ilir; tashmë në interes të kulturës greke ai kishte përmbysur armiqtë e Greqisë dhe fitoi perandorinë e gjithë botës që njihej. Zeus-Amon ishte zoti i diellit; gjithçka i ishte kushtuar shkëlqimit të tij dhe Aleksandri e konceptoi si detyrë që t'ua shpinte të gjithëve."*

Rebeca Ëest shkruan: *"Aleksandri i Madh kishte princeshë ilire për gjyshe e për nënë dhe, ai e babi i tij luftuan në beteja të mëdha kundër vendit të tyre....Iliria e mbajti kokën lart ndërmjet fuqive lindore me të cilat Roma nuk u barazua kurrë në finesë dhe shkëlqim; Aleksandri i Madh, krah të cilit çdo roman duket një mediokër, ishte në tre të katërtat e tij një ilir; dhe pasi ilirët u pushtuan, ata prodhuan shumë burra, të cilët ndërhyrë në punët e Romës dhe bënë që të duken të vegjël të gjithë bashkëmoshatarët me vendlindje Italinë."*

Leëis Vance Cummings shkruan: *"Legjitimiteti i Aleksandrit u vu në dyshim nga Filipi dhe atje kishte edhe shumë shovinistë në atë tokë që e qesëndisnin si biri i Olimpias, një gjysmëbarbar, duke shpërfillur se u vinte për mbarë të thonin se edhe Filipi vet dhe dy mbretër para tij ishin gjithashtu bij grashë ilire."*

Konrad Bercovici, shkruan: *"Është më shumë se e mundur se Aleksandri i Maqedonisë ishte me origjinë shqiptare."*

George H Blakeslee dhe G. Stanley Hall, shkruajnë: *"Shqiptarët kanë një histori heroike, por të pakumtuar* (të pa zbuluar, të pashpallur). *Ata i kanë dhënë botës Aleksandrin e Madh dhe Krispin, kryeministrin e parë të Italisë. Të dy këta burra janë me origjinë shqiptare. Heroi kombëtar i madh, megjithatë është Skënderbeu, i cili në shekullin XV shkatërroi ushtritë turke që pushtuan Shqipërinë. Përgjatë kohës që ai jetoi, Shqipëria ishte e pavarur. Por pas vdekjes së tij, Turqia ristabilizoi sundimin e saj shtypës dhe me përjashtim të një Ilirie të pjesëshme në Shqipërinë jugore siguruar në shek. XVIII*

nga Ali Pashë Tepelena, shqiptarët vazhduan të ekzistonin nën sundimin e sulltanit".

Edhe pse të dhënat për Aleksandrin e Maqedonisë janë filtruar prej bizantinëve, megjithatë, nëse Leka i Madh do të ishte grek, atëherë atij do t'i kishte ngelur emri "Aleksandri i Greqisë", e jo Aleksandri i Maqedonisë.

6.Aleksandri i Madh - grek ose ilir?

Si mbrohet historia mbi 4000-vjeçare, kur vet koncepti i historisë nuk ekziston? Si e mbron një komb historinë e tij, kur civilizime të ndryshme vënë dorë në esencën e jetës së këtij kombi dhe secili prej tyre përpiqet të lërë një shenjë në atë zonë te njerëzimit? Mos, vallë, e shkruan në guri? Sigurisht, por pllakat e gurit thyhen kur kështjellat bien. Mos, vallë e shkruan në letër? Sigurisht, por letrat digjen kur bibliotekat digjen. Pra, si e ruan? Përgjigjja është në gjuhën e kombit.

Çdo fjalë e një gjuhe, ashtu si çdo mbiemër i një njeriu, tregon një histori. Dhe do jetë ndërmjet gjuhës, asaj të ilirëve dhe shqiptarëve të sotëm, që unë do të shpjegoj pse Alesandri i Madh është pellazgo-ilir. Ilirët për shqiptarët janë si romakët për italianët. Ishte një kohë kur burrat ishin burra dhe kur nderi dhe e vërtata mbizotëronin. Ishte koha kur historia, që vjen nga fjala latine "eis storia" dhe që në shqip do të thotë "përralla e tij", bazohej në ngjarje të vërteta dhe jo në "përrallën e tij".

Për të treguar që Alesandri i Madh është ilir, do të shpjegoj se çfarë do të thotë emri **macedon**, çfarë do të thotë emri i kryeqytetit të macedonëve të lashtë, çfarë do të thotë emri i mbretit Filip dhe pse e mori këtë emër. Gjithashtu do të shpjegoj se çfarë do të thotë Dielli në flamurin e Mbretërisë së Macedonëve dhe në fund, çfarë do të thotë emri i Aleksandrit të Madh.

Ç' kuptim ka fjala macedon?

Një romak do ta shqiptonte fjalën mazedon si macedon.

Kështu ngjan, sepse "z" pas një zanoreje në italisht shqiptohet si "c" në shqip. Këtë e shohim në gjuhën italiane sot, te fjalët *zio* ose *zia*, të cilat në shqip do të tingëllonin si *cio* ose *cia*. Kur romakët latinizuan çdo pjesë të perandorisë, ato u munduan në pjesën më të madhe të ruanin tingullin e fjalëve dhe, kuptohet që shtuan edhe prapashtesat *"nia", "ia"* ose *"ian"* në fund të emrit të çdo vendi. Arsyeja që unë po përdor Romën dhe latinishten si pikënisje, është sepse hartat e toponimet që ne kemi sot, janë hartuar ose të paktën mbijetojnë ato që janë hartuar, gjatë Perandorisë Romake.

Macedon është i vetmi emër në rajon që është ruajtur që nga kohët ilire dhe është emër i pandryshuar i zonës. Le të shikojmë se ç' do të thotë mazedon në shqip.

Nëse e ndajmë fjalën mazedon në ***Maz – e – don***, është e lehtë të shikojmë që bëhet fjalë për ***Mazin*** – pjellën e pelës. Maz është në dialektin gegë. Në dialektin tosk maz është ***Mëz***. Pjesa tjetër e fjalës është ***"e don"*** , me theksin te o-ja. E don në shqipen e sotme letrare është ***"e tonë",*** pra përemri pronor veta e tretë, numri shumës. Kështu, kuptimi i plotë i emrit të macedonëve të lashtë në shqip është ***"Mazat tonë"*** (Maz e Don).

Nëse pyesim një grek se çfarë është etimologjia e emrit macedon (etimologjia është kuptimi ose rrënja e një fjale), ato japin përgjigje të tillë: Fjala është ne greqisht, që e përkthyer në shqip do të thotë ***"Malësorët"*** ose ***"Të gjatët".***

Kjo mund të vërtetohet te fjalori etimologjik në internet (ëëë.etymonline.com) dhe duke kërkuar për macedon. Këtu shihet që grekët e përdorin këtë si përshkrim i paraqitjes së këtyre njerëzve. Në një farë mënyre na jep të kuptojmë që macedonët ishin ndryshe nga grekët, pasi kishin tipare fiziko-kulturore dhe gjeografike të ndryshme nga grekët. Ja pse Macedonët quhen malësorë.

Sipas librit në anglisht te Ëheeler, Benjamin Ide, 1854, botuar në Neë York, në vitin 1900 nga G.P. Putnam's sons, me titull - "Alexander the Great; the merging of East and Ëest in universal history", në faqen 171, paragrafi i dytë, tregon që: "…vargje malore të mëdha ndajnë Ilirinë nga Thesalia." Kjo

tregon që në sytë e grekëve macedonët vinin nga malet, d.m.th. Iliria. Ja ç' thotë autori përsëri rreth organizimit të shoqerisë macedone. Këto të dhëna merren nga i njëjti libër në faqen 9, paragrafi i dytë, rreshti 16: "Shteti (macedon) përbëhej nga grupe familjare dhe fise të pandara në klasa dhe rengje (shoqërore). Mbretërimi (prirja ose udhëheqja) i takonte gjithmonë një dhe të njëjtës familje(shtëpi), por rregulla të përhershme dhe të qarta trashëgimie brenda familjes nuk ishin plotësisht të themeluara. Mosha nuk ishte e mjaftueshme për të vendosur zgjedhjen midis princave. Në rrëmujën që pothuajse gjithmonë vinte pas vdekjes së një mbreti, ishin forca, sfidimi, dhe aftësitë udhëheqëse, ato që pohonin të drejtën natyrore të mbretërimit."A nuk janë këto rregullat dhe zakonet kanunore tona rreth shtepisë së nderit të një fshati? Kuptohet që rregullat kanunore, që kemi sot, janë më të evoluara.

Çfarë do të thotë emri
i kryeqytetit të macedonëve të lashtë?

Në Greqinë Veriore, në lindje të Çamërisë, ndodhet krahina me emrin Macedoni. Kryeqyteti i saj quhet Pela. Kuptimi i fjalës është shumë i lehtë, sepse është në shqip, ku pela është kali femër, nëna e mazit. Në hartat e sotme, Pela shkruhet "Pella, e cila, nëse lexohet në Italisht, tingëllon si Pela. Para se të shkojmë te pika tjetër, do të doja të ju informoja që mbretëria e lashtë e macedonëve shtrihej nga Gadishulli i Moresë ose Peloponezi i sotem, nëpër Selanik dhe shkonte deri në Mat, i cili në lashtësi quhej Emadhia – E madhia. Gjurmë të emrave të qyteteve shqip që ekzistojnë akoma në krahinën Macedonia në Greqi janë, si p.sh. Veria që në Shqip është Veriu, Pieria, që në Shqip është Pjerrësia, qytet i cili ndodhet afër malit të Olimpit dhe pranë detit.

Ç'do të thotë emri i mbretit Filip?

Babai i Alesandrit dhe mbreti i macedonëve të lashtë quhej Filipi II. Megjithëse emri Filip është shumë i përhapur në

Shqipëri dhe në botë, ai është në greqisht. Emri përbëhet nga dy rrënjë: Phil (Fil) dhe Hippos (hip), që nga greqishtja në shqip do të thotë: *shok* ose *i dashur i kuajve*. Përsëri kjo duket si përshkrim ose një nofkë më shumë, se sa një emër.

Grekët përshkruanin të huajt në bazë të veprimeve që bënin ose nga mënyra se si dukeshin. Mund ta shohim këtë në "Iliadën" e Homerit, kur autori i referohet Hektorit, që nga greqishtja në shqip do të thotë *mbrojtës*. Hektor nuk është emër, por përshkrim. Hektori ishte ai që mbronte Trojën gjatë lufës në "Iliadën" e Homerit. Përshkrimin mund ta shikojmë edhe kur grekët u referohen macedonëve si malësorët apo të gjatët.

Fakti që babai i Aleksandrit ishte Filipi II, tregon që kishte një Filip tjetër përpara tij, i cili ose ka themeluar mbretërinë e macedonëve, ose ka qenë i pari që ka kontaktuar grekët. Arsyen që mbretit të macedonëve iu dha nofka Filip (adhurues i kuajve) e gjejmë tek emri në shqip i mbretërisë Maz e Don dhe emri në shqip i kryeqytetit Pela. Dyshime që Filipi II(babai i Alesandrit) nuk ishte gjak grek, ka pasur edhe në lashtësi, kur ai hasi në pengesa për të marrë pjesë në lojërat olimpike që zhvilloheshin atëherë. Vetëm grekët mund të merrnin pjesë në to. Pyetja që lind, duke patur parasysh këto të dhëna, është: Nëse emri Filip ishte një nofkë, cili ishte emri që iu dha mbretit të macedonëve(babait të Alesandrit) në lindje?

Çfarë do të thotë Dielli i Macedonëve?

Ilirët kishin dy kulte: atë të Diellit në veri dhe atë të gjarprit në jug. Dielli quhej Hyllis dhe përfaqësonte përjetësinë. Fjala Hyllis ka ndryshuar me kohën si Hylli dhe në shqipen e sotme ne e gjejmë atë si Ylli.

Çfarë do të thotë Aleksandër?

Ta ndajmë fjalën në këtë mënyrë: A - le -k s – andër. A-ja është një shkurtim i fjalës "Asht/Është" në dialektin gegë. Le (e-ja e zgjatur) përsëri në dialektin gegë, do të thotë "lindur". S –ja

është një shkurtim i fjalës "si" dhe në fund Andër është "Andërr" në gegërisht ose "Ëndërr" në toskërisht. Kështu që emri Aleksander në shqip do të thotë ***"A le si andërr"*** ose në gjuhën letrare - ***" Është lindur si ëndërr"***.

Besohet që Olimpia, nëna e Alesandrit të Madh, ëdërroi një ëndërr kur konsumoi martesën me Filipin II(babain e Alesandrit). Ëndrra ishte që një rrufe ra në barkun e saj.

Ne ndeshemi me emrin Alesandër në një vend tjetër të histories, tek "Iliada" e Homerit. Homeri i referohet Paridit në "Iliadë" me emrin Aleksandër. Pse emrin Aleksandër për Paridin? Sepse Hekuba, nëna e Hektorit dhe e Paridit, gruaja e Priamit dhe mbretëresha e Trojës, sikurse Olimpia, nëna e Aleksandrit të Madh, përjetoi një ëndërr. Ëndrra ishte që Paridi do të sillte shkatërrimin e Trojeve të Ilionit. Siç e shikojmë, të dy mbretëreshat vendosën emrat e çunave të tyre nga ëndrrat që kishin parë dhe fakti që të dyjat i quajtën me të njëjtin emër, tregon që ato flisnin të njëjtën gjuhë – shqip ose ilirisht në atë kohë. "Iliada" është tregim rreth trojeve të Ilionit. Ilioni ishte koloni ilire në Azinë e Vogël. Emrat e personazheve të trojeve të Ilionit, që Homeri i përshkruan në "Iliadë", janë tituj shoqërorë në shqip dhe jo emra, siç beson Homeri. Për të mbuluar "Iliadën", duhet një shkrim tjetër, pasi sasia e të dhënave është e madhe.

Nëse pyesim grekët, çfarë do të thotë emri Aleksandër, ato e shpjegojnë kështu: Aleksander përbëhet nga dy rrënjë fjalësh greke - Alexos dhe Ander, që në shqip do të thotë mbrojtës i njerëzve. Përsëri grekët i referohen më shumë një përshkrimi ose titulli, më shumë se një emri. Siç thashë me lart, grekët i përshkruanin të huajt nga veprimet që bënin, siç është rasti me Filipin, me macedonët dhe Hektorin. Fakti që ka pasur një "X" të vendosur te emri i Alesandrit (X tingëllon si KS në shqip), sinjalizon një tentativë për të greqizuar emrin. Në fund të fundit Aleksandri nuk njihet në histori për mbrojtje, por për sulm. Ai pushtoi Greqinë, Persinë dhe gjithë botën e njohur nga njeriu në atë kohë. Një diçka të fundit që dua të sqaroj është Deti Jon. Në hartat ndërkombëtare shkruhet Ion dhe ka prapashtesën latine

"ian", që del Ionian. Në shqip i-ja pas një zanoreje shqiptohet si j. Det Ion do të thotë Deti i jonë. Pyetja që shtroj unë, është: Kur është futur "J"-ja si bashkëtingëllore në alfabetin shqip? Kjo është për gjuhëtarët e shqipes të përgjigjen.

Siç e shikojmë, mbretëria (Mac e don) dhe deti (deti Ion) kanë përemra pronorë. Kjo sinjalizon dy gjëra: Një, që kjo ka qenë mënyra e emërtimit të cilën e kemi akoma dhe sot; ose dy, që ka pasur tentativa për aneksimin e këtyre trojeve që në kohën e Aleksandrit të Madh. Është interesante se si është quajtur edhe emri i kolonisë në trojet e Azisë së Vogël – Ilion – që mund të ndahet në Ili Ion, përsëri me përemër pronor. Mbase Ili do te thotë Ylli dhe emri i kolonisë do të nënkuptonte: Ylli i Jonë. Ylli është kulti i Diellit që simbolizon përjetësinë.

Gjuha hqipe si hartë e historisë ilire

Duhet pasur shumë kujdes me gjuhën shqipe, pasi ajo mund të na ndihmojë shumë në përkthimin dhe kuptimin e historisë ilire. Nuk është kjo e rëndësishme thjesht për të treguar lavdinë e ilirëve, por është më së shumti për të siguruar ardhmërinë e kombit, të identitetit shqiptar dhe të gjuhës shqipe. Nuk e kuptoj pse duhet të ndryshojnë rregullat e drejtshkrimit të gjuhës amë dy herë brenda një brezi. Shqipja si gjuhë nuk ka ndryshuar aq shumë, sa të ketë nevojë për rishikim të rregullave drejtshkrimore të saj. Nëse këto rregulla ndryshojnë, atëherë shqiptarëve dhe femijëve të tyre që jetojnë jashtë kufijve të atdheut do t'u duhet të mësojnë edhe njëherë drejtshkrimin. Nuk dihen efektet që këto ndryshime do të kenë në të ardhmen e gjuhës. Nëse vazhdojmë të ndryshojmë rregullat pa kriter dhe pa nevojë, atëherë ne rrezikojmë humbjen njëherë dhe përgjithmonë të gjurmëve historike ilire në shqipen e sotme.

Nuk mendoj që është e rëndësishme të ndryshohen rregullat e drejtshkrimit të shqipes letrare, por e rëndësishme është që të dokumentohen qartësisht rregullat e dialekteve gege, toske, arbëreshe e arvanitase. Vetëm kështu ne mund të kuptojmë efektin që ka pasur koha te gjuha amë dhe të krijojmë

një ide rreth nevojave të rregullave drejtshkrimore në të ardhmen.

7. Kali i Lekës – BUKEFALI

Kalorësia e stratiotëve u quajt Kalorësia e Shqiptarëve të Venecias, ndërsa Filipi II i Maqedonisë organizoi një ushtri të fuqishme duke krijuar falangën, si peshën më të rëndë të këmbësorisë dhe duke disiplinuar kalorësinë e trupat e tjera ndihmëse. Aleksandri i madh përdorimin e kavalerisë (kalorësisë) e mësoi nga fiset ilire, ndërsa këta të fundit e simbolizuan për njeriun bukurinë, hijeshinë dhe fuqinë që kalorësit e tyre e ndjejnë në shpirtin që gulçon. Ashtu si gozhdët që fiksuan patkonjtë, patkonjtë që shpëtuan kuajt, kuajt që shpëtuan kalorësit dhe ata që shpëtuan mbretëritë për shekuj me radhë, shqiptarët do të trashëgonin kaherë gjenet e të parëve të tyre. Madje, në kohën e Kanunit të Lek Dukagjinit, "jeta e një gruaje u arrit të shkëmbehej me një kalë".

Sipas **Princit Filip**: ***"...kuajt dhe qentë njihen si bashkudhëtarët më besnikë, që nga fillesa e historisë, por kuajt sigurisht që kanë qenë më të vlefshëm".***

Dikur një thesaliot solli për të shitur te Filipi një kalë, Bukefalin. Atëherë të gjithë zbritën në fushë për të provuar kalin, por ai dukej i egër dhe i pafre. Filipi u zemërua dhe dha urdhër të mos e blinin. Aleksandri, që ishte aty pranë, thirri: "Çfarë kali të mrekullueshëm humbin nga frika". Filipi e qortoi se me fjalët e tij u jepte mësime të rriturve. Aleksandri me këmbëngulje kërkoi që ta provonte vet, duke thënë se po të mos mundte ta zbuste kalin, do të paguante vlerën e tij.

Bukefali egërsohej kur shikonte hijen e vet. Prandaj, Aleksandri e ktheu kalin nga dielli, që të mos shikonte hijen e vet e të harbohej. Dhe, pasi e përkëdheli me dorë, flaku pelerinën e tij dhe duke kërcyer qëndroi mbi të vendosmërisht. Kali u qetësua dhe Aleksandri, pasi liroi frerët, e la të vraponte. Filipi II,

i përlotur nga gëzimi, e puthi Aleksandrin dhe i tha: ***"Biri im, të kërkosh një mbretëri të denjë, se Maqedonia nuk të nxë".***

Bukefal, na del emër shqip, sipas mënyrës së evoluimit të fjalëve ilire në gjuhën shqipe. Në këtë rast krahasojmë BUKEFAL dhe MAKEDON. Makedon ka kuptimin "i madh", më saktë "makedhe" ka evoluar duke iu hequr tingujt -ke, duke mbetur vetëm "madhe". Edhe Bukefal, ka pësuar të njëjtin shndërrim, duke iu hequr tingujt **-ke**, mbetet **bufal**, që pas një shndërrimi përfundimtar, ka dhënë fjalën **"buall".** Kali i Aleksandrit duhet të jetë quajtur **Bukefal=Buall**, ose për shkak të madhësisë ose për shkak të egërsisë që kishte shfaqur kur donin ta zbusnin.

8. Urtësi e dialogje të Aleksandrit të Madh

Plaga që të kujton lavdinë

Babai i Aleksandrit, Filipi II i Maqedonisë, po ankohej për një plagë që kishte marrë në luftë. Nga që kishte dhimbje të mëdha, ecte duke aluar. Aleksandri atëherë i tha: "Baba, nuk duhet të dëshprohesh nga kjo plagë që në çdo hap të kujton trimërinë dhe lavdinë tënde.

Plaçkitësit e arit

Aleksandri i Madh qëndronte jashtë çadrës së tij, teksa flakët e mëdha dhe tymi lartoheshin mbi Tebën e mundur, kur një çast disa ushtarë trakas të ushtrisë së tij i sollën përpara një robinjë thebane.

- Çfarë ka bërë kjo, që e sollët tek unë?

- Hymë në shtëpinë e saj, - u përgjigj njëri ushtar, - dhe prijësi i njësitit tonë i kërkoi të na jepte arin që kishte fshehur. Ajo e drejtoi deri te pusi dhe ndërkohë e shtyu dhe e hodhi brenda! Prandaj t'a sollëm që ta ndëshkosh.

Aleksandri pyeti gruan:

- Cila je?

- Më quajnë Timoklea dhe jam motra e gjeneralit Teagen, që luftoi kundër atit tënd në Keronia dhe ra i goditur nga

maqedonët. Aleksandri u dha urdhër ushtarëve që t'a linin të lirë atë dhe fëmijët e saj.

Zemërimi i Lekës së Madh për të ëmën

Kur Filipi, mbreti i Maqedonisë, u nda nga gruaja e tij Olimpia, nëna e Lekës, djaloshi u hidhërua pa masë. Megjithatë, ai mori pjesë në dasmën e të atit. Gjatë ceremonisë e ahengut Atala, i pëlqyeri i Filipit, ngriti një dolli për çiftin, duke uruar që princesha t'i jepte shpejt mbretit një trashëgimtar për fronin. Leka atëherë nuk u përmbajt më, u ngrit në këmbë si i tërbuar dhe iu drejtua Atalës duke i thënë:

- Dhe mua më merr ndoshta për bastard?

Pastaj me sa fuqi që kishte ia kërciti Atalës me gotë në kokë. Filipi, që ishte çakërrqejf dhe që nuk e kuptoi mirë si ndodhi grindja, mendoi se i gjithë faji ishte i të birit, ndaj u lëshua kundër tij me shpatën zhveshur, por rrëshqiti dhe u rrëzua. Aleksandri atëherë qeshi dhe u tha të pranishmëve:

- Vështroni maqedonë, çfarë udhëheqësi keni për fushatën tuaj në Azi, që nuk është i zoti të bëjë një hap pa u rrëzuar përtokë.

Përgjigja e Aristotelit

Përpara se të nisej për në Azi, Aristoteli i tha Aleksandrit të Madh që të priste për këtë ekspeditë sa të arrinte një moshë më të rritur. Ashtu, ai do të luftonte me më pjekuri.

- Kjo është e vërtetë, por nuk duhet harruar se në të njëjtën kohë do të humbisja vrullin rinor.

Aleksandri do të bëhet i madh

Aleksandri në një takim me të dërguarit e Persisë deshi të mësonte jo për pasurinë dhe jetën luksoze që bënte mbreti i tyre, por për qëndrimin që mbante dhe për forcat e tij ushtarake. Të dërguarit e Darit i thanë mbretit të tyre kur u kthyen:

- Ju jeni i pasur, por Aleksandri do të bëhet i madh.

Ujku nuk trembet nga madhështia e kopesë

Kur i thanë Aleksandrit të Madh se mbreti i Persisë, Dari, ishte duke përgatitur një ushtri shumë të madhe, ai u përgjegj:

Ujku nuk e vret mendjen fare për të ditur nëse është apo nuk është e madhe kopeja që do të sulmojë.

Ju merreni pasurinë, unë mbaj shpresën

Kur nisi fushatën e Azisë, Aleksandri ua shpërndau gjithë pasurinë kapedanëve të ushtrisë së tij.

Por, për vete çfarë mbajte? – pyeti njëri prej tyre.

Shpresën, - u përgjegj Aleksandri.

Unë jam mbret, nuk jam tregtar

Përpara Betejës së Arbelës, Dari i bëri të ditur Aleksandrit se, po të pranonte miqësinë me të, do t'i dhuronte gjysmën e mbretërisë së tij. Aleksandri e pyeti tregtarin Parmenion, që e mori vesh ofertën, se çfarë mendonte.

- Në qoftë se do të isha Aleksandër, do të pranoja, - tha Parmenioni.

- Edhe unë, - tha Aleksandri, - do të pranoja, në qoftë se do të isha Parmenion.

Por unë jam mbret, nuk jam tregtar.

Gjumi i qetë i Aleksandrit

Dari kishte mbledhur gjithë ushtrinë e tij pranë qytetit Arbela. Natën para betejës Aleksandri bëri gjumë të thellë dhe në mëngjes gjeneralët mezi e zgjuan. Ndërkohë trupat persiane po afroheshin në kampin maqedon.

- Po si është e mundur, - i thanë, - që ti të flesh kaq i shkujdesur?

- Sepse më qetësoi shumë mbreti Dar, duke mbledhur të gjithë trupat në një pikë. Kështu vetëm me një betejë mund t'i shkatërroj krejt.

Fitimi i fitores

Gjenerali Polisperkonte e këshilloi Aleksandrin ta sulmonte Darin gjatë natës, sepse kështu do ta gjente në befasi dhe do ta shkatërronte lehtë.

- Nuk e kam zakon që t'i vjedhë fitoret natën si hajdutët, - i tha Aleksandri.

Beteja e denjë e Aleksandrit

Kur Aleksandri donte ta kalonte lumin Idapse, iu mblodhën të gjitha rreziqet: një furtunë e tmerrshme me bubullima e rrufe, lumi tejpërtej i mbushur me ujë, ushtria e armikut e vendosur në pozicione dhe e pajisur me elefantë e mjete të tjera. Aleksandri, i qetë dhe i kthjellët tha:

- Ja, më në fund, një betejë e denjë për mua.

Emri i ushtarit të Aleksandrit

Aleksandri e mori vesh se njëri prej ushtarëve kishte marrë emrin e tij. E thirri dhe i tha:

- Ti do të mbash emrin tim? Mbaje mbasi të pëlqen, por mos harro se edhe në beteja e ke emrin Aleksandër.

Shpërblimi i Aleksandrit

Një ditë Aleksandri i Madh, për të shpërblyer filozofin Ksenokrat, që e admironte, deshi t'i dhuronte njëqin dmijë lira. Por, filozofi i prekur në sedër, nuk pranoi. Aleksandri i Madh e kuptoi se shkaku i mospranimit ishte kryelartësia e krenaria e filozofit dhe, duke u treguar këtë radhë më shumë filozof se filozofi, i tha:

- Po si nuk ke ndonjë mik që të ketë nevojë për këtë shumë parash. Mua nuk më mjaftojnë thesaret për të shpërblyer miqtë e mi, kurse ti nuk di si të shpërndash midis miqve të tu vetëm njëqind mijë lira?

Nderimi për Aristotelin

E pyetën njëherë Aleksandrin se përse nderonte më shumë Aristotelin, mësuesin e tij, se sa babain e vet. - Sepse, - u përgjegj

Aleksandri, - mbreti Filip, duke më dhënë jetën, më zbriti nga qielli në tokë, ndërsa Aristoteli me mësimet e tij, më bëri të ngjitem nga toka në qiell.

Djaloshi dhe vajza e bukur

Një i ri maqedonas kishte sjellë në ballo një vajzë shumë të bukur. Aleksandri që ishte i pranishëm e vështroi dhe deshi ta bënte të veten. Kur mori vesh se djaloshi që i rrinte pranë e dashuronte shumë dhe do të martohej me të, e mori më një anë dhe i tha:

- Meqenëse e do kaq shumë këtë vajzë, merre dhe ikë shpejt bashkë me të për t'i shpëtuar çdo rreziku.

Grabitjet e piratit

Kur Aleksandri i Madh po qortonte një pirat për grabitjet që kishte bërë, ai iu përgjegj:

- Jam pirat, sepse kam vetëm një anije. Po të kisha shumë, do të isha mbret.

Aleksandri i Madh dhe Diogjeni

Aleksandri u ndodh njëherë në Athinë, ku donte ta takonte Diogjenin. Shkoi për të vizituar filozofin e futur në fuçinë e tij. Kur po qëndronte përballë, Aleksandri e pyeti se ç'mund të bënte për të.

- Të mos më zësh më diellin, - i tha i indinjuar filozofi.

Nga kjo përgjigje e pasjellshme Aleksandri nuk u zemërua, por gjithë admirim i tha:

- Në qoftë se unë nuk do të isha Aleksandër, do të doja të isha Diogjen.

Parashikimi i Aleksandrit

Para se të vdiste, Aleksandri tha:

- Po i lë perandorisë sime më të merituarit, por parashikoj që miqtë e mi do të bëjnë nderimet e fundit me armë në dorë kundër njëri-tjetrit.

Thesaret e Aleksandrit

Kur Aleksandri ishte duke vdekur, njerëzit e familjes e pyetën se ku i kishte fshehur thesaret e tij. Aleksandri u përgjegj:

Do t'i gjeni në kuletat e miqve të mi.

9. I kujt është Leka i Madh?

Historiografia greke është mbushur me plot "dëshmi" gjoja se Aleksandri është grek dhe gjenerata me radhë grekësh janë indoktrinuar me këto dëshmi false. Shkenca historiografike këto dëshmi që heret i ka hedhur poshtë si jo të qëndrueshme, por historiografia zyrtare greke me kokëfortësi e mban si për të vetin. Por, çuditërisht, nuk janë të vetëm grekët dhe sllavomaqedonasit e sotëm që i dalin zot Lekës së Madh, duke këmbëngulur me të gjitha llojet e intrigave e pseudofakteve që ta përvetësojnë Lekën tonë të Madh të Maqedonisë - Makedhonisë antike pellazgo-ilire.

Në gojëdhënat **izraelite** Aleksandri i Madh i Maqedonisë paraqitet si Mbret(Mesi) Shpëtimtar, i cili i paska takuar fisit të Davidit. Populli **persian(iranian)** gjithashtu, në gojëdhënat e tij e paraqet Aleksandrin si sundimtarin me prejardhje perse(raniane). Edhe **egjiptianët** Aleksandrin e Madh e konsideronin të vetin, me të vetmin arsyetim se ka qenë bir i natyrshëm i Faraonit. **Fiset arabe** i kanë ruajtur kujtimet e tyre për Mbretërinë e Maqedonisë, duke pohuar se Aleksandri ka qenë trim i shenjtë i islamit. Ndërkaq, **etiopianët** bëjnë një çudi të vërtetë me figurën e Aleksandërit të Madh, duke e paraqitur atë si shenjtor, apostull të krishterë, të birin e Filipit të përvuajtur.

Dje, sot dhe nesër, përherë e përjetë shqiptarët e kanë pasur, e kanë dhe do ta kenë për nder e krenari, për mburrje e lavdi që të thonë se janë nip-stërnipërit e Lekës së Madhe të Maqedonisë pellazgo-ilire. Shqiptarët e sotëm kanë dhe do të kenë të drejtë të ligjshme që kurdoherë dhe kudo t'i thonë vetes: ***Jam maqedon,*** sepse kjo është e njëjtë si t'i thonë vetes se jam epirotas, molos, taulant, ardian, dardan, labeat, liburn, trakas -

pellazg, ilir, arbër, sepse maqedonët antikë s'kanë qenë dhe s'janë gjë tjetër pos ***vëllezërit tanë shqiptarë,*** një fis ilir nga **trungu** i përbashkët, ai pellazg nga **rrënja** e **nëna** e përbashkët – Pellazgjia.

Ata janë ne, ne jemi ata.

III. BETEJAT E ALEKSANDRIT TË MADH

HYRJE

Aleksandri vendosi të vinte në jetë planin e të atit për pushtimin e Azisë. Për këtë i hodhi sytë perandorisë më të madhe të kohës, Persisë. Kaloi në Azi me ushtri të vogël, por më e stërvitura e kohës. Pushtoi së pari qytet-shtetet e Azisë së Vogël, së bashku me Egjiptin. Më pas u përball me Persinë, me mbretin Dari III në tri përleshje. E para u bë në vitin 334 para epokës sonë në Granik kundër një ushtrie dy herë më e madhe në numër. E dyta në Issos në vitin 331, pra dy vjet më vonë, ku ushtria persiane kishte 250 mijë ushtarë, ndaj 40 mijë trupave maedonase. E treta ishte në Guagamelë (Arbelë, Arbil) në vitin 329 p.e.s.

Në të tri përleshjet Aleksandri pati tri fitore të jashtëzakonshme. Perandoria më e madhe e kohës u rrëzua nga një burrë i vetëm. Pas pushtimit të Persisë, Aleksandri u drejtua edhe më në Lindje, drejt Indisë, në kërkim të fundit të botës. Një pjesë e ushtarëve mbetën në ato vise dhe pasardhësit, ndonëse kanë kaluar 24 shekuj, krenohen me atdheun e tyre të parë.

Pushtoi edhe shumë vise në Indi dhe Azinë Qëndrore, por nuk arriti të realizonte ëndrrën e tij dhe u detyrua të tërhiqet. Kjo për arsye se ushtarët e tij u lodhën nga 8 vite lufte të pandërprerë dhe filluan të shprehin pakënaqësi e mosbindje. Për t'i dënuar ushtarët, Aleksandri zgjodhi kthimin më të vështirë, ndaj një pjesë e tyre vdiqën rrugës. Asnjë ushtri në botë nuk kishte vuajtur kaq shumë gjatë tërheqjes, përveç asaj të Napoleonit gjatë kthimit nga Rusia më 1812.

Aleksandri i Madh ka mbetur në kujtesë me rininë e përhershme, si Akili, idhulli i tij. Burrat që kanë bërë historinë në vitet e mëvonshme si: Pirroja i Epirit, Napoleoni e shumë të tjerë, e patën Aleksandrin shembull të tyre. Deri më sot vlerësohet si njeriu që ka patur pasurinë më të madhe të botës. Ai shkeli tre kontinente dhe, pasi u kthye nga India, kishte ëndërr që të bashkonte Evropën, Azinë dhe pjesën veriore të Afrikës në një shtet të vetëm. Në të gjithë botën që ai shkeli ndërtoj 14 Aleksandri. Ishin qytete të mëdha për kohën, në të cilat ai la qytetërimin pellazgo-maqedon.

Njëra nga betejat dhe fitoret e mëdha në ekspeditat e tij pushtuese është beteja në Isus (Isos) në vitin 333, kur Leka i Madh kalon Portat e Cilicisë dhe ballafaqohet me mbretin e Persisë, Darin III, i cili në panik jo vetëm që braktis betejën, por edhe nënën, gruan dhe dy bijat e tij, bashkë me një pjesë të pasurisë së tij personale.

Duke përparuar drejt bregdetit mesdhetar, Aleksandri pas rrethimit dhe pushtimit të famshëm të Tyres në Feniki (Tirit në Liban), e pushton edhe Gazën, duke kaluar shumë pranë Jerusalemit.

Përkundër të gjitha rrethanave të çuditshme, Leka i Madh e udhëhoqi ushtrinë e tij drejt pushtimit të Egjiptit, Sirisë dhe Persisë pa pësuar asnjë disfatë.

Aleksandri është gjeniu më i madh ushtarak i të gjitha kohërave dhe njëkohësisht më trimi dhe më guximtari. Ai fillimisht e udhëhiqte ushtrinë nga rreshtat e fundit, por kur fillonte lufta, Leka gjithmonë delte në ballë të kalorësisë dhe udhëhiqte i pari në sulm kundër ushtrisë kundërshtare, duke u plagosur shumë shpesh në luftime.

Pos fitores së tij më të madhe në Betejën e Guagamelës (Arbela, Arbil, në Irakun e sotëm Verior), në vitin 331 p. e. s., Leka i Madh pos se ishte mbreti i Maqedonisë, ishte edhe sundimtari i Azisë së Vogël, Faraon i Egjeptit dhe në moshën 25-vjeçare u bë edhe mbreti i Persisë (Iranit të sotëm).

Gjatë tetë viteve të ardhshme të jetës së tij si mbret, komandant, politikan, dijetar dhe hulumtues, Aleksandri i Madh

e dërgoi më tej ushtrinë e tij për 11.000 milje, duke themeluar mbi 70 qytete me emrin e tij dhe duke krijuar një perandori që shtrihej në tre kontinente me një sipërfaqe territoriale prej afërsisht 2 milion milje katrorë.

E gjithë hapësira gjeografike nga Epiri në Perëndim, nga Danubi në Veri, Egjipti në Jug dhe deri në Lindjen e Largët në Penxhab të Indisë, shtrihej gjerë e gjatë perandoria vigane e Lekës së Madh të Maqedonisë antike pellazgo-ilire. Ajo ka qenë perandori e unifikuar nga gjuha, kultura e tregtia, kurse vet Aleksandri i ka përshtatur ligjet dhe zakonet e huaja me qëllim të sundimit të larmisë së miliona njerëzve të etnive të ndryshme dhe në këtë mënyrë është personaliteti i parë historik që ka realizuar në kohën e tij idetë e sotme moderrne të ndërlidhjes dhe të globalizimit të kulturës e të ekonomisë botërore.

1. Beteja e Keronës (338 p.e.s.)

Lokrët ishin akuzuar se kishin lëvruar kopshtet e shenjta të orakullit të Delfit. Filipi vendosi t'i ndëshkojë. Me ushtrinë e tij, ku ishte edhe Aleksandri, arriti në Elatia. Që andej rruga ishte e hapur drejt Beotisë dhe Atikës. Pas shtytjes së Demostenit, athinasit bënë aleancë me tebanët, duke njohur për herë të parë sundimin beotas mbi ta dhe vendosën t'u rezistonin planeve të Filipit për të pushtuar Helladën. Pas pak në Keronia 32.000 ushtarë maqedonë përballonin 30.000 ushtarë athinas, tebanë dhe aleatë të tyre korinthas, eubeas etj.

Në betejë u shqua Aleksandri në krye të 2.000 kalorësve maqedonë, në moshën 18 vjeç. Filipi, duke ndjekur taktikën e Epaminondës, rralloi formacionin e djathtë për të çarë aleatët. Kur, siç e synoi, athinasit, që ishin rreshtuar përballë krahut të tij të djathtë, lëvizën përpara, u krijua një e çarë mes rreshtimit të aleatëve. Aleksandri, duke depërtuar në të çarën, i mori krahët dhe shfarosi falangën tebane, gjersa ranë të gjithë të vdekur.

Në atë betejë kishte marrë pjesë edhe athinasi Demosten, oratori më i madh i Helladës, i cili urrente me fanatizëm

maqedonët. U detyrua të flakte mburojën dhe heshtën dhe t'ua mbathte këmbëve që të shpëtonte.

Fitorja e maqedonëve ishte e madhe dhe historike. Tani asnjë forcë nuk do të mund t'u kundërvihej që të pushtonin helenët. Pas betejës, Filipi dha urdhër të grumbullonin athinasit e vdekur dhe t'i digjnin.

Mësyemja e kalorësisë në çastin e përshtatshëm u afirmua për herë të parë në Keronia dhe u përsos më pas nga Aleksandri. Pastaj e imituan gjeneralët e mëdhenj të të gjitha kohërave, madje dhe në kohën tonë.

2. Aleksandri nënshtron helenët (grekët)

Puna e parë e Aleksandrit ishte që ta përforconte pushtetin e sapomarrë. Për këtë e ndihmuan shumë dy miq të Filipit, Antipatri dhe Parmenioni. Pasi mundi kundërshtarët, i erdhën lajme të këqija nga qytetet helene. Të parët tebanët, pastaj me radhë athinasit, thesalët, banorët e Argos, të Arkadisë dhe të krahinave tjera, kur mësuan për vdekjen e Filipit, kujtuan se gjetën rastin e përshtatshëm të ngrinin krye.

Kur mori vesh lajmet e këqia, Aleksandri nuk u frikësua aspak. Mblodhi forca të mëdha për të ndëshkuar në mënyrë shembullore qytetet kryengritëse. Të parët ishin thesaliotët që e kuptuan se nuk mund të maten me të, prandaj i kërkuan falje për kryengritjen që bënë. Aleksandri përparoi me ushtri dhe ngriti kampin mes Thebës dhe Athinës. Që të dy qytetet u detyruan t'i kërkonin ndjesë që të mos i shkatërronte. Kështu, mbreti i ri e fitoi këtë betejë pa qenë nevoja për luftë. Atëherë thirri të gjitha qytetet helene të dërgonin përfaqësues në një mbledhje, ku kërkoi ta njohin si sundimtar të tyre. Dhe kjo u bë.

Qysh ditën e parë që Aleksandri shkeli në këmbë Korinthin, të tërë vraponin për t'a parë e për t'a admiruar. Fama e tij ishte përhapur ndër të gjithë helenët.

Pas Korinthit Aleksandri vendosi të vizitonte orakullin e famshëm të Delfit, donte të merrte profecinë nga Pitia, priftëresha e tempullit të Apollonit. Por, kur mbërriti aty, e

lajmëruan se Pitia nuk mund të jepte profeci, sepse ishin ditë ogurkëqija në atë kohë, sipas besimeve. Aleksandri nuk kishte ndërmend të priste shumë. E detyroi Pitinë të hynte në tempull dhe t'i jepte profecinë. Ajo, pasi përtypi gjethe dafine nga druri i shenjtë, dha profecinë që doli e vërtetë: ***"Djaloshi im, do të jesh i pathyeshëm".***

Mbreti u kthye në Pellë dhe pa vonuar u nis të marshonte nëpër mbretërinë e tij që të forcojë pushtetin. Nuk shkoi shumë dhe përsëri i erdhën lajme të këqija nga helenët e bezdisshëm. Teba përsëri e para, pastaj shumë qytete tjera kishin ngritur krye kundër tij. Në Athinë oratori Demosten bënte të pamundurën të bindte athinasit që të ngrinin krye kundër tij. Dhe ia doli mbanë.

Aleksandri e kuptoi se punët u bënë shumë serioze. Duhet të vepronte me shpejtësi rrufeje dhe të ndëshkonte në mënyrë shembullore helenët e pabesë, që para pak kohe e kishin pranuar supremacinë e tij. Nuk e la fare ushtrinë e tij që të çlodhej dhe pas marshimeve rraskapitëse arriti tek dyert e Tebës. Thebanët kishin rrethuar garnizonin maqedon që gjendej në Akropolin e tyre, por kur panë ushtrinë maqedone jashtë qytetit, u habitën. Këtë herë kishin ndarë mendjen të luftonin.

Ia mësyen të parët mbi ushtrinë maqedone, të cilën e ndihmonin disa fqinjë të tebanëve, fokeasit dhe plateasit. Sulmi i tebanëve ishte i egër dhe thyen trupat e para maqedone. Por, kur i përhapën forcat e tyre jasht qytetit, Aleksandri ia mësyen kundër tyre dhe i shpartallon. Maqedonët me aleatët e tyre hynë në Tebë, ku filloi një masakër e egër mbi tebanët. Shumë e akuzojnë Aleksandrin se ndëshkoi jashtë mase tebanët. Por mos të harrohet se herën e parë i fali. Prandaj, u tregua i ashpër, sepse donte të sigurohej që, kur të nisej për fushatën e tij kundër Persisë, nuk do të ngrente krye askush. Dha urdhër që vetëm shtëpinë e poetit Pindar dhe pasardhësit e tij të mos i preknin.

Shkatërrimi i Tebës i tmerroi athinasit, të cilët për herë të dytë kërkuan ndjesë tek Aleksandri. Meqë kishte dobësi për ndërtesat e lashta pellazge që ishin aty, nuk deshi që të bëjë atë që bëri në Tebë, i fali. Tashmë të gjithë helenët e pabesë dhe

mendjelehtë e kuptuan se Aleksandri nuk bënte shaka dhe forca e ushtrisë së tij ishte e tmerrshme.

3. Leka i Madh në Trojë

Në vjeshtë të vitit 335 Aleksandri i Madh u kthye në Pellë dhe filloi të përgatitej për të realizuar ëndrrën e madhe të babait, Filipit II, dhe të jetës së tij: ***të pushtonte Azinë dhe të shkatërronte Perandorinë e madhe Persiane***.

Sigurisht rrëfimi i Trojës e mrekullonte këtë luftëtar romantik. Edhe në fushatën aziatike ai nuk i ndau nga vetja dramat e Euripidit, Sofokliut dhe Eskilit, ndonëse "Iliadën" e Homerit e çmonte si thesar të përsosur, me të gjitha njohuritë e zotësisë ushtarake, duke e mbajtur një kopje të saj së bashku me thikën e tij poshtë jastëkut, kur binte të flinte.

Në vitin tjetër, më 334, në pranverë çdo gjë u bë gati. Në Maqedoni e la gjeneralin besnik të atit të tij, Antipatrin që të qeveriste derisa ky do të ishte në Azi, ndërsa me vete do të merrte Parmenionin, gjeneral i aftë dhe i palodhur, i cili kishte dëshmuar shumë herë aftësitë e tij në luftë, duke fituar beteja të panumërta.

Forca e armatës së Aleksandrit ishte rreth 35 mijë këmbësorë dhe pesë mijë kalorës. Nga këmbësorët e huaj mezi u bënë 600 helenë mercenarë, të tjerët që të gjithë (34.400 vetë) ishin vëllezër të gjuhës dhe gjakut të tij: ilirë, trakë, maqedonë, dardanë, tribalë etj. Forca më e madhe e kësaj armate ishte **Falanga Maqedone**. Këtu kishin hyrë ushtarë të zgjedhur e të kalitur që sulmonin armikun të rreshtuar në falangë. Mbanin heshta të gjata 6-7 metra me emrin **sarisa**. Ushtarët e parë përparonin me sarisat e ngrehura, sulmonin duke shpërndarë panik ndër kundërshtarët, të cilët nuk mund të arrinin dot ushtrinë maqedone me shtiza të shkurtëra.

Aleksandri nuk u nis vetëm me ushtri, ai mori me vete edhe dijetarë. Njëri prej tyre ishte dijetari ilir, Olinthi, nip i

Aristotelit, mësuesit të tij të madh. Mori gjithashtu gjeografë, arkitektë dhe inxhinierë.

Brenda njëzet ditësh armata e madhe arriti nga Pella në qytetin Sisto, që gjendej e ndërtuar në brigjet e Helespontit të gadishullit trakas. Me prijës Permenionin dërgoi armatën e tij të kalonte matanë në brigjet e Azisë, në një qytet që quhej Abido. Që të kryhej kjo punë, u deshën 160 trirrema (lloj anijesh me tri rrema). Vet ai me një forcë të vogël ndoqi bregun trakas ndërsa arriti në Heleunta, qytet i ndërtuar përballë Trojës. Me një anije, të cilën e drejtoi vet, kaloi edhe ai në bregun e Azisë së Vogël. Shkeli këmba e tij në bregdetin e Trojës, atje ku para shumë vitesh kishin zbarkuar akejt, që të luftonin dhjetë vite të tëra kundër trojanëve.

Me 60 anije Aleksandri kaloi Hellespontin, një ngushticë që ndan Evropën me Azinë, që tani quhet Dardanele, në vitin 334 p. e. s. Kur zbriti në breg, nguli shpatën në rërë dhe i deklaroi ato toka të tijat.

Ushtari i parë grek, Protesilau, u vra nga një dardan sapo kapërceu anëdetin e Trojës. Në varrin e Protesilaut në Eleus (Esqi-Hisarliku i sotëm) Leka i Madh therri kurbanë dhe u fal për të pasur ogur në fushatën për shkatërrimin e Perandorisë Persiane të darëve në Azi.

Ishte i madh mallëngjimi i Aleksandrit kur pa Trojën. Me tëshkelur këmba në breg, mori heshtën dhe e flaku me forcë, duke e ngulur në rërë. Aleksandri, mbreti i maqedonëve, trakëve dhe gjithë ilirëve, tmerri i helenëve, ashtu siç u mbërthye heshta në këtë rërë, po ashtu do të pushtonte me forcën e tij Azinë dhe shtetin persian.

Aleksandri më se një herë kërkoi ndihmën e hyjnive pellazge që të arrinte suksesin në këtë ndërmarrje të madhe. Gjatë udhëtimit të tij për në Azi bëri edhe një ndalesë të vogël në bregdetin e Trojës, që tashmë ishte shkatërruar e tëra nga lufta dhjetëvjeçare midis trojanëve dhe akejve. Kur mbërriti në Trojë, Aleksandri u mallëngjye.

Në Hellespont (Dardanele), në udhën midis Evropës dhe Azisë, ai dhuroi një dem si flijim për Neptunin, perëndinë e

detit, kurse për "Zanat" (zërat apo shpirtrat) e detit derdhi në altar verë me një kupë të artë. Me të shkelur në bregun aziatik, ai ngriti altare për Zotin e Pellazgëve, për perëndeshën Athina dhe për Herakliun (Herkulin), heroin pellazg, të cilin e konsideronte si stërgjysh nga ana e të atit.

Kur arriti në Trojën e famshme, bëri fli për perëndeshën Athina në faltore, që sapo ia kishin përkushtuar dhe nderoi kujtimin e heronjve që kishin rënë atje, duke derdhur libacione solemne.

Kur gjeti varrin e mbretit trojan, Priamit, i cili ishte vrarë nga i biri i Akilit, Pirroja, stërgjyshi i tij nga e ëma, Aleksandri dhuroi flijime në altar për të qetësuar zemërimin e mbretit. Përveç vendosjes së kurorave me lule, e leu varrin me mirrë dhe, sipas një zakoni të vjetër, kapitenët zunë të rendnin përreth varrit.

Emocioni më i madh i tij ishte se po shikonte Trojën, këtë vend ku pellazgët e lashtë nëntë shekuj para tij, kishin krijuar një epos të pavdekshëm. Libri i dashur i Aleksandrit ishte "Iliada". E merrte me vete ngado që shkonte dhe kur flinte e vinte nën jastëk.

Troja asokohe ishte një fshat i vogël. Aleksandri i flijoi një mëshqerrë hyjneshës Athina, duke e lutur ta ndihmonte në fushatën e tij, një fli për Herakliun. Bëri fli edhe në kujtim të Priamit, mbretit të pafat të Trojës.

Aleksandri e vizitoi Trojën edhe për një qëllim tjetër. Nga gjithë heronjtë Akej, që luftuan këtu, ai adhuronte Akilin, i cili ishte edhe stërgjysh i tij nga e ëma, Olimpia. Pasi qëndroi pranë varrit të tij pak kohë pa lëvizur dhe i prekur thellë, duke sjellë ndërmend bëmat e tij, tundi kokën dhe tha:

- "Ishe me shumë fat, Akil!, - se për ty u gjend një poet i madh për të himnizuar bëmat e tua dhe t'i bënte të pavdekshme". E kishte fjalën për Homerin.

Pas kësaj me ushtarët e tij ndoqi bregun e Azisë së Vogël dhe nuk vonoi të takonte armatën e tij që e priste pak më tej prej Abidos, në një qytet që quhej Arisbi. Pasi inspektoi gjithë ushtarët e tij, dha urdhër të niseshin. Nuk do të përparonte drejt

thellësive të Azisë së Vogël, që ishin vende të shkreta, pa gjurmë ushqimi, por nga ato veriore.

4. Beteja e Granikut (334 p. e. s.)

Dari III, mbreti i perandorisë së madhe persiane, kishte prijës të ushtrisë së tij një helen, Memnonin nga Rodosi. Ishte një njeri shumë i zgjuar. Kur Memnoni u lajmërua se Aleksandri me armatën e tij zbarkoi në Azinë e Vogël dhe përparonte drejt brigjeve të Propontidës, hartoi një plan vërtet të zgjuar dhe ua njohtoi satrapëve persianë të atij rajoni.

Tha: Nuk duhet të godasim Aleksandrin. Mund ta mundim në një betejë, por mund edhe të na mund, se kam dëgjuar që ka luftëtarë të aftë dhe të kalitur. Ekziston një mënyrë që mund ta thyejmë pa luftë.

- Dhe si mund të bëhet kjo gjë? - pyeti Arsiti, një nga satrapët persianë.

- Dëgjoni cili është plani im. Do ta lëmë Aleksandrin të përparojë dhe ne, ndërsa do të tërhiqemi, do të djegim të lashtat, do të vrasim bagëtinë dhe nuk do të lëmë as gjurmën më të vogël të ushqimit që ta gjejë armata e tij. Kështu, sa më shumë të përparojë, aq më vështirë do të bëhet gjendja e tij. Dhe, kur t'i rrënojë uria, do t'i sulmojmë dhe do t'i dërrmojmë.

- Jo - u përgjigj Arsiti. - Unë kam një plan më të mirë. T'i presim ilirët prapa lumit Granik. Do të rreshtojmë forcat tona, që janë shumë më të mëdha sesa ato të armikut tonë dhe, pasi të hyjnë në lumë, do t'i godasim dhe do t'i thyejmë.

Njëri pas tjetrit satrapët persianë ranë në një mendje me Arsitin. Më kot u përpoq Memnoni t'ua ndërronte mendjen. Kësisoj, u detyrua të ndiqte planin e tyre dhe të priste ilirët prapa lumit Granik.

Forcat persiane ishin tmerruese për kah numri. Memnoni kishte nën urdhërat e tij njëzet mijë kalorës, dhjetë mijë

këmbësorë helenë, dhe gjithashtu me dhjetëra mijëra këmbësorë persianë. Pra, të paktën sa dyfishi i ushtrisë ilire të Maqedonisë.

Një pasdite kalorësi nga pararoja erdhi ta lajmëronte Aleksandrin se persianët i prisnin në pozicione lufte në bregun lindor të lumit Granik. Gjuha greke përdorej si gjuhë ndërkombëtare dhe zyrtare nga bota e qytetëruar në atë kohë. Megjithatë, në momente të veçanta kritike, si p.sh. në rastin kur një kapiten i tij, Kliti, i nënçmoi maqedonët në krahasim me grekët, Aleksandri u thirri rojeve në gjuhën maqedonase, shenjë kjo e sigurtë e zemërimit të tij të madh. Në një rast tjetër, kur Aleksandri nxori para gjyqit ushtarak një gjeneral grek, njëfar Filota, ai i kërkoi këtij të fundit që të fliste në maqedonisht, në mënyrë që ta kuptonin gjykatësit maqedonë. Mirëpo, gjenerali refuzoi, duke thënë: "Do flas në greqisht, sepse dua që të më kuptojnë bashkëkombasit e mi".

Siç po duket, shumica e krerëve dhe e ushtrisë në ekspeditën aziatike ishin pellazgë ose shqiptarë, sigurisht që ata nuk ishin grekë, por maqedonë. Mosbesimi i Aleksandrit te grekët do të shtohej me shpejtësi, pasi që më shumë se 30.000 ushtarë mercenarë grekë ishin bashkuar me persët në luftë kundër armikut të përbashkët, Aleksandrit.

Fitorja e parë mbi persët dhe mercenarët grekë u arrit në lumin e Granikut, në lindje të Trojës. Në vendin ku do të bëhej beteja, brigjet e Granikut ishin të rrafshta. Ilirët do t'i kalonin me lehtësi. Prandaj, persianët prisnin pikërisht aty për të zhvilluar betejën. Aleksandri i Madh mund të përparonte ndërsa të gjente një kalim tjetër. Por, persianët me kalorësinë e shumtë do ta ndiqnin dhe, ngaqë brigjet ishin të përthyera, do t'i shkaktonin dëm të madh. Aleksandri i Madh ishte i detyruar të përdorte këtë vendkalim dhe të mos i shmangej betejës.

Në armatën e Aleksandrit ishin rreth 32.000 këmbësorë dhe 5.100 kalorës, nga të cilët:

12.000 - falanga maqedone
7.000 - këmbësorë aleatë (epirotë)
12.000 - trakë, ilirë dhe dardanë
1.000 - harkëtarë agrianë (nga viset iliro-trake)

1.800 - kalorës maqedonë
1.800 - kalorës thesalë
600 - kalorës helenë (mercenarë)
900 - kalorës thrakë dhe peonë

Heleno-persianët kishin pothuaj dyfish më shumë forca.

- E pra, do ta zhvillojmë betejën!, - tha Aleksandri

- Nesër në mëngjes? - pyeti Parmenioni

- Në këtë çast, Parmenion! Do të marrësh komandën e krahut të majtë dhe unë të djathtin.

- Por..., Aleksandër, pas pak do të erret. Dhe, pastaj ushtarët tanë janë të lodhur nga marshimi.

- Pikërisht pse janë të lodhur, duhet të zhvillojmë betejën që të qetësohen dhe të flenë pa kokëçarje e ankth. Persianët nuk do të përfytyrojnë se do t'i godasim tani dhe do t'i befasojmë.

Persianët që ndiqnin lëvizjet e ilirëve, morën masa. Kur panë se Aleksandri i Madh i printe kalorësisë për nga e majta e tyre, e kuptuan se atje do të bëhej mësyemja e madhe. Kështu, Memnoni dhe më të shumtët e satrapëve me forcën më të madhe të kalorësisë, vendosën të përforconin atë krah të frontit dhe të dërmonin ilirët.

- Duhet të vritet Mbreti i Maqedonëve! - u tha Memnoni satrapëve. - Me vdekjen e Aleksandrit do të marrë fund beteja dhe do të shpartallojmë lehtësisht ilirët, se do t'u bjerë morali.

Por Memnoni dhe persianët nuk e njihnin mirë Aleksandrin. Mbreti i ri i ilirëve e dinte se forca më e madhe e persianëve do ta priste që t'i jepte goditjen e madhe dhe vendimtare. Mendja e tij demoniake e ndërroi planin e betejës. Kur hynë në lumë dhe e fshihnin brigjet dhe shkurret nga sytë e persianëve, mori me vete forcat më të zgjedhura dhe përparoi nga e majta, duke ndjekur rrjedhën e lumit. Plani i tij ishte i thjeshtë, por dhe tmerrësisht i zgjuar. Ndërsa persianët do ta prisnin me forcat në krahun e majtë të rreshtimit të tyre, ai do të shfaqej befasisht në qendër, ku forcat e tyre nuk ishin të fuqishme, do të thyente kollaj frontin dhe do të fitonte betejën. Dhe, kështu u bë. Ilirët të parët u ngjitën në brigje dhe persianët filluan sulmin. Nisi një luftë e egër, e tërbuar. Memnoni dhe

satrapët përpiqeshin të shikonin përpara tyre Aleksandrin. Por ai i goditi rrufeshëm në mes të frontit dhe, duke dobësuar qëndresën e heleno-persianëve, përparoi mjaft thellë më tutje bregut.

Gjersa të kuptonte Memnoni se ç'po ndodhte, ishte shumë vonë. E kishte pësuar nga mbreti i ilirëve. Ndërkohë u përpoqën të gjithë të rrethonin Aleksandrin dhe ta vritnin. Një betejë e tërbuar shpërtheu rreth e rrotull tij. Helenët dhe persianët sulmonin vazhdimisht valë-valë. Gjithë sulmet e tyre thyheshin mbi këmbënguljen prej guri të ilirëve. Aleksandri hipur mbi Bukefalin, godiste majtas-djathtas me heshtë, duke rrëzuar kalorësit persianë, që i afroheshin.

Në një çast heshta iu thye. Miku i të atit, Dimarati (prej të cilit kishte si dhuratë Bukefalin), që luftonte përkrah tij, i dha heshtën e vet. Aleksandri njohu ndërmjet persianëve dhëndërrin e Darit, Mitridatin dhe u sul ta qëllonte. E shënoi në fytyrë me heshtë dhe e rrëzoi përtokë. Atëherë një gjeneral persian u vërsul kundër Aleksandrit dhe e uli shpatën mbi kokën e tij. Por përkrenarja e shpëtoi mbretin ilir, i cili, duke u kthyer e shpoi tejpërtej me heshtë gjeneralin persian.

Ndërkohë që e kishte mendjen te gjenerali, një satrap persian, Spitridati, ngriti shpatën i gatshëm t'i merrte kokën Aleksandrit. Do ta bënte nëse këtë, nëse nuk do të gjendej pranë Aleksandrit miku i tij, Kliti (djali i mbretit Bardhyl të Ilirisë). Me shpejtësinë e rrufesë ngriti shpatën e vet, e uli me forcë dhe këputi dorën e satrapit persian.

Kalorësit persianë para forcës së paepur të ilirëve kthyen kuajt dhe vrapuan të shpëtonin. Të njëjtën gjë bënë edhe mercenarët helenë që ishin në ushtrinë persiane. Fronti persian u thye. Iliromaqedonët triumfuan! Ndoqën persianët për pak dhe pastaj ndaluan se filloi të errej.

Persianët pësuan një katastrofë të vërtetë. Rreth 1.000 prej tyre u vranë ose u zunë rob. Nga ilirët u vranë vetëm 34 luftëtarë, prej tyre 9 këmbësorë dhe tjerët kalorës. Ishte një fitore e madhe, që theu moralin e persianëve dhe u dha krah shpirtërave të ilirëve.

Me zbardhëllimin e ditës së re, puna e parë e Aleksandrit ishte vizita e të plagosurve. I pyeste një nga një se si quheshin, nga ishin dhe se si u plagosën. Të gjithë e pritën të mallëngjyer këtë vizitë dhe te Aleksandri nuk shikonin vetëm mbretin, por edhe bashkëluftëtarin.

Pastaj dha urdhër të varrosnin të rënët me tërë nderimet dhe porositi skulptorin e famshëm, Lisip, t'u bënte shtatoren e tyre të bronztë. Pastaj tregoi shpirtmadhësinë e vet, dha urdhër të varroseshin edhe satrapët e gjeneralët persianë të vdekur. Mercenarët helenë që u zunë rob në betejë i dërgoi në Maqedoni që të punonin si skllevër.

Pas kësaj fitoreje Aleksandri ndërroi rrugë dhe u drejtua kah jugu. Pas disa ditësh arriti në Sard, kryeqytet i Lidisë, në akropolin e së cilës ruheshin thesare të parrëfyera. Kryerojtari dhe arkondët persianë të Sardit e pritën Aleksandrin jashtë qytetit dhe i shpallën bindje. I dorëzuan tërë thesarin e akropolit.

Gjersa Aleksandri ishte duke soditur bukuritë e akropolit, befas një vetëtimë çau qiellin dhe vijuan gjëmime të mëdha.

- Është një shenjë hyjnore! - tha njëri nga falltorët që shoqëronte Aleksandrin në fushatën e madhe.

Atëherë Aleksandri dha urdhër të ndërtohej një faltore kushtuar Zojsit(Zeusit). Kjo ishte një dhuratë ndaj Atit të Hyjnive Pellazge, që ta ndihmonte në luftën e madhe që kishte filluar kundër Perandorisë së Persisë.

5. Beteja në Issus(Issos) 333 p. e. s.

Në pranverën e vitit 333 p.e.s., pas Betejës së Granikut dhe fitores së parë kundër Persisë, Aleksandri i drejtohet Sirisë dhe në Isso përballet me ushtrinë e mbretit persian Dari III. Aziatikët ishin superiorë në numër, megjithatë u sulmuan keq nga maqedonët, sa që Dari shpëtoi me arratisje.

Darit, mbretit të persëve, i kishin rënë shumë kokëçarje. Shpartallimi i ushtrisë së tij në Granik, përparimi i Aleksandrit dhe, sidomos vdekja e Memnonit, e kishin shqetësuar thellë. Duhej të gjente një kryekomandant të ri, të grumbullonte forcat e

tij dhe të ndalte ilirët, duke zhvilluar një betejë të dytë dhe vendimtare. Cilin të zgjidhte për kryekomandant? Nuk u besonte aftësive të satrapëve të tij. Iu paraqit një athinas që rrinte në oborrin e tij dhe që e urrente në mënyrë të paimagjinueshme Aleksandrin dhe maqedonët. Quhej Haridimo dhe të gjithë e admironin për trimërinë dhe për aftësitë strategjike.

- Nëse dëshiron të mundësh Aleksandrin, - i tha - të më ngarkosh mua komandën e ushtrisë tënde. Unë di si të luftoj dhe si të mund kundërshtarët tu. Po të duash të shpëtosh shtetin tënd, bëmë kryegjeneral.

Mirëpo, satrapët persianë që trembeshin se do t'u zinte vendin një helen, filluan të shpifin te Dari dhe më në fund ia dolën mbanë ta bindnin se Haridimo ishte një spiun i Aleksandrit, që kishte qëllim të shkatërronte shtetin persian.

- Ta vritni menjëherë! - dha urdhër Dari.

Ata e rrëmbyen menjëherë, që të mos arrinte të pendohej Dari, dhe filluan ta hiqnin zvarrë jashtë pallatit.

Satrapët e vranë Haridimon jashtë pallatit. Ky është fati i tradhëtarëve, Haridimo ishte një tradhëtar.

Darit menjëherë pas vdekjes së Haridimos, i shkoi inati dhe u pendua, por tani nuk mund ta ndreqte të keqen që bëri. Ngaqë nuk kishte besim te satrapët e tij, mori përsipër të përballonte vetë Aleksandrin në krye të ushtrisë. Përqëndroi në Babiloni mjaft forca nga gjithë mbretëria, mori me vete të ëmën, gruan, të birin dhe dy vajzat e u nis për në Kiliki, i vendosur të ndërpriste rrugën e Aleksandrit dhe të ilirëve. Atje do të zhvillonte betejën e dytë, në Isso.

Aleksandri në betejën e Issus (333 p. e. s.) kishte këta trupa:
Spahie: 3.000
Falangë: 12.000
Trakas: 6.000
Ilirë: 1.000
Kretas: 1.000
Peonianë: 300
Kalorës: 2.100
Thesaliotë: 2.100

Aleatë grekë: 750
Prodromë: 600
Mercenarë tjerë: 5.000

Dari me armatën e tij të madhe që e përbënin rreth 50.000 luftëtarë, u nis nga Babilonia dhe, duke kaluar nëpër Siri, ngriti kampin në fushën e Sohos. Atje kishte ndërmend të priste Aleksandrin dhe ta godiste. Por Aleksandri u vonua në Kiliki, për shkak sëmundjes së tij në Tarso. Dari pyeste veten: "Përse mbreti ilir nuk po përparonte?!".

- A nuk e kupton, o Mbret i Madh, përse nuk përparon? - i thanë atëherë satrapët e tij për t'a lajkatuar. Sepse të ka frikë. Në vend që ne ta presim kot, duhet ta takojmë dhe ta detyrojmë të zhvillojë betejën që po e shmang.

Ia dolën mbanë të bindnin Darin dhe mbreti pers u nis me armatën e madhe për në Kiliki. Mori vesh se Aleksandri gjendej në Isso, një qytet i vogël bregdetar dhe u drejtua për atje. Por, në Isso persët nuk gjetën ilirët. Aleksandri i Madh kur mësoi se Dari e priste në fushën e Sohos, ishte nisur me ushtrinë e tij ta takonte, duke lënë në Isso vetëm të plagosurit.

Persët shpërthyen zemërimin e tyre të egër për disfatat e vazhdueshme mbi të plagosurit ilirë, duke i vrarë të gjithë.

Aleksandri nuk vonoi të informohej se persët nuk ndodheshin para tyre, por prapa. Ftoi menjëherë një këshill lufte.

- Do të kthehemi pas, - u tha oficerëve të tij. - Duhet t'i arrijmë persët në luginën e ngushtë të Issos. Po t'i përballojmë në një hapësirë të madhe të hapur, armata e Darit, që është e shumtë në numër, do të na vërë në pozitë të vështirë.

Dhe i arriti. Rrafshultën e vogël të Issos e ndante një lumë i vogël, Pinaros. Kur persët mësuan se ilirët po mbërrinin, u rreshtuan në bregun perëndimor të lumit. Dhe, Dari përpunoi planin e tij. Meqë hapësira ishte e ngushtë, vendosi të luftonin disa nga njësitë e tij, më të aftat. Në krahun e djathtë të rreshtimit të tij, për nga deti, dërgoi trupën e kalorësisë. Në këtë betejë Dari kishte mbi 30.000 kalorës. Me këtë forcë të tmerrshme synonte të thyente frontin e ilirëve dhe t'u merrte krahët. Në qendër dhe në

të majtë rreshtoi këmbësorët e tij, në njëfarë mënyre donte të kopjonte planin e ilirëve të betejës së Granikut.

Dari ishte i sigurt se Aleksandri do të bënte mësymjen me kalorësi nga ana e detit, ku trualli ishte i sheshtë dhe mund të lëviznin kuajt. Në anën tjetër të frontit trualli ishte mjaft i thyer, mbushur me gurë dhe shkurre, në skaj të kodrës. Atje ishte e natyrshme që ilirët të rreshtonin këmbësorinë e tyre. Kësisoj, Dari me epërsinë shkatërrimtare të këmbësorisë së tij llogariste të thyente frontin e armikut për nga deti dhe të rrethonte falangën maqedone.

Aleksandri kur pa persët, qëndroi larg lumit Pinaros. Nga kreshta e kodrës vëzhgonte forcat armike dhe nuk vonoi të kuptonte se cili ishte plani i Darit. Përpiloi planin e tij. Drejt detit dërgoi disa kalorës dhe gjeneralin Parmenion, qëllimi i të cilit ishte të siguronte mbrojtjen ndaj presionit të fuqishëm të persëve. Gjithashtu u dha urdhër kalorësve thesaliotë që të përparonin fshehtësisht për nga vendi pranë detit. Në mes të frontit do të vendoste Falangën Maqedone. Kalorësia e tij ishte e lehtë dhe mund të lëvizte në terren të thyer.

Ky ishte plani i Aleksandrit. Një pasdite nëntori të vitit 333 p. e. r. u zhvillua një nga betejat e mëdha të botës, Beteja e Issos.

Pasi priti më kot që të mësyenin persët, Aleksandri sulmoi vetë. U nis shumë ngadalë, duke përparuar drejt lumit. Parmenioni dhe Falanga Maqedone ndaluan në bregun e rrafshët të lumit. Atëherë befas Aleksandri me kalorësinë që gjendej në anën e majtë të rreshtimit të tij filloi një sulm të vetëtimtë. Këmbësorët persë, që ishin rreshtuar përballë tij, u habitën dhe nuk arritën të kundërvepronin. Kur tendosën kordat e harqeve të tyre, maqedonët ndodheshin tashmë mes tyre!

Se çfarë vijoi, është e vështirë të përshkruhet. Filloi një betejë e egër e përgjakshme në tërë frontin. Këmbësorët persë që pësuan mësymjen e rrufeshme të këmbësorisë së ilirëve, nuk vonuan të jepeshin. Nisën të zbrapsen dhe shumë prej tyre për të ikur më shpejt e për të shpëtuar, hidhnin armët.

Rasti ishte i rrallë për Aleksandrin e Madh. Atë që kërkonte Dari me këmbësorinë e vet të çante frontin e ilirëve në rreshtimin

e majtë të tyre, e arriti i pari Aleksandri me kalorësinë e tij pas një sulmi të vetëtimtë. Kështu, tani ktheu forcën e kalorësisë për nga e majta dhe nisi të godiste nga brinjët armatën perse.

Persët nuk vonuan të kuptonin gjendjen e tyre të vështirë. Ilirët thyen frontin e tyre dhe pas pak i mbyllën në mes. Dari e ndjeu rrezikun dhe e mbërtheu paniku. Në vend që të qëndronte në pozicionin e tij dhe t'u jipte zemër luftëtarëve me shembullin e vet, zgjodhi ikjen për të shpëtuar. Ndoshta mendoi se po të binte në duart e ilirëve, do të shkatërrohej shteti persian, ndërsa po të ikte, do të mund të vazhdonte luftën.

Rrëmbeu frerët e karrocës nga duart e ngarësit dhe, duke qëlluar vazhdimisht kuajt me kamxhik, iku duke braktisur prapa vetes ushtrinë. Kur terreni u bë i përthyer, la koçinë, kërceu në shpinën e një kali dhe vijoi galopin e shkalluar. Ishte aq i madh nxitimi dhe ankthi që të mos binte rob në duart e ilirëve, sa la në qerre heshtën, mburojën dhe pelerinën e tij të qëndisur me ar. Mbreti i persëve nuk mendoi se afër lumit, prapa luftëtarëve të vet, kishte lënë familjen e vet: nënën, gruan, djalin e vogël dhe dy vajzat. Kaq shumë e kishte mbërthyer paniku.

Më vonë do të merrte lajmin e hidhur. Njerëzit e dashur ranë në duart e ilirëve. Në duart e Aleksandrit të Madh.

Kalorësit persë që kishin përparuar mjaft dhe që me shumë fli përpiqeshin t'i ndalonin kalorësit thesaliotë të Aleksandrit, kur morën vesh se Dari i braktisi, e ndërprenë edhe ata luftimin dhe, duke galopuar mes këmbësorëve në panik, u përpoqën të largoheshin. Kështu mori fund Beteja e Issos. Për herë të dytë persët nuk mundën t'i rezistonin guximit dhe vrullit të ilirëve. Për herë të dytë mendja strategjike e mbretit të ri të maqedonëve triumfonte. Tani ishte e hapur rruga drejt perandorisë së pafundme persiane.

Dhe ishin vërtet të rënda humbjet e persëve. Rreth 10.000 këmbësorë dhe 1.000 kalorës gjetën vdekjen, veç të plagosurve dhe robërve. Humbjet e ilirëve pas kësaj ndeshjeje të tmerrshme ishin të pakta. U vranë rreth 300 këmbësorë dhe 150 kalorës. Por, kishte mjaft të plagosur, ndërmjet tyre edhe Aleksandri. U plagos lehtë në kofshë nga një shpatë armike.

Ilirët në Betejën e Issos kishin fatin e keq të humbnin prijësin e Falangës Maqedone, Ptolemeun, djalin e komandantit Seleuk. U rrethua nga mjaft kundërshtarë, vrau shumë prej tyre dhe në fund, pasi iu thye shpata nga goditjet e shumta, ra heroikisht. Ishte i madh hidhërimi i Aleksandrit dhe i ilirëve për humbjen e këtij trimi.

6. Nyja e Gordianit

Pas Sardit, Aleksandri i Madh përparoi drejt Hefesit. Arriti për katër ditë, e çliroi dhe risolli demokracinë. Pasi i bëri një fli madhështore hyjneshës Artemida, vijoi marshimin triumfues drejt jugut.

Rrethoi Militin, të cilin e mbronte vet Memnoni, kryekomandant i forcave perse dhe arriti ta pushtonte pas luftimeve të egra. Pastaj i erdhi radha Halikarnasit, një qyteti tjetër që rënkonte nën zgjedhën persiane.

Po afronte dimri dhe Aleksandri i Madh dërgoi Parmenionin me një pjesë të madhe të ushtrisë që të kthehej në Sardë dhe që andej të drejtohej për kah Frigia e pafundme, e cila ndodhet në zemrën e Azisë së Vogël. Ai përparoi drejt rajonit të Likisë dhe Pamfilias. Që andej u drejtua për në kryeqytetin e Frigisë, Gordio, ku do të takonte Parmenionin.

Në akropolin e këtij qyteti gjendeshin të ndërtuara pallatet e mbretit Gordio, që ishte i ati i Midës legjendar. Në pallatet ndodhej edhe karroca e Gordios, e cila ishte lidhur me nyja kaq të forta dhe me mënyrën që askush nga sa kishin provuar, nuk ia kishte dalë mbanë ta zgjidhte. Një profeci madje thoshte se kush do të mund të zgjidhte karrocën, do të zotëronte gjithë Azinë dhe do të bëhej mbret i saj.

Sipas legjendës, Frigjianët, që jetonin në Turqinë qendrore të sotme, ishin thënë nga orakulli të bënin mbret njeriun e parë që do të shkonte në qytet me një qerre. Siç e donte fati, ky burrë ishte Gordiani, një fshatar i varfër. Pas kurorëzimit, Gordiani ia dedikoi qerren Zeusit dhe e lidhi në një shtyllë jashtë tempullit me lëvore thane që forcohej me kohën. Thuhej që kush do që

zgjidhte nyjën, do të pushtonte Azinë. Aleksandri nuk e la t'i shpëtonte një mundësi e tillë, por në pamundësi ta zgjidhte, e preu me shpatë nga inati. Që prej asaj dite nyja e Gordianit është sinonim i një problemi të vështirë që kërkon zgjidhje origjinale.

Aleksandri kishte kurreshtje të madhe të shihte karrocën e mbretit Gordian. Do të përpiqej edhe ai ta zgjidhte. Të gjithë që e shoqëruan gjer në akropol ishin kuriozë të shikonin nëse mbreti ilir do të mund të bënte atë që nuk e bënë aq e aq të tjerë.

Aleksandri me hap të sigurt arriti deri te karroca dhe qëndroi para saj. Pa litarët me nyjat e ngatërruara dhe ndjeu ta zotëronte njëfarë frike. Heshtje e gjallë ra mes shoqëruesve të Aleksandrit. Përpiqej të zbërthente nyjat. E panë të bënte një hap para, të nxirrte shpatën dhe me një lëvizje të shpejtë e të vendosur ta ulte me forcë e të këputste litarët. Karroca e Gordianit u zgjidh me mënyrën që askush nuk e priste. Aleksandri vuri shpatën në mill dhe u kthye duke buzëqeshur nga shokët e tij.

- Siç e shihni, ishte shumë e thjeshtë, - u tha.

Në pranverë të vitit 333 Aleksandri mori vesh se vdiq Memnoni, kryekomandanti i shtetit persian dhe u gëzua se kundërshtari i tij ishte njeri trim dhe i zgjuar e do t'i krijonte shumë probleme. Pasi u largua nga Gordioni, Leka i Madh u nis drejt Kapodikisë dhe që andej u kthye përsëri nga jugu, drejt krahinës së Kilikisë.

Në kryeqytetin e Kilikisë, në Tarso, persët vendosën t'i rezistonin dhe të luftonin kundër tij. Por kur armata ilire-maqedone iu afrua qytetit, persët në panik ua mbathën këmbëve dhe ikën për të shpëtuar.

7. Marshimi i Lekës së Madh drejt Lindjes së Afërme

Menjëherë pas fitores në Issus, Aleksandri urdhëroi gjeneralin e tij, Parmenionin, të nisej me një pjesë të ushtrisë për

në Damask, sepse ishte informuar që mbreti persian kishte lënë atje pjesën më të madhe të thesarit shtetëror.

Aleksandri ishte i rraskapitur nga beteja, por edhe i stërlumtur për fitoren. I vetmi shqetësim i tij ishte se nuk zuri të gjallë Darin. Por u gëzua shumë kur i thanë se ndërmjet robërve gjendej edhe familja mbretërore.

- Aleksandër, ia vlen mundimi të vizitosh çadrën e Darit, - i tha njëri nga oficerët e tij.

- Atëherë..., le të vemi të shplajmë djersën dhe pluhurin e betejës në banjën e Darit, - tha me buzëqeshje Aleksandri.

Kur hyri në çadrën e lartë dhe me hapësirë të gjerë të mbretit persian, e humbi mendjen nga pasuria dhe luksi që i panë sytë. Objektet më të shumta ishin prej ari dhe atmosfera ishte e mbushur me aromën e mistershme të lindjes.

Aleksandri u la në banjë dhe pastaj u ul për të ngrënë në kuzhinë. Ndërsa po hante, dikush e informoi se e ëma dhe e shoqja e Darit po qanin dhe vajtonin se kujtonin që Dari kishte vdekur.

- Shko t'i qetësosh, - i tha Aleksandri njërit nga oficerët e tij. - Thuaju se Dari arriti të shpëtonte. Vetëm armët dhe pelerina e tij mbetën në duart tona. Thuaju se për mua armik mbetet Dari dhe jo familja e tij. Do ta mbroj si i përket një familjeje mbretërore dhe do të kujdesem për edukimin e djalit të Darit, sikur të ishte im bir. Mund t'u thuash të gjitha grave se janë të lira të varrosin sa të duan nga persët e vdekur.

Ditën tjetër vendosi të njihte familjen e armikut të tij të madh, e cila rrinte në një çadër të vogël. Me vete mori vetëm mikun e tij, Hefestionin. Kur hynë në çadër, një grua e moshuar, nëna e Darit, Sisigambris, bëri përpara t'i falej mbretit ilir. Mendoi se shtatlarti ishte mbreti, dhe kështu u gjunjëzua para Hefestionit.

- Bëre gabim, grua. Nuk jam unë Aleksandri. Gruaja e turpëruar u kthye nga Aleksandri.

- S'ka gjë, - i tha ai duke buzëqeshur. - Edhe miku im është i barabartë me Aleksandrin.

Pas nënës së Darit iu fal e shoqja, pastaj iu afruan fëmijët. Aleksandri ngriti në duar të birin gjashtëvjeçar të Darit, i cili nuk u trëmb aspak dhe i buzëqeshi.

Aleksandri i Madh tani duhet të përparonte kah Mesopotamia, ku gjendej dhe kryeqyteti i persëve. Por, para se të bëhej kjo, donte të mos e linte asnjë vatër armiqësore prapa vetes, ndaj vendosi të fushatojë më parë kundër Fenikisë dhe Egjiptit. Kur përparonte drejt kryeqytetit të Fenikisë, Tiros, erdhën dy ambasadorë të Darit. Sillnin një letër të mbretit të tyre për Aleksandrin. Në këtë letër Dari shkruante se nuk ndjente armiqësi ndaj ilirëve, megjithëse ata e filluan të parët këtë luftë. E luste të ndërpritnin veprimet armiqësore, të bëheshin miq e aleatë dhe të lironte familjen e tij. Për këtë i premtoi shpërblim 10.000 talanta. Aleksandri iu përgjigj me një letër mbushur me ironi. I shkruante se të parët ishin persët që fushatuan kundër ilirëve dhe i kujtonte Maratonën, Termopilet, Salaminën dhe Platenë.

"Dhe unë", i shkruante, "për ato katastrofa që bëtë kundër ilirëve, si hegjemon ilir, erdha të marrë hak. Nëse dëshiron të mbash mbretërinë tënde, duhet të dish të luftosh dhe të mos ua mbathësh këmbëve. Tani e tutje do të më sillesh si një persian i thjeshtë dhe jo si mbret i Azisë. Sepse mbret i Azisë është Aleksandri! Sa për familjen tënde, s'bëhet fjalë që t'a liroj, por të jesh i sigurt se do të sillem me të shumë më mirë sesa do të silleshe ti me një familje mbretërore ilire të zënë rob".

Para se të mbërrinte në Tiro, erdhi Parmenioni nga Damasku, duke sjellë thesarin e çmuar të persëve.

Në janar 332 arriti përpara Tiros, që ishte në një ishull të vogël dhe nuk ishte shumë larg nga bregu. Aleksandri me flotën e tij e bllokoi nga toka dhe deti, por ishte e vështirë ta pushtonte se Tirosi kishte mure të lartë dhe banorët ishin furnizuar me ushqime, që të rezistonin për shumë kohë të rrethuar. Atëherë mbreti ilir vendosi të ndërtonte një mol, një krah që do të bashkonte sterénë me ishullin. Banorët e Tiros e përqeshën, se gjoja do të zbuste detin si Poseidon, por ky mol e ndihmoi

Aleksandrin të pushtonte Tiron shtatë muaj më vonë, në korrik 332.

Pas Tiros u drejtua për në jug dhe rrethoi Gazën, një qytet i fortifikuar shkëlqyeshëm, ndërtuar në lartësi dhe që kishte mure të larta.

Ditën kur Aleksandri po u bënte fli hyjnive që ta ndihmonin për të pushtuar Gazën dhe tek ndodhej afër altarit, kaloi sipër lart një zog i egër. Mbante një gur në çapokë dhe tek e lëshoi, guri qëlloi mbretin riosh. Me siguri do ta vriste po të mos mbante përkrenaren e tij.

- Ç'do të thotë kjo? – pyeti Aleksandri falltarin e tij, Aristandron.

- Mbret, - u përgjigj Aristandroja, - qytetin do ta pushtosh, por duhet të bësh kujdes sot, se mund të plagosesh.

Pas pak filloi beteja dhe Aleksandri qëndroi prapa makinave rrethuese që të mos e arrinin shigjetat. Një çast pa ushtarët e tij të përparonin drejt mureve. Atëherë nuk duroi dhe u vërsul edhe ai përpara. Shigjeta armike, e hedhur me ballistë dhe me forcë të tmerrshme, i shpoi mburojën, i shpoi edhe parzmoren dhe e plagosi në sup. Ishte plagë e keqe, por Aleksandri u gëzua, sepse doli e vërtetë profecia e falltarit. Kështu, ishte i sigurt se do të pushtonte edhe Gazën. Vërtet pas ca ditësh Gaza binte në duart e ilirëve. Plaçkë të shumta dhe të pasura gjetën luftëtarët e Aleksandrit në Gaza. Një nga oficerët maqedon i ofroi Aleksandrit një kuti të çmuar, të gdhendur mrekullisht dhe të zbukuruar me gurë të çmuar.

- Në këtë kuti vetëm diçka e vyer dhe e dashur mund të vihet, - i tha oficeri Aleksandrit.

Dhe ai u përgjigj menjëherë:

- Ke të drejtë. Në këtë kuti do të vendos “Iliadën”.

Pasi iu shërua plaga, përparoi tashmë kundër Egjiptit. Ishte ëndërr e vjetër e ilirëve që të pushtonin Egjiptin. E kishin sulmuar edhe më herët, kur njiheshin si "popuj të detit". Por, kjo ëndërr po realizohej sot nga Aleksandri.

Në nëntor të 332 hyri në Egjipt dhe përparoi drejt kryeqytetit të tij, Memfidës. Andej kah kalonte egjiptianët me në

krye priftërinjtë e tyre e prisnin si çlirimtar. Se edhe ata, sikundër shumë fise tjerë, rënkonin nën zgjedhën perse.

Para se të depërtonte në brendësi të Azisë, ai dëshironte të sigurohej mbi forcën e tij që kishte në pjesën mesdhetare. Depërtoi në Egjipt, mori pjesën e djathtë të deltës së Nilit dhe themeloi qytetin Aleksandria.

Pas fitores në betejën e Granikut, Aleksandri marshoi në drejtim të bregut perëndimor të Azisë së Vogël, duke çliruar qytetet greke nga pushtimi persian. Sardi u dorëzua dhe Aleksandri dha urdhër që në kala të ngrihej një faltore për zotin e pellazgëve. Edhe Efesi u dorëzua dhe Aleksandri urdhëroi që taksat që i paguheshin Persisë, t'i kalonin tempullit të Dianës. Ai tregoi shumë kujdes për organizimin e administratës qeveritare të territoreve të pushtuara dhe mbajti lidhje të vazhdueshme me administratorët e tij në Maqedoni.

Thjesht hyjnor, i deklaruar si biri i perëndive, pasi mundi persianët në betejën e Issusit, Aleksandri vendosi të hyjë në Egjipt, që ishte nën sundimin persian prej 200 vitesh. Egjiptianët i urrenin persianët për taksat e rënda dhe jotolerancën fetare. Ata e shpallën me kënaqësi Aleksandrin si faraon, duke nxitur një shkëmbim kulturor mes Greqisë dhe Egjiptit që zgjati 300 vjet. Në tempullin e Zeusit në Egjypt priftërinjtë i thanë se ishte djali i Zeusit, gjë të cilën pavarësisht në e besonte apo jo, e përdori për avantazhin e tij.

Themeloi Aleksandrinë. Përveç ngritjes së qyteteve ekzistuese, Aleksandri themeloi 20 të reja, duke u vënë emrin e tij. Më jetëgjata është Aleksandria e sotme në bregun e deltës së Nilit. Më pas erdhën njëra pas tjetrës rënia e Sirisë, fitorja vendimtare e Issusit, dorëzimi i Sidonit dhe, pas një rrethimi shtatëmujor, shkatërrimi i Tirit.

Gjatë rrethimit të Tirit, Dari, që ishte hedhur shëndosh e mirë përtej Eufratit, propozoi të bënin marrëveshje me Aleksandrin. Sipas saj, ai ishte gati të dorëzonte perandorinë e tij të madhe në perëndim të Eufratit dhe t'i jepte të bijën për grua Aleksandrit.

Mirëpo, Aleksandri që ia kishte vënë syrin të gjithë perandorisë, nuk pranoi. Njëri prej gjeneralëve të tij veteranë, Parmioni, i vuri në dukje Aleksandrit: "Po të isha si ti, do t'i pranoja këto kushte". Aleksandri ia ktheu: "Po ashtu edhe unë do të pranoja, sikur të isha Parmioni".

Gaza dhe qytetet egjiptiane ranë dhe populli i çliruar e bëri atë **faraon**. Një prift i atyshëm e përshëndeti Lekën e Madh, duke e quajtur **"Bir i Zeusit"**. Për shkak të fitoreve ushtarake të mahnitshme dhe kombinimit të rreptësisë me mëshirën në gjykimin e tij ndaj të mundurve, atij vazhdimisht zunë t'i drejtoheshin si **Hyjni**. Ndonëse, më vonë, thuhet se e ka pranuar një nderim të tillë, në këtë fazë që po flasim, sigurisht që nuk ushqente iluzione të tilla.

8. Beteja e Gaugamelës – pushtimi i Mesopotamisë dhe i Babilonisë *(Maj-Nëntor 331 p.e.s.)*

Marshimi i Aleksandrit nga Memfisi për t'u kthyer në Tir mbi 650 km rrugë duhet të ketë zgjatur rreth një muaj, të ketë arritur kah fundi i majit. Aty gjeti edhe flotën e tij detare, që kish arritur nga Maqedonia. Në Tir u organizuan festime të mëdha kuturore, artistike, shfaqje teatrore, konkurse muzikore, gara sportive dhe parada ushtarake madhështore. Pastaj Aleksandri i dha fund këtij kremtimi të madh kulturor e fetar për nder të Herkulit (Heraklitit). Kështu kishte vepruar Aleksandri edhe atëherë, kur ishte nisur nga Maqedonia drejt Egjyptit dhe Mesopotamisë, duke organizuar kremtime të mëdha në Dion. Tani, pas marrjes së Egjyptit, shikimi ishte drejtuar drej Mesopotamisë dhe Babilonisë.

Ushtria pellazgo-iliro-maqedonase e Aleksandrit të Madh mezi priste të shkatërrojë ushtrinë persiane dhe për të përmbysur sundimin e Darit III mbi Mesopotami, Babiloni e deri në Indi. Gjatë shtatë-tetë muajve të fundit, që nga beteja për marrjen e Gazës, luftëtarët e Lekës së Madh nuk kishin luftuar më, sepse Egjipti u dorëzua pa luftë.

Diku në muajin korrik ushtria maqedonase arriti në brigjet e lumit Eufrat. Vapa ishte e padurueshme, kurse lumi i pakalueshëm. Leka i Madh urdhëroi ndërtimin e një ure dhe me ndihmën edhe të disa barkave ushtria e tij kaloi matanë lumit.

Gjatë marshimit të ushtrisë maqedone drejt fushëbetejës së Gaugamelës e shoqëronte edhe familja mbretërore persiane, e zënë rob në Betejën e Issusit(Isos): nëna e perandorit Dari III, Sisygambis dhe gruaja e tij, mbretëresha Statira, bashkë me fëmijët e saj. Po ashtu ishte edhe nusja e Aleksandrit të Madh me origjinë persiane, Barkina me djalin e tij njëvjecar, Herkulin(Heraklitin). Kur në gusht u freskua pak koha, Leka i Madh u hodh në veri, duke kaluar nëpër Mesopotaminë Veriore deri në një vend të lumit Tigër, i cili është 100 km larg nga Mosuli i sotëm (Kurdistani irakian). E lajmëruan se Dari III gjendej në atë krahinë.

Në fillim të shtatorit ushtria e Lekës arriti në brigjet e Tigrit, të cilin e kaluan me vështirësi të madhe këmbë, ku uji i lumit u vinte ushtarëve deri në fyt. Me shumë sakrifica ushtria doli në anën tjetër të bregut të lumit, ku ngritën tendat e pushimit. Të nesërmen, më 21 shtator, vazhdoi marshimin përgjatë bregut të Tigrit, duke shkuar në drejtim të Mosulit të sotëm. Më 25 shtator ndeshi në pararojën kalorsiake persiane. Duke vrapuar me kuaj drejt tyre, Aleksandri dhe bashkëluftëtarët e tij i ndoqën ata, duke kapur robër disa prej tyre. Nga ata mësuan se sa e madhe ishte ushtria persiane dhe se ku ndodhej ajo. Robërit persianë njohtuan se Dari III nuk ishte larg nga këtu, se ndodhej me ushtrinë e tij në Gaugamela, buzë lumit Likos, i cili ishte një degëzim i Tigrit, por pjesa kryesore e ushtrisë persiane ishte në Arbela (Erbili i sotëm), gati 28 km në veri të Mosulit. Në të vërtetë Dari III e kishte zgjedhur fushën e Gaugamelës për t'u ndeshur me ushtrinë maqedonase dhe ishte duke e pritur aty.

Nga data 26-29 shtator Aleksandri i Madh qëndroi në pushimoren e ushtrisë së tij, vetëm 12 km larg pozicioneve persiane. Mund të kishte shpresë dhe qëllim që ta shkulte Darin III nga ajo fushë, ose të merrte informata më të sakta rreth planeve të kundërshtarit. Kjo pritje ishte plotësisht e

pazakonshme për Lekën e Madh, sepse, në përgjithësi, ai mburrej me shpejtësinë e befasishme të goditjes së tij, që asnjëherë nuk u linte kohë armiqve të përgatiteshin për luftë e për qëndresë. Duket se tani, për herë të parë në jetën e tij, ai e kuptoi rëndësinë me pasoja të rënda të betejës që kishte përpara. Gjatë këtyre katër ditëve ai dha urdhër që të rrethohej vendqëndrimi i ushtrisë maqedonase me pahisore dhe të hapeshin hendeqet përqark, në mënyrë që ushtria të kishte liri të plotë lëvizjeje gjatë luftimit. Ai mendoi t'i lërë të gjitha plaçkat. Në marrjen e kësaj mase shihet se Aleksandri tanimë kish filluar të piqet, të bëhet më serioz, më i mendueshëm, duke e frenuar rrëmbimin e tij të papeshuar mirë.

Gratë e familjes mbretërore persiane, që ishin zënë rob nga ushtria maqedone, ishin lodhur e rraskapitur aq shumë nga marshimet e gjata të ushtrisë, saqë gruaja e Darit III, Statira, u sëmur pa shpresë shërimi. Ajo ndihej fatkeqe, e dëshpëruar dhe e mërzitur në kulm, sepse po të fitonte betejën Dari III, atë do ta vriste ushtria maqedone. Por, nëse do të fitonte luftën Aleksandri i Madh, ajo do të ishte e humbur dhe robëreshë e përhershme e ushtrisë maqedone. Të gjitha këto halle e mendime pa shteg çuan në dobësimin e saj shpirtëror e trupor dhe në ditët që vijuan, para betejës së Gaugamelës, ajo ndërroi jetë në krahët e nënës së Darit III.

Aleksandri i Madh u prek thellë nga ky rast i pikëllueshëm. Në rrethanat e deritanishme kishte bërë çmos që t'i trajtonte robërit miqësisht dhe për t'ua lehtësuar jetën. Kur shkeli në çadrën persiane, duke parë trupin e pa jetë të mbretëreshës, nuk u përmbajt dhe i shpëtuan lotët. Bashkë me nënën mbretërshë të pangushëlluar, ai u mallëngjye dhe mbajti zi si një bir për të vdekurën. U përkujdes t'i bënin një varrim madhështor, sipas zakonit persian dhe të vdekurës i bëri nderim të veçantë. Agjëroi një ditë të tërë, sikur ai të ishte një i afërm i saj.

Kur mori vesh Dari III për vdekjen e gruas së tij mbretëreshë dhe për nderimin e varrimin madhështor që kishte bërë Aleksandri i Madh për nder të saj dhe familjes mbretërore persiane, i prekur thellë nga ai gjest fisnik, vrapoi te miqtë e tij,

duke ngritur duart drejt qiellit, u lut: "O ju perënditë e familjes dhe të perandorisë sime, po ju kërkoj të ndihmoni Persinë që i kërcënohet rreziku! Bëni të mundur ta lë vendin po aq në gjendje të mirë sa e gjeta dhe të më paraqitet rasti t'ia shfaq Aleksandrit falenderimin tim për nderimin që ka treguar kundrejt të afërmve të mi, megjithëse jemi armiq. Por, nëse ka ardhur koha që perandorisë persiane i është afruar fundi, në qoftë se perënditë ziliqare kërkojnë shparatallimin tonë, atëherë po ju lutem që njeri tjetër mos të hipi mbi fronin e Kirit, përveç Aleksandrit të Maqedonisë".

Disa autorë mendojnë se Dari III para betejës së Gaugamelës i bëri ofertë të re paqeje Aleksandrit të Madh, sipas të cilës rishtas propozohej martesa e tij me princeshën persiane, bijën e Darit III, si dhe ndarjen e perandorisë persiane midis Darit dhe Aleksandrit. Madje thonë se Dari III i shprehu Aleksandrit falenderime për trajtimin miqësor të pjesëtarëve të familjes së tij, si dhe për varrosjen madhështore të mbretëreshës. Por, disa autorë antikë rrëfejnë se në ndërkohë Dari i Persisë kishte thurrur një komplot, sipas të cilit disa oficerë maqedonë (me origjinë greke) duhej të vrisnin Aleksandrin e Madh të Maqedonisë! Kur Leka e mori vesh këtë komplot, nuk e zgjati më. Me zemërim të papërmbajtur ai deklaroi se nderimin që i kishte bërë mbretëreshës së vdekur persiane, nuk e kishte bërë për hir të Darit, por për humanizëm. Dhe nga ky moment Leka i Madh i shpallë Darit III luftë për jetë a vdekje.

Natën e 29 shtatorit, në errësirë, Aleksandri u shty 4-6 km përpara në drejtim të llogoreve të ushtrisë persiane. Kur zbardhi drita, ai e pa veten përballë pararojës së ushtrisë armike. Aleksandri mendonte që të niseshin direkt në sulm, por Parmenioni e këshilloi të prisnin së paku edhe një ditë për ta vrojtuar më mirë sheshin e luftës. Qarkullonin zëra se Dari para pozicioneve të tij, përfundi llogoreve, kishte hapur gropa që të shembej dheu e të binin në grackë ushtarët e kundërshtarit. Për zbulimin e saktë të terrenit u mor vetë Aleksandri, që nuk kishte më moskokëçarjen e tij të zakonshme, e cila e shtynte deri në

afërsitë e rrezikshme të vijave armike. Kjo taktikë zbulimi para betejës ishte edhe një dëshmi tjetër e maturisë së Aleksandrit.

Për numrin e trupave të ushtrisë persiane kemi të dhëna të ndryshme. Një herë thuhej se ishin 200 000 këmbësorë të përforcuar me 45 000 kalorës, një herë tjetër thuhej se ishin 1000 000 këmbësorë dhe 100 000 kalorës. Sipas Arrianit, ushtria e Aleksandrit përbëhej nga 40 000 këmbësorë dhe 7000 kalorës, prandaj është e pabesueshme të mendohet që ushtria persiane të ketë qenë më e madhe se 100 000 ose 150 000 ushtarë. Në ushtrinë persiane kishte ushtarë nga lloj-lloj popujsh, si: persianë, baktrienë, indianë, skithë, parthë, mederë, armenë, mesopotamë, arabë, babilonas, sirianë, si dhe anëtarë të disa popujve e fiseve tjerë. Dari III kishte varur shpresë të madhe te 200 qerret korrëse. Secila tërhiqej nga 4 kuaj, në rrotat e tyre ishin vendosur kosa të mprehta të ngjashme me terplotet e makinave korrëse moderrne. Ai kishte sjellë edhe 50 elefantë, të cilët qenë përdorur për herë të parë në luftë kundër ushtrive europiane. Garda e Darit përbëhej nga 1000 veta, të gjithë burra të zgjedhur, përveç 2000 mercenarëve grekë që e përcillnin.

Pas një vëzhgimi të kujdesshëm të sheshit të luftimit, Aleksandri i mblodhi oficerët e tij në këshill dhe u mbajti një fjalim të mahnitshëm, ku ua kujtoi të gjitha premtimet që u kishte bërë para Betejës së Issusit (Isosit), që mendohej se do të ishte luftimi i fundit kundër Darit III të Persisë, ngase me atë betejë mendonte se do ta shkatërronte përfundimisht. Aleksandri u tha komandantëve të tij: ”Deri tani ne me trimërinë tonë kemi fituar vetëm Sirinë dhe Egjiptin, por tani është në lojë fati i gjithë Lindjes”.

Pastaj Leka dha disa urdhëra të përgjthshëm. Sulmi do të fillonte porsa të lindte dielli, pasi që ushtria të kishte pushuar e fjetur sa duhet. Parmenioni propozoi të bënin një mësyemje të befasishme natën, por Leka e kundërshtoi me vendosmëri, duke ia kthyer: ”Unë nuk i vjedh fitoret, pushtimet i bëj në dritë të diellit dhe jo me të pabesë!”.

Aleksandri nuk ishte aq i sigurt në fitore, siç kishte qenë zakonisht në betejat e mëparshme, prandaj atë natë nuk kishte

gjumë. Qielli ishte i ndriçuar nga yjet, kurse fusha ndriçonte e tëra nga pishtarët dhe zjarret persianë. Duket se Dari III i kishte në këmbë të armatosur tërë natën ushtarët e tij nga ana e një sulmi të befasishëm natën të ushtrisë maqedone dhe vetëm të nesërmen do ta kuptonte se ata mund të mos ishin në formë për luftë. Kurse ushtria e Aleksandrit kishte ngrënë mirë e fjetur tërë natën, sa që Dari heshtjen në kampin armik e mori si një shenjë të rrezikshme për të.

Papritur Aleksandri dërgoi e thirri "orakullin" e tij, Aristanderin, si edhe disa falltarë dhe magjistarë që së bashku të kryenin një ceremoni mistike. Magjia misterplotë, të cilën Leka e kishte mësuar që në prehrin e nënës së tij, Olimpisë, dhe e kishte pasuruar edhe me shenjat dhe mrekullitë e magjive egjiptiane, i vlente tani për të dëbuar fuqitë e padukshme. Vetëm pasi pati kaluar gjysma e natës, u shtri në shtrat dhe fjeti deri vonë në mëngjes. Në ndërkohë në hyrje të çadrës së tij ishin grumbulluar gjeneralët e tij. Ata s'dinin si të bënin, ta zgjonin apo mos ta zgjonin nga gjumi Lekën. Më në fund hyri brenda Parmenioni, i cili duke e shkundur e pyeti: "Si mundeni të flini në një mëngjes të tillë?". Aleksandri qeshi duke pyetur se përse ia prishin gjumin kur Darin e ka në dorë. Nuk dihej se çfarë vegimesh kish parë në ëndërr, por nga sytë i shkëlqente vetëbesimi i madh për fitore. Kur nën kurorën e zjarrtë të diellit vrapoi mbi shpinë të kalit të tij Bukefalit, pranë rradhëve të ushtarëve të tij, sytë shndrisnin me më shumë shpresë se kurrë. Krahas tij vinte kaluar Aristanderi me mantelin e tij të bardhë dhe me kurorën e artë të priftit në kokë. Në fytyrë dukej siguria në fitore dhe besimi i ngulur se hyjnitë i mbanin krahun.

Në sulmin kundër ushtrisë persiane, Aleksandri e ndau ushtrinë në dy pjesë. Njëra pjesë, e prirë nga vet Leka, do të sulmonte në krahun e djathtë, kurse pjesa tjetër e ushtrisë maqedone do të sulmonte nga krahu i majtë, e udhëhequr nga Parmenioni. Kjo ndarje u bë për shkak të dyshimit nga Aleksandri se qendra e fushëbetejës mund të ishte përplot pusi të nëndheshme, të ndërtuara ditë më parë nga Dari III. Prandaj, Leka vendosi që mos ta sulmojë ushtrinë persiane ballë për ballë,

por në formë gjysmërrethi nga të dy anët, djathtas dhe majtas. Persianët këtë sulm nga brinjët të Aleksandrit e pritën me një hapje të gjerë, duke ia prerë rrugën Aleksandrit, me një gjysmërrethi kalorësish skithë dhe baktrianë. Pararoja maqedone rrezikohej të mbetej e rrethuar. Pasi këmbësoria i duhej për sulmin e madh, Leka e çoi kalorësinë e vet në anën e djathtë luftës, ku u zhvillua një betejë e ashpër kalorësish. Në të njëjtën kohë Dari III i dërgoi përpara qerret korrëse kundër krahut të majtë të ushtrisë maqedone, por kjo përpjekje i dështoi plotësisht, sepse ushtarët e Lekës rrihnin me forcë mburojat e tyre me heshta për t'i trembur kuajt persianë, pastaj i prishnin radhët dhe i linin qerret të kalonin. Ktheheshin shpejt dhe i vrisnin kuajt e karrocierët me shtiza dhe shigjeta. Dari III, i tmerruar, kërkoi ta rrethonte krahun e djathtë të armikut, duke hedhur atje një aradhë të madhe kalorësish. Papritur e pakujtuar u krijua midis persianëve një zbazëti, atëherë Aleksandri shfrytëzoi rastin e përshtashëm për të ndërhyrë menjëherë me bashkëluftëtarët e tij. Tani, si në betejën e Isos(Issusit), u vërsul kundër qendrës së ushtrisë persiane të Darit III dhe, si gjithmonë, nuk kishte ushtri që mund t'i bënte ballë sulmit rrufe të ushtrisë maqedone, kur në ballë i printe vet Aleksandri i Madh. Njësoj edhe kësaj rradhe, Leka brenda një kohe të shkurtër e çau shtegun dhe u sul drejt gardës persiane, ku u gjet përballë Darit III. Mbreti i tmerruar persian drejtoi heshtën kundër Aleksandrit, por në atë çast korrocieri i qerres së Darit III ra i vdekur nga heshta e Lekës. Me shpejtësi Dari III zbriti nga karroca luftarake, i kërceu kalit të qerres në shpinë dhe iku me panik, i ndjekur nga shumica e trupave të tij ushtarake, si dhe nga elefantët, të cilët nuk kishin hyrë ende në luftim. Ushtria e Lekës doli nga rrethimi, sepse kjo pjesë e ushtrisë persiane u shpartallua vetvetiu. Në shesh të luftës filloi një gjakderdhje e pamëshirshme mbi armiqtë që po iknin. Ndoshta Leka i Madh do të kishte mundur ta arrinte Darin III dhe ta godiste për vdekje, po të mos i kishte ardhur,papritur lajmi se krahu i majtë i ushtrisë, i komanduar nga Parmenioni, gjendej keq. Ndaj, hoqi dorë nga ndjekja e mëtejshme e Darit III dhe gardës së tij

ushtarake. Që në fillim të përleshjes ushtria persiane ishte ngatërruar keq me Parmenionin. Gjenerali persian, Mazaios, vazhdonte ta detyronte atë të tërhiqej. Me përparimin e shpejtë të Aleksandrit në qendër të fushëbetejës, mbeti e zbrazët ana e djathtë e ushtrisë maqedonase e Parmenionit dhe aty shumë shpejt depërtuan një numër i madh kalorësish persianë dhe indianë, të cilët sulmuan ashpër prapavijën maqedone. Persianët liruan disa nga robërit e tyre dhe u kthyen në shesh të betejës. Ndërkohë Parmenioni i kishte dërguar Aleksandrit një lejmëtar me kërkesë të ngutshme për ndihmë. Leka me bashkëluftëtarët e tij, duke iu përgjegjur pa vonesë këtij kushtrimi, ndeshën me repartin e kalorësve armiq që po kthehej me robërit e liruar. Aty u zhvillua përleshje e ashpër. Por, në atë kohë persianët morën vesh për ikjen e Darrit III nga fushëbeteja, ndaj braktisën menjëherë luftimin e ia mbathën. Në atë rast Aleksandri bashkë me Parmenionin iu qepën Darit III pas. I vetmi qëllim i tij tani ishte të arrinte mbretin e persianëve. Në vrullin e tij të etshëm Leka i Madh kaloi shumë përpara luftëtarëve të tij. Papritur i dolën në rrugë një numër i madh kalorësish persianë që e vunë atë në një pozitë shumë të rrezikshme. Por ai u vërsul i guximshëm kundër komandantit të tyre duke e vrarë atë, si dhe disa kalorës tjerë, kurse pjesa tjerë e kalorësve persianë i kthyen kuajt mbrapsht dhe ikën me vrap.

Tashmë kishte rënë muzgu dhe errësira. Duheshin këmbyer kuajt dhe sa më parë ushtarët e lodhur nga luftimi i gjithë ditës duhej të pushonin. Përkohësisht duhej ndërprerë ndjekja e mëtejshme e Darit III dhe ushtrisë së tij në ikje. Në mesnatë Aleksandri u nis përsëri, pa ngrënë e pa fjetur dhe qëndroi i vetëm në bazën e braktisur të persianëve, në Arbela, gati 100 km larg sheshit të vërtetë të luftimit. Ndërkohë Dari III nëpër rrugën nga Etabana kishte ikur në Medieni, i përcjellë nga kalorësia baktrike e komanduar nga Bezusi, prej disa mijëra mercenarësh grek dhe nga mbeturinat e ushtrisë tjetër. Aleksandri e kuptoi se fitorja nuk ishte ende e plotë, megjithëse shumica e ushtrisë persiane u asgjësua e u shpartallua. Sidoqoftë, kjo ishte një fitore madhështore, edhe nëse Aleksandri në sulmin

e tij të papërmbajtur nuk arriti qëllimin e fundit, kapjen e mbretit persian, Daritt III. Kështu, edhe në këtë betejë, Leka i Madh u dallua si luftëtar trim, guximtar, kalorës i shkëlqyer dhe me një qëndresë vigane, gjithnjë i gatshëm të shfrytëzojë rastin e përshtatshëm.

Nga Arbela Aleksandri i kaloi me ngut ato 500 apo 550 km rrugë në drejtim të jugut për në Babiloni. Gjenerali babilonas, Maziosi, i cili përpak sa nuk e mposhti Parmenionin maqedon, ishte drejtuar pikërisht atje dhe i kishte këshilluar banorët e qytetit që të dorëzoheshin. Kur u afrua ushtria maqedone e Lekës së Madh, asaj i dolën përpara Maziosi dhe paria e qytetit: pleqtë, priftërinjtë, nëpunësit dhe i gjithë populli i veshur me teshat më të mira festive, duke mbajtur në duar kurora lulesh. Aleksandri i Madh hyri në Babiloni nëpër sheshin e shtruar me lule, që kundërmonte temjan dhe aromë të këndshme lulesh.

Në Babiloni Dari III ishte po aq i huaj sa në Egjipt. Aleksandri kishte dërguar më parë lajmëtarët e tij në Babilon dhe i kishte premtuar qytetit rivendosjen e të drejtave dhe ligjeve të vjetra autoktone. Ai, njëlloj si në Memfis, u prit dhe u përshëndet nga populli i Babilonit si shpëtimtar e çlirimtar nga zgjedha e urryer e Persisë. Pasi u shpall mbret i Babilonisë dhe i Azisë, Aleksandri filloi të sillej ndryshe, ashtu siç mund të pritej nga një mbret me origjinë hyjnore. Pak kohë më parë kishte kremtuar ditëlindjen e tij të 25-të dhe besonte se misioni i tij hyjnor i linte atij pak kohë për endjet tokësore. Ai u rrethua nga priftërinj të moçëm kadaikë, dijetarë dhe njerëz të mençur. Arriani thotë: "Gjithnjë atë që e këshillonin të bënte në drejtim të fesë, ai e zbatonte pa kundërshtim". Perëndia aramaike, Beli ose Marduku, njihej në Pellazgji(Iliri)Maqedoni si Zeus-Beli, pra, vlente si një mishërim tjetër i atit të Aleksandrit, Zeus-Amonit. Kështu, Leka i Madh, mbreti i Babilonisë, u bëri flijime hyjnive babilonase, sipas udhëzimit të priftërinjve dhe urdhëroi të rindërtohej menjëherë tempulli i lashtë.

Aleksandri i Madh, pasi e emëroi Mazaiosin si mëkëmbësmbret të Babilonisë, në një mot të freskët nëntori iu drejtua kryeqytetit tjetër persian, Suzas, që gjendej 200 km në

lindje të Babilonit. Pararoja e tij kishin arritur atje përpara ushtrisë dhe i ftuan banorët që të nënshtroheshin në mënyrë paqësore. Kah fundi i nëntorit Leka me ushtrinë e tij arriti në qytet, ku u pritën dhe u përshëndetën nga paria e vendit, nga banorët, si dhe nga mëkëmbësi i mbretit, Abulites, të cilin Aleksandri e la në postin që kishte. Ata i uruan mirëseardhjen Aleksandrit dhe shoqëruan në qytet. Edhe Suza, sikurse Babiloni, Darin III e konsideronin si pushtues dhe sundimtar të huaj. Krahina e Suzit nuk qe gjë tjetër, veçse mbretëria e vjetër e Elamit që e kishte pushtuar Persia. Leka i Madh edhe këtu, si në Babiloni, u brohorit si çlirimtar dhe si shpëtimtar. Prandaj, si në Babilon, edhe në Suza, Aleksandri urdhëroi ushtrinë e tij të përmbahet nga sjelljet vandale dhe plaçkitëse. Si në Babilon, ashtu edhe në Suza, Aleksandri dhe u ushtria e tij u mjaftuan me pasurinë personale e mbretërore që kishte lënë pas Darri III me të marrë arratinë pas disfatës ushtarake në Betejën e Gaugamelës. Kjo pasuri ishte përrallore dhe shumë e madhe, sa i mjaftoi Lekës dhe ushtrisë së tij për të përballuar shpenzimet e luftës dhe për finansimin e marshimeve e betejave të ardhshme në Azi. Në damarët e Aleksandrit vlonte etja e pushtimit, një vrull i zjarrtë që nuk njihte kufinj. Perandorisë së Darit III i kishte rrëmbyer vetëm disa gjymtyrë, pa mundur t'i qëllonte kryet e zemrën. Sytë e tij drejtoheshin tani kah jugu, ku ende qëndronte kryeqyteti i perandorisë persiane, Persepolisi, kurse në veri ia shtonte lakminë Ektabana. Vetëm pas pushtimit të tyre, - pleqëronte ai,- do të asgjësohej Persia. Dhe nuk do të ishte aq e vështirë ta bënte ushtrinë për vete, që të mund të zbatonte planet e reja të pushtimit. Ai duhej që së paku t'i lejonte ushtarët të plaçkisnin Persepolisin. Këtë vendim e mori pasi bëri luftë me vetveten. Ky qytet kishte tamam vulën persiane dhe prej këtej, siç mendonte Leka, para 150 vitesh kishin ardhur ata njerëz që kishin plaçkitur e i kishin vënë zjarrin Athinës, si dhe kishin përdhosur shenjtoren e Amonit në Egjipt.

Në të tri betejat me Persinë, Aleksandri pati tri fitore të jashtëzakonshme. Perandoria më e madhe e kohës u rrëzua nga një burrë i vetëm! Pas pushtimit të Persisë, Aleksandri u drejtua

për në Lindjen e Mesme e të Largët, drejt Pakistanit dhe Indisë, në kërkim të fundit të botës.

9.Marrja e Persepolit dhe pushtimi i Persisë, i Medisë dhe i Hirkanienisë
(dhjetor 331 p. e. s – tetor 330 p. e. s.)

Aleksandri i Madh e nisi marshimin e tij prej Suzës drejt Persepolit, kryeqytetit të Persisë, në fillim të dhjetorit të vitit 331 p. e. s. Ai mori drejtimin nga juglindja nëpër krahinën e sotme persiane të Arabistanit dhe Shirazit modern. Persepoli duhej të gjendej 56 km në verilindje të tij dhe kishte 650 km rrugë nga Suza. Pasi ushtria kaloi 160 km, arriti në bjeshkën e Uksierit për shfrytëzimin e rrugëve dhe qafave të së cilës edhe mbreti Dari III paguante para për kalim. Edhe Aleksandrit i doli përpara një dërgatë e këtyre malësorëve për të kërkuar një tagër të tillë. Leka u tha atyre se do të merrnin atë që u përkiste, kurse me vete mendoi planin e dënimit ndaj tyre. Kështu, Aleksandri, me 10 000 ushtarët e tij më të zgjedhur i sulmoi natën fshatrat më të afërta uksiere, duke vrarë shumicën e banorëve të tyre. Pastaj u ngjit lart në qafat e maleve dhe zuri robër malësorët e armatosur, të cilët kërkonin pagesë për lejekalim nëpër tokat e tyre. Disa nga robërit i vrau, një pjesë u arratisën, kurse një numër prej tyre i fali dhe i la të lirë, pasi kërkuan falje.

Leka i Madh kaloi 200 km sipër vargmaleve dhe luginave që gjendeshin midis tyre. Disa prej këtyre maleve arrinin deri në 5000 m lartësi. Kalimi i këtyre maleve ishte i vështirë në verë, e jo më në dhjetor, kur bora kishte zbardhur qafat e majat e maleve. Ashtu siç kishte udhëhequr ushtrinë e tij në mes të vapës së verës së korrikut nga Egjipti përmes Sirisë për në Mesopotami, përsëri po ngutej përmes acarit të egër të dimrit sipër maleve të larta, për të shkuar në zemër të Persisë, në Persepolis.

Por fati e deshi që për ndihmë u doli njëfarë Lykios si udhërrëfyes i Lekës për ta dërguar atë drejt Persepolit. Ky babanë e kishte nga fisi Likes i Azisë së Vogël, kurse nënën e kishte persiane. Po të rikujtojmë parashikimin e orakullit të

Delfit që i bëri Lekës para se të nisej nga Maqedonia drejt Persisë, do të shohim se orakulli i kishte thënë Lekës se atë do ta ndihmonte për në Persi një ***likos***, d. m. th. një ***ujk***.

Arritën në grykën shkëmbore të fundit. Tani duhej të përcaktonte nëse do të zgjidhte rrugën më pak të vështirë nga jugu, apo atë më të vështirën nga lindja, që kalonte nëpër grykën e njohur si "Dera persiane" dhe viset kodrinore të saj. Në këtë rast Aleksandri vendosi që shumicën e ushtrisë, të kryesuar nga Parmenioni, ta dërgojë kah jugu, gjatë rrugës së shtruar, kurse vet, bashkë me shtabin e ushtrisë dhe luftëtarët më të mirë të tij u ra maleve përmes. Shumë shpejt doli në pah se kishte gabuar. Zbuluesit e mbretit të Persisë, Dari III, nuk kishin qëndruar duarkryq. Leka dhe ushtria e tij e gjetën grykën të zënë prej 25 000-40 000 ushtarëve persianë nën komandën e nënmbretit të asaj treve, Ariobarzanesit.

Persianët e kishin mbyllur kalimin tejpërtej me mur, ndaj sulmi i parë i Aleksandrit dështoi. Atëherë ai e urdhëroi Krateriosin që me pjesën më të madhe të ushtrisë të kthehej, kurse vet me një çetë të vogël ushtarësh natën në errësirë të futej nëpër një shteg të panjohur mali për të kapërcyer pengesën dhe për të sulmuar armikun prapa krahëve. Kjo përpjekje e guximshme ia arriti qëllimit dhe plani që dukej i pamundur, tani u realizua. Me bërtima të larta luftarake Leka me çetën e tij u vërsul mbi armikun, duke i dalë para Krateriosit. Mijëra ushtarë persianë u therën, të tjerët u arratisën bashkë me komandantin e tyre. Tani Aleksandri zbriti nga malet, rruga ishte e hapur dhe kështu vazhdoi marshimin e ngutshëm drejt Persepolit. Ai shumë shpejt u gjend para portave të kryeqytetit të Persisë. Nëpunësit e qytetit nuk arritën t'i shpëtonin në kohë thesaret e Darit III, as që të merrnin masa të tjera sigurimi. Kur ushtria e Lekës hyri në qytet, asaj i ra në dorë një sasi e madhe ari dhe argjendi, enë e orendi të çmuara. Ushtarët kishin marrë leje të plaçkisnin qytetin, përveç pallatit mbretëror. Të gjithë banorët e Persepolit që nuk ikën me kohë, u vranë me urdhër të Aleksandrit. Kjo ishte hakmarrja e Lekës së Madh për tiraninë që kishte ushtruar Dari III dhe paraardhësit e tij ndaj trojeve të

Pallazgjisë, Maqedonisë, Egjiptit dhe Babilonisë. Kjo ishte hakmarrje ndaj barbarive të mbretit persian, Kserksi, që kishte bërë ndaj Spartës e Athinës 150 më parë.

Aleksandri u vendos në pallatin madhështor të Darit III, të rrethuar me lulishte. Në javët që kaluan ai e provoi se çfarë do të thoshte të ishe një mbret oriental. Dhe, ndërsa pjesa më e madhe e ushtrisë po shijonte pushimin dhe qejfin në Persepolis, Leka ndërmori bashkë me një grup luftëtarësh një udhëtim zbulimi në viset malore të mbuluara me borë midis Persepolit dhe Gjirit Persik. Tridhjetë ditë rresht udhëtoi Leka me shokët e tij nëpër borë e akull deri sa arritën në breg të detit ku i zuri frika, sepse ata menduan se Gjiri Persik i përkiste detit më të jashtëm që rrethonte botën, dhe se ata kishin arritur në Had, ku sipas legjendave, banonin shpirtërat dhe djajtë. Aleksandri më shumë anonte kah mendimi se ky gji ishte një det i mbyllur, po shpresonte që faktet të mos i jepnin të drejtë, sepse ai donte t'i zgjeronte kufijtë e perandorisë së tij deri te caqet e botës.

Pasi kthye në Persepolis, Leka shpalli se kishte për qëllim të bënte edhe 800 km rrugë drejt veriperëndimit në Ektabana, kryeqyteti i Medias, i cili gjendej në mes të rrugës midis Bagdadit dhe Teheranit, pak a shumë ku është sot qyteti i Hamadanit. Në Ektabana Dari III po bënte përpjekje që ta njihnin si mbret të Persisë. Kurse ushtria maqedone besonte se me zënien rob të tij, do t'i jepnin fund luftës. Kufiri i Medias ishte afër 200 km larg në veriperëndim të Persepolit. Arritën aty kah mesi i majit. Leka nga vendqëndrimi i tij e mori vesh se Dari III kishte planifikuar që në Ektabana t'i dilte përballë ushtrisë së Lekës, por nuk mundi të mbledhë asnjë ushtri të madhe që ia vlente, ndaj kishte vendosur që të tërhiqej bashkë me disa mijëra ushtarë të tij në drejtim të verilindjes, për të gjetur strehë në provincën e Baktrianës, ku mëkëmbësmbret ishte Beziusi.

Aleksandri dhe ushtria e tij po marshonin me shpejtësi drejt Etabanës, por në ndërkohë mori vesh se Dari III kishte ikur nga ai qytet. Tani Leka duhej të vendoste: ta ndiqte pas, apo ta braktiste ndjekjen e Darit III dhe ta linte atë në fatin e tij. Në fund të majit apo në fillim të qershorit Aleksandri arriti në Ektabana.

Aty ai mori vendim të prerë: ajo pjesë e trupave që kërkonte patjetër të kthehej, të merrte rrugën për në shtëpi, ndërsa pjesa tjetër të vazhdonte ndjekjen e Darit III. Shumicën e thasaliotëve dhe kalorësve grekë i liroi. Atyre që mbetën, me anë të një fjalimi prekës u premtoi plaçkë edhe më të madhe, nëse mundimi i fundit do të sillte kapjen rob të Darit III. Në këtë mënyrë, shumica e ushtrisë nën komandën e Parmenionit nuk kishte nevojë të lodhej, sepse një repart i lëvizshëm i udhëhequr nga Aleksandri u vu në ndjekje të persianëve që iknin me nxitim të madh, bashkë me mbretin e tyre, Darin III.

Në fund të qershorit Leka bashkë me repartin e tij të zgjedhur e të lëvizshëm ushtarak arriti në Rage, Rei i sotëm, afër Teheranit. Atje e mori vesh se ndjekja do të mbetej pa rezultat, sepse secilin të arratisur që takonin rrugës, ose të ngelur prapa nga ushtria e Darit III, të gjithë i thoshin të njëjtën gjë: se Dari III nuk mund të kapej më. Leka tani nuk dinte nga t'ia mbante. Ashtu, i hutuar e i menduar, humbi 5 ditë të vlefshme në Rage. Para tij gjendeshin malet me grykën e famshme që njihej me emrin "Dera kaspike" dhe përtej shtrihej toka djerrë e stepave, ku në korrik të mbyste vapa. Por, papritur një natë i erdhi lajmi se Bezusi bashkë me tre fisnikë persianë e kishin detyruar Darin III që të dorëzonte titullin e mbretit. Me shpatë në dorë Dari III ishte përpjekur të mbrohej nga tradhëtarët, por i dëshpruar nga pamundësia, ishte tërhequr në çadrën e tij. Atje e zunë rob dhe e dërguan larg mbi një qerre. Me ta dëgjuar këtë lajm, Aleksandri bashkë me disa luftëtarë të zgjedhur u nis nëpër natë me shpresë që ta shpëtonte, po të ishte e mundur, mbretin fatkeq. Tanimë çdo mendim hakmarrës ishte shuar në mendjen e Aleksandrit. Tani armik ishte Bezusi që duhej luftuar. Tërë natën dhe tërë ditën e nesërme Aleksandri udhëtoi mal më mal, pushoi pak në muzg dhe përsëri natën dhe ditën e dytë vazhdoi udhëtimin derisa arriti te vendi ku e kishin zënë rob Darin III. Këtë Leka me bashkëluftëtarët e tij fjatin gjatë ditës së nxehtë dhe në mbrëmje nisi sërish udhëtimin me vrap të pandërprerë dhe në të gëdhirë të ditës së tretë arriti në vendin që një ditë më parë kishte qenë Bezusi. Këtu e mori vesh se edhe persianët ditën pushonin, kurse

natën udhëtonin. E vetmja mundësi që të arrinte Bezusin ishte që të nisej vetëm pas një orë pushimi. Por ushtarët e tij ishin tepër të lodhur, ndaj Aleksandri vendosi të marrë vetëm 500 ushtarë më të fortë dhe vazhdoi ndjekjen e Bezusit nëpër disa shtigje të shkutëra, kurse pjesa tjetër e ushtrisë së tij do të marshonte me ritëm më të ngadaltë. Ishte një ditë e nxehtë sa të zihej fryma. Ritmi i ndjekjes ishte ngadalësuar dukshëm dhe gati po e humbiste çdo shpresë për t'ia arritur qëllimit, kur në agim të ditës së nesërme, jo larg Damghanit, në veriperëndim të Korasanit, afro 80 km në jug të Asterabadit, u ndesh me Bezusin dhe grupin e tij. Aleksandri ishte aq i këputur, sa me zor po qëndronte mbi kalë. Vetëm 60 luftëtarë kishte me vete, që kishin mundur të mbanin hapin e marshimit me të. Ndonëse kishte këtë çetë të vogël rreth tij, të lodhur për vdekje, hipur mbi kuaj, Leka pati guximin të sulmojë. Kjo ishte aventura më e krisur dhe më e guximshme e tij. Persianët, në ballë me Bezusin, ishin në numër pesëdhjetë herë më shumë se luftëtarët e Lekës, të cilët as nuk ishin në gjendje të luftojnë nga udhëtimi i gjatë e rraskapitës. Por, armiku nuk e dinte se sa të lodhur e të paktë në numër ishin Aleksandri dhe luftëtarët e tij. Kur e pa Lekën e Madh ballë për ballë me ushtrinë e tij, Bezusi u mpi nga frika, pothuajse nuk bëri qëndresë. Atij dhe oficerëve persianë që e ruanin Darin III nuk u mbeti gjë tjetër, veçse ta ftonin mbretin e Persisë që të dilte nga qerrja në të cilën ata e kishin mbajtur të burgosur, por ai nuk pranoi që t'i hipte kalit që ishte bërë gati për të. Atëherë rojat e tij, duke mos dashur të rrezikonin jetën e tyre në luftë me Aleksandrin, e therën me thika Darin III dhe ikën. Dari III ra me shpinë në shtrojen e qerres, kurse dy kuajt pa zot u lëshuan menjëherë me trok dhe u ndalën më tej në një luginë të vetmuar. Disa ushtarë të Lekës e gjetën qerren e braktisur me Darin III të mbytur në gjak. Kur njëri prej tyre u përkul sipër Darit III, ai hapi sytë dhe kërkoi ujë. Pastaj pëshpëriti si në jerm emrin e Aleksandrit dhe me fjalë të pakuptueshme u duk sikur e falenderoi për trajtimin plot nderim që i kishte bërë familjes së tij. Ai u përpoq me zor të ngrinte dorën në ndjenjë miqësore, por menjëherë e humbi vetëdijen. Pak çaste më vonë Aleksandri, pa

frymë, i mbuluar në pluhur, arriti pranë Darit III që po jepte shpirt. Tregojnë se i tronditur thellë e puthi në ballë dhe thirri duke qarë: "Të betohem, këtë nuk e kam dashur". Por Dari III kishte vdekur. Gjatë ditës pak nga pak erdhën edhe ata përcjellës të Aleksandrit që kishin ngelur prapa. Më në fund Leka mundi të flinte pak dhe të qetësohej. Por ushtria e madhe arriti vetëm pas disa ditësh, pasi kishte kaluar 800 km nga Ektabana deri këtu. Ndërkohë kufoma e Darit III ishte vendosur në një arkivol të përkohshëm. Leka e dërgoi atë duke kaluar nëpër Ektabana te nëna mbretëreshë në Suza. Ai dha urdhër t'i bëhej një varrim madhështor dhe të varrosej pranë mbretërve të tjerë persianë.

Papritur Aleksandrit i erdhi lajmi se Bezusi donte të hipte në fronin e Persisë me emrin e Artakserksit IV dhe se ai tani gjendej në rrugë e sipër për në provincën persiane Baktrienia, të sunduar më parë prej tij, që shtrihej në veri të Afganistanit. Kështu, Leka i Madh përsëri u detyrua të pohojë se vetëm pasi ta ketë ndjekur Bezusin deri në Baktrieni, do të përmbushte plotësisht detyrën e tij. Ai i tha ushtrisë se nevojitej edhe një marshim në provincën fqinje Hirkanieni, Korasani i sotëm verior, dhe se ishte i domosdoshëm pushtimi i kryeqytetit Zadrakarta në skajin juglindor të detit Kaspik, gati 160 km larg nga Hetakompilosi. Aleksandri e ndau ushtrinë në tri kolona. Kolona e tij zgjodhi rrugën më të vështirë dhe u gjend shpejt e gozhduar në luftime të ashpra. Për kënaqësi të Lekës, një numër i madh fisnikësh persianë u dorëzuan, ndaj ai hyri në Zadrakarta më parë se dy kolonat tjera të ushtrisë së tij.

Ndërsa pjesa më e madhe e ushtrisë qëndroi e qetë dhe pa telashe në Zadrakarta, Aleksandri i shqetësuar u nis përsëri me një repart të vogël drejt lindjes, për të zbuluar në viset e margëve, midis Teheranit të sotëm dhe brigjeve të detit Kaspik. Për këtë udhëtim zbulimi iu desh gjysma e gushtit dhe tërë shtatori. Me mundim ngjiti male dhe zbriti në lugina, ku sulmoi fshatrat e qendrat e fiseve të egra. Shpirti i Lekës ishte i shqetësuar, sa gjithnjë kërkonte raste për veprime të reja. Ai jetonte në një gjendje të tillë tendosjeje të vazhduar, sa për të mosveprimi ishte i padurueshëm. Kur u kthye në Zadrakarta,

atje ishte përhapur fjala se ai, më së fundi, kishte ndërmend të kthehej në Maqedoni. Po mbusheshin plot katër vjet e gjysmë që ata ishin larguar nga atdheu. Kishin marshuar mbi 6000 km dhe qenë lodhur së tepërmi me këtë jetë endacake, ngul e shkul çadra, kërko ushqim e ujë, ngarko plaçka që mezi i bartnin. Shumë nga ushtarët i kishte korrur vdekja, të tjerëve u dhimbnin plagët e pashëruara, shumë vuanin nga sëmundjet dhe vështirësitë në vapë e në ngricë, me tendosjen e vazhdueshme të nervave. Pikërisht për këtë arsye i vinte keq ta zhgënjente përsëri ushtrinë. Aleksandrit nuk i shkonte fare mendja që të kthehej në Maqedoni. U tha ushtarëve se të gjithë ata që kishin mall për shtëpi, të ktheheshin në atdhe. Ai nuk do të mbante asnjë ushtarë me dhunë. Ai vetë do të përpiqej që me ushtarët vullnetarë që do të mbeteshin, t'i bënte maqedonët zotër të botës. "Por, Bezusi, - thirri ai, - me çdo kusht duhet bërë i padëmshëm, përndryshe ky uzurpator do të na e rrëmbejë vendin që ne e kemi pushtuar me kaq e kaq mundime".

Siç e përmend Plutarku, këtu në Zadrakartë Aleksandri kishte me vete pjesën më të zgjedhur të ushtrisë, afro 20 000 këmbësorë dhe 3000 kalorës, sepse në shumë vende kishte lënë garnizone dhe pjesa kryesore e ushtrisë së tij gjendej nën komandën e Parmenionit në Ektabanë. As që mund të mendohej që pjesa kryesore e ushtrisë së tij ta linte në baltë. Sapo Leka përfundoi fjalimin, ushtarët e brohoritën të entusiazmuar dhe u treguan të gatshëm ta ndiqnin kudo që t'i udhëhiqte. Tërë gëzim e krenari për premtimin e besës së re, Leka i Madh përsëri organizoi gara, si dhe bëri flijime falenderimi si atëherë në Dion, në Maqedoni para nisjes, në Tir përpara marshimit drejt Mesopotamisë, si dhe porsi në Suza para depërtimit në Persi.

Për katërmëdhjetë ditë me radhë, në gjysmën e dytë të tetorit, Leka qëndroi në Zadrakarta për të përpunuar me imtësi planet e tij rreth marshimit të mëtejshëm. Tani që e kishte ushtrinë në dorë, më i vetëdijshëm se kurrë mori qëndrimin e zotit më të lartë të Azisë, si dhe të pasardhësit të Darit III. Kështu, i shtoi vetes edhe titullin e vjetër persian "Petriti i luanëve". Tani ai i kishte mbushur 26 vjet, por i pëlqente të

paraqitej si një djalosh i ngjashëm me perënditë dhe as zakonet e traditat maqedone e as ata persiane nuk e bënë që të linte mjekërr sipas modës së kohës, e cila mbahej si shenjë e vlerave burrërore. Tri rrethana e përcaktonin qëndrimin e Aleksandrit të Madh:

1. Ai ishte mbreti-ushtar i iliro-maqedonëve të ashpër, udhëheqësi i shokëve të pandarë, të regjur në beteja, të sprovuar nga moti, të mësuar me mundime, i çiltër dhe mik i përzemërt për të gjithë ata që kishte afër, i tmerrshëm për armiqtë e tij.

2. Përveç kësaj, fati e kishte zgjedhur për të qenë zot i madh dhe i fuqishëm, që duhej të mburrej si bir i Zeus-Amonit me prejardhje hyjnore, zot i Azisë, mbret i Babilonisë, faraon i Egjiptit, i prirur nga çdo magji besimtare, i pagabueshëm, i madhërishëm si një hyjni, aq i tmerrshëm sa dhe i mëshirshëm dhe në këtë rol po i pëlqente vetja gjithnjë e më shumë.

3. Aleksandri ndjente kënaqësinë më të thellë pse ishte komandanti i përgjithshëm i pellazgëve, ilirëve, maqedonëve e helenëve, njeri i arsimuar e i qytetëruar, i zhvilluar shpirtërisht, me prirje artistike, burrë elegant, i hijshëm, fisnik dhe heroik sipas vështrimit të Homerit, zemërgjerë, diplomat e i zgjuar, entuziast për çdo gjë që ia shtonte lavdinë Maqedonisë.

Të tre rolet i luante për mrekulli, vetëm se jeta e tij e shkurtër, e bën të pamundur përcaktimin në njëfarë shkalle të zhvillimit të tij. Edhe nëse tiparet e këtij karakteri të ndarë trish në personalitetin e tij kryqëzohen, gërshetohen me njëri-tjetrin dhe herë pas here shfaqin krenari të errët dhe mani madhështie, përsëri deri në fundin e tij të parakohshëm, ai mbeti një figurë kontradiktore dhe mjaft e komplikuar.

10. Pushtimi i Arianës, i Baktrienisë dhe i Sogdianës
(Tetor 330 p. e. s – prill 327 p. e. s.)

Në tetorin e vitit 330 p. e. s. Aleksandri doli nga Zadrakarta dhe, pasi bëri edhe mbi 900 km rrugë drejt lindjes, në mesin e nëntorit arriti në qytetin Susia, në afërsi të Meshedit të sotëm, jo

larg nga kufiri veriperëndimor i Afganistanit. Këtu i doli përpara princi i quajtur Satibarzanes, nënmbreti i Darit III për provincën e Arianës, që i përgjigjet pak a shumë Afganistanit të sotëm dhe Beluçistanit Verior. Pasi shpalli se donte t'i nënshtrohej Aleksandrit, Leka e lejoi ta mbante provincën dhe e la Anaksipin, njërin nga oficerët e tij me një çetë garde prej 40 kalorësish, ta drejtonte. Por, ende nuk ishte mbushur java prej ksaj ngjarjeje kur ushtria e Lekës ishte në udhëtim e sipër, atij i erdhi lajmi se Satibarzani e kishte vrarë Anaksipin së bashku me gardën dhe kishte marrë anën e Bezusit. Tani ishte rrugës për në Artakoana, drejt kryeqytetit të Arianës, jo larg nga Jerati, në veriperëndim të Afganistanit.

Aleksandri vendosi të shkëputej deri në Artakoana, 120 km në jug. Tërë atë rrugë e bëri për dy ditë. Satibarzani iku, por Leka i pezmatuar për pabesinë dhe krimin që ai kreu kundër ushtarëve të tij, dha urdhër të vriteshin 3000 ndjekës të Satibarzanit, shumë të tjerë i mori robër dhe i shiti si skllevër. Pastaj themeloi një qytet të ri – Aleksandrinë. Para se të vihej në lëvizje me ushtrinë e tij, mori vesh se një tjetër nënmbret persian, Barsaentasi, i cili kishte pasur gisht në vrasjen e Darit III, ishte përqëndruar vetëm 200 km në jug dhe pikërisht në atë krahinë të Arianës, që njihej me emrin Drangiana në jug të Afganistanit, vendosi që edhe këtij t'i japë dënimin e merituar. Me t'u afruar Aleksandri, Barsaenti ua mbathi këmbëve, por i prerë në besë, e zunë rob dhe ia sollën përpara Aleksandrit. Për shkak të tradhtisë ndaj mbretit të Persisë, Darit III, Leka e dënoi me vdekje. Ka të ngjarë që në dhjetorin e vitit 330 p. e. s. Aleksandri të ketë kaluar nëpër Afganistanin Lindor me qëllim që të dilte në Paropamisos ose në Hindukush për të arritur në Baktrieni, që gjendej në veri të këtyre vargmalave dhe në jug të Buharasë së sotme. Gjatë rrugës themeloi dy qytete: i pari sot quhet Kandahar dhe shtrihet në afërsi të Beghramit të sotëm, 40 km në veriperëndim të Kabulit. Në këtë trevë iu desh të ndalonte për mjaft kohë, që nga fundi i janarit e deri në fund të marsit të vitit 329 p. e. s., pasi bora ndër male ishte e lartë. Gjatë kësaj pritjeje Lekës i erdhën përforcime të mëdha, kryesisht trupat që kishte

lënë në Ektabanë nën udhëheqjen e Parmenionit. Kështu, kishte kohë dhe ushtarë për të bërë ekspeditë ndkjeje pas gjurmëve të Satibarzanit, i cili u zbulua dhe u vra.

Qëkur qenë nisur nga Zadrakarta tetorin e kaluar, ushtria e Lekës kishte kaluar në këmbë afro 2500 km dhe ishin ende 1600 km larg nga Baktrienia. Koha kalonte dhe ai bëhej gjithnjë e më i paduruar. Aleksandri u nis shumë heret dhe vetëm në fillim të prillit mundi të kalojë Grykën e Khavakut, ende të mbuluar me borë, afro 4000 m mbi sipërfaqen e detit. Pasi u krye kalimi i vështirë dhe zbritën në luginën e lumit Oksus, të Amusit të sotëm, trupat i priste një vuajtje e re. Bezusi gjatë tërheqjes e kishte shkretëruar e djegur fare vendin, ndaj ishte e pamundur që të gjenin ndonjë ushqim. Bezusi me forca të rëndësishme trupash, duke kaluar mbi Oksus, ishte tërhequr në veri. Leka pasi e pushtoi qytetin e shkretëruar të Baktras ose të Zariaspas, që ishte kryeqyteti i Baktrienisë, Balku i sotëm, u detyrua të ndërtonte trape për të kaluar Oksusin. Në bregun e përtejmë të lumit të provincës së Sogdianës, tani e quajtur Buhara, gjatë muajit maj mori vesh lajmin e gëzuar se Bezusi kishte pësuar të njëjtin fat që i kishte përgatitur Darit III. Njëri nga oficerët e tij të parë, Spitamenes, e kishte bërë rob. Pas negociatash të vështira iu dorëzua Aleksandrit. Ky urdhëroi ta rrihnin me kamxhik gati për vdekje dhe e ktheu në Zariaspa (Baktras). Pas disa muajsh u padit për tradhti ndaj Darit III. Pasi u faktua faji, i prenë hundën dhe veshët, e kështu të gjymtuar e dërguan në Ektabanë, ku vdiq. Pas zënies dhe dënimit të Bezusit, ushtarët e Lekës menduan se tani çdo gjë kishte përfunduar dhe se së shpejti do të fillonte marshimi i kthimit të tyre për në Maqedoni. Por përsëri u zhgënjyen. Aleksandri donte me çdo kusht të arrinte kufijt persianë në lumin Jaksartes, Syr-Darja e sotme në Turkestan, i cili buron nga malet Tienshan të Kinës Perëndimore dhe derdhet në liqenin Aral, në lindje të detit Kaspik. Leka besonte se Jaksartesi dhe liqeni Aral qenë të lidhur me Detin Kaspik dhe se vetë Deti Kaspik ishte pjesë e brezit ujor rreth botës. Kështu, përtej Jaksartesit duhej të gjendej vetëm vendi i hijes. Sipas përfytyrimit të Lekës, në jug të Persepolit, në detin e Gjirit Persik,

kishte arritur fundin e botës dhe gjithashtu në perëndim të Zadrakartës në dheun e murgëve, në brigjet e detit Kaspik, në Jaksartes ai kishte takuar verilindjen. Kufijtë e perandorisë së tij në lindje do të puqeshin me ata të botës. Leka donte t'i arrinte kufijtë e fundit të njerëzve.

Duke u nisur prej Oksusit, pranë Zadrakartës, Aleksandri kaloi afro 500 km afër Marakandas, Samarkanda e sotme, kryeqyteti i Sogdianës, ku arriti në qershor. Prej aty shkoi edhe 200 km kah verilindja, në bregun jugor të Jaksartesit, ku në korrik themeloi një qytet të ri, Aleksandria Ultima (Aleksandria e Fundit), ku gjendet sot Khokandi në Fergana, sot treva perëndimore e provincës kineze të Sing-kiangut. Gjatë luftimeve që u zhvilluan në rrugë drejt lumit Jaksartes, Leka sulmoi edhe kështjellat malore të një fisi, i cili kishte vrarë në pusi disa ushtarë të tij. Në këtë sulm një shigjet e plagosi në këmbën e majtë. Për disa javë rresht Lekën u desh ta bartnin me vig, por para se t'i shërohej plaga, ai i hoqi fashat për t'ua mbushur mendjen ushtarëve se plaga ishte e lehtë.

Përpara se Aleksandri të shërohej plotësisht, në Marakanda plasi kryengritja e udhëhequr nga Spitamenes, i cili kishte zënë vendin e Bezusit, e cila u përhap shpejt në tërë Sogdianën. Garnizoni maqedon në Marakanda u rrethua dhe si në shumë vende të tjera, ata u therën. Lekës iu ndërprenë udhët e ndërlidhjes dhe papritmes u gjend në një situatë tepër të rrezikshme. Kundërgoditja ishte e tmerrshme. Në ballë të një çete të zgjedhur, me gjithë këmbën e tij të lënduar, ai vrapoi me kalë kundër qyteteve që qenë më afër. Brenda dy ditëve pushtoi pesë qytete dhe nuk kurseu asnjërin nga banorët meshkuj, kurse gratë dhe fëmijtë e grumbulluar i shiti si skllevër. Qyteti i gjashtë në fillim bëri qëndresë, deri sa Leka zbuloi një rrugë të fshehtë, mbi shtratin e një lumi të shterur dhe hyri në qytet. Gjatë një përleshjeje të dëshpëruar me banorët, ndër të parët u plagos Krateriosi. Aleksandrin e qëlloi një gur i rëndë në kokë dhe në zverk, sa humbi vetëdijen, madje për një kohë humbi edhe shikimin. Mijëra armiq u vranë dhe të gjitha gratë e fëmijët u zunë robër. Edhe qyteti i shtatë pësoi të njëjtin fat.

Gjatë këtyre luftimeve nuk u harrua garnizoni maqedon i rrethuar në Marakanda. Aleksandri ende i dobët nga humbja e gjakut, u kthye në Jaksartes, por nuk harroi të dërgojë repartin e veçantë në ndihmë atyre në Marakanda.

Ishte fundi i korrikut dhe fillimi i gushtit. Një ndjenjë e papërcaktuar e shtyu të kalonte lumin e Jaksartesit, që t'u dridhej zemra atyre fiseve të çuditshme, që e quanin veten skithë ose tartarë dhe që sipas mendimit të tij jetonin në "kufijtë e botës". Edhe pse ende ishte i lodhur nga plaga e këmbës dhe kokës, ai nuk deshi kurrsesi të heqë dorë nga kalimi i atij lumi. Në bregun përtej ishin grumbulluar skithët dhe i ngacmonin maqedonët me thirrje përbuzëse. Aristanderi, astrologu i Lekës, i quajti këto shenja si ogur i zi, madje ai kishte frikë nga ndonjë rrezik të afërt të Aleksandrit. Kjo profeci, duke marrë parasysh gjendjen e keqe shëndetësore të tij, nuk qe e vështirë të bëhej. Leka ia ktheu me inat se nuk mund të duronte më sharjet e skithëve, ndaj një ditë vendosi ta kalonte lumin. Meqë një natë më parë përpëlitej nga ngacmimi i etshëm e nuk e merrte gjumi, prej tendës vëzhgonte armikun që rrinte rreth zjarreve të fushimit. I çuditur, u detyrua të pranojë se nuk kishte djaj përpara tij, por njerëz që jetonin në zgripin e tokës. "Fundi i botës" gjithnjë zmbrapsej përpara tij dhe ai gjendej edhe shumë më larg nga sa e kishte përfytyruar në fantazinë e tij. Përtej lumit shtriheshin vise të pafund, të cilat ia vlente t'i pushtoje, por ku kishte kohë ai për to!

Të nesërmen në mëngjes u bë kalimi nën mbrojtjen e shigjetarëve. Leka, si gjithmonë, qëndronte në këmbë me mburojën e tij të ngritur mbi kokë dhe udhëhiqte flotën e çuditshme të barkave, të trapeve dhe të thasëve të mbushur me kashtë. Kuajt notonin pranë tij. Sapo zbriti në tokë, menjëherë u ndez përleshja, si gjithmonë kur udhëhiqte Leka. Pasi u korr fitorja, Lekën e rraskapitur nga pandjenja dhe me ethe u detyruan ta bartnin në tendën e tij. Skithët lanë 1000 të vdekur dhe 160 robër, por edhe humbjet e Aleksandrit qenë të rënda, arritën së paku në 160 të vdekur e afro 1000 të plagosur. Nuk zgjati shumë dhe erdhën të dërguarit e mbretit të skithëve, që kërkonin paqen, duke siguruar Lekën se luftimi kundër

maqedonëve ishte zhvilluar kundër vullnetit të tij. Kështu, ranë në ujdi dhe i liruan robërit. Pas pak ditësh Aleksandri tok me ushtrinë e tij u rikthye nëpër lumë në qytetin e themeluar prej tij, Aleksandria Ultima. Në shtator këtu i erdhi lajmi i keq se të gjithë maqedonët që pati dërguar për të çliruar garnizonin e Marakandas, kishin rënë në pusi duke ndjekur Spitamenesin në ikje e sipër dhe ishin vrarë të gjithë. Aleksandri u nis me nxitim tok me kalorësit e tij për në Marakanda, ndërsa Kraterosi e ndiqte pas me pjesën tjetër të ushtrisë më ngadalë. Leka bënte çdo ditë 80-100 km rrugë dhe arriti mjaft shpejt ta shpëtonte garnizonin prej fatit që e pësuan të tjerët. Kur arriti Aleksandri, Spitamenesi ia mbathi me të katra. Leka e ndoqi këmba-këmbës, ndërkaq maqedonët gjetën në mal kufomat e shokëve të vrarë dhe i varrosën me nderime bashkëluftëtarët e masakruar mizorisht.

Në Zariaspa kah fundi i vitit 329 p. e. s., Aleksandrit i erdhën shumë trupa të freskëta nga Maqedonia. Këtu ai priti dy dërgata të dy fiseve skite, të cilët deshën të lidhin krushqi dhe aleancë me Aleksandrin, por ai nuk u pajtua me asnjërën palë, përveç lidhjes së paqës me ta. Nga skitët Leka mësoi rreth shtrirjes së tyre në veri të Detit Kaspik dhe të Detit të Zi, si dhe rreth liqenit Aral. Kështu, atij iu zhduk iluzioni se gjendej pranë "Fundit të botës". Duhej të pranonte se nevojitej një periudhë kohe më e gjatë se sa jeta e një njeriu për të arritur kufijtë e botës. As që kishte më kuptim të humbte kaq kohë të çmuar në këtë vend verilindor të perandorisë së ti, ndaj duhej të zbriste kah jugu dhe kah lindja drejt Indisë për të kërkuar Oqeanin e Jashtëm, sepse në këtë drejtim ia merrte mendja se do të arrinte më parë vendbanimet e fundit të njerëzve. I shqetësuar vëzhgonte horizontin. Ndoshta mendonte përtej asaj kodre ose atij mali papritur mund të shfaqej "Fundi i Botës". Gjithnjë sërish dilnin vende të reja, të panjohura dhe gjithnjë ambicia dhe ëndrra e shtynin drejt mbretërisë së mjegullt. Nga skitët kuptoi se sapo e kishte filluar veprën e tij herkuliane. India duhej të ishte synimi i tij i ardhshëm, por pastaj, çfarë do të vinte më tutje? Ndërsa në Zariaspa i paduruar priste pranverën për të

kaluar grykat e Hindukushit, për të dalë në Indi, papritur në shkurt të vitit 328 p. e. s. i erdhi lajmi se në Sogdianë kishte shpërthyer një kryengritje. Sërish u detyrua të kalojë lumin Oksus. Para marshimit drejt Sogdianës Leka e ndau ushtrinë në pesë kolona, që të mund të spastronte me kujdes tërë trevën. Kolona që udhëhiqte ai kaloi gjatë rrugës perëndimore përbri Oksusit, sepse Aleksandri kishte dëgjuar se Spitamenesi gjendej në perëndim. Pastaj menjëherë mori vesh se persiani ishte arratisur në Margiana të krahinës së Mervit të sotëm. Aleksandri u kthye të ndiqte të arratisurin, por Spitamenesi përsëri ia arriti t'u dredhojë ndjekësve. Në Margiana Leka paraprakisht ndreqi gjashtë fortesa për të mbrojtur rrugën midis Ektabanës, Baktrienisë dhe Sogdianës, rrugën që sot nga Teherani, duke kaluar nëpër Merv, të çon në Samarkand.

Pas disa muajsh, kur Aleksandri u kthye në Marakanda, duhet të ketë qenë verë. Që nga pranvera kur u nis nga Zariaspa, kishte përshkuar 1000 km rrugë. Pikësynim para tij qëndronte gjithmonë India, derisa të vinte koha që të mos e pengonte moti për të kapërcyer Hindukushin, në katër ose pesë muajt e ardhshëm. Ai para së gjithash iu përvesh punës për të vendosur paqen në Sogdianë. Leka emëroi si nënmbret të Baktrienisë dhe të Sogdianës Kleitin e Zi, një nga miqtë më të besuar të tij. Artabazi ishte plakur dhe nuk e përballonte më detyrën. Kleiti ishte vëllai i mendeshës fisnike të Aleksandrit, të Lanikës ose Helanikës, i cili në betejën e Granikos i pati shpëtuar jetën Lekës.

Pak ditë më vonë Aleksandri dha urdhër të ktheheshin në Zariaspa, kryeqytetin e Baktrienisë, prej nga do të kapërcente qafat e Hindukushit para dimrit. Pikërisht ato ditë, kur festonte datëlindjen e tij të njëzetetetë, papritur u mor vesh se Spitamenesi përsëri kishte shpërthyer një kryengritje të re. Sërish Leka humbi tërë atë kohë të çmuar, por përsëri trazirat nuk morën fund, as kur Spitamenesi u vra. Leka u detyrua të kalojë edhe dimrin në këtë trevë të largët dhe ta shtynte fushatën e tij për në Indi deri në pranverë. Por e dinte se vetëm kur të vendoset rregulli e qetësia në Baktrieni, ai do të mund t'u përvishej detyrave të reja.

Në javët e para të vitit 327 p. e. s., kur bora ende e lartë e mbulonte dheun, Aleksandri e shpërnguli vendqëndrimin e tij të përhershëm për në Nautaka, në veri të lumit Ksus, për t'u përleshur me Oksiartin, princin bakterien, i cili ishte kundërshtari i tij i fundit ende i pamposhtur, më armiqësori në këtë trevë. Aleksandri kishte dëgjuar se gruaja dhe bija e Oksiartit qenë strehuar në një kështjellë malore. Ai i dërgoi lajmëtarët e tij deri atje dhe kërkoi të dorëzoheshin me disa kushte, por garnizoni i kështjellës nuk e mori seriozisht kërkesën dhe i dërgoi fjalë Lekës se ai duhet të kishte "ushtarë me fletë" po të donte ta pushtonte këtë kala, muret e së cilës ishin prej shkëmbinjsh. Kjo përgjigje i acaroi maqedonët. Treqind nga ushtarët më të stërvitur dolën vullnetarë për t'u kacavarur sipër shkëmbinjve, pasi Leka u premtoi një shpërblim të mirë. Ata u nisën nëpër terr, të pajisur me kunjat e çadrave prej hekuri dhe me litarë. Tridhjetë prej tyre humbën jetën, por pjesa tjetër u ngjitë deri në majë. Në agim garnizoni u dorëzua pa bërë fare qëndresë, duke kujtuar se Aleksandri me anë të magjive bëri që trimat e tij të ngjiteshin deri lart.

Midis robërve të luftës të zënë në kështjellë, gjendej edhe Roksana, njëra nga persianet më të bukura të asaj kohe, bija e princit kundërshtar, Oksiartit. Edhe pse në të shumtën e rasteve Leka ishte mospërfillës ndaj grave dhe vajzave të zëna rob, kësaj rradhe atë e tërhoqi njëmend bija e hijshme e Oksiartit dhe kur i ati i saj u nënshtrua, u prit me nderime të mëdha në oborrin mbretëror të Aleksandrit. Leka deklaroi se donte të martohej me bijën e tij, por nuk e kishte ndërmend që ta bënte atë mbretëreshë. Ai ishte martuar edhe me Barcinën, pa e ngritur atë në rangun e mbretëreshës. Si babait të tij, Filipit II, ashtu edhe Lekës i pëlqente të kishte shumë gra, por në këtë rast ai shpresonte t'i qetësonte krahinat e vështira të Baktrienisë dhe të Sogdianës. Ishte edhe një kështjellë që i bënte rezistencë Aleksandrit të Madh, të cilën ai donte ta rrethonte, por Oksiarti, vjehrri i tij i ri, ia mbushi mendjen komandantit të saj, të cilin e kishte mik, që t'u nënshtrohej maqedonëve. Aleksandri, të cilit iu kursye një rrethim i gjatë dhe i mundimshëm, duhet të jetë

gëzuar nga martesa me Roksanën dhe që me ndihmën miqësore të Oksiartit, shpejt u vendos qetësia dhe rregulli në këtë vend, ku maqedonasit kishin humbur dy vite të çmuara. Leka me mendje të mbledhur u kthye në Zariaspa, që në prillin e vitit 327 p. e. s. t'i kthehej planit të tij të kahershën për pushtimin e Indisë.

11.Marshimi drejt Indisë
(Prill 327 p. e. s. – janar 325 p. e. s.)

Bora ishte shkrirë në male, kur Aleksandri i ktheu prapa trupat e tij mbi Hindukush. Ai shfrytëzoi grykën e Kaoshanit deri në pellgun e Kabulit në Afganistan. Në atë copë toke deri në Jalalabad kaloi pranverën dhe fillimin e verës. Prapa në Baktrieni kishte lënë 10 000 këmbësorë e 3500 kalorës me gjithë garnizonet e perandorisë së tij kaq të gjerë, që çdo vit bëheshin më të shumta dhe vazhdimisht kërkonin furnizim. Me gjithë humbjet e rënda në të vdekur, të plagosur e të sëmurë, ushtria e tij duhet të ketë qenë ende e madhe, rreth 120 000 ushtarë. Sipas vlerësimit modern, kjo shifër është e lartë. Ndoshta mund të arrinte dyzet deri në gjashtëdhjetë mijë forca.

Në Baktrieni dhe në Sogdianë Aleksandri kishte mobilizuar jo më pak se 30.000 të rinj, të cilët i stërviti ushtarakisht, por që njëkohësisht do t'i mbante edhe si pengje të sigurojë paqen në krahinat e pushtuara. Ata vetëm pjesërisht e ndoqën në marshimin kundër Indisë. Përveç maqedonëve, në trupat e tij bënin pjesë orientalë nga të gjitha anët e perandosrisë, si p.sh., një repart kalorësish skitë që, edhe duke vrapuar në kuaj, qenë shigjetar të rrallë.

Aleksandri i Madh edhepse gjendej në vendet e egra të Afganistanit, nuk ishte i shkëputur nga bota. Kudo ku e ngulte vendqëndrimin përkohësisht, ishte edhe kryeqyteti i perandorisë së tij, prej ku shpërndaheshin në formë rrezesh rrugët lidhëse me të gjitha vendet dhe qytetet e nënshtruara. Në të gjitha këto rrugë kishte një vajtje-ardhje të vazhdueshme ushtarësh dhe civilësh,

nga perëndimi derdhej te ai një rrjedhë e pafund luftëtarësh të rinj. Vetë Leka i Madh në atë kohë rrethohej nga një shoqëri e larmishme maqedonësh, ilirësh, trakësh, persianësh, egjiptianësh, arabësh, fenikasish, grekësh, etj.

Në Afganistan erdhën dhe e takuan shumë princër vendës, midis tyre edhe rajahu i rëndësishëm i Taksilës, të cilin disa e thërrisnin Ambhir, të tjerët e quanin Taksili, sipas emërtimit të mbretërisë së tij. Taksila ishte pjesa e Pandshabit (Panxhabit) që gjendej midis lumenjve Ind dhe Hidaspes, Ibelumi i sotëm, dega më veriore e pesë degëve më të mëdha të Indit. Taksili nxitoi shumë që të binte në ujdi me perandorin maqedon – Lekën e Madh, për të luftuar kundër Porit, rajahut rival të krahinës që ndodhej në bregun lindor të Hidaspesit. Aleksandri u gëzua shumë me marrëveshjen me Taksilin, e cila u forcua edhe më shumë nga këmbimi i dhuratave. Taksili (Ambhiri apo Omfisi) i dërgoi aleatit të ri 25 elefantë lufte dhe, pasi i la kalim të lirë nëpër krahinën e Taksilës. Leka marshoi me ushtrinë e tij në mes të verës së vitit 327 p. e. s., në drejtim të Indit. Në pellgun e Jalalabadit e ndau ushtrinë e tij në dy pjesë: njërën e vuri nën komandën e Hefestionit që duhej të kalonte nëpër qafën e Kiberit, ndërsa vetë zgjodhi udhën veriore në drejtim të krahinës së sotme të Zvatit. Gati çdo milje e kësaj rruge veriore nga Taksila e tutje duhej mbrojtur, sepse fiset e egra e bënë veshin e shurdhër ndaj kështillave të Taksilit. Kështu Aleksandri u gjend i gozhduar për 5-6 muaj në luftime të ashpra me këti fise. Pikërisht në këtë kohë ai kremtoi 29-vjetorin e datëlindjes së tij. Duheshin rrethuar e pushtuar kështjellat malore njëra pas tjetrës. Me mijëra vendës u vranë në këto luftime të rrepta. Tani Aleksandri nuk ishte më luftëtari hyjnor i paarritshëm dhe i lartësuar. Tash ai ishte sërish mbreti ushtar që luftonte krah për krah ushtarëve të tij, që futej në lëmshin më të ndërlikuar të betejës dhe ua kalonte të gjithëve për trimëri. Më se një herë u plagos. Gjatë njërës prej këtyre përleshjeve një shigjetë ia përshkoi parzmoren prej çeliku dhe iu ngul në shpatull. Edhe Ptolemeu që mbahej si gjysmëvëllai i tij dhe që ishte njëri nga gjeneralët më të zot, edhe ai mori një plagë. Disa herë ndodhi që

Aleksandri, Ptolemeu dhe gjeneralë të tjerë të ndesheshin në dyluftim me krerë vendës dhe t'i vrasin kundërshtarët e tyre.

Shumë priftërinj të fiseve malore ishin arrestuar, sepse përpiqeshin të ngritnin popullin në kryengritje. Një herë një garnizon kështjelle u dorëzua pa luftë. Atyre Leka ua fali jetën, sepse premtuan se do të futeshin në ushtrinë maqedone. Natën, njëri pas tjetrit u zhdukën të gjithë, sepse nuk donin të luftonin kundër bashkëatdhetarëve të tyre. Aleksandri menjëherë urdhëroi që t'i rrethonin e t'i vrisnin pa pikë mëshire. Plutarku këtë veprim e cilësoi: "Si të vetmen thyerje të besës nga ana e Aleksandrit gjatë fushatave të tij". Edhe historiani Arriani thekson se Leka e mbante fjalën e dhënë, premtimin – besën.

Njëra nga kështjellat që pushtoi Aleksandri, e quajtur Aornos, Pir-Sari i sotëm, thoshin që u kishte bërë ballë me sukses sulmeve të Krishnës, të një hyjnie që pellazgët dhe grekët e barazonin me Heraklitin (Herkulin), prandaj Aleksandri u gëzua shumë, kur pas kapërcimit të një gremine të rrezikshme shkëmbore, hyri në atë kështjellë në krye të ushtrisë maqedone. Duke u mburrur, ai shpalli se ia kishte kalusr edhe Heraklitit dhe njëkohësisht në rrënojat e kështjellës organizoi shërbesa fetare dhe falenderoi perënditë që ia kishin lejuar t'i bënte hije stërgjyshit të tij të madh – Heraklitit (Herkulit).

Kah mesi i dimrit të viteve 327-326 p.e.s., pas përpjekjesh të përgjakura në Kitralin e sotëm, si dhe në kufirin e Kashmirit, arriti në një vend afër Indit, 25 km më sipër Atokut, në mesin e rrugës midis Ravalpindit dhe Peshavës. Këtu Leka i Madh u takua me gjysmën tjetër të ushtrisë së tij, e cila nën udhëheqjen e Hefestionit kishte ndërtuar një urë sipër lumit. Përpara se të merrte rrugën për në Taksila, Aleksandri bashkë me një repart të vogël u përpoq të zinte kopenë e elefantëve, që banorët e arratisur i kishin lënë pas në toka të pashkelura. U ndesh me një qytet misterioz të quajtur Nisa, që Hefestionit nuk i kishte rënë në sy, megjithëse pati kaluar andej. Sundimtari plak i këtij qyteti, Akufisi, u nis për te Aleksandri me disa nga këshilltarët e tij që t'i lutet të mos i dëmtonte. E përcollën për te tenda e Lekës, i cili po rrinte vetëm me veshjet e metalit në trup dhe përkrenaren në

kokë të pluhurosura dhe me një heshtë të përgjakur në dorë. Akufisi dhe shokët e tij ranë përdhe dhe qëndruan një copë herë të shtangur para tij, me fytyrën përtokë. Duket se Leka i Madh u kujtua që ky nënshtrim i tepruar, bashkatdhetarët e tij më shumë do t'i shqetësonte, se që do t'i përkëdhelte, ndaj i bëri të ngriheshin në këmbë dhe urdhëroi një shërbëtor t'i sillnin karrige Aufisit. Burri i vjetër, i mahnitur prej një mirësie kaq të madhe, e lavdëroi thjeshtësinë luftarake dhe mirësjelljen tamam mbretërore të pushtuesit të madh dhe e pyeti se çfarë duhej të bënte që të ishte i denjë për miqësinë e tij. Aleksandri dashamirës e lejoi të vazhdonte të sundonte qytetin e tij po në atë mënyrë paqësore, vetëm i kërkoi që t'i dërgonte njëqind nga njerëzit e tij më të mirë të shërbenin në ushtrinë maqedone. Aufisi me zor po e mbante gazin dhe, kur e pyeti Aleksandri se çfarë kishte, ai iu përgjigj: "Si mund të vazhdoj unë të sundoj një qytet, të cilit i ke hequr njëqind njerëzit më të mirë? A nuk do të ishte më e arsyeshme sikur unë t'ju dorëzoja njëqint më të këqijtë?". Kjo anekdotë e tregon Aleksandrin jo më si despot oriental të frikshëm, por si një ushtar të thjeshtë, të regjur në luftë, që e pret një burrë të moçëm me mirësjellje, madje bën edhe shaka. Duket se Aufisi i rrëfeu mbretit për të kaluarën e qytetit. Të tëra ato që dëgjoi Aleksandri rreth kësaj historie ishin sajuar si me porosi, që të formonte bindjen se vet Dionisi e kishte themeluar Nisën, sepse kjo ishte pika më e largët që Dionisi shkeli, kur u ra qark vendeve të botës.

Aleksandri gjithnjë e kishte rrezikuar jetën e tij ndër beteja dhe në rrethime kalash, shumë herë edhe u plagos. Disa herë ushtarët e tij qenë gati të rebeloheshin haptas, madje ishin përpjekur ta hiqnin qafe edhe me vrasje. Por, Leka rishtas kishte në mendje një plan të guximshëm: pushtimin e Indisë, të një vendi për forcën ushtarake të të cilit çdo ditë merrte lajme kërcënuese. Në pranverën e vitit 326 p. e. s. Aleksandri kapërceu Indin dhe pas një shërbese të madhe falenderimi hyjnisë, hyri në kryeqytetin mik të Taksilës. Këtu ndejti si mik i Taksilit (Omfisit) për disa javë, por tani nuk ishte më edhe aq i stuhishëm, siç kishte qenë para pak vitesh. Më së fundi në maj ushtria ishte gati

të marshonte përpara. Përsëri u zhvilluan lojërat e zakonshme, garat dhe kurbanet e falenderimit, që i organizonte gjithnjë para ndonjë ndërmarrjeje të re ushtarake të rëndësishme. Pastaj u nis drejt lindjes, duke kaluar nëpër Pandshabin veriperëndimor, gjithnjë i përcjellë prej rajahut Omfis deri te lumi Hidaspes. Prej andej Leka i dërgoi lajmëtarë Porit, që ta ftonte për t'u dorëzuar pa luftë. Pori e hodhi poshtë këtë kërkesë. Sipas historianit Arriani, Pori ndihej mjaft i fortë për t'i bërë ballë me sukses me 25. 000 këmbësorë, 4000 kalorës, disa qindra qerre lufte dhe mbi 300 elefantë. Kjo ishte ushtria më e madhe luftarake që i doli përballë, pushtuesit të guximshëm – Lekës së Madh, që nga beteja e Gaugamelës.

Është e çuditshme se Aleksandri shpesh i niste marshimet e tij në kohën më të papërshtashme të vitit. Koha e shirave donte edhe pak që të vinte, kur atij i shkrepi që të kalojë Hindaspesin. Leka as që pyeste për motin, madje besoi se pikërisht kjo stinë, kur stuhitë ndiqnin njëra-tjetrën dhe kur shiu binte rrëke ishte më e përshtatshmja për të. Sidoqoftë, ai nuk bëri asnjë përpjekje ta kalonte lumin para mesit të qershorit. Fill me të arritur stina e shirave, ai i kaloi më tepër ditët e bukura të fundit në bregun perëndimor, por nuk e linte Porin të qetë, duke i çuar lajme të rreme. Ushtria maqedone vazhdimisht i binte lumit lart e poshtë, sikur kërkonin vend për të kaluar matanë. Pori i vëzhgonte me kujdes të gjitha lëvizjet e saj. Në çdo çast ai ishte i gatshëm t'i vërsulej ushtrisë maqedone, i mbështetur nga elefantët e tij. Këta gjigandë të vjetër të xhunglës, - mendonte ai, - do t'i trembnin kuajt e pushtuesve sapo t'i shihnin. Vështirësia që kishte ushtria e Lekës për të kaluar lumin, duke pasur përballë një qëndresë kaq të fortë, ishte aq e madhe, ndaj e detyroi atë të hartojë një plan sa të rrezikshëm, aq edhe të guximshëm. Aleksandri vendosi t'i tërheq vëmendjen Porit. Pjesën kryesore të ushtrisë nën komandën e Kraterosit e la në bregun perëndimor të Hidaspesit, kurse vet me një repart të vogël u mundua ta kalonte lumin në errësirën e natës, disa milje më tutje, dhe t'i binte në befasi nga krahu. Kraterosi kishte për detyrë të bënte sikur po ndërmerrte sulm të rremë, sikur do t'i fuste ushtarët në varka

dhe në trape, kurse një oficer do ta vishte me teshat e Lekës. Kështu, Pori do të mendonte se Aleksandri po kalonte përfundimisht në ofensivë. Mjetet e nevojshme të lundrimit për sulmin e guximshëm u përgatitën në një zonë pyjore, disa milje sipër. Kur të gjitha ishin gati, Aleksandri nëpër shiun që binte rrëke u nis në terrin e natës me 14 000 ushtarë dhe 5000 kalorës. Që para mëngjesit u mblodhën te vendi i grumbullimit. Kur po barteshin me varka, plasi një tufan i madh, disa ushtarë të qëlluar nga rrufeja ranë të vdekur përdhe. Pa ndonjë ngatërresë dhe pa rënë në sy, duke kaluar mbi lumin e rrahur nga stuhia dhe shiu, varkat e trapet e ngarkuara me njerëz dhe me kafshë dolën në bregun tjetër. Por, Leka, duke mos pasur asnjë mundësi të saktë orientimi, pa se nuk kishte zbarkuar në bregun e përtejmë të lumit, por në një ishull. I habitur, zbuloi se ishte edhe një degë e hollë lumi që duhej kaluar. Për fat zbuluan një cektinë që e bëri të mundur transportimin matanë, megjithëse kuajt dhe kalorësit përpak sa nuk i përpinë valët. Në ndërkohë shiu kishte pushuar dhe ishte zbardhur, kështu që nuk kishte asnjë shpresë të zihej armiku në befasi. Zbuluesit armiq njohtuan Porin se po afrohej ushtria maqedone. Nga të katër anët u dha kushtrimi dhe Aleksandri tani gjendej në tokë armike. Nga ana numerike indët kishin shumë më tepër ushtarë. Ushtria e stërlodhur e Lekës ishte e lagur gjer në palcë, e tmerruar nga tufani i frikshëm i natës, ishte ende e paralizuar. Pos kësaj, Porit i erdhi në ndihmë nga veriu rajahu i Kashmirit, gjë që Leka e mori vesh rastësisht kur u ndesh me të. Vendimi i nxituar i Aleksandrit e kishte shtuar shumë rrezikun, por edhe këtë herë, si edhe më parë, fati i qëndroi atij përkrah. Djali i Porit i doli përpara rajahut të Kashmirit me 2000 kalorës dhe me 120 qerre lufte. Kur u dha kushtrimi, ai dhe njerëzit e tij në kuaj vrapuan te vendi që kishte zbarkuar Aleksandri, por vonë u kujtuan se pushtuesi kishte epërsi tepër të madhe kundrejt tij. U përpoq të shkëputej, por shpejt u mund dhe u vra së bashku me 400 luftëtarë të tij. Shumica e qerreve ranë në duar të Lekës. Sapo Pori e mori vesh këtë gjë, u vu në lëvizje me një numër të madh elefantësh dhe me një të tretën e këmbësorisë, që me çdo kusht t'ia pengonte

Kraterosit kalimin e lumit. Sapo u dukën kalorësit e Aleksandrit dhe këmbësoria që po i ndiqte pas pak më prapa, Pori i ndaloi trupat dhe para frontit vendosi elefantët në një largësi 30 metrash njëri nga tjetri. Prapa tyre radhiti këmbësorinë, kurse në krahët e kafshëve rreshtoi kalorësit dhe qerret.

Aleksandri i Madh urdhëroi që kalorësia e tij të priste këmbësorët që e ndiqnin. Pas një pushimi ai e vendosi këmbësorinë para kalorësisë, pra, përballë elefantëve, në formacione të shkëputura. Kalorësit i ndau në dy grupe: krahun e majtë e vuri nën komandën e Koinosit, ndërsa vet mori përsipër krahun e djathë, ku bënin pjesë edhe 1000 shigjetarë skitë. Kur të sulmonin indianët, ai duhet të përpiqej t'i dilte nga prapa frontit të tij për t'iu shmangur në këtë mënyrë trembjes së kuajve nga elefantët. Leka dërgoi shigjetarë skitë me kuajt e tyre të shpejtë kundër vijës së parë me urdhër që ta bënin të lëkundet me çdo kusht krahu i majtë indian nga breshëria e shigjetave. Edhe Pori e ndau kalorësinë e tij në grupe të veçanta, të cilat duhet të ndalonin sulmin e Koinosit dhe të Lekës. Filloi beteja. Sulmet e maqedonëve patën sukses vetëm kur garda e pandalshme mori hov dhe kur Aleksandri, si zakonisht, depërtoi thellë në radhët e armikut. Sakaq indianët u zmbrampsën në afërsi të elefantëve, radhën madhështore të të cilëve e udhëhiqte vetë Pori. Tani beteja nuk ishte e qartë. Leka i Madh me gardën e tij ushtarake nuk patën mundësi t'i afrohen Porit, kështu që nuk u arrit përleshja e fundit. Nuk u mbeti tjetër, vetëm ta çanin rrugën me shpatë në të gjitha drejtimet përballë radhëve të ngjeshura indiane. Këmbësoria ia doli mbanë më mirë me elefantët. Shumë ushtarë armiq qenë vrarë në kullat e larta të luftimit, sipër kurrizit të elefantëve dhe shumë nga kafshët ose qenë plagosur, ose kishin ngordhur. Sa vinte dhe beteja po thjeshtësohej. Armiku u rrethua nga të katër anët prej maqedonëve. Ndërkaq, edhe pjesa kryesore e ushtrisën nën komandën e Krateriosit kishte kaluar lumin dhe i vuri në ikje ushtarët indianë. Shumica u vranë në vend. Gjatë betejës Leka kishte luftuar mbi kalin e tij, Bukefali, i cili pas tetë orë luftimi ishte stërlodhur dhe ra përdhe i ngordhur.

Mbreti i indianëve, Pori, megjithëse i plagosur, qëndronte në ballë të kalorësve të vet. Elefanti i tij ishte i fundit që u kthye për të ikur. Aleksandri e admiroi shumë kundërshtarin e tij mbretëror për guximin, për këmbënguljen, por edhe për aftësinë strategjike që kishte treguar gjatë betejës, prandaj dërgoi rajahun e Taksilës t'i shkonte pas dhe ta ftonte t'i dorëzohej fituesit, – Lekës. Kur Pori e njohu armikun e tij të vjetër, Taksilin (Omfisin), rrëmbeu heshtën e fundit që i kishte ngelur, me qëllim që ta godiste, por rajahu i bëri dredhë shigjetës. Më vonë, i mahnitur, Leka e dëgjoi tregimin rreth qëndrimit të paepur të indianit. Ai dërgoi edhe princa të tjerë vendas që ta bindnin Porin se ikja e tij ishte e pamundur. Së fundi, luftëtari trim, gjysmë i vdekur nga etja, i dobësuar nga derdhja e gjakut, i humbi ndjenjat. Elefanti i tij ndaloi dhe kalorësi u rrëzua përdhe. Aleksandri vrapoi atje në kalë dhe e pyeti Porin me anë të një përkëhyesi, se çfarë trajtimi priste t'i bënin. "Unë pres që të më trajtojnë si mbret", - ia ktheu Pori. Leka me një hov zemërgjerësie kalorsiake u përgjegj: "Sa për pjesën time, unë ty do të të trajtoj si mbret, por më thuaj troç, çfarë kupton ti me këtë?". Pori ia priti se përgjigja ishte te fjalët e mësipërme. Merita dhe trimëria e armikut truphedhur tërhoqën admirimin e Aleksandrit. Ai e siguroi për miqësinë e tij, ia ktheu mbretërinë dhe për zemërimin e madh të maqedonëve, dha urdhër që të respektohej prona e Porit dhe të mos plaçkitej.

Fushata drejt lindjes përparonte ngadalë, duke kaluar nëpër Pandshabin e ngopur me shi, në veri të të cilit gjendej Kashmiri dhe në jug Rajputana. Tridhjetë e shtatë qytete, shumë rrethe dhe fshatra iu dorëzuan ushtrisë së Lekës pa qëndresë. Shumica kaluan nën zotërimin e Porit, aleatit të ri të Aleksandrit. Me dëshirën e tij të posaçme i detyroi Porin dhe Omfisin (Taksilin) t'u jepnin fund mosmarrëveshjeve të tyre. Omfisin e dërgoi në Taksila, kurse Pori qëndroi të grumbullonte mbeturinat e ushtrisë së tij për t'i vënë në shërbim të Lekës. Ndërsa Hefestioni ishte ngarkuar që me një pjesë të ushtrisë maqedonase të luftonte kundër kundër një rajahu tjetër, kushëririt të Porit, ndërsa vetë Leka kapërceu dy degë të lumit Ind, Akesinos dhe Hiarotes, që sot quhen Kenab dhe Ravi, dhe

arriti në Sengala, që mendohet se është Lahore e sotme. Ky qytet rezistoi, ndaj duhej të merrej me sulm. Luftimet ishin aq të ashpra, sa që Leka la 1000 të vdekur dhe 1200 të plagosur Ai urdhëroi të masakrohen mijëra indianë, kurse mori robër 10 000 të tjerë. Kaloi mbi lumin Hifazis, degë e Indit, i cili buronte nga Himalajet në këndin më lindor të Pandshabit, afër kufirit tibetian. Ai i ra kryq e tërthor Indisë së Veriut pothuajse në tërë shtrirjen e saj. Tani gjendej në lindje të Amritsarit, në veri shtrihej Kashmiri, mbi 160 km në lindje ishte Simla dhe 100 km në lindje Delhi. Para tij vezullonin majat e Himalajeve. Përsëri iu mbush mendja se gjendej afër kufijve të botës. Por atje dëgjoi për një perandori tjetër të madhe në juglindje, mbi të cilën sundonte rajahu Ksandrames, të cilit i bindeshin 250 000 njerëz. Thuhej se ai nuk ishte popullor, prandaj mund të përmbysej shpejt.

Aleksandri duhej të ketë pasur zhgënjim të thellë kur dëgjoi se midis tij dhe kufirit lindor të tokës gjendej perandoria gjigante. I kishin treguar edhe për dy lemenj që buronin nga Himalajet. Njëri ishte Sutlej, 3-4 ditë marshimi larg, kurse lumi tjetër ishte Gangu, që përshkonte viset e perandorisë së Ksandramesit dhe që ishte larg 7 ditë udhëtim. Sipas mendimit të Lekës, këta lumenj formonin kufirin lindor të botës së banuar në Jug, pra deri në brigjet e tyre do të shtrihej parandoria maqedone, deri atje ku njeriu do të mund të shikonte oqeanin e largët, që e rrethonte tokën si një unazë. Ndoshta edhe nuk ishte shumë larg nga synimi i ëndrrave të tij. Duke fluturuar nga gëzimi i kësaj shprese të re, u përgatit që menjëherë të kalonte mbi Hifazia.

Trupat ushtarake të Aleksandrit po ankoheshin gjithnjë e më me zë të lartë, të paduruara dhe të pakënaqura. Reshjet e forta të shirave ishin të padurueshme. Diodori shkruan: "70 ditë me radhë rridhte uji si një përmbytje mbi kurrizin e maqedonëve dhe shkrepëtimat shkarkoheshin rreth e rrotull tyre, kurse ata gjithnjë vazhdonin të marshonin drejt të panjohurës". Ambicia e Lekës u dukej atyre e pangopur. Ai tani kërkonte prej ushtarëve të tij që t'i matnin forcat me ushtrinë gjigante të Ksandramesit, para të cilit Pori kishte qenë vetëm një mbret xhuxh. Ushtarët

maqedonë qenë të rraskapitur dhe të ngopur me luftë deri në grykë, prandaj dëshironin të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Megjithatë, Leka kishte thënë: "Le të murmurisin sa të duan, mjafton që mua të më binden!".

Në breg të Hifazisit maqedonët u mblodhën me njëri-tjetrin dhe filluan të ankoheshin. Aleksandri u detyrua t'i thërrasë eprorët e t'ju mbajë një fjalim. Ai u kujtoi atyre pushtimet fitimtare të deritashme dhe u numëroi me radhë vendet që ata kishin mundur, që nga Helesponti (Dardanelet) deri në Siri, prej Sirie në Egjipt, nga Persia në Sogdianë dhe prej Sogdianës në Indi. Sipas historianit Arriani, Leka i Madh u tha eprorëve të tij:

"Se mos trembeni, - i pyeti ai, - dhe tërhiqeni, që vendet nga Hifazisi dhe tutje lumit mos të përfshihen në atdheun tuaj maqedon? Unë mendoj, - vazhdoi ai, - se për një burrë trim vuajtjet mbarojnë vetëm kur u ka ardhur fundi, kur përfundimi del fitimtar. Por, në qoftë se ndonjëri nga ju kërkon të dijë se kur do të mbarojë kjo luftë, ja po jua them se vetëm një copë e shkurtër rruge na ndan nga Gangu dhe deti lindor. Deti Kaspik ka lidhje me këtë oqean, sepse oqeani i madh i jashtëm qëndron tamam si një brez rreth tokës. Unë do të jua dëshmoj se Oqeani Indian komunikon me Detin Persik, si dhe me Detin Kaspik. Duke u nisur nga Deti Persik, trupat tona do të lundrojnë rreth Afrikës derisa të arrijnë te Shtyllat e Herkulit (Gryka e Gjibraltarit). Atëherë e gjithë Afrika dhe Azia do të jenë tonat dhe kufijtë e perandorisë sonë, si në lindje ashtu edhe në jug, do të përputhen me kufijtë që perënditë i kanë caktuar botës! Por, - vazhdoi ai, - nëse do të kthehemi prapa, përpara se t'i kemi arritur këta kufij, të gjitha lodhjet dhe mundimet do të na ikin kot ose do të na duhet që t'i vuajmë rishtas edhe një herë nga e para. A nuk i keni marrë ju kështjellat e Aornosit, kundër të cilave vetë Herakliti (Herkuli) ishte përpjekur më kot? Dhe, në Nisa a nuk keni shkuar ju edhe më në lindje se sa vetë Dionisi? O maqedonë, mbahuni të fortë! - thirri ai. - Të lavdishme janë veprat e atij që vë jetën në rrezik duke luftuar. Është mrekulli të çosh jetë trime për të kaluar në përjetësi. Të gjitha lodhjet dhe rreziqet unë po i duroj njëlloj së bashku me ju. Të gjitha frytet e

fitores janë të arritshme për të gjithë. Toka ju përket juve, ju jeni nënmbretërit e saj!".

Historianët e kohës së vjetër janë të gjithë të një mendimi se Aleksandri kishte një aftësi të jashtëzakonshme për t'i entuziazmuar njerëzit dhe për t'i bërë për vete. Këtë herë, pas fjalimit të tij, pati një heshtje vdekjeje. Përse, pyeste veten, kur shikonte shikimet e ulura përtokë të bashkëluftëtarëve të tij, përse asnjëri nuk përgjigjej? Kur i pa më afër, vërejti lotët që u rridhnin poshtë mollëzave të oficerëve më besnikë. Leka donte ta dinte çfarë i mundonte ata. Më në fund i doli përpara njëri nga gjeneralët më të mirë, Koinosi, i cili ishte dalluar posaçërisht në betejën kundër Porit.

"Po marr guximin të flas, - filloi ai, - sepse mbreti gjithnjë e ka shpallur se nuk do të sundojë me dhunë, por përkundrazi kërkon ta bind ushtrinë për saktësinë e planeve të tij". Pastaj Koinosi vazhdoi t'i thotë se ai, siç e dinte mbreti (Aleksandri) asnjëherë nuk i qe trembur rrezikut. Por, kësaj radhe do ta thoshte troç: "Duhej t'i jepej fund kësaj lufte, ushtria kishte vetëm një dëshirë, të kthehej në Maqedoni! Ti vetë e di, - iu kthye Lekës, - se sa shumë maqedonë janë nisur bashkë me ne dhe sa pak kemi ngelur! Shumë prej tyre janë vendosur si kolonë në qytetet e themeluara rishtas, jo të gjithë me dëshirën e tyre, të tjerë kanë vdekur, disa të tjerë janë kthyer në atdhe invalidë, kurse një numër i madh prej tyre janë shpërndarë nëpër garnizonet e kështjellave të tërë Azisë. Edhe sikur t'i grumbullonim të gjithë këta së bashku, nuk e arrijmë numrin e atyre që vdiqën nga sëmundjet dhe epidemitë. Ata të pakët që ende janë këtu dhe që u kanë bërë ballë të gjitha rreziqeve dhe mundimeve, janë tërësisht të këputur fizikisht dhe shpitërisht!".

"Kthehu Aleksandër! – thirri Koinosi, - kthehu në mëmëdheun tënd, kthehu te nëna jote dhe çoje lajmin e fitoreve të mëdha dhe të panumërta në vebdin e baballarëve. Pastaj, po të mundesh, nisu për një fushatë të re. Të tjerë maqedonë do të të ndjekin pas. Ushtarë të rinj do t'i zëvendësojnë të vjetrit, luftëtarët e lodhur do të zëvendësohen me luftëtarë të çlodhur, të vrullshëm e të guximshëm. Ata do të të vijnë pas më me qejf kur

të kenë vërtetuar me sytë e tyre se si burrat që kanë përcjellë në fushatat e deritanishme dhe që kanë ndarë bashkë me ty të gjitha rreziqet, u kthyen te njerëzit e tyre të shpërblyer më së miri. Vetëvendosja në kulmin e suksesit është më fisnikja e të gjitha vyrtyteve!".

Fjalimi i Koinosit u përcoll me duartrokitje nga më të zjarrtat. Shumë oficerë i shtrinë duart drejt tij me lutje, por Aleksandri u bë si i shurdhër dhe me një gjest pakënaqësie i liroi të mbledhurit. Zemërimi i tij shkoi duke u shtuar deri të nesërmen në mëngjes, kur ai i thirri përsëri eprorët para tij me urdhër dhe tërë inatin e shkrepi kundër tyre: "Të gjithë ata që shfaqën dëshirën, - thirri ai, - mund të kthehen në shtëpi! Por mos harroni t'i tregoni gjakut tuaj se ju e keni braktisur mbretin tuaj, kur ai qe i rrethuar nga armiqtë!".

Pastaj i liroi dhe u kthye në çadrën e tij, ku në një pështjellim hidhërimi dhe zhgënjimi, u shtri në tokë. Në qoftë se luftëtarët e tij nuk donin të qëndronin më me të, deri sa ai të arrinte fundin e botës, mendonte i revoltuar, atëherë s'ia dinte fare për falenderim, për atë që ata kishin bërë deri më sot. Atij as që i shkonte nëpër mend të kthehej tani në Maqedoni, kthim që do të ishte njësoj si të pranonte disfatën. Atë ditë dhe të nesërmen nuk doli fare nga tenda dhe nuk pranoi asnjë lloj bisede me miqtë e tij. Në tërë vendqëndrimin, si pasojë e kësaj, mbretëronte heshtje ndrydhëse. Heshtja e tij e mbyllur e shtonte edhe më shumë zemërimin e ushtarëve, vendimi i prerë i të cilëve, që në asnjë mënyrë mos të shkonin më tutje, vinte duke u forcuar nga ditë në ditë. Ditën e tretë pas fjalimit, Aleksandri thirri astrologët e tij, për t'i pyetur se ç'tregonin shenjat për kapërcimin e lumit. Për t'i shpëtuar fytyrën mbretit, ata shpallën se oguret nuk ishin të mira dhe se synimi i tij nuk u përgjigjej dëshirave të hyjnive. Aleksandri iu bind këtij gjykimi, i mblodhi miqtë, eprorët dhe u tha ta njohtonin ushtrinë me vendimin për t'u kthyer. Vendimi i mbretit u ndoq nga skena gëzimi të papërshkruar dhe brohoritje të pafund. Ushtarët thërrisnin, qanin dhe ngazëlleheshin para mbretit. Grupe-grupe vraponin për te çadra e Lekës për ta falenderuar. Fytyra e tij, përkundrazi,

shprehte mëri. Ai në asnjë mënyrë nuk kishte ndërmend ta ndërpriste fushatën. Ai donte të kthehej deri në Hidaspes, por kurrë në shtëpi. Që andej ai mendonte t'i binte përgjatë Indit dhe, duke kaluar nëpër Indinë Perëndimore, të dilte në det. Ai ende nuk e dinte se ku derdhej Indi në Oqeanin Indian, nëse bënte ndonjë kthesë nga perëndimi apo rridhte nëpër Persinë Jugore Megjithatë, Aleksandri kishte qëllim të shkonte nga perëndimi për të dalë në bregun persik dhe në Sizianë, pastaj të bënte ekspeditën dy-trivjeçare rreth e qark Afrikës dhe, gjatë rrugës nga India drejt Europës Perëndimore të arrinte kufijtë jugorë të botës. Në Lindje s'ia kishte arritur këtij qëllimi, ndoshta në jug do të kishte më shumë fat. Vetëm pasi t'i binte kryq e tërthor në udhëtim e sipër dhe të arrinte në pikën më të largët veriore, mund të kthehej në Maqedoni. Atdheu dhe nëna e tij Olimpi, duhet të pritnin edhe shumë vjet për ta parë përsëri.

Para se të nisej, Aleksandri në breg të lumit ngriti dymëdhjetë altarë të mëdhenj, që ua kushtonte 12 perëndive të Olimpit. Bëri shërbesa fetare dhe një paradë të madhe trupash. U bënë gara e vrapime me kuaj dhe shtroi një gosti të majme. Tashti tërë brenga i qe zhdukur dhe planet për fushatën gjatë Indit merrnin gjithnjë trajtë më të qartë, tamam në atë kohë kur 30-vjetori i datëlindjes po i trokiste në derë.

Kremtimet e zgjatura dhe marshimi pastaj drejt Hidaspesit duhet të ketë zgjatur së paku një muaj. Ka të ngjarë të ishte fundi i shtatorit të vitit 326 p. e. s., kur maqedonaët iu afruan përsëri sheshit të luftës. Tash shtrëngatat kishin kaluar dhe Leka mund të jepte urdhër që të ndreqeshin dëmet e pësuara në qytetet e themeluara rishtas, Nikaia dhe Bukefala. Në qershor ai kishte urdhëruar të ndërtohej një flotë detare dhe tani në tetor e në nëntor kjo vepër e rëndësishme kishte përfunduar me sukses. Aleksandri mori në dorëzim 800-1000 anije. Diodori tregon se pikërisht në këtë kohë arritën përforcime të mëdha trupash nga perëndimi. Planet e Lekës kuptoheshin lehtë, me 8000 ushtarë më të zgjedhur kalorës, të ngarkuar në anije dhe trape, do t'i binte lumit teposhtë. Si admiral të kësaj flote ai kishte emëruar shokun e tij të fëmijërisë, Nearkun. Kurse detyra e Kraterosit

ishte që me një pjesë të madhe të ushtrisë të zbriste përgjatë bregut të djathtë të lumit Gjatë bregut perëndimor, ndërsa Hefestioni me pjesën kryesore të ushtrisë, ku bënin pjesë edhe 200 elefantë, do të zbiste gjatë bregut lindor. Sapo Leka shkeli mbi anije, derdhi kupën e artë sipër valëve dhe disa herë me radhë kërkoi ndihmën e perëndive. Pastaj kumbuan boritë dhe nën diellin që shkëlqente, ditën e fundit të nëntorit mjete të panumërta lundrimi u vunë në lëvizje. Në breg të lumit buçitën brohoritjet dhe këngët e përshëndetjes së banorëve.

Lundrimi kaloi pa ndonjë shqetësim të madh deri aty, ku bashkoheshin lumenjtë e Ihelumit me Kenabin. Pas pak ditësh arritën në një trevë luftarake, Multa e sotme, banorët e së cilës nuk deshën të dorëzoheshin pa luftë. Atëherë Aleksandri urdhëroi flotën e tij që të lëshonte spirancën aty dhe në fillim të vitit 325 p. e. s. filloi kundër fiseve të kësaj treve fushatën e tij luftarake. Në qendrën e kësaj treve mund të arrihej nëse kaloheshin 80 km nëpër shkretëtirën pa ujë, Sanda. Leka nuk iu tremb rrezikut, vrapoi me kalë natë e ditë pa pushim, këmbësorët e ndoqën më ngadalë dhe arritën në qytet në të gëdhirë. Banorët që mendonin se kalimi i shkretëtirës vdekjeprurëse ishte i pamundshëm, u kapën në befasi pa armë, tek po dilnin nga arat e tyre. Qindra e mijëra prej tyre u vranë. As ata që ikën e u strehuan në kështjellën e tyre nuk mundën të përballojnë sulmin e ushtrisë maqedonase dhe u dorëzuan. Kur arriti këmbësoria, Aleksandri iu drejtua një qyteti të shenjtë brahman, banorët e të cilit u mbyllën në kështjellë. Ai dha urdhër të viheshin shkallët e sulmit në ledhe dhe ai vetë e udhëhoqi sulmin kundër qytetit kokëfortë. Brahmanët më parë pranonin vdekjen, se të dorëzoheshin, ndaj i vunë zjarrin kështjellës. Maqedonët për të hyrë në qytet u detyruan të luftonin pëllëmbë për pëllëmbë nëpër tymin verbues. Të gjithë ata që nuk kishin vdekur nga flakët u vranë nga ushtria e Lekës. Kështu, 5000 banorët mbrojtës të kalasë humbën vdekjen.

Të nesërmen maqedonët u përgatitën për një pushtim tjetër në bregun përtej lumit të Ravit, ku iu desh të përballonin një kapërcim të rrezikshëm. Kur më në fund arritën qytetin që

mendonin edhe të pushonin, maqedonët e gjetën atë të mbrojtur mirë, por edhe këtu Leka nuk ngurroi të sulmonte. Më parë shembën muret e jashtme dhe me ndihmën e shkallëve të sulmit depërtuan në zemër të qytetit. Thonë se Aleksandri e humbi durimin, i zemëruar ia rrëmbeu nga duart shkallët një ushtari, i mbështetur te ledhet dhe me mburojën sipër kokës u ngjit lart. Me këtë donte t'ju jepte shembull ushtarëve. Menjëherë pas tij u ngjit shkallëve lart Peukestas, duke mbajtur si gjithnjë mburojën magjike, marrë në tempullin e Trojës. Atë e ndoqi oficeri Leonati dhe fill pas tyre një ushtar i thjeshtë, Abreas, i cili edhe më parë kishte dhënë prova guximi të madh. Sapo Aleksandri dhe tre pasuesit e tij kishin arritur pragun e ledhit dhe kishin nxjerrë shpatat, prej peshës së ushtarëve të tjerë që e ndoqën, shkalla u thye, ushtarët ranë në humnerë, kurse mbreti Leka me grupin e vogël mbeti vetëm sipër mureve.

Armiqtë nuk e kishin të vështirë ta njihnin nga trupi i tij i ngjeshur dhe tufa e bardhë mbi përkrenare. Me habi dhe tmerr shikonin ushtarët maqedonë Aleksandrin lart mbi bedene të kështjellës se si përpiqej të mbrohej duke lëvizur me shkathtësi mburojën sipër kokës për t'u mbrojtur nga breshëria e shigjetave dhe e heshtave që e kishin në shenjë. Eprorët nga poshtë, të shqetësuar për jetën e tij, i thirrën që të hidhej në krahët e tyre, pasi që shkallët ende nuk ishin vendosur. Por, Leka vetëm shante e mallkonte dhe kur një shigjetë e armiqve u ngul në mburojën e tij, papritur shpërtheu bërtima e tij e njohur e luftës. Atëherë ai nuk u hodh në krahët e shokëve jasht kalasë, por u hodh në krahun tjetër, brenda në kështjellë duke ra në mes të një grupi armiqsh shigjetarë. Aty fare afër qëlloi një dru i vjetër. Aleksandri menjëherë u ngrit në këmbë, vrau disa armiq me shpatë dhe të tjerët i mbajti larg vetes duke i gjuajtur me gurë. Kur më pas iu afruan, ai përsëri i goditi me shpatë. Pas pak çastesh edhe Leonati dhe Peukestasi bënë kërcimin e guximshëm dhe i shkuan në ndihmë. Maqedonët ende nuk e kishin humbur guximin dhe, duke u mbrojtur prapa drurit dhe murit, u vërsulën kundër sulmusve dhe njërin pas tjetrit i shtrinë të vdekur përdhe.

Papritur Arbeasi u rrëzua i vdekur nga një shigjetë që e kishte goditur në ballë. Në çast edhe Leka u qëllua nga një gur i rëndë apo copë druri në kokë. U detyrua të lëshojë mburojën dhe atëherë iu ngul edhe një shigjetë në gjoks. Ra në gjunjë dhe, megjithëse bëri përpjekje të dëshpëruara për t'u ngritur, u mbështet te një degë e drurit dhe u rrëzua pa ndjenja. Në çast Peukestasi i mbajti sipër mburojën e tij trojane për ta mbrojtur, por edhe ai u shtri i goditur nga tri shigjeta. Leonati i plagosur ia kishte dalë t'i zmbrapste armiqtë, qëndroi para Aleksandrit, por një shigjetë e qëlloi në grykë dhe ai u shemb përdhe. Ndërkohë ushtarët nga jashtë kalasë sollën shkallët dhe i vendosën sipër ledheve, kurse një derë që deri atëherë qëndronte e patundur u shkallmua. Kështu ushtria maqedone në çastin e fundit i shkoi në ndihmë mbretit Leka dhe shokëve të tij luftëtarë, duke i shpëtuar nga shigjetat dhe masakrimi. Por, shumë nga ushtarët maqedonë ende nuk e dinin se mbreti për mrekulli kishte shpëtuar nga vdekja, prandaj u sulën me ulërima tërbimi kundër qytetit të mundur për të vrarë pa mëshirë burra, gra e fëmijë.

Aleksandri me shigjetën ende të ngulur në gjoks u çua në një vend të sigurt. Ata u detyruan të sharronin boshtin e drunjtë të shigjetës, në mënyrë që mbreti të mund të hiqte veshjen e metaltë ushtarake, por maja ishte ngulur thellë në dërrasën e kraharorit. Duhej operuar. Miqtë e lutnin të mos bënte asnjë lëvizje të pakontrolluar e të rrezikonte jetën dhe t'i lejonte ta mbanin. Ai iu përgjegj: "Nuk është nevoja të mbash atë që është i zoti të mbahet vet!". Ditë të tëra u përpëlit midis jetës dhe vdekjes. U përhap lajmi se ai kishte vdekur dhe një panik i tmerrshëm i përfshiu ushtarët. Kur e mori vesh gjendjen, Aleksandri urdhëroi që ta mbartnin të kalonin lumin e ta çonin te ushtria që ta shikonin të gjithë. Ushtarët kujtuan se po sillnin kufomën e tij dhe vetëm kur Leka i Madh ngriti krahun për t'i përshëndetur, ankthi i tyre u kthye në thirrje e brohoritje gëzimi. Një vig rrinte i gatshëm për të, por ai urdhëroi që t'i sillnin kalin. Me përpjekje të mëdha u ngrit në këmbë dhe kërkoi ta ndihmonin për të hipur në kalë. Kështu, përmes dhembjeve shkoi deri te çadra e tij, ku e rrethuan ushtarët duke i puthur

gjinjtë dhe veshjet e tij, shumë prej tyre i hidhnin lule, të tjerët brohoritnin. Te hyrja e tendës e zbritën nga kali dhe ai kaloi qiri i drejtë para luftëtarëve të tij, edhepse kishte nevojë urgjente për qetësi, pushim dhe përkujdesje.

Eprorët e qortuan Aleksandrin për guximin e tij të tepruar që i kishte rrezikuar jetën, ndërsa një gjeneral beotik e ngushëlloi mbretin me një thënie të Eskilit: "Aleksandër, heronjve të mëdhenj u takon të kryejnë vepra të mëdha!". Jeta e tij kishte pasur lodhje e dhembje, por sipas botëkuptimit fetar të asaj kohe, një perëndi i bërë njeri duhej të vuante për popullin e tij, madje edhe të vdiste! Sëmundja ia kishte përforcuar Lekës mendimin për misionin e tij të shenjtë. Ishte vullneti i hyjnive që popujt e botës të bashkoheshin nën zotërimin e tij.

12.Nga Indi te Tigri
(Janar 325 – Qershor 324 p.e.s.)

Ka të ngjarë që Aleksandri të jetë plagosur në janar të vitit 325 p. e. s., por vetëm në pranverë qe në gjendje të ecë me këmbët e veta. Gjatë kohës së pritjes ushtria maqedonase shfrytëzoi rastin për të ndërtuar anije të tjera. Kështu, 15 000 trupa mundën të transportoheshin me anë të ujit. Pjesa tjetër e ushtrisë marshoi e ndarë në dy kolona gjatë dy brigjeve të lumit. Arritën ku Indi bashkohet me degët e tij dhe Leka qëndroi për të themeluar një qytet të ri. Ai u quajt Aleksandri, si shumë qytete të tjera. Këtu ai priti princin baktrian, Oksiatrin, babanë e nuses së tij, Roksanës, dhe e emëroi nënmbret të Afganistanit dhe të trevës në jug të Hindukushit. Pak kohësh Oksiarti u ngarkua me qeverisjen e të gjitha viseve indiane që do të pushtonin maqedonasit gjatë udhëtimit drejt detit, 400 000 milje katrore.

Pra, duket se Aleksandri e vlerësonte baktrianin dhe e donte bijën e tij, Roksanën.

Me padurim të madh shkonte Leka drejt grykës së rrjedhës së lumit Ind, ngaqë mendonte se deti duhej të ishte Oqeani i Jashtëm, që i vinte qark tokës dhe më kot ishte përpjekur ta arrinte atë përtej lumit Jaksartes dhe Gang. Më në fund, këtu në lumin Ind mendonte Leka, kufijtë e perandorisë së Maqedonisë puqeshin me kufijtë lindorë të botës. Në pril apo në maj ai u shërua plotësisht. Në qershor arriti në qytetin Patala, jo larg nga deti, afër Karaçit të sotëm. Në korrik emëroi një institucion për të hulumtuar viset rreth vendit ku Indi derdhej në det. Vendin e gjeti të braktisur dhe të tharë, pasi me t'u afruar ushtria e Lekës, banorët merrnin arratinë. Deti (Oqeani Indian) që tani gjendej para ushtrisë, ishte për ushtarët diçka e frikshme. I pushtoi një llahtar i madh. Kur anijet iu afruan grykëderdhjes së Indit në oqean, ato u ngritën lart nga rryma dhe si pasojë e rrjedhës së vrullshme, u përplasën me njëra-tjetrën. Aleksandri nuk deshi t'ia dinte, vendosi që me anijen e tij të shtyhej edhe disa milje thellë në det, jo vetëm për t'ua larguar frikën ushtarëve të tij, por edhe për të shijuar ndjenjën ngacmuese të aventurës, rrëshqitjen mbi thellësitë magjike, që kufizoheshin me tokën e fundit të banuar.

Me anijet më të mëdha ndërmori udhëtim-zbulimin, që e çoi deri në Karaki. Një pjese të kalorësisë i kishte dhënë urdhër të gjendej atje, ku së bashku me ta mbi kalë, bëri udhëtim-studimin që zgjati tri ditë, duke i rënë bregut për së gjati. Pastaj u kthye në Patala. Interesi i tij u shtri edhe mbi vendet e Lindjes. Ai ndërmori ekspeditën ndëshkimore në atë drejtim, ndërsa Hefestioni kujdesej për krijimin e bazës detare të fortifikuar, si pikëmbështetje për flotën që do të ishte shumë e rëndësishme për lidhjet tregtare të atëhershme me Indinë. E gjithë India Perëndimore deri te delta e Indit, fundi i botës nga jugu, ra në dorë të Lekës së Madh dhe nuk kishte më nevojë të qëndronte gjatë në këto visa të largëta. Plani i tij ishte: gjysma e ushtrisë, nën komandën e Krateriosit, duhej të kthehej në një lloj pike në Karmani, afër rrugës së sotme të Ormuzit dhe pikërisht duke

kaluar nëpër Dranganieni ose nëpër Beluçistanin Verior. Vet Leka me afro 20 000 ushtarë donte të arrinte në të njëjtin vend, duke marshuar gjatë bregut. Flota ushtarake detare, duke lundruar gjithnjë pranë bregut, duhej të drejtohej po atje nën komandën e Nearkut. Derisa të gjithë të takoheshin në vendgrumbullim, në Karmani, Aleksandri shpresonte të kishte sigurinë nëse bregdeti shtrihej deri në Arabi dhe prej atje, deri në Afrikë, ose përfundonte në Gjirin Persik. Vetëm atëherë do të vendoste nëse duhej të lundronte përqark Afrikës ose të shkonte në Suza. Flota mund të merrte detin vetëm në të hyrë të dimrit, por Aleksandri mori vendim të priste vetëm deri në shtator dhe për nëntë ditë arriti te lumi Arabios, që sot quhet Porali, afro 200 km nga Indi. Gjatë bregut u detyruan të ndalonin për të hapur puse, prej të cilëve furnizonin flotën me ujë të freskët. Banorët vendas në bregun përtej lumit i bënë qëndresë të fortë, prandaj u shfarosën pa mëshirë prej kalorësisë së Aleksandrit. U hapën puse dhe u ndërtuan depo bereqeti, në largësi të rregullta, gjatë bregut deri në malësinë që njihet sot si Ras Malan. Pastaj arritën në krahinën e shkretëruar të Gedrozisë, që sot quhet Makran, afër kufirit të sotëm persian. Në shkretëtirën gati paralel me detin, Leka zbuloi një rrugë që të çonte në qytetin Pura, i cili ndoshta i përgjigjet Bunpurit të sotëm në Persinë Juglindore. Kështu, mbreti vuri në plan që nëpër këtë udhë herë pas here të dërgonte një repart për plotësimin e depove në bregdet për Nearkun. Gjatë kthimit të tij nga India, Aleksandri duket se nuk kishte ndonjë përfytyrim të qartë për rreziqet e marshimit nëpër shkretëtirë, ndaj gjendej përpara alternativës - ta kalonte ushtrinë nga veriu në skaj të shkretëtirës dhe në këtë mënyrë të hiqte dorë nga furnizimi i flotës, ose t'i binte mes përmes Persisë e të qëndronte kështu në afërsi të bregut. Më vonë admirali i flotës, Nearku, do të thoshte se Leka i njihte mirë rreziqet e vështirësitë që e kërcënonin, por atij i kujtohej mbretëresha gjysmëhyjneshë e perandorisë asiriane, e cila kishte përshkuar tejpërtej këtë shkretëtirë shumë kohë para Aleksandrit. Këtë udhë e kishte kaluar edhe Kiri, mbreti i Persisë. Por të dyja këto ushtri ishin përgjysmuar si mos më keq. Me këtë marshim përmes

shkretëtirës së Gedrozisë ndoshta Leka i Madh donte të tregojë se ai ishte më i zgjuar e më i fortë se mbretëresha asiriane dhe mbreti paraardhës i Persisë.

Udhëtimi nëpër shkretëtirë zgjati 60 ditë, në muajt tetor e nëntor dhe gjatë gjysmës së parë të këtij udhëtimi vapa ishte ende shumë e madhe, prandaj shpeshherë ditën pushonin kurse natën udhëtonin. Ushqimet e pakta mbaruan shpejt. Burra, gra e fëmijë u rrëzuan njëri pas tjetrit anës rrugës. Të braktisur pa mëshirë, vdiqën në mjerim. Qerret e plaçkave ngecnin në rërën e imët dhe të thellë, kurse në disa zona të tjera shkrepat dhe blloqet e mëdha të shkëmbinjve qenë pengesa të mëdha në mes të rrugës. Gjatë marshimit nëpër shkretëtirë Aleksandri përsëri tregoi trimërinë e tij të zakonshme, por pa fituar admirimin e mëparshëm. Vetëm pasi kaluan mbi 800 km nga pikënisja e lumit Ind, arritën në Pura, të lodhur e të përgjysmuar. Plutarku shkruan se vetëm çereku i atyre që e ndoqën në shkretëtirë dolën të gjallë së andejmi. Edhe në qoftë se kjo është shifër e tepruar, sërish duhet pranuar se numri i atyre që vdiqën gjatë këtij marshimi prej 60 ditësh duhet të kenë qenë së paku 10 000 veta. Shumë historianë mendojnë se edhe Aleksandri gjatë këtij udhëtimi të tmerrshëm u bë si i çmendur, por edhe qëndrimi i mëvonshëm i tij nuk ishte më pak i çuditshëm. Në asnjë periudhë të jetës së tij ai nuk kishte qenë krejt i qetë, sepse trimëria, guximi dhe furia e tij kalonin çdo kufi njerëzor. Pak kohë më parë Leka kishte kremtuar 31-vjetorin e lindjes. 15 vite fushatash luftarake të pandërprera i kishin tronditur shumë nervat e tij. Përveç kësaj, shëndeti i tij i hekurt prej natyre ishte dobësuar nga plagosjet e shumta, gjendja e dalldisjes fetare dhe e rrëmbimit mistik, në të cilin ai kishte jetuar për vite me radhë duke e mbajtur veten si qenie mbinjerëzore, që duhej të kryente një detyrë të urdhëruar nga perënditë, nuk kishte kaluar pa lënë vrragë. Gjithnjë përpiqej të çante errësirën e botës abstrakte, të paprekshme. Në të shumtën ishte i ngrysur, gjithnjë në gjendje acarimi nervor. Megjithatë, energjia dhe fuqia që e shtynin gjithnjë përpara, aftësia për t'u bërë ballë vështirësive, nuk shteroi. Ai nuk pati kurrë shkatërrim fizik ose mendor.

Në Pura u furnizuan me të gjitha ato që kishin nevojë: me ushqime, me verë dhe me materiale luftarake. Pas një pushimi të shkurtër kaluan 200 km më tutje deri në një vend në Karmani, në Kermaninë e sotme, në thellësi jo larg Bandar-Abazit gjatë rrugës për në Ormuz. Shtatë ditët e para ushtarëve iu shpërndanë sasi të mëdha vere, që e patën marrë nga Pura. Aleksandri donte që ushtria të harronte tmerrin e kaluar e të mos mendonte për miqtë e shumtë dhe farefisin, që i kishin lënë kockat në shkretëtirë. Në fushimin përpara Bandar-Abazit e arriti edhe pjesa kryesore e ushtrisë, e cila nën komandën e Kraterosit shfrytëzoi rrugën në veri për t'u kthyer nga India dhe solli me vete elefantët dhe mjetet e rrethimit. U kthyen edhe repartet që para pesë vitesh, afërsisht në kohën e vdekjes së Darit III, kishin mbetur prapa në Ektabanë. Prej trevave tjera për të dhënë llogari erdhën nënmbretërit. Shumë prej tyre sollën furnizime dhe kafshë transporti që mund t'i nevojiteshin Aleksandrit. Ndërkohë ai priste me padurim nga Nearku lajme për flotën detare, fatin e së cilës ishte shumë merak. Kur i erdhi lajmi se Nearku me gjashtë shokë të tjerë kishin zbritur në tokë e ishin duke ardhur rrugës, nuk përmbahej nga gëzimi. Në fillim pati frikë mos qe shkatërruar flota dhe se ata të shtatë ishin të vetmit që kishin shpëtuar gjallë, meqë ia përshkruan si të dobësuar e të shpupurishur. Prandaj, kur u paraqit Nearku, Aleksandri e përqafoi atë me lot në sy, si të ishte ngritur nga varri. Pastaj Nearku i raportoi se të gjitha ekuipazhet ishin shëndosh e nirë dhe se të gjitha anijet i kishin lëshuar spirancat në Salmos, jo larg prej Bandar-Abazit. Ky lajm i papritur e mahniti plotësisht mbretin, i cili, duke dënesur u betua për Amonin se kjo gjë e gëzonte më tepër se sa ta kishin brohoritur fitimtar mbi gjithë Azinë.

Takimi i madh i ushtrisë së tij në Karmani, arritja e papritur e flotës dhe prania e kaq shumë nënmbretërve, mëkëmbësve dhe gjeneralëve që donin ta përgëzonin për pushtimet indiane dhe të jepnin llogari për mbarëvajtjen e trevave që u ishin besuar, ia provokuan Aleksandrit kujtimet torturuese të ngjarjeve të tmerrshme që kishin kaluar e përjetuar në shkretëtirën e

Gedrozisë. Gjithnjë e më tepër i forcohej mendimi se marshimi i llahtarshëm nëpër shkretëtirë kishte qenë vetëm njëra nga veprat heraklitiane (herkuliane) që ia kishin frymëzuar hyjnitë për plotësimin me sukses të së cilës ishte përgjegjës para tyre. Shtrirja e pafund e kampit të ushtrisë së tij i forconte besimin se ishte i pathyeshëm. I ngjashëm me një perëndi të pavdekshme, ai donte të riorganizonte Perandorinë e Lindjes para se t'i përvishej nënshtrimit të pjesës tjetër të botës.

Në ditët e para të janarit të vitit 324 p.e.s., pas zhvillimit të kremtimeve fetare të shumta, të kurbaneve falenderuese dhe garave të zakonshme, Leka dërgoi Hefestionin me pjesën kryesore të ushtrisë, me plaçkën më të madhe dhe me të gjithë elefantët, nëpër rrugën e rehatshme gjatë bregdetit për në Persi, ndërsa Nearku me flotën lundroi nëpër Gjirin Persik deri te derdhja e Tigrit, duke u përpjekur të mbajë lidhje sa më shumë që të ishte e mundur me Hefestionin. Aleksandri bashkë me shtabin e ushtrisë dhe me një pjesë të këmbësorisë shkuan në Pasargade të Persisë, gati 600 km në juglindje të Persepolit dhe 300 km në veriperëndim të Bandar-Abazit. Në Pasargade gjendej varri i Kirit të Madh, të cilin Leka donte ta nderojë. Por, ai u zemërua shumë kur dëgjoi se varrin e kishin plaçkitur, duke i vjedhur objektet me vlerë dhe vetë kufomën e kishin nxjerrë nga arkivoli. Leka urdhëroi që të merreshin në pyetje të gjithë rojet e varrit. Por, fajtorët nuk u zbuluan. Nuk mbeti gjë tjetër, pos të pastronin varrin dhe ta vulosnin hyrjen.

Aleksandri shkoi në Persepolis, ku emëroi nënmbret Peukestasin, që i kishte shpëtuar jetën në kështjellën malike. Pas kësaj shkoi në Suza, ku u takua me ushtrinë në shkurtin e vitit 324 p. e. s. Në ndërkohë arriti Nearku, që e kishte drejtuar flotën pa vështërsi nëpër derdhjen e Tigrit. Po afrohej edhe Hefestioni me pjesën kryesore të ushtrisë dhe me elefantët. Nuk dihet asgjë rreth ritakimit të Lekës me nënën mbretëreshë persiane dhe nipërit e saj, djemtë e Darit III. Nuk dihet asgjë rreth fatit të Barcinës, gruas së parë të Aleksandrit, as djalit të saj të vogël, Heraklitit (Herkulit), as për Roksanën, gruan e tij të dytë. Mbreti mori vesh se motra e tij Kleopatra, burri së cilës ishte mbreti i

Epirit, pak kohë më parë kishte humbur jetën në një luftë kundër Italisë së Jugut, ishte kthyer në Maqedoni, kishte mënjanuar Antipatrin e moçëm dhe se qeverisjen e Epirit e kishte marrë përsipër nëna e Lekës, Olimpia. Kur e dëgjoi këtë lajm Aleksandri, mendoi se Olimpia me marrjen në dorë të qeverisjes së Epirit, kishte bërë atë që duhej, sepse një maqedon nuk do të pranonte ta qeveriste një grua e huaj.

Në Suza ndodhi diçka e çuditshme. Sigurisht që të gjithëve na kujtohet se dijetari indian, i quajtur Kalan, kishte shkuar pas Aleksandrit kur ai u nis nga India drejt Babilonisë. Tani ai ishte 73 vjeç dhe pak kohë më parë kishte vendosur që t'i japë fund jetës së tij. Më kot u përpoq Aleksandri që t'ia mbushte mendjen të heqë dorë nga ky vendim. Kalani kërkoi që t'i reshtonin një turrë drush dhe ditën e caktuar e sollën me kurorë lulesh mbi kokë në vendin ku do të digjej. Rrugën e bëri duke kënduar këngë indiane dhe atë e përcolli një varg festiv, në të cilin morën pjesë ushtarë në këmbë dhe në kalë dhe elefantët me Aleksandrin në krye. Kur arriti te vendi i varrosjes Kalani dhuroi pronën e tij tokësore, përqafoi miqtë dhe me nderim u nda me Aleksandrin, të cilit i bëri një vërejtje ogurzezë: "Ne do të takohemi përsëri në Babiloni!" (atje ku vdiq më vonë Aleksandri). Mandej Kalani preu një tufë të flokëve të tij dhe i dogji, hipi sipër turrës së druve dhe u shtri në shtratin që kishin përgatitur për të. Ndërsa po i jepnin zjarrin turrës së madhe të druve, ai e mbuloi fytyrën me mantel. Pa u ndier fare, përpara turmës që shikonte e llahtarisur, Kalani u hodhë në mes të flakëve. Buçitën boritë, ushtarët lëshuan bërtimën e tyre maqedonase të sulmit, elefantët klithën egër. Aleksandri, sipas kërkesës së Kalanit, shtroi një gosti, ku u pi sipas mënyrës maqedonase, duke pirë një sasi vere të madhe shpejt, kupë pas kupe, jo ngadalë si shijues të vërtetë, por deheshin shpejt.

Kur Leka i Madh u kthye në Persi dhe në Suzianë, ai konstatoi se nëpunës të tij të ndryshëm kishin shpërdoruar pushtetin, duke menduar se ai nuk do të kthehej i gjallë nga India. Të gjithë käta njerëz persianë, grekë apo maqedonë, duke përfshirë këtu edhe disa nënmbretër, i ekzekutoi pa u matur fare.

Pikërisht këtu në Suza, në ditët e para të pranverës së vitit 325 p. e. s. edhe njëherë Aleksandri ishte si i dehur nga madhështia e pushtetit të tij, si udhëheqës i Perandorisë Persiane të pafund dhe nga madhështia e luksi i jetës së oborrit mbrtëror, që e kishte trashëguar nga Dari III. Para afro pesë vitesh Aleksandri kishte dhënë urdhër që 30 000 fisnikë të rinj orientalë të stërviteshin sipas mënyrës ushtarake maqedone. Këta quheshin epigonë dhe ishin nën urdhërat e Seleukut, të njërit prej oficerëve më të aftë. Pas përpjekjes për rebelim të maqedonasve në Indi, mbreti kishte urdhëruar që numri i tyre të shtohej dhe stërvitja të thellohej edhe më tepër. Me këtë korpus të ri në Suza ai zhvilloi një paradë. Ishte shumë i kënaqur për sjelljen ushtarake dhe për aftësinë e trupave. Me një buzqeshje të zemëruar vërente habinë e inatosur të ushtarëve maqedonë, të cilët habiteshin me përpikërinë dhe me aftësinë luftarake të vendësve. Në këtë kohë Leka i Madh kishte marrëdhënie me një numër të madh fisnikësh dhe princash aziatikë që i kishte futur në radhët e gardës kalorësiake dhe krah për krah me trupat perëndimorë luftonin edhe skuadrone persianësh, baktrienësh, skitësh dhe lindorësh të tjerë.

Për një kohë të gjatë Aleksandrin e kishte munduar pasiguria se çfarë mund të ngjante sikur të braktiste Orientin, nëse do t'i çonte deri në fund planet e tij për pushtimin e botës dhe cila do të ishte mënyra më e mirë që ta detyronte Azinë të ishte besnike ndaj tij? Gjithnjë i shkonte mendja të martohej me njërën nga vajzat e Darit III, të paraqitej kështu si pasardhës i mbretit persian. Duket se në Suza ky mendim u përcaktua më mirë. Vet Aleksandri u kujdes që të përhapej fjala sikur Dari, duke vdekur, kishte shfaqur dëshirën që ai të ishte pasardhësi dhe dhëndrri i tij. Pasi e pati përcaktuar planin në mendje, Lekës iu deshën disa javë ta vinte në zbatim. Kështu, do të martohej me dy gra: me Statirën (Plutarku dhe Diodori e quajnë Statirë, Focciusi e quan Arsinoj, kurse Arriani e thërret Barcinë) si dhe me Parisatisin, vajzën e vogël të Artakserksit III, i cili vdiq në vitin 338 p. e. s. dhe princesha Parisatis në atë kohë duhet të ketë qenë 14 ose 15 vjeçe. Kësisoj Aleksandri shpresonte të krijonte

lidhjen midis dy degëve armike të dinastisë së vjetër persiane, pasi Dari III nuk rridhte në vijë të drejtë nga familja e vjetër mbretërore persiane. Duket se Statira ishte shumë e bukur. Kur Leka e pa së pari, pas betejës në Issos, ajo ishte në moshë për martesë 14-15 vjeçe, kurse tani duhet të ishte 22 ose 23 vjeç. Vetë fakti që ajo nuk ishte martuar deri tani me ndonjë fisnik persian, prej atyre që ishin në shërbim të Lekës, tregon se mbreti maqedon e kishte pasur në vëmendje mundësinë e martesës së tij me të. Sigurisht që nëna e moçme mbretëreshë, Sisygambis, do ta kishte dëshiruar prej kohësh të lidhte krushqi me Lekën e Madh. Ajo shpresonte që një nip i Darit III do të mund të trashëgonte fronin e botës. Natyrisht kishte mundësi që edhe Parisatisi të lindte djalë, pastaj ishte edhe Herakliti (Herkuli) i vogël, djali i Barcinës. Nuk përjashtohej që edhe Roksana të nxirrte në dritë një fëmijë mashkull. Sidoqoftë, Statira do të zinte vendin e parë ndër katër gratë e Aleksandrit dhe djali i saj do të kishte më shumë mundësi për të qenë treshëgimtar i ligjshëm i fronit. Por, Statira kishte edhe një motër pak më të re. Emri i kësaj princeshe ishte Drypetis. Ajo duhej të martohej me Hefestionin. Së këndejmi, fëmijtë e Aleksandrit dhe të Hefestionit do të ishin kushërinj. Pikërisht ky ishte qëllimi i tij. Simpatia e tij për Hefestionin ishte gjithnjë e thellë dhe e zjarrtë. Në shumë histori të përhapura rreth veseve dhe mizorive të Aleksandrit ruajtja e një miqësie të qëndrueshme me Hefestionin, të lidhur që në fëmijëri, ishte rreze drite e gëzueshme. Kjo miqësi do të kurorëzohej pasi Aleksandri dhe Hefestioni do të martoheshin me dy motra prej gjaku mbretëror. Edhe Kraterosi besnik, i cili pas Hefestionit numërohej ndër miqtë më të mirë të mbretit, duhej të ishte në krushqi me familjen mbretërore, e pikërisht nga martesa me Amastrinë, të bijën e vëllaut të Darit III. Dy motrat e Barcinës, Artakama dhe Artonisi, të bijat e Artabazit, njëra duhej të martohej me Ptolemeun dhe tjetra me Eumenesin, sekretarin e mbretit Aleksandër. Perdika, që kishte bërë emër si gjeneral i zoti, ishte caktuar si dhëndërr për vajzën e nënmbretit vendës nga Media, kurse Nearku, admirali i flotës ushtarake detare, do të merrte Barcinën, të bijën e mentorit të Rodit, vëlla i Memnonit.

Për Seleukun, që stërviste korpuset e reja persiane për ushtrinë maqedonase, ishte zgjedhur e bija e princit batrian, Spitamenes, vdekjen e të cilit e kishte shkaktuar Aleksandri, por familjen e tij, njëlloj si edhe familjen e Roksanës, mendonte ta pajtonte me anë të kësaj martese. Edhe për 80 gjeneralë të tjerë maqedonë u kërkuan nuse persiane të rangut të lartë, kurse 10 000 vajza persiane me origjinë të thjeshtë duhej të lidhnin kurorë me oficerë të gradave më të ulëta dhe me ushtarë që ishin gati për lidhje të tilla. Shumë nga këto martesa u lidhën të njëjtën ditë, duket se në fund të marsit ose në fillim të prillit të vitit 324 p. e. s. Pas përfundimit të gostisë së madhe përnjëherë të Aleksandrit, u bë celebrimi zyrtar i 90 çifteve më të rëndësishëm në një tendë të madhe, brenda oborrit të pallatit mbretëror të Suzës. Dhëndurrët u vendosën në një rradhë të gjatë dhe pastaj sollën nuset. Secila qëndroi para atij që i ishte caktuar për burrë. Aleksandri i mori përdore të dyja princeshat dhe i puthi, edhe të gjithë burrat tjerë i puthën nuset e tyre dhe i çuan në 90 dhomat e përgatitura për ta. Festimet zgjatën për pesë ditë dhe të ftuarit u zbavitën nga aktorët, muzikantët, këngëtarët, poetët dhe komikët më të famshëm. Në gosti duket se morën pjesë më shumë se 9000 veta. Martesat në masë tregojnë se Aleksandri deri në një farë mase nuk i ndante më njerëzit sipas parimit të dallimit aristokratik në dy kategori armike me njëra-tjetrën: në grekë dhe në barbarë (të huaj). Edhe nëse me qëndrimin e tij shembi pengesat popullore që e zemëronin, sepse vetë maqedonët deri pak kohë më parë i mbanin si barbarë, kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë se këtë e bëri për shkaqe etike. Aleksandri nuk shpalli barazinë mes njerëzve, madje as se Lindja me Perëndimin janë njëlloj. Po të ishte kështu, s'do të kishte lënë gurë pa lëvizur që shumë grave maqedone, ilire, epirote apo greke t'u krijonte rastin të martoheshin me burra persianë.

Leka luante thjesht politikë praktike. Bota duhej të pushtohej dhe njerëzimi duhej t'i qëndronte besnik atij dhe dinastisë së tij. Vendosja e marrëdhënieve të krushqisë në mes elementëve me ndikim politik te popujt duhej t'i shërbente arritjes së këtij synimi. Këto martesa nuk kishin dhe aq kuptim,

derisa Leka me ushtrinë e tij përgatitej të nisej drejt një pjese tjetër të botës. As që mund të mendohej për një jetë familjare të qetë dhe të qëndrueshme të këtyre çifteve të rinj. Burrat që u martuan me gra persiane pas pak kohe do të pushtonin Kartagjenën, Europën Perëndimore, Italinë, si dhe vende të tjera. Kurse në Persi këto martesa kishin shumë rëndësi. Masakrat masive ndaj fiseve që i prishnin punë, vërtetojnë më së miri se qëndrimi i tij kundrejt njerëzimit nuk ishte aspak ai i një ëndërrimtari me ndjenja fisnike. Nga kujdesi për sigurimin e frontit lindor kundër kryengritjeve i interesonte që jo vetëm ushtria, me sa të ishte e mundur të linte pas vetes një numër të madh fëmijësh të lindur brenda martesës, të cilët do të rriteshin në shtresat e larta dhe të mesme të shoqërisë, por edhe ndër viset e pushtuara të ruanin një kujtim miqësor për maqedonët të mos kishte as hidhërim, as armiqësi.

Aleksandri tani besonte se këtej e tutje e kishte siguruar mjaft pushtetin në Lindje. Në rrethin e tij të ngushtë bënin pjesë princa persianë, shumë vendës ishin në ushtrinë e tij. Ai kishte pasurinë e Darit III dhe nëpërmjet martesës me dy trashëgimtaret e familjeve mbretërore të Persisë ishte bërë pasardhës i ligjshëm i Lindjes. Kështu, i sigurt mund të përgatitej për nisjen. Leka i Madh tashmë ishte mbreti i Maqedonisë së pamposhtur, faraoni i Egjiptit, mbreti i Babilonisë, i zoti i tërë Azisë dhe, siç dukej, së shpejti edhe sundimtari i ardhshëm i gjithë botës.

Në prill ose në maj Aleksandri i dha lamtumirën Suzës dhe u nis drejt Tigrit, që gjatë majit dhe qershorit të zbulonte viset gjatë rrjedhës së poshtme të lumit. Në këtë ekspeditë zbulimi i jepte ndihmë të madhe flota detare. Prej andej Hefestioni me pjesën kryesore të trupave maqedone iu ngjit lumit në drejtim të Opisit, gati 80 km në veri të Bagdadit dhe në fund të qershorit u takua rishtas po atje. Leka donte ta kalonte verën në Ektabana, që gjendej afro 500 km më tej në veri, ku e kishin kaluar gjithnjë mbretërit e mëdhenj stinën e ngrohtë. Pastaj do të shkonte në Babiloni, përpara se të fillonte lundrimin rreth Afrikës. Për t'u kthyer në Maqedoni, nuk kishte as kohë dhe as dëshirë.

13.Viti i fundit i jetës i Aleksandrit
(qershor 324 p. e. s. – qershor 323 p. e. s.)

Kur arriti në Opis, Aleksandri i gjeti trupat maqedone shumë të pakënaqura dhe të mërzitura. Kishin kaluar 2 vjet që nga rebelimi në Indi. Ai u detyrua t'i ndryshonte planet dhe të kthehej në perëndim. Ushtria kujtoi se do të kthehej në Maqedoni, por dy vjet më vonë u duk qartë se ai s'e kishte këtë qëllim. Në vend që të bënte atë që duhej, ata vërtetuan me një zhgënjim të madh se ishte shtruar këmbëkryq në pallatin e verës të mbretërve të mëdhenj persianë në Ektabanë për të kaluar pjesën tjetër të vapës dhe gjithnjë e më shumë dëgjohej të flitej për fushatën e ardhme dimërore drejt Babilonisë. Ata dronin mos po ngulte banimin e tij të përhershëm në Lindje. Me martesat në masë që u bënë në Suza dhe me kurorëzimin me dy princeshat persiane u duk sikur ai kishte hequr dorë plotësisht prej kombësisë (etnisë) maqedone dhe gjithnjë e më shumë i pëlqente vetja në rolin e Mbretit të Madh (Darit III).

Ushtarët e Aleksandrit i irritonte jo vetëm rrethi persian, veshjet persiane dhe trupat persianë të parapëlqyer prej tij, por edhe dëshira e tij të nderohej nga grekët si perëndi. Deri kur do ta shtynte pa kërkuar të njëjtën gjë edhe në Maqedoni? Ç'qëndrim do të mbanin shtetet e ndryshme ndaj kërkesës së Aleksandrit, që ta mbanin atë si hyjni të bërë njeri? Për egjiptianët ai nuk ishte vetëm bir i Amonit, por edhe faraoni-hyjni i kthyer në tokë. E njëjta gjë vlente për mesopotamët, si mbret të Babilonisë dhe si perëndi. Përkundrazi, Mbreti i Madh i Persisë nuk vlerësohej si hyjni, por vetëm si zëvendës i paprekshëm i qiellit në tokë. Për botëkuptimin grek ishte diçka e vetëkuptueshme që një njeri mund të ishte edhe perëndi. Por,

për maqedonasit, me përjashtim të bujarëve të helenizuar, ky mendim ishte po aq i huaj, sa është edhe për ne sot.

Aleksandri u zemërua shumë me shqetësimin e ushtarëve të tij. Për t'i qetësuar vendosi që afro 10 000 nga ata që kishin shërbyer gjatë, t'i khtente në Maqedoni, sidomos ata më në moshë, për arsye të gjendjes shëndetësore ose për shkak të pakënaqësisë së tyre të vazhdueshme nuk vlenin më për luftë. Vendimi i tij u kundërshtua me protesta, megjithëse çdonjërit që linte shërbimin, ai i dhuroi një shumë aq të madhe parashë, saqë shumë të rinj në atdhe do të kishin dëshirë t'ua zënë vendin përkrah Aleksandrit. Ushtarët shpallën botërisht se Aleksandrit nuk i bëhej më vonë për bashkatdhetarët e tij dhe se ai parapëlqente lindorët, prandaj donte t'i dërgonte në shtëpi të gjithë. Kur Aleksandri dëgjoi shfaqjet e pakënaqësisë së ushtrisë, mblodhi oficerët dhe përfaqësuesit e ushtarëve në oborrin e pallatit dhe prej një podiumi u mbajti një fjalim të gjatë. Por, për çudinë dhe revoltën e tij u gjend përpara një turme burrash të zemëruar, kryengritës, zhurmëmëdhenj, që i bërtisnin nga poshtë, e quanin renegat dhe e përqeshnin se donte të ishte më tepër se njeri.

Për mbretin gjendja ishte shumë e rrezikshme, se shumë nga eprorët e tij më të besuar ishin në mes të kryengritësve. Ndjekësit e tij të afërt dhe truproja që e rrethonte menjëherë e kuptuan se gabimi më i vogël në këtë çast mund t'i rrezikonte jetën mbretit, por Aleksandri nuk dinte ç'është frika dhe as që mendonte për sigurinë e vet. Pa u menduar fare ai u hodh nga podiumi në mes të turmës, kapi udhëheqësit kryesorë të revoltës dhe i përplasi në krahët e rojave të tij të armatosur rëndë. Brenda pak çastesh u arrestuan 13 veta. Pa marrë parasysh revoltën e miqve të tyre, urdhëroi që këta të ekzekutoheshin menjëherë. Pasoi një heshtje e frikshme. Aleksandri hipi përsëri në podium de iu drejtua ushtarëve me një gojëtari që prej zemërimit ishte bërë më e vrullshme:

"Atë që kisha ndërmend t'jua thosha,* - filloi Leka, - *nuk e them se dua të ju ndaloj të shkoni në Maqedoni, por dua t'ju kujtoj se çfarë njerëzish keni qenë në fillim dhe si keni

ndryshuar. Kur Filipi, babai im, ju doli për zot, ju keni qenë si mos më keq. Shumica prej jush vishej me lëkura kafshësh dhe kulloste dy kokë dele në shpatijet e malit. Më kot luftonit atëherë kundër banorëve të bjeshkëve për të mbrojtur atë pak pasuri. Mbreti Filip në vend të lëkurëve ju veshi rroba. Prej maleve djerrë ju zbriti në fusha. Ju mësuat se si të mbroheni kundër fiseve të egra dhe nuk patët më nevojë të rrethoheni në kulla të veçuara në male për të shpëtuar jetën nga njerëzit e egër. Mbreti Filip ju solli në qytet, ju dha ligje dhe ju bëri njerëz të qytetëruar. Nga skllevër dhe të nënshtruar që ishit, ju u bët zotrinj mbi po ata barbarë që më parë ju rrëmbenin pasurinë. Mbreti Filip e përfshiu pjesën më të madhe të Thesalisë brenda Maqedonisë. Me pushtimin e qyteteve më të rëndësishme në bregdet, duke shtuar tregtinë, pasuroi vendin dhe ju dha punë të leverdisshme në minierat e tij. Ju u bëtë zotrinj mbi thesalët, prej të cilëve më parë kishit frikë për vdekje. Nënshtrimi i fokëve bëri të mundur të ndërtoheshin rrugë të gjera, të rehatshme për në Greqi dhe ne nuk kemi më nevojë të udhëtojmë nëpër shtigje të ngushta e të vështira. Athinasit dhe Tebanët, që ju kërcënonin vazhdimisht me sulmet e tyre, u nënshtruan kaq shumë nga mbreti Filip, sa duhet të jenë të lumtur që janë ende gjallë. Ju kurrë më nuk do të keni nevojë të kërkoni shërbimin e tyre. Në këtë fitore kam dhënë edhe unë ndihmën time. Më vonë mbreti Filip kaloi në Peloponez, i rregulloi punët atje dhe u shpall kryekomandant i të gjithë helenëve për fushatën e madhe kundër persianëve. Ai ngriti lart jo vetëm famën e tij, por edhe lavdinë e të gjithë maqedonëve.

Për të gjitha këto duhet t'ia dini për nder atit tim, Filipit, por të gjitha këto janë pak në krahasim me ato që më detyroheni mua. Megjithëse kam trashëguar prej babait vetëm disa kupa të pakta floriri dhe argjendi, megjithëse arkat e thesarit ishin të zbrazura dhe vendi i mbytyr në borxhe, aq sa u detyrova të kërkoj hua, përsëri e ndërmora këtë fushatë me ju, pa ditur se si do të ju ushqej. Me ju unë çava rrugën e Helesponiti (Grykës së Dardaneleve), që në atë kohë ende ishte e kërcënuar nga epërsia e flotës persiane. Pasi munda nënmbretërit e Darit III me kalorësinë time, atdheut iu shtuan viset e jonëve dhe të eolëve,

përveç gjith Frigjisë dhe Lidisë. Deri edhe Mileti u pushtua me sulm. Vende të tjera u dorëzuan vullnetarisht. Me zemërgjerësi unë ju kam lejuar të pasuroheshit me thesaret e tyre. Në këtë mënyrë ju përfituat nga pasuritë e Egjiptit dhe të Kirenës që unë i fitova pa luftë. Siria, Palestina dhe Mesopotamia ju përkasin juve, si edhe Babilonia, Baktrienia dhe Suza. Dhe, kush tjetër përveç jush do t'i shfrytëzojnë thesaret e lidëve, dhe të persianëve, floririn, argjendin dhe gurët e çmuar të indianëve? Ju jeni të vetmit zotërinj të Oqeanit të Jashtëm. Dhe unë, pas tërë këtyre lodhjeve, çfarë kam mbajtur për vete, përveç këtij manteli të purpurt dhe kësaj diademe (kurore)? Për veten time nuk kam kërkuar asgjë. Asnjeri nuk mund të ma përplasë ndër sy se kam grumbulluar pasuri për vete, vetëm për ju. Mua as që më nevojitet gjë. Unë ha të njëjtat gjellëra si ju, madje shpesh unë e gëdhij natën pa gjumë, që ju të mund të flini të qetë. Mua më duket se sofra juaj prej kohësh është po aq e pasur, sa edhe imja. Ndoshta ndonjëri nga ju mund të ankohet se unë si edhëheqësi juaj u jam shmangur mundimeve, ndërsa duhej të lodheshit ju sa të rraskapiteshit fare. Po ju pyes ndershmërisht, kush mendon se ka vuajtur më tepër për mua se sa unë kam vuajtur për ju? Le të dalë njëri prej jush dhe t'i tregojë plagët e trupit. Edhe unë do të bëj të njëjtën gjë! Pastaj mund të bindeni, asnjë pjesë e trupit tim nuk është e pacënuar dhe nuk ka asnjë lloj arme që nuk ka qëlluar mbi mua. Unë kam provuar gurë e kërcunj druri, të gjitha për të mbrojtur jetën tuaj, për të ngritur lart lavdinë tuaj, për të shtuar pasurinë tuaj. Gjithnjë ju kam udhëhequr si pushtues ndër vende të tjera, mbi dete, gjatë rrjedhave të lumenjve, ndër male e fusha të pambarim. Së bashku me ju kam lidhur martesën time dhe shumë nga fëmijtë tuaj do të jenë kushërinj me fëmijtë e mi.

Unë i kam paguar të gjitha borxhet tuaja, pa ju pyetur një nga një, se si mund të ngjante kjo, ndërsa ju keni rroga të larta dhe keni bërë plaçkë të majme. Shumica nga ju mbani mbi kokë kurora floriri për lavdi dhe ai që e la jetën në dhe të huaj u varros me nderime të plota. Për nder të të rënëve atdheu ka ngritur një statujë bronzi. Prindërit e këtyre heronjve nderohen shumë nga populli dhe janë të përjashtuar prej shërbimeve

publike dhe nga çdo lloj takse. Nën udhëheqjen time nuk është vrarë asnjë i vetëm duke ikur. Dhe unë tani duhet të dërgoj në shtëpi ata që nuk e durojnë më luftën Në Maqedoni do t'ua kenë zili përvojën dhe fitoret!

Por meqë dëshironi të shkoni të gjithë, shkoni të gjithë, kthehuni në shtëpitë tuaja dhe tregoni se si e keni trajtuar ju mbretin tuaj, Aleksandrin, fitimtarin kundër persianëve, madëve, baktrienëve dhe skithëve. Burrin që mposhti uksierët, arakotierët dhe drangierët, ata që i vuri nën zgjedhë partët, sogdianët dhe hirkanianët deri në Detin Kaspik; atë që kapërceu Kaukazin, që kaloi nëpër "Derën Kaspike", që u hodh përtej Oksit dhe Jaksartës e kaloi edhe në Indi, që përveç Hidasperit, Akesinsit dhe Hidarotesit dhe që s'u ndal as para Hifazit, kur ju tërhiqeshit nga frika; po atë që ka arritur në dy grykat e Indit në Oqeanin e Jashtëm, që mundi shkretëtirën gedrozike, gjë që asnjëherë më parë nuk ka arritur ta bëjë asnjë ushtri, që i mori në dorëzim hapësirat nga Karmania deri në vendin e oritëve, përveç kaq viseve të tjera të pushtuara, dhe flota e të cilit lundroi prej kufijve të Detit të Indisë deri te ata të Persisë.

Kthehuni në shtëpi dhe tregoni se, kur erdhët në Ektabanë, braktisët mbretin tuaj dhe e latë nën mbrojtjen e të huajve dhe të mundurve. Nuk ka dyshim se tregimi juaj do t'ju bëjë edhe më të përmendur përpara syve të bashkatdhetarëve tuaj dhe do t'ju sigurojë njëherë e përgjithmonë mbrojtjen e perëndive! Shkoni!"

Atëherë Aleksandri u kthye shpejt, zbriti nga podiumi dhe menjëherë hyri në pallat. Atë ditë e të nesërmen ai nuk pranoi asnjërin nga miqtë e tij, kuptohet me përjashtim të Hefestionit. Thuhet se as nuk lahej e as nuk i ndërronte veshjet. I zemëruar, shfrynte si bënte në fëmijëri, sjellje që ai duhej ta kishte kapërcyer prej kohësh. Ndërkaq ushtarët i kishte pushtuar një zhgënjim i madh. Kur ata e lutën që t'i lironte të gjithë, ashtu të pakënaqur siç ishin, natyrisht nuk e prisnin kurrë që ai do t'i kapte në fjalë, por tani Aleksandri i kishte liruar, ata nuk ishin më ushtarët e tij.

Kur pas tre ditësh dëgjuan se mbreti kishte mbledhur oficerët më të lartë persianë, se do të ngrinte regjimente persiane

e se komandat e larta do t'i zëvendësonte me lindorë, dhe kur morën vesh se prej këtyre persianëve kishte zgjedhur bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, u erdhi keq. Ata u vërsulën te dyert e pallatit, i hodhën armët përdhe dhe thërrisnin vazhdimisht: "Aleksandër, Aleksandër!" U grindën keqas midis tyre. Bërtisnin, premtonin se do t'i dorëzonin atij të gjithë nxitësit e rebelimit, krerët e kryengritësve dhe e siguronin se ata do të mbanin të rrethuar pallatin e tij, derisa ai t'i falte.

Kur më në fund mbreti doli përpara tyre, ata duke qarë e duke rënkuar i ranë ndër këmbë. Mbreti u përpoq të fliste, por nuk e la mallëngjimi, shpërtheu në vaj. U ngrit një oficer me emrin Kalinës, iu afrua atij dhe i tha: ***"Ajo që na prek më tepër, është se persianët i ke preferuar në mënyrë të veçantë. Kaq shumë i ke afruar pranë vetes, saqë madje ata i përshëndet deri me puthje. Asnjë maqedon, me përjashtim të miqve tuaj të ngushtë, nuk ka pasur deri tani një nderim të tillë".***

Aleksandri e ndërpreu folësin. ***"Ju të gjithë, pa përjashtim,*** **- thirri ai,** ***- jeni të mitë dhe kurrë s'ka për të qenë ndryshe".*** Pastaj Aleksandri e pushtoi atë dhe e puthi. Të gjithë ata që qenë afër mbretit bënë të njëjtën gjë. Atëherë ai u gjend i rrethuar nga një turmë burrash histerikë, që të rrëmbyer nga mallëngjimi, e përqafonin dhe i puthnin duart dhe rrobat. Pastaj ata i morën përsëri armët nga toka dhe vallëzuan në një gëzim të egër rreth mbretit; bërtisnin, qeshnin, qanin, më në fund të gjithë së bashku i kënduan një lavdi falenderimi Apolonit.

Për një kohë të gjatë Aleksandri kishte menduar se misioni i tij i caktuar nga Zeus-Amoni ishte që ta vinte tërë botën nën zotërimin e tij. Por, kohët e fundit e kuptoi qartë se zilia dhe armiqësia midis ushtarëve maqedonas fitimtarë dhe persianëve të nënshtruar ishin të pashmangshme dhe se rebelimi që sapo kishte marrë fund, kishte ngjarë vetëm se ai i trajtonte njëlloj maqedonasit e lindorët. Ai tanimë e kishte të qartë se pas pushtimit të pjesës tjetër të botës perëndimore përsëri do të krijoheshin po të njëjtat vështirësi midis fitimtarëve dhe të mundurve, ndaj ai patjetër duhej të krijonte një vëllazërim të

ngushtë në mes maqedonasve dhe popujve të nënshtruar prej tyre.

Nëse Aleksandri kishte si qëllim vetëm lavdinë dhe pushtetin e tij, nëse ambicia e tij vetjake e pangopur e shtynte atë të mendonte vetëm për nënshtrimin e botës, atëherë lutja e bërë në Opis ishte vetëm shprehje e një dëshire të zjarrtë, që zilia e maqedonëve për persianët të mos i pengonte planet e tij të pushtimit. Nga ana tjetër, Leka ishte i bindur se ai ishte Dionisi i ri, i zgjedhur nga hyjnitë, perëndi i bërë njeri, perëndia dashamirëse që flijohej për të mirën e njerëzimit. Nëse ia nënshtrojmë këtë bindje logjikës, atëherë nga lutja e tij mund të dallojmë shpresën e patundur, që ushtarët e tij të bashkëpunonin me ata të perandorisë së vjetër persiane për vendosjen e një paqeje të përgjithshme dhe për të mirën e popujve. Martesat në masë në Suza dhe gostia e vëllazërimit në Opis qëndrojnë në një binar me kërkesën e tij që të njihej si perëndi. Prej luftës së përgjakur doli një Aleksandër që kërkoi të bëhet bamirës i njerëzimit dhe që përpiqej me zell të krijonte një lidhje të fortë bashkimi midis lindjes dhe perëndimit të botës. Këto dy pikëpamje mund të puqen me njëra-tjetrën. Lekës i ishte mbushur mendja se po e pushtonte botën për të mirën e tërë njerëzimit, por njëkohësisht ai ishte gati të vriste cilindo që mund ta kundërshtonte. Ai besonte në një vëllazërim të njerëzve, por nën zotërimin e tij autokratik. Ai besonte në mundësinë e bashkimit të të gjithë njerëzve, por më së pari duhej të kryhej midis trupave të tij maqedone dhe atyre persiane.

Pas gostisë Aleksandri shpalli se pjesa kryesore e ushtrisë duhet të qëndronte pranë tij, kurse 10 000 nga ushtarët e papërshtatshëm ose të moshuarit e të sëmurët duhej të ktheheshin në shtëpi. Ushtarët u kënaqën, aq më tepër kur udhëheqja e atyre që do të ktheheshin, iu besua Krateriosit, gjeneralit të aftë e të dashur. U premtoi se do t'u paguante rrogë të plotë derisa të arrinin në vendlindje, përveç kësaj edhe një rrogë tjetër për shtatë vjet shërbime lufte. Për më tepër, mbreti u premtoi vendet më të mira në shfaqjet teatrore dhe në të gjitha tubimet publike dhe i lejoi të mbanin kurora me lule.

Kur u nisën dhjetëmijë ushtarët për në atdhe, ndarja ishte shumë e vështirë. Edhe Leka qau njëlloj si ushtarët, kur ata u larguan nga Suza. Maqedonët që po ktheheshin në atdhe morën me vete në kujtesë pamjen prekëse të mbretit të tyre. Për të tjerët ai mund të ishte një hyjni që të fuste frikën, kurse për ta ishte njeriu i tyre, që njëlloj si ata e donte Maqedoninë.

Aleksandri kishte vendosur që si mëkëmbës të tij në Maqedoni, në vend të Antipatrit, të emëronte Kraterosin, sepse fama e tij ishte dëmtuar rëndë nga grindjet e vazhdueshme me nënën e tij, Olimpinë. Kurse Antipatri mori urdhër të rekrutonte 10 000 ushtarë të rinj, të aftë për shërbim ushtarak dhe t'i sillte vet në Persi. Sidoqoftë, këto urdhëra e plane nuk u realizuan, sepse pak më vonë Aleksandri vdiq.

Pra, Leka i Madh ndërmori udhëtimin e tij deri në Ektabanë, 500 km larg, për të kaluar pjesën tjetër të verës dhe vjeshtës në pallatin e freskët dhe madhështor të mbretërve të mëdhenj persianë. Para së gjithash, i interesonte të lundronte rreth Afrikës nga lindja në perëndim dhe pastaj të hynte në detin Mesdhe nëpër ngushticën e Gjibraltarit. Me këtë besonte se kishte arritur fundin e botës në perëndim. Me urdhër të tij në të gjithë kantieret detare të Mesdheut lindor filloi ndërtimi i një flote prej 1000 anijesh lufte, të cilat duhet të ishin shumë më të mëdha se sa trirremëshet e zakonshme. Kjo armatë duhej të zbriste përgjatë bregut jugor të Mesdheut deri në Kartagjenë, kështu që gjatë lundrimit rreth Afrikës, të dyja pjesët e flotës duhet të takoheshin përsëri dhe së bashku do të mundnin pa vështirësi Kartagjenën, fuqinë detare më të rëndësishme të Perëndimit Për këtë do t'i shërbente edhe ndërtimi i një rruge të gjerë, që nisej nga Egjypti dhe kalonte gjatë bregdetit të Afrikës Veriore nëpër Kirenë drejt Kartagjenës, si dhe hapja e puseve dhe kantiereve në largësi të caktuara.

Në Ektabanë Aleksandri ishte shumë i zënë me hollësitë e projekteve të tij dhe me qeverisjen e perandorisë së tij vigane. Megjithato, ai gjeti kohë ta transformonte jetën e oborrit të tij dhe ndërtesën e komandës së përgjithshme luftarake e ktheu në qendër kulture. Afro 3000 aktorë e artistë u grumbulluan në

Ektabanë. Ai nuk kishte më nevojë të dehej me verë, vetë jeta ishte bërë për të një dehje e pafund. Punët i shkonin mbarë dhe ai kishte shpresë që brenda pak vitesh të bëhej i zoti i botës. Gjysma më e rëndësishme e saj ishte në duart e tij dhe ai sapo kishte festuar datëlindjen e tij të 32-të. Ushtria maqedone sërish ishte lidhur pas tij me dashuri e besë dhe fama e tij ishte rritur kudo. Në mbretërinë persiane sundonte paqja. Athërë papritmas u përplas përmbi të katastrofa që ia dërmoi fare lumturinë dhe i kujtoi se një njeri i llojit dionisian duhej të pësonte shumë vuajtje dhe dhimbje, deri sa në fund të mbetej i vetmuar. Një mëngjesi kah fundi i verës, kur Aleksandri ishte i pranishëm në lojërat në stadium, i erdhi lajmi se Hefestioni ishte sëmurë rëndë. Kishte një javë që miku i tij ishte me ethe, por ai nuk ishte bërë merak për të, pasi mendonte se fajin e kishte një darkë që kishte ngrënë e pirë pa masë. Një ditë më parë mjeku i Hefestionit, Glauku, që kishte shkuar për të parë lojërat, i tha mbretit se i sëmuri nuk ishte dhe aq keq. Por në mungesë të tij, Hefestioni kishte ndjerë uri dhe kishte kërkuar t'i sillnin një racion të madh mish pule. E kishte ngrënë duke e shoqëruar me verë, sa ishte bërë shumë keq. Duket se e gjithë kjo ngjau jashtë qytetit. Kur Leka vrapoi te shtrati i të sëmurit, miku i tij sapo kishte vdekur. Pikëllimi i Aleksandrit qe i pamasë. Ai ra pranë trupit të pajetë, e pushtoi ndër krah, qau dhe rënkoi tërë ditën dhe gjithë natën. Të nesërmen në mëngjes shokët e larguan me forcë nga kufoma. Gjatë ditës së nesërme dhe gjatë natës u shtri pothuajse vazhdimisht në dysheme, qau dhe i ngulte sytë para vetes i përhumbur. Kur më së fundi kufomën e Hefestionit e nxorën nga shtëpia, ai ngau karrocën e të vdekurit. Kur u kthye në pallat, nuk njihej. Sytë i xixëllonin të egër dhe të trembur, ishte prishur në fytyrë, flokët e prerë fare shkurt i qenë ngatërruar, kurse nëpër mollëzat e zbehta i rridhnin rrëke lotët dhe rrobat i kishte të ndyra.. Nëse e humbi ndonjëherë arsyen, kjo ndodhi këto tri ditë të tmerrshme. Kur u kthye në pallat, mori masat e nevojshme për një zi të përgjithshme dhe për ceremoninë e varrimit. Muzika dhe kënga u ndaluan, urdhëroi t'u prisnin jelet dhe bishtat e kuajve. Përveç kësaj, Leka dha urdhër që në të

gjithë perandorinë të zbatoheshin me përpikëri ritet e zisë. Kufomën ai e dërgoi në Babiloni, ku ishte ndërtuar një përmendore varri madhështore. Është e vështirë të thuhet se përse ai zgjodhi Babiloninë, si vend të prehjes së fundit të mikut të tij, por duket se ky qytet do të bëhej kryeqyteti i perandorisë së gjerë aziatike, pra as Suza, as Ektabana. Kështu, shpirti i Hefestionit duhet të sillej sipër Lindjes, ndërsa vetë Aleksandri do të kthehej kah Perëndimi. Faraonët e vjetër të Egjiptit kishin secili nga dy a tre varre, njërin për trupin e të tjerët për shpirtin. Prandaj Leka dha urdhër që në Aleksandrinë e Egjiptit, që do të ishte kryeqytet i pjesës perëndimore të perandorisë, të ngriheshin dy përmendore, njëra te ishulli i Farit, tjetra brenda në qytetin e Aleksandrisë.

Vetëm në fillim të dimrit përfundoi koha e zisë. Deri atëherë Aleksandri e kishte marrë veten, sa gjatë rrugës për në Babiloni ndërmori një fushatë gjashtëjavëshe kundër popullit të Kosaias, një regjioni në veriperëndim të Suzës. Kur në fillim të shkurtit të vitit 328 p. e. s. erdhi në afërsi të Babilonisë i dolën përpara të deleguar fisesh e popujsh të ndryshëm që ende nuk ishin nënshtruar. Ata kishin frikë nga ndonjë sulm i papritur kundër tyre. Nga Afrika erdhën të deleguarit e Kartagjenës, përfaqësuesit e Etiopisë, të Saharasë, nga Europa Perëndimore erdhën galët dhe iberët, nga Veriu erdhën skitët, nga Italia erdhën brutët, etruskët dhe, siç thonë, edhe romakët. Romakët në atë kohë ishin popull i fuqishëm, ishin dalluar në një luftë të rreptë me fqinjët e tyre, në luftën e dytë samnitike. Nuk ka dyshim se edhe ata kishin frikë prej pushtuesit maqedon. Duket se e gjithë Italia e pështpëriste emrin e tij me ankth dhe priste kur Aleksandri do t'i drejtonte hapat nga ajo.

Në kufi të Babilonisë e arriti një përfaqësi e priftërinjve që, duke njohur prirjet e tij nga bestytnitë, e këshilluan të mos hynte në qyet, sepse orakulli i perëndisë së tyre, i Belit, kishte parafolur për këtë rast një fatkeqësi. Por, mbreti e mendoi këtë paralajmërim si një grackë që donte ta pengonte për të parë me sytë e tij porosinë e dhënë për ndërtimin e tempullit të Belit dhe të shihte se sa keq ia përmbushnin dëshirat. Prandaj, Aleksandri

nuk e përfilli fare paralajmërimin dhe u recitoi priftërinjve një varg nga Euripidi, ku thuhej se profeti më i mirë është ai burrë që e parashikon deri-diku drejt të ardhmen. Ndoshta ai me këtë donte të thoshte se e ndiente vdekjen e parakohshme dhe që me zhdukjen e Hefestionit, ai po e shihte se po i afrohej fundi. A nuk kishte qenë edhe Hefestioni "gjithashtu Aleksandër". As Akili nuk kishte jetuar gjatë, pas vdekjes së mikut të tij, Patroklit. Për më tepër, Aleksandrit i kishte ardhur edhe një lajm tjetër ndjellakeqës verën e kaluar. Një oficer i quajtur Apolodor, i cili komandonte garnizonin maqedon të Babilonisë dhe që ia kishte varur shumë detyrës, kishte dërguar fjalë të pyeste orakullin përmes vëllait të tij, për të marrë vesh nëse do t'i shpëtonte zemërimit të Hefestionit, me që ai ishte nën urdhërat e tij. Pitagora, vëllau i Apolodorit, gjatë hulumtimit zbuloi se ai e kishte mëlçinë të sëmurë, shenjë e keqe për Hefestionin. Prandaj nuk kishte për të pasur frikë se dukej qartë se ai do të vdiste tamam pas dy-tre ditësh pas vdekjes së Hefestionit. Atëherë Apolodori e luti përsëri të vëllanë të gjurmonte sërish nëse do të ndiqej nga Aleksandri. Edhe kësaj here flija e kishte mëlçinë të sëmurë. Apolodori dhe Pitagora u tronditën prej përsëritjes të së njëjtës shenjë ogurzezë, ndaj vendosën t'ia tregonin atë edhe Aleksandrit. Kur dëgjoi tregimin e tyre, ky i falenderoi që ia zbuluan të vërtetën. Pas vdekjes së Hefestionit dukej se ai më nuk kishte asnjë joshje për jetën.

Pak kohë pasi kishte arritur në Babiloni, erdhi prej Maqedonisë Kasandri, djali i Antipatrit. Ai ishte dërguar nga mëkëmbësi te mbreti për ta mbrojtur atë edhe veten nga akuzat e disa armiqve. Ditën e parë, ndërsa po hanin drekë, Kasandri u shkri duke qeshur, kur pa se si uleshin përdhe përpara mbretit fisnikët persianë. Kjo pamje për të ishte krejtësisht e papritur dhe e huaj. Aleksandri i dehur tapë u ngrit i zemëruar, e kapi Kasandrin për flokësh dhe e përplasi në mur. Pak kohë më vonë, kur mbretit i doli pija, Kasandri përfitoi nga rasti për të mbrojtur Antipatrin nga paditë e kundërshtarëve të tij, por Leka e ndërpreu dhe e pyeti me tallje: "A kujton se këta njerëz do të kishin marrë gjithë këtë rrugë, sikur yt atë do të kishte vepruar

drejt?" Kasandri ia ktheu: "Vet fakti që ata janë larguar kaq shumë prej Maqedonisë, ku njeriu mund të vërtetonte padrejtësinë e padive të ngritura, flet kundër tyre". Aleksandri ia preu fjalën në gojë me një lëvizje të dorës dhe e cilësoi këtë si sofizëm aristotelik, dëshmi që na provon se sa pak e çmonte këtë filozof. Mandej e paralajmëroi Kasandrin duke e kërcënuar atë dhe babanë e tij me dënime të rënda, po qe se do të vërtetohej faji i tyre. Ai i foli aq i egërsuar, saqë Kasandri u llahtaris.

Në fillim të prillit Leka u bë përsëri i zoti i vetvetes dhe u interesua për zbatimin e planeve të tij. E dinte se koha që i mbetej për të jetuar ishte e shkurtër dhe se ai kishte shumë gjëra për të bërë. Me guxim dhe vrull i hyri punës, por kishte edhe një parandjenjë, sikur armiqtë qiellorë dhe tokësorë do t'i përgatisnin vdekjen e parakohëshme. Thonë se ai ishte shqetësuar nga mendimi i fuqive të mbinatyrshme dhe nga pabesia e rrethit të tij më të ngushtë. Oborri i tij ishte përplot priftërinj, astrologë dhe njerëz të tjerë të ditur. Ai ishte gjithnjë i gatshëm të besonte në një ogur të mirë ose të keq. Aleksandri kishte urdhëruar të ndërtoheshin edhe një numër tjetër anijesh në mbështetje të Nearkut. Porositi të ndërtonin një kantier për ndërtimin e anijeve edhe në Babiloni. Gjithashtu, për një qarkullim të vazhdueshëm të anijeve të luftës dhe transportit të mallrave ai përgatiti kolonizimin e tërë bregdetit persian nga Eufrati e deri në Ind. Ndërkohë zbuloi se Deti i Kuq nuk ishte det i mbyllur, por vetëm një pjesë e Oqeanit të Jashtëm. Ai besonte se brenda një kohë të shkurtër do të mund të krijonte rrugë ndërlidhjeje me të dhe të bënte qarkullimin e rregullt përmes Indisë dhe viseve rreth Suezit të sotëm në Egjipt.

Pasi u largua nga Babilonia, Aleksandri bëri udhëtim të gjatë zbulimi nëpër kanalet dhe liqenet në afërsi të derdhjes së Eufratit. Qëllimi i tij ishte të përmirësonte ujitjen e vendit dhe rrjedhat e ujërave. Kur në prill u kthye në qytet, ishte në gjendje shpirtërore shumë të mirë. Interesat e tij të shumanshme e ndihmuan ta kalonte çdo mërzi dhe derisa profecitë rreth vdekjes së tij të parakohshme nuk po vërtetoheshin, atij sërish iu ngjall shpresa se do të mund ta vinte në jetë planin e tij për

pushtimin e botës. Moralin ia ngrinte mjaft Roksana e bukur, e cila priste të bëhej nënë. Ndoshta edhe Barcina me djalin e saj, Heraklitin, gjendeshin pranë tij. Straboni shkruan se pas vdekjes së Lekës dhe lindjes së Roksanës, fëmijtë e tij u kthyen në Maqedoni.

Aleksandri me entuziazmin e tij iu përvesh riorganizimit të ushtrisë që do të qëndronte në Orient. Afro 20 000 rekrutë të rinj persianë të stërvitur nga Peukastasi u grumbulluan në qytet për t'i inspektuar mbreti. Pas pak erdhën regjimente të tjera nga Azia e Vogël dhe nga vise të ndryshme të perandorisë. Trupat aziatikë nuk mbaheshin më të veçuara praj maqedonëve, por ishin të organizuar në njësi të përziera. Që kur doli çështja e Lindjes, falanga maqedone pushoi së ekzistuari.

Pjesën tjetër të muajit Aleksandri u mor vetëm me kurbane e me të pira, së paku kështu na tregon Plutarku. Kjo jetë, çuditërisht e dyfishtë, e cila u kushtohej sa fuqive të padukshme aq edhe të pirit me miqtë e tij, na vë në dukje fazën e re të qejfit për punë dhe të vrullit veprues të Lekës. Të gjitha planet e tij për ekspeditën e madhe përqark botës rreth Afrikës dhe kthimi prapa nëpër udhën e Gjibraltarit për në Kartagjenë, i kishte përgatitur deri në imtësi dhe që kur Hefestioni, si shpirt i dashur, përkujdesej për mbarëvajtjen e punëve të mikut, i ishte mbushur mendja më shumë se kurrë për suksesin e veprës që kishte në plan. Natyrisht, ai nuk kishte përfytyrime të sakta rreth madhësisë së Afrikës dhe mendonte se kufijtë e saj gjendeshin ndër viset që ne sot i quajmë Sudan. Largësitë në hapësirë nuk kishin luajtur kurrë rol as në rininë dhe as në vrullin e tij të veprimit. Ai kishte bërë rrugë, që kur u nis nga Pela, kryeqendra e Maqedonisë, më shumë se 32 000 km.

Në atë kohë Babilonia ishte qendër tregtie jashtëzakonisht e gjallë. Rrugët e saj ishin mbushur plot me tregtarë dhe detarë. Të gjithë flisnin për ekspeditën e ardhshme, përgatitjet e së cilës në ndërkohë kishin marrë fund. Kudo që takoheshin burrat, menjëherë niste biseda rreth pushtimit të ardhshëm të gjysmës së dytë të botës. Aleksandri ishte shpirtërisht shumë mirë, siç ndodhte gjithnjë para nisjes për fushatë luftarake të re. Disa ditë

më vonë Leka bëri therori shumorëshe hyjnive dhe, pasi pyeti orakullin, u shtroi gosti të madhe lamtumire Nearkut dhe oficerëve të lartë. Darka kaloi shumë mirë. Kur natën vonë Leka deshi të shtrihej, një thesalas i quajtur Medios e ftoi të shkonte në shtëpinë e tij dhe atje të vazhdonin pijen me pak miq të zgjedhur. Mbreti e pranoi ftesën dhe ndenji te Mediosi deri në të zbardhur. Pastaj shkoi e fjeti tërë ditën. Në darkën e 2 qershorit shkoi përsëri në shtëpinë e Medios për ta gëdhirë rishtas duke ngrënë e duke pirë. Nuk u mjaftua me kaq, por u dha të ftuarve nga një kupë të madhe e kërkoi ta pinin me fund. Tregojnë se prej kësaj kupe ai piu një gëllënkë me një frymë, saqë e zuri gjumi përpara se ta mbaronte kupën. Pasojat e kësaj pije të tepruar bënë që të kishte dhembje të forta në kurriz. Megjithëse e ndiente se i kishin hipur ethet, ai bëri banjë, hëngri diçka dhe urdhëroi që mbi një vig ta mbartnin përjashta. Sapo të lindte dielli do t'u flijonte perëndive, detyrë së cilës rrallë i ishte shmangur, madje edhe kur dehja e fortë ia kishte mpirë gjymtyrët. Pastaj orët e nxehta të ditës i kaloi duke fjetur në një sallë të freskët ngrënieje. Në muzg të datës 3 qershor kërkoi ta sillnin te lumi dhe ta nxirrnin deri në bregun përtej. Atje do të priste në një pavion brenda lulishteve mbretërore që t'i dilte pija. Të nesërmen në mëngjesin e 4 qershori e ndjeu veten më mirë, përsëri bëri banjë dhe mori pjesë në veprimet e therorit. Gjatë ditës bisedoi me Mediosin dhe luajti zare me të. Oficerëve u dërgoi urdhër që të nesërmen të mblidheshin te ai. E ndiente veten mirë dhe në mbrëmje hëngri darkë të bollshme. Pas këtij veprimi të pamend përsëri i hipi zjarrmia dhe kaloi një natë të keqe. Nuk dihet me saktësi karakteri i sëmundjes së tij.

Megjithëse ndihej i dobët më 5 qershor, herët në mëngjes bëri banjën e zakonshme dhe flijimet për perënditë. Pastaj thirri Nearkun dhe i dha direktivat që ta mbante flotën të gatshme për luftim më datën 8 qershor. Edhe data 6 qershor kaloi si ditën e mëparshme me banjën dhe me therorë, megjithëse ishte mjaft i sëmurë. Përsëri e thirri Nearkun, që t'i mbushej mendja se të gjitha përgatitjet ishin kryer. Anijet i kishin ngarkuar me furnizime të shumta, ekuipazhet qenë të gjitha në vendet e tyre

dhe trupat në gatishmëri për të marshuar. Përsëri në darkë Aleksandri bëri banjë që t'i zbriste zjarrminë, por u bë më keq dhe tërë natën u përpëlit nga dhimbjet. Megjithatë, më 7 qershor kreu ritualin e përditshëm, por nuk ishte më në gjendje të bënte asnjë hap, duhej ta bartnin të tjerët. Në të vërtetë ai foli me shumë oficerë, por ishte në kllapi. Mbretin e sëmurë për vdekje e bartën në një pavion tjetër afër shatërvanit, në lulishten mbretërore, sepse ishte më freskët.

Të nesërmen e mëngjesit të 8 qershorit dha urdhërin përkatës për shtyrjen e nisjes së flotës. Gjatë ditës e rikthyen në pallat, dhomat e brendshme të të cilit ishin më pak të ekspozuara ndaj nxehtësisë së diellit, se sa shtëpitë e vogla të verës buzë lumit. Me urdhër të mbretit të gjithë oficerët e rojës duhej të qëndronin vazhdimisht në vendet e tyre. Ishte dobësuar aq shumë, sa nuk mund të komunikonte as me rrethin e tij më të afërt. Kështu vazhdoi deri në mëngjesin e datës 12 qershor, kur u përhap fjala se kishte vdekur. Ngjarjen e trishtueshme donin t'ia fshihnin ushtrisë. Prandaj, shumë oficerë u grumbulluan te shtabi dhe kërkuan ta shikonin edhe njëherë me sytë e tyre. Ata u lejuan që të parakalonin me ngadalë para shtratit të të sëmurit. Aleksandri kishte ardhur në vete dhe mundohej me zor të përshëndeste miqtë e tij me një lëvizje të dobët të dorës apo me një shenjë të kokës. Nuk fliste, meqë nuk kishte fuqi, por edhe pa fjalë bashkëluftëtarët e vjetër e kuptuan dhe të tronditur i pëshpërisnin: "Lamtumirë!"

Gati tërë ditën e nesërme mbreti përsëri ishte pa ndjenja. Thonë se në një çast vetëdijeje i dorëzoi vulën mbretërore Perdikës, njërit prej gjeneralëve të tij më të besuar, por nuk u mor vesh përgjigjja se kush duhet ta pasonte në fron. Kur dielli i datës 13 qershor u zhduk në horizont, në vitin e trembëdhjetë të mbretërimit të tij, në moshën 33- vjeçare, Aleksandri i Madh dha shpirt. Pas vdekjes së tij pati ngjarje të tmerrshme. Roksana, e cila gjithnjë kishte qenë ziliqare për Statirën, nusen persiane mbretërore të Aleksandrit, kurdisi vrasjen e saj dhe të motrës, të vesë të Hefestionit. Kufomat u hodhën në pus. Nëna mbretëreshë, Sisygambis, e pushtuar nga dhimbja dhe hidhërimi,

nuk pranoi asnjë ushqim dhe brenda pesë ditësh vdiq. Kur u mbushën ditët Roksana lindi një djalë që e quajti Aleksandër. Ai së bashku me djalin e Filipit, Arrhidaios, më në fund, trashëguan së bashku fronin. Disa vjet më vonë Olimpia shpalli se Aleksandrin e kishte helmuar Antipatri me ndihmën e birit të tij, Kasandrit. Ajo e pranoi Roksanën dhe birin e saj dhe urdhëroi që të vrisnin Arrhidaiosin bashkë me nusen e tij. Me një urrejtje të zjarrtë luftoi Kasandrin dhe ndjekësit e tij, derisa edhe atë e vranë. Pastaj i mbytën të gjithë me radhë: Roksanën me të birin, Aleksandrin dhe Barcinën me të birin Heraklitin (Herkulin). Në luftë për pushtet së fundi vdiq nga një vdekje e panatyrshme edhe motra e Aleksandrit, Kleopatra.

Ndërkohë, gjeneralët më të fortë e ndanë perandorinë midis tyre. Ptolemeu kërkoi Egjiptin. Ai mori me vete edhe kufomën e Aleksandrit dhe e çoi në tokën e Nilit. Këtë veprim e përligji me dëshirën e shfaqur nga vet Leka, për ta varrosur në oazin e Sivës, në tempullin e babait të tij, Amonit. Por, përfundimisht ai u vendos në një mauzoleum në Aleksandri, në qytetin e ri të bregdetit egjiptian. Këtu u preh kufoma e tij deri në kohën e Perandorisë Romake.

14. Kthimi nga India dhe vdekja e Aleksandrit

Trupat e Lekës së Madh morën udhën për në atdhe, së kaluari përmes qyteteve që kishin pushtuar duke kontrolluar qeveritë që kishin vendosur aty, duke bërë riorganizimet e nevojshme dhe duke zëvendësuar disa nëpunës, të cilët ishin korruptuar gjatë mungesës së gjatë të Aleksandrit. Në këtë kohë, kur ai po projektonte pushtimin e Kartagjenës, u sëmur rëndë nga ethet e malaries në Babiloni (Iraku i sotëm). Udhëtimi i gjatë e i vështirë i kthimit nga India e bëri të veten edhe në shëndetin e Aleksandrit.

Ishte mëngjesi i 3 qershorit të vitit 323 p. e. s., kur Aleksandri ndjeu se kishte zjarrmi të brendshme. Pasi bëri një banjë ai u shtri përsëri në gjumë. Kur u zgjua, thirri të gjithë

gjeneralët për planin e betejës, por pa se vet ai ishte i pamundur. Për disa ditë ai rënkoi në shtrat nga temperatura e lartë dhe më 13 qershor vdiq në moshën 33-vjeçare.

Mbreti i Maqedonisë që kishte mposhtur në fillim Greqinë dhe i kishte marrë emrin nuk mundi të realizonte ëndrrën e tij për të pushtuar tërë botën. Ai për dhjetë vjet pushtoi pjesën më të madhe të botës, ndërsa stërgjyshi i tij, Akili, me aleatët e tij iu deshën dhjetë vite për të mposhtur trojanët me dredhi. Aleksandri i Madh ka mbetur në kujtesë me rininë e përhershme, si stërgjyshi dhe idhulli i tij, Akili. Burrat që kanë bërë historinë në vitet e mëvonshme, si Pirroja - Burri i Epirit, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, Napoleoni arbëresh, Perandori i Francës dhe shumë të tjerë e patën Aleksandrin e Madh të Maqedonisë pellazgo-ilire si shembull të tyre.

Shqiptarët kanë të drejtë të krenohen me këtë hero legjendar. Ai në flamurin e Maqedonisë mbante shqiponjën dykrenare, të cilën e mbanin edhe epirotët dhe ilirët. Deri më sot vlerësohet si njeriu që ka patur pasurinë më të madhe të botës. Ai shkeli tre kontinente dhe mbasi u kthye nga India, kishte dëshirë të bashkonte Evropën, Azinë dhe pjesën veriore të Afrikës në një shtet të vetëm.

Siç del nga ky studim, Aleksandri dhe shumë heronj të kohës antike ishin pellazgë dhe ilirë, pra shqiptarë. Sot intelektualët, studiuesit dhe politikanët shqiptarë duhet të mbrojnë trashëgiminë e tyre të lashtë pellazgjike-ilire nga mosprivatizimi i kombeve të tjerë që nuk kanë heronj trashëgimtarë të historisë antike, kombe, të cilët sot janë futur në garë për të fituar privatizimin e tyre të historisë sonë pellazgo-ilire bashkë me heronjtë e tyre trima e legjendarë. Nga gjiri i kombit shqiptar kanë dalë burra që udhëhoqën shtetet, si Francën, Rumaninë, Greqinë, Turqinë, Italinë etj. Xhuzepe Garibaldi, Napoleon Bonoparti, Qemal Ataturk e shumë burra të tjerë lindën nga prindër shqiptarë.

Leka ka qenë i martuar me disa princesha të territoreve të pushtuara persiane, me Roksanën nga Bactria, me Statirën, të bijën e Darit III të Persisë dhe Parisatisin, të bijën e Okusit. Ka

qenë baba i dy djemve: Heraklitit, të lindur me konkubinën e tij Barcinën dhe Aleksandrit IV të Maqedonisë, të lindur me Roksanën, menjëherë pas vdekjes së tij më 324 para erës sonë.

Aleksandri vdiq, por mbeti gjallë emri, vepra dhe legjenda e tij. Lavdia e tij herë ndriçon e herë errëson të kaluarën, të tashmen dhe të ardhshmen e njerëzimit, edhe 2343 vjet pas vdekjes së tij. Asnjë figurë e madhe e historisë botërore nuk mund të barazohet me Lekën e Madh.

15.Vdekja e Aleksandrit të Madh
(Rrëfimi i historianit grek, Arrian)

Ishte maji i vitit 323 p.e.s. dhe Aleksandri i Madh ndodhej në Bagdad. Mbreti 32-vjeçar i Maqedonisë i kish kaluar 13 vitet e fundit duke pushtuar pjesën më të madhe të botës së njohur dhe kish krijuar një perandori që shtrihej nga Maqedonia, përmes Greqisë dhe perandorisë persiane, deri në skajet e Indisë. Ai kish plane të zgjeronte perandorinë e tij, por këto ëndrra nuk do të realizoheshin asnjëherë.

Fushata e Aleksandrit për dominim kish nisur kur ai kapërceu Helespontin për të pushtuar perandorinë persiane. Pas fitoreve të njëpasnjëshme, Aleksandri marshoi në drejtim të lindjes, në zonën në perëndim dhe veri të Indisë. Ai asgjësoi këdo që sfidonte autoritetin e tij dhe do të kish shtrirë mbretërimin në Indi, nëse ushtria e tij nuk do ta kish zhgënjyer duke e detyruar të braktiste planin për vazhdimin e marshimit drejt lindjes.

Tani që ish rikthyer në Bagdad pas disa vite fushata ushtarake, Aleksandri përfitoi nga rasti për të pushuar dhe planifikuar pushtimin e ardhshëm. Më 29 maj ai mori pjesë në një darkë të shtruar nga një mik i ngushtë. Pasi piu disa gota, ai u largua duke thënë se nuk ndihej mirë. Shëndeti i mbretit u përkeqësua në mënyrë të vazhdueshme teksa ethet i pushtuan gjithë trupin. Më në fund, shumë i dobët për të lënë shtratin, pushtuesi i botës vdiq dhjetë ditë pasi e mbërtheu sëmundja. Shkaku i vërtetë i vdekjes nuk dihet, historianët kanë debatuar

prej shekujsh për këtë gjë, duke ia vënë fajin helmimit, malaries, etheve të tifos etj.

Dëshmia

Kjo dëshmi për vdekjen e Aleksandrit u shkrua nga historiani grek, Arrian. Ndonëse jo një bashkëkohës i Aleksandrit, Arriani e shkroi rrëfimin e tij tek vepra "**Ditarë mbretërorë** - ***kronika bashkëkohëse të fushatës së Aleksandrit***": "... Pak ditë më vonë Aleksandri kish bërë flijimet për hyjnitë dhe ish shtruar me të pirë deri natën vonë me disa miq. Disa thonë se ai dëshironte të largohej nga festa dhe të shkonte në shtrat, por më pas u takua me Mediusin, një prej miqve të tij më të besuar dhe ai i kërkoi të shkonin në një festë, ku i premtoi se do të ishte me të vërtetë e mirë.

Dita e parë

Ditarët mbretërorë na tregojnë se ai kish pirë dhe ish dehur bashkë me Mediusin. Më pas u ngrit, bëri banjë dhe shkoji të fle. Më vonë Aleksandri u rikthye të hajë darkë me Mediusin dhe sërish piu deri natën vonë. Duke lënë të tjerët të pijnë, ai bëri sërish një banjë, hëngri diçka dhe më pas shkoi të fle. Ethet tashmë e kishin zënë.

Dita e dytë

Çdo ditë ai merrej dhe të tjerë e ulnin në kolltukun e tij për të kryer flitë e zakonshme dhe, pas përfundimit të tyre, ai qëndronte në apartamentet e burrave deri në muzg. Gjatë kësaj kohe u jepte udhëzime oficerëve të tij për ekspeditën e radhës dhe udhëtimet në det, për forcat tokësore që të ishin të gatshme të lëviznin në ditën e katërt dhe për ata që do të lundronin me të të bëheshin gati për t'u nisur një ditë më vonë. Prej aty bashkë me kolltukun ai transportohej drejt lumit, ku hipte në një varkë dhe lundronte përgjatë kopshtit ku qëndronte sërish pasi bënte banjë.

Dita e tretë

Ai bëri sërish banjë dhe kreu flijimet e parashikuara. Më pas ai hyri në dhomën e tij, u shtri dhe nisi të flasë me Mediusin. Pasi urdhëroi oficerët ta takojnë në mëngjes, hëngri shumë pak

ushqim. I dërguar sërish në dhomën e tij, ai qëndroi aty i shtrirë me ethe të vazhdueshme dhe temperaturë gjatë gjithë natës.

Dita e katërt

Në mëngjes ai bëri banjë dhe flijimet. Nearkusi dhe oficerët e tjerë u udhëzuan të përgatiteshin për lundrim dy ditë më vonë.

Dita e pestë

Ditën tjetër, ai bëri sërish banjë dhe flijimin e përhershëm dhe, pasi i kreu, mbeti sërish i shtrirë me ethe që nuk pushonin. Por, pavarësisht kësaj, thirri sërish oficerët dhe i urdhëroi të bëjnë çdo gjë gati përpara udhëtimit. Pas një banje në mbrëmje, ai ishte tashmë shumë, shumë i sëmurë.

Dita e gjashtë

Ditën tjetër, ndonëse në një gjendje shumë të rëndë, pas banjës dhe sakrificave, Aleksandri thirri edhe një herë oficerët e tij për të dhënë udhëzimet e reja para udhëtimit.

Dita e shtatë

Ditën tjetër me vështrësi e transportuan për të bërë flijimet dhe vazhdoi të japë urdhëra për udhëtimin te oficerët e tij.

Dita e tetë

Ditën tjetër, ndonëse shumë i dobët, ai arriti të bëjë flijimet për perënditë. U kërkoi gjeneralëve të qëndrojnë aty pranë me brigadierët dhe kolonelët përpara dyerve. Tashmë jashtëzakonisht shumë i sëmurë, ai u mor sërish nga kopshtet për në apartamentet mbretërore. Teksa oficerët hynin brenda, ai i njihte shumë mirë, por nuk u thoshte asnjë fjalë.

Dita e nëntë dhe e dhjetë

Kishte një temperaturë shumë të lartë atë natë; po kështu ditën tjetër. Deri sa erdhi fundi. Ky informacion vjen nga ditarët mbretërorë, ku mësojmë gjithashtu se ushtarët donin ta shihnin, disa shpresonin që ta takonin përpara se të vdiste dhe të tjerë për arsye se ishin përhapur zëra që ai kishte vdekur tashmë dhe ata hamendësonin se vdekja e tij mbahej e fshehtë nga garda personale. Shumë hynë me forcë në dhomë, të pushtuar nga dhimbja dhe me dëshirën për të parë Aleksandrin. Thonë se ai mbeti pa gojë teksa ushtria i kalonte para syve. Megjithatë, mirëpriti secilin prej tyre me një lëvizje të kokës apo të syve.

Ditarët mbretërorë thonë se Peitoni, Atalusi, Demofoni, Peukestasi, Kleomenesi, Menidasi dhe Seleukusi kalonin natën në tempullin e Serapisit dhe pyesnin perëndinë nëse do të ishte më mirë sikur Aleksandri të sillej vetë në tempull dhe të lutej për shërimin e tij. Nga Zoti erdhi një përgjigje se ai nuk duhej sjellë në tempull dhe se do të ishte më mirë për të të qëndronte atje ku ishte. Shoqëruesit sollën këtë lajm, dhe vetëm pas pak çastesh Aleksandri vdiq, sepse kjo ishte më e mira. Ky është fundi i rrëfimit që ofrojnë Aritobulosi dhe Ptolemeu".

16.Aleksandri i Madh vdiq nga konsumi i tepërt i verës

Toksikologët dhe ekspertët e historisë antike të Universitetit të Otagos në Zelandën e Re kanë kryer një studim bashkë me Universitetin e Birmingemit mbi shkakun e vdekjes se Aleksandrit të Madh. Për vite me radhë janë hedhur hipoteza të ndryshme për vdekjen misterioze të Aleksandrit të Madh në vitin 323 para erës së re. Një grup studiuesish pretendojnë se do të zbardhin misterin historik. Ata thonë se dashuria për verën i ka sjellë fundin tragjik perandorit 32-vjeçar që kishte mposhtur persianët e fuqishëm dhe kishte pushtuar gjysmën e botës në 13 vitet e fundit të jetës së tij.

Sipas studimit të ri, të publikuar në revistën "Clinical Toxicology", përgjatë banketeve të shumta të tij në Babiloni, Aleksandri, pasi kishte konsumuar sasi të mëdha alkooli, kishte pirë verë që përmbante një substancë toksike të nxjerrë nga një lule e bardhë, që përdorej në antikitet me doza të vogla me besimin se dëbonte demonët nga trupi, duke shkaktuar teshtitje dhe të vjella. Ekspertët arritën në përfundimin se është pikërisht vera shkaktarja e vdekjes së parakohëshme të Aleksandrit të Madh.

17.Tri porositë e Aleksandrit të Madh

Pasi kishte nënshtruar shumë mbretëri, Aleksandri i madh po kthehej në vendin e tij. Gjatë rrugës u sëmur rëndë, sëmundje

që e çoi në shtratin e vdekjes. Ndërsa e ndjente vdekjen e tij si dikush që nuk ia shqiste sytë, Aleksandri kuptoi se të gjitha fitoret e tij, ushtria e tij madhështore, shpata e tij e mprehtë dhe gjithë pasuria nuk vlenin më tashmë asgjë.

E kishte marrë malli për shtëpinë dhe mezi priste të shikonte fytyrën e nënës së tij dhe t'i jepte lamtumirën. Por, duhet të pranonte faktin e hidhur se shëndeti i tij, që po fundosej çdo ditë, nuk do ta lejonte të arrinte në atdhe. Kështu, fitimtari madhështor ra përmbys dhe i alivanosur, duke pritur i pashpresë të jepte frymën e tij të fundit. Thirri gjeneralët e tij dhe u tha: ***"Shumë shpejt do të largohem nga kjo botë. Kam tre amanete, ju lutem a mund t'i çoni në vend?"***

Me lotët që u rridhnin nëpër faqe, gjeneralët ranë dakord të betoheshin për të mbajtur dëshirat e fundit të mbretit.

1.*"Amaneti im* i parë *është*, - tha Aleksandri, *– që arkivolin tim ta mbajnë vetëm mjekët e mi".*

Pasi pushoi pak, ai vazhdoi:

2.**"Së dyti,** *dua që kur arkivoli im të transportohet për në varr, rruga që çon deri në varrezë të shtrohet me arin, argjendin dhe gurët e çmuar që unë kam mbledhur në thesarin tim."*

Mbreti u ndje i rraskapitur, pasi tha këtë. U çlodh për pak dhe vazhdoi:

3.*"Dëshira* e tretë *është, që duart e mia të lihen të varura jashtë arkivolit".*

Njerëzit e mbledhur rreth tij u habitën me dëshirat e çuditshme të mbretit, por askush nuk guxoi të bënte zë apo ta pyeste. Gjenerali që e kishte më për zemër iu afrua, i puthi dorën dhe ia shtrëngoi fort afër zemrës. ***"O mbret, të japim fjalën se të gjitha këto dëshira të tua do të plotësohen. Por, të lutem, më thuaj pse këto dëshira kaq të çuditshme?"***. Duke dëgjuar këtë, Aleksandri mori frymë thellë dhe tha: ***"Dua që bota të dëgjojë 3 mësimet që kam mësuar:***

- Dua që arkivoli im të mbahet vetëm nga mjekët, në mënyrë që gjithë populli të mësojë se asnjë mjek mbi dhe nuk mund të shërojë asnjë përgjithmonë. Ata janë të pafuqishëm

dhe nuk mund të shpëtojnë asnjë njeri nga kthetrat e vdekjes. Prandaj, asnjë njeri të mos e marrë jetën për të mirëqenë.

- Dëshira e dytë e shtruarjes së rrugës me ar, argjend dhe gurë të çmuar, është për t'i treguar popullit se as edhe një grimcë ari nuk do të vijë me mua atje poshtë në varr. Harxhova gjithë jetën time i shtyrë nga lakmia për pushtet dhe etja për pasuri, por nuk mund të marr asgjë me vete. Le ta marrin vesh njerëzit se të rendësh pas pasurisë nuk është gjë tjetër, veçse humbje kohe.

- Dhe për sa i përket dëshirës sime të fundit, që duart e mi të varen jashtë arkivolit, dua që njerëzit të dinë se duarbosh erdha në këtë botë dhe duarbosh po iki."

Me këto fjalë mbreti mbylli sytë. S'kaloi shumë dhe ai e la vdekjen ta mposhtë, duke dhënë frymën e tij të fundit. Ai njihet nga të gjithë si Aleksandri i Madh, si njeriu që pushtoi shumë mbretëri, si një emër i madh në historinë e botës.

18.Ku gjendet varri i Aleksandrit të Madh?

Perdika i kishte ndërtuar një sarkofag dhe e kishte mështjellur me një mbulojë të dyfishtë prej ari dhe donte ta dërgonte trupin e tij ende të ngrohtë në Maqedoni, por ndodhi diçka e papritur...

Trupin e tij e kërkonin tani edhe gjeneralë të tjerë, Ptolemeu Soter, i biri i Lagosit, dëshironte të bëhej faraoni i Egjyptit, ndaj ai donte ta varrosë trupin e tij në Aleksandri. Pas një beteje të ashpër mes katër udhëheqësve të mbretërisë së Aleksandrit, më në fund fiton Ptolemeu, i cili e dërgon sarkofagun në Aleksandri dhe më vonë Ptolemeu II, i biri i tij, e varros në një tempull në Aleksandri në vitin 280 p.e.s., por më vonë, Ptolemeu IV e ndërton një mauzole të stilit maqedon, në një dhomë prej albatri, të ngritur mbi një tumul prej gurve, si ato që u gjetën në Vergina gjatë vitit 1978.

Gjatë vitit 89 p. e. s. Ptolemeu X e zëvendëson arin dhe e vendos trupin e Aleksandrit në një sarkofag prej albatri të tejdukshëm që e shohim pastaj edhe sipas dëshmisë së Strabonit,

i cili e vizitoi varrin e Aleksandrit aty kah viti 20 p.e.s. Edhe Jul Qesari e viziton në vitin 48 p. e. s, pas tij edhe Oktavian Augusti në vitin 30 p. e. s., bile Augusti shkon më tej; për simpatinë ndaj Aleksandrit ai e nxjerr trupin e tij që ishte në sarkofagun prej albatri dhe ia vendos mbi kokën e tij një kurorë prej ari. Mirëpo e dëmton shumë trupin e tij që deri këtu ishte i ruajtur mirë. Sipas të dhënave të Flavius Jozefit, edhe Kleopatra e famshme e kishte hapur këtë sarkofag për t'i marrë disa gjësende prej ari.

Sipas Seutonit, perandori Kaligula kishte vjedhur xhamadanin e famshëm të Aleksandrit, kurse Karakala ia kishte vjedhur xhaketën e purpurt, unazën dhe rrypin në vitin 215 të erës sonë.

Në vitin 365, pas një vërshimi të madh, u dëmtua tërë Aleksandria dhe me këtë rast edhe Mauzoleu i Aleksandrit të Madh. Që prej kësaj kohe e deri sot, arkeologë e amatorë nga e tërë bota e kërkojnë varrin e Aleksandrit, por pa sukses.

"Një varr i mjafton atij, për të cilin bota nuk ishte e mjaftueshme", është epitafi i Aleksandrit të Madh, mbretit të Maqedonisë dhe pushtuesit të madh që sundoi botën.

19. Statutet e Shkodrës apo "Testamenti" i Lekës së Madh

Zbulimi arkivor, surprizë e studiueses italiane, Luçia Nadin

Zbulimi i Statuteve të Qytet-Komunës Republikane të Shkodrës të shek XIV-XV dhe brenda tyre i një lloj "Testamenti" me privilegje të Aleksandrit të Madh, akorduar disa popujve të gadishullit tonë "me gjuhë të përafërt", na jep mundësinë të shprehim disa mendime. Bëhet fjalë për librin "Statuti di Scutari"(della prima metà del secolo XIV con le addizioni fino al 1469, a cura di Lucia Nadin, giugno 2002, Roma).

Fillimisht do të ishte me interes që lexuesi të njihet konkretisht me tekstin që po e citojmë sipas përkthimit shqip:

"PRIVILEGIUM ALEXANDRI MAGNI MACEDONIS EX GRECO ORIGINALI TRADUCTUM"

Unë Aleksandri, bir i Filipit, mbretit të Maqedonasve, mishërim i Monarkisë, krijues i Perandorisë Greke, bir i Zeusit të madh, bashkëbisedues i Brahmanëve dhe i Pemëve, i Diellit dhe i Hënës, triumfues mbi mbretëritë e Persëve e të Medëve, Zot i botës prej ku lind dhe deri ku perëndon dielli, nga veriu në jug, pinjoll i farës së shquar të popujve Ilirikë të Dalmacisë, Liburnisë, dhe të popujve të tjerë të së njëjtës gjuhë që popullojnë Danubin dhe zonën qëndrore të Thrakës, u sjell dashurinë, paqen dhe përshëndetjet e mia dhe të të gjithë atyre që do të më ndjekin në sundimin e botës. Duke qenë se ju gjithmonë më jeni treguar të besës dhe të fortë e të pathyeshëm në betejat e bëra krah meje, u jap e u dorëzoj juve në zotërim të lirë gjithë hapësirën prej Akuilonit e deri në skaj të Italisë së jugut. Askush tjetër veç jush, të mos guxojë të vendoset e të qëndrojë në ato vende, dhe po u gjet ndonjë i huaj, ai do të mund të qëndrojë vetëm si skllavi juaj, dhe pasardhësit e tij do të jenë skllevër të pasardhësve tuaj.

U shkrua në kështjellën e qytetit të Aleksandrisë, themeluar prej meje buzë lumit madhështor të Nilit, në vitin XII. Me vullnet të perëndive që nderohen në mbretëritë e mia, Zeusit, Marsit, Plutonit dhe Minervës, perëndisë së perëndive. Dëshmitarë të këtij akti janë Atleti, logotheti im, dhe njëmbëdhjetë princë të tjerë, të cilët unë po i emëroj si trashëgimtarë të mi dhe të të gjithë botës, meqenëse po vdes pa lënë pasardhës.

***

Në lidhje me këtë dokument të cilësuar si apokrif, që është një kopjim me dorë i shek. XV nga një tekst në latinisht, i cili pretendohet se ishte përkthyer nga një "ish origjinal greqisht", konsideratat e para janë shprehur se kemi të bëjmë me një lloj falsifikimi, të një kohe të papërcaktuar ende.

Ne na rezulton se kemi të bëjmë me një njohës ekspert të burimeve antike dhe nuk e përjashtojmë që formulimi ka pasur edhe ndonjë bazë reale. Nga formulimi i tekstit bindemi plotësisht se aty kemi një lloj akti testamentar kolektiv të kohës

dhe tipit të natyrës skllavopronare dhe jo të një kohe feudale. Në ndihmë vjen edhe vërejtja se aty nuk ka asnjë lloj prezence e as pretendimi të sferës sllavojugore. Gjithsesi, këto "privilegje të një akti testamentar" duhet të jenë shfrytëzuar për pjesën kohore kur i hynin në punë komunitetit e më pas Komunës Qytetare Republikane mesjetare të Shkodrës. Në këtë arsyetim ndonjë premisë na çon së paku në një kronologji aty rreth shek XI. Kështu, nuk mund të mohohet se "Privilegjet dhe Testamenti", kanë shërbyer si një lloj preambule e dëshmie për të treguar lashtësinë dhe ligjshmërinë e të drejtës së pronësisë autoktone etj. Qytetarët shkodranë mund ta kenë shfrytëzuar, për t'u mbrojtur, për të ruajtur e konfirmuar autonomitë e privilegjet e tyre përballë okupatorëve sllavojugorë dhe përgjithsisht nga feudalët.

"Privilegjet dhe Testamenti" janë pasuar pastaj me të drejta dhe privilegje të reja qytetare, siç i gjejmë nga disa gjurmë të ish "Statuteve antike" para këtij Statuti mesjetar, të cilat janë përforcuar edhe me dekrete të akorduara nga perandorët bizantinë.

"Privelegjet" dhe "Testamenti", edhe sikur t'i marrim në minimumin e vlerës së tyre, na tregojnë se kemi një lloj dokumentimi për të hetuar vetëdijen e hershme të brendshme të atyre popullsive autoktone që e pretendonin trashëgiminë e lavdishme të Filipit II dhe gruas së tij epirote, Olimpisë, të Aleksandrit të Madh, Aleksandrit Molos e Pirros së Epirit.

***

Shkenca historike moderne e ilirologjisë, e albanologjisë dhe e shqiptarologjisë nuk ka mundur t'i evidentojë me siguri të plotë shkencore lidhjet fisnore, zakonore, etnografike, gjuhësore etj, si një proces të lidhur dhe të avancuar etnosi ndërmjet fiseve të afirmuara ilire, epirote, albane, dardane, dalmate, liburne, maqedone, trake, tribale…, etj. Këto fise, edhe pse kufitare, helenët të gjithë i konsideronin "si barbarë", pra që nuk ishin inkuadruar në etnosin grek.

Në plan të parë nga teksti i Shkodrës, sigurisht na vjen ajo deklarata e kushërinisë farefisnore, pastaj ajo e gjuhës së njejtë ose së paku të përafërt dhe, në fund vetëdija e një autoktonie të thellë gadishullore. Sipas mitologjisë së lashtë të Gadishullit Pellazgjiko-Ilirik, bazileusi me emrin **Maqedon** ishte bir i Zeusit dhe Etrisë.

Maqedoni u martua me një vajzë vendëse dhe kështu i lindën dy fëmijë: Pierja dhe Emathi, që tek Homeri në "Iliada" na dalin si emra toponime të dy krahinave të Maqedonisë. "Dhe Hera fluturim…kaloi mbi Pierje dhe u hodh mbi fushat pjellore të Emathjes".

Homeri përmend edhe një nimfë detare me emrin Amathia.

Një paraqitje interesante, bazuar në autorë më të hershëm, na jep Straboni: ***"Maqedonia kufizohet nga perëndimi me bregdetin e Adrias…dhe arrin në lindje deri në Thesalonik… Maqedonia më përpara quhej Emathia. Emrin e mori nga një udhëheqës i vjetër që quhej Maqedon. Ishte edhe qyteti me emrin Emathia, afër detit. Këtë vend e sundonin disa nga fiset epirote dhe ilire…".***

Është shumë e qartë dhe logjike se një pjesë nga kjo ish-krahina homerike, Emathia, ruhet me krahinën e sotme të Matit tonë, ku kemi edhe lumin homonim Mati dhe në grykëderdhjen e tij në buzëdet edhe fushën Breg-Matia. Në brendësinë e kësaj krahine, së paku qysh nga konstatimi mesjetar, hyn edhe një mikrokrahinë e quajtur Maqellarë (me një ndërhyrje të sufiksit turk "llarë"). Mund ta supozojmë se në bregdetin e Adrias(Adriatikut), diku matanë Kepit të Rodonit, duhet të ketë qenë edhe qyteti, për të cilin nuk ka ndonjë lloj hetimi nga arkeologjia jonë. Vërejtja që bën Straboni për mbi një ndërthurje e kontestim të një zone adriatike midis ilirëve dhe maqedonëve, rezulton te disa autorë antikë.

Sipas Pompe Trogut në shek. I p. e. s. (në kompilimin e Justinit të shek II) dhe gjeografit K. Ptolemeu të shek II:...***edhe fisi i albanojve e qyteti Albanopolis radhiteshin midis fiseve e territoreve maqedone etj.***

Ndonjë nga autorët antikë mendonte se Emathia ishte emri më i lashtë i Maqedonisë.

Sipas sa shkruhet në dokumentin e cituar të Shkodrës, rezulton se popullsitë gadishullore ilirike që përmenden shprehimisht dhe ato që nënkuptohen, ishin të lidhura me një unitet e interes reciprok me Aleksandrin e Madh. Do të ishte jologjike të mendohej se perandoria e Aleksandrit të Madh me atë shtrirje gjigante të mos e kishte zotëruar bregdetin Adriatik. Pra, shtrirja e maqedonëve, si liderë mbi gadidhullin tonë, nuk duhet parë thjesht e vetëm tek pushtimet direkte maqedone, por si një aleancë mbarëgadishullore e më gjerë. Popullsitë ilire ishin kontribuese e bashkëpjestare të atij pushtimi më të madh botëror dhe të realizuar gjithashtu në një kohë rekorde.

Aleksandri pati rastin t'i njihte Ilirët dhe gjuhën e tyre direkt dhe kjo tregon se "afërsia e të njëjtës gjuhë" e tekstit të Shkodrës e ka një bazament, së paku logjik. Aleksandri gjithashtu e konstatoi vet në betejat kundër ilirëve në vitin 335 p. e. s. se ishte pothuajse e pamundur që t'i nënështronte nën zgjedhë "ilirët kryelartë", prandaj ishte më mirë t'i kishte aleatë. Në vitin 337 p. e. s. që të mbrohej nga një zemërim i Filipit, Olimpia iku në Epir, ndërsa vet Aleksandri shkoi te mbreti i Ilirisë.

Me mendimin në kokë të një fushate europiane kundër Azisë, fillimisht kundër Persisë, Aleksandri nxitonte të formonte aleancën gadishullore europiane dhe të mos linte vatra të rrezikshme "prapa shpine" dhe kështu dalngadalë: ***"tribalët, ilirët dhe fise të tjera të pavarura që jetonin buzë Istrit (Danubit) ...të gjithë thanë se kishin ardhur të kërkonin miqësi me Aleksandrin. Të gjithë ata lidhën me të miqësi".***

Siç e shohim, pra e kemi edhe të shkruar në burimet antike atë shtrirje aleance dhe dhënie bese nga Epiri te Iliria e deri në Danub, të cilin e nxjerr në evidencë teksti i Shkodrës. Detyrimisht të gjitha këto do të kondicionoheshin edhe nga hiseja në privelegje tokësore, në pagesat me ar e argjend etj. Ja se si pasqyrohet kjo në betejën kundër Darit të Persisë: ***"Aleksandri vizitoi gjithë ushtrinë dhe popujve të ndryshëm iu drejtua me***

fjalë të ndryshme. Ilirët dhe trakët i nxiti me pasuritë e mëdha të persëve…".

Qysh në kohën e Filipit II, siç duket, maqedonët e fuqizuar e zgjeruan prezencën e tyre mbi hapësirën detare adriatike dhe kjo është arësyeja që athinasi, oratori i famshëm, Demosteni, i shqetësuar jep alarmin: ***"Filipi po fortifikon qytete në Iliri".***

Në këtë vijë është logjike edhe një vazhdimësi prezence ndërtimtare dhe fortifikuese nga Filipi te Aleksandri i Madh. Këtu ne tentojmë ta fusim Shkodrën. Por, duhet të kemi parasysh edhe pohimin që kishte bërë para 500 vjetëve M. Barleti, i cili shkruante: ***"...Tashti pra, thonë disa të huaj se Shkodrën e paska themeluar Aleksandri i Madh, por ky pohim nuk duhet pranuar, sepse Shkodra ka ekzistuar shumë kohë më përpara se të lindte Aleksandri i Madh; por edhe vet turqit muhamendanë shkojnë me këtë mendim, sepse qytetin e Shkodrës në gjuhën e tyre e quajnë Skanderie(Iskenderie) dhe ky emërtim, sipas tyre, është i njejtë me emrin Aleksandrie…".***

Kjo vërejtje shumë e drejtë e Barletit lidhet me kohën e ekzistencës së Skodrinon-it si një qytezë(peripolis), ku ai e përjashton Aleksandrin e Madh nga "themelimi i parë-aedificationem", të cilin ai e fut lashtë në mjegullën mitologjike. Ndërkaq, rezulton se nuk e ka përjashtuar Aleksandrin e Madh nga ndonjë ish-prezencë ndërtimtare e rifortifikuese e më vonshme e shek IV p. e. r.

Dihet se në hapësirën mesdhetare e më gjerë Aleksandri i Madh u dha emrin e vet shumë qyteteve antike, ku disa prej tyre nuk ishin themeluar nga ai dhe natyrisht, i kishin emrat e tyre të parë. Deri më sot ne nuk kemi asnjë farë pikëmbështetje nga burimet e shkruara antike dhe ato arkeologjike që të hedhim së paku ndonjë lloj hipoteze që Skodrinon-i ishte quajtur edhe me ndonjë emërtim të dyzuar, si Aleksandri. Ne dimë vetëm se Shkodra qysh nga shek. XV filloi të mbante edhe një emërtim të dytë(Iskenderie-Aleksandri). Gjithashtu dimë se më herët qe bërë edhe njëfarë barazimi midis Scutarisë bizantine dhe Scutarit(Shkodrës) mesjetare etj.

Në "Testamentin dhe privilegjet" e tekstit të Shkodrës pamë se na del drejtpërdrejt kulti i njeriut "perëndi" të Aleksandrit si "biri i Zeusit"**.** Ta ilustrojmë e ta krahasojmë pak këtë me disa nga literaturat antike të njohura, për të parë edhe se çfarë roli kishte luajtur ky kult në ekspansionin gjigant territorial të Aleksandrit të Madh.

Te **Lukiani i shek. II** gjejmë shumë informata interesante: ***"Filipi: – Tani, pra, o Aleksandër, s'mund të thuash që s'je djali im, se, po të ishe i Zeusit, nuk do të kishe vdekur.***

Aleksandri: - ...e pranova titullin, pasi m'u duk se më hynte në punë..., barbarët u tmerruan duke kujtuar se isha perëndi...

Filipi: - ...Me të vërtetë kush nuk do të qeshte, po të shihte të birin e Zeusit të hiqte shpirt dhe të kërkonte ndihmën e mjekëve?..."

Në këto dialogje gjejmë edhe njëlloj episodi, ku një pjesë e madhe nga toka italike konsiderohej si e nënështruar me vullnetin e saj ndaj Aleksandrit të Madh. Aleksandri shfajësohej ndaj Filipit për kritikat që i ishin bërë: ***"Më qorton se unë u drejtova kundër Lindjes, mbasi s'i dhashë rëndësi të madhe Perëndimit. Po ç'të bëja në Perëndim, kur mund të kisha pushtuar pa luftë Italinë, Libinë dhe gjithë viset deri në Gadire?*** (qyteti Kadiks në Spanjë, afër Gjibraltarit) ***S'e gjeta të udhës të luftoja me popujt e atjeshëm, pasi këta u trembën dhe më njohën për Zot të tyre".***

Duke pasur parasysh këtë mundësi, mund të merret në konsideratë ideja e privilegjeve skllavopronare, që u jepen aleatëve gadishullorë në bregdetin adriatik italik nga Akuiloni në veri e deri poshtë Otrantos në jug.

Diodori i Sicilisë (shek. I p. e. s.), na informon: ***"Filipi II, mbreti i maqedonëve, i mundi ilirët në një betejë të madhe dhe më pas vuri nën zotërimin e tij gjith banorët gjer në liqenin Lyhnid dhe u kthye në Maqedoni. Ai bëri me ilirët një paqe fitimtare...u lëshua mbi Ilirinë, me një ushtri të fortë...nënshtroi shumë fortesa...".***

Diodori jep edhe këtë informatë mjaft të rëndësishme: ***"Në atë vit (324 p. e. r.) erdhën në Babiloni të deleguar pothuajse nga e gjithë bota. Një palë përgëzonin mbretin Aleksandrin e Madh për fitoret e tij, të tjerët i ofronin kurora, shumë ndër ta i sillnin dhurata të çmueshme, disa lidhnin me të marrëveshje miqësie e aleanca… Të gjithë popujt, qytetet e sundimtarët e Azisë i paraqitën atij homazhe. Erdhën shumë dinastë nga Europa…nga Libia …Kartaga e krejt popujve …deri te Shtyllat e Herakliut. Përsa i përket përfaqësuesve të Europës, këtu dalloheshin ata të qyteteve helene, të Maqedonisë, të Ilirisë dhe të një pjese të madhe të bregdetit të Adriatikut...ata të popujve të Trakisë…"***

Në këtë pohim i shohim qytetet ilire dhe ato të bregdetit Adriatik si përfaqësues të denjë e të radhës së parë të Evropës. Këtu pra, kemi përsëri një hapësirë ku mund t'a radhisim edhe qytetin Skodrinon(Skodreinon), i cili në monedhat e tij të shek.. III-II p. e. s. na paraqitet edhe me trajtën Drinon(Dreinon).

Duke pasur parasysh edhe datimin e vitit 324 p. e. s. me 325 p. e. s. të "Privilegjeve e Testamentit" dhe 323 p. e. s. të vdekjes së Aleksandrit në Babiloni, shihet qartë se përpiluesi ka qenë i mirëinformuar me burimet e shkruara antike dhe ka vepruar me kujdes për t'u paraqitur sa më i besueshëm. Mirëpo, dihet se edhe burimet e shkruara antike përmbajnë pasaktësi historike. Në tekstin e Shkodrës thuhet se ky dokument ishte përpiluar në Aleksandri në vitin 325 p. e. s. dhe se ishte aprovuar nga Aleksandri personalisht. Në dukje të parë kjo do të krijonte idenë sikur në atë vit edhe Aleksandri ndodhej në Aleksandri, gjë që realisht nuk duket të ketë qenë ashtu. Për ta kapërcyer disi këtë lëshim historik, duhet menduar se dokumentet madhore përpiloheshin në Aleksandri dhe për aprovimet përfundimtare i dërgoheshin Aleksandrit me korrierë, sepse dihet që ky sistem komunikimi me stacione të njëpasnjëshme ka funksionuar. Sipas disa autorëve antikë, Aleksandri i Madh vdiq 33 vjeç (po aq edhe Jezus Krishti) në Babiloni.

Adjutanti i tij, Ptolemeu, i kishte dhënë premtime se do t'ia dërgonte kufomën në Aleksandri të Egjiptit, ku do të adhurohej si një nga hyjnitë e Egjiptit etj. ***"Qysh në vegjëli e ëma, Olimpia***

nga Epiri, e ushqeu Aleksandrin me gjithfarë bestytnish. Si ato gratë e hershme të basileuave homerikë, ajo përhapi legjendën se e kishte ngjizur Aleksandrin, jo duke u mbarsur me Filipin II, por me një lloj "ore të hyjnishme", me një lloj gjarpëri bollë a dragua, si një vullnet e metamorfizim i vetë Zeusit".

Lukiani jep sqarime edhe për një lloj bolle të butë natyrale, që pinte qumësht gjiri, që luante me fëmijë etj. Legjendën e gjarprit si "babai i Aleksandrit" e përmendin edhe autorët antikë si Plutarku e Tit Livi.

*"**Zeusi kishte gjithfarë paraqitjesh të metamorfizuara, si dem dybrinoç me brirë të artë, si cjap, si dash, si gjarpër, si mjellmë etj. Në këto imitime edhe Aleksandri pati "suksese" dhe, sipas Lukianit, Aleksandrin e kishin futur me gjallje edhe ndër "12 perënditë" politeiste më të rëndësishme, kishin ndërtuar edhe faltore ku bënin flijime për të etj."**.*

Ne theksojmë këtu se paraqitja e Aleksandrit në disa literatura si politeist i pastër ose si një monoteist i pastër, nuk është korrekte. Aleksandri i Madh synonte drejt një feje të re botërore, ku ai do të ishte protagonisti, biri i perëndisë Zeus ose si biri i Amonit. Siç e shohim të qartë edhe nga teksti i Shkodrës, ky bir Zoti tenton të shtrihet në mbarë botën e njohur. Këtë reformë ai kërkoi ta realizonte nga lart, me mashtrimin si "bir Perëndie", me kompromise e bashkëbisedime, mbështetur edhe në forcën dhe madhështinë e pushtimeve. Aq në zenit ia ngritën, por edhe e vetngriti Aleksandri i Madh kultin e **"Njeriut-Perëndi"**, sa filloi të përhapej edhe një lloj legjende se ai ishte i pavdekshëm. Një skulptor madje propozoi që një kreshtë të malit të Olimpit ta gdhendnin me fytyrën e Aleksandrit.

Njihet se helenët qysh heret bënë identifikime, përafrime e krahasime të disa perëndive të tyre me ato egjiptiane etj. Në rastin e Aleksandrit ne shohim se dy nga "kryeperënditë" politeiste janë afruar. Pra, kemi edhe një hap të madh më përpara në evolucionin tokësor drejt kalimit në monoteizëm. Ky kalim bëhet jo direkt nga kryezotërit e vjetër të ekipeve politeiste, por nga një "bir" i ri reformator. Në këtë ide Aleksandri bëri edhe kompromise e përshtatje, duke ***"hedhur poshtë klamidën***

maqedone e duke veshur kandin e tiarën persiane e orientale". (Lukiani, f 258), apo kur ***"hoqi dorë nga zakonet e të parëve dhe zuri të imitonte medët".***

Në mënyrë shumë interesante, te teksti ynë i Shkodrës e gjejmë Aleksandrin me pushtetin më të madh qiellor e tokësor, si **"biri i Zeusit",** si **"Zoti(Pronari) tokësor në të katër koordinatat gjeografike të tokës"** dhe si **"bashkëbiseduesi me brahmanët e pemët"**, që shkon në përputhje të plotë me thënien e Lukianit, me gojën e Aleksandrit: ***"desha të sundoja të gjithë Tokën".***

Shqiponjë, padyshim ai quante Aleksandrin e Madh dhe zogjtë e saj, popullin arbër, epirot e maqedon.

Teksti i Shkodrës rihap një diskutim mjaft interesant në lidhje me fillim-kohën e ndarjes së trashëgimisë dhe atë "Testamentin" e pretenduar nga Aleksandri i Madh. Sipas burimeve antike, që shkruanin mbi historinë e Aleksandrit të Madh dhe sipas interpretimeve moderne, nuk kemi pohime rreth ndonjë lloj "Testamenti" të shkruar apo të ndonjë lloj ndarjeje zotërimesh para vdekjes së tij. Historishkruesit antikë vazhdimisht na konfirmojnë pjesëmarrjen e ilirëve në pushtimet e Aleksandrit të Madh, çka për rrjedhojë e normalisht Aleksandri duhej t'i rradhiste e llogariste edhe ata në ndonjë ndarje eventuale.

Historiani romak, **Rufi,** shkruante: ***"Në fillim të pranverës së vitit 334 p. e. s. Aleksandri kaloi në Azi me një ushtri më të fortë nga guximi, se sa nga numri. Parmenioni udhëhiqte tridhjetëmijë këmbësorë maqedonë, pesë mijë grekë dhe pjesa tjetër ishin nga ata që i kishin dërguar aleatët për këtë luftë. Ilirët, trakët e tribalët vinin pas tyre me pesë mijë njerëz dhe, veç këtyre, kishte edhe një mijë shigjetarë agrianë...***

Kur Aleksandri sapo kishte vdekur (323 p.e.r.), mësojmë për një grindje të madhe për ndarjen e zotërimeve nga një numër i madh komandantësh veteranë së bashku me bijtë e tyre, grindje që shtrihet edhe midis reparteve të ndryshme, veçanërisht midis kalorësve dhe këmbësorëve. Ne duhet të mendojmë se "kazani po ziente" dhe kësisoj hapet supozimi se më 325 p. e. s. Aleksandri mund t'i ketë paraprirë kësaj situate, me atë ndarjen

midis 12 trashëgimtarëve. (Kjo shkon edhe në përputhje me 12 apostujt e Jezusit!) Duhet nënvizuar se në vitin 325 p. e. s. Aleksandri nuk kishte akoma një pasardhës trashëgimtar mashkull ose femër dhe, prandaj ky as nuk përmendet në tekstin e Shkodrës, që do të thotë se formulimi ishte nga Aleksandri i Madh. Sipas burimeve antike që shkruanin mbi historinë e Aleksandrit të Madh dhe sipas interpretimeve moderne, nuk kemi pohime rreth ndonjë lloj "Testamenti" të shkruar apo të ndonjë lloj ndarje zotërimesh gjatë jetës së tij. Historishkruesit antikë vazhdimisht na konfirmojnë pjesëmarrjen e ilirëve në pushtimet e Aleksandrit të Madh, çka për rrjedhojë normalisht Aleksandri duhej t'i radhiste e llogariste edhe ata në ndonjë ndarje eventuale.

Sapo ishim njohur mirë me këtë tekst "apokrif" të Shkodrës, që ka pretendimin si datim vitin 325 p. e. s., neve na shkoi mendja për një krahasim te "Libri i parë i makabenjve" - Bibla e Vjetër, fq. 1311, 1, 1: ***"Pasi Aleksandri, biri i Filipit, maqedonas, që më parë mbretëroi në Greqi, doli nga dheu Ketim e goditi Darin, mbretin e persianëve dhe të medëve, ndërmori shumë luftëra, pushtoi qyteza dhe i vrau mbretërit vendës, atëherë arriti deri në skajin e tokës e pushtoi shumë popuj. Toka mbarë heshti para tij, iu rrit mendja e zemra iu mbush me krenari. Bashkoi një ushtri tejet të fortë, nënshtroi krahina, popuj e princa e i bëri t'i paguajnë të dhjetat e vartësisë. U sëmur dhe e pa se po vdiste. I thirri oficerët e vet, bujarët që kishin qenë rritur bashkë me të që në moshën e re dhe, ndërsa ishte ende gjallë, ua ndau mbretërinë e vet. Aleksandri vdiq pasi kishte mbretëruar 12 vjet. Oficerët e morën pushtetin secili në krahinën e vet. Pas vdekjes së tij të gjithë u kurorëzuan, kështu edhe bijtë e tyre pas tyre gjatë vjetëve vijues. Kështu u shumëzuan të këqiat mbi tokë.***

Përkthyesi, komentuesi dhe shpjeguesi i këtij citimi e thekson se ky shkrim ka karakterin historik, pra nuk kemi të bëjmë me ndonjë lloj "parashikimi" dhe në shënimet (1, 1-9; 1; 3) shkruan dhe ripërsërit, duke e nxjerrë jo të saktë tekstin e Makabeut: ***"Leka s'e ndau në shtratin e vdekjes perandorinë, por***

ajo vetëvetiu shkoi duke u shkatërruar e ndarë nga oficerët e tij që e okupuan pushtetin me forcë".

Ky komentim, me njohuritë që njiheshin deri më 1994 të botimit shqip të Biblës, ishte i pranueshëm, por tashti që ai shkon edhe në përputhje me tekstin e Shkodrës, mund të bëhet disi i diskutueshëm. Komentuesi e ka theksuar atë që nuk e thekson as vet kapitulli biblik: ***"Aleksandri nisi ta mbajë veten për hyjni"*** dhe për këtë na rekomandon një shembull tjetër te "Profecia e Ezekielit", fq. 28, 2.5:

"Biri i njeriut, thuaj princit të Tirit:
Kështu thotë Zoti Hyj:
Pasi mendja t'u rrit e the:
"Unë jam hyjni,
rri mbi fronin e zotave,
në kërthizën e detit!",
megjithse je njeri e jo hyj…
Ja, po qenke më i mençur se Danieli…
Do të vdesësh…
Vallë a do të thuash më:
"Jam Hyj"?…

Grindjet dhe ndarjet ishin në kulm, kur trupi pa jetë i Aleksandrit (qershor 323 p. e. s.) qëndronte akoma në një sallë të madhe, ku e kishin vendosur që të ishte, si të thuash, edhe dëshmitar i vendimeve dhe marrëveshjeve të ushtarakëve. Tashti ne informohemi se një pjesë pranuan mendimin e Perdikës që të pritej lindja nga shtatzania e Roksanës, gruas së Aleksandrit të Madh dhe, po qe se ishte mashkull, atij t'i caktoheshin disa tutorë, si Leonati, Perdika, Krateri dhe Antipatri etj, e me atë rast u bënë edhe betimet përkatëse.

Burimet kanë treguar se në rrugë gjatë fushatës në lindje, diku andej nga Afganistani, Aleksandri u dashurua dhe u martua me një vajzë që quhej Roksana. Ndërkaq, çuditërisht, nuk kishte pasur informacione as për ndonjë shtatzëni të saj, as nëse vet Aleksandri kishte pasur dijeni dhe as për ndonjë lloj

testamenti të mundshëm ndaj këtij trashëgimtari të pritshëm! Normalisht, Roksana duhej të kishte ngelur shtatzënë me Aleksandrin, ndoshta aty nga fundi i vitit 324 p. e. s. ose përgjatë vitit 323 p. e. s. Burimet na tregojnë se ajo ndërkohë ishte dërguar në Maqedoni.

Kontradiktat e brendshme e kishin dobësuar perandorinë gjigante, por vdekja natyrore e "birit të pavdekshëm të Zeusit" shkaktoi një tronditje të menjëheshme dhe kontradiktat shpërthyen haptazi. Ndaj propozimeve të Perdikës u rebeluan këmbësorët. Ata caktuan si mbret Adrideun, vëllanë e Aleksandrit nga një grua tjetër e Filipit, por duke i lënë edhe trashëgimtarit të Aleksandrit, të supozuar mashkull, "një copë nga pjesa e shtetit"! Në krye të Maqedonisë e Greqisë vendoset Antipatri, babai i Kasandrit, (krahaso: Antipatrea, ish emri i Beratit) e pasuar pastaj me një listë të gjatë ndarjesh të provincave, ku vërehen edhe disa nga udhëheqësit e vjetër me të bijtë e tre. **Atje shohim se ilirit Pito i ka takuar Media e Madhe (Persia e sotme)**. Kjo është një copë e madhe, çka edhe tregon se Aleksandri e ka mbajtur fjalën ndaj ilirëve.

Pas pak muajsh (nuk përcaktohet se sa) burimet tregojnë se Roksana, e dërguar në Maqedoni, ka lindur trashëgimtarin mashkull **Aleksandrin e Ri**, të cilit si regjent kryesor fillimisht i ishte caktuar Polyperku, i pasuar me një numër regjencash të tjera. Tashti mësojmë për fillimin e peripecive të Olimpisë dhe Roksanës me Aleksandrin e Ri, nën përndjekjet e Kasandrit.

Në vitin 317 p. e. s., gjashtë vjet pas vdekjes së Aleksandrit, Olimpia si mjeshtre e komploteve, e vret mbretin Adrideun dhe gruan e tij Euridikën dhe merr qeverisjen. Një vit më pas, më 316 p.e.s., Kasandri, biri i Antipatrit, i martuar me Thesalonikën bijën e Adrideut dhe Euridikës, arrin ta vrasë Olimpinë, kurse Roksanën dhe Aleksandrin e Ri i internon nën vërejtje në kështjellën e Amfilopolit. Vetëm pasi kanë ndodhur gjithë këto ngjarje e pasi kanë kaluar disa vite, ne informohemi edhe për kalimin, nga ajo ish-ndarja e madhe kaotike, në katër pjesë ku dominojnë: Kasandri, Lisimaku, Seleuku e Ptolemeu.

Konstatojmë se "parashikuesi" biblik, Danieli, nuk është ndalur në këtë vorbull ngjarjesh e personash dhe nuk na jep ndonjë informacion "me parashikime brirësh" për mbretin Adrideu(ose Arideu) dhe as për çështjen e Roksanës e Aleksandrit të Ri trashëgimtar, "birin e të birit të Zeusit", por ka kapërcyer direkt te "katër brirët". Informacione për ato nuk jep as Makabeu, i cili megjithatë nuk i ka përfillur fare "brirët e shenjtë". Por, ç'ndodhi me Aleksandrin e Ri dhe Roksanën? Ç'gjë dhe arsye të pazakontë kishte Kasandri dhe ndjekësit e tij ndaj këtij trashëgimtari që duhet t'i takonte legjitimiteti?! Mos ndoshta Olimpia kishte sajuar ndonjë lloj "ngjizje hyjnore" edhe për Roksanën, apo se kohëlindja e Roksanës shkaktoi dyshime?! "Mjegulla e Bunës mbi Rozafat" nuk na lejon të shohim. Ajo që dimë, është se Aleksandri i Madh nuk e përmbushi porosinë e të parëve të tij për t'u varrosur në varrin e në tokën atërore dhe, prandaj dinastia nga gjaku i tij u shua. Këtë e kishte "parashikuar" edhe orakulli politeist i Delfit, megjithëse me kohë i kishte dalë nami për ato përgjigjet "parashikuese" me dy e tre kuptime.

Aleksandri i Madh me të vërtetë ishte edhe një "pinjoll i farës së shquar të popujve ilirikë të së njejtës gjuhë". Ai e provoi të ishte një reformator si "Biri i kryezotit Zeus me Olimpinë tokësore në Tokë", por megjithatë ai nuk ishte vetë kryezoti politeist e as zoti monoteist.

Do të vinte edhe koha monoteiste kur "Biri i Perëndisë e njëkohësisht vet Ati(Perëndia) dhe Shpirti i Shenjtë" do të na prezantohen me Jezu Krishtin, ashtu si një lloj klonimi hyjnor, po qe se do t'a përshtatnim termin me shkencën e arritjet moderne të inxhinierisë gjenetike. Ndërsa "mbarësia me hyjnorë" e nuseve dhe e virgjëreshave tokësore dhe e pjelljes së tyre me binjakë e trinjakë nuk ishte ndonjë gjë e re, triniteti ngjalli shumë kundërshtime në interpretimet e ndryshme të sekteve.

Akoma edhe kur u shkrua Kur'an-i i Shenjtë i britur nga Qielli prej engjëllit Xhibril (Xhebrail), nuk konceptohet dot monoperëndia si "tri perëndi në një" dhe, gjithashtu kundërshtohet prerazi, sepse **Perëndia-Zoti-All'llahu** nuk mund

të kishte një fëmijë, megjithë theksimin se s'ka asnjë gjë që nuk mund ta arrijë All'llahu, mjaft që ai ta bëjë në mendim dhe t'i thotë: ***Bëhu!*** Kur'an-i e pranon ngjizjen në mitrën e virgjëreshës Mejreme/Maria(pa i prekur cipën e virgjërisë) me idenë(mendimin) e frymën e All'llahut. E pranon Jezusin(Isanë) si pejgamber, si të ngjitur tek All'llahu, madje edhe si një bashkbisedues e dialogues i tij atje në hapësirat ndëryjore. Por, Kur'an-i i Shenjtë dhe vetë All'llahu i Madh absolutisht nuk e pranojnë atësinë e ligjshme për Jezusin sipas koncepteve vullgare politeiste e tokësore.

Amësia e Aleksandrit ishte tokësore, po ashtu edhe ajo e Jezusit, por ndryshimi qëndron se te Olimpia, jo virgjëreshë, kemi "një kontakt direkt seksual fizik me farë/spermë gjarpëri të mirë, si metamorfizim i Zeusit", ndërsa tek e martuara Maria, megjithatë virgjëreshë, nuk kemi asnjë lloj kontakti seksual fizik, por vetëm një vetëngjizje e llojit të hemafroditizmit me idenë(mendimin) e Zotit nga një hapësirë ndëryjore.

Olimpia, "njëra nga të përzgjedhurat e kryezotit politeist, Zeusit", ishte grua kriminele e gënjeshtare, e aftë t'ia vinte "brirët e turpit" burrit Filip dhe "brirët e Zeusit pellazgjik" të birit Aleksandër. Ajo madje e nxiti vrasjen e burrit të saj me vrasësin e paguar, Pausanin, të cilin e gozhdoi në një kryq druri, duke i vënë në kokë një kurorë të artë. Përkundrazi, Maria e urtë, e ndershme dhe e butë, e përzgjedhura e mono-zotit, nuk i la asnjë turp Jozefit, burrit legjitim dhe të aftë tokësor. Birin e saj dhe të vetëm hyjnor të Zotit, zotin Krisht, njerëzit e kryqëzuan dhe i vunë në kokë një kurorë ferrash!

Monoperëndisë kristiane parimisht nuk do t'i lejohej më asnjë lloj kontakti seksual i drejpërdrejtë me engjëllushat qiellore, me murgeshat e gratë tokësore, e për më tepër në kristianizëm nuk do të ketë më asnjë lloj ngjizjeje tjetër ndërhyjnore si ai me Marien(Mejremen). Monozoti kristian riprodhon një fëmijë mashkull vetëm një herë në infinit kohën, ndërsa monozoti islam nuk ka absolutisht asnjë të tillë në infinit kohën e megjithatë thuhet se ata janë një i njëjti.

Mund të themi se me kohë gradualisht në hapësirat e feve të mëdha monoteiste zhduket kujtimi i brirëve, megjithë ndonjë mbetje të vogël simbolike aty-këtu. Tashmë vetëm dreqi, djalli, satana, shejtani, demoni na paraqiten me brirë, si një simbolizim i djallëzisë dhe i mençurisë në sensin e keq.

Në botën njerëzore përpjekja e Aleksandrit "me një bri të mrekullueshëm cjapi" që imitonte Zeusin me mitologjinë e dhisë amalteze në një shpellë të Kretës, megjithëse siguroi dy vende në "Besëlidhjen e Vjetër" nuk e kaloi klasën për në "Besëlidhjen e Re", as së paku si ndonjë i dërguar, pejgamber. Jezusi triumfoi nga poshtë si "biri i vërtetë dhe i vetëm i monozotit" dhe fitoi edhe "pavdekësinë e përjetëshme", të cilën aq me dëshpërim e kishte kërkuar Aleksandri i Madh.

20. Disa sqarime mbi "Privelegjin e Aleksandrit të Madh" që paraprin Statutet e Shkodrës

*Teksti i **Statuteve të Shkodrës,** i rizbuluar në vitin 1995 nga dorëshkrimet e Bibliotekës së Muzeut Correr në Venecia, mendohet të jetë kopjuar me përpikëri nga teksti origjinal i ruajtur në Arkivin e Këshillit të të Dhjetëve të Venecias (Consiglio di Dieci), ndoshta pasi origjinali u humb fatkeqësisht për shkak të zjarreve që mbuluan pallatin Dukal (palazzo Ducale) në shekullin XVI.*

Teksti u kopjua nga njëfarë Marino Dulcichio rreth vitit 1504(siç ka dëshmuar ai që shkruan) të nesërmen e paqes së nënshkruar nga Venediku me Turqinë pas dhjetëra vitesh luftë.

Në të njëjtën periudhë kohore në Shkollën e Shqiptarëve në San Maurizio u ngarkua Vittore Carpaccio për të realizuar një cikël të bukur pikturash mbi jetën e Virgjëreshës Maria. Jo rastësisht po në vitin 1504 doli nga shtypi *"De Obsidione Scodrense"* i Marin Barletit, i cili u bë prift në tokën venedikase në vitin 1494 dhe u emërua pastor në Piovene, pranë Viçensës;

vepra u botua nga Bernardino de Vitali me prejardhje nga një familje me origjinë shqiptare.

Komuniteti shqiptar në Venecia në fillim të shekullit XVI ishte i angazhuar për të mbajtur gjallë kujtimin e së shkuarës së tyre nga më e largëta e deri te më e afërta, duke përkujtuar rolin strategjik në kufi të mbajtur nga Shqipëria në ngjarjet dramatike të gjysmës së dytë të shekullit XV, nisur nga roli i jashtëzakonshëm që luajti Skënderbeu, "Ushtar i Krishtit", e gjer tek rezistenca heroike antiosmane që mbajti Shkodra dhe Drivasti në veriun e Shqipërisë.

Ripropozimi i tekstit të "Statuteve të Shkodrës" për mërgimtarët në tokat venedikase do të thoshte të rikujtohej periudha e lavdishme në të cilën ishin krijuar komunitetet qytetare në Shqipëri, në një kohë kur këta të fundit i bashkoheshin një rrethi më të gjerë mesdhetar, pra një rrethi europian të marrëdhënieve ekonomike e kulturore.

Pos si vend i maleve që në fillim të shekullit XIV, Shqipëria ishte edhe vendi i qyteteve dhe i detit. Nga leximi i Statuteve(një tekst që do të ishte mirë të lexohej dhe të studiohej në të gjitha strukturat shkollore shqiptare), del në pah imazhi i një komuniteti mesjetar tejet i civilizuar dhe, jo rastësisht fjala e parë me të cilën fillon teksti, është Liria.

Kështu reciton titulli i kapitullit të parë: "De la libertà de li forestieri a venir ne la Cità nostra a star" Shkodra, zemra e tregtisë së asaj pjese të Europës qëndrore që lidh Baltikun me Egjeun, Shkodra e metabolizuar nga një rrjet ujor që e bën atë edhe një qytet detar, Shkodra që hyri nën zotërimin venedikas, por duke qenë shumë më përpara vendi i mbretërve ilir, Shkodra romake, Shkodra e mbretërve serbë: komuniteti i mërgimtarëve shqiptarë që mori pjesë në ceremonitë e paqes me osmanët në fillimshekullin XV nuk mund të mos prezantonte edhe madhështinë antike, shekullore të tokës mëmë, e tejmbushur me histori.

Ja përse teksti i Statuteve të Shkodrës paraprihej nga një Privelegj, me të cilin Aleksandri i Madh, mirënjohës për ndihmën ushtarake të marrë, u jepte popujve që e banonin sovranitetin

mbi tokat "nga ekstremi verior i Evropës gjer në kufi me Italinë Jugore": më saktësisht bëhej fjalë për "popujt e fisit të shquar të ilirëve, të dalmatëve dhe të liburnëve" dhe të gjithë atyre që banonin nga *"Danubi deri tek zonat e mesme të Trakës"*, duke specifikuar se vetëm ata duhet të konsideroheshin pronarët e vërtetë të këtyre tokave: kushdo tjetër të kërkonte pronësinë, duhej konsideruar si "shërbëtor" i tyre.

Privelegji i Aleksandrit, i biri i Filipit mbret i Maqedonisë, duhet të jetë lëshuar në "Aleksandri në vitin e dymbëdhjetë të mbretërimit". Gjer më sot nuk dihet ende se kush e ka krijuar këtë tekst, i njohur edhe në shekullin XIV; me disa rregullime dhe ndryshime të vogla ai shoqëron themelimin e komuniteteve të ndryshme në zonën ballkanike ose më qartë të asaj zone që kritika e kohëve të fundit, sipas studimeve të Francesco Leoncinit, e konsideron si Evropën Qendrore, duke riinterpretuar edhe vendndodhjen gjeopolitike të Shqipërisë. Në rastin e Privilegjit që shoqëron Statutet e Shkodrës nuk flitet për popujt sllavë, të cilët as nuk citohen, por për popujt ilirë, sepse të tillë quheshin në shekullin XVI banuesit e Shqipërisë nga mërgimtarët në Venedik: varianti në kodin venedikas është shumë domethënës.

Ky tekst ka pasur një qarkullim të gjerë, siç dëshmojnë kopjet e ndryshme të ruajtura në dorëshkrimet e Bibliotekës Marciane në Venecia, rikthen mitin e krijuar ndër shekuj të Aleksandrit të Madh.

Nuk duhet harruar, përsa i përket pretendimive specifike mbi origjinën e tyre nga ana e shqiptarëve të mërguar në Venedik, edhe figura e veçantë e dajës së Aleksandrit: Aleksandri I, i ashtuquajtur Molosi, siç dihet, ishte mbreti i Epirit dhe ikonografia e tij është lidhur së fundmi nga studiuesja Maddalena Bassani me statujën e vendosur në vitin 1606 në Bucintoro-n venecian që paraqet Skënderbeun.

Për të mos folur më tej për Olimpian, e ëma e Aleksandrit, me origjinë nga Epiri.

Ndërsa Giorgio Merula, humanist venecian, përcaktonte në vitin 1474 në shkrimin e tij "Bellum Scodrense" se "osmanët

kishin pushtuar Maqedoninë, e cila nga "më të rinjtë" quhej Shqipëri".

Pra, Privelegji i Aleksandrit të Madh nuk është tekst origjinal, ndoshta në këtë rast është "rishikuar" nga ndonjë punishte shkrimi në Padova në fillim të shekullit të XV, ku ende vazhdonte ndikimi i Annio da Viterbo që vite më parë kishte riprodhuar ex novo shumë dokumenta dhe që më pas shpërndaheshin si të ishin origjinale.

Në Padovë jetonte asokohe edhe Pietro Angeli, i mërguar nga Drivasti, i cili u përpoq të ringjallte kujtimin historik të vendit të tij. Dokumenti kontribuonte në krijimin e një "mit-historie" që paraqiste shqiptarët e lidhur me Aleksandrin e Madh përmes një testamenti(siç dëshmon qartë edhe Maddalena Bassano). Gjithsesi Privelegji është dëshmi shumë e çmuar për historinë e Shqipërisë, sepse hap dritare specifike mbi problemin e ndërlikuar të origjinës së popullit shqiptar.

Më vitin 1532 Marin Sanudo shkruante në "Ditarët" e tij (Diarii), siç na kujton Stefano Trovato: "*E gjithë Shqipëria do të marrë një ditë emrin që mbante në kohën e Aleksandrit*".

Në shekullin XIX Niccolò Tommaseo, duke iu referuar Aleksandrit të Madh, shkruante: "*Nga Maqedonia, vendi i popujve ilirë, doli shqiponja e fortë që me krahët e saj të rrufeshme e shtriu fluturimin gjer në Indi*".

Molosi, Olimpia, Aleksandri i Madh; Iliria, Epiri, Molosia, Shqipëria.

Një skenar ballkanik i ndërlikuar ndër shekuj nga ndërhyrje dhe pretendime të llojeve të ndryshme.

21.Orakulli politik i Aleksandrit

Për të pushtuar botën, luftëtari i madh kishte nevojë për një legjitimim hyjnor. E gjeti në një oazë të humbur në shkretëtirën egjiptiane. Në vitin 332 p. e. s. gjatë marshimit të tij fitimtar

kundër perandorisë së mbretit të madh pers, Dari III, Aleksandri i Madh arriti deri në kufijtë e Egjiptit. Pushtuesit maqedon iu desh të angazhonte të gjithë mjetet e tij ushtarake për të nënshtruar qytetet e mëdha fenikase, mbi të gjitha Tiron dhe Gazën. Në pushtimin e vendit mbi Nil nuk hasi asnjë rezistencë. Në kështjellën e Pelusios që ndodhet në kufi, satrapi persian që qeveriste Egjiptin në fakt i doli përpara duke i dorëzuar pushtetin dhe të gjitha pasuritë. Aleksandri vazhdoi përparimin e tij deri në Menfi, kryeqyteti i Egjiptit të Poshtëm, ku bëri dhe hyrjen triumfuese, i brohoritur nga populli.

Për pjesën më të madhe të egjiptianëve Aleksandri ishte çlirimtar. Që nga pushtimi i Egjiptit nga ana e mbretit Kambis më 526 p. e. s. dominimi persian kishte shkaktuar pakënaqësi të madhe në popullsinë lokale, mbi të gjitha për shkak të rritjes së presionit fiskal dhe përçmimit për kultet egjiptiane. Revoltat ishin diçka konstante dhe që nga viti 404 p. e. s. dominuan tri dinasti të ndryshme egjiptiane në luftë të vazhdueshme kundër persëve. Në vitin 343 p. e. s., vetëm dhjetë vite para mbërritjes së Aleksandrit, faraoni i fundit i pavarur i Egjiptit, Nektanebi II, u dëbua nga mbreti pers, Artakserksi.

Në Menfi Aleksandri u përpoq të shfaqë nderimin e tij për perënditë egjiptiane, duke i bërë të gjitha nderimet Apit, demit të artë. Në këmbim ai u njoh si faraon legjitim dhe u ngjit në fron sipas riteve tradicionale, me mbështetjen e popullit dhe të priftërinjve. Por faraoni i ri nuk qëndroi gjatë në Menfi. Nga kryeqyteti ai u nis drejt veriut, duke ndjekur degën perëndimore të Nilit deri në portin e Kanopit dhe prej aty vazhdoi përgjatë brigjeve të Mesdheut deri në fshatin Rakotis, një vend kufitar mes Egjiptit dhe Libisë. Bëhej fjalë për një vendbanim të vogël në një gjuhë toke mes lagunës Mareotide dhe bregut, përballë të cilit ndodhej ishulli i Faros. Një vend ku, sipas disa versioneve të legjendës, ishin ndalur Menelau dhe Helena pas kthimit nga Lufta e Trojës.

Në atë rrip toke Aleksandri vendosi të ngre një qytet që do të merrte emrin e tij dhe që shumë shpejt do të bëhej porti i madh mesdhetar i Egjiptit dhe metropoli më i madh helenistik:

Aleksandria. Thuhet se ai vet vendosi gurin e themelit të qytetit dhe urdhëroi ndërtimin e tij. Por, pikërisht kur punëtorët po ngrinin ndërtesat e para, Aleksandri vendosi të nisë marshimin drejt perëndimit me qëllim që të vizitonte tempullin e perëndisë Amon, në oazën e Sivës dhe që të këshillohej me orakullin.

Bëhej fjalë për nismën në shumë drejtime alarmuese, që nga momenti kur oaza e Sivës nuk kishte asnjë lloj interesi ushtarak dhe që vizita do të shkaktonte vonesë në përballjen vendimtare me mbretin pers Dari III, i cili në Azi ishte duke rekrutuar një ushtri të madhe për t'u hakmarrë lidhur me humbjen e tij në Betejën e Isit në Turqi. Beteja kish ndodhur në nëntor të një viti më parë. Ishte një ekspeditë e rrezikshme, meqë për të shkuar tek oaza që ndodhej pothuajse pesëqind kilometra larg nga lugina e Nilit, duhej të përshkoje një hapësirë të madhe shkretëtire. Herodoti rrëfen se në përpjekjen për të arritur në Sivë edhe ushtria e mbretit pers, Kambisi II, kishte humbur dhe ndoshta kishte përfunduar e varrosur nën rërë. Shumë mbretër maqedonë që shoqëronin Aleksandrin pyesnin se çfarë dobie do të kishte vizita tek një orakull i huaj dhe kaq larg nga fushëbetejat.

Aleksandri i patrembur dhe kokëfortë nuk ishte mësuar të tërhiqej para vështirësive dhe, pa hezituar nisi ekspeditën e rrezikshme. Në marshimin e tij drejt perëndimit përgjatë brigjeve i erdhi një dërgatë e qytetarëve kireneas me një propozim për aleancë dhe dhurata të mrekullueshme: pothuajse 300 kuaj dhe 5 karroca të mëdha. Kirenea ishte një qytet i prosperuar, i lindur si koloni greke në brigjet libiane, që i shtrinte dorën e bashkëpunimit pushtuesit të Egjiptit dhe i garantonte mbështetjen e vet. Që atëherë flota greke dominonte ujërat e Mesdheut.

Që nga zona bregdetare e Paretonit, 265 kilometra nga perëndimi i Aleksandrisë, Aleksandri mori rrugën drejt jugut, i shoqëruar vetëm nga disa miq besnikë, një trupë e përzgjedhur mirë mee disa udhërrëfyes vendës. Pas largimit nga deti, rruga drejt Sivës përshkonte zona të thata, me shkëmbinj dhe rëra të shkretëtirës. Gjatë marshimit të mundimshëm maqedonët, të zënë në befasi nga një stuhi e fuqishme rëre, humbën rrugën dhe

u detyruan të endeshin pa asnjë drejtim për katër ditë, të mbërthyer nga etja dhe dëshpërimi. Përparonin gjatë natës nën dritën e hënës dhe yjeve, për të shmangur diellin përvëlues të ditës. Për fatin e tyre, nisën disa shira të lehtë, që menjëherë u konsideruan si mrekulli hyjnore. Burimet tregojnë edhe ngjarje të tjera që mund të konsiderohen akte të tjera shpëtuese nga perënditë. Sipas gjeografit Ptolomeu, dy gjarprinj që flisnin u treguan rrugën maqedonëve; sipas historianit pseudo-Kalisten, autor romani i Aleksandrit, ishte në fakt një çift korbash që, duke thirrur krrak-krrak, i sinjalizonin se po gabonin rrugë. Të inkurajuar nga këto shenja të mbështetjes së perëndive, Aleksandri dhe të tijtë e gjetën oazën e shumëdëshiruar. Shumë i madh ishte gëzimi i maqedonëve, kur pas shumë etjesh dhe aq shumë rëre dhe ditëve të tëra të kaluara mes dunave gjithmonë të njëjta, arritën të shohin drurët frutorë dhe jeshillëkun e oazës së Sivës me livadhet e saj, me palmat, shegët dhe ullinjtë, burimet e ujit, muret e larta dhe shtëpitë. E gjithë kjo në qendër të një rrafshnalte shumë pak mikpritëse, e mbushur me këneta. Në fund, Aleksandri u gjend përballë tempullit të famshëm egjiptian, ku e priste zëri profetik i perëndisë Amon.

Prej më shumë se njëqind vitesh kulti i perëndisë Amon, i identifikuar me Zeusin, gëzonte prestigj të madh në botën greke. Në fillim oaza e Sivës kish qenë tempulli i një perëndie vendëse libiane, i njohur si Amun, një hyjni që me kalimin e kohës u asimilua në perëndinë egjiptiane Amon, kur egjiptianët pushtuan zonën. Amoni me brirët e tij të mëdhenj të dashit ishte për besimtarët ai që kishte krijuar universin dhe zot i çdo krijese. I vendosur në një tempull që ishte ndërtuar dyqind vjet më herët nga faraoni Amasis, konsiderohej nga kolonët grekë në Kirenea dhe të përzier me fiset berbere të zonës si figurë e ngjashme me Zeusin e Olimpit. Ishin pikërisht ata që kontribuuan në përhapjen e famës së tij. Në fakt ata kishin ngritur një tempull të Zeusit Amon dhe në monedhat e qytetit u vendos imazhi i hyut me brirët tipikë të dashit. Edhe në Spartë, në Olimpia, në Athinë dhe në portin e kësaj të fundit, në Pire, u përhap kulti i Sivës. Veç të tjerash, poeti grek, Pindari, i dedikoi një poemë. Pa asnjë

dyshim fama dhe kulti i Amonit kishin mbërritur edhe në Maqedoni.

Sipas historianëve të lashtësisë, kanë qenë të shumta motivet që shtynë Aleksandrin e Madh të konsultohej me orakullin Amon. Sipas disave, ishte "ambicia për lavdi e Aleksandrit që të bënte një vizitë në tempullin e Amonit, sepse kishte dëgjuar që Perseu dhe Herakliu kishin qenë aty para tij".

Dëshira e tij për të përsëritur bëmat e heronjve të mëdhenj e stimulonte të konkuronte me Herkulin dhe Perseun, të dy bij të Zeusit dhe të famshëm për bëmat e tyre në toka të largëta. Herkuli ishte prej paraardhësve mitikë të Aleksandrit dhe një model për të; Perseu (që për nga emri mund të lidhej me origjinën mitike të persëve) i dukej si një hero në gjendje të simbolizonte lidhjen mes Perëndimit dhe Lindjes. Sipas historianit Arriani, i cili përmend dëshminë e Ptolomeut, shok i Aleksandrit dhe pas vdekjes së tij, mbret i Egjyptit, Aleksandri donte në fakt të mësonte sa më shumë gjëra për vetveten, për origjinën e tij dhe për të ardhmen e tij si sovran. Ndoshta dy motivet, rivaliteti dhe dëshira për të njohur më mirë fatin e tij, përmblidheshin në tipin impulsiv të mbretit maqedon, gjithnjë i tërhequr nga mundësia për të shkuar më tej dhe i karakterizuar nga ajo dëshirë për të eksploruar të panjohurën, që në lashtësi e shihnin si një prej tipareve të tij më të spikatura.

Nuk dimë me saktësi atë që Aleksandri pyeti dhe dëgjoi në brendësi të tempullit. Hyri i vetëm si mbret dhe faraon i Egjyptit. Në dalje u shfaq shumë i kënaqur nga vizita, por ruajti heshtjen absolute për atë që i ishte zbuluar. Nuk vonoi që të përhapeshin verzione të ndryshme në lidhje për këtë episod. Thuhej se Aleksandri kishte pyetur nëse do të mbretëronte mbi të gjithë tokën dhe nëse vrasësit e babait të tij, viktimë e një komploti në pallat, kishin marrë ndëshkimin e merituar. Prifti ishte përgjegjur në mënyrë pohuese ndaj të dyja pyetjeve.

Elementi më i rëndësishëm ishte deklarata e orakullit, sipas të cilës Aleksandri nuk ishte bir i Filipit, por i hyut të madh Amon, që grekët e identifikonin me Zeusin. Sipas disave, që në hyrje të tempullit orakulli e kish thirrur si "biri i Zeusit" (edhe

pse historiani grek, Plutark, flet për një pasaktësi gjuhësore: duke dashur të thotë paidion, "djalë" në greqisht, prifti kishte thënë pai Dios, apo "bir i Zeusit". Duhet kujtuar që në Egjipt faraoni konsiderohej me origjinë hyjnore dhe nderohej si "biri i Amon-Ra".

Që atëherë mbreti maqedon prezantohej si biri i Hyut të Madh dhe vazhdoi të ushqejë nderim të madh për perëndinë Amon. Në shumë monedha të qyteteve të ndryshëm dhe në monedhat e para në Egjipt në kohën e mbretit Ptolome koka e Aleksandrit shoqërohet me brirët e kthyer të dashit, mu si Amoni. Në fundin e jetës, në Babiloni, sipas shumë burimeve, Aleksandri shprehu madje dëshirën që të varrosej në tempullin e Amonit në Sivë.

Përpjekja e Aleksandrit për t'u paraqitur si biri i një perëndie i dha një tjetër shtysë propagandës perandorake, por shkaktoi pakënaqësi të madhe mes maqedonëve në ushtrinë e tij. Sipas tyre, duke vepruar kështu Aleksandri zbulonte se e përçmonte figurën e Filipit si prind i tij. Veteranët maqedonë, të lodhur dhe të pakënaqur, ankoheshin hapur për një sjellje të tillë, duke ia thënë në sy në shumë raste. Në fushatën e Indisë, për shembull, gjatë një mosbindjeje të tyre në brigjet e lumit Hifasis, ata refuzuan të përparojnë duke i thirrur me sarkazmë mbretit të tyre: "Shko në luftë i vetëm, me ndihmën e babait tënd!" I referoheshin Amonit. Deklarimi i tij si bir i Amonit bëri që të lind legjenda, sipas së cilës Hyu i kish bërë një vizitë nënës së luftëtarit, mbretëreshës Olimpia në oborrin e Maqedonisë, i maskuar si një gjarpër.

Kjo histori u përmend në romanin e Aleksandrit, sipas të cilit faraoni Nektanebi II pas pushtimit persian të Egjiptit më 343 p. e. s., u strehua në Pella, kryeqyteti maqedon. Këtu kish gjetur mënyrën që të mashtronte Olimpian, i maskuar si Amoni. Nëntë muaj më vonë lindi Aleksandri.

Gjatë qëndrimit në Egjypt Aleksandrit duhet t'i ketë ardhur lajmi se Dari po grumbullonte një ushtri të re më të madhe dhe po marshonte në ballë të saj. Aleksandri vendosi ta arrinte në Mesopotami dhe të mos kthehej në Maqedoni. Tani Dari e

detyroi të kthehej menjëherë nga lindja, për të mbrojtur nga persianët zotërimet e tij. Nën sundimin e Aleksandrit tashmë gjendej i gjithë brezi rreth Mesdheut, që nga Greqia deri në Afrikën Veriore. Prej Danubit në Nil, prej Detit Adriatik deri në Eufrat.

Duhet të ketë qenë fundi i prillit ose fillimi i majit i vitit 331 p. e. r., kur Aleksandri u nis nga qyteti Memfis në drejtim të Sirisë, pasi kish riorganizuar ushtrinë për në betejën vendimtare kundër Darit III, e cila do të zhvillohej në Gaugamelë, në qendër të perandorisë persiane. Në pranverën e vitit 331 p. e. s. mbreti maqedon linte Egjyptin në cilësinë e themeluesit të qytetit dhe birit të perëndisë më të lartë, i vetëdijshëm për madhështinë e tij dhe i legjitimuar në misionin e tij si pushtues i botës.

22. Aleksandri i Madh dhe Skënderbeu me epitetet: "Gjarpri - Dragoi - Kuçedra"

Zbulohet nga arkeologjia muri ”Gjarpri i Kuq” i Aleksandrit të Madh. Arkeologjia iraniane në bashkëpunim me një mision arkeologjik anglez kanë raportuar më 2008 të dhënat e para të hetuara qysh nga viti 1999 për ekzistencën e një muri dhe të një vepre hidrike të përmasave gjigante, i quajtur si ”Muri ose barriera, Gjarpri i Kuq i Aleksandrit të Madh”, ndryshe edhe si ”Muri i Gorgonit”. Ky mur fillonte qysh nga Deti Kaspik dhe vazhdonte përgjatë maleve Elbrus e më tej. Ngjyra e kuqe e këtij ”gjarpri” vjen, siç mendohet, nga tullat e kuqe prej balte të pjekur. Të dhënat e para tregojnë për një vepër kolosale dhe një kryevepër të inxhinierisë së ndërtimit civil dhe ushtarak. Kam shkruar edhe herë të tjera për një pasazh dhe një interpretim mjaft të çuditshëm të M. Barletit, të cilin po e citoj: ”Është shumë turp për ne, shumë turp për Venedikun dhe të gjithë mbretërit e krishterë, që ne të durojmë si sundimtarë ata, nga ato fshatra të përbuzur të Skytisë, të cilët në kohën e etërve tanë me zor se mund t'i mbanin edhe për skllevër. S’ka gjë më të ulët se ata që

janë mësuar të jetojnë vetëm me hajdutëri e me të rrëmbyer... fundëri gjindjesh, llum skllevërish... turqit, siç thuhet, atdheun e lashtë e kanë pasur përtej maleve Rife, përtej viseve të Murranit, pranë Oqeanit të Veriut. Racë e ndyrë, e poshtër e rritur në strofka ujqërish, që s'ka të ndytë as nga mishi i ujqërve dhe i hutinave..."

Thuhet se Aleksandri i Madh i pat mbyllur këta me shula hekuri, si bagëti në një vathë dhensh ndërmjet maleve Hyperborë. Unë kisha menduar se Barleti diku-diku ishte ndikuar nga tregimi i Dhulkarnejnit-Kokëdybrirëshit në Kuran, për atë pendën ndarëse për jexhuxh-maxhuxhët. Këta njerëz shkonin në kuptimin si njerëz të një race të shkurtër, xhaxhallarët. Por, gjithsesi misteri mbetej i pazgjidhshëm, sepse nuk mund të përafrohej këtu "Muri i Madh Kinez".

Tashti që ky "Muri i Aleksandrit" është sinjalizuar si një realitet, pavarësisht se ndoshta mundet të kishte qenë edhe si ndonjë vazhdim-përvetësim i një tradite ndërtimtare vendëse pararendëse, po na del se "Penda e Dhulkarnejnit" paska qenë një realitet. (Suria, El Kehf, ajetet 83-98). Aleksandri i Madh, duke "ndjekur gjurmët e Herakliut", nga lindja donte të arrinte deri te Oqeani-briri i lindjes dhe ndoshta edhe më shumë, duke kapërcyer "anën e anës së oqeanit" dhe shkuar gjithnjë nga lindja, donte të rikthehej në perendim. Siç e kam shkruar në një rast tjetër, edhe Pirroja i Epirit, duke ndjekur edhe ai "gjurmët e Herakliut", donte të hidhej nga Sicilia në Tunizi për të arritur në Perëndim në "fundin e tokës"...

Ëndrra e Vojsavës, e shpjeguar si "mrekullitë profetike biblike"

Për lindjen e Gjergj Kastriotit M. Barleti shkruan: "Por, përpara se të kaloj më tutje, nuk mendoj se duhet lënë mënjanë ajo që unë e mora si krejtësisht një shfaqie mrekullie dhe që u profetizua prej shumë njerëzve, mbi lavdinë e këtij njeriu, megjithëse e di mirë se shumë veta s'do t'a përfillin fare, si fort të ngajshme me përrallat e vjetra. Thonë, pra, se kur Vojsava mbeti

me barrë me të, pa në ëndër se lindi një gjarpër aq të madh, saqë mbulonte gjithë Epirin, kokën e shtrinte ndërmjet kufijve të turqve, të cilët i përpinte me gurmazin e vet të gjakosur, ndërsa bishtin e mbante në det ndërmjet kufijve të krishterë, sidomos të shtetit të Venedikut. Gjoni, me t'iu rrëfyer ëndrra, nga që ajo nuk ishte një punë që të hetohej me anë rropullish apo që kërkonte për shpjegues Apollonin, e qetësoi me gëzim të madh të shoqen dhe profetizoi me lehtësi se prej saj do të lindte një burrë i përmendur në luftë e në vepra, i cili do të ishte armiku më i rreptë i turqve dhe njëkohësisht kapedani i tyre më fatbardhë, mbrojtës i fesë së krishterë..."

Origjinali latinisht e shkruan gjarpër, por përkthyesi S. Prifti e ka sjellë si dragua.

Mendoj se përpara se t'a konsiderojmë këtë ëndërr tërësisht si një "manipulim e përrallë të tipit folklorik", mbase duhet t'i hapim paksa vend edhe hipotezës së një ëndrre që Vojsava e kishte parë realisht. Kjo ëndërr ndoshta mund të kishte qenë si një pasqyrim i deformuar i traditave të folklorit dhe të leximeve të literaturave antike, e ndërthurur edhe në kuadrin e shqetësimeve të mëdha kohore në shtëpinë e Kastriotëve. Më konkretisht, Vojsava mund të ketë parë një ëndërr si imitim, pak a shumë si legjenda e Olimpisë së Epirit në shtatzëninë me Aleksandrin e Madh. Duhet të vërejmë këtu se Gjoni ka dijeni dhe mban qëndrim disi tolerues për besëtytnitë pagane. Ai ka njohuri për interpretimet me të përbrendshmet(rropullitë) e flijeve me berra dhe për shpjegimet orakulltare me Apollonin etj., por duke i përjashtuar këto, i jep kësaj ëndre veshje e justifikim sipas mrekullive kristiane. Këtë interpretim i jep edhe vetë Barleti, madje duke shtuar edhe diçka tjetër, se në gjirin e natyrës ekzistojnë mrekullitë.

Një pjesë e ish-traditave antike, me sa duket, ekzistonin ende si rudimente në mesjetë tek ne. Këtë mund t'a konstatojmë edhe te vet M. Barleti. Jo rrallë meshtarit kristjan Barlet i shpëtojnë dhe i dalin mbi ujë disa shprehje si: "betohem për Herkulin", "bestytni" të antikitetit të rremë, etj. Por, kur është e domosdoshme, prifti popullor jo vetëm se i aprovon dhe ia gjen

justifikimin traditave të lashta, por edhe na i përshkruan ato për të mos u fshirë fare nga kujtesa. Kështu përshkruan lavdërimin e trimërisë në gostitë: "ndërmjet trimërive të tjera të ndritura të të vjetërve dhe lavdeve të të parëve, të cilat këndohen zakonisht nga tanët nëpër gosti, sipas një zakoni të lashtë dhe ndoshta jo të përbuzshëm, brezi i ri ka futur jo pa mirënjohje sidomos këtë ngjarje...". Po ashtu ka përshkruar "gjamën mortore": Mamica thirri, sipas zakonit të gjindjes, shumë zonja dhe nderoi varrimin e burrit me zi e lotë që s'pushonin ditë e natë... Unë me plot të drjetë do të kujtoja se të vjetrit e kanë quajtur këtë gjamë Nenia. Dhe me të vërtetë ata e kanë pasur zakon që gjatë vajtimit të përmendeshin jo vetëm trimëria dhe veprat e shquara të të ndjerit, por edhe trimëritë e etërve dhe gjithë kujtimet stërgjyshore dhe lavdet e lashta të families. Ky zakon ka qenë dikur aq fort në përdorim nga shumë popuj të lindjes, saqë merreshin për këtë detyrë gra të mësuara me pagesë, të cilat t'i nxirrnin lotët me këngët dhe gjestet e përvajshme. Në fakt, përmes rreshtave ne mund t'a gjejmë edhe thelbin e atij përkufizimi, siç e kishte konceptuar Barleti vetë: "Populli epirot(alban)maqedon është një popull më tepër luftarak se sa fetar". Është trajtuar nga disa autorë se Olimpia e Epirit, nëna e Aleksandrit të Madh, kishte përhapur një legjendë mbi bazën edhe të një ëndrre, se Aleksandrin e kishte ngjizur me një lloj gjarpri bollë ose me një dragua, me të cilin kishte fjetur, i cili në fakt ishte vetë Zeusi i metamorizuar. Këta shembuj të ngjizjes direkt me Zeusin Olimpia i imitonte nga fondi popullor dhe, me sa duket, edhe nga leximet te Homeri. Këtë legjendë të manipuluar të Olimpisë e përmendin disa autorë antikë, si Plutarku, Livi etj. Lukiani duke u përpjekur të na japë një burim shpjegues sa më natyral tokësor, na njoftonte se kjo legjendë me variantin si dragua-gjarpër bazohej edhe te një lloj gjarpri-bollë orëmirë, që pinte qumësht gjiri direkt nga gratë, luante me fëmijët etj. Ai tregonte për një ish specie që sot konsiderohet si e zhdukur në gadishullin tonë.

Nisur edhe nga disa deklarata të vet Gj. K. Skënderbeut, i cili i quante vazhdimisht Aleksandrin e Madh dhe Pirron e Epirit

si ”të mitë” e si ”paraardhës të fisit tim”, nisur nga deklarata e origjinës së fisit alban, maqedon, epirot, mendoj se Vojsava e dinte dhe e kishte lexuar në autorët antikë legjendën e Olimpisë për lindjen e Aleksandrit të Madh. Gjithashtu ajo e kishte edhe një lloj parafytyrimi se si mund të ishte ai gjarpër ose dragua i paraqitur në artet e ndryshme të antikitetit. Pra, kemi një arsye të besojmë se ajo ëndër mbase e ka pasur një fillesë reale dhe pastaj mbi të padyshim është manipuluar në modën folklorike. Kështu, konceptimi i parardhësve tanë në mesjetë pretendonte një pjesë të konsiderueshme nga trashigimia e Aleksandrit të Madh. Dhe, realisht e kishin një bazament shumë më të justifikuar se sa pretendimet e varfëra të maqedonasve ardhës e folës sllavojugorë të mëvonshëm. Këtë paraqitje të këtij dragoi ose kuçedre si minigrafikë na e ka paraqitur edhe M. Barleti qysh në hapjen e kapitullit(librit I) në botimin e parë. Duhet të vërejmë se në ribotimet e mëvonshme këtë e kanë hequr!

Gjarpri, Dragoi, Kuçedra

Gjarpri, dragoi ose kuçedra(kushedrat) në folklorin tonë, siç e kanë shënuar ekspertët, shpesh janë ngatërruar e përzier njera për tjetrën. Ato ishin qenie të përmasave të mëdha, ndonjëherë edhe gjigante, me një ose me shumë kokë, mund të zhyteshin në ujërat detare e të ëmbla, mund të futeshin nëpër shpellat karstike etj. Këto mund të ishin në role pozitive e negative ose shpesh janë përdorur nga njerëzit për asgjësimin e armiqve të tyre, për ruajten e shpellave dhe kullave me thesare etj. Në raste si më të veçanta dragoi e kuçedra e kuqe vihen në role pozitive, ndërsa kuçedrat qimezeza në role negative dhe madje i gjejmë në ndeshje për jetë a vdekje midis tyre. Si edhe kimerat e lashtësisë, këto qenie të mëdha ishin gjakpirëse, mund të shternin burimet, liqenet, lumenjtë etj. Ngatërresa midis këtyre qenieve diku është shkaktuar nga koha e largët e mjegulluar, diku janë përzier edhe kombinacione të ndryshme të fantazive njerëzore edhe identifikime nëpër hapësira gjeografike të largëta. Në lashtësi këto lloje qeniesh i gjejmë deri edhe me origjina

hyjnore, siç e përshkruante Homeri Kimerën e Liqes: ”Me gjak e fis hyjnish lubi kuçedra ishte: / në kokë luan, dhi n’mes, n'bisht gjarpër a dragua,/ e zjarr shkrumbues për tmerr nga goja villte...”. Kjo ishte Kimera e Likisë, në zonën e liqeneve të Azisë së Vogël jug-perëndimore. Liqia(Likia) duket se lidhet me liqen(lekanon, gr. e vjetër), ndërsa Kimera si gjakpirëse mbase shkon edhe me gjakpirësen e njohur në shqip qimra(kimra) Parafytyrimi dhe paraqitja e tyre në skulptura, basorelieve në piktura, në minigrafika e nëpër monedha, në popuj të ndryshëm ndryshonte dhe ka ndryshuar në kohë edhe brenda të njëjtit popull. Më 1636 F. Bardhi shkruante: ”Ancora oggi i nostri connazionali... chiamano il nostro Scanderbeg col nome specifico di Kulshedra e Arbënit, cioè il Drago d'Epiro... Epiri Draco, cioé Il Drago o per dirla in albanese, il Drangue d'Epiro o dell Albania”, dmth. si ”Drangoi i Epirit ose i Albanisë”. Po ashtu, F. Bardhi, edhe te ”Dictionarium latino-epiroticum...”, Roma 1635, f 197 e përkthente nga lat. Draco me arbnishte si ”Kulshedra e Arbnit”.Siç vërehet, edhe ai e ka bërë ngatërresën si një lloj barazvleshmërie midis dragoit dhe kuçedrës.

Prof. E. Çabej në ”Studime Etimologjike në fushë të shqipes” III, f. 300-302, te zëri ”dragua, drague” jep një sintezë mjaft të plotësuar të karakterit gjuhësor e etimologjik, të vështruar edhe sipas interpretimit e funksioneve mitologjike dhe të përhapjes mbarëevropiane. Mbi këtë ai përpiqet të vë edhe njëfarë rregulli kronologjik, duke i dhënë përparësi një bazamenti të gadishullit tonë. Çabej shënon se ”dragoi mbetet si simboli i trimërisë dhe mund të jetë i një burimi paralatin dhe të jetë përzier pastaj me përfytyrimet romake, ashtu si te figura e kuçedrës”. T. Dhama në ”Fjalori i Mitologjisë”(1987) në fakt bën një lloj ndarjeje e dallimi midis dragoit, kuçedrës, përbindëshit, divit e lubisë, duke i trajtuar si ish-qenie mitologjike të veçanta. Më veçanërisht për dragoin dhe kuçedrën na duket se ky autor referon diçka, sepse kuçedra është e mbuluar me qime, ndërsa dragoin e gjejmë në shumë figurime edhe me luspa detare etj.

Sa i përket ndonjë shpjegimi konkret të etimologjisë, linguistët në rastin e dragoit shohin ngjashmëri me greqishten e

vjetër (shih Çabej cit., "dreq" k, f 316-317) dhe latinishten "drakonem", ndërsa te kushedra-kuçedra gjithashtu shohin greqishten e latinishten "chersydrus". Nisur nga lidhja, edhe si qenie ujore - hidros, duket se diku mund të ketë lidhje rrënja e vjetër sanskrite "dri-dra"=rrjedhje ujore, si te Drin, emri i lashtë ilir për lumë e te deti Adriatik. (Shih te Çabej, "Dri", "dragunarë" etj) Këtu hyn edhe qenia mitologjike "Hidra e Lernës", ku Hidra shkon qartë si qenie ujore dhe Lerna, një lloj kënete me llucë, "lera", siç quhet ende në Myzeqe. Te "kuçedra/kuçedria", mbase do të shkonte edhe kompozita nga ngjyra e kuqe, të cilën e zhvillon Çabej në lidhje edhe me gjakun e dragoit. Në shpella, në toponime e oronime Çabej përmend "Vrima e Dragoit" në Shpirag; "Guri i Drangonit" në Preshevë, kurse K. Luka e gjen dragoin edhe me konsultimin e Çabejt, te Dragoç; Dragovojë-a; Shpella e Dragobisë, në krahasim edhe me arumanishten "drakul" si "drek/dreq" të shqipes. Profesor Çabej ndër variantet e shumta ka gjetur në arbëreshët e Kalabrisë një "drangolé, zdrangolé", me të cilin quajnë një lloj gjarpri. Edhe në afërsi të Shkupit është gjetur një mbishkrim i formës "Drakon-Draccena", që interpretohet si një kult i një çifti gjarpërinjsh. (P. Margilaj, "Ilirët flasin shqip-shqiptarët flasin ilirisht", bot. 2000, f 231). Edhe Marlekaj shënon nga folklori shqiptar se "Thesari i Skënderbeut na ishte fshehur në një shpellë në male dhe atë e ruante një gjarpër gjigant".

Imagjinatat dhe deshifrimet për dragoin dhe kulçedrat gjigante padyshim zhyten lashtë, kur si të tillë njerëzit interpretonin sa duket mbeturinat e eshtrave gjigante të dinozaurëve, ku këmbët e përparme shpesh i interpretonin si krahë fluturues etj. Të tilla mbeturina gjendeshin në Sahara, në një pjesë të ngurtësuar në bregdetin Adriatik të Kroacisë etj. Bazuar në krahasimin e dragojve tanë gadishullorë me ata të ishujve britanikë, unë kam ngritur edhe një hipotezë. Është e mundshme që vet dragoi fluturues, aq i përhapur në legjendat anglo-saksone, si vizatim-figurë të ketë shkuar atje nga gadishulli ynë sipas modelit të shqyteve(mburojave), helmetave dhe monedhave prej argjendi. Në një faqe kodre të Skocisë është

gjetur një figurë e Herakliut me topuz, e zmadhuar me teknikën e mbushjes me gurë, sipas modelit të një monedhe argjendi që është e krahasueshme me modelet e Dyrrahut. Është plotësisht i mundshme po ashtu si shtegtimi i emrit Albania, deri në Francë dhe Skoci nga ushtarët ilirë në legjionet romake të ketë shtegtuar edhe Herakliu me topuz. Në Shkodër ne kemi gjetur një monedhë argjendi në gjendje shumë të mirë, e cila është me prejardhje nga Lukania (ish-kolonitë e Magna Grecia në Italinë Jugore), por që është kopje e modeleve greke të kohës së Aleksandrit të Madh, shek IV p. K. Në helmetën e Athinasë ka një dragua me krahë fluturues e me kokë shqiponje me brirë etj. Ana tjetër e monedhës ka një luan, sfurkun e Poseidonit etj. Dragoin dhe luanin ne i kemi gjetur të krahasueshëm me dragoin, luanin paleokristian (aty ka edhe një shqiponjë) të vendosur në murin e kishës së Mesopotamit pranë Delvinës.

Këtë krahasim e kanë miratuar edhe disa studiues italianë dhe dr. Moikom Zeqo. Objektet paleokristiane ”Dragua, Shqiponjë, Luan” në murin e kishës së fshatit Mesopotam (gr. mes dylumenjve) duhet të jenë të kohës së Aleksandrit të Madh. (Duke vështruar edhe deshifrimet e emërtimit Aleksandër në egjiptianishten antike pjesërisht edhe piktografike, na del se germa e parë A ishte aethos=shqiponjë, germa e dytë L = luan dhe kështu mbase kjo enigmë zgjidhet...)

Unë do të do të shprehesha se ngatërresa e dragoit me kuçedrën nuk mund të ndahet me ”shpatën e Aleksandrit si te Nyja Gordiane”. Edhe në përkthimin shqip në Biblën e Vjetër ndodh një ngatërresë ”gjarpër me kuçedër”, te ”Profecia e Danielit”, ku ”gjarpër-kuçedra nderohet si e shenjtë”. Unë mendoj se ngatërresa gjarpër- dragua-kuçedër rrjedh sipas bishtit të gjatë rrëshqanor që ne e gjejmë edhe te mitologjia e Kadmit në Iliri, kur ai lufton te enkelejtë ilirë, kur vret dragoin ose kur mbas vdekjes, së bashku me Harmoninë shndërrohen edhe vet si dragonj a gjarpërinj, siç e shkruajnë dhe e ngatërrojnë edhe autorët antikë Scymni, Apollodori, Straboni, Pausani, S. Bizantini…

Me sa dihet, me evolucionin dhe censurën e monoteizmit kuptimi fillestar i qenieve mitologjike të politeizmit, sëbashku edhe me perënditë e tyre protektore, u nxorën "on bloc" jashtë ligjit. Kështu, ndryshoi edhe "draco-drago", duke u barazuar me "dreqin/diavolo", ndoshta si ndonjë lloj ish-kategori homonime dhe ndoshta edhe për shkak të ish-brirëve, u fut në kategorinë si Përbindësh etj. Duhet nënvizuar se, ndërsa Aleksandri i Madh në reformën e madhe fetare e unifikuese si "biri i Zeusit, Amonit, perëndive diell" me epitetet shqiponjë, luan, gjarpër-dragua-kuçedër e kuqe, me përkrenaret e tilla etj. ishte brenda moralit dhe fesë së kohës. Për Skënderbeun këto vazhdonin për një inerci të traditës popullore, sepse në fakt për moralin e krishterë, me ndonjë përjashtim, nuk ishin edhe aq të preferueshme e të pranueshme imitimet e traditave antike pagane.

23. *Thomas Gazis:* Aleksandri i Madh në astrologji *(Fragment)*

Çfarë është ajo që e bën Aleksandrin e Madh kaq figurë unike në historinë botërore? Para së gjithash ai përmbushi disa gjëra për një kohë mjaft të shkurtër. Në moshën 20 vjeçare ai u bë mbreti i Maqedonisë. Nën komandën e tij ai çoi ushtrinë prej 30 000 burrash në fund të botës, që njihej atëherë në toka të huaja e të rrezikshme. Në përputhje me faktet historike, ai luftoi në më shumë se njëqind beteja pa e humbur asnjërën. Formoi perandorinë më të madhe që është bërë ndonjëherë nga një njeri i vetëm në lashtësi dhe vdiq në kulmin e lavdisë së tij pa mbushur akoma 33 vitet e jetës së tij. Aleksandri i Madh është njëkohësisht person heroik dhe tragjik.

Kam përshtypjen se ai prek disa fije të ndjeshme shumë të veçanta tonat, disa fije që kanë të bëjnë me parimet më të thella të jetës. Për disa arsye që nuk janë të lehta për t'u përcaktuar/ shpjeguar (njëra prej të cilave duhej të ishte vdekja e tij tragjike rreth moshës 33 vjeç, një moshë që lidhet disi me atë të Krishtit).

Unë besoj që në zemrat tona Aleksandri është shndërruar në martir(dëshmor), në një martir të racës njerëzore. Ai ishte i ri, i

pashëm, i fortë dhe guximtar, por prapëseprapë ishte njeri prej mishi dhe gjaku, pikërisht siç jemi edhe ne. Kështu, ai u bë një përfaqësues i racës sonë që tejkaloi kufijtë e dimensioneve njerëzore dhe arriti pothuajse zotërimet hyjnore, një njeri që guxoi të sfidonte hyjnitë dhe ndoshta për këtë arsye vdiq. Për të gjithë ne që merremi me astrologji do të ishte e dukshme të pyesim nëse harta e Aleksandrit të Madh është ruajtur. A do të mund të ishte aty, për shembull, ndonjë zbulim arkeologjik në Maqedoni, në atdheun e Aleksandrit të Madh dhe që lidhet me hartën e tij? Si fillim, do doja të qartësoja diçka këtu.

Që në kohët e lashta krahina veriore e Greqisë ka qënë quajtur Maqedoni. Kohët e fundit një republikë ish-jugosllave pretendon emrin Maqedoni. Kjo republikë e përbërë nga popullsitë, që e kanë prejardhjen nga Ballkani të paktën njëmijë vjet pas vdekjes së Aleksandrit, nuk ka të bëjë fare me Maqedoninë për të cilën po flasim.

Në çdo rast, as në Maqedoni, as në ndonjë pjesë të Greqisë nuk ka elemente që janë gjetur për astrologjinë të asaj periudhe. Personalisht kam studiuar me qindra statuja antike, urna, mbishkrime pllakash, monedha etj. dhe në asnjërën prej tyre nuk kam gjetur simbole astrologjike.

Jam bindur që deri në fundin e shekullit të katërt p.K astrologjia nuk mbizotëronte në Greqi. Megjithatë, nga fundi i shekullit IV p. e. s. ndodhi një ngjarje e jashtëzakonshme, një ngjarje që doli se ishte shumë domethënëse në historinë e astrologjisë. Kjo ishte ekspedita kryesisht luftarake (ushtarake), por edhe me disa nivele kulturore e Aleksandrit të Madh në Azi dhe veçanërisht në Mesopotami, në djepin e astrologjisë.

Duhet të theksoj këtu se Aleksandri, duke qënë fëmija i një priftëreshe dhe veç kësaj një fëmijë shpirtëror i filozofit Aristotel, nuk ishte i interesuar vetëm për të pushtuar kombe, por edhe për të mësuar për kulturën e tyre. Me këtë fakt, ai solli me vete shkencëtarë grekë (gjeografë, historianë, botanistë, astronomë, filozofë etj.). Deëshira e tij e zjarrtë ishte të eksploronte, të pushtonte dhe pastaj të bashkonte të gjithë popujt, të gjitha vendet dhe të gjithë botën e njohur.

Për shkak të zgjuarsisë së tij, ai e dinte se nëse do të kishte sukses, do të tregonte tolerancë për kulturën e secilit vend dhe do të lejonte rrjedhjen e ideve midis tyre. Pra, në kohën kur ushtria e Aleksandrit hyri plot fitore në qytetin e Babilonisë, astrologjia në formën e saj jo-horoskopike kishte arritur zhvillim të plotë në Mesopotami. Grekët u interesuan menjëherë për astrologjinë.

Ata u bënë disi trashëgimtarë të pikëpamjeve të gjëra astrologjike të grumbulluara gjatë shekujve ndërmjet dy lumenjve të mëdhenj. Me mendjet e tyre filozofike dhe sajuese ata i shqyrtuan këto pikëpamje, vunë në përdorim forma matematikore dhe gjeometrike për vete dhe përfundimsiht e transformuan astrologjinë mesopotamike në astrologjinë horoskopike që kemi ne sot. Dhe e gjitha nisi me Aleksandrin e Madh. Sigurisht që mbështetja e astrologjisë nuk ishte një nga qëllimet e tij kur ai bëri fushatë kundër persianëve në Lindjen e Mesme. Sidoqoftë, me sa dimë ne, astrologjia nuk ishte në kundërshtim me besimet e tij. Akeksandri ishte marrë me mistere të ndryshme, kështu që ai mund të kishte njohuri në astrologji. Fakti është që, jo vetëm se nuk e ndaloi atë, por ndiqte edhe traditat e vendit dhe i mbajti astrologët në oborrin e tij mbretëror.

Kështu, jam mjaft i sigurtë që disa nga këta astrologë mbretërorë "formuan" hartën astrologjike të Aleksandrit dhe ndoshta i pasuan pozicionet planetare të tij edhe te kolegët e tjerë. Identiteti astrologjik i këtij pushtuesi bjond supreme që erdhi nga perëndimi duhet të ketë qënë çështje interesi kryesor ndërmjet astrologëve babilonas të asaj kohe. Sidoqoftë, gjer tani asnjë nga këto harta të supozuara nuk është gjetur.

Duke mos pasur në dispozicion hartën e "dorës së parë" të Aleksandrit të Madh, për nevojë duhet të kthejmë vëmendjen tek ajo e "dorës së dytë". Dy harta të tilla, të supozuara të Aleksandrit, u publikuan në shekullin XVII. E para u formua nga "Ptolemeu i vogël", Andrea Argoli më 1652. Në të mund të lexojmë: "Genitura Alexandri Magni, 12 Augusti 355 Anno Christum, 16:40 P.M". Duke llogaritur pozicionet planetare për

këtë datë p. e. s. vura re që përgjithësisht ato janë të sakta (Kishte vetëm një devijim të pozicionit të Hënës dhe Merkurit).

Sidoqoftë, kjo nuk ishte harta e vërtetë e Aleksandrit, sepse ne dimë që ai ka lindur në 356 p.K. dhe jo ne 355. Rasti i dytë ishte horoskopi që përfshihej në "Collection of divers choice Nativities" të Gadbury-t, i publikuar në 1662.

Në të lexojmë: "Alexander Magnus, born 357 years ante Christu, July 1, 9h. 26 m. P.M". I llogarita pozicionet planetare edhe për këtë datë dhe zbulova se, edhe pse janë shumë të sakta, data ishte e pasaktë sepse Aleksandri nuk kishte lindur në 357 p. K. Duke parë që këto dy harta janë të pasakta, lind përsëri pyetja se si astrologët e shekullit VII mund të llogaritnin me një saktësi të tillë pozicionin planetar për datat e së kaluarës së largët. Fatkeqësisht, nuk ka zbulime historike që mund të hedhin dritë mbi identitetin astrologjik të Aleksandrit të Madh, prandaj alternativë e vetme është të përcaktojmë datën e lindjes së tij dhe si pasojë të formojmë horoskopin e tij. Shumë historianë të lashtë kanë shkruar për Aleksandrin, por vetëm veprat e pesë prej tyre janë ruajtur, ato të Plutarkut, Arrianit, Diodorus Siculus, Quintus Curtius dhe Justinit, të gjithë pas periudhës së Aleksandrit.

Midis pesë prej këtyre historianëve vetëm Plutarku përmend datën e lindjes së Aleksandrit. Ai thotë: "Aleksandri ka lindur më gjashtë të muajit të quajtur Hekatombaion nga athiniotët dhe Lóos nga Maqedonasit" (1). Ky është treguesi kryesor që kemi për datën e lindjes së Aleksandrit. Sidoqoftë, ky tregues nuk e zgjidh automatikisht problemin tonë.

Para së gjithash, Plutarku jetoi katër shekuj të plotë pas Aleksandrit. Si mund të jemi të sigurtë që ai e dinte datën e saktë të lindjes të Aleksandrit? Dhe pastaj, edhe nëse ishim të sigurtë për saktësinë e datës që jep Plutarku, përsëri do të kishim vështirësi ta konvertojmë atë datë (me 6 të Lóos të 356 p.e.s.) në datën që i korrespondon kalendarit tonë.

Ju e shikoni që kalendarët e popujve të lashtë ishin me plot gabime. Ishte teknikisht e pamundur për ta të përcaktonin me saktësi revolucionin vjetor të Tokës përreth Diellit (që sot e dimë që është i barabartë me 365.242217 ditë. Tek të lashtit ky numër

do të ishte i shenjtë, ata i erdhën afër atij por kurrë nuk e arritën atë). Kalendari i tyre bazohet në një vit me kohëzgjatje më të ndryshme se sa i lartpërmenduri; kështu, me afat të gjatë ata ose i kanë ngrënë disa ditë, ose i kanë shtuar ato. Mund të ndodh, për shembull, që në përputhje me kalendarin e tyre ata ishin në një muaj që korrespondonte me qershorin tonë, ndonëse përjashta ata mund të shikonin dëborë (në Mesdhe).

Fakte si këto, kur përsëriten shpesh, i bënë ata të kuptojnë se diçka ishte gabim në kalendarin e tyre. Por, përsëri, nuk mund të bënin shumë për këtë. Për të mbajtur muajt e kalendarit të tyre në sinkronizëm me stinët e vitit, ata fusnin nga një muaj shtesë herë pas here. Parregullsia e një shtimi të tillë është pengesa kryesore e secilit që përpiqet të konvertojë një datë antike në një moderne. Për t'i bërë gjërat edhe më të komplikuara, marrim në konsideratë faktin që secila prej qytet-shteteve greke kishte kalendarin e vet, i cili ishte rregulluar pavarësisht qytet-shteteve të tjera. Ndoshta tani është më e qartë se pse data që jep Plutarku nuk e zgjidh automatikisht problemin tonë.

Personalisht mendoj se ajo datë është e saktë. Plutarku, siç njihet nga veprat e tij, ishte një historian shumë serioz dhe i kultivuar. Ai nuk do të përmendte një datë vetëm sa për ta thënë atë. Ai ishte grek, prandaj ai futej lehtësisht në shkrimet e "dorës së parë", të ruajtura në epokën e historianëve dhe oficerëve të Aleksandrit të Madh.

Përveç kësaj, ne kemi një burim tjetër historik që në njëfarë mënyre vërteton datën e përmendur nga Plutarku. Ky burim vjen nga shkrimtari romak Claudius Aelianus(Aelian), i cili jetoi midis shekullit të dytë dhe të tretë A.D. Aeliani thotë në "Varia historinë" e tij: "data 6 e muajit thargelion konsiderohet si një ditë shumë fatsjellëse për grekët…ata fituan shumë beteja në atë datë…edhe Aleksandri i Maqedonisë, biri i Filipit, kishte lindur në atë datë" (2).

Faktikisht, Aeliani nuk e përcakton nëse kjo nënkupton 6-tën e muajit thargelion ose përgjithësisht 6-tën e një muaji të rastësishëm si datëlindjen e Aleksandrit. Mendoj se është kjo e fundit, jemi mjaft të sigurt që Aleksandri nuk lindi në muajin

thargelion. Aeliani që jetoi pas Plutarkut, nuk e ka kopjuar Plutarkun, sepse në këtë rast ai do të shkruante që Aleksandri lindi me 6 të muajit hekatombaion. Kështu, kemi dy historianë të lashtë që theksojnë 6-tën e një muaji të caktuar si datëlindjen e Aleksandrit (dhe muaji i tij nuk mund të jetë tjetër veçse hekatombaion – Loos, siç e shohim më vonë).

Edhe nëse ky është rasti, kur kemi ende nevojë t'i bëjmë një tjetër pyetje vetes sonë: a ishte data e lindjes një datë e rëndësishme për grekët e lashtë? Për t'u përgjigjur, do të mjaftone të citojmë një rresht nga testamenti i filozofit Epikurus (bashkëkohës i Aleksandrit): "... dhe të lë ty një shumë të konsiderueshme parash, kështuqë mund të festojmë çdo vit datëlindjen time, me 10 të muajit gamelion, siç kemi bërë kur isha gjallë".

Grekët e lashtë e festonin datëlindjen e tyre pikërisht siç bëjmë ne sot. Ky fakt konfirmon supozimin tim që data e lindjes së Aleksandrit njihej nga publiku i gjithanshëm, le pastaj nga oficerët që shkruan biografinë e tij. Për gjitha këto arsye unë mendoj si pikë referimi datën e dhënë nga Plutarku.

Plutarku bën diçka më tepër sesa thjesht na tregon datën e lindjes së Aleksandrit. Ai na informon që Aleksandri ka lindur në një muaj maqedon (Lóos), që korrespondon me muajin Atintan (dialekt i greqishtes, Athinës) hekatombaion. Kjo është një pjesë informacioni e rëndësishme. Meqënëse kemi një bibliografi relativisht të gjerë të kalendarit Atintan, mund të dimë që hekatombaion korrespondon afërsisht me periudhën mes korrik – mes gusht.

Aleksandri I Madh mund të ketë lindur me një hapësirë kohore ndërmjet korrikut dhe tetorit të vitit 356 p. e. s. Dielli i tij duhet të jetë në një nga këto shenja zodiakale: Gaforre, Luan, Virgjëreshë apo Peshore. Hapi tjetër është që ta vërtetojmë këtë hapësirë kohore me shpresë që ta shkurtojmë atë. Historiani Arrian do të na ndihmojë në këtë drejtim.

Duke përmendur Aristobulus-in, një nga oficerët dhe historianët e Aleksandrit, Arrian thotë që Aleksandri jetoi 32 vjet e 8 muaj – dhe këto 8 muaj të plotë (3). Fakti është që ne e dimë

me saktësi të mjaftueshme datën e vdekjes së Aleksandrit(e cila është ruajtur veçmas nga kronikat mbretërore greke në shkrimet babilonase dhe egjiptiane). Aleksandri, sipas Aristobulus, vdiq në ditën e fundit të muajit maqedon daisios, në vitin 323 p. e. s. (4).

Disa kronologjistë dhe historianë modernë (5) pohojnë se data e vdekjes së Aleksandrit korrespondon përafërsisht me datën 12 qershor të vitit 323 p. e. s., ndoshta 10 ose 13 qershor. Nëse nga ajo ditë e 323-it ai jetoi 32 vjet e 8 muaj të plotë të muajve maqedonë, atëherë ai duhet të ketë lindur midis 7 shtatorit dhe 9 Tetorit 356 p. e. s., një periudhë që përputhet absolutisht me hapësirën kohore që parapërcaktuam.

Tashmë kemi një tjetër referim historik që barazvlerësohet me muajin Loos të Maqedonisë të periudhës shtator–tetor. Është një citim nga Demosteni në fjalimin e tij "në majë" të një cope letre nga mbreti Filip II, drejtuar peleponezianëve në 339 p. e. s. Në letër mbreti Filipi II u kërkon peleponezianëve ta takojnë atë në Fokis "në muajin Loos, të cilin athinasit e quanin boedromion dhe Corinthians Panemos" (6)

Meqë boedromion ishte muaji i tretë i kalendarit të Athinës (që nis në solsticin e verës), do të korrespondonte përafërsisht me shtator-tetorin. Por nuk e dimë nëse barazimi Loos = Boedromion ishte i vërtetë për të gjitha ose shumicën e viteve në shekullin e katërt p. e. s. apo nëse ishte i vërtetë vetëm për disa vite të caktuara, siç është një nga ato që mbreti Filip shkroi letrën e lartpërmendur. Gjithsesi tri provat e tjera, që vijnë nga Plutarku, Diodorus Siculus dhe nga një kronikë e hershme bizantine, flasin për një lindje më të mëparshme.

Plutarku konstaton se Filipi, i ati i Aleksandrit, mori njëkohësisht tre lajme të mira ndërsa po drejtonte një ekspeditë ushtarake në Potidea, në Greqinë Veriore: 1) që një nga gjeneralët e tij korri një fitore, 2) që një nga kuajt e tij fitoi garën në lojërat olimpike dhe 3) që Aleksandri lindi. Atëherë, lojërat olimpike zhvilloheshin në verë (historian britanik George Thomson konstatoi se lojërat olimpike zhvilloheshin ose në muajin e Apolonit ose atë të Parthenius.

Apoloni ishte (në kalendarin e Olimpias) muaji i tetë pas solsticit të dimrit dhe Parthenius i nënti. Këta dy muaj i korrespondojnë përafërsisht gushtit apo shtatorit tonë (8). Normalisht do të duhej një javë që lajmëtari t'i çojë Filipit në Potidea lajmin që kali i tij fitoi. Por, lajmi i fitores së kalit dhe lindja e Aleksandrit i erdhen Filipit në të njëjtën kohë, ndaj Aleksandri nuk mund të ketë lindur në fund të shtatorit, aq më pak në tetor (Thomson tregon edhe më me hollësi, duke sugjeruar se lojërat olimpike zhvilloheshin me 9 ose me 22 gusht, ose me 6 shtator, duke u varur nga viti (8)).

Prova e dytë që Aleksandri u bë mbret direkt pas vrasjes së babait të tij Filipit, po t'i referohemi Plutarkut, ai sapo kishte mbushur 20 vitet e jetës së tij (9). Filipi u vra gjatë një ceremonie në një teatër të hapur, në mëngjes. Diodorus Siculus përshkruan me hollësi detajet që lidhen me këtë vendngjarje (10).

Nga përshkrimi i tij, mund të kuptojmë që dita kur u vra Filipi ishte mjaft e nxehtë. Mund të ishte një ditë vere ose fillim shtatori. Mos harroni që jemi në Greqinë Veriore, qytet që shtrihet pothuajse në gjerësinë e Nju Jork Sitit. Mëngjeset e fundshtatorit dhe tetorit janë vërtetë të freskëta atje, jo ideale për një ceremoni në një arenë të hapur. Ndaj, Filipi është vrarë në fund të gushtit ose në fillim të shtatorit.

Menjëherë pas kësaj populli maqedonas dhe ushtria e shpallën Aleksandrin si mbretin e tyre të ri. Duke iu referuar kronologjistit të mirënjohur gjerman, Ideler, Aleksandri u bë mbret në shtator 336 p. e. s. (11). Nëse ai tashmë i kishte mbushur 20 vitet e tij (siç konstaton Plutarku), atëherë ai duhej të kishte lindur në fillim të shtatorit ose në gusht.

Përfundimisht, prova e rëndësishme është ruajtur në "Chronicon Paschale" një kronikë e hershme bizantine. Meqë kemi mundësinë të shohim në këtë kronikë, kalendari maqedon ishte ende në përdorim në shekullin e katërt A.D në Kostandinopojë (dhe ndoshta në tërë ish-botën helenistike).

Në një nga dëshmitë e saj kronika "Paschale" lidhet me ne: "dhe në të njëjtin vit (367 AD) Gratianus Augustus u shpall perandor në Francë, në muajin Loos, 9 ditë përpara "kalendave"

(hënës së plotë) të shtatorit (12). Pra, shpallja e tij është e rëndësishme (edhe pse vjen nga një periudhë pasuese), sepse është një nga të parët që barazvlerësohet me muajin Loos të gushtit maqedon!

Duke marrë në konsideratë të gjitha këto dëshmi, do të thonim që gjysma e dytë e gushtit është periudha që korrespondon më shumë me kushtet paraprake që përmendëm më përpara. Kjo periudhë shtrihet ndërmjet dy rasteve ekstreme të lindjes së Aleksandrit në korrik ose në tetor. Duke u rikthyer te Aristobulus, mendoj se ai është mashtruar nga kalendari maqedon, i cili ishte me plot rregullime dhe kështu i hoqi një muaj kohëzgjatjes së jetës së Aleksandrit.

Në vend të 32 vjet e 8 muaj të plota, ne duhet të kishim thënë 32 vjet e 9 muaj të plota (duke nënkuptuar që nga momenti i vdekjes së tij Aleksandri faktikisht po shkonte drejt muajit të dhjetë pas datëlindjes së 32- të të tij).

Një tjetër fakt që mund të tregojë prova të vlefshme për ne është që kalendari maqedon ishte soli-lunar. Secili prej muajve të tyre zakonisht rregullohej në përputhje me fazat hënore. Data e parë e çdo muaji duhej të përputhej me Hënën e Re, ose të paktën me dukjen e saj të parë kur hëna po rritet në qiell. Ata e mbanin mend gjithmonë këtë, sidomos kur rregullonin kalendarin e tyre. Hëna e Re në gushtin e 356 p. e. s. bie në datën 13.

Në kushtet ideale data 6 e muajit maqedon Lóos do të korrespondonte me datën 19 gusht të atij viti (13 6=19). Me 19 gusht 356 p.e.s. (13) Dielli ishte në Luan dhe Hëna po kalonte përmes Peshores dhe Akrepit. Por, personalisht do të zgjidhja një tjetër datë: 24 gushtin. Një fakt tjetër se pse Aleksandri mund të jetë i shenjës së Luanit, është se Plutarku thoshte se ai ishte bjond. Zakonisht meshkujt luanë janë bjondë, gjë që te Gaforrja nuk ndodh, ose ndodh rrallë herë.

Një devijim prej vetëm pesë ditësh nga 19 gushti, data që do të kishim pranuar, po të ishim të sigurtë që dita e parë e muajit Lóos të 356 p. e. s. ishte dita e Hënës së Re, është në përshtatje me atë çfarë kemi thënë tashmë në kalendarin e lashtë maqedon, më se i pranueshëm.

Më 24 gusht 356 p. e. s dielli ishte në luan, hëna po shkonte përmes shigjetarit dhe bricjapit, merkuri dhe venusi ishin përkrah njëri-tjetrit në virgjëreshë duke formuar gjashtëkëndësh me marsin dhe trekëndësh me uranin, Marsi ishte në gaforre katërkëndësh me jupiterin në peshore, në një opozitë të fortë me uranin në bricjap dhe në opozitë me hënën (karakterin gjaknxehtë të Aleksandrit?).

Saturni ishte në dem katërkëndësh me diellin e tij (marrëdhënia e vështirë që kishte me të atin?). Nëse do të kisha bërë një zgjedhje ndërmjet peshores, akrepit, shigjetarit dhe bricjapit si shenja të mundshme hënore të Aleksandrit, do të zgjidhja pa hezitim shigjetarin.

Hëna në shigjetar përfaqëson shumë mirë shpirtin e pasur (e gjallë) të Aleksandrit të Madh, ekspeditat e tij ndërkontinentale, interesat e tij në letërsi, besimin e tij të thellë në perëndi, nënën e tij Olimpia, e cila ishte një priftëreshë, dhe tri gratë e tij që ishin të gjitha të huaja. Në atë kohë, pra hëna ishte në shigjetar nga ora 20:00 e datës 21 gusht deri në 07:00 më 24 gusht (14).

Zgjodha 24 gushtin, sepse vetëm atëherë hëna, megjithëse mbetet në shigjetar, i afrohet aksit marsi opozitë e Uranit, një aks shumë shpërthyes që mund të ketë të bëjë me natyrën shpërthyese (të vrullshme) të Aleksandrit. Nëse data e tij e lindjes është 24 gushti dhe hëna e tij është në shigjetar, atëherë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë kemi vendosur një hapësirë kohore për orën e lindjes së tij.

Ai duhet të ketë lindur midis orëve 00:00 – 07:00. Në realitet nuk kemi dëshmi të sigurta për orën e lindjes të Aleksandrit. Pseudo–Kallisthenes që shkroi njëfarë biografie romantike të Aleksandrit në shekullin e 3-të AD, se ai kishte lindur kur po lindte dielli dhe vdiq kur po perëndonte ai. Meqë Plutarku konstatoi se Aleksandri vdiq vërtet gjatë mbrëmjes (perëndimit të diellit), ai mund të ketë lindur në agim.

Në këtë rast do të kemi luanin si ashendent që i përshtatet atij shumë më tepër se binjakët ose gaforrja. Veç kësaj, do preferonim që dielli i tij të ishte afër ashendentit, në shtëpinë e tij

të parë dhe kjo mund të ndodhte nëse ai ka lindur rreth orës 05:30 të mëngjesit. Në një rast të tillë do të kishim diellin, merkurin, venusin dhe neptunin të vendosur në shtëpinë e tij të parë (një skemë e rrallë që mund të shpjegojë forcën tërheqëse të jashtëzakonshme të këtij djaloshi, magnetizmin që rrezatonte rreth tij dhe kjo i bëri ushtarët e tij ta ndiqnin atë deri në fund të botës së njohur deri atëherë si të ishin hipnotizuar).

Saturni i tij i lindjes do të ishte në shtëpinë e tij të dhjetë, përkrah MC të tij, ndërsa sunduesi i shtëpisë së tij të dhjetë do të ishte në shtëpinë e tij të parë. Këto pozicione planetare përputhen plotësisht me faktin që në moshë shumë të re Aleksandri pranoi përgjegjësitë dhe me faktin e famës së tij të përhershme.

Mund të themi që kjo hartë astrologjike spekulative e Aleksandrit të Madh paraqet tiparet kryesore të karakterit të tij në mënyrë shumë të kënaqshme (të pranueshme). Theksimi i shtëpisë së tij të parë pasqyron qartë impulsivitetin e tij, shpirtin e tij luftarak dhe dëshirën e tij për të qënë i pari i të parëve në çdo situatë. Edhe në seriozitetin (vetëpërmbajtjen) e tij në çështjet për sa i përket ushqimit dhe kënaqësive sensuale mund të shpjegohej nga venusi në virgjëreshë. Por, testi final do të konsistonte në verifikimin e hartës së tij me anë të tranziteve dhe progresioneve dytësore për ngjarjet më madhore të jetës së Aleksandrit. Le të fillojmë me ngjarjen me rëndësinë më të madhe, vdekjen e tij. Data më e besueshme e vdekjes së tij është 10 qershor 323 p. e. s.. Tranzitet planetare për këtë datë janë shumë domethënëse: Plutoni dhe Urani janë në tranzit përkrah njëri-tjetrit 21 gradë tek Demi, që formojnë katrore me aspektin e supozuar të Aleksandrit, Diellin 25 gradë në luan.

Tranziti i Neptunit 28 gradë në akrep formon gjithashtu aspekt katror me Diellin e tij (një aspekt që bëhet më domethënës nëse konsiderojmë Neptunin si sunduesin e shtëpisë së 8-të të hartës së lindjes së Aleksandrit). Tranziti i Saturnit 29 gradë tek binjakët formon opozitë me Hënën e tij të lindjes, aspektin përkrah me Marsin e lindjes së tij, dhe katrore me Jupiterin e lindjes së tij.

Tranziti i Jupiterit 15 gradë në gaforre formon katrore me Plutonin e lindjes. Marsi tranzit në shtëpinë e tij të parë është përkrah Venusit të lindjes (sunduesin e shtëpisë së tij të dhjetë) dhe Neptunit të tij. Venusi formon tranzit kuadrat me aksin e tij nyjor. Tranziti i Merkurit është përkrah Marsit të tij dhe në opozitë me Uranin e tij. Së fundmi, tranziti i Diellit, që në ditën fatale ishte 14 gradë tek binjakët formon kuadrat me Neptunin e lindjes së Aleksandrit(një aspekt midis shumë të tjerëve që tregon vdeken e tij të përfolur nga helmi. Përgjigja e kësaj harte të lindjes spekulative të Aleksandrit të madh në tranzitet e vendosura për datën e tij të vdekjes është vërtetë mbresëlënëse.

E njëjta gjë mund të thuhej për përgjigjje përsa i përket progresioneve: Hëna e progresuar në opozitë me Neptunin e lindjes (sunduesin e shtëpisë së tetë), Dielli i progresuar katrore me Hënën e lindjes (sunduesen e shtëpisë së 12-të), Merkuri dhe Venusi i progresuar në opozitë me Plutonin e lindjes dhe Marsi i progresuar katrore me Plutonin e lindjes. Një tjetër ngjarje e rëndësishme është vrasja e babait të Aleksandrit, Filipit, nga fillimi i shtatorit 336 p. e. s. Urani, që atëherë ishte tranzit në shtëpinë e tetë të Aleksandrit, formonte një katrore të përkryer me Hënën e tij të lindjes (një vdekje e papritur dhe mjaft e rastësishme që po ndryshonte gjendjen e tij familjare?).

Tranziti i Jupiterit ishte përkrah Marsit të lindjes, ndërsa Saturni formonte opozitë me Marsin e tij. Ky ndikim dypolar i Jupiterit dhe Saturnit me Marsin e lindjes tregon përgjegjësitë që bien mbi Aleksandrin pas vdekjes së të atit dhe dëshirën e tij të zjarrtë për t'u bërë udhëheqës, për të marrë iniciativa, për të vepruar. Një konfigurim dypolar i ngjashëm rezulton nga progresionet e vendosura për këtë ngjarje: Dielli i progresuar përkrah Neptunit të lindjes (sundues I i shtëpisë së 8-të), ndërsa Hëna e progresuar shumë afër Jupiterit të lindjes.

Në një ditë të nxehtë vere të 333 p. e. s. (ndoshta në mesin e gushtit) Aleksandri bëri not në ujërat e akullta të lumit Kydnos, në Turqinë e sotme. Menjëherë pas kësaj u sëmur dhe qëndroi në shtrat disa ditë. Atëherë Saturni formonte opozitë me Diellin e tij

të lindjes, ndërkohë që mundet që tranziti i Diellit dhe Marsit ishin në shtëpinë e tij të 12-të të lindjes.

Në fillim të vitit 325 p. e. s. Aleksandri kishte arritur pozicionin më të largët të ekspeditës së tij (Indi), por prapëseprapë donte të shkonte më tej (tranziti i Jupiterit ishte në shtëpinë e tij të nëntë). Ushtarët e tij refuzuan ta ndiqnin atë. Në janar të atij viti, gjatë një beteje kundër popullit të Mallonit, Aleksandri vepronte me shumë pakujdesi dhe ishte dëmtuar rëndë në kraharor nga një shigjetë. Ai mezi i shpëtoi vdekjes dhe si pasojë qëndroi në barelë për disa javë. Tranziti i Neptunit atëherë ishte 25 gradë tek akrepi, në kuadrat të përkryer me Diellin e tij të lindjes, ndërsa tranziti i Saturnit 23 gradë tek demi formonte kuadrat me Diellin e tij të lindjes. Marsi ishte tranzit në shtëpinë e tij të 12-të të lindjes dhe Dielli tranzit në shtëpinë e gjashtë të tij. Si ngjarje e fundit për të verifikuar, këtu do të marrim martesat kolektive të kremtuara në Suza midis 10 mijë ushtarëve grekë dhe atë të disa grave aziatike. Këto martesa ndodhen rreth ditëve të para të prillit 324 p. e. s. dhe ishin idetë e Aleksandrit (në rastin kur ai u martua vet).

Duke shqyrtuar Progresionet Dytësore, shohim se Hëna e progresuar është përkrah Deshendentit të lindjes së Aleksandrit dhe sapo kishte hyrë në shtëpinë e tij të 7-të. Duke iu referuar mësimeve të Dane Rudhyar, Hëna e progresuar sapo kishte plotësuar këtu gjysmëfazën e vetëdijes (ndërgjegjës) subjektive dhe po hynte në gjysmëfazën e vetëdijes objektive.

Besoj që ky interpretim pasqyron në mënyrë të përkryer gjendjen e brendshme të mendjes së Aleksandrit gjatë asaj periudhe. Nga tipi individual i vetëdijes, ai po kalonte, pra, në atë kolektiv dhe shndërrimi i tij i brendshëm shprehet jashtëzakonisht nga martesat kolektive që kremtoi (shpalli) në Suza. Për sa i përket Tranziteve, është interesante të përmendim venusin, që me të gjitha mundësitë ishte tranzit në shtëpinë e tij të shtatë opozitë me Neptunin e tij të lindjes, ndërsa tranzititi i Jupiterit dhe Saturnit përkrah njëri-tjetrit formojnë katroret me Venusin e tij të lindjes.

Ky aspekt i fundit thekson gjithashtu një ndryshim në mënyrën se si Aleksandri i sheh marrëdhëniet e tij me të tjerët. Së fundmi, tranziti i Uranit, sunduesit të shtëpisë së tij të shtatë të lindjes, ishte përkrah Mesqiellorit të tij. Ky përshkrim astrologjik pasqyron, si të thuash, shumë qartë këto martesa kolektive të pazakonshme të pajtimit (harmonisë).

Ishte në pasardhësit e këtyre 10.000 çifteve (bashkimeve) greko-aziatike që Aleksandri po planifikonte të ndërtonte formën e së ardhmës së perandorisë së tij, një perandori që ai e përfytyroi homogjene (të njëtrajtshme), të suksesshme dhe gjithmonë të qëndrueshme!

SHËNIME

1. Plutarku: Aleksandri, III-5.
2. Claudius Aelianus: Varia Historia,B,25,28-34.
3. Arrian: Historia e Aleksandrit, VII-28.
4. Jacoby: FGrH, 59.
5. Beloch,Samuel,Hamilton etc.
6. Demosthenes: De Corona,157.
7. Plutarku: Aleksandri, III-8.
8. Plutarku: Aleksandri, XI-1.
9. Diodorus Siculus, XVI, 92-2.
10. Beloch,III,2, 59-60.
11. Të gjitha datat e përmedura janë të Stilit të Vjetër.
12. Orët në E.E.T.

*(Autori dëshiron të falenderojë James H. Holden për dhënien e informacioneve të çmuara).

(Ky artikull është një fragment nga leximi që Thomas Gazis bëri në Konferencën Ndërkombëtare të Astrologjisë në Venecia në vitin 1994).

IV. VENDOSJA E SLLAVËVE NË ILIRIK DHE MAQEDONIA

Pas vdekjes së perandorit Teodosi i Madh më 395 Perandoria Romake u nda në dy pjesë: në Perandorinë e Lindjes(Bizanti) me kryeqendër Konstantinopojën dhe në Perandorinë e Perëndimit, me kryeqendër Romën. Iliria mbeti nën sundimin e Bizantit. Historiani Tajar Zavalani, shkruan: *"Vendbanimet fillestare të Sllavëve kanë qenë moçalet e luginës së lumit Pripet në një krahinë të Bjellorusisë që quhej Polesje. Sllavët jetonin si tribu primitivë, me regjim patriarkal e merreshin me pak bujqësi duke djegë pyjet, në toket e të cilëve mbillnin për një stinë, duke shfrytëzuar hirin si pleh."*

Profesori çek, Dvornik, shkruan: "*Sllavët nuk kanë asnjë legjendë heroike që të kujtojë vendosjen e tyre në Gadishullin Ballkanik. Historia e invazioneve sllave filloi nga fundi i shekullit VI pas Krishtit."*

Në një epokë të historisë që nuk dihet me saktësi sllavët filluan të dalin nga Polesja dhe të përhapen në Evropën e Mesme dhe Juglindore. Ata nuk ishin iniciatorët e këtij invazioni, por ishin skllevër dhe shërbyen si "mish për top", masë mbrojtëse të avarëve, hunëve e bullgarëve.

Historiani Ë.Temperly, shkruan: "*Sllavët nuk erdhën si një ushtri invaduese që mund të luftohej me armë, por si një masë njerëzish kundër të cilëve nuk kishte asnjë fuqi që mund të qëndronte. Ishte një gjë e lehtë të shfaroje individë ose grupe të tërë nga invaduesit sllavë, por ishte e pamundur të ndalosh dyndjet e tyre, ku numri ishte aq i madh sa zinte vendin e vetive luftarake."*

Në fillim fushatat sllave në Ballkan patën një karakter të përkohshëm. Ata hynin në një vend, vrisnin, prisnin, digjnin, rrënonin e grabisnin sa mundeshin dhe ktheheshin pas maleve Karpate, ku ishin vendosur. Në vitin 580 një fuqi e përzier sllavësh dhe avarësh, rreth 100.000 vetë, u nisën nga gryka e Danubit dhe bënë kërdinë në Iliri dhe Traki. Ata dogjën, plaçkitën e grabitën për 4 vite rresht. Një pjesë e tyre u tërhoqën me një pasuri të madhe, por shumica e sllavëve u ngulitën në trojet e pushtuara ilire. Këto episode tragjike të invadimeve sllave në Ilirik arritën kulmin e tyre në vitin 617, kur pas

vërshimeve të tyre masovike u vendosën përfundimisht në Ballkan, duke filluar sllavizimin gradual të tij.

Historiani i Bizantit, Prokopi, shkruan: "*Si një valë deti prej njerëzish me burra, gra e fëmijë, ata u vërsulën në tokat e Perandorisë dhe kthyen në gërmadha e zhytën në gjak Ilirinë, Epirin dhe Trakinë, duke përparuar deri në thellësi të Greqisë së vjetër. Prej orës që skllavinët u turrën në tokat e perandorisë, ata grinë dhe masakruan të gjithë njerëzit, pa dallim gjinie e moshe që u ranë në duar. Kjo shfarosje me shumicë mbuloi në kufoma Ilirinë dhe Trakinë, që sipas llogaritjeve ishin më shumë se 200.000 vetë, duke përfshirë edhe ata që u morën si skllevër.*"

Në fund të shekullit VIII bullgarët u shkëputën nga dominimi i avarëve të së njëjtës racë dhe filluan të pushtojnë toka për llogari të tyre. Në vitin 679 nën udhëheqjen e Khanit bullgar, Asparuh, ata u vendosën në tokat e Bullgarisë së sotme, duke hedhur themelet e një shteti bullgar të pavarur nga Bizanti. Duke qenë një popullsi më e vogël në numër se sllavët, bullgarët morën gjuhën sllave dhe si rezultat u sllavizuan.

Historiani arbëresh nga Kroacia, Aleksandër Stipçeviç, për dundjet dhe vendosjet sllave në Ilirik, shkruan: "*Mbarimi i kohës së vjetër dhe fillimi i kohës së mesme vijoi në Ballkan si një ndër periudhat më të errta. Gotët, hunët, avarët dhe popujt e tjerë barbarë sulmuan nga të gjitha pjesët, duke plaçkitur e shkatërruar çdo gjë që krijuan romakët dhe ilirët gjatë atyre shekujve të punës e të përparimit. Një qytetërim i zhvilluar filloi të zhduket nën goditjet vdekjeprurëse që i shkaktonin hordhitë barbare me tërbimin e tyre shkatërrues. Në fillim të shekullit VII fillon kolonizimi nga ana e popujve të ndryshëm sllavë, të cilët pak nga pak e pushtuan gati tërë vendin që dikur u takonte ilirëve.*"

Në këtë mënyrë Serbët e Bullgarët u vendosën në Ballkan, duke shtyrë popullsinë autoktone ilire drejt jugut, të cilët u quajtën ilirë të Jugut dhe shtriheshin nga Kosova në Artë dhe nga Deti Adriatik në Shkup. Pjesa veriore e Dardanisë u pushtua dhe u sllavizua nga serbët, kurse pjesa lindore e saj dhe Trakia u pushtua dhe u asimilua nga bullgarët. Popullsia sllave e përbërë nga serbët, kroatët, sllovenët e më vonë edhe bullgarët, që u

formuan gjatë Mesjetës, ishin me besim fetar pagan. Serbët më 879 dhe bullgarët më 866 u futën në vitin 879 në kishën e krishterë ortodokse, kurse kroatët e sllovenët u futën në kishën e krishterë katolike. Në të gjitha kishat e sllavëve të Jugut gjuha serbe quhej si gjuhë ilire dhe shënohej si "iliryca lingua" e që nuk ka qenë aspak ilire, por sllave. Në këtë mënyrë serbët e sllavët tjerë përpiqeshin të përzihen me ilirët autoktonë. Bullgarët arritën ta quajnë gjuhën e tyre maqedonishte (pra ilire), por edhe ajo ishte gjuhë sllave. Bullgarët pasi që pushtuan Maqedoninë, e quajtën Aleksandrin e Madh paraardhës të tyre, d. m. th. bullgar! Mirëpo, historiani francez, D'Anzhieli, shkruan: ***"Nuk mund të harrohet që Aleksandri i Madh ishte me prejardhje ilire, me arsim helen dhe i edukuar nga një shqiptar(ilir) tjetër prej Stragjirës së Maqedonisë, Aristotelit. Nëna e Aleksandrit të Madh , Olimpia(Olimbia), ishte nga fiset iliro-epirote, babai i tij, Filipi II, ishte ilir maqedon, pra shqiptar..."***

Ndryshe nga dyndjet e tjera barbare që nuk zunë vend në Shqipëri, ardhja e sllavëve qe me pasoja të mëdha për popullin dhe trojet tona. Në shekullin VIII dyndjet sllave morën fund në Ballkan. Popullsia trake u zhduk plotësisht dhe u formua Bullgaria e sotme. Vendbanimet ilire u ngushtuan shumë dhe popullsia ilire që banonte në vendet që sot quhen Slloveni, Kroaci, Bosnjë, Mal i Zi, Serbi dhe Maqedoni u asimiluan krejtësisht ose u shfarosën me dhunë.

***

Sipas historianëve bizantinë Teofani, Nikifori, Kedreni dhe Zomara, bullgarët sllavë u vendosën në Siujdhesën Ilirike dhe në trojet e Maqedonisë antike diku kah gjysma e shekullit VII të erës sonë, rreth viteve 650-680 dhe në vitin 687, pra tetë-nëntë vjet pas themelimit të mbretërisë bullgare, popullsia e Maqedonisë antike ishte bullgaro-sllave. Në shekullin IX shteti sullgar u forcua dhe filloi të zgjerohet në kurriz të Perandorisë Bizantine. Në vitin 851 ata u shtrinë në Maqedoninë Qendrore dhe në Shqipërinë e Jugut, duke pushtuar Ohrin dhe Devollin, kurse disa vjet më vonë pushtuan Beratin dhe gjithë luginën e Vjosës. Në vitin 904

ata pushtuan edhe Vlorën, Himarën, Butrintin e Nikopojën (Prevezën), por nuk mundën ta marrin Durrësin dhe Shkodrën. Të gjitha këto toka shqiptare hynë nën sundimin e mbretërisë bullgare dhe Simeoni e ktheu shtetin bullgar në perandori, duke e shpallur veten car të bullgarëve dhe bizantinëve.

Pas vdekjes së Simeonit perandoria bullgare u dobësua, por pas marrjes së fronit nga një feudal i fuqishëm, Samuili, ajo u rimëkëmb përsëri. Qendra e saj u bë Prespa e më vonë Ohri. Në vitin 1005 ai shtiu në dorë Durrësin dhe më 1014 Manastirin. Vendin e Samuilit e zuri vëllai i tij, Ivan Vlladisllavi. Në vitin 1017 Ivan Vlladisllavi u vra në afërsi të Durrësit. Pas kësaj bullgarët iu nënshtruan Bizantit, por vojvoda Ivaca e vazhdoi rezistëncën e tij në Skrapar, ku u shtyp përfundimisht nga gjenerali shqiptar, David Arianiti. Ky qe dhe fundi i mbretërisë bullgare dhe e sundimit bullgar në Shqipëri (851-1017) për 166 vjet.

Bullgaro-sllavët depërtuan shumë lehtë drejt Ilirikut dhe Maqedonisë, duke krijuar shumë shpejt mbretërinë e tyre, sepse ata i morën me të mirë vendësit e atjeshëm: Ilirët, vllehët, trakasit, myzianët dhe popuj të tjerë, të cilët ishin nën robërinë dhe sundimin e egër të perandorisë bizantine dhe të nëpërkëmbur edhe nga grekët. Këto popuj të shtypur nga pushtuesit bizantinë bullgarët sllavë i pritën gati si "çlirimtarë", sepse mbretëria bullgare ishte në luftë e armiqësi të përhershme me Bizantin dhe popujve të shtypur nga ai u njohu shumë të drejta, të cilat ata nuk i kishin pasur prej shekujsh.

Perandori bizantin, Justinian Rinometi, nuk pranoi t'u paguajë bullgarëve tributin e pranuar nga ati i tij, por ngriti një ushtri të fuqishme dhe mundi në fushat e Trakës një ushtri bullgare. Ai më pas marshoi drejt perëndimit dhe përparoi deri në Selanik, duke i nënshtruar popullsitë sllave.

Nga kronikat bizantine del edhe çështja e ushtrisë së bullgarëve të vendosur në Maqedoni: "***Këtë vit*** (v.691),- shkruan Nikifori,- ***perandori Konstantin i ktheu në robër një pjesë të popullsisë sllave të Maqedonisë dhe ia nënshtroi të tjerat perandorisë romake***". Kjo ndodhi ngase ushtria bullgare sllave, e

komanduar nga Nebuli, kaloi në anën e ushtrisë arabe, të udhëhequr nga kalifi Abdel-Malek në luftën e tij me ushtrinë bizantine. Në këtë kohë bullgaro-sllavët shtriheshin jo vetëm në Maqedoni e Greqi, por deri në Peloponez.

***

Në vitin 168 p. e. s. Maqedonia ra nën sundimin romak, ndërsa në vitin 148 p. e. s. ajo u bë provincë e thjeshtë romake. Me ndarjen e perandorisë romake më 395 Gadishulli Ballkanik u bë pjesë e Perandorisë Lindore romake(Bizantit), me këtë edhe provinca e dikurshme e Maqedonisë antike u bë pjesë përbërëse e saj. Në shekullin XIV dhe XV hapësirat e Ballkanit ranë nën sundimin e Perandorisë Osmane dhe ngelën aty gjer në prag të Luftës së Parë Botërore. Rajoni i dikurshëm i Maqedonisë antike me Traktatin e Bukureshtit, të vitit 1913 u nda midis Greqisë, Bullgarisë dhe Serbisë. Maqedonia nuk u përmend për afro dy mijë vjet, që nga rënia e saj nën erandorinë romake e deri në fillim të shekullit XX. Poashtu, gjatë tërë historisë nuk ka ekzistuar asnjë përpjekje e ndonjë populli për të ringjallur shtetin me emrin Maqedoni. Ideja për një Maqedoni si shtet lindi nga fundi i shekullit XIX. Atëherë doli në skenë një lëvizje e fuqishme që njihet me emrin VMRO. Sipas platformës politike të saj, Maqedonia do të duhej të ishte një "Zvicër ballkanike", ku do të jetonin në barazi të plotë banorët e saj: bullgarët, shqiptarët, turqit, vllehët, grekët etj. Duke u nisur nga parimet e lartpërmendura, përkundër kundërthënieve, më 1903 shpërtheu kryengritja që njihet me emrin Kryengritja e Ilindenit. Ngjarjet kryesore të kësaj kryengritjeje u zhvilluan në hapësirat, ku jetonin shumica shqiptare. Për shkak të karakterit çlirimtar të Kryengritjes së Ilindenit shqiptarët morën pjesë aktive në të. Këtë e dëshmojnë edhe shumë autorë sllavo-maqedonas, të cilët kanë shkruar për këto ngjarje. Ndër ta është edhe Todor Simovski, i cili në punimin e tij: **"Për pjesëmarrjen e kombësive në Kryengritjen e Ilindenit"**, shkruan: *"…përpjekjet e para për një shtet maqedonas filluan aty kah fundi i shekullit XIX, nën ndikimin e lëvizjeve çlirimtare të popujve fqinj, të cilët tentonin të çlirohen nga*

sundimi shekullor osman. Nga ndikimi i këtyre lëvizjeve, edhe tek sllavo-maqedonasit u formua organizata "VMRO", nën frymën e së cilës më 1903 shpërtheu Kryengritja e Ilindenit, e cila kryesisht kishte karakter antiosman. Prandaj, asaj iu bashkangjitën dhe e ndihmuan edhe shqiptarët. Pa ndihmën e shqiptarëve ajo vështirë se do të kishte sukses, kur dihet se ajo u zhvillua kryesisht në viset e banuara më tepër me shqiptarë". Më tej ai vazhdon: "*Shqiptarët kishin merita të veçanta për Komitetin dhe Kryengritjen e Ilindenit, që ishin bartës të sigurtë dhe të mirë të armëve, barotit dhe materialit tjetër ushtarak*".

Në lidhje me çështjen e Kryengritjes së Ilindenit dhe luftën e shqiptarëve në këtë periudhë kanë shkruar edhe historianë tjerë maqedonas, si: Aleksandër Hristov, Orde Ivanovski,…etj. Poashtu, për këtë flitet edhe në librin "Historia e popullit maqedonas", botuar në Shkup më 1993, ku theksohet pjesëmarrja masive e shqiptarëve në atë kryengritje.

Edhe pse Kryengritja e Ilindenit për disa ditë u shua nga forcat ushtarake osmane, kjo ishte ngjarja e parë me rëndësi historike për popujt që jetonin në Maqedoni. Këto ngjarje shënuan zanafillën historike të bashkëpunimit në mes sllavomaqedonasve (apo sllavobullgarëve) dhe shqiptarëve, si dhe gatishmërinë e këtyre dy popujve të robëruar, për t'u çliruar nga zgjedha osmane. Konferenca e Londrës(1913) e njohu pavarësinë e Shqipërisë, por e sanksionoi ndarjen e hapësirave gjeografike të popullit shqiptar si tërësi, në dy pjesë gati të barabarta. Gjysma e kombit shqiptar mbeti në përbërje të Shqipërisë së pavarur, ndërsa gjysma tjetër hyri në përbërje të mbretësisë serbe. Pas Luftës së Parë Botërore shqiptarët etnikë që mbetën jashtë kufijve të Shqipërisë u futën në përbërje të Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene, që pak më vonë u quajt Mbretëria e Jugosllavisë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, përkundër propagandës komuniste për "vetëvendosjen e popujve", ajo jo që nuk ndodhi me shqiptarët, por hapësirat e tyre etnike u copëtuan në shumë shtete. Komunistët u ofronin shqiptarëve të drejta dhe barazi "fiktive", siç ishte rasti me mbledhjen e ASNOM-it më 2 gusht 1944 në Prohor Pçinski.

Lidhur me këtë Prof. Dr. Gjorgji Caca thotë: *"Republika Socialiste e Maqedonisë sot është ajo që asnjëherë nuk ka qenë. Ajo është kështu, sepse është formuar në luftën e përbashkët të popullit maqedonas së bashku me kombësinë shqiptare dhe turke … "* As në fazën e parë dhe as në të dytën Maqedonia nuk përkufizohet si shtet nacional i maqedonasve. Në fazën e tretë kushtetuta e re e qartësoi përbërjen e popujve të Republikës së Maqedonisë. Kjo ishte ushtetuta e vitit 1974, e cila e definon Maqedoninë kështu: *"Republika Socialiste e Maqedonisë është shtet nacional i popullit maqedonas dhe shtet i kombësisë shqiptare dhe turke në të, bazuar në sovranitetin e popullit, pushtetit dhe vetëqeverisjes së klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punonjës dhe bashkësi socialiste demokratike vetëqeverisëse të popujve punonjës dhe qytetarëve, të popullit maqedonas dhe me të të barabartë të kombësisë shqiptare dhe turke "*. Nga definicioni i aktit më të lartë juridik për Maqedoninë si shtet i maqedonasve, shqiptarëve dhe turqve mund të konstatohet se kjo i përgjigjej realitetit historik për kontributin e dhënë të popujve të saj dhe përbërjes etnike të kësaj republike multinacionale.

***

Ekziston për një kohë të gjatë kontesti ndërmjet disa shteteve ballkanike në lidhje me territorin e ish-provincës otomane të Maqedonisë. Ky kontest etno-territorial në periudha të caktuara historike ka marë përmasa të rrezikshme për paqen dhe stabilitetin në rajon. Përderisa pushteti okupues otoman ishte i fuqishëm dhe stabil, kontradiktat mes etnive të ndryshme mbaheshin nën kontrollin e organeve qëndrore. Fillimi i rënies dhe i largimit të ngadalshëm të otomanëve nga Ballkani me paqen e Karlovcit të vitit 1699 dhe fillimi i ndërhyrjes së fuqishme ruse pas vitit 1820 me pavarësimin e Greqisë, e bashkuar kjo edhe me dëshirën e natyrshme të popujve ballkanikë për liri, sollën deri te tërmete të mëdha në Evropën Juglindore. Në këtë kuadër, si rezultat i luftës ruso-turke të vitit 1877/78 dhe disfatës së tmershme të armatave otomane, Rusia ia diktoi Turqisë termat e paqes së Shën-Stefanit (Jeshilkojit) nga 3 marsi 1878. Në bazë të kësaj marëveshjeje Bullgaria fitoi

autonominë dhe u zgjerua shumë në dëm të vendeve fqinje, duke fituar Vranjën, Pirotin, Trakën etj. Implikime të mëdha solli sidomos zgjerimi në perëndim, duke përfshirë gati gjithë territorin e Maqedonisë otomane. Kundër këtij forcimi të madh të ndikimit rus në jug reaguan fuqitë e mëdha, duke organizuar Kongresin e Berlinit (13 qershor-13 korrik 1878), me të cilin Bullgarisë iu reduktuan ndjeshëm kufijtë e propozuar nga Rusia në Shën-Stefan. Prej kësaj kohe politika bullgare në drejtim të Maqedonisë mer formë më të sofistikuar, duke folur gjithmonë për një Maqedoni autonome, kuptohet si një fazë e ndërmjetme drejt bashkimit me Bullgarinë.

Në vijim të aktiviteteve revolucionare të kontrolluara nga Sofja, më 1893 në Selanik formohet "Organizata revolucionare e brendshme maqedonase-odrinase", e cila më vonë do të ndryshojë disa herë emrin, por jo edhe qëllimin e deklaruar: Çlirimin e Maqedonisë nga okupatori turk dhe bashkimin e natyrshëm të popullit bullgar me shtetin amë Bullgarinë. Themeluesit e saj Kristo Batanxhiev, Dame Gruev, Kristo Tatarçev etj. e ndjenin veten të gjithë për bullgarë etnikë dhe asnjëherë nuk e vinin në dyshim këtë. Madje vetë **Dr. Kristo Tatarçev** e shpreh qartë në memoaret e tij idenë mbizotëruese në bazë të së cilës u formua organizata, kur pohon se *"E kishim në mendje se një Maqedoni autonome do ta kishte më lehtë të bashkohej me Bullgarinë më vonë"*. Ky është vetëm një nga qindra e mijëra dokumente në të cilat pasqyrohet qartë karakteri etnik bullgar i popullsisë sllavishtfolëse të Maqedonisë së asaj kohe. Në Luftën Ballkanike të vitit 1912 dhe në rregullimet pasuese të Bukureshtit e të Londrës si humbës më i madh doli populli shqiptar, territori i shtetit-komb të të cilit u reduktua në vetëm 30% të territorit të banuar nga shqiptarë etnikë në Ballkan. Paqja e Bukureshtit nga 10 gushti i vitit 1912 megjithëse i dhuroi Bullgarisë një territor prej gati 26.000 kilometra katrore, përsëri nuk kënaqi aspiratën e natyrshme popullore për t'u bashkuar me bullgarët e Maqedonisë, pasi kjo pjesë e tokave bullgaro-shqiptare në masë të madhe u nda nga fitimtarët e luftës ballkanike, Sërbisë dhe Greqisë. Që nga kjo kohë sllavët bullgarishtfolës të Maqedonisë

jetuan nën çatinë sërbe, respektivisht greke që e mohonin kombësinë bullgare të tyre. Edhe në mesin e intelegjencisë sllavishtfolëse nga Maqedonia ka pasur elemente, si p.sh Kërste Petkov Misirkov që në periudha të caktuara historike e kanë pasur të turbullt dhe me dyzime përkatësinë e tyre kombëtare, duke u shpallur herë si bullgarë, herë si bullgaro- maqedonas e herë si maqedonas. Elemente bullgare nga Maqedonia, të shkolluara para Luftës II Botërore me fondet e Mbretërisë Sërbe në Beograd, pas ndryshimeve të vitit 1945 fitojnë përparësi dhe në kuadër të politikave titoiste fillojnë me një punë serioze për krijimin përfundimtar të një kombi të ri, atij maqedonas.

Federata komuniste e Jugosllavisë për herë të parë njeh zyrtarisht një kombësi të veçantë sllave-jugore, atë maqedonase me të gjithë elementet e veçantësisë kulturore që e dallojnë një komb, në radhë të parë gjuha. Në një periudhë kohore 50-vjeçare, dhe në rreth 18 vite pavarësi nga ish-federata jugosllave në këtë vend bëhet përpjekeje që të etablohet dhe përforcohet elementi etnik maqedonas, si i ndryshëm nga ai bullgar. Në këtë drejtim Bullgaria dhe Maqedonia paradoksalisht pretendojnë njëkohësisht në përkatësi etnike bullgare, respektivisht maqedonase për heronjtë e njëjtë kombëtarë, shkrimtarët e njëjtë nga e kaluara, shenjtorët e kishës ortodokse, gjuhën e folur e cila është gati identike, kulturën popullore e deri tek mitet popullore.

Kjo në radhë të parë ka të bëjë me gjuhën gati identike, por shumë më tepër me figurat e mëdha historike nga e kaluara që janë njëkohësisht bullgare e maqedonase!. Që nga Shën Kirili, Shën Metodi, Shën Naumi e Car Samuili, Krali Marko e Karposhi, e deri tek Goce Dellçev, Nikolla Karev e Kristo Tatarçev, për të numëruar disa shembuj të paktë, gjithë këto figura historike janë për bullgarët bullgarë, kurse për një pjesë sllavishtfolëse të qytetarëve të IRJM-së, që e mban veten për maqedonase në aspekt etnik, këta janë maqedonas. Një numër i ngjarjeve të mëdha historike nga e kaluara, si mbretëria e Samulit, beteja e Maricës, kryengritja e Karposhit, kryengritja e Kresnës, Kryengritja e Razlovit, kryengritja e Ilindenit, etj merren si ngjarje madhore në historinë bullgare dhe në historinë

"maqedonase". Qëndrimi zyrtar i shtetit bullgar ka qenë në vazhdimësi mohues ndaj ekzistencës së popullit të veçantë maqedonas si i ndryshëm nga populli bullgar. Bullgaria me të drejtë vë pikëpyetje të mëdha tek shumë figura e ngjarje historike nga e kaluara të cilat e demaskojnë seriozisht "maqedonizmin" si identitet të veçantë brenda sllav.

Qeveritë e ndryshme maqedonase të periudhës së pavarësisë kanë bërë përpjekje për imponimit e qëndrimit të tyre zyrtar për ekzistencën e një kombi të veçantë maqedonas krejtësisht origjinal dhe të ndryshëm nga ai bullgar. Në këtë drejtim më konsistente dhe këmbëngulëse kanë qenë rrymat e majta që gjeografikisht, etnikisht dhe shpirtërsht ndihen më afër Beogradit. Rrymat djathtiste, nga ana tjetër, janë më të vagëllta dhe të mjegullta në drejtim të refuzimit kategorik të opcionit bullgar. Kjo shihet qartë edhe gjatë dy-tri viteve të fundit, kur në qeveri janë elementet e VMRO/DPMNE-së.

Situata bëhet më e komplikuar kur të kihen parasysh përpjekjet 20-vjeçare greke për të ndryshuar emrin e Maqedonisë. Ndryshimi i emrit të vendit implikon edhe shumë pikëpyetje tjera në lidhje me identitetin kombëtar të banorëve të vendit që ndryshon emrin. Në këtë pikë çështja bëhet shekspiriane për qytetarët sllavishtfolës këtu. Janë ata maqedonas antikë të sllavizuar më vonë? Janë fis i veçantë sllav që u vendosën në Ballkan gjatë shekujve VI-IX bashkë me fiset tjera sllave? Apo janë bullgarë të shkëputur me dhunë nga gjiri i shtetit amë e që duhet t'i rikthehen atij? Apo mos janë bullgarë etnikë që me kalimin e kohës nën ndikimin e propagandave jugosllave dhe komuniste kanë evoluar në një kombësi të re të quajtur maqedonase? Teoritë më të reja në lidhje me kombformimet njohin edhe mundësi të formimit ("zbulimit" i quan Andersoni) të tyre nga lart-poshtë, pra nën kontrollin politik dhe ndikimin e elitave të caktuara pushtetare. Elita maqedonase projugosllave e kohës së Titos dhe kjo e këtyre 20-vjetëve pavarësi, si duket ka pasur sukses në injektimin artificial të një identiteti të ri kombëtar, atij maqedonas. Një identitet i tillë i bazuar krejtësisht në një ndjenjë përkatësie krahinore dhe në

dialektet lindore të bullgarishtes sot është ngritur në komb dhe gjuhë të veçantë maqedonase. Ky identitet jo vetëm që del si i ndryshëm nga ai bullgar, por është në kontradiktë të drejtpërdrejtë me të, pasi pretendon në vlerat e njëjta, në të cilat bazohet historikisht edhe identiteti kombëtar bullgar.

Shikuar në tërësi, çështja e identitetit kombëtar të maqedonasve të sotëm të IRJM-së është e paqartë dhe e komplikuar, pikërisht ashtu si thanë edhe vetë liderët e sotëm të "dy popujve" në fjalë, atij maqedonas dhe atij bullgar: fqinjë, vëllezër apo një komb i ndarë në dy shtete?

***

Shteti i sotëm, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, shtrihet midis Bullgarisë, Greqisë, Shqipërisë, Serbisë dhe Kosovës. Sipas pozitës gjeografike, ajo përfshin hapësirën, ku kryqëzohen rrugët dhe hekurudhat në drejtimin Veri-Jug, që lidhin Greqinë dhe Kosovën e Serbinë me vijat komunikative Lindje-Perëndim, edhe Shqipërinë e Bullgarinë.

FYROM (IRJM) - Maqedonia aktuale e Vardarit

Banorët më të lashtë të Maqedonisë së sotme, Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, që përmenden te autorët antikë grekë e romakë, janë fiset ilire, trakase e helene. Këto të dhëna na lënë të kuptojmë se sot trashëgimtarët e banorëve më të vjetër të këtij shteti janë shqiptarët që jetojnë këtu. Kjo për shkak të një fakti shumë të qartë se pasardhësit e ilirëve janë shqiptarët, pasardhësit e helenëve janë grekët, ndërsa si pasardhës të trakëve të vjetër nuk përmendet ndonjë popull i sotëm, përpos hapësirës gjeografike "Trakia", që shtrihet midis Bullgarisë dhe Greqisë.

Historianët sllavë përpiqen që të dëshmojnë se populli i sotëm maqedonas është pasardhës i maqedonasve antikë. Tërë kjo bëhet për shkak të politikës ditore maqedonase, për të arsyetuar krijesën dhe ekzistimin e shtetit të sotëm "Republika e Maqedonisë", si vazhdimësi historike e Maqedonisë antike. Por,

për saktësinë e kësaj teorie sllave nuk ekzistojnë fakte shkencore relevante të historiografisë së huaj, prandaj përpjekja në këtë drejtim është joshkencore.

Fiset sllave që erdhën më vonë në hapësirat gjeografike të Ballkanit, u vendosën këtu përgjithmonë. Ky proces i vendosjes dhe kolonizimit të Gadishullit Ballkanik pati reperkusione të mëdha për popullatën autoktone ilire në Ballkan. Grupe të ndryshme sllave që në shekullin VI u vendosën në rrethinat e Selanikut. Kolonizimi sllav mori përmasa të mëdha në shekullin VII. Perandoria bizantine në këtë periudhë ishte në luftë me Persinë dhe nuk ishte në gjendje të ndalë procesin e depërtimit të sllavëve. Si rezultat i kolonizimit sllav, u ndërrua struktura etnike e hapësirave ballkanike.

Në librin "Historia e opullit maqedonas" thuhet: "*…me shndërrimin e Maqedonisë në tokë sllave u krijua simbioza midis sllavëve të ardhur dhe popullsisë vendase maqedonase (që ishte pakësuar). Si rezultat i simbiozës midis sllavëve dhe popullsisë së vjetër vendëse maqedonase pak nga pak tek sllavët u imponua emri i vjetër i vendit "Maqedoni". Në këtë mënyrë, pas asimilimit definitiv të popullatës së vjetër maqedonase, nga etnosi sllav erdhi në shprehje " populli-etnosi"* ***i ri ".***

Është e vërtetë se vendosja masive e sllavëve në hapësirat ballkanike ka pasur ndikim të madh jo vetëm në ndërrimin e strukturës etnike, por edhe në ndërrimin e toponimisë (emrave të vendbanimeve, lumenjve, maleve, ultësirave dhe krahinave të tëra). Por, assesi nuk mund të jetë e vërtetë se etnosi i vjetër maqedonas është asimiluar tërësisht, ashtu siç synojnë të vërtetojnë historianët e sotëm sllavë, sepse shtrohet pyetja dhe dilema tjetër: Pse nuk u asimiluan tërësisht helenët dhe ilirët? Në fakt, procesi i asimilimit të tërësishëm ka mundur të ndodhë në ato hapësira gjeografike, ku presioni i sllavëve ka qenë më i madh, sidomos në Luginën e Vardarit, Moravës apo në rrafshirat pjellore të Trakisë. Por, një proces i tillë s'ka mundur të ketë ndikim të madh në viset kodrinoro-malore të Maqedonisë së sotme ose të Shqipërisë, ku ende jetojnë pasardhësit e

maqedonëve antikë ilirë, të cilët tashmë ekzistojnë me emrin shqiptarë.

Nuk duhen ngatërruar vëndësit e asaj kohe me sllavomaqedonasit e sotëm, megjithëse ai vend quhej Maqedoni tamam si sot. Dikur, deri para shekullit VII-XI, kur ndodhën edhe ardhjet masive sllave në Ballkan, Maqedonia ishte e populluar me ilirë, ndërsa tani me shqiptarë e sllavë.

***

Për çfarë në të vërtetë luftojnë maqedonasit e tashëm? A janë ata antikë ose sllavë? Pse çështja e identitetit është problemi më i madh mes maqedonasve dhe grekëve, janë disa prej pyetjeve që janë sqaruar në një dokument të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase (VMRO) në vitin 1946. Dokumentin e siguruar nga gazeta "LAJM", nga arkivi i VMRO-së që gjendet brenda Arkivit të Shtetit të Maqedonisë, historiani **Kiril Ivanov** ka dhënë sqarime se cili është identiteti i tanishëm i maqedonasve. Ivanovi në një fjalim të mbajtur më 7 mars 1946 para anëtarëve të Organizatës së të Rinjve Maqedonas të Sofjes, me titull "Historia më e vjetër e Maqedonisë", ka dhënë fakte me të cilat sqaron se maqedonasit e tanishëm janë me prejardhje sllave dhe jo antike.

"*Çka na lidh neve, maqedonasit e sotëm me atë popullin e humbur që moti? A mund që ne t'i përkujtojmë pasardhësit e tyre historikë? Historia jep përgjigje negative në këtë pyetje. Populli i sotëm maqedonas, i përbërë kryesisht nga fise sllave që kanë ardhur në Ballkan rreth shekullit të 6-të pas Krishtit dhe nga mbetjet e fiseve të vjetra ilire që po humbeshin, ka fizionomi të tilla etnike, te të cilat nuk mund ta zbulojmë fizionominë etnike të maqedonasve të lashtë*", thuhet në këtë dokument.

Kiril Ivanov këtë teori e ka sqaruar më poshtë para rinisë maqedonase të asaj kohe në Sofje të Bullgarisë. **"As traditat dhe zakonet e lashta të maqedonasve të tanishëm sllavë nuk i përngjajnë asnjë prej atyre të maqedonëve të vjetër",** ka thënë Ivanov. Historiani maqedonas në atë kohë ka bindur rininë në organizatën e të rinjve se **"Lidhja e vetme reale historike me ata**

maqedonas mund ta shohim vetëm në kuadër të aspektit gjeografik dhe në përgjithësi mund të shihen elementet ilire në përbërjen e tyre", thuhet në dokumentin e arkivit të VMRO-së. Gjithashtu, ai ka dhënë sqarime se maqedonasit nuk janë drejtpërdrejt pasardhës të maqedonëve antikë. Kiril Ivanov në mars të vitit 1946 vazhdon edhe më tutje, duke sqaruar dhe duke shprehur se cilat mund të jenë pasojat historike për këto të pavërteta. "Ta dhunojmë historinë dhe faktet historike me atë që do t'i vendosim maqedonasit e sotëm drejtpërdrejt si pasardhës të Aleksandrit të Madh, do të thotë jo vetëm që po ndryshojmë të vërtetën historike, por edhe të shndërrohemi në shovinistë qesharakë", ka deklaruar para rinisë maqedonase Ivanov. Ai ka akuzuar edhe palën greke, të cilën e ka quajtur si agresore dhe ndryshuese të historisë. "*Mësimi i asaj parahistorie të lashtë të popullit tonë na lidh me një çelik të padrejtë kundër falsifikuesve të shovinistëve të atij lloji të Haxhi Taksis, i cili për ta arsyetuar rrëmbimin e Maqedonisë Lindore dhe jugore nga Greqia, pa turp 'pohon' se maqedonët e lashtë, por edhe të tanishmit janë grekë*", thuhet në fund të dokumentit që u lexua më 7 mars 1946 në Sofje.

***

Dimitrov: Maqedonasit do të zhduken

Maqedonasit do t`i gjejë fati i majëve, astekëve dhe inkëve, bën të ditur parashikimi i Ministrit Bullgar të Diasporës,* Bozhidar Dimitrov, *të dhënë në intervistën e së hënës në Radion Kombëtare Bullgare.

Teza e ministrit bullgar është se maqedonasit sot nuk kanë krizë me emrin, por me identitetin. Sipas tij, kjo krizë shihet edhe nga fakti se gjatë tetë viteve të fundit 30 mijë qytetarë të Maqedonisë janë pajisur me shtetësi bullgare. "Vetëm gjatë vitit 2009 mbi 4.900 qytetarë maqedonas kanë marrë shtetësinë bullgare. Në mesin e tyre ka ministra, mjekë, ish-ministra, me ç`rast nuk mendoj vetëm në ish-kryeministrin Lubço Georgievski", ka theksuar Dimitrov në intervistën për radion shtetërore bullgare.

"Nëse vazhdon kështu, atëherë ata do të përballen me shok kulturor dhe do t`i gjejë fati i majëve, astekëve dhe inkëve", ka konkluduar Ministri i Diasporës i Bullgarisë, i cili është aktiv me politikën zyrtare bullgare në raportet me Maqedoninë. Dimitrov ka shtuar, gjithashtu, se Maqedonia nuk ka argumente të tjera për të diskutuar për ngjarjet historike dhe personalitetet që i konsideron si të vetat.

Ai ka përqesh procesin dhe fushatën e "antikitetit", që po udhëhiqet në Maqedoni. ***"Nëse në të kaluarën shkencëtarët kanë mundur të diskutojnë për historinë maqedone, gjegjësisht rreth asaj se çka kanë qenë car Samoili, vëllezërit Milladinov, tanimë na mbetet vetëm që të qeshemi dhe në pamundësi t`ia shtrijmë duart. Ata tash i kërkojnë rrënjët diku në Pakistan ose Egjipt. Nëse nuk e keni ditur, edhe Kleopatra është maqedone…Edhe e gjithë mbretëria e Ptolomejve është maqedone"***, deklaroi Dimitrov. Ai pret që marrëdhëniet mes dy vendeve të pësojnë ngrirje deri sa të zgjidhet kriza e identitetit në Maqedoni, gjegjësisht sa të ndalojë gjuha e urrejtjes dhe falsifikimi i përmendoreve bullgare, kishave dhe të mos lejohet vendosja e përmendoreve bullgare në territorin e Maqedonisë. Që kjo sjellje të ndalohet, sipas Dimtrovit, duhet të firmoset marrëveshja e vitit 1999, me të cilën ishin tejkaluar mosmarrëveshjet e mëparshme me dy vendeve.

"Presidenti Parvanov shumë qartë i sqaroi këto punë në takimin me kolegun e tij maqedonas, ku direkt i sqaroi se mbështetja e jonë për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe BE varet nga këto gjëra", ka deklaruar Dimitrov.

(Agjensia e Lajmeve INA, 23 dhjetor 2009)

V. PARAARDHËSIT DHE PASARDHËSIT ILIRË TË LEKËS SË MADH

1. Pellazgët në Azinë Qendrore

Iliro-maqedoni i pavdekshëm, **Leka i Madh** (356-323 p. e. s.) pushtoi pjesën më të madhe të botës që njihej në lashtësi. Perandoria e Lekës së Madh shtrihej nga ujërat e Adriatikut e Jonit në perëndim e gjer në kreshtat e larta të Himalajeve në lindje, të cilat janë gjëra të mirënjohura për shkencën e historisë. Robert D'Angely në veprën e tij "**Enigma**" vë në pah faktin se dy mijë vjet para Lekës së Madh ka ekzistuar një dyndje e të bardhëve prej Evropës Juglindore drejt Lindjes. Ekspedita e Lekës, vë në dukje Robert D'Angely, ishte veçse një përsëdytje e së parës ekspeditë pellazge. Aristidh Kola nxjerr të vërteta edhe më të mprehta. Dardanët kanë bërë shtegëtime-ngulime të shumta drejt Lindjes, ku kanë përhapur kulturën dhe qytetërimin e tyre, madje gjer në Tibet e Indi, ku edhe sot e tutje në brigjet e lumit Ind ekziston një trevë që quhet **Dardanistan**, popullsia e të cilëve është e dhënë pas zejes së metalurgjisë, ngjashëm si profesioni i dardanëve të lashtë. Madje, thuhet se kur Leka i Madh arriti në Indi, priftërinjtë e atyshëm i rrëfyen për fushata të mëparshme të bashkëatdhetarëve të tij në atë vend.

Ndërkaq, nga rrëfenjat e lashta janë të njohura shtegëtimet epike të Dionisit dhe Herkulit drejt Lindjes. Pra, përforcohet një nga ligjet e mirënjohura shoqërore të shtegtimeve të mëdha të popullsive **"nga i njohuri te i njohuri"**, ku popullsia shtegëtuese paraprakisht ka të dhëna mbi popullsitë ku mund të zhvendoset. Një udhëtar i vetëm mund të shkojë drejt së panjohurës, drejt një vendi të panjohur, porse një popullsi shkon drejt së njohurës, drejt një vendi me popullsi të njohur. Duket, se ekspedita epike e Lekës së Madh ishte veçse përvijim i ekspeditave të mëparshme pellazge në ato vende. Robert D'Angely madje paraqet një fakt tjetër interesant: ushtarët e Lekës u hakërryen pamasë nga udhëheqësi i tyre, kur ky i fundit u kërkonte të vazhdonin edhe më tej brenda Indisë dhe ata thoshin se nuk donin të shkonin më larg së stërgjyshërit e tyre.

Ngulimet e ushtrisë së Lekës së Madh në viset e pushtuara aziatike janë kyçi i zgjidhjes së enigmës së popullsive të bardha në Azi. Sipas jetëshkruesit të Lekës së Madh, Arrianit, pjesa më e madhe e ushtrisë së Lekës përbëhej nga ushtarë me zanafillë iliro-trake (ilirë, trakë, maqedonë, peonë, agrianë, etj.) si 'popujt më të fortë dhe më luftarakë të Evropës kundrejt racave më të dobëta dhe më pak burrërore të Azisë'. Sipas studiuesit Eduin Zhak, Leka i Madh para se të nisej në fushatat e Lindjes kishte kërkuar nga qytet-shtetet greke 7000 ushtarë, por faktikisht siguroi shumë më pak. Madje, një studiues shqiptar (Qafëzezi, 1929) pohon se në ushtrinë e Lekës ishin vetëm 600 grekë. Duket se Leka i Madh s'u zinte besë grekëve, prandaj ai mbështetej më shumë te maqedonët, epirotasit, ilirët e trakasit. Më tej, gjithnjë sipas Eduin Zhakut, në vitin 331 p. e. s. pakënaqësitë e grekëve ndaj Lidhjes së Korintit rrjedhuan në kryengritje e cila kërkonte ndërhyrjen e maqedonëve për ta shtypur këtë kryengritje. Prandaj, Leka i liroi nga ushtria e tij të gjithë aleatët e vegjël grekë dhe vitet që pasuan vazhdoi pa ndihmën e tyre. Ky fakt është më se i mjaftueshëm (në mesin e shumë të tjerëve) për ta hedhur poshtë pretendimin e pabazë se gjoja pasardhësit e Lekës në Azi janë grekë. Prandaj, me arsye të thjeshtë çelësi i hapjes së enigmës së pasardhësve të Lekës në Azi kërkohet pikërisht te pasardhësit e Lekës dhe ushtrisë së tij në Evropën Juglindore, saktësisht te populli shqiptar.

"Përgjigjja gjendet në përbërjen e ushtrisë së Aleksandrit të Madh, d. m. Th. në popullin që jo vetëm pushtoi Azinë, por edhe u vendos në vendet e pushtuara si klasë udhëheqëse. Ky popull ishin maqedonasit dhe ilirët, d. m. th. populli i vendit që kishte për burim popullin pellazgjik...", - shkruan Aristidh Kola në librin e tij "**Gjuha e Perëndive**", **Plejad 2003, fq. 73.**

Fushatat luftarake të Lekës së Madh në malësitë e Baktrienisë (Afganistani i sotëm) dhe Sogdianës (330-327 p. e. S.) fatmirësisht janë të dokumentuara. Pushtimi i këtyre krahinave të pabindura e dërmoi rëndë ushtrinë e Lekës. Ndërsa, marshimi kundër Indisë së madhe për pak sa nuk e ndjelli një rebelim-dezertim shkatërrimtar në ushtrinë e Lekës, e cila ishte e lodhur

nga pushtimet e tepërta. Vlen të nënvizohet fakti se në Baktrieni Leka kishte lënë prapa 10 mijë këmbësorë dhe 3500 kalorës me gjithë garnizionet në fortifikatat e ndryshme në pika kyçe rrugore e malore. Ndërprerja e mësymjes kundër Indisë dhe kthimi i detyruar prej ushtarëve Lekën ambicioz e vuri përballë një sprove të vështirë. Leka i Madh hamendësonte me të drejtë se kthimi i ushtrisë së tij në atdhe mund të shkaktonte humbjen e të gjitha tokave të fituara me gjak, veçmas në krahinat e Baktrienisë dhe Sogdianës. Leka i Madh zgjuarësisht shtroi një plan largpamës dhe gjenial: përse të mos martoheshin oficerët e tij të lartë maqedonë me gra persiane, në mënyrë që të krijohej një brez fisnikërie prej gjaku maqedono-persian? Vetë Leka u martua me dy gra: me Statirën, vajza e madhe e Darit dhe me Parisatisin, vajzën e vogël të Antarkserksit III. Më parë, për të paqësuar Baktrieninë, Leka qe martuar me Roksanën, bijën e një prijësi baktrien.

Arthur Ëaigall (Artur Vajgal 1880-1934), historian i Lekës së Madh, thotë se me këto veprime Leka donte që në zemrën e perandorisë persiane të krijonte një aristokraci të re si hallkë lidhjeje mes Lindjes dhe Perëndimit. Në gjysmën e parë të viti 324 p.e.s. në pallatin mbretëror të Suzës u bë zyrtarizimi i martesave aristokrate të 90 çifteve, domethënë oficerëve më të lartë të ushtrisë së Lekës me gra aristokrate perse. Ndërkohë, u kërkuan edhe 1000 vajza perse me origjinë të thjeshtë që duhej të lidhnin kurorë me oficerë të gradave të ulta dhe ushtarë të thjeshtë. Arthur Ëaigall vijon më tej në librin e tij (1933): ***"Bota duhej të pushtohej dhe njerëzimi duhej t'i qëndronte besnik atij dhe dinastisë së tij. Vendosja e marrëdhënieve të krushqisë në mes elementëve me ndikim politik te popujt, duhej t'i shërbente arritjes së këtij synimi. (...) Nga kujdesi për sigurinë e frontit lindor kundër kryengritjeve i interesonte që jo vetëm ushtria, me sa të ishte e mundur, të linte pas vetes një numër të mirë fëmijësh të lindur brenda martesës, të cilët do të rriteshin në shtresat e larta dhe të mesme të shoqërisë, por që edhe ndër viset e pushtuara të ruanin një kujtim miqësor për maqedonasit që të***

***mos kishte as hidhërim, as armiqësi.*"** ("Aleksandri i Madh", fq. 359-360, Shtëpia Botuese "Bargjini", Tiranë 2002).

Arif Mati në librin **"Shqipëria-Odiseja e pabesueshme e një populli parahelen"** shkruan: ***"Të gjithë ushtarët e kësaj ekspedite nuk u kthyen në vendlindjen e tyre: ata krijuan trungun e tyre dhe përhapen kulturën e gjuhën e tyre nëpër të gjithë Lindjen, prej Azisë së Vogël deri në Himalajë (mal maja), duke kaluar nëpër Persi, Baktrianë, Afganistan dhe Luginën e Indusit".*** **("Plejad" 2007, fq. 279)**

Mbretëri të veçuara pas shpërbërjes së perandorisë jetëshkurtër të Lekës kanë ekzistuar të pavarura për thuajse tre shekuj pas vdekjes së Lekës, deri te mbreti Hermes II (55 ose 35 p. e. s.). Lugina e Hundzës, ku jetojnë hundëzakë-burushët (Pakistani Verior), lugina Kalasha ku jeton fisi kalasha (Nuristan, Afganistan-Çitral, Pakistan), rrafshnalta e Pamirit (Taxhikistan) janë disa "ujdhesa" të të bardhëve që vazhdojnë ta ruajnë edhe sot e kësaj dite në ndërdijen e tyre se janë pasardhës të ushtarëve të Lekës së Madh. Këto populllsi të përveçme nuk janë gjë tjetër, veçse copëza të thyera të xhamit të perandorisë që krijoi kryepellazgu gjenial, Leka i Madh. Rrjedhimisht përforcohet thënia se këto populllsi janë pasardhëse të ushtrisë së Lekës, duke pasur si bazë historike: martesat e shumta maqedono-perse në Suzë më 324 p.e.s. Ky është shpjegimi i përgjithshëm historik i etnogjenezës së tyre, duke i shtuar kësaj edhe faktin që Leka i Madh prapa vetës la shumë garnizone në qytetet që mbanin emrin e tij. Populllsi nga Europa Juglindore i vinin pas ushtrisë së Lekës dhe mbushnin qytetet që krijoheshin. Prandaj, populllsitë e bardha në Azinë Qendrore janë pikërisht edhe rrjedhojë e atyre garnizoneve dhe qytetarëve që ruanin e mbushnin qytetet me emrin e Lekës. Këtu gjen vend më shumë se kudo tjetër thënia kuptimplotë e studiuesit të zellshëm britanik Ëadham Peacock në librin e tij të shkëlqyer - **"Albania: the Foundling State of Europe"** (London 1914) , i cili shkruan: ***"Njerëzit që mësyen në Babiloni, Persi dhe Indi ishin stërgjyshërit e shqiptarëve"*** (the men ëho marched to Babylon, Persia, and India ëere the ancestors of the Albanians).

Ndaj, sot në Azinë Qendrore në katërkufirin midis Avganistanit, Pakistanit, Taxhikistanit dhe Kinës, rrëzë maleve të Himalajeve, jetojnë tre fise iliriro-maqedone-arbërore-shqiptare:

1.Fisi i **Pamirëve**, me rreth 350.000 banorë,

2.Fisi i **Burrushëve**(burrave), me rreth 87.000 banorë,

3.Fisi i **Kalashëve**, me rreth 60.000 banorë.

2.Mbretëria maqedone në Indi

Ilirët e Baktrisë (mbretëri ilire pasaleksandriane), të prirë nga Demetri i Parë dhe nga Menandri, shumë kohë pas vdekjes së Aleksandrit të Madh e pushtuan një pjesë të madhe të Indisë rreth vitit 200 p. e. s. Trojet e pushtuara ishin shumë më të mëdha se ato që pushtoi Aleksandri i Madh në Indi.

Është me rëndësi të ceket se paraardhësit e kalashëve, khovarëve dhe nurestanëve në atë kohë ishin fise të pastra ilire dhe u qeverisën për dy shekuj rresht nga një shtet kombëtar i tyre. Gjuha e këtyre fiseve ilire dhe gjuha amtare e sundimtarëve të kësaj mbretërie ishte shqipja e lashtë. Helenishtja ishte vetëm një gjuhë konvencionale, një lingua franca që përdorej në tregti, shkencë, komunikim ndërkombëtar, diplomaci etj. Vendësit kanë folur gjuhët e tyre lokale, por shqipja ka lënë gjurmë në gjuhët e tyre. Ndër të tjera, në sanskritishte u huazua fjala "kalem" (kalamo) dhe "fre i kalit" (khalina).

Ushtarët ilirë ishin të armatosur me heshta, shpata dhe harqe. Përveç kalorësisë, kishin edhe elefantë. Numri i ushtarëve ishte shumë i madh. Një sundimtar indian, i quajtur Kalinga, kishte 60.000 këmbësorë, 1.000 kalorës dhe 700 elefantë, por ai e konsideronte ushtrinë ilire të Dhemetriut "shumë të madhe". Shkrimtari romak, Justini, shkruan se ushtria e Dhemetriut të Dytë i kishte 60.000 ushtarë.

Mbretëria ilire e Indisë zhvilloi tregtinë detare në Oqeanin Indian, ku për herë të parë u bë lundrimi nga Egjipti në Indi. Anijet qarkullonin nga Egjipit Ptolemean (Deti i Kuq) dhe arrinin

në deltën e lumit Ind. Eudoksi i Kyzikut raporton për një udhëtim të suksesshëm rreth vitit 130 p. e. s., ku një anije e mbushur me parfume dhe gurë të çmueshëm arriti në Indi. Aty kah fundi i mbretërimit të ilirëve, për çdo ditë 120 anije arrinin nga Egjipti në Indi përplot me mallra. Bëhej tregti edhe me Kinën, nga ku importohej dru bambusi. Sasia e madhe e monedhave në përdorim dëshmon një veprimtari të madhe xehetare.

Nuk ka pikëdyshimi se pjesa dërmuese e ushtrisë së Lekës së Madh mbeti në Azinë Qendrore, d. m. th. nuk u kthye asnjëherë në vendlindjen Iliri-Maqedoni-Traki. Madje, shumë prej tyre gjykuan nga rrethanat e krijuara që të mbeteshin atje. Cilat janë arsyet që mbetën atje? 1) Si pasojë e nënshtrimit të monarkive satrape perse, ushtria e Lekës u imponua si një klasë sunduese, nga ku komandantët do të duhej të ishin sunduesit e rinj; oficerët zyrtarë të rinj - arisktokracia e monarkisë, dhe ushtarët, si klasë e privilegjuar.

2) Shumë fise iliro-trake që ishin në ushtrinë e Lekës nuk kishin edhe aq arsye të ktheheshin në Iliri e Traki. Përse? Sepse resurset ekonomike të tyre do të duhej të ishin më të gjera në viset e pushtuara se sa në atdhe. E dyta, sepse në Iliri e Traki asokohe fiset ishin në hasmëri të përbetuara me njëra-tjetrën.

3) Mosnjohja e territorit. Toka e pushtuar nga Leka i Madh përfshinte më se 3 milionë km², gjë që është një territor jashtëzakonisht i madh. Si pasojë e kësaj mosnjohjeje të një territori të gjerë, të huaj dhe të pasigurt për kthim, ushtarët e Lekës duhet të kenë preferuar që më mirë të qëndrojnë të sigurt nëpër pikat e larta malore e strategjike ku i ka caktuar Leka.

Edhe sot e kësaj dite në Indi është një vendbanim i quajtur ***Sikanderpur***. Ky qytet ishte themeluar nga Aleksandri i Madh. ***Pur*** në indishte d. m. th. ***"qytet"***. Sikur një qytet që përmendet dikund, Sikanderabad, ***"bad"*** është në arabisht ***"qytet"***. Janë katër qytete në zonën indike (Indi, Pakistan etj.) që quhen Sikanderpur.

Një mendim të njëjtë e jep edhe studiuesi klasik i Lekës së Madh gjatë vieteve '30-ta, George Radet, në librin e tij

"**Aleksandri i Madh"**. Ja ç'shkruhet në hyrje të librit të tij: "Ushtritë e Aleksandrit u ndeshën me ato vendëse. E luftërat mbaronin me përfundimin e aktit të nënshtrimit, bashkëpunimit dhe aleancën me Aleksandrin, ***i cili nga ana e tij krijoi një rrjet të tërë qytetesh të populluar me veteranë të ushtrisë së tij dhe koloni helene me fise të tjera, që falë Aleksandrit gjetën paqen e shpëtuan nga fqinjët armiq të papajtueshëm.*** Pasardhësit e këtyre protagonistëve, që luftuan, u pajtuan, u krushqizuan deri në atë shkallë sa Aleksandri me miqtë e tij e ushtrinë u bënë dhëndurë e me fëmijë të lindur nga këto martesa, u krijuan armata të rinjsh të edukuar me kulturën helene e artin ushtarak maqedon, me të cilët Aleksandri synonte ta çonte deri në fund ëndrrën e tij të sundimit".

3."Pas vdekjes s'Aleksandrit, maqedonasit bënë disa mbretëri n'Azi..."

Sami Frashëri

Vargmalet e pathyeshme të Hindukushit (Afganistani Verior), Pamirit(Taxhikistan) dhe Karakorumit (Pakistani Verior, Himalaje) krahas krenarisë së tyre si malet më të larta në botë, po nxjerrin në dritë qytetërime të pazakonta e befasuese për këto vise të harruara. Është fjala për disa bashkësi popullsish të racës së bardhë me gjuhë, zakone dhe kulturë të pavarur nga popullsitë e tjera përqark tyre. Këto "Atlantida" të njëmendta po bëhen gjithnjë e më shumë një temë e ethshme, tërheqëse dhe tunduese. Çështja bëhet edhe më e mprehtë kur kihet parasysh fakti se këto "qytetërime të fosilizuara" e të ndara nga pjesa tjetër e njerëzimit u kanë qëndruar kryeneçësisht furtunave shekullore në këtë rajon të përplasjes me qytetërimet aziatike: mongole, islame, budiste e hinduse. Interesimi për këto popullsi të bardha europiane në këto vise të humbura shfaqet që nga shekulli XIX prej dijetarëve e udhëpërshkruesve britanikë në Azi. Te ata qe krijuar bindja e përgjithshme se ekzistonin mbetje legjendare të ushtrisë së Lekës së Madh, të ngulitura thellë në malësitë aziatike. Një ide e tillë ishte edhe te romani "***Njeriu që don të***

bëhet mbret"(1888) i autorit **Joseph Rudyard Kipling** (1865-1936), libërqë kaloi edhe në film artistik më 1975.

Romani tjetër me nam "***Horizonte të humbura***"(1933) i **James Hilton**(1900-1954) përshkruan me imtësi jetën e këtyre popullsive epike. Dokumentim interesant në këtë aspekt ka lënë edhe danezi **Ole Olufsen** në librin e tij etnografik **"Përgjatë Pamirit të panjohur; ekspedita e dytë daneze 1898-1899",** ku thuhet se: ***"Leka i Madh njihet nga të gjithë popujt e Azisë Qendrore si Iskandar dhe sundimtarë të ndryshëm të luginave të Pamirit e konsiderojnë vetën si pasardhës të Iskandarit".***

Gjatë shekullit XX interesimi për këto popullsi të panjohura u shtua edhe më dhe, si rrjedhojë do të bëheshin dhjetëra ekspedita etnografike e dokumentime të tjera të vyeshme. Televizioni Kombëtar i Japonisë në reportazhin epik pesëvjeçar (vitet e '80-ta) mbi Rrugën e Mendafshtë e ka pohuar shumë çështjen e këtyre popullsive të bardha. Pohimi i një qytetërimi të shkëputur në kohë e hapësirë, ndër të tjerash, qe një thikë me dy presa, sepse menjëherë megafonët grekë nxituan të trumbetonin madhështinë e "qytetërimit helen" në botë! Ky falsifikim i vjetër me stil të ri krijoi keqpërkufizime të shumta mbi këto popullsi, duke iu mveshur ***a priori*** një "origjinë greke"!

4. Hundëzakët – 6 mijë kalorësit ilirë rrëzë Himalajeve

Hundëza është krahina më në veri të Pakistanit, një luginë-pllajë e gjërë e rrethuar nga malet shkëmbore të Karakorumit (vazhdimësi e Himalajeve). Lugina e Hundëzës zë sipërfaqe tokësore prej 10.101 km katrorë, afërsisht sa Kosova e sotme. Kjo luginë magjepsëse, e mbyllur midis malesh me dëborë të përjetshme, për një kohë të gjatë ka qenë e shkëputur prej pjesës tjetër të njerëzimit. Hundëza "theu" izolimin e saj më 1978, kur u ndërtua rruga më e lartë në botë që lidhte Kinën me Pakistanin, duke krijuar një epokë të re mbarsur me sprova për Hundëzën. Kryeqendra e Hundzës është qyteza e Baltitit. Lugina e Hundëzës është hëpërhë vendi më i vizituar nga turistët e huaj

në mbarë Pakistanin. Nuk ka dyshim se Hundëza është arketipi i "**Shangri-la**", vendit legjendar në romanin "**Horizonte të humbura**" të **James Hilton**'it. Një gjë pranohet nga të gjithë: njerëzit e Hundzës janë populli më mikëpritës në këto vise. Për qindra vjet me radhë Hundëza ka gjalluar si mbretëri e vetëqeverisur në krye me një prijës që vendasit e thërrasin **"Mir"**.

Pavarësinë e vet malësore Hundëza e humbi pas luftërave të gjata kundër perandorisë britanike më 1892, sundim i cili zgjati deri më 1949. Kurse, zyrtarisht si pjesë e Pakistanit u bë me 1974 në sajë të një marrveshjeje të Kombeve të Bashkuara.

Paraardhësit tanë, ilirët, janë shpërndarë gjithandej. Pas betejave pa lavdi të prijësve të tyre, ata endeshin në kërkim të një atdheu të dytë, larg nënshtrimit dhe shfrytëzimit. Në librin "Arvanitasit" historiani i madh me prejardhje shqiptare, Aristidh Kola, dëshmon një nga qindra histori të vendosjes së ilirëve në një shtet larg Ilirisë. Po ashtu edhe një skenarist i quajtur Hilton, xhiroi një fis në Pakistanin e largët. Vendi ku ishin vendosur këta njerëz quhej Hundëz. Hundëzakët, një fis me prejardhje ilire, tashmë edhe sot e kësaj dite me tradita, gjuhë dhe zakone të ndryshme, është vendosur në Kafiristan, në pjesën e Pakistanit, aty ku e kanë kufirin e përbashkët Afganistani, Pakistani, Kina e Taxhikistani. Historia e hulumtuar deri më sot tregon se këta janë pasardhësit e 6000 luftëtarëve ilirë, të larguar nga shteti i tyre pas vrasjes së mbretit Kliti nga Aleksandri i Madh. Karakteristikat e banorëve të Hundëzës janë të ndryshme nga ato të pakistanezëve. Ata jetojnë gjatë, janë shtatlartë dhe kanë flokë gështenjë, bëjnë dhe pijnë verë si askush tjetër nga zonat dhe rajoni ku jetojnë. Flasin një gjuhë të veçantë, e cila nuk shkruhet. Banorët e Hundëzës njihen si hundëzakë dhe shquhen nga popullsitë e tjera të Pakistanit. Si në planin antropologjik, antropometrik, etnologjik dhe përgjithësisht si kombësi e pavarur, hundëzakët dallojnë nga popullsitë e tjera përqark. Në gojëdhënat e përcjella brez pas brezi, hundëzakët ruajnë kujtimin për ushtarë të humbur të Lekës së Madh që u vendosen në këto male. Këta ushtarë të humbur mendohet se janë vendosur në

Hundëzë rreth vitit 300 p. e. s., nja 23 vjet pas vdekjes së Lekës. Çdo përshkrim antropologjik ka prodhuar të njëjtin pohim: ata janë të bardhë me mollëza të mërdhezura, kanë përgjithsisht sy të kaltër, flokë të kuq ose të gështenjtë dhe trup të gjatë.

Agjencia e lajmeve angleze, BBC, ka rizbuluar një fshat me emrin Hundëzë midis Afganistanit dhe Pakistanit, banorët e të cilit flasin në një gjuhë të klasifikuar si ***maqedonishte e lashtë*** ose si ***ilirisht***. Më pas atje kanë shkuar studiues të ndryshëm nga Amerika dhe Evropa, kanë filmuar dhe kanë botuar studime e libra të shumtë. Një revistë e botuar në SHBA që merret me çështje gjuhësore, "History of Language", në numrin e saj të 6-të është ka botuar një artikull nga studjuesja Elena Bashir lidhur me pasardhësit e maqedonëve të Lekës së Madh, të cilët banojnë në dy krahina në të dyja anët e kufirit avgano-pakistanez.

Më 1961 Xhoi Hofman dhe gruaja e tij, Trudi, janë finansuar nga një akademi shkencore amerikane për të shkuar në Pakistan te ky venbanim antik. Ata arritën në fshatin Hundëza, i cili shtrihet pranë një lumi me të njëktin emër rrëzë maleve shumë të larta. Emri i këtij fshati e lumi lidhen me emrin shqip: ***Hundë-a,*** ndaj edhe banorët quhen ***hundëzakë.***

Hundëzakët nuk njiheshin nga shkenca deri në vitin 1890. Gojëdhëna e fshatarëve flet për 5 oficerë ilirë të ushtrisë së Aleksandrit të Madh, të cilët në kohën kur ushtria maqedone marshonte drejt Persisë në kthim nga India, ishin ndarë bashkë me familjet e tyre nga ushtria dhe ishin kthyer në luginën e lumit, duke ngritur banesat e themeluar fshatin e Hundëzës. Kjo ka ndodhur afërsisht në vitin 310 p. e. s.

Banorët e Hundëzës kanë flokë të verdhë, sy të kaltër, fytyrë të bardhë dhe formë të kafkës si të maqedonëve ilirë të Aleksandrit të Madh. Hundëzakët maqedonë gjatë gjithë këtyre 2300 viteve kanë jetuar të izoluar e të vetmuar në një reliev gjeografik malor. Dr. Hofman dhe shoqja e tij kurreshtare ndoqën në këmbë rrugën e ashpër e të thepisur që çon në fshatin Hundëzë, të cilën ata e quajtën "rruga më e rrezikshme e botës". Vetëm në vitin 1980 Kina ka finansuar ndërtimin e një rruge tregtare që përshkon luginën e Hundëzës. Dr.Hofman në librin e

tij shkruan se hundëzakët, duke jetuar në një rajon të izoluar me natyrë të paprekur nga industria "civilizuese", janë njerëzit më të shëndetshëm e më jetëgjatë të botës, me një jetë mesatare prej 120 vjetësh. Studiuesi Hofman, ndër të tjera, arriti të zbulojë 15 sekrete të jetës origjinale të hundëzakëve, prandaj edhe librin e tij e titulloi: ***"15 sekretet e njerëzve më të shëndetshëm dhe më jetëgjatë të planetit"***.

Hundëzakët janë kopshtarë, jetojnë në një luginë që shtrihet 3000 metra mbi nivelin e detit. Kopshtet e tyre frutore natyrore-biologjike, uji i mineral i akullt, mjedisi i qetë e pa strese, ajri kimikisht i pastër, ushtrimet natyrore, lëvizjet dhe ecjet fizike, gjumi nga mbrëmja në mëngjes, ushqimet me shumë pak karbohidrate(pothuaj pa yndyra), pijet e shëndetshme bimore e frutore(nuk e njohin alkoolin si pije, as pijet freskuese të gazuara e me kafetinë), raporti i caktuar gjeografik i tokës, lartësisë dhe ajrit…, kanë bërë të mundur që hundëzakët të arrijnë moshën e quajtur ***adamike*** (për burrat) dhe ***amenses*** (për gratë).

Ky vend i shërben krijuesit Xhon Hillton për të shkruar librin me titull: ***"Horizonti i humbur"***, në të cilin ai shkruan se në vendin e vetmuar, në Hundëzë, koha është ndalur.

Jetëgjatësia e hundëzakëve frymëzoi revistën autoritative shkencore ***"National Geografic"*** që të shkruajë shumë herë për ta, duke finansuar disa ekspedita. Sipas kësaj reviste, hundëzakët hanë bukë prej ***meli***, kurse frutat e mineralizuara, që rriten në këtë vend, kanë shije të pazakontë. Sa për kurreshtje: presidenti amerikan, Ronald Regan, porosiste për çdo muaj një sasi frutash nga Hundëza gjatë kohës kur ishte në Shtëpinë e Bardhë. Buka e hundëzakëve, sipas specialistëve, është shumë e përafërt me një lloj buke që përgatitej në Egjiptin e lashtë të faraonëve, rreth 5000 vjet më parë. Te hundëzakët nuk njihet mbipesha, as sëmundjet e zemrës e të kancerit, as nuk vuajnë nga prishja e dhëmbëve deri afër moshës 1000 vjeç, nuk përdorin syza optike dhe e ruajnë shikimin e rregullt deri në vdekje. Gratë hundëzake 80-vjeçare duken si 40 vje,carë, burrat 90-vjecarë hundëzakë mund të përshkojnë në këmbë një rrugë prej 70 km. brenda ditës, ndonjëherë edhe duke bartur një barrë mbi shpinë.

Elena Bashir, në studimin e vet linguistik, citon disa studime gjuhësore paraprake mbi gjuhën e hundëzakëve, të kryera në vitet 1854-1871 nga studiuesit britanikë Kanin, Gam e Hejuart, si dhe studimet e bëra më 1970 nga Kilimov dhe Ederman. Elena Bashir në sintezën e saj vërteton se gjuha e hundëzakëve është një dialekt muzeor që lidhet me gjuhët e vjetra indoevropiane, si ilirishtja, por edhe me disa elementet ë vogla të greqishtes së vjetër. Duke shkuar në Hundëzë, "arrin" te një pjesë e pafundosur në det e kontinetit të Atlantidës, por të balsamosur për së gjalli te maqedono-ilirët e Hundëzës dhe te lugina e shtrirë midis shpatijeve të larta të Himalajeve. Në këtë mënyrë, kapedanët e Aleksandrit–Lekës së Madh u kanë lënë e u kanë dhënë diçka nga enigma e misteri i tyre pasardhësve të vet – shqiptarëve nga koha e largët e shekullit IV para erës sonë.

Aristidh P. Kola në librin e tij **"Arvanitasit dhe prejardhja e grekërve"** për Hundëzën shkruan: ***"Rreth 6 mijë ushtarë ilirë, pas vrasjes së Klitit nga Aleksandri i Madh, e veçuan pozicionin e tyre prej tij dhe u endën nëpër Braktanë, derisa përfunduan në Kafiristanin e sotëm, midis Afganistanit dhe Pakistanit verior".***

Para pak vjetësh skenaristi Xhejms Hilton xhiroi një dokumentar të titulluar "Horizonte të humbura"(Lost Horizons). Banorët e asaj zone quhen **burrushët** dhe janë të gjatë, të bardhë, me flokë gështenjë dhe jetojnë shumë vjet. Lugina ku jetojnë quhet në ditët e sotme **Hundëza** (hundë e vogël) dhe me të vërtetë kjo fushë mbyllet me një hundëz midis dy maleve që e rrethojnë. Një tjetër vendndodhje moçalore quhet **Balta**. Dialekti i burrushve të Hundëzës quhet **burrusheski**, që do të thotë **gjuhë e burrave**. Hundëzakët reaguan ndaj imponimit me forcë të fesë myslimane, ndaj, edhepse muslimanë, edhe sot bëjnë dhe pijnë (në kundërshtim nga të gjithë banorët e atjeshëm) verë e madje të përzierë me ujë, siç bënin të lashtët. Shumë zakone dhe tradita të tyre dëshmojnë prejardhjen iliro-arbërore. Këtë e dëshmon edhe Ernesto Skura në shkrimin e tij "Ilirët në Afganistan" në gazetën "Lidhja" të Antonio Bellushit, maj 1983.

Kërkimi në bibloteka dhe internet nxori shumë të dhëna, sqarime, studime, receta shëndeti dhe botime për Hundëzën dhe

gjuhën **burushaski**, ***gjuhën e burrave***, e cila është një gjuhë e pashkruar. Tani Kafiristanin e quajnë Nuristan–Vendi i Dritës, pasi që banorët kanë pranuar fenë myslimane. Kafiristan do të thotë Vendi i Kafirëve, Vendi i të Pafeve. Vendndodhja e Kafiristanit(Nuristanit) është aty ku takohen Afganistani, Pakistani, Kina e Taxhikistani. Hundëza ndodhet në pjesën e Pakistanit. Hundëzakët janë shumë të ndryshëm në krahasim me pakistanezët (që janë me lëkurë të errët) apo me afganistanasit, taxhikistanasit e kinezët. Hundëzakët janë të bardhë dhe me mollëza të kuqe. Shumica e 50 mijë hundëzakëve kanë sy blu, të gjelbër ose bojë hiri dhe flokë që kalojnë nga e verdha e misrit tek e zeza e korbit. Disa fëmijë kanë edhe flokë të kuq.

Lart në male është një fis i madh që quhet KALASH dhe ngjashmëria e tyre me paraardhësit evropianë të lë gojëhapur. Perënditë e kalashëve kryesohen nga perëndia Di-Zau (Diell-Zeus). Kalashët skalisin në portat e tyre edhe një gjë që shpreh origjinën e tyre të lashtë ilire dhe lidhjen e tyre me Aleksandrin e Madh: dy brirë dhije (edhe Skënderbeu dy brirë dhije kishte në përkrenare). Një lule të egër me ngjyrë të verdhë, që fëmijët e mbledhin në mal apo fushë, e quajnë BISHA.

Një libër gjuhësor i hollësishëm për rajonin e Hundëzës është botuar nga prof. Etienne Tiffou, "Hunza Proverbs", University of Calgary Press, Calgary 1993. Nga ky libër tregohet se hundëzakët përdorin shprehjet apo fjalët e mëposhtme: I bukur si yll (gjinia mashkullore). E bukur si Hëna (gjinia femërore). Foljet kam dhe baj në zgjedhimet e tyre të ndryshme, si psh., e kam ba; Dhelpra e quan të tharët rrushin kur nuk e arrin; zor (vështirë); Shtrij kambët sa ke jorganin; BUE (buejt e arës); Ku damë na zer besa; Sheja si ka ra e ka da; IN (nj_); BAR; Agon, a ke ni (po agon, e ndjen); bubullima; Çila (hapa); kurban; beson; hunda; ballkon etj.

5. Hundëza-vendi i vendosjes së maqedonëve ilirë

Ata që njohin gjuhën e mistereve të Qiellit e të Tokës.

Këta janë Hundëzakët, banorë të një lugine majë malesh, 2500 metra mbi nivelin e detit, aty ku takohen: Afganistani, Pakistani, Taxhikistani dhe Kina. Ata flasin Sanskritisht, sot e mijëra vjet, e kjo gjuhë në fakt nuk është gjë tjetër përveçse gjuha antike pellazgo-iliro-shqiptare.

Edhe pse vendi është malor, ai është shumë pjellor në prodhimin e zarzavateve, frutave e drithërave të ndryshme, si për shembull: patate, bizele, kastraveca, grurë, misër, elb, kajsi, dardhë, mollë, pjeshka, kumbulla, fiq, qershi, rrush, shalqi etj. Banorët janë bujq (ar-bërës) të shkëlqyer dhe kanë krijuar një sistem mahnitës e madhështor taracash dhe vaditjeje për to. Kanalet kullues, që lidhin dhe ushqejnë taracat me ujë quhen KULLSE. Një mal ngjitur me luginën është i mbuluar me akullnaja, të cilat rrëshqasin me kalimin e kohës, ky mal quhet RAKAPOSHI (Ra kah poshtë). Banorët jetojnë në harmoni të plotë, kanë shëndet shumë të mirë dhe rrojnë gjatë. Banorët e Hundëzës janë të gjatë, racë e bardhë dhe me flokë ngjyrë gështenjë. Banorët e Hundëzës rrojnë 100-140 vjeç dhe nuk njohin ndonjë sëmundje, çfardolloj qoftë. Njerëzit janë shumë mikpritës dhe ndihmues të njëri-tjetrit. Nuk ekziston ndonjë lloj krimi në Hundëza. Një djalë i lindur ushqehet me gji për tre vjet, kurse një vajzë për dy vjet dhe gjatë kësaj periudhe burri dhe gruaja nuk kanë marrëdhënie. Në Hundzë nuk ka ndarje të çifteve martesore.

Hundëzakët - tradita të njëjta me Shqiptarët

Banorëve u pëlqen të quhen hundëzakë (hunzakuts), e cila tingëllon saktë sipas shqipes. Vallet e hundëzakëve shoqërohen nga daullet, fyejt apo pipëzat dhe valltarët kërcejnë të kapur dorë më dorë në formë rrethi. Një valle popullore e rëndësishme është Vallja e Shpatave, që kërcehet vetëm nga burrat dhe valltarët vishen me rrobe me ngjyra të quajtura KAMARBUNDE. Veçan shtohet se për vallen e spikatur shqiptare të shpatave gjendet një pikturë madhështore në Vjenë, e punuar nga një piktor i famshëm austriak. Në raste festimesh më të vjetrit veshin

pelerina leshi të qëndisura, të quajtura Çuka. Kryetari i Hunzës e ka titullin "I MIRI" (The Mir). Në tetor bëhet festa e verës (pijes alkoolike). Gratë nuk janë të mbuluara me perçe. Festa më e rëndësishme është festimi i Vitit të Ri diellor (ashtu si pellazgët, arbëreshët) që festohet më 21 mars. Ky festim quhet NA UROSH dhe dita e parë e vitit të ri bie më 21 mars. Në një ditë të vetme të dhjetorit organizohen të gjitha martesat e vitit.

Zakonet shqiptare të hundëzakëve

Burrat veshin pantallona të bardha që i quajnë SHALVARE (shal–varë), ndërsa gratë bluzën e tyre e quajnë KAMISHE (Këmishë). Banorët tregojnë histori se si ata janë ngulmuar aty që nga koha e Aleksandrit të Madh. Nuk ka insekte, përveç mizës së zakonshme. Derri nuk ekziston atje dhe po ashtu edhe mishi i derrit nuk përdoret për t'u ngrënë. Ata mund të quhen 99 për qind vegjetarianë, sepse mishin e dhive të egra e hanë me pakicë, vetëm në dimër. Nuk hanë qen, mace, pula apo bretkosa. Veçanërisht dr. Hofman vërejti që banorët hanin shumë frutin e kajsisë dhe tulin e bërthamës së kajsisë, bile dhe aq yndyrë, sa përdorin e nxjerrin nga tuli i bërthamave të kajsive. Sipas Hofman, hundëzakët janë të shëndetshëm dhe të shlodhur. Jetojnë në një klimë të mirë, ku mbizotëron ajri i pastër. Hundëza është një vend me tokë pjellore në thellësi. Këta banorë kryejnë ushtrime fizike ditore, duke iu ngjitur dhe zbritur taracave. Sipas Hofman, ata bëjnë gjum të plotë dhe në qetësi absolute për tërë natën. Prirja e këtyre banorëve është të pijnë ujin që rrjedh nga akullnajat. Preferojnë çajin me rrëshirë shkëmbi që e quajnë "shëllir-jete". Hundëzakët nuk kanë shqetësime dhe ushqehen me vitamina e minerale frutash, drithëra të pasitur, zarzavate. Ushqehen me asortimente ushqimore të pasheqerosura, pa dhjamëra dhe yndyrna. Tek ata mungojnë sëmundje. Nuk e hanë mishin e derrit dhe janë pothuaj jomishngrënës. Nuk e pinë kafenë. Studimi i Hundëzës dhe hundëzakëve ka rëndësi të madhe për kulturën shqiptare, sepse, ngaqë ka qenë një vend i

izoluar për mijëra vjet, atje janë ruajtur të gjalla tiparet popullore gjuhësore e zakonore pellazge-ilire-arbëreshe-shqiptare.

6.Pamiri – Zgjidhja e një enigme iliro-maqedone

Ku është Pamiri? - Vështrim gjeografik

Krahina malore e Pamirit është një nga viset më magjepsëse të Azisë Qendrore. Pamiri përfshin një sipërfaqe të gjerë vargmalesh e pllajash që njihen rëndomë si Malet e Pamirit ose Pllajat e Pamirit. Pamiri gjendet në juglindje të Taxhikistanit të sotëm, pikërisht në provincën autonome të Gorno-Badakhshan, e cila për një kohë të gjatë kërkon shkëputje prej pjesës tjetër të Taxhikistanit.

Leka i Madh dhe Pamiri

"…Arnautët, ose shqiptarët si pasardhës të drejtpërdrejtë nga ilirët dhe maqedonët".
(Journal of the Royal Anthrpological Institute of Great Britain and Ireland - 1879, fq.232).

"Epirotët, ilirët dhe maqedonët e vjetër rilindën në mesjetë si raca bashkëkohore shqiptare". (Great races of mankind - John Clark Ridpath, 1893, fq. 209).

Në krahinën e Pamirit qenësojnë dhjetëra bashkësi të përveçme etnike të dallueshme njëra nga tjetra, por që e quajnë veten me etnonimin "pomirian". Disa prej këtyre bashkësive etnike shquhen nga të tjerat me faktin se janë të racës së bardhë. Për njëfarë kohe sundoi mendimi se popullsitë e Pamirit duhen të jenë me zanafillë iraniane. Njëra ndër bashkësitë e përveçme etnike në Pamir njihet me emrin uakhan, që numëron diku 15.000 frymë. Është për t'u shënuar se një pjesë e uakhanëve jetojnë edhe në Hunzë të Pakistanit, ndërsa pjesa tjetër e uakhanëve janë të ngjashëm jo vetëm antropologjikisht me kalashët, por kanë edhe pikëtakime gjuhësore. Ngjashmërisht, sikur që hundëzakët dhe kalashët e cilësojnë veten pasardhës të ushtarëve të Lekës së Madh ose Iskandarit, siç e kanë të ngulitur në vetëdijën e tyre,

poashtu edhe uakhit e quajnë vetëveten si pasardhës të Lekës së Madh (për më tepër shih: "Një udhëtim nëpër Pamirin afgan", A JOURNEY TO THE AFGHAN PAMIR".

Fushata e paharrueshme gjurmuese e sipërmarrë nga etnologu i guximshëm danez, Ole Olufsen në vitet 1898-99, shënon disa kënde tjera të prejardhjes së mundshme të popullsive të Pamirit nga ushtarët e Lekës së Madh. "Leka i Madh njihet nga të gjithë popujt e Azisë Qendrore si Iskandar dhe sundimtarë të ndryshëm të luginave të Pamirit e cilësojnë veten si pasardhës të Iskandarit", - shkruan Ole Olufsen në librin e tij të vyeshëm "Përgjatë Pamirit të panjohur, ekspedita e dytë daneze 1998-1999".

Leka i Madh

Siç e kemi vënë në dukje edhe më parë, pushtimet e Lekës u bënë më të zorshme në malësitë e Baktrisë dhe Sogdianës, nga ku fiset e atyshme sulmonin në mënyrë të befasishme dhe të çrregullt ushtrinë e Lekës e cila edhe ashtu ishte e pakënaqur me kuturisjet e udhëheqësit të tyre që nuk dinte për ndalje. Sidoqoftë, pas luftërave të rrepta Leka arriti të zaptojë këto krahina të pabindura në të cilat ai la një pjesë të garnizioneve të tij për të ruajtur rendin dhe lidhi martesë me bijën e një prijësi vendas, e cila njihet me emrin Roksana. Natyrisht, një lidhje e tillë e krushqisë i detyrohet më shumë arsyeve politike, sepse duke u lidhur martesa, synohej paqësimi i atyre krahinave. Kemi përmendur gjithashtu se pas vdekjes së Lekës së Madh asnjëri nga ushtarët e tij nuk u kthye në atdhe; ushtarët e tij mbetën në garnizionet ku ishin, garnizione të cilat duhet të jenë bërë pjesë e mbretërive të veçuara të ushtarëve të Lekës në Azinë Qendrore. Privelegji i të qenit klasë sunduese e ushtarëve të Lekës, sigurisht se u krijonte edhe epërsi; dhe pikërisht kjo epërsi e të sunduarit mund të jetë njëra nga arsyet e moszhdukjes së identitetit iliro-maqedonas të ushtarëve të mbetur në këto vise të harruara. Është fare e pavend të thuhet se bashkësitë etnike që e quajnë vetën pasrendëse të Lekës e kanë ruajtur të pandryshuar identitetin e

tyre burimor, ama fatmirësisht nuk janë përzier me raca të tjera. Aristidh Kola në librin e tij "Arvanitët dhe prejardhja e grekëve" shkruan se "Rreth 6 mijë ushtarë ilirë pas vrasjes së Klitit nga Aleksandri i Madh e veçuan pozicionin e tyre prej tij dhe u endën nëpër Braktanë, derisa përfunduan në Kafiristanin e sotëm, midis Afganistanit dhe Pakistanit verior". Ndërkaq, një pohim po kaq të sigurt e gjejmë gjithashtu edhe te historiani romak, Justini, i cili duke folur për caktimin e hisenikëve të perandorisë maqedone pas vdekjes së Lekës, thotë se "Iliri Pito u vu në krye të Medisë së Madhe…" (M. Junian Justini, Epitoma Historiarum Philippicarum Pompei Trogi, Libri XIII, 4, 13).

Ndonëse Media e Madhe dhe Baktria ndodhen larg njëra-tjetrës, fakti i pasqyruar nga Justini na jep arsye të mendojmë se edhe ushtarët e thjeshtë ilirë duhen të jenë vendosur pikërisht në këto vende, varësisht ku gjendeshin ata: nëpër garnizione, fortifikata, pika kyçe malore e rrugore, etj.

Gjurmë të tjera të Lekës së Madh në Pamir

Ekspedita të ndryshme turistike nënvizojnë faktin se diku në vargmalet e Pamirit gjendet liqeni Iskandarkul (vërejtje: Iskandar është shndërrim lindor i emrit Aleksandër, i emërtuar pas Lekës së Madh). Ky liqe është njëri prej më ngjashnjyesve në mbarë Azinë Qendrore. Këndejpari duhet të ketë kaluar Leka i Madh, duke synuar pushtimin e Samarkandit. Në viset rreth e përqark gjëllijnë shumë tregime legjendare mbi kultin e Lekës së Madh. Një tjetër dëshmi e pranisë së mëvonshme të Lekës së Madh në këto treva është edhe qyteti i Khujandit, i cili edhe pse nuk ndodhet bash në Pamir, por përtej Pamirit diku në Taxhikistanin Verior, i cili është themeluar nga Leka i Madh dhe është quajtur si Aleksandria e largët. Mbase një qytet i themeluar nga Leka i Madh logjikisht duhet të ketë qenë i populluar nga ushtarët e Lekës së Madh, sepse Leka i Madh synonte të mos linte prapashpine mundësi për kryengritje kundërmaqedone nga fiset vendëse. Në librin interesant 'Azia Qendrore: Kazakistani, Taxhikistani, Uzbekistani, Kirigistani' të grupit të autorëve

Bradley Mayheë, Greg Bloom, John Noble, Dean Starnes në faqen 368 flitet se Aleksandria e largët (dmth Khujandi i sotëm) ishte ngulimi (avanposti) më i largët në lindje i ushtrisë së Lekës së Madh. "Në të vërtetë, Leka nuk u zgjerua edhe aq shumë në Samarkand, por trupat e tij u kthyen sërish dhe Aleksandri i Madh vendosi të ndërtojë një kala të fuqishme në anën e Khujandit modern, i cili strategjikisht ishte i përsosur për mbrojtje dhe pushtim".

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të qartësohet një gjë sa i përket gjurmëve të Lekës së Madh në këto vise të Pamirit e gjetiu. Hulumtues të ndryshëm e pranojnë gjerësisht faktin e pranisë së padiskutueshme të ndikimit të Lekës së Madh, si në qytete të vjetra, rrugëkalime, liqene, madje ndonëse në mënyrë më të kursyer, edhe popullata pinjolle të ushtrisë së Lekës së Madh. Keqindentifikimi ka të bëjë me keqparaqitjen e këtyre gjurmëve si mbeturina të ushtrisë "greke" ose kulturës "greke". Nëse qytetet janë ndërtuar sipas stilit arkitektonik të Greqisë së lashtë, kjo nuk flet aspak se qytetet e Lekës së Madh në Azi janë greke. Sot qytetet që ndërtohen gjithandej botës bëhen sipas stilit të ndërtesave të larta amerikane; por kjo nuk i bën qytetet amerikane. Pjesa më e madhe e ushtrisë së Lekës së Madh ishte e përbërë nga popullsi jogreke, siç ishin maqedonët, fiset ilire e trake d. m. th. të së njejtës gjuhë. Kjo edhe është afërmendësh, për shkak se Leka i Madh e ka pasur precedanin e shpërthimit të qytet-shteteve greke kundër Lidhjes së Korintit, d.m.th kundër Maqedonisë. Sipas Laërence A. Tritle në librin e tij "The greek ëorld in the fourth century" fq. 123, thotë se Filipi (i ati i Lekës) me fitoren në Keronë mori kontrollin e gjithë qyteteve greke dhe se parandaloi një marrëveshje greko-perse. Gjatë tërë kohës, shtetet e nënshtruara greke nën sundimin e Lekës mezi prisnin të kryengriteshin kundër maqedonëve. Në librin interesant "Greek mercenaries: from the late archaic period to Alexander" Mattheë Trundle, në fq. 8 dhe 52 përmend se mbreti persian, Dari, angazhoi mbi 50.000 mercenarë grekë kundër Lekës së Madh. Prandaj, dosido Leka i Madh në ushtrinë e tij nuk mund të jetë mbështetur gjithaq në trupat greke: vendin më të rendësishëm

padyshim se e kanë zënë maqedonët, ilirët e trakasit që ishin të një trungu etnik. Këtu gjen vend thënia kuptimplotë e studiuesit të zellshëm britanik për shqiptarët, Ëadham Peacock, në librin e tij të shkëlqyer "Albania: the Foundling State of Europé" (London 1914), ku shkruan se "njerëzit që mësyen mbi Babiloninë, Persinë dhe Indinë ishin stërgjyshërit e shqiptarëve". Diodori i Sicilisë, i cili jetoi në kohën e Cezarit dhe Augustit romak ka lënë një fragment shumë të rendësishëm që mund të na ndihmojë sadopak ta përforcojmë mendimin tonë. Diodori thotë se "grekët që ishin vendosur në Baktri dhe Sogdianë, e që për një kohë të gjatë kishin duruar me hidhërim qendrimin e tyre midis njerëzve të racave të tjera, tani kur u përhapen fjala se mbreti ka vdekur prej plagëve të marra, ngrenë krye kundër maqedonëve. Ata krijuan një bandë prej 3000 burrash dhe kaluan nëpër vuajtje të mëdha gjatë rrugës së kthimit të tyre për në shtëpi. Më vonë ata u masakruan nga maqedonët pas vdekjes së Lekës". (Libri XVII 99.5-6)

Lidhjet me shqiptarët

Pamiri për njëfarë kohe është cilësuar nga mbështetësit e teorisë indo-europiane të gjuhëve si djepi i gjuhëve indo-europiane. Më pas, ky "djep" është zhvendosur edhe në vende të tjera, gjë që flet për pasigurinë e madhe të tezës indo-evropiane. Mirëpo, a thua përse u pandeh për njëfarë kohe Pamiri si djep i gjuhëve indo-europiane? Ky cilësim i Pamirit është jo i merituar dhe është shkaktuar nga mosnjohja e historikut të gjuhëve që fliten brenda Pamirit. Asnjëherë nuk i është dhënë rëndësi faktit të qartë se në Pamir kanë qenë vendosur fise iliro-maqedone të Lekës së Madh. Më vonë gjuha ilire e përhapur nëpër Pamir është menduar se është gjuha bërthamë, ndërkohë që gjuha bërthamë duhet kërkuar në hapësirën danubo-egjeane në Ballkan, ku jetonte i ndarë në fise populli pellazg.

Zanafilla e gjuhëve që fliten në Pamir duhet kërkuar në Iliri. Pamiri fatkeqësisht përgjatë historisë është kredhur nga dyndjet prej më të ndryshmëve të pushtuesve mongolë, iranianë etj.

Gjithsesi këto pushtime duhet të kenë pasur çmimin e vet: ato i kanë zhdukur emërtimet ilire ose, nëse nuk i kanë zhdukur, atëherë kanë krijuar përzierjet nga më të ndryshmet, që mund t'i ngatërrojë edhe studiuesit më të mirë. Dimë se emrat e maleve-oronimet, lumenjve e rrjedhave ujore-hidronimet, janë më të qendrueshme nga ndërfutjet gjuhësore. Si të tilla, duke e njohur aftësinë e qëndrueshmërisë së këtyre toponimeve, i duhen dhënë rëndësi më shumë për të njohur më mirë Pamirin. Në kapitullin për Hundëzën kemi nënvizuar se toponimi-etnonim Hunza ka një shpjegim të bindshëm që e jep gjuha shqipe, d.m.th. "Hundë e vogël", lugina-pllajë që ka trajtën e një hunde të rrethuar nga malet. Janë hedhur disa shpjegime të ndryshme mbi kuptimin etimologjik të fjalës "Pomir", mirëpo kjo nuk i ka dhënë fund mirë shpjegimit të plotë shkencor të emërtimit "Pamir". Pikërisht ky mosrrumbullakësim i etimologjisë së Pomirit kërkon domosdoshmërisht edhe shpjegime të tjera.

Një shpjegim goxha bindës mund ta gjejmë sërish nga gurra fjalësore e gjuhës shqipe, madje në dy mënyra. Zakonisht në literaturën historike dhe etnografike Pamiri njihet me po këtë emër, edhe pse banorët vendas e quajnë Pomir. "Pamir" në gjuhën shqipe mund të zbërthehet në dy fjalë: Pa=Pamje, Mir= e Mirë, pra: **Pamir=*Pamje e Mirë***, gjë që ka njëfarë logjike. Le ta bëjmë një përfytyrim sado modest: ta zëmë se jemi ushtarët e Lekës së Madh. Malet e pafundme të Hindokushit duhet t'i kenë lodhur me të vërtetë ushtarët e Lekës, mirëpo zbutja e terrenit malor dhe shfaqja e pllajave të magjishme e të pakufishme bëri që ushtarët e Lekës të kishin para syve të tyre një pamje të mirë. Varianti tjetër "Pomir" aspak nuk bie në kundërshtim me kuptimin e të parit, sepse Pomir në gjuhën shqipe mund të zbërthehet edhe si Po + Mirë. Që të dy variantet etimologjike të gjuhës shqipe përputhen plotësisht me të vërtetën dhe ndjenjën e mirë që shkakton kundrimi i pllajës së Pamirit nga malet e Hindokushit.

Në aspektin etnografik popullsitë e Pamirit ose Pomirit shfaqin një larmi trajtash të ndryshme që meritojnë një vrojtim të posaçëm. Në dyert e shtëpive pamiriane skaliten dy brirë të

përdredhur cjapi ose dhie, që mund të shihet edhe në Hundëzë ose në luginën Kalashe. Natyrisht, dukuria e ruajtjes së këtij simboli dybrirësh që është i lidhur pashmangshëm me Lekën e Madh dhe helmetën e tij me dy brirë dhie (sipas Plutarkut), është çështje që do trajtim më të gjërë.

Shkurtimisht, le të përmendim se kjo ndihmon edhe mbështetësit e teorisë së Dhul Qarnenit, personazhit legjendar të përmendur edhe në Kur'an, që e identifikojnë me Lekën e Madh. Dhul Qarnain në arabisht ka kuptimin e "Dy Brirëshit". Natyrisht, engima "Dhul Qarnain" nuk është zgjidhur ende, sepse ka interpretime nga më të ndryshmet, mirëpo simboli i dybrirëshit, i ruajtur besnikërisht në etosin pamirian, ofron një perspektivë tjetër në mbështetje të ithtarëve të Lekës së Madh. Tjetër aspekt që nguc vëmendjen tonë është edhe përdorimi i disa veglave muzikore që janë të ngjashme me lahutën shqiptare.

7. Kalashët

E njëjta gjë ndodh edhe me fisin kalash në Hindukush. Kalashët (Kalasha) janë një tjetër fis në malet e Hindukushit me kombësi të pavarur që rron në krahinën afgane të Nuristanit dhe në atë pakistaneze të Çitralit në pjesën veriperëndimore të Pakistanit (në luginat Bumburet, Rumbur dhe Birir). Sipas regjistrimit të vitit 1998, kalashët janë vlerësuar si një popullsi prej 3660 banorësh. Të tjera vlerësime këtë shifër e afrojnë deri në 4000 sish. Thonë se 5 ushtarë të Aleksandrit të Madh ishin ndalë në këtë pjesë të botës dhe ishin martuar me femrat e atij vendi. Ata janë më të bardhë se pakistanezët dhe ndyshojnë nga ata.

Paolo Graciozi, profesor i antropologjisë dhe parahistorisë në Universitetin e Firences, në një artikull të botuar në një revistë londineze më 1963 thotë se kalashët kanë trajta të pastra evropiano-mesdhetare, më saktësisht me ato të njerëzve alpin. Ai kalashët i përshkruan si njerëz me lëkurë të bardhë, tipare të rregullta të fytyrës dhe shtat të hedhur. Populli kalash është i veçantë në mbarë rajonin si për nga veshjet, doket e feja. Kjo kombësi gjykohet si popullata e vetme pagane në këtë rajon të

islamizuar. Kjo popullsi i ka bërë qëndresë të thekshme kalimit në islam, të cytur nga pushtuesit arabë, ndaj edhe sot e kësaj dite kalashët quhen "qafirë", kategorizim që muslimanët ua bëjnë "pabesimtarëve". Më vonë, kur një pjesë e kalashëve u islamizua, vendi i kalashëve që deri dikur quhej "**Qafiristan**" u rimërua si "**Nuristan**" (vend i dritës).

Pasi që këta ushtarë të Lekës së Madh janë martuar me femrat e atij vendi, natyrisht edhe gjuha e tyre është e përzier. Duke qenë se fëmijët flasin gjuhën e nënës, nuk mund të presim ngjashmëri shumë të madhe mes gjuhëve të kalashëve, burushëve e nuristanëve dhe me siguri edhe disa fiseve tjera. Por, me siguri mund të gjejmë shumë fjalë që kanë kuptimin e njejtë. Këta kanë mbetur prapa në kohë dhe me këtë edhe mënyra e jetesës, besimi i tyre i vjetër etj. Këta besojnë në vëllain e Zeusit, Zaun. Edhe kjo nuk është kurrfarë rastësie, sepse ZË, siç e dimë, ishte burimi i ZE-usit në toskërishte, kurse ZA gegnishte është burim i ZAU-t të kalashëve.

Këta e dinë fare mirë se prej nga e kanë prejardhjen (nga Leka i Madh), por kurrsesi nuk mund të dinë se kanë lidhje me shqiptarët. Sepse, historianët grekë i bënë të gjithë grekë, duke përfshi këtu edhe Lekën. Kjo është arsyeja pse sot kalashët thonë se e kanë prejardhjen prej grekëve.

***

Fisi pellazgo-ilir u shpëtua midis shekujsh dhe mijëvjeçarësh falë mundësisë së pafundme të rezervave që pozicioni gjeografik dhe morfologjia e terrenit i siguroi. Domethënë, burimi i madh i popullit tonë ndodhej në malet shkëmbore të Epirit dhe të Shqipërisë së sotme dhe prej andej, si lumenj grupesh popullore, kohë pas kohe zbriste për në Greqi, Itali dhe Azi të Vogël. Në këto vende si rezultat i kushteve pakrahasimisht më të mira zhvillohej qytetërimi i saj dhe u ndryshua nga njëri vend në tjetrin, sipas kushteve ekzistuese. Në çdo rast që popullsia në vendet e reja dobësohej për çdo lloj arsye, kishim zbritje dinamike grupore nga origjina. Zbritja e fundit është ajo e arbëreshëve të shekullit XIV.

Aleksandri i Madh, ilir nga nëna e tij, i kishte fuqizuar legjionet e tij me ushtarë të zgjedhur ilirë. Po nga kjo periudhë veçojmë se pas vrasjes së Klitit nga Aleksandri i Madh rreth 6 mijë ushtarë ilirë e veçuan pozicionin e tij nga ky i fundit dhe u endën nëpër Braktane, derisa u përqëndruan në Kafiristanin e sotëm, midis Pakistanit dhe Afganistanit….

Aleksandri i Madh kishte gjak ilir në venat e tij, ashpërsia e tij ilire nuk mund të krahasohet me atë të Periandrit dhe as me të gjithë mitet të varianteve të Ali Pashë Tepelenës. Ilirët nuk e gjetën asnjëherë rrugën që të çon në bashkim, megjithëse përpjekjet për të krijuar një konfederatë ishin të shumta. Por, pas luftës së Peloponezit dhe fitores së maqedonëve kundër helenëve ata luajtën një rol të rëndësishëm, megjithëse në Greqinë Jugore ashtu dhe atje nuk ishte e lehtë njohja e Aleksandrit të Madh, të cilit iu desh të jepte beteja të ashpra për të treguar vlerat e tij. Një nga armët më të forta të Filipit, aq dhe të Aleksandrit, nuk ishte dhe aq formacioni, rreshtimi i ushtrisë maqedone, se sa ari i Pangjeut. Pas Aleksandrit dhe pasardhësve kemi Pirron, i cili tregohet një nga prijësit më të aftë dhe më aktivë që përpiqet me hir apo me pahir të bashkojë ilirët.

8.Nga Dodona në Tibet

Atlantidën, mbi historinë e së cilës janë shkruar mbi 20 mijë libra, e kam rikujtuar sepse mendoj se raca ilire prej saj ka ardhur.
Xhuzepe Katapano

1. *Ëndrra e Hitlerit*

Kjo ëndërr zuri fill pikërisht në shkretëtirën e Saharasë, aty ku piramidat madhështore të faraonëve qëndrojnë si të tërhequra mbrapa ndërtimit më të lashtë, *SFINKSIT*, vepër e atlantidasve, që i kishin shpëtuar Përmbytjes.

Më 1938, falë mikpritjes së derës mbretërore shqiptare të Egjiptit, studiuesi Xhuzepe Katapano vendosi të priste rrezet e

para të agimit pranë piramidave të Saharasë, një rit i lashtë i fshatrave arbëreshe të Sicilisë. Edhe mbas 46 viteve, kur e mbaroi veprën e tij « Thoti fliste shqip », ai e kujton këtë çast magjik:

"Drita e Lindjes, ndërsa ngjitej drejt qiellit, përhapej me ngjyrim të zbetë trëndafili që forcohej gradualisht, duke ndriçuar qetësisht Sfinksin, me ato buzët e trasha të palëvizshme në përputhje të plotë me emrin, i cili, si të gjithë emrat në zanafillë, tregonte thelbin dhe funksionin e tij: SFINGE. (SFJET + GJË, do të thotë « s'flet gjë, hesht», zbërthyer nga studiuesi Bernardo Bilota (1843 - 1918) në librin: "Studime filologjike rreth parahistorikëve", Kastrovilar 1915).

Sfinksi është emërtuar "Varri i Hermesit", i njohur në Egjiptin e lashtë me emrin shqiptar "Thot" (ai që thotë, na flet) nga doktrina e të cilit u frymëzuan Iniciuesit e Mëdhenj të njerëzimit, si Rama (cikli arian), Krishna (inicimi bramanik), Orfeu (misteret dionisiake), Pitagora (misteret e Delfit), Platoni (misteret eleuziane) dhe Moisiu (misioni izraelit).

Askush deri më sot nuk ka mundur të hyjë në varrin e Thotit. Sfinksi, ashtu si shqiponja e ilirëve apo e Perandorisë Romake, përfaqëson *DRITËN* dhe *DIJEN* në përgjithësi (në dialektin çam, fjala "di" do të thotë "dije" dhe "u bë dritë").

Viti 1938, për rastësi të fatit, do të shënonte dy nisma që lidheshin me ndërtuesit e Sfinksit:

E para, ajo e Xh. Katapanos që zbuloi alfabetin fonetik të hieroglifeve egjiptian, me anën e gjuhës shqipe.

E dyta, nisjen e ekspeditës gjermane të zbulohen misteret e dijeve të Thot - it, të kyçura në heshtjen e përjetshme të Sfinksit.

Ishte Himleri (Heinrich Himmler), themeluesi i repartit special SS, që ia ushqeu këtë ëndërr Fyhrerit të tij. Të dy krerët e nazizmit shpresonin të zbulonin shkencën e atlantidëve dhe, sidomos formulat magjike të sundonin botën si arianët mitikë. Sipas filologëve dhe antropologëve gjermanë të shkekujve XIX - XX gjermanët e kohëve moderne ishin me origjinë nga popujt e lashtë arianë. Ferdinand Osendovski në librin e tij (Ferdinand Ossendoëski: «Bêtes, hommes et dieux») pohon se disa Lama të Tibetit i kishin folur për një vend të fshehur në thellësi të tokës të

emërtuar "Agati" (në shqip: ag-dritë + Ati-Zoti d. m. th. Zoti-Dritë) që ishte vendqëndrimi i Mbretit të Botës. Një mbret i jashtzakonshëm që ndër shekuj kontrollon fatet e njerëzimit. Himleri ishte i magjepsur nga Tibeti dhe ishte i bindur se pikërisht aty ishte origjina e racës ariane dhe aty ruheshin forcat e lashta të pushtetit. Ekspedita me shkencëtarë gjermanë, e udhëhequr nga biologu Ernest Shefer (të gjithë anëtarë të trupave SS), u nis nga porti i Gjenovës më 21 prill 1938 në drejtim të Indisë britanike për të kërkuar "rrënjët e humbura të popullit gjerman". Pas afro katër muajsh përpjekjesh për t'u lejuar të hynin në "qytetin e ndaluar" budist, Lhasa, grupi i shkencëtarëve gjermanë më së fundi qëndronte perballë tij. Antropologu Bruno Beger kishte marrë urdhër nga Hitleri të zbulonte ngjashmëritë e kafkës midis popujve gjermanikë dhe tibetianëve. Sipas Hitlerit, në rast se kjo vërtetohej, çdo forcë magjike që kishin trashëguar dijet e tibetianëve nga arianët e lashtë, ju takonin edhe gjermanëve. Vetë ekspedita ishte emërtuar «Trashëgimia e paraardhësve»(Héritage des Ancêtres). Beger bëri qindra matje atropometrike të formës së kafkës, mbi vetullat, përmasat e fytyrës, por me gjithë kujdesin që patën kërkimet e tij, tiparet e gjermanëve nuk ishin të ngjashme me ato të banorëve aziatikë në Tibet. Studiuesi nuk gjeti aty as ndonjë banor me flokë bjondë dhe sy bojë qielli. Të gjithë shkencëtarët i mundonte pyetja: A ka ekzistuar vërtetë një racë ariane dhe a ndodheshin vërtet në Tibet dijet dhe formulat e tyre magjike? Megjithatë, Sheferi arriti të marrë lejen për të vizituar fortesën Orion-Burakan, të ndërtuar nga mbreti i parë i Tibetit para 1500 viteve. Për habinë e madhe të shkencëtarëve gjermanë, në vend të dijeve magjike të arianëve të lashtë, në Tibet ata gjetën simbolin e tyre nazist "Svastikën", me përmasa gjigante të shtrirë mbi faqen e një mali me emrin "Kalash". Prej shpateve të tij buronin tre lumenjtë më të mëdhenj të botës. Mali Kalash mbahej si një mal hyjnor nga tre besime të ndryshme të Azisë dhe ndodhej 1500 km në perëndim të qytetit të Dalaj Lamës në Tibet. Fillimi i luftës II Botërore e detyroi Sheferin të ndërpriste kërkimet e mëtejshme dhe të kthehej mbrapsht. Vetëm pas afro 50 vitesh nga ekspedita gjermane në

Tibet, 200 km larg malit të shenjtë Kalash u zbuluan gërmadhat e një mbretërie të lashtë tibetiane. Kryeqyteti i mbretërisë legjendare, Kuke, ishte gërmuar tërësisht në brendësi të një mali.

Mali i shenjtë budist Kalash në Tibet

Këtu po e lëmë ekspeditën e Sheferit dhe ëndrrën e humbur të Hitlerit dhe do të nisim një "ekspeditë" të re: Zbulimin e mbretit-perëndi, që sipas traditës së popujve prehistorikë, i dha emrin e tij malit të shenjtë *KALASH* dhe popullit mitik më të famshëm të lashtësisë.

2.Kalashët - ushtarë të Aleksandrit

Koloneli anglez Robertson, qe i pari evropian që zbuloi në fund të shekullit XIX në veri të Gadishullit Indian, mes vargmalit të Hindukushit (Afganistani Verior), Pamirit (Taxhikistan) dhe



Karakorumit (Pakistani Verior, Himalajë) një popullsi të racës evropiane që jetonte në izolim të plotë nga popullsia aziatike që e rrethonte. Një luginë e kësaj zone malore dhe banorët e bardhë të saj emërtohen gjithashtu si mali i shenjtë i budistëve tibetianë: Kalash. Kalashët banojnë në malet e Hindukushit në krahinën afgane të Nuristanit dhe në atë pakistaneze të Çitralit në pjesën veriperëndimore të Pakistanit (në luginat Bumburet, Rumbur dhe Birir). Janë një fis me popullsinë që jeton në luginën e Hundëzës të rrafshnaltës së Pamirit.

Gjuha që flasin "burushaski" (gjuhë e burrave në shqip) nuk ka asnjë lidhje me dialektet e folura në gadishullin indian. Sipas gjuhëtarëve, gjuha e kësaj popullsie për shkak të afrive mund të futet në familjen e gjuhëve dene-kaukaziane (denecaucasica), ku bëjnë pjesë gjuha baske dhe e Kaukazisë Qendrore. Gjuhëtari Ilia Kazul (Ilija Casule) mendon se gjuha burushaski shpreh ndikimin e një gjuhe të lashtë indoeuropiane. Analizat e ADN-së së kalashëve dhe hundëzakëve dëshmuan lidhjen gjenetike të tyre me popullsinë evropiane.

Studiuesit shqiptarë, duke krahasuar gjuhën e kësaj popullsie me gjuhën shqipe, kanë vërejtur jo vetëm rrënjë të përbashkëta, por edhe fjalë të njëjta që flasin kalashët dhe shqiptarët e ditëve të sotme. Kjo përputhje shfaqet qartazi në toponime, si psh: Lugina "Hundëza"-hundë; një vend moçalor emërtohet "Baltor" si dhe qyteti "Balti"–balta; mali Bubullimating, që mund të lidhet me fjalën e shqipes–bubullimë; Nuristan (nur-një pamje bukurie, dialekti çam). Edhe vargmali i Himalajave, sipas studiuesit Arif Mati, vjen nga gjuha shqipe (mal maja). Vetë emri i gadishullit e ka burimin nga besimi dhe gjuha e pellazgo-shqipetarëve: Hindi = hyn (në dialektin çam "hin") + Di-a, d. m. th. vëndi ku ka ardhur(hyrë) Zoti, emër që e ka edhe gjuha më e përhapur në gadishull–hindi. Edhe filozofi Sami Frashëri (1850 –1904) e emërtonte Hindi.

Nga studiuesit e huaj nuk është gjetur origjina dhe kuptimi gjuhësor në gjuhët evropiane, aziatike apo sanskriten e lashtë, për këto toponime dhe për vet gjuhën "burushaski". Ngjashmëria e madhe e kalashëve në veri të Gadishullit Indian

me shqipetarët e Gadishullit Ballkanik vërehet edhe në traditat historike kulturore, në ritet e simbolet e besimit dhe të jetesës së tyre të përditshme. "Zakonet rrojnë jo vetëm me shekuj, vëren J. G. Hahn, por edhe me mijëra vjet, bile kemi (edhe sot) zakone të vjetra, të cilave nuk ua dimë kuptimin".

Në vitet 20 të shekullit të kaluar amerikania Rose Lane udhëtoi drejt Malësisë së Shalës në veri të Shqipërisë. Në atë qoshe të harruar edhe nga Zoti u hap një debat me një malësor të moshuar, i cili ngulte këmbë se Filipi II, i ati i Aleksandrit, rridhte po nga raca ilire si e shoqja, Olimbija (Mirtali, stërmbesë e mbretit të mirmidonëve, Akilit). Një djalosh që po dëgjonte kundërshtimin e mikes së largët, e cila siç duket nuk i njihte "ligjet" e shqipetarëve, u hodh: " Shqipetarët martohen me shqipetarët. Filipi II u martua me një grua prej popullit të vet, siç ka qenë gjithëmonë zakoni. Po të ishte grek, asnjë i parë i shqipetarëve nuk do t'i jepte bijën për grua". Kjo traditë mijëravjeçare u shkel mbas 1945. Por hundëzakët e ruajnë me fanatizëm edhe sot këtë zakon. Ata nuk martohen me të huaj. Kalashët nuk i varrosin të vdekurit, por i lenë deri sa treten në sipërfaqe të tokës, zakon që e gjejmë edhe te disa krahina shqiptare. Banorët në Karmë dhe Galishtë të Malësisë së Veriut të Shqipërisë, i kishin treguar albanologut Nopça se të parët e tyre i linin mbi sipërfaqen e tokës të vdekurit dhe vetëm kur mbeteshin kockat, i varrosnin. Si iliro-shqipetarët, kalashët hundëzakë nuk e pranonin nënshtrimin ndaj të huajve dhe kanë luftuar për lirinë e tyrë.

Sipas të dhënave historike, për 900 vjet ata kanë patur principatën e tyre dhe kanë jetuar të pavarur nga ndonjë shtet i huaj deri në vitin 1974. Udhëheqësit kalashë në kohët e vjetra emërtoheshin *TSIAM* (Çam-popullsia e Tesprotisë), që më vonë u zëvëndësua me titullin *MIR* (i miri, i urti në shqip). Studiuesi Gulliam Darlling pohon se në gojëdhënat kalashe "Tsiam" është vendlindja e kombësisë së tyre, ku shpresojnë se do të kthehen një ditë. Sipas Aristidh Kolës, vendndodhja burimore e kalashëve është te lumi i lashtë tesprotas "Thiamis", prej nga rrjedh edhe vet emri i Çamërisë. "Tsiam" domethënë Çam. Dhia Amaltea,

sipas mitit pellazg, ushqeu Zeusin e Dodonës me qumështin e vet në ishullin e Kretës. Për adhurimin e dhisë në trojet arbërore ka shkruar Plini i Vjetër, Varoni, Eliani, Atheneu, etj. Dhinë e gjejmë të vizatuar në shpellën paleolitike pranë Butrintit (Shën Marinës) para afro 40 000 viteve. Edhe për kalashët dhe hundëzakët, dhia është kafshë hyjnore dhe gdhendin në dyert e shtëpive dy brirë dhije si simbol të mbrojtjes së tyre nga perendia Dezau (dhias-Zeus) dhe mbajnë për nder të tij një zjarr të pashuar në shtëpitë e tyre.

Skulpturë e fundit të shek. XIX të kafirëve Bashgali, gjetur në luginën Kalash të Pakistanit.

Është një skulpturë gruaje në fron me dy brirë dhie mbi kokë.

Koka e Zeusit pellazg me brirë dhie

Përkrenarja e heroit kombëtar të shqipetarëve,
Gjergj Kastrioti-Skënderbeut me një kokë dhie. (Muzeu i Vjenës)

Sipas gojëdhënave të tyre, kalashët dhe hundëzakët e quajnë veten pasardhës të ushtrisë së Aleksandrit të Madh– Iskanderit, që është edhe emri i heroit kombëtar të shqiptarëve dhe një emër shumë i përhapur dhe në ditët e sotme.

Po a janë vërtet kalashët burrat dhe gratë që e shoqëruan Aleksandrin e Madh deri në Indi?

Unë mendoj se faktet e sipërpërmëndura e mbështesin këtë origjinë sipas gojdhënave të tyre. Por, emri *KALASH* dhe *simbolet* e besimit që i kanë ruajtur deri në ditët e sotme, zbulojnë një prejardhje shumë më të lashtë, se sa koha e pushtimeve të Aleksandrit në Indi më 326 p. e. s.

3.Kalash = Sëastika

Do t'i trajtoj këto emra me anën e gjuhës shqipe, e nisur nga fakti i ngjashmërive të popullsisë kalashe në gjuhë, zakone dhe simbolet e bësimit me ato të trashëguara nga shqiptarët e ditëve të sotme. Jo pa qëllim kam vënë shenjën e barazimit midis emrit të malit Kalash dhe emrit të simbolit Svastika. Këto dy emra, siç do ta shikojmë më poshtë, jo vetëm që dëshmojnë përkatësinë e tyre pellazge, por edhe kanë të njejtin kuptim simbolik në besimin hënor të Dodonës dardano - tesprote.

Këto dy fise (të Kosovës dhe Iperisë) ishin jo vetëm *NJË GJINI* (Titanët=Tanët, gjaku ynë) siç e tregojnë edhe mitet, por edhe formuan besimin istitucional te pellazgëve në Dodonë.

Në këtë drejtim na ndihmon materiali i dy studiuesve të njohur të shkrimit pellazg, Luftulla dhe Liljana Peza, të cilët shprehen se "Sipas mendimit tonë, duke gërmuar në domethënien e fjalës Sëastika, del se kjo fjalë ka ardhur nga dy fjalë pellazge-shqipe, që më pas janë huazuar nga gjuha sanskrite. Pjesëza e parë e fjalës " Së" vjen po nga gjuha e lashtë pellazge Su = Zu (Zeu). Emri përbëhet nga dy fjalë: Zeu (Zeus) + ast d. m. th. "Zeusi asht" (dialekti gegë).

Unë do t'i shtoj edhe pjesën "Ka" (Së + ast (i) + ka) jo si mbaresë (në parahistori nuk ka patur mbaresa apo nyje), por si një fjalë që shpreh kuptimin e krejt emërtimit dhe do të thotë "Zeu është Ka (u) ". Zbërthimi i emrit të sipërpërmendur mbështetet edhe tek miti dhe skulpturat pellazge të Minotaurit. Minotauri pasqyrohet me kokë kau dhe disa herë me trup kali dhe kokë njeriu. Mendoj se pasqyrimi më i hershëm i minotaurit ka qënë me trupin e kaut, siç e dëshmon edhe emri. Kau dhe kali, siç do ta shikojmë më poshtë, mbartin të njejtin simbol në besimin hënor të pellazgëve.

Edhe emri Kalash ka po të njejtën ndërtim: Kal + ast, që në gjuhën e sotme bën Kal + ash (t), ku nënkuptohet emri i mbretit, siç ndodh edhe sot kur themi "është luan" pa thënë emrin e njeriut. Po ky emërtim vërehet edhe tek emri Deukalion, i cili së bashku me familjen shpëtuan nga përmbytja e madhe dhe krijuan racën e re njerëzore: Deu-Zeu + kal+i on d.m.th. mbreti-perëndi kali ynë (apo Zeu kalorësi i jonë).

Kau i shenjtë, perëndia Api në Egjiptin e lashtë. Brirët e tij në formën harkore mbajnë hënën e plotë, si perëndia hënore Isis, që dëshmon për besimin pellazg në Egjiptin e lashtë

Sipas albanologut G. Hahn, ky emër vjen nga gjuha shqipe "dhe - u".

Studiuesi nuk na e shpjegon pjesën tjetër të emrit dhe i marrë si "dhe-u" nuk ka kuptim sipas mitit. Plutarku dhe Aristoteli gojëdhënën e Deukalionit e lokalizojnë në krahinën e Dodonës në Çamëri dhe J. G. Hahn shprehet se: "Besoj që (ky emër, shën. im) është shumë i vjetër dhe priftërinjtë e Dodonës e kanë përdorur në vendin e tyre".

Po këtë emërtim e gjejmë si toponim në Shqipëri-Kalimash: Kal + im + ash (t), dmth. Zeu-kal i jonë.

Kokë kau e gjendur në Akropolin e Mikenës, shek. XVI p. e. s.

Siç vërejnë studiuesit, në besimin e kalashëve kali kishte një rëndësi të veçantë. Në shekullin XX, kur europianët mblodhën dhe restauruan objektet e kulteve të tyre, pjesa më e madhe e figurave prej druri ishin ato që paraqitnin kalin. Edhe në materialet arkeologjike të ilirëve, Dioskurët, binjakët e Zeusit paraqiten gjithmonë të shoqëruar me kuaj.

Në mitet pellazge kuajt me krahë shqiponje çojnë çdo vit Apolonin në vendin e Ipe - borealëve, fise dardane të Kosovës (Ipe-dialekti çam-shqiponjë + borë d.m.th. shqiponjat e vendit të borës).

Shqipetarët rritnin kope të mëdha me kuaj të racës. Këtë na e dëshmon edhe Pukëvili "…qentë e tmershëm (molosë-shënimi im) që ruajnë kopetë e bagëtive dhe kuajt e famshëm të Shqiperisë janë më të mirët në Turqinë evropiane, si nga bukuria e trupit, ashtu dhe nga shpejtësia e vrapimit»
(F. Pouqueville, Voyage dans la Gréce, Paris, 1820).

Në këtë pikë të "ekspeditës" sonë duhet të sqarohen dy probleme:

***Së pari*:** Përse emri "ka-u" = "ka-l" ("ka" është rrënja) në kuptimin simbolik të besimit pellazg?

***Së dyti*:** Nga e ka origjinën mbreti hyjnor i Tibetit me emrin Kalash?

Dua të theksoj se sqarimi i këtyre dy pikave lidhet me problemin më të rëndësishëm të historisë së lashtësisë evropiane: Vërtetësinë me fakte të ekzistencës historike të fiseve *ARIANE* dhe vëndin e *ORIGJINËS* së tyre.

Që të sqarohet pika e parë, duhet të zhytemi në thellësitë e parahistorisë, në përiudhën kur në besimin e njeriut primitiv nuk ishin krijuar akoma mitet e perëndive me pamjen e njeriut.

4. Svastika – energjia e përjetshme

Për të sqaruar pyetjen e parë, së pari duhet të kuptojmë së çfarë ka përfaqësuar simboli i sëastikës apo kryqi i thyer, siç e njohim sot. Padyshim sëastika është ndër vizatimet gjeometrike të parahistorisë. Ky simbol është gjetur i gdhëndur në kockat e mamutit (Gagarin) që i përkasin periudhës së fundit të akullnajave, si simbol i besimit të parë të njeriut primitiv.



Sëastika (kryqi i thyer) në vizatimet e kulturës pellazge Vinka (periudha neolite, mijëvjeçari 6 - 5 p. e. s.)

Qeramikë gjetur në Tebë 680 p. e. s.
Muzeu i Athinës-Britomartis

Arti etrusk, viti 700 p. e. s.

Vetëbesimi ka lindur krahas shkëputjes së njeriut nga bota shtazore (njeriu i Paleontropit) dhe siç shprehet M. Eliade: "Të jetojë si njeri, ishte në vetvete një veprim besimtar".

Ajo që i ka habitur studiuesit, ka qenë qenia e figurave të njejta gjeometrike, domethënia e të cilave duket se ka mbetur e pandryshuar gjatë 30 000-9 000 viteve në një hapësirë gjeografike prej bregut perëndimor franko-spanjoll e deri në Siberi.

Sipas studiuesit Leroi-Gourhan, kjo pandryshueshmëri e simboleve të besimit ka të bëjë me përhapjen nëpërmjet takimeve të ***të njëjtit sistem ideologjik*** që përcakton "besimin e shpellave".

Këtë fakt e ka pohuar edhe shkencëtari arbëresh, Xh. Katapano: "Studimet shumëvjeçare të rendit filozofik, teofizik, historik, arkeologjik, etnografik, mitologjik, matematik, kimik,

fizik më kanë çuar në përfundimin se ***duhet përmbysur tradita, që e paraqet qytetërimin neolitik si fryt kryqëzimesh***"

Ky pohim na sqaron se përse svastikën (krahas simboleve të tjera) e gjejmë në Evropë, Afrikë, Azinë e Afërt dhe të Largët e deri te astekët e Amerikës dhe përse ka ngjashmëri në simbole, mite dhe rite në këtë hapsirë gjeografike. Këto studime dëshmojnë tezën se Njeriut primitiv, duke lëvizur *NË VAZHDIMËSI* gjatë mijëravjeçarëve në hapsira shumë të mëdha gjeografike, ka përhapur (apo ju ka detyruar) vëndësve *NJË BESIM* zanafillor, atë më të zhvilluarin për kohën nga Evropa deri në Azinë e Largët, i cili u përhap nga *FISE TE SË NJEJTËS RACË*. (siç do të shtjellohet më poshtë).

Po çfarë simbilizon svastika? Studiuesi N. Stillo e trajton si shkronjë e shkrimeve lineare tepër të lashta në Evropë. Këto germa të shk VI, V, IV p. K. janë gjetur 14 km. në lindje të Beogradit, (Vinka), në Argisa të Larisës 8200 p. K. (Greqinë e sotme), në Sesklo të Magnezisë 8700 p. K., në manastiret e Çamërisë 5508 p. K. etj.

Kryqi bask

Siç është vërtetuar, njeriu primitiv, për të shprehur mendimin e shkruar me anën e hieroglifeve, ka marre si model figurat nga natyra dhe simbolet e besimit, një prej të cilave qe edhe svastika. Deri sot nuk është dhënë përgjigje shkencore se çfarë shpreh ajo në besim dhe jo rrallë lexojmë se është një simbol diellor. Duke parë materialin arkeologjik, vërejmë se ka patur paraqitje të ndryshme grafike të svastikës, por si pasqyrim i një simboli të vetëm në besim.

Buda



Qilim i fronit të Dalaj Lamës. Është simbol i riteve të besimit në Buddhism, Bön, Himalayan Shamanism, Korean Buddhism, dhe Japanese Buddhism



Hieroglifi që shpreh Svastikën në kulturën asteke e emërtuar "Teotihuacan"



Monument i Rilindjes i Armenisë

Svastika dhe briri i kaut.
Muzeu arkeologjik, Arle, Francë

Mozaik në bazilikën e qytetit të Tiranës (shek. IV - V)

Vërehet se i njëjti simbol përfshin pothuaj të gjithë botën dhe kudo shpreh të njëjtën ide: *LËVIZJEN*. Pra, svastika nuk ka paraqitur simbolin e diellit rrezatues, por të turbinës që është në lëvizje. N. Stillo vëren se në fjalorin arvanitas kemi fjalën "tërmboni" dhe në alfabetin neotosk kemi fjalën "türmboni" për pendën e mullirit me ujë, që në greqisht i thonë "turbinë". Këtë figurë e gjejmë si simbol në mburojën e eolasve dhe të Eneas që quhet si prijësi i parë dhe themelues i eolëve latinë.

Mullinjtë e ujit dhe të erës e morën idenë dhe modelin nga simboli dhe kuptimi që ka patur svastika në besimin e njeriut primitiv.

Se çfarë shprehte në besim rrënja "ka", do ta kërkoj tek popullsia pellazge, me gjuhën e së cilës (pellazgo-shqipen) janë emertuar **ka**u, **ka**li dhe svasti**ka**. "Ekspedita" jonë e lashtësisë nuk ka marrë parasysh kufijtë e sotëm shtetërorë, por do të përfshijë të gjithë hapsirën ku kanë jetuar këto fise. Përgjigjen e gjetëm pikërisht në shkrimet që u zbuluan në Egjipt, ku siç dihet dinastitë e para dhe më të famshme kanë qenë me origjinë *PELLAZGE*. Këtë e dëshmon edhe filozofia okulte, sipas së cilës egjiptianët e lashtë ishin atlantidët-arianë që shpëtuan nga

përmbytja. (Il Glossario Teosofico di Helena Petrovna Blavatsky, ROMA)

Për rrënjën "ka" që ndodhet në emërtimet Kalash-Svastika në librin "Mësimet e Ptahhotepit" të periudhës së faraonit Djedkare Isesi (mijëvjeçarit III p.K.), në besimin e kohës thuhet: "Maksima 26-Mbi përdorimin e drejtë ***të energjisë krijuese "ka***"; Ajo gjendet kudo në qeniet me shpirt dhe tek ato pa shpirt. I takon të urtit të mësojë se si ta përdorë Ka - në ".

Pra, svastika në të gjitha format e saj simbolizon në besimin e pëllazgëve *ENERGJINË KRIJUESE* të përjetshme, e njohur sot si "shpirti", të cilën Zoti e ka mëshiruar kudo në natyrë. Rrënja e njëjtë "ka" te emrat e Kaut e Kalit dëshmonte se këto kafshë ishin hyjnore dhe simbole të njëjta në besim. Në shumë monedha të shtetit të Epirit (Aleksandër dhe Pirro Molosit) paraqitet kau në sulm. Kau i flijohej perëndeshës Dhemetra, Zeusit tesprot, Dionisit, Apolonit etj. dhe shumë toponime mbanin emrin e tij. Në kostumet popullore të krahinave të ndryshme në Shqipëri gjendet i stilizuar kulti i kaut (Gjirokastër, Tepelenë, Berat, Kukës, Lezhë etj.)

Në mitet e lashta të popujve që kanë patur besimin hënor të Dodonës (Tesproti) apo janë ndikuar prej tij, "Energjinë Krijuese" e gjejmë edhe me një emër tjetër: "Mana". (F. Demi "Besimi hënor dëshmi e autoktonisë së Kombit Arbër")

Simbolin e svastikës e shikojmë edhe në objektin e kultit te kalashët. Këto dy skulptura binjake druri u janë kushtuar "Kultit të të parëve", që dëshmohet nga froni karakteristik në skulpturat e perëndive të parahistorisë. Tek këmba e drurit kemi simbolin e "energjisë krijuese-Ka". (Bumburet)
Dëshmi e origjinës pellzgo-ilire të kalashëve janë qeleshet mbi kokat e statujave, që është karaktëristikë vetëm e veshjes së iliroshqipetarëve.

Statujat e Kalashëve i kushtohen mitit pellazg të bijëve binjakë me qeleshe të Zeusit, bijë të Kaut,dëshmuar nga svastika.
Kjo skulpturë ju kushtohet dy binjakëve me qeleshe, Dioskurëve, bijve të Zeusit.

Në lashtësi veshja, modeli i flokëve, simbolet te armët, zbukurimet, etj. tregonin se ç' populllsie dhe besimi i përkisnin. Per iliro-romakët koka dhe bishti i kalit ishin vëndet ku ndodhej "ka"-ia dhe para betejave ua bënin fli perëndisë së luftës, Marte. Gjithashtu, në helmetat e tyre vendosnin bishtin e kalit, që Zoti t'i mbronte në luftë (fig. a).
Këtë "bisht kali" e gjejmë edhe në qeleshen e shqiptarëve, që dëshmonte lidhjen me Krijuesin.

Campo Marzio, Roma 100 p. K.

Bishti i kalit te qeleshja në kostumin shqiptar, Shkodër, shek. XX

Kau në zanafill ishte simbol kulti i hënës (brirët e tij kishin formën harkore të saj) dhe në gjetjet arkeologjike pasqyrohet si figurë e plotë ose vetëm koka apo brirët e tij, për të shprehur gjithmonë besimin *HËNOR* të iliro-pellazgëve. E theksoj këtë emërtim të besimit, sepse ka qenë besimi zanafillor i njeriut primitiv, më jetëgjati dhe më i fuqishmi në lashtësi. Dalja në skenë e mbretërve-heronj që vendosën pushtetin me anën e *FORCËS* ushtarake, *LIGJEVE* dhe *DIJES* mbi hapësira të mëdha gjeografike, solli ndryshime të mëdha në besim. Perënditë mashkullore të Evro-Azisë që u vendosën në Panteonin e Hyjnive(gjatë patriarkatit) morën nga perëndeshat, krahas fronit edhe simbolet e periudhës së hershme(të matriarkatit) kaun, shqiponjën, yllin-kryq, etj.

Perëndesha hënore e Dodonës, Sellena me dy dema

Siç dëshmon Maria Gimbutas ("Il linguaggio della Dea", f. 25, Venezia 2008), në artin e Paleolitikut, të Hekurit e sidomos të Bakrit, svastikën e gjejmë të shprehur në statujat primitive, enë balte, pllaka, altarë, etj. si shprehje e figurës femërore të hyjnizuar. Në përiudhat e më vonshme svastika u emërtua dhe iu bashkangjit figurave mashkullore.

Mbreti me brirët e kaut dhe hëna me yll
dëshmojnë besimin hënor në Persinë e shek. IV p.e.s.

Në Fjalorin e ezoteristes së shek. XIX të Helena Blavatski lexojmë se në alfabetin e hebrejve Kau (♉) është simbol i germës A(Aleph), me të cilën fillojnë pothuaj të gjithë alfabetet e botës. Kjo shkronjë ka një fuqi të madhe mistike dhe shpreh vlerën numerike "një".

Tek Kabala kristiane përfaqëson Trinitetin te Uniteti dhe është e ndërtuar nga dy Y me drejtim të kundërt (א), që nuk është gjë tjetër, pos svastika. Ky fakt dëshmon drejtësine e zbërthimit gjuhësor që kemi bërë, si dhe lashtësinë e gjuhës shqipe.

Shiva e Uma mbi kaun Nandī,
skulpturë në Prang Song Phi Nong, Tajlandë

Kau dhe Kali, që sipas bësimit pëllazg shprehnin "enegjinë hyjnore", kishin vlerë simbolike të barabartë. Shumë sende apo dukuri të ndryshme në natyrë, që shprehin simbole të njejtë në besim, u janë vënë emra apo kanë rrënjën e emrit të njejtë. Prandaj, emri i malit Kalash dhe i simbolit të Svastikës në faqen e tij, shprehin të njëjtin *PORTRET*–mbretin tokësor të hyjnizuar të Tibetit.

Vetëm të Tibetit... ?

5.Mbreti më i drejtë i antikitetit dhe më i harruari i historisë

Që emri Kalash i takon një mbreti tokësor të hyjnizuar, na e dëshmon Esiodi: "Perënditë dhe njerëzit e vdekshëm kanë të njëjtën origjinë" (Le opere e i giorni, 108).

Fakt që e mbështet edhe emri i popullit "kalash" që jeton edhe sot në atë hapësirë gjeografike. Studiuesi J. G. Hahn shkruan se "Nuk është nevoja të sjellim prova që shumë emra popujsh të vjetër janë të njejtë me emrat e perëndive të tyre kombëtare". Shëmbull është edhe emri Alban i shqiptarëve, siç do të shikojmë më poshtë.

Emri në parahistori ishte "biografia" e njeriut, d. m. Th. shprehte cilësitë apo "punët" e tij. Prandaj, njeriu kishte shumë emra, të cilat mund t'iu viheshin edhe të tjerëve në rast se dalloheshin për të njejtat merita. Hasim disa Zeus, Horos, Moisi, Herkul, Agamemnon, Dionis, etj. Në Mit kujtohej ai më i famshmi, bëmat e të cilit na kanë mbërritur deri më sot nga autorët e lashtë, objektet arkeologjike, gjuha dhe besimi.

Për të lehtësuar problemin, nuk po përshkruaj rrugën se si studiuesi Niko Stillo ("Etruskishte-Toskërishte") arriti të zbulojë disa nga emrat, shpikjet dhe heroizmat e "mbretit më të drejtë të antikitetit dhe më të haruar të historisë", siç e ka emërtuar ai bashkëkombasin e tij të parahistorisë.

Nga mitet më të njohura të lashtësisë është ai i Minotaurit, foton e të cilit e paraqitëm në fillim të materialit. Ky emër përbëhet prej: Mino+taur, d. m. Th. mino-kau dhe sipas N. Stillos bëhet fjalë për mbretin e Mikenës, Mino, i njohur edhe me shumë emra të tjerë. Në lashtësinë egjiptiane e gjejmë me emrin e faraonit tokësor, Amasi – t, që egjiptologët e quajnë Ahmose (1550 - 1525 p. e. s.).

Në gjuhën shqipe kalit i thonë edhe at, që është gjithashtu një nga emrat e Minos dhe në foton poshtë (fig. a) paraqitet si djalosh (në besim), i njohur me emrin Attis apo Atunis, në gjuhën shqipe zbërthehet: At + un (is) d. m.th. unë–Ati/Kal. Sipas Diodorit (Diodori 3, 70, 1) atë e quajnë "Ipokentaurë", gjysmëkalë dhe gjysmënjeri, "sepse ishin të parët që e zbutën kalin dhe u mbruajt miti se lindën dyformësh".

Kapelja “frige” e Attis apo Adonis (Kalorësi i parë) është e njejtë me atë të Zeusit dhe të shqiptarëvë të Çamërisë në shek. XIX.

Skulptura e Attis me qeleshen frige, shek. II p. e. s.

Në materialet arkeologjike mbretin e famshëm, Mino, e kemi të paraqitur në kulmin e moshës, gjysmëcjap e gjysmënjeri, i njohur me emrin PAN. Pani ose emri i plotë i tij-Alpan shpjegohet me dialektin çam të gjuhës shqipe: A LË PAN d. m.th. A (i pari) LË (lëri - vuri) PAN (panat - velat).
Sipas miteve, PANI qe i pari që përdori velat në anije.

Emri i tij është përjetësuar në vargmalet e Evropës dhe Shqipërisë Veriore, ALPET. Te latinët germa "p" u ndërua me "b" dhe sot e kemi emrin ALBAN, që përbën një nga emrat e shqiptarëve dhe e gjejmë si toponim në shumë vende të botës. Pani ka qenë mbreti-bari që mprehu kaun dhe i hipi kalit.

Në mite e njohim si baba të Zeusit të Olimpit me emrin Kroni. Emri i vërtetë i tij është Momfeu, mbret i Çamërisë-Tesprotisë.

Gerasa (Jerash), Giordania.
Dy svastika në dy anët e lepurit,
që në mite lidhet me hënën,
dhe majtas dallohet qartë emri PAN

Ky vend nga vendësit autoktonë emërtohej Iperi (Shqipëri–Ipe në dialektin çam "shqiponjë", zogu i Zeusit), ku nga shkruesit dy zanore kanë ndërruar vëndet (i/e) dhe ka mbetur Epir. Në Iperi lindën ritet e para të misterit dhe shumë mbretër e mbretëresha u hyjnizuan si perëndi.

Pani me kokë dhie dhe Kau në sulm me shkrimin poshtë:
Thorius(kau)-Albus.

Albani apo Pani kishte dy djem binjakë, mbretër-luftëtarë, shpikës, ligjvënës dhe priftërinj të mëdhenj: Nakon dhe Sharrian,

që historiografia i njeh me emrin *DIOSKURË.* Ata emërtoheshin kabirë (Cabir) (Ka+bir, në gjuhën shqipe: bij të Kaut), siç u emërtua edhe fisi i tyre.

Sipas Xh. Katapanos, pellazgo-ilirët duke kaluar nëpër Kaukaz i janë ngjitur vargmalit të Himalajave që në epokën e Gurit. Nga këto marshime drejt Lindjes, grykat shkëmbore të maleve të Kaukazit në lashtësi emërtoheshin "Portat e Albanit". Që nga ajo kohë nuk kanë reshtur emigrimet e këtyre fiseve drejt Lindjes. Ky fakt mbështetet në toponimet, gjuhën, mitet dhe simbolet e besimit pellazg, që kanë paralelet e tyre në Azi, sidomos në besim dhe gjuhën sanskrite. (shiko Petro Zheji: "Shqipja dhe sanskritishtja" II, Tiranë, Tertiumdatur, 2006)

Besimi në Azinë e lashtë, sipas teksteve të Rig Vedës, i përkiste një elite priftërinjsh të nënshtruar ndaj nje aristokracie ushtarake. Bëhet fjalë për një ushtri që u diktonte banorëve autoktonë me anën e forcës. Në Rig Vedën indiane flitej për një popullsi armike me emrin "Pani", të cilët u vidhnin lopët dhe nuk pranonin besimin vëndës.

Për pushtuesin më të madh të të gjitha kohërave na dëshmon edhe Diodori: « Më të kulturuarit ndërmjet indianëve tregojnë një mit (…) Thonë se në vitet më të lashta, atëherë kur banorët e vendit të tyre jetonin të shpërndarë në fshatra, arriti Dionisi nga anët e Perëndimit me një forcë të konsiderueshme. Përshkoi gjithë Indinë, ngaqë nuk ekzistonte asnjë qytet i rëndesishëm të kishte aftësinë që paraqiste qëndresë (...) u bë themelues i qyteteve të rëndësishme duke përmbledhur shumë fshatra bashkë në vënde të përshtatshme, u predikoi të nderojnë hyjnitë dhe parashtroi ligje dhe gjykata. Me pak fjalë, me veprat e shumta dhe të veçanta që kreu, u besua si zot dhe iu bënë nderime të pavdekshme. Thonë se mbarti bashkë me ushtrinë, një numër të madh grash dhe në betejat e luftës përdori tambure dhe cimbale, se ende nuk ishin shpikur trumbetat (...). Kreu vepra më të ndritshme nga çdo mbret tjetër para tij (…). Që Diodori flet për Albanin, mbretin e Tesprotisë, na e dëshmon jo vetëm N. Stillo që pohon se Dionisi dhe Ari ishin gjithashtu emrat e tij, por edhe emri i popullsisë "kalash" të Hundëzës, i

malit në Tibet dhe simbolit të svastikës, që kuptohen me gjuhën dhe mitet iliro-pellazge. Asnje gjuhë tjetër nuk i ka shpjeguar deri më sot.

Këtë e dëshmojnë edhe pasardhësit e fiseve iliro-pellazge: *ALBANËT* apo *ARBANËT* e sotëm (Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni, Greqi dhe diasporë) që, siç e vërtetuam në fillim të materialit, është e vetmja popullsi që ka ngjashmëri në gjuhë, besim e traditë me *KALASHËT* hundëzakë. Janë gjithashtu legjendat e kësaj popullsie që dëshmojnë se origjinën e kishin në Çamëri.

Përfundim

Emri i mbretit legjendar Kalash i përket mbretit tesprot, Alban (Alpan), ose Ari apo Joni, etj. Ushtria që mbeti pas tij dhe valët e fiseve iliro-pellazge që vijuan të shkojnë në Lindje, siç bëri edhe Aleksandri i Madh, përhapën në Azinë e Largët kultin e besimit hënor të Dodonës. Ata e "vulosën" emrin e tij (svastikën) në shpatin e malit të shenjtë në Tibet dhe në besimin budist. Këto fise pellazge qenë të parët që hapën rrugën midis Perëndimit dhe Lindjes, e cila më vonë u emërtua "Rruga e mëndafshit".

Origjina *ALBANE* dhe vendlindja *NË TREVAT HISTORIKE TË ARBËRVE* e mbretit ***ARI*** dhe e fiseve të tij ***"ariane"*** lexohet edhe në "pasaportën" e tij: Rrënja ***"AR"*** e emrit që shpjegohet vetëm me gjuhën dhe mitet iliro-pellazge (që nuk është objekt i këtij materiali).

Këtë rrënjë e gjejmë edhe te perëndia pellazge e luftës, Ares, edhe tek latinët, Marte, që quhej edhe Pirro e Silvanus (që gjithashtu lidhen me historinë e lashtë të iliro-shqipetarëve), i cili kishte si simbol kulti, krahas shigjetës, kalin dhe kaun.

Mbreti më i madh i të gjitha kohërave, *ARI*, të cilin e kërkoi deri në Tibetin e largët ekspedita gjermane e Himlerit, e humbi jetën gjatë betejës në Kosovë, ku sot gjëndet qyteti i Prishtinës, emri i së cilës në gjuhën shqipe e tregon këtë fatkeqësi.

Perëndia pellazge e luftës, Ares

VI. BIBLA E SHENJTË PËR ALEKSANDRIN E MADH

Gjatë leximit të Biblës në kapitullin e tetë, **Profecia e Danielit**, thuhet se në shek. VII p. k. do të lindte Aleksandri i Madh.

Profecia ka titullin **"Vegimi i Danielit Dashi e Cjapi"**, ku shkruhet:

"Në tretin të vit të

mbretërimit të mbretit Baltazar, unë, Danieli, pata një vegim pas atij që pata në fillim të mbretërimit. Pashë në vegim dhe, ndërsa

po shikoja, më ndodhi të gjëndesha në qytezën e Suzas, që është në krahinën e Elamit. Nga vegimi e kuptova që isha pranë lumit Ulai. Ngrita sytë dhe shikova dhe ja, pranë lumit pashë më këmbë një dash me dy brirë; të dy brirët ishin të lartë, por njëri ishte më i lartë se tjetri, megjithëse më i larti kishte dalë i fundit. Pashë dashin që godiste kundrejt perëndimit, drejt veriut dhe drejt jugut; asnjë kafshë nuk mund t'i rezistonte, askush nuk mund të çlirohej nga pushteti i tij; kështu ai bëri atë që desh dhe u bë i madh. Ndërsa kisha parasysh këtë, ja, ku po vinte nga perëndimi një cjap, që përshkonte tërë sipërfaqen e dheut pa e prekur tokën; cjapi kishte një bri të madh midis syve të vet. Arriti deri te dashi me dy brirë që kisha parë më këmbë përpara lumit, dhe iu hodh kundër me furinë e forcës së tij. E pashë të afrohet dhe të zemërohet kundër tij; pastaj i ra me bri dashit dhe copëtoi dy brirët e tij, ndërsa dashi nuk kishte fuqi për t'i rezistuar; kështu e hodhi për tokë dhe askush nuk mundi ta çlirojë dashin nga pushteti i këtij. cjapi u bë shumë i madh; por, kur u bë i fuqishëm, briri i tij i madh u thye; në vend të tij dolën katër brirë të mëdhenj, që drejtoheshin drejt katër erërave të qiellit. Nga një prej tyre doli një bri i vogël, që u bë shumë i madh në drejtim të jugut, të lindjes dhe të vendit të lavdishëm. U rrit deri sa arriti ushtrinë e qiellit, bëri të bjerë për tokë një pjesë e ushtrisë dhe e yjeve dhe i shkeli. U ngrit madje deri te komandanti i ushtrisë, i hoqi flijimin e vazhdueshëm dhe vendi i shenjtërores së tij u shemb. Ushtria iu la në dorë bashkë me flijimin e vazhdueshëm, për shkak të shkeljes; ai hodhi për tokë të vërtetën; bëri tërë këto gjëra dhe i shkoi mbarë. Pastaj dëgjova një të shenjtë që fliste, dhe një i shenjtë tjetër i tha atij që fliste: "Deri kur do të vazhdojë ky vegim: ndalimi i flijimit të përditshëm, shkretimi për shkak të paudhësisë, shenjtërorja dhe ushtria të shkelur?" Ai më tha: "Deri dymijë e treqind ditë; pastaj shenjtërorja do të pastrohet". Tani, ndërsa unë, Danieli, e kisha parasysh vegimin dhe përpiqesha ta kuptoja, ja ku po rri para meje dikush që ka pamje burri. Dëgjova pastaj në mes të lumit Ulai zërin e një burri, që bërtiste dhe thoshte: "Gabriel, shpjegoja këtij vegimin". Ai iu afrua vendit ku ndodhesha unë dhe, kur arriti, unë pata frikë

dhe rashë me fytyrë. Por ai më tha: "Kuptoje mirë, o bir njeriu, sepse ky vegim ka të bëjë me kohën e fundit". Ndërsa ai fliste me mua, unë rashë në një gjumë të rëndë me fytyrë për tokë, por ai më preku dhe më bëri të ngrihem më këmbë në vendin ku ndodhesha. Dhe tha: "Ja, unë do të të tregoj atë që ka për të ndodhur në kohën e fundit të indinjatës, sepse ka të bëjë me kohën e caktuar të fundit. Dashi me dy brirë, që ti ke parë, përfaqëson mbretërit e Medisë dhe të Persisë. Cjapi leshtor është mbreti i Javanit dhe briri i madh që ishte në mes të syve të tij është mbreti i parë. Briri i thyer dhe katër brirët që dolën në vend të tij janë katër mbretëri që do të dalin nga ky komb, por jo me të njëjtën fuqi të tij. Në fund të mbretërisë së tyre, kur rebelët do ta kenë mbushur kupën, do të dalë një mbret me pamje të egër dhe i rrahur në dredhitë luftarake. Fuqia e tij do të rritet, por jo për shkak të forcës së tij; do të bëjë shkatërrime të habitshme, do të ketë sukses në ndërmarrjet e tij dhe do të shkatërrojë të fuqishmit dhe popullin e shenjtorëve. Për shkak të dinakërisë së tij do shtohet mashtrimi në duart e tij; do të krenohet në zemër të vet dhe do të shkatërrojë shumë njerëz që janë në siguri; do të ngrihet kundër princit të princave, por do të thyhet jo nga dorë njeriu. Vegimi i mbrëmjeve dhe i mëngjeseve, për të cilin është folur, është i vërtetë. Ti e mban sekret vegimin, sepse ka të bëjë me gjëra që do të ndodhin mbas shumë kohe". Dhe unë, Danieli, e ndjeva veten të sfilitur dhe qeshë i sëmurë disa ditë; pastaj u ngrita dhe u interesova për punët e mbretit. Unë isha i tronditur nga vegimi, por askush nuk e vuri re".

***

Shkencëtarët e kanë zbërthyer profetësinë e Danielit dhe kanë nxjerrë përfundimin se bëhet fjalë për ngjarje që lidhen me Aleksandrin. Dashi ishte mbreti i Medisë dhe Persisë, që në shek. VI-V para K. vunë nën kontroll Maqedoninë dhe Trakinë. Cjapi me një bri është Aleksandri i Madh, i cili mundi Persinë, Darin III që na paraqitet me shenjën e dashit. Cjapi që është shenja e Aleksandrit që pushtoi Persinë brenda 10 vjetësh, pra ashtu siç ka ndodhur me të vërtetë. Briri i thyer në katër pjesë ishte ndarja

që pësoi mbretëria e Aleksandrit nga gjeneralët e tij: Ptolemeu, Lisimarku, Antipatriti (Kasandri) dhe Seleku, që ishin të njëjtës kombësi ilire. Po të shohim emrin Lisimarku, ka kuptim në gjuhën e sotme shqipe-Lis i Markut, edhe emri Seleku mund të jetë fjala shqipe-Shelek, që emërtohet qengji i vogël i sapoqethur. Këtë fjalë e ndeshim në tërë territoret ballkanike që banohen nga shqiptarët.

Teksti i Shkodrës e përmend shprehimisht Aleksandrin si "biri i Zeusit", shohim se në "Biblën e Vjetër", te "Vizionet e Danielit" nuk përmendet si parashikim Aleksandri i Madh "njeri-bir perëndie me fuqi hyjnore", përkundrazi atje i caktohet "parashikimi" i fundit të keq të tij, si një pësim-mësim i parashkruar. Shkruesit çifutë, si idhtarë të monoteizmit, ishin të interesuar ta shtynin mundësisht sa më thellë monozotin në kohë që nga zanafilla dhe, kësisoj në Biblën e Vjetër u la pak vend, për të mos thënë aspak për periudhën e evolucionit nga politeizmi në monoteizëm. Në tregimet e tyre pothuajse nuk shkruhet fare për fetë politeiste. Sigurisht se aty kanë vepruar edhe rregullimet, maskimet e kamufluara e deri edhe censurat retrospektive etj.

"Parashikimet e Danielit" në Biblën e shenjtë e paraqesin Aleksandrin e Madh vetëm si ***"mbreti i Mbretërisë së grekëve"***, me një lloj simbolike të maskuar si ***"Cjapi me një bri të mrekullueshëm"***, parashikojnë thyerjen e këtij briri, shuarjen e dinastisë në vijën e gjakut dhe daljen e katër brirëve, që simbolizojnë ndarjen e territoreve nga katër gjeneralët etj., dhe më në fund ndoshta edhe një ***"profeci" për ardhjen e një Mesie….*** " Në numrat me shënimet shpjeguese të këtyre fletëve shkruhet se ndër interpretuesit biblistë ka mendime diskutuese se te "Profecia e Danielit", mbas vdekjes së Aleksandrit na parashikohet edhe ardhja e mesisë, thuhet se ka edhe shtesa e rregullime të mëvonshme nga pseudo-Danielë etj. Pra, duket sikur krahas simbolit "qengji", mesia na paska pasur edhe një tjetër më të hershëm si edhi me një bri, pastaj edhe "Aquila Cristi" krahasuar me shqiponjën e Zeusit etj. Pas mbretit, monobricjapit të parë që identifikohet me Aleksandrin e Madh,

katër brirët e cjapit në katër erërat janë gjeneralët e tij: Kasandri në Maqedoni, Lisimaku në Traki e Azinë e Vogël, Seleuku në Siri, Mesopotami e Persi dhe Ptolemeu në Egjipt.

Më poshtë në origjinal po japim të plotë nga **Bibla e Shenjtë** Kapitujt (Chapter): 7, 8 dhe 11, me titull: DANIELI.

***)**Nëntitujt e kapitujve janë të autorit të këtij libri.

DANIELI
(Ëndrra e Parë e Danielit)*

Chapter (Kapitulli) 7 **Faqe:** 1273-1274

1
Në vitin e parë të Belshatsarit, mbretit të Babilonisë, Danieli, kur ishte në shtrat, pa një ëndërr dhe pati vegime në mendjen e tij. Pastaj shkroi ëndrrën dhe tregoi thelbin e ngjarjes.
2
Danieli, pra, filloi të thotë: "Unë shikoj në vegimin tim, natën, dhe ja, katër erërat e qiellit tronditnin Detin e Madh,
3
dhe katër kafshë të mëdha po dilnin nga deti, njera ndryshe nga tjetra.
4
E para i ngjante një luani dhe kishte krahë shqiponje. Unë shikoja deri sa ia shkulën krahët, pastaj e ngritën nga toka e vunë të qëndrojë drejt mbi dy këmbët e veta si një njeri dhe iu dha një zemër njeriu.
5
Dhe ja një kafshë tjetër, e dyta, që i ngjante një ariu; ngrihej mbi një krah dhe kishte tri brinjë në gojë, midis dhëmbëve, dhe i thanë: "Çohu, ha shumë mish".
6
Mbas kësaj unë shikoja, dhe ja një tjetër që i ngjante një leopardi, dhe që kishte katër fletë shpendi mbi kurrizin e vet; kafsha kishte katër koka dhe iu dha sundimi.
7

Mbas kësaj, unë shikoja në vegime nate, dhe ja një kafshë e katërt e llahtarshme, e tmerrshme, jashtëzakonisht e fuqishme; kishte dhëmbë të mëdha prej hekuri; hante, thërrmonte dhe shtypte kusurin me këmbë; ishte ndryshe nga të gjitha kafshët e mëparshme dhe kishte dhjetë brirë.
8
Isha duke vërejtur brirët, kur ja, midis tyre filloi të dalë një bri tjetër i vogël, para të cilit tre nga brirët e parë u shkulën; dhe ja, në atë bri ishin disa sy që i përngjanin syve të njeriut dhe një gojë që thoshte gjëra të mëdha.
9
Unë vazhdova të shikoj deri sa u vendosën fronet dhe i Lashti i ditëve u ul. Veshja e tij ishte e bardhë si bora, flokët e kokës së tij ishin si leshi i pastër; froni i tij ishte si flokët e zjarrit dhe rrotat e tij si zjarr përvëlues.
10
Një lumë zjarri rridhte, duke dalë nga prania e tij; mijëra e mijëra njerëz i shërbenin dhe mori dhe mori qëndronin përpara tij. Gjykimi u bë dhe librat u hapën.
11
Atëherë unë shikova për shkak të fjalëve të mëdha që briri thoshte; shikova deri sa u vra kafsha, dhe trupi i saj u shkatërrua dhe u hodh në zjarr për t'u djegur.

12
Sa për kafshët e tjera, u hoq sundimi i tyre por iu lejua atyre një zgjatje e jetës për një periudhë të caktuar kohe.
13
Unë shikoja disa vegime nate, dhe ja mbi retë e qiellit po vinte dikush që i ngjante një Biri njeriu; ai arriti deri te i Lashti i ditëve dhe iu afrua atij.
14
Atij iu dha sundimi, lavdia dhe mbretëria, me qëllim që gjithë popujt, kombet dhe gjuhët t'i shërbenin; sundimi i tij është një

sundim i përjetshëm që nuk do të kalojë, dhe mbretëria e tij është një mbretëri që nuk do shkatërrohet kurrë".
15
"Sa për mua, Danielin, fryma ime mbeti e brengosur në mbështjellën e trupit dhe vegimet e mendjes sime më turbulluan.
16
Iu afrova njërit nga ata që ishin aty afër dhe e pyeta mbi të vërtetën që lidhej me tërë këtë punë; dhe ai më foli dhe më bëri të njohur interpretimin e atyre gjërave:
17
Këto kafshë të mëdha, që janë katër, përfaqësojnë katër mbretër që do të dalin nga toka;
18
pastaj shenjtorët e Shumë të Lartit do të marrin mbretërinë dhe do ta zotërojnë përjetë, në përjetësi".
19
Atëherë dëshirova të mësoj të vërtetën lidhur me kafshën e katërt, që ishte ndryshe nga të gjitha të tjerat dhe jashtëzakonisht e tmerrshme, me dhëmbë prej hekuri dhe me thonj prej bronzi, që hante, thërrmonte dhe shkelte me këmbë kusurin,
20
dhe lidhur me dhjetë brirët që kishte mbi kokë, dhe lidhur me bririn tjetër që i dilte dhe para të cilit kishin rënë tre brirë, domethënë briri që kishte sy dhe gojë për të thënë gjëra të mëdha dhe që dukej më i madh se brirët e tjerë.

21
Unë shikoja dhe po ky bri bënte luftë kundër shenjtorëve dhe i mundte,
22
deri sa arriti i Lashti i ditëve dhe iu dha e drejta shenjtorëve të Shumë të Lartit, dhe erdhi koha në të cilën shenjtorët zotëruan mbretërinë.
23

Dhe ai më foli kështu: "Kafsha e katërt do të jetë një mbretëri e katërt mbi tokë, që do të jetë ndryshe nga të gjitha mbretëritë e tjera, dhe do të hajë tërë tokën, do ta shkelë dhe do ta thërrmojë.
24
Dhjetë brirët janë dhjetë mbretër që do të dalin nga kjo mbretëri; mbas tyre do të dalë një tjetër, që do të jetë ndryshe nga të mëparshmit dhe do të rrëzojë tre mbretër.
25
Ai do të shqiptojë fjalë kundër Shumë të Lartit, do të përndjekë shenjtorët e Shumë të Lartit me qëllim që t'i shfarosë dhe do të mendojë të ndryshojë kohërat dhe ligjin; shenjtorët do të bien në duart e tij për një farë kohe, disa kohë dhe për gjysmën e një kohe.
26
Pastaj do të bëhet gjyqi dhe do t'i hiqet sundimi, i cili do të asgjësohet dhe do të shkatërrohet përjetë.
27
Pastaj mbretëria, sundimi dhe madhështia e mbretërive nën të gjithë qiejt do t'i jepen popullit të shenjtorëve të Më të Lartit; mbretëria e tij është një mbretëri e përjetshme, dhe të gjitha zotërimet do t'i shërbejnë dhe do t'i binden atij".
28
Këtu mbaruan fjalët që më ishin drejtuar. Sa për mua, Danielin, mendimet e mia më turbulluan shumë dhe ndryshova pamje por i ruajta fjalët në zemrën time.

Ëndrra e Dytë e Danielit

Chapter (Kapitulli) 8 Faqe: 1275-1276

1
Në vitin e tretë të mbretërimit të mbretit Belshatsar, unë, Danieli, pata një vegim, pas atij që pata në fillim të mbretërimit.
2

Pashë në vegim dhe, ndërsa po shikoja, më ndodhi të gjëndesha në qytezën e Suzas, që është në krahinën e Elamit; nga vegimi e kuptova që isha pranë lumit Ulai.
3
Ngrita sytë dhe shikova, dhe ja, pranë lumit pashë më këmbë një dash me dy brirë; të dy brirët ishin të lartë, por njëri ishte më i lartë se tjetri, megjithëse më i larti kishte dalë i fundit.
4
Pashë dashin që godiste kundrejt perëndimit, drejt veriut dhe drejt jugut; asnjë kafshë nuk mund t'i rezistonte, askush nuk mund të çlirohej nga pushteti i tij; kështu ai bëri atë që desh dhe u bë i madh.
5
Ndërsa kisha parasysh këtë, ja, ku po vinte nga perëndimi një cjap, që përshkonte tërë sipërfaqen e dheut pa e prekur tokën; cjapi kishte një bri të madh midis syve të vet.
6
Arriti deri te dashi me dy brirë që kisha parë më këmbë përpara lumit, dhe iu hodh kundër me furinë e forcës së tij.
7
E pashë të afrohet dhe të zemërohet kundër tij; pastaj i ra me bri dashit dhe copëtoi dy brirët e tij, ndërsa dashi nuk kishte fuqi për t'i rezistuar; kështu e hodhi për tokë dhe askush nuk mundi ta çlirojë dashin nga pushteti i këtij.
8
Cjapi u bë shumë i madh; por, kur u bë i fuqishëm, briri i tij i madh u thye; në vend të tij dolën katër brirë të mëdhenj, që drejtoheshin drejt katër erërave të qiellit.

9
Nga një prej tyre doli një bri i vogël, që u bë shumë i madh në drejtim të jugut, të lindjes dhe të vendit të lavdishëm.
10
U rrit deri sa arriti ushtrinë e qiellit, bëri të bjerë për tokë një pjesë e ushtrisë dhe e yjeve dhe i shkeli.
11

U ngrit madje deri te komandanti i ushtrisë, i hoqi flijimin e vazhdueshëm dhe vendi i shenjtërores së tij u shemb.
12
Ushtria iu la në dorë bashkë me flijimin e vazhdueshëm, për shkak të shkeljes; ai hodhi për tokë të vërtetën; bëri tërë këto gjëra dhe i shkoi mbarë.
13
Pastaj dëgjova një të shenjtë që fliste, dhe një i shenjtë tjetër i tha atij që fliste: "Deri kur do të vazhdojë ky vegim: ndalimi i flijimit të përditshëm, shkretimi për shkak të paudhësisë, shenjtërorja dhe ushtria të shkelur?"
14
Ai më tha: "Deri dymijë e treqind ditë; pastaj shenjtërorja do të pastrohet".
15
Tani, ndërsa unë, Danieli, e kisha parasysh vegimin dhe përpiqesha ta kuptoja, ja ku po rri para meje dikush që ka pamje burri.
16
Dëgjova pastaj në mes të lumit Ulai zërin e një burri, që bërtiste dhe thoshte: "Gabriel, shpjegoja këtij vegimin".
17
Ai iu afrua vendit ku ndodhesha unë dhe, kur arriti, unë pata frikë dhe rashë me fytyrë. Por ai më tha: "Kuptoje mirë, o bir njeriu, sepse ky vegim ka të bëjë me kohën e fundit".

18
Ndërsa ai fliste me mua, unë rashë në një gjumë të rëndë me fytyrë për tokë, por ai më preku dhe më bëri të ngrihem më këmbë në vendin ku ndodhesha.
19
Dhe tha: "Ja, unë do të të tregoj atë që ka për të ndodhur në kohën e fundit të indinjatës, sepse ka të bëjë me kohën e caktuar të fundit.

20
Dashi me dy brirë, që ti ke parë, përfaqëson mbretërit e Medisë dhe të Persisë.
21
Cjapi leshtor është mbreti i Javanit; dhe briri i madh që ishte në mes të syve të tij është mbreti i parë.
22
Briri i thyer dhe katër brirët që dolën në vend të tij janë katër mbretëri që do të dalin nga ky komb, por jo me të njëjtën fuqi të tij.
23
Në fund të mbretërisë së tyre, kur rebelët do ta kenë mbushur kupën, do të dalë një mbret me pamje të egër dhe i rrahur në dredhitë luftarake.
24
Fuqia e tij do të rritet, por jo për shkak të forcës së tij; do të bëjë shkatërrime të habitshme, do të ketë sukses në ndërmarrjet e tij dhe do të shkatërrojë të fuqishmit dhe popullin e shenjtorëve.
25
Për shkak të dinakërisë së tij do shtohet mashtrimi në duart e tij; do të krenohet në zemër te vet dhe do të shkatërrojë shumë njerëz që janë në siguri; do të ngrihet kundër princit të princave, por do të thyhet jo nga dorë njeriu.
26
Vegimi i mbrëmjeve dhe i mëngjeseve, për të cilin është folur, është i vërtetë. Ti e mban sekret vegimin, sepse ka të bëjë me gjëra që do të ndodhin mbas shumë kohe".

27
Dhe unë, Danieli, e ndjeva veten të sfilitur dhe qeshë i sëmurë disa ditë; pastaj u ngrita dhe u interesova për punët e mbretit. Unë isha i tronditur nga vegimi, por askush nuk e vuri re.

Danieli parashikon betejat perso-maqedone,

Chapter (Kapitulli) 11 Faqe: 1280-1283

1
Gjatë vitit të parë të Darit, Medasit, unë vetë qëndrova pranë tij për ta përkrahur dhe për ta mbrojtur.
2
"Dhe tani do të të bëj të njohur të vërtetën. Ja, në Persi do të dalin akoma tre mbretër, por i katërti do të bëhet shumë më i pasur se gjithë të tjerët; kur të jetë bërë i fortë për shkak të pasurive të tij, do t'i ngrerë të tërë kundër mbretërisë së Javanit.
3
Atëherë do të dalë një mbret i fuqishëm (*Aleksandri i Madh*) që do të sundojë mbi një perandori të madhe (*Perandorinë e Maqedonisë*) dhe do të bëjë çfarë të dojë.
4
Por kur të jetë formuar mbretëria e tij (*Lekës së Madh*) do të copëtohet dhe do të ndahet në drejtim të katër erërave të qiellit, por jo midis trashëgimtarëve të tij dhe as me po atë forcë me të cilën ai mbretëronte, sepse mbretëria e tij do të çrrënjoset dhe do t'u kalojë të tjerëve (*4 gjeneralëve e bashkëluftëtarëve të Lekës së Madh: Ptolemeut, Kasandrit, Lisimakut dhe Seleukut*), dhe jo trashëgimtarëve.
5
Kështu mbreti i jugut do të bëhet i fortë (*Ptolemeu në Egjypt*), por një ndër princat e tij do të bëhet më i fortë nga ai dhe do të sundojë; sundimi i tij do të jetë një sundim i madh.
6
Mbas disa vjetëve do të lidhin aleancë; pastaj bija e mbretit të jugut (*Kleopatra VII, bija e Ptolemeut – mbretit të Egjiptit pas vdekjes së Aleksandrit të Madh*) do të vijë te mbreti i veriut (*Kasandri – mbreti i Maqedonisë, pas vdekjes së Lekës dhe ndarjes së Perandorisë së Maqedonisë*) për të bërë një marrëveshje, por nuk do ruajë më as forcën e fuqisë së saj, dhe nuk do të mund të zgjasë as ai as pushteti i tij; në ato kohëra ajo do t'i dorëzohet vdekjes bashkë

me ata që e kanë çuar, që e kanë lindur dhe që e kanë mbështetur.
7
Por një nga pasardhësit nga rrënja e saj do të dalë dhe do të zërë vendin e saj; ai do të vijë kundër ushtrisë, do të hyjë në fortesat e mbretit të veriut, do të veprojë kundër tyre dhe do të dalë fitimtar (*Kush është pasardhës i Kleopatrës ose Olimpisë që rrëzon Kasandrin?).*
8
Do të shpjerë gjithashtu si plaçkë në Egjipt perënditë e tyre me figurat e tyre të derdhura dhe me sendet e tyre të çmuara prej argjendi dhe prej ari, dhe për disa vjet do të rrijë larg mbretit të veriut.
9
Ky do të dalë kundër mbretit të jugut (*Mbretit të Egjiptit*), por pastaj do të kthehet në vendin e tij. (*Kush është Ky*?)
10
Bijtë e tij do të përgatiten pastaj për luftë dhe do të mbledhin turma forcash të mëdha, dhe një prej tyre do të dalë me siguri përpara, do të vërshojë si një përmbytje dhe do të kalojë tutje për ta çuar luftën deri në fortesën e tij.
11
Atëherë mbreti i jugut, i tërbuar, do të dalë të luftojë kundër këtij, kundër mbretit të veriut, i cili do të mobilizojë një turmë të madhe, por turma do të bjerë në dorë të armikut.
12
Kur turmën do ta kenë çuar tutje, zemra e tij do të mbushet me krenari; do të mposhtë me mijëra, por nuk do të jetë më i fortë.
13
Në fakt mbreti i veriut do të mobilizojë përsëri një turmë edhe më të madhe se e mëparshmja, dhe pas një kohe të shkurtër do të përparojë me siguri me një ushtri të madhe dhe me pajime të shumta.
14

Në atë kohë shumë njerëz do të ngrihen kundër mbretit të jugut; edhe disa burra të dhunshëm të popullit tënd do të ngrihen për të realizuar vegimin, por do të rrëzohen.
15
Atëherë do të vijë mbreti i veriut, do të ngrerë një ledh dhe do të shtjerë në dorë një qytet të fortifikuar. Forcat e jugut nuk do të mundin t'i rezistojnë; as trupat e zgjedhura nuk do të kenë forcën për t'i rezistuar.
16
Ai që i ka ardhur kundra do të bëjë çfarë të dojë, dhe askush nuk do të mund t'i rezistojë; ai do të ndalet në vendin e lavdishëm duke pasur pushtet të shkatërrojë çdo gjë.
17
Pastaj do të vendosë të vijë me forcat e gjithë mbretërisë së tij, duke ofruar kushte të ndershme paqeje, dhe kështu ka për të bërë. Do t'i japë të bijën për grua për ta korruptuar, por ajo nuk do të mbajë anën e tij dhe nuk do ta favorizojë atë.
18
Pastaj do t'u drejtohet ishujve dhe do të shtjerë në dorë shumë prej tyre, por një komandant do të bëjë që të marrë fund arroganca e tij, duke bërë që ajo të bjerë mbi të.
19
Pastaj do të kthehet drejt fortesave të vendit të vet, por do të pengohet, do të rrëzohet dhe nuk do të gjendet më.
20
Në vend të tij do të dalë dikush që do të dërgojë një tagrambledhës për lavdinë e mbretërisë; por brenda pak ditëve ai do të zhduket, por jo në zemërim a në betejë.
21
Në vend të tij do të dalë një njeri i neveritshëm, që nuk do të ketë dinjitet mbretëror; ai do të vijë paqësisht, por do ta shtjerë në dorë mbretërinë me intriga.

22
Para tij forcat e mëdha do të thyhen dhe do të shkatërrohen, po ashtu edhe kreu i një aleance.

23
Menjëherë pasi të ketë lidhur një aleancë me të, ai do të veprojë me pabesi dhe do të arrijë në pushtet me pak njerëz.
24
Ai do të hyjë në mënyrë paqësore edhe në pjesët më të pasura të krahinës dhe do të bëjë atë që nuk kishin bërë kurrë as etërit e tij as etërit e etërve të tij; do të shpërndajë midis tyre plaçkë, plaçkën e luftës dhe pasuritë dhe do të hartojë plane kundër fortesave, por vetëm për një kohë.
25
Me një ushtri të madhe do t'i nxitë forcat e tij dhe zemrën e tij kundër mbretit të jugut. Mbreti i jugut do të futet në luftë me një ushtri të madhe dhe shumë të fuqishme, por nuk do të mund të rezistojë, sepse do të kurdisen komplote kundër tij.
26
Vetë ata që hanë bashkë me të do ta shkatërrojnë; ushtria e tij do të thyhet dhe shumë do të bien të vrarë.
27
Zemra e këtyre dy mbretërve do të drejtohet për të bërë keq; ata do të flasin gënjeshtra të ulur në të njëjtën tryezë, por gjëja nuk do të ketë sukses, sepse fundi do t'u vijë në kohën e caktuar.
28
Duke u kthyer në vendin e tij me pasuri të mëdha, zemra e tij do të vihet kundër besëlidhjes së shenjtë; kështu ai do të kryejë qëllimet e tij dhe pastaj do të kthehet në vendin e tij.
29
Në kohën e caktuar ai do të dalë përsëri kundër jugut, por këtë herë të fundit puna nuk do t'i vejë mbarë si herën e parë,
30
sepse anijet e Kitimit do të vijnë kundër tij; prandaj ai do të trembet, do të zemërohet përsëri kundër besëlidhjes së shenjtë dhe do të zbatojë planet e tij; kështu përsëri do të merret vesh me ata që kanë braktisur besëlidhjen e shenjtë.
31

Forca të dërguara prej tij do të ngrihen për të përdhosur shenjtëroren fortesë, do të ndalojnë flijimin e përditshëm dhe do të bëjnë veprime të neveritshme që shkaktojnë shkretim.
32
Me lajka ai do të korruptojë ata që veprojnë pabesisht kundër besëlidhjes; por populli i atyre që njohin Perëndinë e tyre do të tregojë qëndresë dhe do të veprojë.
33
Ata që kanë dituri midis popullit do të udhëzojnë shumë të tjerë, por për një kohë të shkurtër do të bien nga shpata, nga zjarri, nga mërgimi dhe nga plaçkitja.
34
Kur do të rrëzohen, do t'u jepet pak ndihmë, por shumë njerëz do të bashkohen me ta pa qenë të sinqertë.
35
Disa nga ata që kanë dituri do të bien, me qëllim që të përsosen, të pastrohen dhe të zbardhen deri në kohën e mbarimit, sepse kjo do të ndodhë në kohën e caktuar.
36
Pastaj mbreti do të veprojë si të dojë, do të lartohet, do të hyjnizohet përmbi çdo perëndi dhe do të thotë gjëra të habitshme kundër Perëndisë të perëndive; do të ketë sukses deri sa të mbushet kupa e indinjatës, sepse ajo që është dekretuar do të bëhet.
37
Ai nuk do të tregojë respekt për Perëndinë e etërve të tij dhe për dëshirën e grave; nuk do të ketë respekt për asnjë perëndi, sepse do të hyjnizojë veten përmbi të gjithë.
38
Por në vend të tyre ai do të nderojë perëndinë e fortesave dhe do të nderojë me ar, me argjend, me gurë të çmuar dhe me gjëra të këndshme, një perëndi, që etërit e tij nuk e njohën.

39

Ai do të veprojë kundër fortesave më të fortifikuara me ndihmën e një perëndie të huaj; do të mbushë me të mira ata që do ta njohin, do të bëjë që të sundojnë mbi shumë njerëz dhe do t'u japë toka si shpërblim.
40
Në kohën e fundit mbreti i jugut do të ndeshet me të, mbreti i veriut do të dalë kundër tij si një shakullimë, me qerre dhe kalorës dhe me shumë anije; do të depërtojë në vendet, do t'i përmbytë dhe do të kalojë tutje.
41
Do të hyjë edhe në vendin e lavdishëm dhe shumë njerëz do të vriten; por këta do të shpëtojnë nga duart e tij: Edomi, Moabi dhe pjesa më e madhe e bijve të Amonit.
42
Ai do të shtrijë dorën edhe mbi vende të ndryshme dhe as vendi i Egjiptit nuk do të shpëtojë.
43
Do të shtjerë në dorë thesaret prej ari dhe argjendi dhe të gjitha gjërat e çmuara të Egjiptit; Libianët dhe etiopiasit do t'i shkojnë pas.
44
Por lajmet e ardhura nga lindja dhe nga veriu do ta turbullojnë; prandaj ai do të niset me zemërim të madh për të shkatërruar dhe vendosur shfarosjen e shumë njerëzve.
45
Do t'i ngrerë çadrat e pallatit të tij midis deteve dhe malit të shenjtë të lavdishëm; pastaj do t'i vijë fundi dhe askush nuk do ta ndihmojë".

VII. KUR'ANI I MADHËRISHËM

PËR ALEKSANDRIN E MADH

Dy Brirët legjendarë e kanë prejardhjen nga dhia **Amaltea** që ushqente fshehur Zeusin fëmijë. Amaltea = T'amli (gegënisht), - qumështi (toskërisht). Jo rastësisht Dy Brirët, simbol pellazg, i mbanin të Tre Heronjtë e Pellazgjisë–Ilirisë-Arbërisë: 1. Aleksandri i Madh i Maqedonisë, 2. Pirroja i Epirit dhe 3. Gjergj Kastrioti – Skënderbeu (Aleksandri i Madh i Arbërisë).

Dybrirët – Dhulkarnejn (në arabisht) i citon edhe **Kur'ani i Shenjtë,** sepse kanë lënë gjurmë që herët në Lindje. Në Kur'anin e Madhërishëm Aleksandri i Madh nuk përmendet me emër, për të flitet tërthorazi, por vlen të theksohet se në Kur'an për Lekën e Madh, pra për Dybrirëshin (Dhulkarnejnin), për jetën, luftën dhe idealet e tij flitet më pak, por në mënyrë më pozitive se në Bibël.

KUR'ANI i Madhërishëm,
SURJA 18, EL-KEHF:

Ajeti 83. Ata (hebrenjtë) të pyesin ty (Muhamed) për Dhulkarnejnin, thuaj: "Do t'ju tregoj për punën e tij me Kur'an (me shpallje)."

Ajet 84. Ne i mundësuam atij forcë në Tokë dhe i dhamë mundësi për çdo send që të mund ta arrijë.

Ajeti 85. Ai (Dhulkarnejni) iu rrek një aso mundësie (dhe mori rrugën kah perëndimi).

Ajeti 86. Kur arriti vendperëndimin e diellit, e gjeti se po përëndon në njëfarë burimi me lym të zi dhe aty e gjeti një popull. E ne i thamë:

"O Dhulkarnejn, ose do t'i dënosh, ose do t'i marrësh me të mirë e t'i udhëzosh!"

Ajeti 87. Ai (Dhulkarnejni) tha: "Ai që vazhdon edhe më tej të jetë zullumqar, atë do ta dënojmë, pastaj i kthehet Zotit të vet e Ai e dënon atë me një dënim të tmerrshëm".

Ajeti 88. Sa i përket atij që besoi dhe bëri vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë (xhenneti/parajsa) dhe atij nga ana jonë do t'i bëjmë lehtësi (në jetë).

Ajeti 89. Pastaj, ai iu rrek një aso mundësie (mori rrugën e lindjes).

Ajeti 90. Kur arriti në vendin e lindjes së Diellit, Ai e pa të lindte mbi një popull, të cilit Ne nuk i kishim dhënë gjë, për t'u mbrojtur nga dielli.

Ajeti 91. Ashtu (bëri edhe me këtë popull), e Ne e kemi të ditur gjendjen e tij (mundësitë dhe sundimin e drejtë të tij).

Ajeti 92. Mandej, ai iu rrek përsëri një aso mundësie (një rruge të tretë mes perëndimit e lindjes – nga veriu).

Ajeti 93. Derisa, kur arriti në mes dy malesh (si penda), dhe prapa tyre gjeti një popull i cili thuajse nuk kuptonte asnjë gjuhë (përveç gjuhës së vet).

Ajeti 94. Ata thanë: "O Dhulkarnejn, vërtetë Jexhuxhët dhe Mexhuxhët janë duke bërë shkatërrime në tokë, a bën që ne të japim ty një kontribut (në formë tagri a tatimi), e që të bësh një pendë mes nesh dhe mes tyre?".

Ajeti 95. Ai (Dhulkarnejni) tha: "Atë që mua më mundësoi Zoti im, është shumë më i mirë (nga ajo që më ofroni ju), po ju më ndihmoni me fuqi punëtore të bëjë një pendë të fortë mes jush dhe mes atyre!".

Ajeti 96. Më sillni copa të hekurit!" E kur e nivelizoi ai me dy anët e kodrave, tha: "Ndizni!", e kur e bëri atë (hekurin) zjarr (si zjarr nga të ndezurit) tha: "Më sillni bakër të shkrirë t'ia hedhë atij!".

Ajeti 97. E, ata (Jexhuxhët dhe Mexhuxhët) as nuk arritën ta kapërcenin atë e as ta shponin.

Ajeti 98. Ai (Dhulkarnejni) tha: "Kjo është një e mirë nga Zoti im, e kur të vjen caktimi i Zotit tim, Ai e bën atë rrafsh. E premtimi i Zotit tim është i sigurt.

***

Rreth personalitetit të Dhulkarnejnit janë dhënë mendime dhe interpretime të llojllojshme. Kur'ani nuk cek ndonjë sqarim të thukët se kush ishte Dhulkarnejni, kur ishte dhe në ç'vend udhëtoi dhe veproi. Përmend sundimin e tij, drejtësinë në sundim, ndihmën që u ofroi njerëzve, devotshmërinë dhe

besimin e tij të sinqertë… **Dhulkarnejn**, nga arabishtja do të thotë: **dybrirësh**. Përse quhet kështu, ka shumë mendime dhe ndoshta më i pranueshmi prej tyre është pse sundimi i tij arriti deri tek "briri", cepi i Perëndimit dhe "briri", cepi i Lindjes, çka jep të kuptohet për një territor shumë të gjerë dhe me dy krah, me dy drejtime, me dy "brirë".

Kur'ani përmend tre udhëtime të Dhulkarnejnit: një në ***Perëndim***, një në ***Lindje*** deri tek një popull që thuajse ishte i egër, nuk kishte shtëpi, nuk kishte rrobe në trup, pra jetonin në shpella dhe lakuriq. Ai bëri dhe një udhëtim në ***veri,*** diku tek Azerbajxhani dhe Liqeni Kaspik. Populli i atij vendi ankohet për krimet që bënin fisi Jexhuxh dhe Mexhuxh, e që ishin të përçudnuar dhe me fizionominë e tyre tepër të gjatë ose tepër të shkurtër. Dhulkarnejni u ndihmoi kundër tyre duke u ndërtuar një pendë të fortë, të cilën nuk mund ta kalonin deri kur të afrojë Koha e Kijametit, e Zoti ta shkatërrojë atë pendë.

Gazeta "Lunxhëria", Shtator 2006, botoi shkrimin e Dr. Moikom Zeqos me titull: "***Aleksandri i Madh, lidhjet e ngushta me shqiptarët***", marrë nga "Gazeta shqiptare", dhjetor 2000, ku thuhet se shumë studiues, midis tyre edhe Sami Frashëri, mendojnë se Dhulkarnejni është Aleksandri i Madh. Në shkrim jepen edhe gjurmë të Aleksandrit si, poezia në Kishën e Manastirit të Shën Marisë në Himarë. Shqipëria është një nga vendet e bëmave të tij, që krijoi perandorinë që nga Deti Adriatik dhe deri në Indi, Himalaje dhe në Oqeanin Indian.

***

Emri **"Dhulkarnejn"** vjen nga arabishtja: **dhul-***posedues*; **karn-***bri*; **ejn-** *çift*. **Dhu+el+karn+ejn** do të thotë: **Poseduesi i dy brirëve (**ose: **Posedues i brirëve çift)**. Me pak ndryshim ky emër ka kuptim dhe në latinisht, mbase nga koha e Perandorisë Romake. Në librin latinisht ***"Anatomia Umana"*** shpjegohet një pjesë prej kërci të butë pas kombit, lukthit ose Mollës së Adamit në grykën e njeriut, që ka dy cepa anësh si bri, të sipërmet më të gjata se të poshtmet dhe që quhen Kornea superiori dhe Kornea inferiori, briri i sipërm dhe briri i poshtëm.

Dhulkarnejn nuk do të thotë vetëm pse arriti te briri i Perëndimit dhe tek briri i Lindjes, por edhe sepse mbante në luftë helmetën me dy brirë të dhisë mitologjike Amaltea, që kishte ushqyer e rritur në shpellën e Kretës Kryeperëndinë e Olimpit, Zeusin. Sipas shkrimeve të përmendura më sipër, kurorën me dy brirë e ka mbajtur Aleksandri i Madh, Pirrua dhe Skënderbeu. Është simbol pellazgjik. Popujt e lindjes që e shikonin Lekën e Madh e quanin **Dhulkarnejn-Dybrirësh**, nisur nga pamja. Emrin Aleksandër e ka marrë më vonë, kurse emrin e fëmijërisë e kishte **Meriamun** (Mejr jam un-Mirë jam unë–I mirë jam unë).

Kur'ani i Madhërishëm, që do të thotë Shpallje, Këndim, Recitim, është Libri i Shenjtë i muslimanëve e i gjithë njerëzimit. Nëse do të supozonim se në këtë libër të shenjtë Dhulkarnejni është vetë Leka i Madh, atëherë Kur'rani e shpall të drejtë sundimin e Aleksandrit dhe të Perandorisë pellazgo-ilirike që krijoi ai. Faktet historike flasin për drejtësinë gjatë sundimit të Aleksandrit. Ai armikut të tij, Darit III të Persisë, i bëri një varrim madhështor. Dari qysh para vdekjes së tij kishte thënë se pas vdekjes së tij nuk dëshironte asnjë tjetër në fron të Persisë, përveç Aleksandrit. Aleksandri u martua me vajzën e Darit.

Ana morale e Aleksandrit. Urdhëroi dënimin e dy ushtarëve maqedonë që çnderuan disa gra, të vriteshin me gurë si bisha të egra. Nëna e Darit, kur vdiq Aleksandri, nga dëshpërimi i thellë për këtë humbje shpalli grevë urie deri sa vdiq. Aleksandri pushtoi kala dhe theu ushtri armike, por nuk masakroi popuj, nuk zhduku qytete siç bënë grekët në Trojë, romakët në Epir, Iliri etj. Romakët kryqëzuan edhe Jezu Krishtin dhe Pilati "i lau duart". Evropianët persekutuan hebrenjtë për kryqëzimin e Krishtit. Në Perandorinë e Aleksandrit popujt ishin të barabartë.

Ajeti 84: ***"Ne i mundësuam atij forcë..."***. Kjo shpallje e Kur'anit tregon se Perëndia i dha atij, Lekës(gjithmonë nëse do të ishte i vërtetë supozimi që Dhulkarnejni ishte Leka i Madh), forcë dhe mundësi për çdo send që mund të arrijë, të cilat janë të

paarritshme për njerëzit e tjerë. Sipas fjalëve të Kur'anit, del njeri me fuqi të jashtëzakonshme. 323 vjet me vonë u lind Krishti. Aleksandri është meteori më i shndritshëm në historinë e njerëzimit. Aleksandri shfaqej si "perëndi" para popujve barbarë, kurse ndaj grekëve me shumë ndrojtje. Dy dekrete nga kryeqyteti romak, Suza, u impononin qyteteve greke që ta nderonin si hyjni. Aleksandri u kthye në mit dhe hyjni qysh kur ishte gjallë. Në oazat e Sivës prifti i tempullit të perëndisë, autoriteti më i madh fetar i kohës, e priti Aleksandrin me të njëjtin rit që priste faraonët dhe e përshëndeti si **"bir i perëndisë Amon–Ra"**. Në letrën që Aleksandri i dërgon së ëmës, Olimbisë, ai e quan veten bir i Amon-it.

Afërmendsh që mitet, në arabisht hadithet, zënë vend edhe në Kur'an. Çuditërisht, fjala **hadith-e** koincidon me rrënjët shqip: **di, dhe, the**, pra dituritë e thëna të transmetuara brez pas brezi. Edhe në greqisht mite, mitologji, do të thotë tregim. **Mite/Mithe = Mi+the = Mi the**, pra: mi tregove, mi the të gjitha.

Arsyetimi i vetëm që nuk pranohet të jetë Dhulkarnejni Leka i Madh është se Leka ishte politeist, besonte në shumë perëndi. Si i tillë nuk ka vend në Kur'an. Por, Dhulkarnejni është personazh mitologjik rreth 1.000 vjet para se të shkruhej Kur'ani. Në atë kohë gjithë bota ishte pagane, besonte në shumë perëndi, rrjedhimisht nuk bën përjashtim as Dhulkarnejni.

Historikisht monoteizmin e ka praktikuar për herë të parë vetëm nje faraon i Egjiptit dhe vetëm gjatë kohës së sundimit të tij, besimin e vetëm në një perëndi, perëndinë e diellit, Aton, si krijues i jetës. Por faraonët e Egjiptit nuk kanë shkuar as në lindje as në perëndim. Sipas krahasimit të të gjitha dokumenteve historike dhe të dhënave shkencore, Dhulkarnejni i Kur'anit të Shenjtë është Aleksandri i Madh. Udhëtimi në vendperëndimin e Diellit, tek burimi me lym të zi. E ëma e Aleksandrit, Olimbia, kur u nda nga burri, Filipi II, mbreti i Maqedonisë, e mori Aleksandrin fëmijë me vehte në Epir. Burimi me lym të zi, që përshkruan Kur'ani, janë fontanat e naftës të përmendura edhe në antikitet, zjarre që dalin nga toka në fushën e Myzeqesë të

Ilirisë. Më tutje është edhe Selenica me bitumin e saj. Sot janë zbuluar rezerva shumë të mëdha gazi dhe nafte.

Sipas Kur'anit, Dhulkarnejni shkoi në vendperëndimin e diellit, mund që Aleksandri do të ketë vizituar "qytetin hijerëndë" të Apolonisë natyrisht pa ushtri. Mbase ka marrë edhe mësime atje. Vendperëndimi i diellit është deti Adriatik, në antikitet Deti Jon (i jonë, yni). Dhulkarnejni nuk mund të jetë thjesht një personazh, real apo mitologjik. Ai është një sundimtar i madh, më i madhi. Simbol kishte diellin-dritën. Perandoria Romake simbol kishte ujkonjën-egërsinë. Perandoria Osmane simbol kishte hënën. Nuk dihet se kur ishte Dhulkarnejni? Po dihet me siguri sundimi i Lekës së Madh, viti 336-323 p. e. s.

Briri perëndimor është Deti Jon (Jonë). Territori i gjerë i sundimit të tij arrin në bririn lindor, Indinë dhe Oqeanin Indian. Emri i kontinentit të Azisë rrjedh prej fjalës asire **"asu"**, që do të thotë: **Toka prej ku lind Dielli**, Lindje.

Turqit e quajtën Gjergj Kastriotin, Iskanderbej. Me emrin më të lartë (në kuptimin e titullit) Aleksandër. Pse nuk quajtën sulltanët e tyre të mëdhenj, Muratin dhe Mehmetin Ngadhënjyes? Ose, gjeneralët e mëdhenj të kombeve të tjerë si Huniadin? Aq më tepër që Skënderbeu për turqit ishte qafir (i pabesë), bukëshkalë që i tradhtoi në ndeshjen me Huniadin. E quajtën, në radhë të parë, se i përkasin një kombi. Që nga bregdeti Adriatik deri në Selanik quhej Maqedoni. Maqedoni, Epir, dhe më pak Arbëri, quhej gjithë Shqipëria sipas Barletit. Kruja në Epir, sipas librit. Kjo nuk është lajthitje e Barletit. Skënderbeu u varros në Lesh. Çfarë koincidence, kishte emrin e Aleksandrit dhe u varros në qytetin e Aleksandrit!

Feliks Zhulien shkruan: ***"Në të gjitha kohërat Shqipëria ka qenë vendi klasik i heronjve: Homeri atje gjeti Akilin, Greqia Aleksandrin etj".***

Do të ishte një nder i madh për ne, si shqiptarë, nëse supozimi që Dhulkarnejni të ketë qenë Aleksandri i Madh do të ishte i vërtetë, për vet faktin që një prej gjeneralëve më të mëdhenj të botës, me origjinën e tij të padiskutueshme shqiptare, të përmendet në librin e muslimanëve, **Kur'anin e Shenjtë,** si një

personazh pozitiv. Është madhështore dhe frymëzuese për ne e brezat që do të pasojnë, thesari më i paçmuar i kombit shqiptar dhe i Shqipërisë, atdheut të Aleksandrit të Madh–Lekës.

***

Sipas interpretimeve të shkollës egjiptiane, ky kokëdybrirësh nuk duhet të ishte Aleksandri i Madh, por një lloj "ejgamberi-njeri", i cili kishte pranuar një Zot, më përpara zbritjes së Kur'an-it të Shenjtë. Vetëkuptohet se Kur'an-i nuk deklarohej se kishte kopjuar nga Bibla e Vjetër, për disa interpretime me "monozotin", por pretendon se All'llahu Xh. Sh. ia kishte zbritur ato informacione drejtpërdrejt profetit Muhammed me anën e Xhebrailit/Gabrielit.

Sipas interpretimeve të shkollës mesjetare turke, ky Dhulkarnejn i Kur'anit a. s. nuk është kush tjetër, pos pikërisht idhulli imitues i Muratit II dhe Mehmetit II: **Iskender Zül Karneyn = Aleksandri i Madh Kokëdybrirëshi** dhe me këtë emër ***Iskenderie*** ata quanin Shkodrën.

I. Bitlisi: ***"Në viset perëndimore të Rumelisë në Arnavudili, ndodhej një fortesë e madhe që njihej me emrin Iskenderie, themeluar për herë të par,ë siç thonë, nga Iskender Zül Karneyn"*** **(***Aleksandri i Madh Kokëdybrirëshi***).**

Është shumë interesant ta përmendim këtu se nga ky interpretim i Kur'anit diçka ka rënë edhe në veshët e M. Barletit, madje nga një fjalim i vetë Gj. Kastriotit. Fillimisht ai shkruan: ***"Epirotëve: pasi ua ndërruan emrat e parë, u vunë të tjerë, sipas zakonit të asaj gjindjeje. Gjergji…s'di se ç'gjë të pazakontë dukej se kishte, u quajt Skënderbeg, që është baraz me tonën: Aleksandër Beg,"*** dhe më pas vazhdon: ***"Turqit, siç thuhet atdheun e lashtë e kanë pasur përtej maleve Rife, përtej viseve të murranit, pranë Oqeanit të Veriut…Thuhet se Aleksandri i Madh i pat mbyllur këta me shula hekuri si bagëti në një vathë dhensh ndërmjet maleve Hyperborë"***.

Ne mendojmë se ky informacion, sado me një interpretim të lirë, lidhet me ajetin e Dhulkarnejnit/Dybrirëshit - Aleksandrit të Madh dhe me jexhuxhët e mexhuxhët me origjinë nga fiset

turko-selxhuke dhe mongole. Këtu, me sa duket, përzihet e ngatërrohet edhe "Muri i Madh" kinez.

Ndër autorët e shkollës shqiptare të interpretimit të Kur'anit të Shenjtë, e pranuan Aleksandrin e Madh si Dhulkarnejnin: S. Frashëri, N. Frashëri, L. Malltezi, M. Zeqo, J. Brahaj… etj.

Kur Mehmeti II Fatihu, ose ndryshe "Mehmet Pushtuesi", ishte duke zhvilluar betejën legjendare përpara Shkodrës, nga kodra-shkëmbi i Kazenës përballë, deklaroi: ***"Oh se ç'vend të shkëlqyer dhe të lartë paska zgjedhur shqiponja për vete dhe për folenë e zogjve të vet"!***

Është gjetur stema heraldike origjinale e qytetit të Shkodrës në "Statutet e Shkodrës" me Shqiponjën e Zezë të Aleksandrit të Madh dhe Pirros së Epirit.

*"**Nga burimet antike dhe ato numizmatike Aleksandri i Madh kishte edhe simbolika me cjap e shqiponjë, po ashtu edhe Pirrua i Epirit në përkrenare kishte bri cjapi, i pëlqente ta thërrisnin "shqiponjë" e madje se njihej edhe si "rritës shqiponjash"**.*

Të gjithë kemi dëgjuar se simbole të Aleksandrit dhe Pirros i kishte imituar edhe Skenderbeu në kuptimin e ruajtjes së traditës dhe vazhdimësisë së lashtë të fisit të tij. Në qoftë se edhe Aleksandri i Madh, sipas tekstit të Shkodrës, e kishte pasur një "atlet të tij", edhe Skënderbeun e mbiquajtën "Atlet të Krishtit".

Por, ne vërejmë se kokëcjapi i Skënderbeut ka dy brirë dhe jo një "të mrekullueshëm" si ai i Aleksandrit të Madh në Bibël! Përkrenarja e Skënderbeut është punuar në Itali dhe i është dhuruar atij si një simbolikë, edicioni i dytë i ndeshjes së cjapit njëbri të Perëndimit me dashin dybrirësh të Lindjes, që gjendet te "Vizionet e Danielit" në Biblën e Vjetër", pra si një lloj "profecie e re mesjetare kristiane.

Ndërkaq, ishin turqit që ia dhanë emrin Gjergj Kastriotit si Iskender/Skanderbeg në kujtim e nderim për Aleksandrin e Madh, të cilin ata në turqisht e quanin **Iskender Beg Zül Karneyn = Aleksandri i Madh Kokëdybrirëshi.** A thua dhurata italiane e ruajti kuptimin e Dhulkarnejnit-Dybrirëshit?!

VIII. SHQIPTARËT PËR LEKËN E MADH

Figura e shquar e historisë botërore, Aleksandri i Maqedonisë-Leka i Madh i ka frymëzuar dhe inkurajuar ndjeshëm shqiptarët në luftërat e tyre për liri e pavarësi. Duke filluar së paku nga shek. XV, shqiptarët e kanë konsideruar atë si paraardhës të denjë të tyre. Arsyet përse kjo figurë u bë kaq popullore dhe hyri aq thellë në ndërgjegjen kombëtare shqiptare duhen kërkuar në lëvizjen humaniste të Rilindjes(Renesansës) evropiane, në njohjen e historisë dhe kulturës antike, në leximin nga elita intelektuale shqiptare e kohës së trashëgimisë antike, të veprave të autorëve të greko-romakëve dhe të gjithë letërsisë humaniste me pikësynim njohjen e rrënjëve të historisë së vendit, të së kaluarës së tij, etj.

Historiani ynë i shquar, Marin Barleti qysh në titullin e veprës së tij "Historia e Skënderbeut" e cilëson Skënderbeun si epirotas: "Marin Barleti, shkodran, mbi jetën dhe veprat e Skënderbeut, princit shumë të ndritur të epirotasve", do të thotë si pasardhës të drejtpërdrejtë të Pirros së Epirit dhe të Lekës së Madh të Maqedonisë.

Barleti e vendos principatën e Kastriotëve në Epir. ***"Gjatë kësaj kohe në Epir - shkruan ai - shquhej ndërmjet mbretërve të vegjël dhe princërve të tjerë emri fisnik i Gjon Kastiotit për sundimin e tij si në qytete të tjera e në Krujë veçanërisht".***

Njëherësh me Pirron Barleti njeh si pararadhës të shqiptarëve edhe Aleksandrin e Maqedonisë. Kjo shprehet sidomos qartë në hyrjen e veprës, kur autori shpjegon shkaqet që e nxisin të shkruajë historinë e Skënderbeut: ***"Përkundrazi, gjithë lumturia dhe lavdia epirote u përplas përdhe nga kulmi i saj me nam pothuaj në një çast dhe liria u shemb e u thërrmua aq sa të mos duket tanimë fare asnjë gjurmë dhe asnjë shenjë e bujarisë së stërlashtë. Prandaj sikur të ngjallej ai Aleksandri i Madh, që i pari bëri të mbahej në gojë emri i fisit..., sikur të kthehej në këtë jetë ai mjeshtri i luftërave, Pirroja, me siguri nuk do ta njihnin***

Maqedoninë e tyre, nënën e kryetrimave, do ta braktisnin vendin që e patën vatër të lirisë dhe do ta përbuznin si të zvetnuar".

Barleti përdor dy emërtime për Shqipërinë e kohës së tij: **Epir** dhe **Maqedoni**. Duke bërë fjalë për rrethimin e dytë të Shkodrës dhe pushtimin e saj nga turqit (1479), Barleti shkruan këto fjalë për Maqedoninë: ***"Sulltani menjëherë u hodh në Maqedoni që sot në gjuhën popullore quhet Arbëri, sepse arbërorët e atij vëndi thuajse të gjithë flasin gjuhën arbërore".***

Në këtë vepër pushtimin e Shqipërisë Barleti e quan pushtim të Maqedonisë, nisur nga fakti se Shqipëria kishtë qenë pjesë e saj në kohën e Aleksandrit të Madh. ***"Shkrodra, -*** shkruan Barleti, ***- është qendra e bregut të Maqedonisë dhe e asaj pjese të Dalmacisë që e ka afër"***, ndërsa më tej shkruan se "Shkodra ishte qyteti më i përmendur dhe kryeqendra e Shëqipërisë". Sulmet e para turke mbi tokat shqiptare Barleti i quan sulme të ndërmarrra ndaj Maqedonisë. Këtë emërtim për vendin përdor autori kur bën fjalë për betejën që u zhvillua në Savër (afër Lushnjës) midis turqve dhe Balshës II (1385). Por krahas emërtimit Maqedoni, Barleti përdor edhe emërtimin Epir. "***Epiri vdiq***, - shkruan ai, - ***bashkë me kryetrimin Skënderbe"***.

Barleti, si të gjithë humanistët e kohës, bazohej tek autorët e vjetër si: Homeri, Straboni, Plini, Platoni, Lukani, Katoni, Cezari...etj. Pra, Barleti përdor për vendin e tij, Shqipërinë, emërtime antike të njohura prej autorëve të vjetër të lartpërmëndur, sepse Maqedonia, Epiri, Arbëria ishin i njëjti vend i njëjti popull, ishin vazhdimësi dhe pjesë integrale e Pellazgjisë së lashtë dhe Ilirisë antike.

Nisur nga këta autorë, Barleti e quan Skënderbeun epirotas dhe Shqipërinë herë Epir dhe herë Maqedoni. Madje, ai shkruan Epiri ose Maqedonia, emra këta të përdorur nga autorët e vjetër për trojet e shqiptarëve të kohës së tij. Epirotas e quajnë Skënderbeun edhe shumë historianë të tjerë humanistë të shek. XV–XVI.

Burimet historike, të nxjerra nga arkivat e kohës, provojnë se shqiptarët vendin e tyre dhe vetveten e quanin Epirotas e pasardhës të Pirros dhe të Aleksandrit të Madh të Maqedonisë.

Në qoftë se kronikat nuk gënjejnë, ne quhemi epirotë. Skënderbeu përmend në letër si paraardhës të shqiptarëve edhe Pirron e Epirit dhe luftërat e tij fitimtare në Itali. Besimi se shqiptarët rridhnin nga Pirroja ishte i pranishëm edhe te turqit. Duke bërë fjalë për qëndresën heroike të shkodranëve në vitet 1478-1479, Barleti shkruan këto fjalë të thëna nga një oficer i lartë turk: ***"Njeriu në botë ndjek gjurmët e gjakut e të fisit të vet, ky është ligj, pra edhe shqiptarët kanë shpirtin dhe zjarrin e Pirros, sepse prej tij rrjedhin***".

Po kështu, edhe shkrimtari i ynë, Frang Bardhi, në kapitullin tretë të fjalorit të tij, ku përshkruan fjalën "Arbni", shkruan se ***"ky është emri i saktë i disa kështjellave që i përkasin asaj pjese të Maqedonisë, e cila quhet Epir ose Albani".*** (Hoc est propria nomina nonnularum, atque Castellorum ad eam partem Macedoniae spectantium, quae Epirus sive Albania dicitur). Duke bërë fjalë për Shkodrën, autori shkruan se ky qytet ndodhet në Epir ose ndryshe Shqipëri (Scodra - vrbs in Epiro, seu Albania).

Si sinonim të Shqipërisë e quan Epirin edhe gjeografi i shquar i shek. XVI, Gerardius Mecator (1512 - 1594). Në atlasin e tij "Theatrum Orbis" autori shkruan: "Epiri, i quajtur ndryshe Shqipëri" (L'Epiro detto l'Albania).

Një barazim të tillë të Arbërisë me Maqedoninë bën edhe historiani humanist, Gjergj Merula, në veprën e tij që bën fjalë për rrethimin e parë të Shkodrës nga turqit më 1474. Sipas tij, sulltani vendosi të sulmonte atë pjesë të Maqedonisë që gjendet buzë Adriatikut e që sot quhet Arbëri. Po ashtu, sipas tij, ***"Shkodra ishtë mu në kufi me Dalmacinë dhe Maqedoninë".*** Më tej, bazuar tek autorët e vjetër, Merula shkruan se lumi i Lezhës "ndan Dalmacinë nga Maqedonia". Duke bërë fjalë për ardhjen e ushtrisë së madhe turke, autori shkruan se tmerri përfshiu jo vetëm krahinën e Shkodrës, por të gjithë "banorët e bregut të Ilirisë dhe të Maqedonisë", pra tërë vendin.

Krahas Pirros, autorë të ndryshëm bëjnë referenca të shqiptarëve edhe me Aleksandrin e Madh. Një nga statutet e Shkodrës, të botuara kohët e fundit (Statuti di Scutari), hapet me

një privelegj dhënë Shkodrës nga Aleksandri i Madh. Barleti e shpjegon emrin e Skënderbeut nga Aleksandri i Madh i Maqedonisë, pikërisht nisur nga fakti se shqiptarët e konsideronin veten pasardhës të tij.

Frang Bardhi shkruan se Shkodra ishte themeluar prej Aleksandrit të Madh të Maqedonisë (Scodra esse conditam ab Alexandro Magno). Bardhi shkruan se këtë e besonin edhe vetë turqit dhe pikërisht për këtë arsye edhe e quanin Skënderia për ta dalluar nga qyteti i Aleksandrisë në Egjipt, i themeluar nga Aleksandri i Madh. Mendimi se Shkodra ishte themeluar nga Aleksandri i Madh qarkullonte në fakt që në kohë të Barletit. ***"Tashti pra***, - shkruan Barleti - ***disa të huaj thonë se Shkodra paska qënë themeluar nga Aleksandri i Madh".*** Sipas Barletit, këtë e besonin të gjithë, edhe vetë muhamedanët shkojnë me këtë arsyetim, sepse Shkodrën në gjuhën e vet e quajnë Skanderi dhe ky arsyetim, sipas shpjegimit të tyre, është një me emrin Aleksandri. Barleti e shpjegon edhe emrin e Skënderbeut si një emër të dhënë nga turqit në kujtim të Aleksandrit të Madh, që shqiptarët e konsideronin paraardhës të fisit të tyre.

Duke bërë fjalë për ndryshimin e emrave të bijve të Gjon Kastriotit nga turqit, Barleti shkruan: ***"Epirotëve, pasi ua ndërruan emrat e parë, u vunë të tjerë, të ndryshëm sipas zakonit të asaj gjindjeje. Gjergji, qoftë rastësisht, qoftë pse ishte më i dalluari ndër të tjerët për natyrën e tij, u quajt Skënder, që është baraz me (emrin) tonë Aleksandër".***

Barleti bën të qartë se Skënderbeu e mbante Aleksandrin si paraardhës të shqiptarëve. Në një rast, duke i dhënë zemër ushtrarëve të tij, Skënderbeu u përmend atyre thyerjen e Darit të Persisë nga Aleksandri ynë (Barleti, vep. cit. f. 224). Me të vërtetë ishte kthyer përsëri shkëlqimi i lashtë i Maqedonisë dhe dukej se kishin ardhur prapë, pikërisht si ishin dikur kohët tashmë të harruara të Aleksandrit dhe të Pirros (Barleti, vep. cit. f. 285).

Si paraardhës të shqiptarëve e njihnin Aleksandrin e Madh edhe shtetet e tjera të kohës, si Republika tregare e Raguzës (Dubrovniku). Kur Skënderbeu me ushtrinë e tij u prit aty nga autoritetet e vendit (gjatë kalimit të tij për në Mbretërinë e

Napolit), në fjalimin e rastit, të mbajtur nga shkrimtari David, duke i uruar atij fitore, oratori tha midis të tjerave se: ***"I lumtur do të shkosh, o princ i pathyeshëm, më i lumtur do të kthehesh. As Aleksandri yt epirotas, as ai Pirroja, mbreti rrufe i epirotasve dhe mjeshtri i luftërave, nuk u kthyen fitimtarë nga Italia, ashtu siç do të kthehesh në atdhe i lumtur e fitimtar ti, o mbret i fuqishëm dhe bujar".***

Vet Skënderbeu, sipas Barletit, në çastin e vdekjes përmend në porositë që i lë të birit fjalët që Filipi II i Maqedonisë i lë të birit të tij, Aleksandrit të Madh.

Autorë të tjerë shqiptarë, si Frang Bardhi, i cituar më lart, besonin madje se Aleksandri i Madh kishte lindur në Petrelë. Autorët e vjetër njoftonin se Aleksandri kishte lindur në Pella. Sipas Bardhit, Pella nuk ishte tjetër veçse Petrela.

Studiuesi i njohur **J. Falemerajer** në veprën e tij **"Elementi shqiptar në Greqi"** shkruan: ***"Maqedonasit e vjetër, fitimtarët e Athinës e të Babilonisë, kishin farefisni me shiptaro-epirotas-ilirianët".***

Edhe patrioti i shquar, Mërkur Bua, pretendonte se rridhte nga Pirroja dhe nga maqedonët e Aleksandrit të Madh. Dihet se në fund të shek. XIX mercenarët shqiptarë të mbretërisë së Napolit mbanin emrin **regjimenti i maqedonëve** (reggimento dei macedoni).

IX. GJAKU S'BËHET UJË, LEKA I MADH: *PELLAZG - ILIR – SHQIPTAR*

Aristidh Kola:

''Askush nuk na ka faj,
se vet i kemi verbuar sytë tanë
me duart tona''!

Leka i Madh ka folur **shqip** dhe duhet të kuptohet si **shqiptar**, edhepse në atë kohë nuk kishte etni shqiptare, por kishte etni ilire, makedhone, dardane, molose, epirote etj., pra kishte etni pellazge, e cila është paraardhësja e etnisë së sotme Shqiptare.

Në çdo luftë në lashtësi kanë marrë pjesë historianët (sikurse sot gazetarët) dhe në një luftë, ku Leka i Madh luftonte me ushtrinë e tij, një historian iu ofrua shumë afër, sepse Leka fliste tmerrshëm. Historiani u interesua ta dëgjojë nga afër (aq sa ka guxuar të afrohet), se në çfarë gjuhe fliste Leka. ***''Zjarm ore''***, - ishin fjalët bubullimë të Lekës komandant, kur i urdhëronte ushtarët e tij që të hidhen në sulm gjatë betejës.

Historiani kuptoi se ky urdhër nuk ishte as greqisht, as latinisht dhe shkroi: ***''Aleksandri fliste në një gjuhë barbare, kur i urdhëronte ushtarët e tij''.***

Kjo do të thotë se Leka i Madh ka folu ilirisht, pra shqip, prandaj ne sot duhet ta quajmë Aleksandri Shqiptar, pavarësisht se si janë thirrë fiset illire nëpër shekuj dhe epoka!

***

Emri i Aleksandrit të Madh ende vazhdon të krijojë turbullira politike. Edhe sot, këtu e dymijë e treqind vjet nga vdekja e tij, duke bërë që politikat e vendeve të ndryshme të varen shpesh herë nga lavdia dhe emri i tij për ta privatizuar, vjedhur e përvetësuar!

Disa pseudohistorianë të sotëm të fqinjve tanë të afërt dhe të largët pretendojnë që Leka i Madh nuk ka prejardhje shqiptare. Por, historianët e lashtë kanë lënë shënime që tregojnë se Aleksandri i Madh ishte i biri i mbreti të Maqedonisë, Filipit II dhe i Olimbisë, një princeshë ilire, e bija e mbretit të Epirit, Neoptolemi I.

Shumë shkrues të historisë antike, ndër ta Herodoti dhe Tukididi, na njohtojnë se pellazgët (shqiptarët e sotëm) janë popull para grekëve ("proelinioi").

Edhe pas kaq shumë faktesh e dokumentesh dhe pohimeve të historianëve e filozofve antikë helenë (grekë), dikush akoma nuk e ka të qartë se kush ishte, çfarë gjuhe fliste, çfarë prejardhje etnike kishte dhe i kujt ishte dhe është Aleksandri i Madh i Maqedonisë, Leka.

Një pirateri, vjedhje, përvehtësim e falsifikim të përkatësisë etnike të Lekës së Madh e bënë grekët modernë dhe tani së fundi këtë gjë përpiqen ta bëjnë edhe sllavo-bullgarët që veten e quajnë sllavo-maqedonas, bile për ironi të shekujve të shkencës e të dritës: XX dhe XXI ata nuk ngurrojnë ta quajnë veten edhe sllavë edhe maqedonas, pasardhës të Aleksandrit të Madh, vetëm për faktin se ata sot banojnë në një pjesë të trojeve të Maqedonisë së dikurshme antike pellazgo-ilire.

***

Çfarë populli janë "maqedonët" e sotëm?

Këta "maqedonë" të tashëm në të vërtetë nuk janë komb më vete. Këta i bëri të ashtuquajtur "komb maqedonas" vetë Tito. Ju dha emër, territor dhe pavarësi. Thjesht, këta janë "komb" i shpikur. Ishte dhe mbeti një lloj testimi, eksperimenti se si do të vegjetojë një shtet i formuar artificialisht me nje komb të trilluar dhe me troje të huaja. Ky grup njerëzish, në fakt, as vet nuk pranojnë se janë komb më vete. Vetë Konstandin Milladinov, poet i parë, asnjëherë nuk pranon se është maqedonas, as nuk pranon se ky farë "kombi" ekziston. Ai e quan veten bullgar dhe të gjithë këta njerëz që na paraqiten sot si "maqedonas", i kosideron si bullgarë.

Maqedonasit nuk janë asnjë përzierje popujsh apo kombesh, ato janë sllavë të ardhur prej përtej Karpateve në Gadishullin Ilirik(Ballkanik), duke uzurpuar toka ilire dhe duke u ngulitur në territorin e Maqedonisë antike ilire, duke u vetëquajtur me emrin maqedon. Por, në fakt këta, kushtimisht të

themi ”maqedonë”, s'kanë asgjë të përbashkët me maqedonët antikë të Pellazgjisë-Ilirikut-Ballkanit.

Sllavomaqedonët e FYROM-it(IRJM) kanë shumë probleme, janë të vetmuar në territorin e tyre të uzurpuar: Bullgaria nuk ua njeh kombësinë, Serbia nuk ua njeh kishën, Greqia nuk ua njeh emrin, Shqipëria nuk ua njeh territorin, kështu që pashmangshëm dhe shumë thjeshtë e qartë janë **shtet dhe komb artificial**.

Ideja për formimin e një shteti dhe kombi artificial, Maqedoni e maqedon modernë, nga ana e diplomacisë europiane u bë me qëllim që të vendosej një stabilitet midis popujve në Ballkan, që kishin aq shumë dallime dhe aq shumë grindje mes veti. Por, u krijua edhe me qëllim të dobësimit dhe copëtimit të mëtejshëm të trojeve pellazgo-ilire të Shqipërisë etnike nga politika shoveniste dhe ekspansioniste e Serbisë e Greqisë.

”Maqedonia e Re” nuk u bë shembull për stabilitet. Ajo, në fakt, qe dhe mbeti burimi i jostabilitetit në rajon. Është shtet që qëndron në këmbë qelqi dhe herët ose vonë, këto këmbë do ta lëshojnë, do t’i thyhen. Është e pamundur të formosh një komb që nuk ka bazë, që nuk ka themele, që nuk ka gjuhë e histori, që nuk ka të kaluar as të tashme, që në fakt është vetëm një marionetë sa për tu argëtuar e kaluar kohën e lirë qarqet politike antishqiptare euro-aziatike.

Besoj se krijesat artificiale nuk mund të jetojnë gjatë. Sidoqoftë, edhe në Bashkimin Evropian po të futet i gjithë Ballkani, përsëri Republika e Maqedonisë (FYROM-IRJM), kështu siç është tani, nuk do mund të mbijetojë.

***

Në Enciklopedinë e ish-Jugosllavisë për shtrirjen gjeografike të Maqedonisë antike theksohet: ***“Maqedonia në periudhën antike ishte shtet i pavarur, i banuar me fise ilиro-trakase, nga maqedonët iu dha emri MAQEDONI”.*** Më poshtë thuhet: ***“Shtrihej rreth brigjeve të Detit Egje. Në histori është njohur me emrin Maqedonia, me kryeqytet Selanikun. Më vonë***

Filipi II, i ati i Lekës së Madh, i zgjeroi kufijtë në veri. Kjo njihej me emrin Maqedonia II, me kryeqytet Stobi. Kufiri i Maqedonisë II shtrihej deri te lumi Astibo dhe rrjedha e poshtme e lumit Erigon". ("Mala enciklopedija", Prosveta, Beograd 1978, f.461).

Fqinji verior i Maqedonisë ishte Dardania, me qytetet më jugore të saj, Justiana dhe Ceflloni. Siç shihet, Maqedonia asnjëherë nuk është shtrirë në veri të lumit Astibo (Bregallnicë) dhe se në perëndim asnjëherë nuk e ka pasur territor të saj Maqedoninë e sotme perëndimore. Ata ishin të banuara me fiset tjera ilire, si: peonët, dasaretët, lynkestët, pirustët, etj. Këtë e dëshmojnë edhe gërmadhat e vendbanimeve të vjetra dhe objektet e shumta arkeologjike të zbuluara anekënd hapësirës së Maqedonisë së sotme.

A mund të jenë sllavo-maqeonasit pasardhës të maqedonëve antikë?

Mitko Panov, akademik për këtë çështje, ndër të tjera, do të theksojë: ***"Makedonski slloveni"***, që në shqip do të thotë ***sllavo-maqedonas***. Në enciklopedinë arsimore theksohet: ***"Maqedonasit - popull i sllavëve të jugut, që emrin e marrin sipas rajonit Maqedoni dhe janë pasardhës të fiseve të vjetra sllave"***. ("Mala Enciklopedija", Prosveta Beograd 1978, f. 463). Në enciklopedinë e gjeografisë theksohet: ***"Maqedonasit - popull nga grupi i sllavëve të jugut, të krijuar nga fiset slave: BERSJAK, STRUMJAN, DRAGOVIT, etj.".***

Ndërkaq, sa i përket etnitetit të këtij populli në enciklopedinë britanike, do të theksohet se: ***"Rilindja maqedonase ishte një process i gjatë i zgjimit kulturor dhe kombëtar. Mendohet se ky process filloi në shek. XIX, kur edhe u paraqitën librat e rilindësve të njohur: Joakim Kërçovski, të Kiril Pejçinoviqit (1816) dhe të Pulevskit (1875)". Kurse*** sociologu i njohur, Ante Flamengo, do të thotë se ***"Popull–komb më i ri që u formua në Jugosllavi është kombi maqedon, i formuar në vitin 1948".*** Pra, identitetin e plotë kombëtar e arritën në vitin 1948. Ja pra pse sllavo-maqedonasit nuk mund të jenë maqedonët antikë. Mu për këtë me shumë të drejtë, **Mitko Panov** e përdor etnonimin **sllavomaqedonas**, në mënyrë që të bëhet dallimi

midis maqedonëve antikë dhe sllavo-maqedonasve të ditëve tona.

Mirë është që autorët sllavo-maqedonas të mos merren me kuazishkencë, sepse kjo u sjell më shumë dëm e huti brenda vet popullit sllavo-maqedonas. Ne i kuptojmë se duan të jenë pasardhës të një populli të stërlashtë, me të cilin mburret historia antike dhe historia më e re, por ja që nuk munden të jenë edhe sllavo-maqedonas edhe maqedonë antikë, sepse maqedonët e Lekës së Madh kanë jetuar në një hapësirë dhe në një kohë krejtësisht tjetër.

X. - K. Frashëri:
E VËRTETA MBI SHQIPTARËT E MAQEDONISË DHE SHTREMBËRIMET E ENCIKLOPEDISË SË SHKUPIT

Edhe pas një mali gjigant me fakte e dokumente shkencore ballkanike e botërore mbi origjinën e vërtetë pellazgo-ilire dhe

mbi autoktoninë e shqiptarëve në këtë gadishull, nacionalizmi dhe shovenizmi sllavomaqedonas nuk ka të ndalur. Ai përmes Akademisë së Shkencave të Maqedonisë dhe Enciklopedisë së saj vazhdon me kokëfortësi dhe naivitet që të mohojë autoktoninë e shqiptarëve në Iliridë dhe vazhdon shtrembërimin e falsifikimin e paskrupullt të historisë së shqiptarëve, të maqedonëve pellazgo-ilirë të antikës dhe glorifikimin e historisë bullgare të sllavomaqedonasve, duke u dhënë atyre tapinë e Maqedonisë antike të Lekës së Madh iliro-shqiptar.

Për këtë çështje në vazhdim po botojmë të plotë punimin shkencor të historianit **Prof. Kristo Frashëri,** të publikuar në Nëntor 2009, në Gazeta SHQIP me titull:

E vërteta mbi Shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimet e Enciklopedisë së Shkupit

Hyrje

Akademia e Shkencave e Republikës së Maqedonisë vuri në qarkullim në shtatorin e kaluar "Enciklopedinë e Maqedonisë", Shkup 2009, botuar nën kryesinë e akademikut të saj, Blazhe Ristovski.

Në zërin kushtuar shqiptarëve të Maqedonisë tërhoqën vëmendjen disa formulime të vjetruara, të cilat opinioni publik shqiptar kishte shpresuar se nuk do t'i dëgjonte më, për faktin se ato kanë qenë gatuar në të kaluarën nga mendje të zhuritura nacionaliste maqedone dhe si të tilla atyre u kishte kaluar koha. Ne nuk do të merremi me përmbajtjen e mbarë zërit "shqiptarët e Maqedonisë", pjesë e Enciklopedisë së përmendur, e cila vuan gjithandej nga pasaktësi, pasi debati do të shkonte gjatë. Do të përqendrohemi vetëm në formulimet historike që ka Enciklopedia e përmendur mbi të ashtuquajturën vendosje e shqiptarëve në Maqedoni, pasi këto formulime krejtësisht të pasakta, pra antishkencore, na kthejnë në shekullin XIX. Aty lihet të kuptohet se shqiptarët nuk kanë qenë të pranishëm në viset e

sotme të Maqedonisë as në Antikitet, as në Mesjetë. Aty ngulet këmbë se:

"Kolonizimet shqiptare në Maqedoni janë regjistruar kryesisht pas shekullit XVI. Janë dyndur heshturazi (sic!) kur tashmë ishin të islamizuar. Dyndjet përfituan nga tollovia e shekullit XVIII, kur feudalët shqiptarë vepronin për pavarësinë e tyre nga pushteti qendror dhe përpiqeshin për zgjerimin e tyre edhe në Maqedoni. Ali Pashë Janina (në fillim të shekullit XVIII) e kishte zgjeruar pushtetin e vet edhe në pjesët jugperëndimore të Maqedonisë, pas së cilës filloi kolonizimi me nga një apo më shumë familje në rreth 30 fshatra. Të gjithë ata arritën nga Shqipëria e Veriut dhe i takonin fisit geg (pra, në kohën e Ali Pashë Tepelenës, i cili ishte nga jugu, qenkan dyndur në Maqedoni shqiptarët e veriut !!! - K.F.). Në Tetovë, Gostivar dhe në vende të tjera, thuhet aty, tashmë kishin dalë pashallarë gjysmë të pavarur me prejardhje shqiptare, të cilët kishin nxitur kolonizimet. Ata përdornin banda kaçakësh të cilat e terrorizonin popullatën maqedone dhe e detyronin të shpërngulej. Nëpër shtëpitë dhe fshatrat maqedone vendoseshin familje shqiptare. Numri i tyre deri në fillim të shekullit XIX ishte rreth 20 mijë veta (sic!!!). Që nga viti 1780-1800 të ardhurit ishin nga fisi Krasniqi dhe Shalë dhe një fis nga Shqipëria e Jugut (sic!). Ata u vendosën në Manastir, në Gostivar (Sërbinovë, Gradec, Reçan dhe Çegran), në Kërçovë (Zajaz, Arangjel dhe Popovjan, Oriziare, Serbicë dhe Çelopek), në Kumanovë (Likovë), në Përlep (Desovë, Zhitoshë dhe Debresht), në Shkup (disa fshatra të Dervenit, Gumalevë, Novo Sellë dhe Brezë), në Strugë (Belicë e Poshtme) dhe në Tetovë (Tearcë, Poroj, Gajre, Reçicë e Vogël, Shipkovicë, Tetovë, Kalishtë dhe Lisec)".

Sipas autorëve të "Enciklopedisë së Maqedonisë", periudha e dytë e kolonizimeve të dhunshme shqiptare në viset maqedone, ndodhi në fillim të viteve '40 të shekullit XIX, pra në vitet e Tanzimatit. Këtë radhë "ardhacakët" shqiptarë erdhën nga Elbasani, Luma dhe Mati, por edhe nga Korça e gjetkë.

Vala e tretë e kolonizimit paska ndodhur në fillim të shekullit XX, kurse vala e fundit, pra vala e katërt e kolonizimit shqiptar të Maqedonisë paska ndodhur pas vitit 1944.

Burimi kryesor për këtë zë ku janë mbështetur akademikët e Maqedonisë duket se është, siç e cilësojnë vetë, vepra e historianit maqedon, Hristo Andonov Polljanski, Shtojcë mbi marrëdhëniet maqedone-shqiptare në të kaluarën, "Vepra të zgjedhura", V.3, Shkup 1981. Nuk është hera e parë që dalin nga qarqet nacionaliste maqedone fyerje dhe shtrembërime në dëm të shqiptarëve. Më se një herë argumentet e tyre të ngjizura me hamendje dhe me pasione janë hedhur poshtë nga kritika historike. Megjithatë, ata vazhdojnë akoma të përsërisin refrenin e tyre të konsumuar se gjoja shqiptarët në Maqedoni janë ardhacakë të zbritur nga skërkat malore të Shqipërisë së sotme.

Synimet që kanë autorët e këtyre formulimeve nuk janë të njëjta me ato që kishin paraardhësit e tyre nacionalistë para se të formohej shteti maqedon. Në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX, gjyshërit e nacionalistëve të sotshëm maqedonë synonin të bindnin diplomacinë e madhe europiane se viset e sotme të Maqedonisë veriperëndimore dhe perëndimore nuk u takojnë shqiptarëve ardhacakë, por banorëve autoktonë maqedonë. Tani që e kanë, si të thuash, tapinë në xhep, kanë synime me qitje të largët. Duan të tregojnë se shqiptarët janë ardhacakë, pra emigrantë ose azilantë. Si të tillë, shqiptarëve nuk u takon e drejta e "isopolitisë", pra e drejta që të marrin pjesë njësoj si maqedonët në drejtimin e shtetit të tyre. Duket se ata përpiqen të spekulojnë aktet ndërkombëtare të kohëve të reja, që flasin për emigrantët, të cilët edhe kur fitojnë të drejtat e qytetarisë nuk gëzojnë të drejtën e formimit të një shteti të veçantë, as pjesëmarrjen si trup i veçantë në shtetin e tyre nacional. Këto janë pa dyshim ëndrra kimerike që i shohin nacionalistët me sy hapur, të cilët flenë akoma në djepin e shekullit XIX.

Të trajtosh shqiptarët që banojnë në atdheun e tyre që nga agimi i historisë si ardhacakë apo emigrantë, apo azilantë, është një fyerje e rëndë për ta. Ashtu siç pritej, sapo "Enciklopedia e

Maqedonisë" doli në qarkullim shpërthyen kundër saj protestat e lexuesve shqiptarë brenda dhe jashtë Maqedonisë. Si pasojë e këtyre protestave krejtësisht të natyrshme, "Enciklopedia e Maqedonisë" u tërhoq shumë shpejt nga qarkullimi, pastaj u vendos që të korrigjohej zëri kushtuar shqiptarëve dhe më pas akoma ky zë të shkruhej nga e para.

Kur këto gërr-mërre dalin nga pena ordinere as që ia vlen të merresh me to. Këtë radhë puna ndryshon, mbasi me gërr-mërre po merren disa "akademikë" maqedonë. Duke marrë parasysh nivelin shkencor tepër të ulët që ka zëri kushtuar shqiptarëve në Enciklopedinë e Akademisë së Shkencave të Shkupit, ne do të përgjigjemi veçse shkurt.

Shpresojmë se formulimet fyese, absurde, provokatore që përmban zëri i përmendur jo vetëm për shqiptarët e Maqedonisë, por për pjesëtarët e mbarë kombit shqiptar - tani që Akademia e Shkupit u detyrua ta tërheqë "Enciklopedinë" nga qarkullimi për ta rishkruar - këto formulime fyese duhet të fshihen nga faqet e saj. Meqenëse historinë e kombit shqiptar ne e kemi temë qendrore të punës sonë shkencore dhe jo kujdes anësor, siç e kanë disa akademikë maqedonë të Shkupit, le të kenë durim dhe ta lexojnë këndvështrimin tonë për historinë e shqiptarëve të republikës së tyre.

Gabime metodike dhe faktologjike

Para se të hyjmë në temën e mirëfilltë e ndiejmë për detyrë të nënvizojmë disa kritere të gabuara që përmban sinteza mbi shqiptarët në "Enciklopedinë e Maqedonisë", të cilat nuk tregojnë shkencë, por amatorizëm dhe nacionalizëm.

Gabimi i parë i palejueshëm për historianët, madje edhe për mësuesit e shkollave të mesme, është shkelja e parimit më elementar të metodologjisë shkencore të historiografisë, e cila kërkon që ngjarjet historike të shihen në kohë dhe në hapësirë. Është pikërisht ky gabim që vihet re në zërin shqiptarët e Maqedonisë. Në bazë të këtij parimi, Maqedonia antike nuk duhet të identifikohet as për nga shtrirja gjeografike, as për nga

etnikoni i banorëve me Republikën e Maqedonisë së ditëve tona. Para së gjithash se shtrirja gjeografike e emërtimit Maqedoni, gjatë shekujve nuk ka qenë kurdoherë e njëjtë. Kohë pas kohe, kufijtë e saj territorialë kanë pësuar luhatje. Madje, ka pasur raste kur emërtimi gjeografik Maqedoni është zhvendosur krejtësisht jashtë kufijve të sotshëm të saj. Kështu për shembull, në shekujt I-II të erës sonë ekzistonin dy provinca romake me të njëjtin emër - Maqedonia e Parë (Macedonia Prima) me qendër Selanikun dhe Maqedonia e Dytë (Macedonia Secunda) me qendër Durrësin. Te vepra e gjeografit Aleksandrin të shekullit II Klaud Ptolemeu (Geographia, Libri 12), Maqedonia e Dytë, pra provinca e Durrësit shtrihej në veri deri në derdhjen e lumit Drin, në Lindje përtej Liqenit të Ohrit deri te qyteti Heraklea i Lynkestëve, kurse në Jug, përtej Vlorës deri në malet Akroceraune të Himarës. Më vonë, Maqedonia e Dytë u quajt provinca e Epirit të Ri (Epirus Nova) me qendër Durrësin dhe përfshinte, sipas njoftimeve që ndeshim në Notitia Dignitatum (III, 13) edhe një pjesë të Maqedonisë historike (Epirus nova et pars Macedonia Salutaris). Për këtë arsye, shpeshherë në burimet historike mesjetare, savante europiane, Arbëria është identifikuar me Maqedoninë (Albania sive Macedonia) dhe shqiptarët e provincës së Durrësit, janë quajtur maqedonë. Përkundrazi, banorët sllavë pasi u vendosën në Maqedoni në fillim u quajtën skllavinë dhe më vonë bullgarë, kurse vendi i tyre në fillim Skllavini dhe më vonë Bullgari. Është e vërtetë se herë pas here emërtimi gjeografik Maqedoni është zhvendosur, por zhvendosja ka ndodhur kryesisht drejt Lindjes deri në Selanik e përtej dhe asnjëherë drejt veriut, në kurriz të provincës së Dardanisë.

Në pragun e dyndjeve sllave ekzistonin, sipas njoftimeve që përmban vepra e udhëpërshkruesit të shekullit V, Hierocles (Synecdemus, 655, XVI, 7), përsëri dy provinca që mbanin emrin Maqedoni - njëra Macedonia Prima (Maqedonia e Parë), me qendër Selanikun, tjetra Macedonia Secunda (Maqedonia e Dytë) me qendër Stobin.

Me një fjalë, në shekullin VI e.s. kur filluan dyndjet sllave në Ballkan, emërtimet gjeografike-administrative antike, Dardani

dhe Maqedoni, vazhdonin të ishin ende në përdorim. Në shekullin VI ato ishin shndërruar në njësi administrative perandorake bizantine me po ato emra - në provincën e Dardanisë dhe në provincën e Maqedonisë së Dytë. Ato ishin përsëri fqinje me njëra-tjetrën. Provinca e Dardanisë vazhdonte të kishte kryeqendër Shkupin. Përkundrazi, provinca e Maqedonisë së Dytë, tani e ngushtuar, kishte për kryeqendër përsëri Stobin. Kufiri i tyre kalonte midis Shkupit dhe Stobit, afër fshatit të sotshëm Kozhle poshtë lart në veri të qytetit Bylazora, sot Velesh, e cila kjo e fundit i takonte Pajonisë. Tjetër pikë kufitare ishte qyteti dardan, Sintia, të cilën Tit Livi e quan shkoqur "urbs dardanorum" (T. Livi XXVI, 253), diku në luginën e lumit Strimon, midis Shkupit dhe Përlepit, nga të cilat kjo e fundit i takonte Maqedonisë. Sikurse shihet, në shekullin VI viset shqiptare të Maqedonisë së sotme nuk bënin pjesë në asnjë nga dy provincat bizantine maqedone.

Përfshirja nga shumë historianë maqedonë e viseve veriore dhe veriperëndimore të Republikës së sotme të Maqedonisë, sot të banuara në shumicën dërrmuese nga popullsi shqiptare, - që nga rrethet e Ohrit, Strugës, Dibrës, Kërçovës, Gostivarit, Tetovës, Shkupit, Kaçanikut, Kumanovës - në kufijtë e Maqedonisë historike, është pra një shkelje e kritereve të historiografisë shkencore. Me këtë hartë gjeografike të shekullit VI, Bjeshkët e Sharrit kanë përbërë për mijëra vjet, si më parë edhe më vonë, deri më 1913, boshtin kurrizor të provincës së Dardanisë apo të Vilajetit të Kosovës dhe jo siç përbëjnë sot kufirin politik midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.

Gabimi i dytë ka lidhje me cilësimin që akademikët e Maqedonisë u bëjnë shqiptarëve si banorë të dikurshëm të maleve të Shqipërisë, të cilët më vonë qenkan dyndur "heshturazi" në fushat e Maqedonisë, duke ia ndryshuar karakterin etnik sllav që këto vise kanë pasur më parë. Ky cilësim ka brenda saj një varg pasaktësish, madje absurditetesh.

Para së gjithash, termi që ata përdorin për dyndje të heshtur të shqiptarëve është një abuzim letrar. Historia nuk njeh

dyndje të heshtura. Dyndjet kryhen kurdoherë me dhunë. Ato që zhvillohen në mënyrë të heshtur janë emigrime apo shtegtime.

Përdorimi i termit dyndje të heshtura

Provinca e Dardanisë me kryeqendër Shkupin, provinca e Maqedonisë së Dytë (Macedonia Secunda) me kryeqendër Stobin, provinca e Maqedonisë së Parë (Macedonia Prima) me kryeqendër Selanikun në shekujt V-VI të erës sonë. Hartë e fotokopjuar nga botimi i Akademisë së Shkencave të Bullgarisë: Izvori za Bëllgarskata Istorija. Fontes Latini, vëll.I, Sofia 1958.

Është përdorur mbasi nuk ka fakte të dokumentuara. Deri sot asnjë historian nuk ka ndeshur në burime historike dokumentare, që të vërtetojnë shtegtime në masë të hapura, ca më pak të "heshtura" banorësh nga malësitë e Shqipërisë nëpër fushat e Maqedonisë. Në të vërtetë, në Maqedoninë historike, fqinjë e Dardanisë, ka disa enklava shqiptarësh në rrethin e Manastirit, të Përlepit apo të Veleshit, të cilat mund të thuhet se janë krijuar nga shtegtime të mëvonshme. Por shqiptarët që përbëjnë shumicën në rrethet veriperëndimore dhe veriore të Republikës së sotme të Maqedonisë, që nga Ohri deri në Kumanovë, kurrsesi nuk mund të quhen enklava, pasi ata përbëjnë shumicën e këtyre krahinave, aq më tepër që këto krahina kanë vazhdimësi territoriale me njëra-tjetrën dhe me viset shqiptare të Shqipërisë së ditëve tona. Përveçse këto krahina nuk kanë bërë pjesë në provincën e Maqedonisë as në Antikitet, as në Mesjetë, as në periudhën osmane, sikurse do të shohim, banorët e tyre janë pasardhësit e stërgjyshërve të tyre, të cilët kanë banuar për shekuj në viset jugore të Dardanisë dhe në viset lindore të provincës së Durrësit, pra në atdheun e tyre historik. Shqiptarët janë pra, banorë autoktonë, kurse ardhacakë janë banorët sllavo-maqedonë, paraardhësit e të cilëve janë vendosur në Gadishullin Ballkanik në shekullin VII të erës sonë. Me këtë pohim, as që na shkon ndër mend të lëvrojmë te shqiptarët pasione nacionaliste, as t'ua mohojmë sllavo-maqedonëve atdheun që krijuan pas shekullit VII të erës sonë.

Qëllimi ynë është vetëm të respektojmë saktësinë historike dhe t'u vëmë ledh fyerjeve dhe synimeve politike që fshihen prapa këtyre fyerjeve.

E treta, çështja më serioze e debatit, ka lidhje me identitetin etnik, apo kombëtar, apo kulturor të maqedonëve të sotshëm.

Të gjithë popujt apo kombësitë kanë një identitet pak a shumë të përcaktuar etnik, apo kombëtar, apo kulturor, një identitet të formuar me ngjyrime të ndryshme sipas kohëve, por që në çdo kohë ai i dallon nga kombësitë dhe kombet e tjera. Në komponentët e identitetit bëjnë pjesë, jo vetëm gjuha, doket, zakonet, mentalitetet, në disa raste feja, por edhe prejardhja gjenetike. Me sa dimë ne, të gjitha kombësitë e kanë formuar prej kohësh identitetin e tyre etnik apo kulturor. Të gjithë e dinë se cila është prejardhja e tyre gjenetike. Vetëm maqedonët e sotshëm, siç po del nga pena e tyre, duket se nuk kanë ende një identitet të përcaktuar. Ata janë ende në kërkim të identitetit të tyre kulturor dhe historik. Në përgjithësi pranojnë se i përkasin familjes së madhe etnolinguistike sllave dhe se procesi i formimit të kombësisë tek ata nisi me vendosjen e tyre në Gadishullin Ballkanik. Deri në fund të shekullit XIX, madje edhe deri në pragun e Luftës së Dytë Botërore, banorët sllavë të Maqedonisë e mbanin veten në përgjithësi si pjesëtarë të kombësisë bullgare. Që nga fundi i shekullit XIX, lindi tek elitat e tyre politike ideja se ata padrejtësisht kanë qenë përfshirë në kombin bullgar. Në qoftë se ata e veçuan veten e tyre nga kombësia bullgare dhe vunë themelet e kombësisë maqedone, kjo është punë e tyre. Ne nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në çështjet e brendshme të ndërgjegjes së tyre. Sigurisht, që nuk na u duk e arsyeshme kur me themelimin e Republikës së Maqedonisë ata filluan të pretendojnë se ishin pasardhësit e etnisë maqedone të kohës antike dhe se Aleksandri i Maqedonisë ishte figurë e ndritur e historisë antike të maqedonëve sllavë. Te kjo tezë e re ne shohim një nonsens, për të mos thënë një absurditet. Por, disa akademikë sllavë të Shkupit duket se nuk duan të dinë fare për saktësi historike. Për ta, maqedonët e ditëve tona, vëllezërit e bullgarëve apo kushërinjtë e serbëve, kur e do puna janë sllavë, kur nuk e

do puna nuk janë sllavë. Kur flitet për autoktoni ata nuk janë sllavë, por pasardhësit e maqedonëve të Filipit të Maqedonisë e të Aleksandrit të Madh. Përkundrazi, kur takohen me vëllezërit e familjes së tyre etnogjuhësore me rusë, bullgarë, serbë, ata shndërrohen në sllavë.

Rreth 30 vjet më parë, erdhi në Tiranë profesori maqedon, Hristo Andonov Poljanski, i cili mbajti në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Historisë një ligjëratë mbi marrëdhëniet shqiptaro-maqedone. Ai e nisi ligjëratën afërsisht me këto fjalë: Marrëdhëniet maqedone-shqiptare kanë rrënjë të lashta në histori. Ato fillojnë, tha ai, që në kohën e Aleksandrit të Madh. I nderuari profesor i Shkupit kujtoi se me këtë lashtësi që ai na atribuoi, ne, shqiptarët e Shqipërisë së sotme duhej të krenoheshim, sepse duke na trajtuar si fqinjë të lashtë nuk ishim ardhacakë, por banorë të viseve tona të paktën që në kohën e Aleksandërit të Madh. Në të vërtetë, gjithë auditori u step kur e dëgjoi këtë profesor të nxirrte nga goja xhevahirin e padëgjuar se maqedonët e sotshëm ishin stërnipër të Lekës së Madh. Ca më tepër, auditori u çudit kur profesor Poljanski tha se Heroi Kombëtar i shqiptarëve, Skënderbeu, nuk ishte shqiptar, por maqedon, sidomos kur shtoi se në ushtrinë që ai udhëhoqi në luftë kundër Perandorisë Osmane bënin pjesë kryesisht luftëtarë maqedonë dhe pak shqiptarë. Ne e përmbajtëm veten, por e pyetëm: Profesor, për cilët maqedonë flisni, sepse për ne historianët, në kohën e Aleksandërit të Madh, juve bridhnit ende në stepat e Rusisë, kurse në viset e Aleksandërit të Madh ju keni ardhur dhjetë shekuj më vonë. Ai u përgjigj afërsisht në këtë mënyrë: Kam respekt, tha, për kulturën tuaj dhe për dijenitë tuaja. Por ju, ende nuk e keni mësuar historinë e vërtetë. Ne, tha ai, maqedonët, me të vërtetë kemi ardhur shekuj më vonë, por përderisa u vendosëm në trojet e maqedonëve të lashtë, ne jemi pasardhësit e tyre, jo vetëm pasardhësit e tyre kulturorë, por edhe gjenetikë. Ne kemi të drejtë të krenohemi me Aleksandërin e Madh dhe të përdorim flamurin e tij. Pranojmë, i thamë, se nuk e dimë mirë historinë, prandaj u pyesim të na sqaroni çfarë do të thoshit ju nëse turqit osmanë, të cilët u vendosën në viset e

Perandorisë Bizantine dhe patën të njëjtin kryeqytet, Stambollin, do ta quanin veten e tyre pasardhës gjenetikë të bizantinëve dhe shtetin e tyre do ta emërtonin në bazë të kriterit tuaj, jo Perandori Osmane, por Perandori Bizantine? Deri sot nuk kemi marrë ende përgjigje. Ne kujtuam se profesor Poljanski ishte një pjellë e rrallë e nacionalizmit maqedonomadh, por tani po shohim se paskemi qenë të gabuar. Paskemi qenë të gabuar, sepse më 1991, kur ish-Republika maqedone e Jugosllavisë u bë republikë e pavarur në Ballkan, udhëheqësit e saj adoptuan për flamur kombëtar të tyre flamurin e Aleksandërit të Maqedonisë. Të adoptosh emrin e lashtë të Maqedonisë si emër kombëtar të republikës së krijuar në shekullin XX dhe të adoptosh për këtë republikë të re flamurin e Aleksandërit të Maqedonisë, kjo përsëri është punë e tyre. Ne nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë kundër vullnetit të një kombi. Megjithatë, si qytetarë të një vendi që synon të integrohet në Bashkimin Europian dhe ca më tepër, si historianë që përpiqen të përvetësojnë standardet e metodologjisë moderne të historiografisë, nuk mund të rrimë pa vënë në dukje se këtu kemi të bëjmë me një ndryshim të rremë, fals të identitetit kombëtar. Ja, në veprën e këtij profesori të mbushur me "madhërinë e vet" (shprehje e Migjenit) është mbështetur zëri shqiptarët e Maqedonisë, që botoi Akademia e Shkupit. Si mund të ndryshohet tri herë identiteti kombëtar brenda një shekulli? Çfarë kombi është ky, pjesëtarët e të cilit janë sllavë dhe si të tillë një shekull më parë quheshin bullgarë, pastaj e shpallën veten maqedonë, por përsëri sllavë, kurse pas vitit 1991 e quajnë veten maqedonë antikë, pra jo sllavë? Na vjen me të vërtetë keq që fqinjët tanë janë ende në kërkim të një identiteti përfundimtar kombëtar, kërkim i cili nuk dimë se ku do t'i çojë më tej.

Tani le të kthehemi në faktet historike.

Struktura etnike në Maqedoninë e sotme në shek. VI, në pragun e dyndjeve sllave

Para se sllavët të vendoseshin në Gadishullin Ballkanik, pra para Mesjetës së hershme, maqedonët e sotshëm, si pjesëtarë të

etnive sllave, banonin në stepat e Rusisë. Nuk dimë të ketë historianë që ta kenë ndriçuar parahistorinë e sllavëve, pra historinë kur ata jetonin në atdheun e tyre të hershëm, e cila është ende thellësisht e errët. Në fakt, etnogjeneza e maqedonëve të sotshëm fillon me dyndjet e tyre nga stepat ruse dhe me ngulitjen e tyre në trevat ballkanike. Pra, fillon kur ata u bënë fqinjë me popullatat ilire, të cilat banonin në Gadishullin Ballkanik që nga agimi i historisë e këtej. Megjithatë, procesi i formimit të etnisë maqedone apo i paraardhësve të tyre bullgaro-sllavëve nuk u krye menjëherë pas vendosjes së tyre në Gadishullin Ballkanik. Ai pushton shekujt e Mesjetës së hershme.

Mesjeta e hershme është një nga periudhat më të rëndësishme të historisë së kombësive të Gadishullit Ballkanik. Si kudo në kontinentin europian, edhe këtu, gjatë kësaj periudhe ndodhën shndërrime të thella në fushën ekonomike dhe shoqërore, politike dhe kulturore. Shkakun themelor këto shndërrime e patën te kriza që mbërtheu rendin skllavopronar dhe te vala e gjatë e dyndjeve barbare që pësoi Gadishulli Ballkanik në fund të Antikitetit dhe në fillim të Mesjetës së hershme. Në kuadrin e këtyre dy fenomeneve, shoqëria antike skllaviste në këto troje u përmbys. Mbi gërmadhat e saj lindi shoqëria feudale e Mesjetës së hershme. Në të njëjtën kohë, në përfundim të dyndjeve barbare në Gadishullin Ballkanik ndodhën ndryshime të rëndësishme edhe në hartën etnike të Europës Juglindore. Disa kombësi antike u zhdukën, disa rezistuan. Vendin e kombësive që u zhdukën e zunë popullata të reja që u dyndën nga veriu dhe nga verilindja e gadishullit. Dihet se Mesjeta e hershme është jo vetëm për trevën shqiptare, por për mbarë Europën Juglindore, një periudhë thellësisht e varfër nga pikëpamja e burimeve dokumentare. Këtë varfëri të burimeve historike e kanë shfrytëzuar historianët e interesuar sllavë për të krijuar përshtypjen fiktive, sikur në Antikitetin e vonë, në fillim të dyndjeve barbare, trojet e Maqedonisë dhe të Dardanisë kishin mbetur pa banorë dhe se ato u mbushën, sipas tyre, me banorë të rinj sllavë, të cilët vërshuan në këto vise në pjesën e parë të shekullit VII. Me një fjalë, sipas tyre, banorët

sllavë nuk janë uzurpatorë, por popullata që mbushën toka të zbrazura pa banorë, duke fituar kështu të drejtën e pronësisë mbi këto vise. Por, për të dyja këto çështje me rëndësi kapitale - për asgjësimin e popullatave të mëparshme ilire dhe për vendosjen e popullatave të dyndura sllave - historianët që përkrahin këtë tezë të re nuk kanë sjellë për asnjërën prej tyre argumente historike. Me këtë rast dua të përsëris atë që kam pohuar në konferencën organizuar në Shkup në dhjetor të vitit 1991, me titull "Shqiptarët e Maqedonisë". Aty kam thënë: "Nuk është e fshehtë se është mohuar prania e shqiptarëve në viset e tyre të Ballkanit gjatë kësaj periudhe (gjatë Mesjetës së hershme - K.F.). Kjo ka krijuar atë interpretim të shtrembër sikur shqiptarët në trojet e tyre historike nuk janë të zotët e shtëpisë, por të ardhur. Është temë e vështirë sigurisht. Mungojnë materialet dhe burimet e shkruara janë shumë të varfra. Por, burimet mungojnë edhe për ata (maqedonët - K.F.) që pretendojnë se janë të zotët e shtëpisë". (Shqiptarët e Maqedonisë, botim i Meshihati i BI në RM, Shkup 1994, f.634).

Ndërkohë, rezultatet e hulumtimeve të mëvonshme kanë hedhur nga pikëpamja dokumentare mjaft dritë mbi strukturën etnike që kishin viset shqiptare të Maqedonisë së sotme në pragun e dyndjeve sllave. Në trajtesën "Historia e Kosovës", vëll.I, Dardania (Kosova antike), përgatitur nga Kristo Frashëri, botuar nga "Dudaj", Tiranë 2008, janë sjellë me sa e ka lejuar vendi dëshmi që provojnë se treva e gjerë e Dardanisë ka qenë që nga agimi i historisë vazhdimisht e banuar nga popullatat e etnisë ilire. Kjo për të treguar se kur filluan dyndjet e popullatave sllave, Dardania nuk ka qenë një provincë e shkretuar, siç pretendojnë historianët sllavë, por një vend me popullsi të dendur ilire, pa mohuar se krahas tyre ka pasur dhe popullata ilire të romanizuara ose thjesht banorë romakë-latinë. Ato provojnë jo vetëm se kjo pjesë e Dardanisë, e cila është e përfshirë në Republikën e sotme të Maqedonisë ka qenë e ngjeshur me banorë ilirë, por edhe faktin tepër të rëndësishëm se kjo popullsi ilire ka qenë në atë kohë shumë dinamike në jetën ekonomike, shoqërore, politike të Perandorisë Bizantine. Më tej

akoma, provinca dardane ka qenë kaq dinamike dhe kaq e populluar me banorë ilirë sa nga gjiri i saj dolën gjatë shekullit VI, tre perandorë të Bizantit me origjinë ilire. Ata qenë: i pari, Justini (518-527) nga Bederiana pranë Shkupit, në Dardani, të cilin kronisti bizantin i kohës së tij, Prokopi i Cezaresë e cilëson në veprën e tij - me prejardhje ilire (Historia quae dicitur Arcana, Lipsiae, B.G. Teubner, 1913, vëll. III, 6,2); I dyti, Justiniani (527-565), i mbiquajtur i Madh, nipi i Justinit, i cili lindi, sipas Prokopit të Cezaresë, në Tauris, fshat pranë Bederianës së Dardanisë, në afërsi të Shkupit, edhe ky ilir; i treti, Justini II (565-578), i cili ishte dardan, pra ilir, posa që ishte nipi i Justinianit të Madh (Menandri, Historici Graeci Minores, edidit Ludovicus Dindofias, fr.25-26).

Fakti që Justiniani ndërtoi dhe rindërtoi në Dardani në mes të shekullit VI më shumë se 158 kala, pra shumë më tepër se në provincat e tjera (në Epirin e Ri 58 kala; në Epirin e Vjetër 36 kala; në provincën maqedone 46 kala), tregon se këtu populllsia vazhdonte të ishte e dendur dhe jo e rralluar, siç pretendojnë jo pak historianë. Edhe dekreti që nënshkroi Justiniani më 18 tetor 532 mbi vështrimin juridik të institutit të familjes drejtuar prefektit të prefekturës së Ilirikut dëshmon për një jetë shoqërore dhe sllaviste tepër aktive te dardanët. Jetën shoqërore aktive të Dardanisë e dëshmon dhe novela XI pjesë e "Codex Justinianus", që Justiniani shpalli në vitin 535, me të cilën ai krijoi në trevën dardane, madje në vendlindjen e tij, pranë Shkupit, një kryepeshkopatë të re nën ombrellën e Romës, pa përfshirë provincën e Maqedonisë, pra një institucion kishtar që nuk do të kishte më lidhje me kryepeshkopatën e Selanikut, e cila mbeti e varur nga Kostandinopoja. Për më tepër, edhe pse nën ombrellën e Romës, institucioni i ri nuk do të ishte mitropoli, siç ishte ajo e Shkupit, por një kryepeshkopatë në një shkallë më të lartë, me statusin e ekzarkatit, e cila nënkuptonte se do të gëzonte një autoqefali kishtare. Vetë ngritja e një ekzarkati nënkupton një populllsi më me peshë se sa kishte një kryepeshkopatë në atë kohë. Fakti që kjo kryepeshkopatë kishte në vartësinë e vet disa

peshkopata, është një dëshmi më tepër që provon popullsinë e dendur të krishterë të Dardanisë.

Në kundërshtim me historianët kryesisht sllavë, të cilët mohojnë karakterin etnik ilir të banorëve që popullonin brezin jugor të trevës dardane, me qendër Shkupin, nuk mungojnë historianë jugosllavë, të cilët nuk pajtohen me kolegët e tyre të politizuar. Midis tyre, vlen të përmendet një nga penat më të njohura të historiografisë bashkëkohore jugosllave, Fanulla Papazoglu. Ajo ka shkruar se Dardania ishte "një nga krahinat ballkanike më pak të romanizuara" dhe se "popullsia e saj vendase duket se e kishte ruajtur më mirë se gjetiu individualitetin dhe vetëdijen e saj etnike". Pastaj "nuk duhet pra, përjashtuar mundësia që dardanët, të cilët i shpëtuan romanizimit, të kenë mbijetuar, përfundon ajo, edhe pas migracionit sllav dhe të kenë dalë në Mesjetë me emrin shqiptar". (F. Papazoglu, Les royaumes d'Illyrie et de Dardanie. Origines et developpement. Structures, hellenisation et romanisation. Në: "Iliri e Albanci", Beograd 1988, f. 19). Po ashtu, gjuhëtari i shquar serb, Henrik Bariç, pranon se shqiptarët banonin në hapësirën e Dardanisë dhe të Peonisë, para se në këto vise të dyndeshin sllavët. Në mungesë të njoftimeve historike, shkruan ai, praninë e shqiptarëve në këto vise në fund të Antikitetit dhe në fillim të Mesjetës e vërtetojnë jo vetëm emrat ilirë të personave që ndeshen në mbishkrimet e varreve, por edhe toponimitë antike të kësaj treve, siç janë Scupi, Naissus, Astibos, Lychnis, shndërrimi i të cilëve në trajtat e mëvonshme Shkup (Scupi), Nish (Naissus), Shtip (Astibos), Ohër (Lychnid), etj., shpjegohet me anën e ligjeve fonetike jo të sllavishtes, por të shqipes (H. Bariç, Hymje në historinë e gjuhës shqipe. Prishtinë 1955, f. 49-50).

Nga sa u tha deri këtu dalin dy konkluzione, të cilat akademikët e Maqedonisë duhet t'i kenë parasysh: e para, se në pragun e dyndjes së barbarëve në Gadishullin Ballkanik provinca e Dardanisë nuk ishte rralluar për nga popullsia, por kishte banorë ilirë aktivë dhe, e dyta, se këto vise ilire ku dhe sot e kësaj dite banojnë shqiptarë në shumicë, të cilët në shekullin VI

vazhdonin ta kishin fytyrën të kthyer nga Roma, nuk kishin asnjë lidhje me provincën maqedone, e cila kishtarisht mbeti e lidhur me Kostandinopojën. Mohimi i këtyre konkluzioneve është një spekulim pa shije.

Të dy këto konkluzione na bindin se, teza e përhapur në historiografinë ballkanistike se në fund të Antikitetit, pra para ngulimeve sllave në Ballkan viset e sotme të Maqedonisë ishin pa banorë, mbështetet në pohime aprioristike pa dëshmi dokumentare. Kundërshtarët e këtyre dy konkluzioneve citojnë jo burimet dokumentare të Antikitetit të vonë, por njëri-tjetrin ose shumë-shumë toponimet sllave që ndeshen në viset shqiptare të Maqedonisë. Toponimet sllave, të cilat sot janë tepër të përhapura jo vetëm në viset shqiptare të Maqedonisë, por edhe në mbarë Gadishullin Ballkanik, nuk ndeshen në shekujt e hershëm mesjetarë. Ato dalin në fushën e burimeve dokumentare më vonë, duke filluar nga shekulli XI e këtej. Nuk është pa vend të përmendim këtu njoftimin që na jep kronisti bizantin me origjinë ilire, Marcelin Komesi, sekretari i perandorit Justinian, me origjinë dardane në veprën e vet "Chronicon". Shkupin ai nuk e vendos në asnjë nga të dyja Maqedonitë, por në provincën e Dardanisë (Marcellinus Comes, Chronicon, ad An. 518). Po ashtu, edhe Hierokli e quan Shkupin “Skupimetropolis”, domethënë kryeqendrën e Dardanisë (Synecdemos 655, XVI, 8).

Si përfundim, nuk është e drejtë orvatja e disa historianëve, të cilët kur ngjarje që kanë ndodhur në brezin jugor të Dardanisë antike i përfshijnë si ngjarje që i takojnë Maqedonisë antike dhe mesjetare.

(Fund i punimit të K.Frashërit)

***

XI. MAQEDONË TË SLLAVIZUAR OSE SLLAVOBULLGARË

1.Konvertimi i maqedonasve të sllavizuar në shqiptarë

Tani më poshtë do të bëjmë qasje hipotetike që, kushtimisht sllavomaqedonasve t'u japim gjasën e fundit strategjike që të konvertohen në maqedonas të vërtetë, por pa imponime ndaj tyre dhe pa keqkuptime nga shqiptarët, por që është në në mirën e përbashkët të të dy palëve:

- Nëse sllavomaqedonasit kanë vërtetë parandenja e ndjenja, intuitë e instikt, besim e bindje se janë pasardhës të sllavizuar të maqedonëve antikë pellazgo-ilirë, atëherë ata duhet të deklarohen publikisht dhe ligjërisht për këtë çështje.

- Ata duhet ta pranojnë se maqedonët antikë kanë qenë pallazgo-ilirë dhe si rrjedhim i kësaj edhe sllavomaqedonasit e sotëm janë pellazgo-ilirë, pra janë shqiptarë të asimiluar që kanë humbur gjuhën iliro-shqiptare, duke pranuar gjuhën sllavo-bullgare. Dhe humbja e gjuhës pellazgo-ilire nga maqedonët ilirë të Lekës së Madh dhe marrja e gjuhës sllavo-bullgare pati si pasojë edhe ndërrimin e etnisë së tyre nga etnia Ilire në atë sllave. Sa për fenë ortodokse nuk është pengesë, sepse edhe një pjesë e shqiptarëve e kanë ndërruar fenë dhe i kanë sot tre religjione të respektuara e të barabarta.

- Që sllavomaqedonasitt e sotëm nga Kumanova në Selanik të Greqisë dhe nga Ohri në Sandanski të Bullgarisë të munden lirisht e moralisht ta konsiderojnë veten si pasardhës të maqedonëve antikë pellazgo-ilirë dhe si pasardhës të Aleksandrit të Madh, ata në radhë të parë duhet që:

1 .- të deklarohen botërisht se maqedonasit e sotëm nuk janë bullgarë dhe që nuk janë sllavë;

2. - ta pranojnë botërisht se janë maqedonë antikë, të asimiluar e të sllavizuar;

3. - të vendosin botërisht, ligjërisht e solemnisht se do të heqin dorë nga asimilimi dhe sllavizimi;

4. - që në rrugë institucionale e shtetërore t'i kthehen etnisë e kombësisë së vjetër, maqedonëve antikë pellazgo-ilirë;

5 .- që përmes ligjeve e kushtetutës ta shpallin gjuhën shqipe (si pasardhëse direkte e ilirishtes së maqedonëve antikë)

si gjuhë amtare të sllavomaqedonasve të sotëm dhe si gjuhë zyrtare të Republikës së Maqedonisë;

6. - që Kuvendi dhe Qeveria e Shkupit zyrtarisht të vendosin që gjuha shqipe të mësohet si gjuhë e parë nëpër çerdhet, kopshtet, parashkollore dhe të gjitha shkollat fillore, të mesme e deri në universitete me qëllim që përmes kthimit në gjuhën amtare të maqedonëve antikë ilirë, maqedonasitt e sotëm të sllavizuar, të rikthehen në etninë e parë, në etninë dhe përkatësinë kombëtare të paraardhësve të tyre, në etninë e vet origjinale pellazgo-iliro-shqiptare;

- Vetëm në këtë mënyrë sllavomaqedonasitt e sotëm do t'i kthehen rrënjës së vet, etnisë së vet dhe historisë së vet, Maqedonisë antike ilire.

- Vetëm përmes mësimit të gjuhës shqipe ata do të kthehen në etninë historike iliro-maqedono-shqiptare të Aleksandrit të Madh.

- Vetëm në këtë mënyrë sllavomaqedonët e sotëm do të kenë të drejtë historike, etnike, gjuhësore, gjenetike, ligjore e morale që të deklarohen se janë pasardhës e trashëgimtarë (së bashku me shqiptarët) të Maqedonisë antike të Lekës së Madh.

- Vetëm në këtë mënyrë sllavomaqedonasitt e sotëm do të ktheheshin në gjirin e kombit shqiptar, nga i cili u shkëputën përmes asimilimit të dhunshëm e të përgjakshëm nga sllavobullgarët.

- Vetëm në këtë mënyrë Republika e sotme e Maqedonisë, si një e treta (1/3) e Maqedonisë antike të Aleksandrit të Madh, do të përbëhej nga një komb: Shqiptarët maqedonas apo maqedonasit shqiptarë të ndarë në dy religjione: të krishterë e myuslimanë.

- Vetëm në këtë mënyrë shqiptarët myslimanë dhe shqiptarët ortodoksë apo maqedonasit myslimanë dhe maqedonasit ortodoksë të Republikës së Maqedonisë do t'i bashkonin zemrat, mendjet dhe forcat për ringjalljen dhe ribashkimin e trojeve etnike të Maqedonisë antike pellazgo-ilire të Aleksandrit të Madh, Lekës.

***

Historiografia dhe arkeologjia, etimologjia dhe linguistika shqiptare, ballkanike, evropiane dhe botërore e kanë vërtetuar shkencërisht se Maqedonia antike, maqedonët antikë dhe Aleksandri i Madh i tyre kanë qenë dhe janë pellazgo-ilirë, pra janë shqiptarë.

Si rezultat i kësaj të vërtete historike, shkencore e realiste, sllavomaqedonasitt e sotëm nuk mund të jenë edhe sllavë(bullgarë) e maqedonë, pasardhës të Lekës së Madh, sepse Aleksandri i Madh i Maqedonisë antike nuk ka qenë sllav, por ka qenë pellazgo-ilir, respektivisht shqiptar. Sllavomaqedonasit e sotëm nuk mund të jenë sllavë edhe shqiptarë dyfish, por njërën nga këto etni. Ata vetëm duke qenë shqiptarë mund të pretendojnë se janë pasardhës të maqedonëve antikë e të Lekës së Madh. Rrugë të mesme për ta nuk ka: ose shqiptarë e me Aleksandrin, ose sllavë e kundër Aleksandrit.

Nëse sllavomaqedonasitt e sotëm vërtet e ndjejnë veten sllavë të Jugut dhe duan të mbeten të tillë (dhe kjo është e drejtë legjitime e tyre), atëherë ata duhet të heqin dorë një orë e më parë nga përvetësimi antihistorik, antiligjor, antimoral e antishkencor i Maqedonisë antike pellazgo-iliro-shqiptare dhe nga mbreti i saj i pamposhtur e legjendar, iliroshqiptari Aleksandri i Madh.

Nëse sllavomaqedonasit e sotëm e konsiderojnë veten intimisht, sinqerisht e shpirtërisht se janë pasardhës të maqedonëve të Maqedonisë antike dhe pasardhës të Aleksandrit të Madh, duhet patjetër që t'i rikthehen gjuhës dhe etnisë së tyre fillestare pellazgo-ilire. Kjo arrihet vetëm duke mësuar e pranuar si gjuhë amtare gjuhën shqipe, sepse shqipja është sot e vetmja gjuhë pasardhëse dhe trashëgimtare e gjuhës pellazgo-ilire të maqedonëve të Aleksandrit të Madh, të cilët ishin njëri nga fiset e mëdha të Pellazgjisë dhe të Ilirisë, sikurse që ishin epirotët, trakët, dardanët, taulantët, molosët, liburnët, albanët, ardianët, paionët, dasaretët, lynkeastët, pirustët, labeatët, triballët…, etj. Pra, ishin vëllezër gjenetikë dhe etnikë të tyre.

***

Duke mbetur me kokëfortësi e mendjelehtësi si sllavomaqedonas, gjegjësisht si bullgarosllavë, maqedonasit e sotëm në fund do të mbesin pa etni, pa kombësi, pa histori, pa rrënjë e themel, pa ardhmëri, sepse ata e kanë e do ta kenë të pamundur që të krijojnë një komb nga asgjëja, nga hiçi, që të krijojnë një "komb maqedonas" hibrid e artificial, duke e shartuar sllavizmin bullgar të tyre me ilirizmin shqiptar të maqedonëve të Aleksandrit të Madh dhe të krijojnë një "komb sllavomaqedonas", pra një "komb sllavoshqiptar" ose "bullgaroshqiptar".

Kjo tentativë është qesharake dhe e turpshme, denigruese dhe nënçmuese për vet sllavomaqedonasit e sotëm, të cilët bëhen joseriozë e naivë para syve e veshëve të botës moderrne të shekullit XXI, me pretendime të këtilla antihistorike dhe antishkencore, është përpjekje thjesht e paarritshme. Nuk bashkohet uji e zjarri, nuk ngjizet dot sllavizmi me ilirizmin, nuk bashkohet dot bullgarizmi me shqiptarizmin. Kjo është e panatyrshme dhe e pamundur.

Ata që sot e quajnë veten Sllavomaqedonas ose edhe më keq, vetëm "maqedonas", janë ose sllavobullgarë ose shqiptarë të asimiluar e të sllavizuar ndër shekuj e mijëvjeçarë. Ndaj, është në vullnetin e tyre që të përcaktohen, që të zgjedhin se çfarë janë dhe cilës etnie i takojnë. Rrugë të tretë për ta nuk ka. Nuk krijohen kombet brenda natës, as brenda dekadash dhe as përmes dekreteve politike, falsifikimeve të historisë dhe as përmes vjedhjeve e përvehtësimeve të tapive të popujve tjerë.

Tapia e Ilirikut u takon ilirëve, shqiptarëve të sotëm

Sllavomaqedonasit e sotëm të Republikës së Maqedonisë të Shkupit janë të thirrur t'u kthehen rrënjëve të tyre etnike, themelit të parë iliro-shqiptar të Maqedonisë antike të Lekës së

Madh. Republika e sotme e Maqedonisë nuk mund të ndërtohet pa themele, pa tapinë e saj iliro-shqiptare, si shtet sllav në trojet shqiptare. Maqedonia e djeshme dhe e sotme ka themele e tapi iliro-shqiptare, sepse është e ndërtuar në trojet e Maqedonisë antike pellazgo-ilire të iliro-maqedonit Aleksandri i Madh.

Është në nderin dhe krenarinë e sllavomaqedonasve të sotëm që t'i kthehen gjuhës e gjakut, kulturës dhe etnisë së tyre të pare, etnisë iliro-shqiptare të maqedonëve antikë të Aleksandrit të Madh. Nuk është as turp e dobësi që sllavomaqedonasit të përqafojnë përsëri gjuhën dhe etninë e të parëve të tyre, gjuhën ilire (shqipe) dhe kombësinë ilire (shqiptare). Përkundrazi, është mençuri e vizion i të tashmes dhe të ardhmes së tyre. Ata e kanë në dorë edhe arrën edhe gurin për këtë çështje. Zgjedhja dhe vendimi është i tyre, kurse historia do të jetë gjykatësja e rreptë, e paanshme, e drejtë dhe e pagabueshme.

2.Leka i Madh ka luftuar kundër grekëve

Historiografia greke e hershme po edhe e tashme, sidomos pas çlirimit të Greqisë nga shqiptarët më 1821 dhe pas formulimit të projektit famëkeq antishqiptar të "Megali idhesë" më 1844 me autor Joanis Kolettis, ka botuar mijëra libra, revista dhe gazeta për t'ia imponuar opinionit ballkanik dhe atij europian se shqiptarët nuk janë vazhdues të linjës pellazgo-ilire, se kapedanët ushtarakë të lashtësisë janë grekë dhe jo shqiptarë, se kudo që ka sinjale të kishës greke, pak histori greke dhe ndonjë varr grek, aty është tokë greke. Haptazi duke mohuar ose shtrembëruar faktet historike, kohët e fundit, kur aerodromit të Shkupit iu vu emri i Aleksandrit të Madh, "megafonët" grekofonë e grekofilë ngritën zërin në kupën e qiellit, se Aleksandri i Madh është grek.

Urtësia popullore thotë: ***"Po të mos kishte gënjeshtra, shumë kredi e shumë myshterinj, askush nuk do të gënjente"***. Grekët në gënjeshtrat e tyre kanë pasur myshterinj jo vetëm në hapsirën ballkanike, por dhe atë evropiane. Më e çuditshme

është se këto gënjeshtra gëlltiten nga politikanë e intelektualë shqiptarë, pse jo dhe nga një pjesë e komunitetit shqiptar.

Çmenduria greke, historianë apo politikanë që sipas kushtetutës së tyre janë një me kishën ortodokse, ka arritur të kundërshtojë jo vetëm studiues ndërkombëtarë të lashtësisë, por dhe të kohës moderne se gjithçka shqiptare që nga lashtësia nuk është gjë tjetër veçse greke. Për këtë çmenduri të shovenizmit grekomadh Kryeministri i Greqisë, Kostandin Karamanlis (me origjinë arvanitase) është shprehur: ***"Greqia është një azil i madh të çmendurish".***

Grekët vazhdojnë përpjekjen për përvetësimin e figurave historike e kombëtare iliro-shqiptare, si Aleksandrin e Madh të Maqedonisë, Pirron e Epirit, Skënderbeun e Arbërisë...etj. Ata nuk kanë turp t'u mësojnë në shkollat e tyre nxënësve se kufiri verior i Greqisë është në lumin Shkumbin, se Tirana është qytet grek, se në jug të Shqipërisë banojnë grekë që paskan harruar greqishten(!), se gjuha shqipe nuk është gjuhë e Zotit(!)... etj.

***

Historia njeh si fakt të pakundërshtueshëm se Olimpia, princesha e Epirit, ishte nëna e Aleksandrit të Madh. Vëllai i Olimpisë ishte Aleksandri i Epirit, Princi i Epirit dhe daja i Aleksandrit të Madh. Bie në sy emri i njëjtë i Aleksandrit të Epirit me Aleksandrin e Maqedonisë. Leka i Madh Pirron e Epirit e kishte kushëri të parë, djalë të dajës, kurse Pirro Epiroti Lekën e kishte kushëri të parë nga halla e tij, Olimpia, nëna e Lekës.

Historia pranon si të vërtetë se Aleksandri ishte i biri i mbretit Filip II të Maqedonisë, edhe pse ka historianë dhe legjenda që thonë se, Aleksandri nuk ishte i biri i Filipit, por i biri i Zeusit, i cili flejti me nënën e Aleksandrit, Olimpinë, për të sjellë në jetë Aleksandrin. Kjo ka hapur një debat të madh në radhët e historianëve në lidhje me natyrën e Aleksandrit: ishte ai një njeri si gjithë të tjerët, ishte gjysmëhyjni ose ishte hyjni? Të mos keqkuptohemi, sepse nuk është këtu fjala për të qenit e Lekës Zot(Perëndi)Allah, por një profet(pejgamber), një diçka si Krishti

apo Muhamedi, edhe pse ai nuk ka bërë predikime filozofiko-fetare, por ekspedita ushtarake dhe reforma politike, ekonomike e ligjore. Suksesi i tij i jashtëzakonshëm dhe i paarritshëm në një moshë aq të re, zgjuarësia dhe pathyeshmëria e tij në beteja u jep më shumë vërtetësi pretendimeve të hyjnizimit të Aleksandrit. Aleksandri i Madh është vigani më i madh i historisë së njerëzimit, që edhe pas plot 24 shekujsh, arrin të pushtojë imagjinatën e njerëzve të vegjël apo të mëdhenj, të fëmijëve që dëgjojnë historitë dhe legjendat rreth tij ose strategë ushtarakë që çdo sukses të tyre e krahasojnë me suksesin e Aleksandrit të Madh.

Dorëshkrimet historike mbi jetën e Aleksandrit nuk janë të plota, pasi "Biblioteka e Aleksandrit" në Aleksandri të Egjiptit të sotëm, u dogj nga legjionet romake të Jul Cezarit në vitin 49 para erës sonë. Në atë bibliotekë ruheshin mijëra dorëshkrime të historisë së hershme të njerëzimit dhe humbja e tyre ishte humbje e kujtesës kolektive historike njerëzore. Kur faktet historike nuk janë të plota, u hapet drita jeshile spekullimeve historike nga historianë, popuj ose njerëz të thjeshtë. Të dallosh faktet historike nga fluskat e imagjinatës njerëzore, nuk është një punë e lehtë.

Mbi stërgjyshët e Lekës nga i ati kemi dy gojëdhëna, të cilat na thonë se zbresin prej derës mbretërore të Erakli Timenit, të ardhur në Maqedoni prej Argës së Thesalisë në shek. IX p. e. s. Njëra nga ato gojëdhëna, të cilën na e jep së pari Teopomp Kiotasi, si edhe Plutarku, na thotë që Karani, vëllai i mbretit Fito të Argës së Thesalisë ka ardhur në Maqedoni (më 815 apo 884 p. e. s.) dhe pushtoi Edeshën(Vodenën e sotme) dhe u bë mbret i Maqedonisë. Sipas një gojëdhënë tjetër, që na e jep Herodoti, thuhet se tre vëllezër, stërnipër të mbretit Timen: Gavani, Eropi dhe Perdika, shkuan prej Argës në Shqipëri të Sipërme (në Illiri) dhe që andej zbritën në Maqedoni të Sipërme. Njëri nga ata, Perdika, u bë mbret i Maqedonisë.

Stërgjyshërit e Aleksandrit të Madh nga e ëma Olimbi, e cila del stërmbesë e trimit Akil-Aqiles-Aqileht, luftëtarit të Trojës. Olimbia ishte bija e mbretit Neoptolem të Molosisë, i cili

rridhte prej fisit të shquar të Pirro Neoptolemit, të birit të Akilit (Aqilehtit), mbretit të mirëmidonëve, që ka jetuar dhe luftuar në shek. XIII p. e. s. Për Pirro Neoptolemin mitologjia na thotë se, pasi vrau mbretin Priam të Trojës, shkoi në Epir (Molosi-Tesproti-Çamëri-Toskëri) dhe themeloi mbretërinë e Epirit. Pirro Neoptolemi, pra, është stërgjyshi i trimit tonë kombëtar, Pirro Epirotit ose Pirro Burrit të shek. III p. e. s.

Si i ati Filipi II, ashtu edhe Aleksandri, nuk i kanë simpatizuar dhe besuar grekët. Për këtë flet edhe përbërja e ushtrisë maqedone gjatë ekspeditës së saj në Azi. Nga të tridhjetë e pesë mijët luftëtarët e ushtrisë së Lekës, vetëm gjashtëqind ishin grekë. Të tjerët ishin maqedonë, ilirë, trakë, triballë e të tjerë bashkëkombës të tyre. Në të njëjtën kohë në ushtrinë persiane të mbretit Dar të Persisë marrin pjesë me dhjetëramijëra luftëtarë grekë të dërguar nga ana e qytet-shteteve greke në luftë kundër ushtrisë së Lekës.

XII. KOMBI SHQIPTAR, THEMELI I KOMBEVE EVRO-AZIATIKE

Shqiptarët janë një komb etnik evropian që ka banuar këto troje që në kohët parahistorike dhe kjo dëshmohet nga të dhënat historike, gjuhësore, arkeologjike e antropologjike. Shqiptarët quhen nga të huajt si ~ alban dhe këtë emër duket se ata e lidhin me fisin e albanëve që përmend gjeografi Ptoleme në shek. II. Shqiptarët e kanë quajtur veten e tyre ~ arbën, pra që është e njëjta fjalë me ~ Alban dhe do të thotë se ata e kanë mbajtur veten e tyre për ~ alban. Kështu, është një emër i lidhur me etninë shqiptare. Fjalët ~ alban, ~ arban dhe ~arian kanë të njëjtin kuptim, **i bardhë**. Pra, shqiptarët ruajnë në emrin e tyre simbolin e racës së bardhë. Shqiptarët e quajnë veten e tyre gjithashtu me emrin shqiponjë, ashtu si dhe gjuhën e tyre. Shqiponja është simboli më i vjetër i arianizmit, e cila ruhet sot në emërtimin tjetër, me të cilin e quajnë veten e tyre shqiptarët. Shqiponja lidhet me Zeusin që kishte simbol shqiponjën dhe

shqiptarët duhet ta kenë quajtur veten bijë të shqiponjës qysh në kohë të hershme. Shqiponja është simbol që është përdorur nga stërgjyshërit e shqiptarëve, si nga Aleksandri i Madh, Pirroja që e quante veten shqiponjë. Perandorët nga Dardania e Ilirisë dhe, pikërisht Konstandini i Madh, e vendosin shqiponjën si simbol në Perandorinë Romake. Ky simbol mbeti dhe në Bizant, ku perandorët e fundit arbëreshë të Bizantit luftonin nën këtë flamur. Flamuri, që u bë simboli i Bizantit, mbeti dhe si simbol i fesë së Lindjes, asaj ortodokse. Kastriotët e patën si flamur të tyre, dhe sot është flamuri kombëtar i shqiptarëve. Flamuri i shqiptarëve pa frikë mund të thuhet që është më i vjetri në botë. Shqiptarët flasin një gjuhë të veçantë dhe të vjetër, e cila gjendet në të gjitha gjuhët e Evropës, të vjetrat e të rejat.

Pse pikërisht shqipja gjendet në të gjitha gjuhët e Evropës?

Shqipja është nëna që ka folur e gjithë Evropa parahistorike dhe antike. Ngaqë shqiptarët flasin gjuhën e vjetër të ilirëve, e cila u ruajt për shkak të maleve dhe karakterit kokfortë të shqiptarit, ajo është e vetmja gjuhë ndoshta në të gjithë Evropën që nuk u prek dhe nuk u ndikua nga gjuhët e tjera. Shqiptarët kanë kaq shekuj që jetojnë në kufij me sllavët, por shqipja nuk ka huazuar nga sllavët dhe këto huazime janë tepër të rralla. Shqipja është gjuha e maleve, ndaj dhe u ruajt në këtë formë të shkëlqyer që është sot. Duke qënë gjuha e substraktit evropian panpellazgo-ilir të bronzit, ajo ishte gjuhë, nga e cila lindën gjuhët e kombeve evropiane. Është gjuhë që lindi gjuhët latine dhe gjermanike. Shqiptarët arritën t'i sjellin Evropës sot një thesar të vërtetë arkeologjik, i cili në ndryshe nga objektet memece, ka një favor të madh, sepse flitet. Shqipja është vlera më e lartë kulturore që kanë krijuar shqiptarët përkrah vlerave të tjera dhe, pa diskutim është edhe një nga vlerat më të mëdha filologjike të qytetërimit evropian dhe atij botëror. Shqiptarët për nga gjuha dhe gjaku janë pasardhës të këtyre popujve dhe janë të vetmit sot në Evropë që ruajnë atë gjuhë arkaike.

Së këndejmi, shqiptarët sot :

Janë ilirë, pasi jetojnë dhe e ruajtën truallin ku u shtri shteti i ilirëve; **Janë epirotë,** pasi ata zënë një pjesë të konsiderueshme

të etnicitetit aktual shqiptar. Territori i shtetit të sotëm shqiptar shtrihet në pjesën më të madhe të tij mbi territorin e shtetit të Epirit; **Janë maqedonë**, pasi shqiptarët e sotëm banojnë një pjesë të madhe të Maqedonisë antike. Madje, po të mos i kishte shpërngulur Greqia me forcë nga Maqedonia jugperëndimore (Follorinë, Kozan, Kastoria, Grevena etj.) shqiptarët sot do të banonin pjesën më të madhe të saj.

Janë dardanë, pasi dardanët sot përbëjnë sërisht një pjesë të konsiderueshme të etnisë shqiptare.

Janë trojanë, pasi dardanët e Ilirisë ishin ata që themeluan Trojën.

Janë pellazgë, pasi epirotët dhe maqedonët janë quajtur pellazgë dhe sot quhen shqiptar.

Janë romakë, pasi vet Roma u themelua nga këta dardanë dhe nga fiset ilire të Italisë.

Janë panonas, pasi maqedonët ndryshe quheshin edhe panonas. Panonasit janë quajtur si fis ilir.

Janë myse, pasi mysët ishin iliro-trakë dhe fusha më e madhe në Shqipëri sot mban emrin e mysëve dhe quhet ~ Myzeqe. Shqiptarët janë edhe **trakë, dakë, skithë, saramantë e baltë**, pasi këta popuj ishin të një origjine me ilirët.

Shqiptarët janë pasardhës të qytetërimit të parë kreto-mikenas dhe qytetërimit antik i quajtur si greko-romak. Ata janë farefis me racën latine, gjermanike, angleze, pasi dhe kjo racë rrjedh nga substrakti ilir i Evropës së bronzit dhe dyndjet gjermanike janë dyndje ilirike. Të dhënat historike dëshmojnë për një autoktoni dhe vazhdimësi të shqiptarëve në këto territore. Gjuha e shqiptarëve me dy dialekte të mëdha dhe tepër të pasura e të larmishme dhe disa nëndialekte, e cila sot gjendet në të gjitha gjuhët e Evropës, dëshmon se ata janë pasardhësit e vetëm nga ana gjuhësore e këtij substrakti ilirik. E them nga ana gjuhësore, pasi nga ana e gjenit kombet gjermanike janë ilire të pastra dhe një racë e vjetër evropiane.

Heberland pohon se në Shqipëri gjenden të gjitha kostumet që ndodhen në Ballkan. Në fakt Shqipëria ka 220 kostume popullore, një numër rekord nga i cili kanë marrë të gjithë

fqinjët. Ai e shtrin këtë ndikim kostumesh nga Azia e Vogël, Europa Qendrore, Ballkani italik, pikërisht aty ku ka qënë dhe shtrirja më e madhe dhe më e fortë e racës pellazgo-ilire. Nga kostumet, xhubleta e veriut është si kostumet e etruskëve dhe kretasve. Veshja e burrave të veriut gjendet edhe tek fise gjermanike, kurse veshja me fustanella gjendet në Skoci dhe Gali. Qeleshja shqiptare del te frigët dhe te hiperborealët.

Panajot Kupitori në veprën e tij "Studime shqiptare" thotë se "**Historianët e Bizantit të shekujve XIV, XV, XVI shqiptarët i quanin arvanit, alvanus, ilirus, trivalus, skithas, mysë, kroat, polanius dhe saramantes".**

***

Populli pellazgo-ilir ka qënë populli më i rëndësishëm i antikitetit dhe nga ai rrjedhin qytetërimet, kombet, gjuha dhe kultura e lashtë evropiane dhe ajo moderne. Këto dëshmohen nga të dhënat historike, arkeologjike, gjuhësore dhe antropologjike.

1. Qytetërimet e vjetra evropiane, si ai i Kretës, Mikenës, Trojës dhe Etruskisë kanë qënë vepër e popullit pellazgo-ilir, ngase kjo dëshmohet prej të dhënave historike që tregojnë se kjo etni ka ngritur këto qytetërime. Edhe të dhënat antropologjike dëshmojnë se popullsia e vjetër e këtyre qytetërimeve ka qënë Brachycephala, ashtu siç janë shqiptarët sot pasardhësit e popullsisë pellazgo-iliro-trako-dako-trojano-skite e më gjërë. Por, qytetërimi i bronzit dhe i hekurit i Evropës është qytetërim pellazgo-ilir. Nëse do u referohemi të dhënave të tjera nga kjo etni, duket se janë themeluar edhe shtetet e vjetra, si Egjypti dhe shtetet e Mesopotamisë, duke filluar me qytetërimin sumer. Kjo dëshmohet nga të dhënat historike që tregojnë për një prezencë të kësaj race në këto territore që në kohë të hershme. ë dhënat antropologjike dëshmojnë se në deltën e Nilit dhe tek Sumerët tre mij vjet para Krishtit, ka banuar një popullsi e bardhë. Të dhënat e mëpasme historike tregojnë se kjo popullsi ka qënë me origjinë pellazgo-ilire. Madje edhe dyndet e popujve të detit janë dyndjet e kësaj popullsie drejt këtyre territoreve në shekullin e

XIII p.k. pasi aty dalin dardanët, lidët etj. që ishin fise pellazgo-ilire.

2. Grekët antik nuk janë etni, por ata janë thjesht fiset pellazgo-ilire që kishin nivel kulturor më të lartë se fiset e tjera të këtij trungu falë pozitës gjeografike dhe kushteve natyrore. Ai që quhet qytetërim antik grek, është qytetërim pellazg, pasi të tre popujt që kanë banuar Heladën antike, ishin me origjinë pellazge. Kështu, **jonët** ishin pellazgë, **dorët** ishin ilirë dhe **eolët** pellazgë. Atëherë ku janë grekët?

Nuk ka dhe nuk ka ekzistuar kurrë kombi grek. Gjuha e vjetër greke është një gjuhë e stisur për t'u përdorur nga të diturit e kohës. Si mund të dal në këtë konkluzion? Është e lehtë, sepse ajo gjuhë e vjetër greke nuk përkthen asnjë fjalë të jonishtes, dorishtes dhe eolishtes. Shkrimet e tyre edhe sot janë në gur dhe nuk flasin, askush nuk e di se çfarë gjuhe kanë përdorur, por një gjë është e sigurt se ajo është një gjuhë e ndryshme nga gjuha greke e vjetër dhe e re. Pse greqishtja nuk përkthen këto gjuhë? Ajo nuk ka se si t'i përkthejë, kur popullsia ishte e gjithë pellazgo-ilire dhe fliste këtë gjuhë që sot gjendet tek shqiptarët. Mirë do bënin studiuesit që të merrnin shqipen e sotme, sidomos gegërishten dhe t'i futen punës të përkthejnë shkrimet antike. Fakti që në kohët moderne në Greqi nuk kishte popull grek, por shqiptar, tregon se asnjëherë nuk ka patur grek. Kombi modern grek është një komb artificial, i përbërë nga disa etni dhe që pjesën më të madhe e zënë shqiptarët, kanë një gjuhë artificiale që nuk është gjuha e tyre, por që kisha dhe shteti vendosi të kishte. Kjo gjuhë u pastrua, rregullua dhe iu imponua popullit, duke ia vendosur si gjuhë të detyrueshme. Kështu u krijua një etni artificiale ashtu, siç është edhe sot. Edhe qytetërimi antik romak ishte pellazgo-ilir, pasi Italinë në antikitet e kanë banuar këto fise nga jugu në veri. Romakët e mbanin veten e tyre si pasardhës të dardanëve të Trojës, por dardanët e Trojës janë ata të Ilirisë, që sot ende jetojnë në territorin e tyre dhe quhen shqiptarë. Qytetërimi romak rrodhi nga ai etrusk apo tusk, që ishte gjithashtu një qytetërim pellazg. Disa studiues

kanë arritur që me shqipen e sotme të përkthejnë shumë shkrime etruske.

3. Evropa e kohës së bronzit ka pasur një popullsi të njëjtë nga ana etnike që ka pas folur të njëjtën gjuhë apo dhe dialektet e saj. Të dhënat tregojnë se: **pellazgët, ilirët, trakët, dakët, skitët, saramantët, trojanët** deri në Atlantik kanë qenë popuj të një etnie. Sipas të dhënave, ata kanë folur një gjuhë të përbashkët, e cila ka qënë **shqipja arkaike**. Ka qenë kjo gjuhë, sepse gjendet në të gjitha gjuhët antike dhe moderne evropiane dhe iu jep kuptimin fjalëve të këtyre gjuhëve. Shumë fjalë të gjuhës së vjetër latine dhe fjalë që kanë përdorur pellazgët e quajtur si helenë, janë shqipe, madje shqipja i përdor edhe sot. Këto fjalë nuk janë të huazuara, pasi në shqip ato kanë kuptimin e asaj që duan të shprehin. Megjithëse gjuha latine dhe ajo greke e vjetër duket se janë gjuhë të krijuara, ato sërish kanë shumë fjalë shqipe brenda tyre. Populli që është quajtur me emrin romak ose helen ka qenë një popullsi ilire që ka folur këtë gjuhë, pasi të dy gjuhët(latinishtja dhe greqishtja) nuk përkthejnë gjuhën që ka shkruar dhe ka folur populli i tyre. Shumë fjalë që kanë mbërritur nga kjo gjuhë e që i kanë folur pellazgët helenë dhe romakë, janë sot tek shqipja dhe marrin kuptim nga ajo. Nga ana tjetër, shqipja përkthen edhe gjuhën e dakëve dhe është e vetmja që u jep kuptim fjalëve të tyre, sepse ajo i ka edhe sot këto fjalë në fondin e saj të gjuhës së përditshme. Straboni dëshmon se dakët kanë patur të njëjtën gjuhë me trakët, skitët, që do të thotë se dhe këta fise kanë folur një gjuhë shqipe, për aq kohë sa shqipja është e vetmja që përkthen gjuhën dake. Trojanët kanë pas folur një gjuhë shqipe, pasi shumë nga fiset trojane janë me origjinë nga Trakia dhe Iliria, ashtu si dardanët që përbëjnë sot një pjesë të konsiderueshme të kombit shqiptar.

4. Në shekujt V-VI kur fuqia e Romës ra, të shtyrë nga dyndjet e popullsive me origjinë Aziatike një pjesë e popullsisë etnike evropiane u detyrua të emigrojë nga territoret e Ilirisë dhe Detit të Zi në drejtim të perëndimit që njihen dhe si dyndje gjermanike. Të dhënat mesjetare tregojnë se këto fise ishin me

origjinë Ilire. Ato ndikuan shumë në krijimin e kombeve moderne gjermane, angleze, franceze etj.

Faktet antropologjike, historike dhe ato arkeologjike dëshmojnë një gjë të tillë. Shqipja luan sot një rol shumë të madh në shpjegimin e kuptimit të fjalëve që këto gjuhë flasin aktualisht. Shpjegimi i fjalëve "të mëdhaja", që kanë përdorim ndërkombëtar, tregon se ato janë formuar nga dy fjalë të shqipes që ajo sot i ka operatorë të lirë, pasi janë fjalë rrokore. Për shumë fjalë të tyre kuptimin e vërtet e ruan gjuha shqipe. Gjetja e shqipes si gjuhë shpjeguese në këto gjuhë tregon se ato kanë lindur nga një gjuhë e përbashkët e racës së bardhë ose, siç quhet ndryshe, japetike, të cilën gjuhë sot e ruan shqipja, për shkak të kushteve gjeografike, historike dhe karakterit të shqiptarit.

5. Teoria e gjuhëve indo-evropiane është një teori që duhet rishikuar, ngase ajo është ngritur pa studiuar gjuhën shqipe, gjuhë që kanë folur edhe popujt të vjetër evropian dhe shumë e quajnë gjuhën e racës së bardhë, asaj japetike. Nuk mund të nxirren teori të tilla pa studiuar gjuhën substrakt të Evropës, shqipen me gjithë dialektet e saj të pasura. E them këtë kur vërej se fondi i fjalëve të përbashkëta midis gjuhëve evropiane dhe sanskritishtes gjendet i gjithë te shqipja. Madje, shqipja këto fjalë i ka dhe sot në gjuhën e saj të përditshme dhe këto fjalë marrin shpjegimin vetëm nga kjo gjuhë. Gjuhëtar i mirë është ai që është së pari një historian i mirë, pasi nuk mund të përcaktosh një gjuhë në disa kategori pa parë se si kanë qënë kushtet historike që kanë çuar në këtë përfundim.

Fjalët që sot gjenden te gjuha indiane dhe iraniane nuk janë fjalë që gjenden nga gjuhët evropiane me këto gjuhë, por gjenden midis shqipes dhe këtyre gjuhëve. Këto fjalë janë marrë nga shqipja, si te europianët, te aziatikët. Ky është edhe çelsi që tregon për gabimin e bërë deri më sot nga gjuhëtarët që kanë nxjerrë konkluzione pa studiuar shqipen dhe historinë. Historia dëshmon se në periudhën e bronzit këta territore janë pushtuar dhe sunduar nga një racë e bardhë. Kështu shumerët janë një popullsi jo-semite. Po të shikohet me vëmendje, ka një koincidencë midis fisit ilir të quajtur ~ medë me Medët.

Jordanes dëshmon se parthët janë myse, pra ilirë. Te ilirët ka gjithashtu edhe një fis të quajtur ~ parthë dhe nga këta duhet ta kenë origjinën dhe parthët. Nga ana tjetër, dëshmohet se skitët kanë patur nën pushtetin e tyre Azinë deri në Oqeanin Lindor, që duhet të bëhet fjalë për Paqësorin, ngaqë ai ndodhet në lindje. Madje, një popullsi indo-skite ka qenë prezente deri vonë në Indi dhe ka lënë gjurmët e saj atje edhe sot. Kjo popullsi ishte e një race me dakët dhe fliste një gjuhë me ta, pra një gjuhë shqipe. Duke qenë se skitët dhe parthët apo ndoshta dhe medët ishin popullsi që ka emigruar nga Evropa në Azi, del se ajo ka lënë edhe fjalët e saja te këto gjuhë.

Lidhjen e gjuhëve evropiane me gjuhët aziatike gjuhëtarët duhet ta shikojnë nëpërmjet shqipes. Shqipja është çelsi për të zbërthyer të vërtetën rreth këtyre gjuhëve. Shqiptarët sot janë komb parahistorik që jetojnë në trojet e tij në Ballkan prej mijëra vitesh. Paraardhësit e shqiptarëve i kanë dhënë Evropës qytetërimin etnik evropian, si atë parahistorik, ashtu atë antik që u bë baza e qytetërimit modern. Ata kanë luajtur rol të madh në formimin e kombeve moderne të Evropës dhe gjuhëve të tyre.

PËRMBLEDHJE

Në qarqet shkencore historiografike gjykimet rreth luftërave, synimeve, sjelljeve, veprimeve, ideve, ambicieve, karakterit dhe aftësive të Aleksandrit III i mbiquajtur dhe i njohur në histori si **Aleksandri i Madh,** janë shumë kontradiktore. Bota e vjetër e kohës së tij u step, u befasua nga vdekja e tij e hershme dhe e papritur. Menjëherë rreth tij e për të u ndezën mendime dhe pikëmamje të ndryshme për dhe kundër, të miqve dhe të armiqve të tij.

Blloku antimaqedonas në Athinë, që udhëhiqej nga Demosteni, ishte gjithmonë dhe për gjithçka kundër Aleksandrit të Madh. Grekët e Egjiptit nën udhëheqjen e Ptolemeut thanë fjalët më të mira për jetën dhe veprën e tij. Shkolla e Aristotelit, e

pakënaqur nga Leka për mënyrën se si e trajtoi Kalistenin (nip i Aristotelit), nuk ia kurseu kritikat. Kalorësit e rinj maqedonë e adhuronin atë dhe e njihnin si prijës të tyre, ndërsa shumë nga veteranët nuk ia kishin fort besën për shkak të simpative të tij orientale dhe lëshimeve që u bënte persianëve. Pjesa më e madhe e banorëve jonikë, si dhe të atyre të pellgut të detit Egje, panë te Leka çlirimtarin e tyre, kurse spartanët e urryen si armik deri në vdekje, ndërsa Orienti e shqiptoi emrin e tij me zë të përmbajtur…

Pas vdekjes së Aleksandrit të Madh u botuan shumë libra për të, në antikë e deri në ditën tona. Autorë kryesorë të këtyre librave janë: ***Ptolemeu i Pelës***, njëri nga gjeneralët e tij, që më vonë u bë mbret i Egjiptit. ***Aristobuli i Kazandrejës***, që edhe ai shërbeu nën urdhërat e tij. ***Kalisteni***, jetëshkruesi i tij zyrtar, i cili për një kohë ka qenë edhe anëtar në shtabin e Lekës. ***Eumeni i Kardias***, i cili shërbente sekretar dhe i mbante shkresat. ***Diodoti i Eritreas***, i cili i ndihmonte Eumenit në punët e tij. ***Hieronimi i Kardias***, njëri nga oficerët e Lekës së Madh. ***Haresi prej Mitileni***, tjetër oficer i tij. ***Kleitarku nga Aleksandria***, edhe ky një nga oficerët e Lekës. ***Onesikriti***, oficer marine, i cili mbajti timonin e anijes mbretërore gjatë lundrimit nëpër lumin Ind. ***Nearku***, admiral i flotës detare dhe njëri ndër miqtë më të afërt të Aleksandrit. ***Anaksimeni prej Lampsaku***, që shërbeu nën urdhërat e tij. ***Marsiasi nga Pela***, që mësoi bashkë në shkollë me Lekën. ***Dikaiarku nga Mesana***, nxënës i Aristotelit. Pastaj me rradhë: Efipi prej Olintit, Aristi nga Qiproja, Polikleiti prej Larise, Hegesiasi nga Magnezia, Timaiu nga Tauromeni, Pilarku nga Neukratisi, Satir inga Aleksandria, Hermipi nga Smirna, Duri prej Samit, Agataharkiti nga Aleksandria, Karisti prej Pergamit, Asklepiadi, Adrostheni, Medi dhe Hegesanderi.

Fatkeqësisht, është për t'u theksuar se të gjitha veprat e këtyre historianëve, zyrtarëve, jetëshkruesve dhe autorëve të drejtpërdrejtë të librave për Aleksandrin e Madh kanë humbur në errësirën e kohës, në rrjedhën e përgjakshme të shekujve dhe mijëvjeçarëve që pasuan pas jetës dhe vdekjes së Lekës së Madh.

Prej gjithë atyre autorëve dhe librave të tyre, i kanë shpëtuar kohës vetëm disa fragmentet ë veçanta.

Të gjitha këto vepra, që duket se e kanë paraqitur Aleksandrin e Madh në mënyra të ndryshme, si dhe shënimet e letrat e tij personale gjendeshin deri në fundin e shekillit të parë para erës sonë, si dhe gjatë shekullit të parë të erës sonë, kur u shtypën 4 studime të rëndësishme mbi jetën dhe veprat e Lekës së Madh. Të parin libër e shkroi ***Diodor Sikuli i Sicilisë***, një bashkëkohës i Jul Cezarit dhe Augustit. Të dytin libër e shkroi ***Trojan Pompeu***, i cili jetoi në kohën e Augustit. Të tretin studim e shkroi ***Kuint Kurt Rufi***, siç duket në gjysmën e parë të shekullit I, si dhe librin e katërt e shkroi ***Plutarku i Keronjës*** në Beoti, i cili mban datën e gjysmës së dytë të shekullit I.

Vepra e Plutarkut gjendet e tëra, kurse një pjesë e punimeve të Diodorit dhe të Rufit mungojnë. Edhe vepra e Pompeut gjendet në formë të përmbledhur në librat e njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë. Të Justinit, cili jetoi në shekullin II. Këto katër studime rreth jetës dhe veprës së Aleksandrit të Madh, të paraqitura nga këto autorë të ndryshëm, na shfaqin atë nga kënde vështrimi të ndryshme. Por, në gjysmën e parë të shekullit I pas erës sonë, ***Arriani i Nikodemisë*** në Bitini mori përsipër të shkruaj jetëshkrimin e Lekës së Madh, duke u mbështetur te Ptolemeu dhe Aristobuli, sepse i shikonte këta dy autorë si më të besueshëm se të tjerët.

Studiuesi modern gjendet përballë pesë autorëve: Diodorit, Rufit, Justinit, Plutarkut dhe Arrianit, të cilët do të mund t'i shfrytëzojë në punimet dhe studimet e tij. Përveç këtyre, gjenden edhe shumë të dhëna për Aleksandrin e Madh te Straboni, Aeliani, Pauzanias, Plini i Vjetër, Jozefi dhe Atheneu. Shënime të shpërndara gjejmë edhe tek Ciceroni, Seneka, Livi, Lukiani, Dion Krizostomi, Apiani, Frontini, Makrobi, Poluksi, Suidasi, Zosimusi dhe të tjerë. Po ashtu për Lekën e Madh janë ruajtur vepra në latinisht, arabisht, sirisht, koptisht dhe etiopisht, të cilat janë versione të këtyre veprave dhe jetëshkrimeve të autorëve të lashtë. Gjithashtu histori legjendare të mbështetura në to, që

vazhdojnë të jetojnë në arabisht, persisht, në turqisht dhe në gjuhë të tjera.

Në ballafaqim me këto gojëdhëna kontradiktore të lashtësisë, shkencëtari modern nuk ka asnjë pikëpamje të qëndrueshme mbi Aleksandrin. Disa e shikojnë atë si gjeni, madje edhe më tepër, si një qenie gati mbinjerëzore, i cili si një meteor shkrepi në qiellin e natës së historisë të mbushur me yje dhe çuditi botën. Të tjerët shikojnë te ai një bajraktar aventurier që u ngatërrua në vorbullën e ngjarjeve dhe vetëm fati e ngriti në lartësi vërtet qiellore, kurse të tjerë e mbajnë atë si një idealist që kaloi nga fitorja në fitore për të vërtetuar atë, i dukej si shpëtimi i vërtetë i njerëzimit.

Por pati edhe të tillë që e gjykuan shkakun e veprimeve të tij si egoizëm dhe ishin të mendimit se udhëheqja e tij ishte një pasion i papërmbajtur, i bazuar në një dëshirë për lavdi vetjake dhe për pushtet, e prapa të gjithave sa bëri, nuhasnin vetëm lëvizje shahu të një mendjeje të jashtëzakonshme.

Në kundërshtim me këtë, së fundi, edhe gjykuan se ai instiktivisht e me zemër të qetë ndoqi vetëm yllin e tij, sepse krenaria e tij e tepruar nuk e lejoi që të pranojë asnjëherë se bëri gabim. Në fakt, as paraqitja e shpeshtë e Aleksandrit përpara gjyqit të historisë nuk na ka dhënë një gjykim të njëjtë. Por në një gjë janë të gjithë të një mendjeje, qoftë për të mirë ose për të keq - ai ia ka ndërruar fytyrën botës, pasi kur vdiq, në duart e tij ishte grumbulluar një pushtet kaq i madh, saqë asnjë qenie njerëzore e lashtësisë nuk mund të mburrej më shumë dhe se asnjëherë në histori, me përjashtim të disa themeluesve të besimeve fetare, asnjë njeri tjetër nuk është parë përgjithësisht si një qenie mbinjerëzore.

Në përgjithësi, kur flitet për Lekën e Madh, qoftë nga historianët, ose edhe nga njohuritë e të cilëve e kanë burimin te librat shkollorë, kjo figurë karakterizohet thjesht si një komandant ushtarak shumë i madh dhe që nuk duhet diskutuar më për të. Pra, Aleksandri duhet të mbetet gjithnjë gjeniu i lartë ushtarak. Kleopatra gjithnjë dhe për të gjitha kohët, sirena e Nilit

të motshëm. Neroni duhet të mbetet si Antikrishti, ndërsa Ciceroni si një shembull ndriçues, gojëtar i shkëlqyer.

Është fakt se Leka i Madh që në lindje ishte mbajtur nga rrethi i tij si bir i hyjnisë pellazgo-egjiptiane Zeus-Amonit. Pikërisht në shekullin I pas vdekjes së tij ai u përjetësua në legjendë si qenie e ngjashme me perënditë. Në shumë pjesë të botës ai u adhurua si perëndi, madje deri sa edhe senati i Romës, i cili shkonte pas udhëheqjes më pak serioze të Athinës, e lartësoi dhe e cilësoi atë si perënditë e trembëdhjetë, pas 12 perëndive të Olompit. Në legjendat popullore hebraike Aleksandri i Madh u cilësua shërbëtori i Jehovës, paraardhësi i Mesias (J. Krishtit), zotërues i fronit të Solomonit, si dhe njëri nga sundimtarët e botës mistike sipas profecisë së Danielit. Për islamin ai ishte njëri nga heronjtë e fesë myslimane. Poashtu u vlerësua edhe në disa kisha katolike.

Kjo ngjau nga fakti se në natyrën e Lekës së Madh kishte momente të fuqishme misticizmi fetar dhe përshpirtmërie të vërtetë, sepse gjithmonë ai shikonte lart drejt perëndive me zemër të hapur. Ai që në rininë e hershme ishte ushtruar dhe edukuar në të gjitha ritet fetare dhe jetoi një atmosferë që ishte vendimtare për lartësinë që iu caktua pas vdekjes dhe për jetën e tij të mëtejshme në përfytyrimin e njerëzve si hyjni ose si i shenjtë.

Aleksandri i Madh nuk ishte vetëm trim, por shpesh edhe i irituar. Gjatë betejës kishte çaste kur ai nuk ishte në vete, kur ai ishte i ngacmuar, e pushtonte një guxim i krisur. Në çaste padurimi ai gjithnjë e rrezikonte ushtrinë e tij, si p. sh. marshimi nëpër shkretëtirën e Gedrozisë. Gjatë zemërimit ishte i tmerrshëm tej mase, e kur bëhej zemërbutë, ai kishte një bujari dhe një dorëgjerësi të tepruar. Kur dehej nga vera ose ekzaltohej nga lajkat e njerëzve që e rrethonin, ai bëhej mburravec i pafrenueshëm. Kur i zgjidhej gjuha, bëhej aq llafazan, saqë e gdhinte natën vetëm duke folur pandërprerë dhe, kur e kuptonte se dikujt i kishte bërë padrejtësi, kërkimfalja dhe përulësia e tij nuk njihte kufij. Një muzikë luftarake mund ta nxiste atë që të kërcente në këmbë me vrull si një fëmijë i shqetësuar, duke e

tundur heshtën e tij. Kur dikush e fyente, ai kapte ndonjë objekt tjetër që ia ziente dore dhe ia përplaste fyesit në kokë. Një lajm i mirë e bënte atë të fluturonte, kurse një i keq e bënte atë ta lëshonte zemra. Pa u menduar për asnjë çast ai mund të jepte urdhër që të vriteshin mijëra armiq, por mund të derdhte lot edhe për një njeri të vetëm.

Besimi i tij në praninë e hyjnive, në favor ose disfavor të ushtrisë maqedonase, ishte i palëkundshëm. Besimi te astrologët dhe magjistarët e tij ishte gati fëmijëor dhe bindja në prejardhjen e vet hyjnore ishte e rrënjosur thellë në mendjen e tij. Kjo bindje iu shtua me një siguri të pandryshueshme dhe ishte vendimtare për tërë zhvillimin e tij të brendshëm. Si një peshë të lëkundur e të rëndë e mbajti misionin e tij mbi shpatulla, atë mision që, siç besonte, ia kishte caktuar qielli, ndaj ai ndihej i detyruar të kryente një punë herkuliane. Punonte deri në sfilitje, kurse mendja dhe shpirti i tij nuk pushonin kurrë. Ambicia e tij ishte e pangopur dhe ai jetonte një gjendje mbingarkimi nervor të vazhdueshëm. Paraqiti lloj-lloj figursh, luajti lloj-lloj rolesh, pa e kuptuar as vet dhe vdiq pa mundur të tregojë personalitetin dhe pjekurinë e tij të vërtetë, të çliruar nga rrëmuja dhe dinamika e jetës dhe luftës së tij.

Kur u nis në fushatën e tij kundër Persisë, Leka i Madh e mbante veten herë si Akili, herë si Herakliti (Herkuli) dhe herë si Dionisi. Cilësitë e tij si komandant ushtarak ishin shumë më të mëdha, se sa aftësitë e tij taktike e ushtarake, por në qindra beteja ai ishte i papërsëritshëm dhe asnjë hero nuk rrëmbehej si ai në luftë. Ai i duronte shumë mundimet e plagët dhe fizikisht ishte aq i fuqishëm, sa që nuk kishte njeri e bishë të egër që mund t'i bënte ballë. Ishte njeri romantik e shumë sentimental. Faktikisht nga shumë pikëpamje ishte aq i jashtëzakonshëm dhe shtegu i jetës së tij aq i ndryshëm nga ai i njerëzve të tjerë, sa dukej gati përrallor. Personaliteti i tij njëkohësisht duket turbullues dhe tërheqës. Në hijeshinë e rinisë së tij Leka i Madh i ngjante Apolonit flokëartë dhe gjatë tërë jetës pamja e tij ishte e rrethuar nga një shkëlqim i çuditshëm madhërie.

Ishte dhe mbeti komandanti i komandantëve, luftëtari i luftëtarëve, trimi i trimave, burri i burrave, idealisti i idealistëve… Me të nuk mund të krahasohet asnjë luftëtarë, asnjë komandant, asnjë mbret, asnjë perandor… Leka i Madh është i papapërsëritshëm, i paarritshëm, më i madhi i të mëdhenjve gjatë gjithë historisë njerëzore, para dhe pas erës sonë. Vetëm Buda, Jezu Krishti dhe Muhamedi mund të krahasohen me personalitetin dhe veprën e tij vigane.

F U N D

FOTOGRAFI, SKICA, HARTA…

"Kryeperëndia" e pellazgëve - ZEUSI

AKILI – Mbreti i mirëmidonëve





Dielli i Vergjinës
– Simbol kombëtar i maqedonëve ilirië
dhe kulti i pellazgëve



Filipi II – Babai i Aleksandrit të Madh

Filipi II – Babai i Lekës së Madh

Princesa e Epirit,
Myrtali/Olimpia – Nëna e Lekës së Madh

Këmbësoria e Filipit II



Ushtria e Filipit II – Falanga maqedone

Maqedonia antike fillestare



Maqedonia e Filipit II

Maqedonia e zgjeruar e Filipit II



Rrënjët gjenetike të Lekës së Madh

LEKA I MADH - Arbër me plis të bardhë

Mirjamun - Lekë – Aleksandër



Aleksandri i Madh i Maqedonisë



Leka i Madh



LEKA - nxënës

LEKA - rinor



ALEKSANDRI - student

LEKA - burrëror

Leka i Madh – filozof

Aleksandri i urtë

LEKA – luftëtar

Aleksandri i Madh – Komandant suprem

Leka i Madh -"Dybrirëshi", në pllakë argjendi

Aleksandri i Madh në pllakë bronzi

Leka mbi kalin Bukefal (skulpturë)

Marshimi luftarak i Lekës së Madh

LEKA në sulm

Leka në dyluftim

Pamje nga mozaiku i Aleksandrit - Shtëpia e Faunit,
Pompei, viti 80 p. e. s.
Muzeu Kombëtar Arkeologjik, Napoli(Itali)

Skenë lufte nga sarkofagu i LEKËS

Mauzoleu i Aleksandrit

Leka i Madh - gjithmonë në këmbë

PTOLEMEU maqedon me plis të bardhë

PTOLEMEU
– Mbreti maqedon i Egjiptit, pas Lekës

SELEUKU
– mbreti maqedon në Azi, pas Lekës

Monedhë e prerë nga Ptolemeu me portret të Lekës,
me përkrenare të kokës së elefantit

Monedha me pamje të Aleksandrit të Madh

Leka i Madh në monedhën e Mbretërisë Shqiptare (1929-1939)

Beteja e Keronës



Rreshtimi i ushtrive në Betejën e Keronjës

Harta e Betejës së Granikut



Rreshtimi i forcave kundërshtare në Granik (Skicë)

Marshimi i ushtrisë maqedone në Gaugamelë

Dari III, në fushëbetejë kundër ushtrisë maqedone

DARI III – i tmerruar nga LEKA I MADH



Betejat e Aleksandrit të Madh dhe perandoria e tij

Harta e pushtimeve të Lekës së Madh



Perandoria e Lekës së Madh

Ekspedita në Azinë Jugore



Ekpedita e ushtrisë maqedone në Indi

Ndarja administrative e Perandorisë së Maqedonisë

Harta e ndarjes së Perandorisë së Maqedonisë

Pas vdekjes së Aleksandrit të Madh,
Perandoria e Maqedonisë u nda në 4 mbretëri:
1 Mbretëria e Ptolemeut i Soter,
2. Mbretëria e Kasandrit, 3. Mbretëria e Lisimakut,
4. Mbretëria e Seleukut i Nikator

Ndarja e perandorisë maqedonase pas Lekës



Vendndodhja e hundëzakëve

Shtrirja gjeografike e Pamirit



Popujt e Pamirit

BIBLIOGRAFIA /LITERATURA

1. BIBLA e Shenjtë
2. KUR'ANI i Madhërishëm
3. Historia e Popullit Shqiptar (Të gjitha botimet)
4. Studime Historike, Tiranë 1967
5. Zh.K. Faveirial: Historia (më e vjetër) e Shqipërisë, Tiranë, 2004
6. Giuseppe Catapano: Thoti-Tati fliste Shqip (Thot-Tat parlava Albanese), Tiranë 2007
7. Bengt Liljegren: Aleksandri i Madh, Falun 2005 (suedisht)
8. Georges Radet: Aleksandri i Madh, Tiranë 2008
9. Georges Castellan: Histori e Ballkanit, Tiranë 1996
10. Edëëin Jaques: Shqiptarët, Tiranë 1996
11. Otto Muck: Sekreti i Atlantisit, Stockholm 1983 (suedisht)
12. George Fred Ëilliams: Shqiptarët, Tiranë 2004
13. Robin Lane Fox: Bota e antikës, Stockholm 2008 (suedisht)
14. Robert D'Anzheli: Enigma, Tiranë 1998
15. Majkël Hart: 100 njerëzit më me ndikim në histori, Shkup 2000
16. Alf Henriksson: Histori të antikës, Stockholm 1959 (suedisht)
17. Antonello Biagini: Historia e Shqipërisë, Tiranë 2000
18. Martin Bernal: Athina e zezë, Stockholm 1997 (suedisht)
19. Ogyst Bajli: Historia e Bizantit, Tiranë 1995
20. Ernest Gombrik: Histori e Shkurtër e Botës, Tiranë 1999
21. E.Hoeschel: Ilirët dhe Iliria në autorët antikë, 1965
22. Homeri: Iliada, Tiranë 1979
23. Homeri: Odisea, Tiranë 1976
24. Aristoteli: Politika, Prishtinë 1978
25. Tukididi: Lufta e Peloponezit, Tiranë 1986
26. Plutarku: Jetë paralele, Tiranë 1980
27. Rufi: Supl.Libri II, 3.Ilirët
28. Lukiani: Vepra të Zgjedhura, Tiranë 1979
29. Diodori i Sicilisë: Bibliotheca Historica
30. Apollodori: Bibliotheca, Libri II
31. Plini Secondi: Natyralis Historia, Libri XXXIII

32. Zaharia Majani: Fundi i Misterit Etrusk, Tiranë 1973
33. Edith Durham: Brenga e Ballkanit, Tiranë 1991
34. Marin Barleti: Historia e Skënderbeut, Tiranë 1968
35. Marin Barleti: Rrethimi i Shkodrës
36. Jakov Mile: Rraca Shqiptare, Tiranë 1944
37. Eqrem Çabej: Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, Tiranë 1994
38. Eqrem Çabej: Studime Etimologjike në fushë të Shqipes, Vëllimi III
39. Aleks Buda: Shkrime Historike, Vol.I, Tiranë 1986
40. Aristidh Kola: Arvanitasit dhe prejardhja e grekërve, Tiranë 2002
41. Artur Vajgal: Aleksandri i Madh, botimi i Parë, Tiranë 1993, dhe Botimi i Dytë, Tiranë 2002
42. Aleksandar Stipçeviç: Ilirët, Prishtinë 1967
43. Aleksandar Stipçeviç: ILIRËT – Historia, Jeta, Kultura – Simbolet e Kultit, Botimi II, Prishtinë 1990
44. Mehdi Frashëri: Historia e Lashtë e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve, Tiranë 2000, 2012
45. Shaban Demiraj: Prejardhja e Shqiptarëve nën Dritën e Dëshmive të Gjuhës Shqipe, Tiranë 1999
46. Tajar Zavalani: Histori e Shqipërisë, Tiranë 1998
47. Sherif Delvina: E vërteta mbi Epirin, Tiranë 1999
48. Spiro N. Konda: Shqiptarët dhe problemi Pellazgjik, Tiranë 1964
49. Dhimitër Canco: EPIRI, Vështrim Historik dhe Etnografik, Tiranë 1999
50. Elena Kocaqi: Roli Pellazgo-Ilir në krijimin e kombeve dhe gjuhëve evropiane, Tiranë 2007
51. Fatbardha Demi: Nga Dodona në Tibet, Tiranë 2014
52. S.Pulaha: Luftat…, Burime osmane, 1968
53. Arsim Spahiu: Pellazgët dhe Ilirët në Greqinë e Vjetër
54. Irakli Koçollari: Arvanitët, Tiranë 1994
55. Blerim Çela: Shqiptarët ndër shekuj, Tiranë 2001
56. Sulejman Mato: Labirinthe – Enigma, Tiranë 2000
57. Akademia e Shkencave të Shqipërisë: Shqiptarët dhe Trojet

e tyre – Përmbledhje punimesh shkencore, historike, gjuhësore - Tiranë 1982
58. Enciklopedia Britanica
59. P.Grimal: Enciclopedia dei miti, 1990
60. Fjalori Enciklopedik, Tiranë 2002
61. Mala Enciklopedija, Prosveta, Beograd 1978
62. Enciklopediski Leksikon Geografije, Beograd 1969
63. Historia e Jugosllavisë Popullore, Zagreb 1953
64. Historia e Popullit Maqedonas, Shkup 1983
65. Instituti për Histori Kombëtare: Historia e Popullit Maqedonas, Vëllimi II, Shkup 2000
66. Instituti për Histori Kombëtare: Libri për Ilindenin, Shkup 1969
67. Prof. Kristo Frashëri: E vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimet e Enciklopedisë së Shkupit, Tiranë 2009
68. Lucia Nadin: "Statuti di Scutari", della prima metà del secolo XIV con le addizioni fino al 1469, giugno 2002, Roma. (Fragment)
69. Dr. Nebi Dervishi: E vërteta mbi Maqedoninë antike (Fragment), Strugë, 5 maj 200
70. Tomas Gazis: Aleksandri i Madh në Astrologji (Fragment), Venecia 1994
71.Prof.Dr. Gjorgji Caca: Zhvillimi kushtetues në RSM, Fletorja Zyrtare e RSM-së, Shkup 1983
72.Agjensia e Lajmeve - INA, 23 Dec 2009
73.Nga shkrimet dhe opinionet e publicistëve, historianëve, studiuesve e përkthyesve shqiptarë:
- Moikom Zeqo,
- Arben Llalla,
- Luan Malltezi,
- Rrahim Veliu,
- Filip Boga,
- Fatbardha Demi,
- Adnan Abrashi,
- Nezir Myrta,
- Nebi Dervishi,

- Salih Mehmeti,
- Ilir Cenollari,
- Agron Luka,
- Valon Kurtishi,
- Fahri Xharra.

P Ë R M B A J T J A

DY FJALË PËR LEXUESIT…….....5

I – MAQEDONËT DHE MAQEDONIA ANTIKE

1.Shfaqja dhe mbretërimi
i Maqedonëve në Pellazgjinë jugore…….....…7
2.Etnia – Origjina e Maqedonëve antikë……10
3.Emri i Maqedonisë…….18
4.E vërteta mbi Maqedonët antike...……...22
5.Dinastitë mbretërore të Maqedonisë……...50
6.Filipi II dhe Olimpia/Olimbia…….59

II – ALEKSANDRI I MADH I MAQEDONISË – LEKA

1.Fëmijëria e Lekës së Madh……...64
2.Edukimi i Aleksandrit……...66
3.Burrërimi i Aleksandrit……..…69
4.Kuptimi i emrit – ALEKSANDËR……...71
5.Origjina ilire e Aleksandrit të Madh……...74
6.Aleksandri i Madh – grek apo ilir?.....78
7.Kali i Lekës – BUKEFALI……..…85
8.Urtësi e Dialogje të Aleksandrit të Madh……...86
9.I kujt është Aleksandri i Madh?.....91

III – BETEJAT E ALEKSANDRIT TË MADH

Hyrje……93
1.Beteja e Keronës (v.338 p.e.s.)……...95
2.Aleksandri nënshtron Helenët (grekët)……..96
3.Leka i Madh në Trojë…….98
4.Beteja e Granikut (v.334 p.e.s.)……...101
5.Beteja e Issos (Isus) (v.331 p.e.s.).....105
6.Nyja e Gordianit.....110
7.Marshimi i Lekës së Madh drejt Lindjes së Afërt.....112

8.Beteja e Gaugamelës – Pushtimi i Mesopotamisë dhe
i Babilonisë (maj-nëntor 331 p.e.s.)…….....117
9.Marrja e Persepolit dhe pushtimi i Persisë, i Medisë
dhe i Hirkanienisë (dhjetor 331 p.e.s. – tetor 330 p.e.s.)…….127
10.Pushtimi i Arianës, i Baktrienisë dhe i Sogdianës
(tetor 330 p.e.s. – prill 327 p.e.s.)…….....135
11.Marshimi drejt Indisë (prill 327 p.e.s. – janar 325 p.e.s.)…..143
12.Nga Indi te Tigri (janar 325 p.e.s. – qershor 324 p.e.s.)……160
13.Viti i fundit i jetës së Aleksandrit
(qershor 324 p.e.s. – qershor 323 p.e.s.)…….....171
14.Kthimi nga India dhe vdekja e Aleksandrit……..187
15.Vdekja e Aleksandrit të Madh…….188
16.Aleksandri i Madh vdiq nga konsumi i tepërt i verës…….192
17.Tri porositë e Aleksandrit të Madh…….192
18.Ku gjendet varri i Aleksandrit të Madh?.....194
19.Statutet e Shkodrës apo "Testamenti" i Lekës së Madh…..195
20.Disa sqarime mbi "Privilegjin e Aleksandrit të Madh"
që paraprin Statutet e Shkodrës…….....210
21.Orakulli politik i Aleksandrit…….…..214
22.Aleksandri i Madh dhe Skënderbeu me epitetet:
"Gjarpri - Dragoi – Kuçedra"!.....220
23.Aleksandri i Madh në astrologji……..228

IV – VENDOSJA E SLLAVËVE NË ILIRIK
DHE MAQEDONIA…….....243

V – PARAARDHËSIT DHE PASARDHËSIT ILIRË
TË LEKËS SË MADH

1.Pellazgët në Azinë Qendrore…….259
2.Mbretëria maqedone në Indi…….263
3.Sami Frashëri – "Pas vdekjes s'Aleksandrit,
maqedonasit bënë disa mbretëri n'Azi..."…….265
4.Hundëzakët – 6 mijë kalorësit ilirë rrëzë Himalajeve…….....266
5.Hundëza – Vendi i vendosjes së Maqedonëve ilirë…….....272
6.Pamiri – Zgjidhja e një enigme iliro-maqedonase.....274

7.Kalashët.....281
8.Nga Dodona në Tibet.....283

VI – BIBLA E SHENJTË
PËR ALEKSANDRIN E MADH.....319

VII – KUR'ANI I MADHËRISHËM
PËR ALEKSANDRIN E MADH.....335

VIII– SHQIPTARËT PËR LEKËN E MADH…….....344

IX– GJAKU S'BËHET UJË, LEKA I MADH:
PELLAZG – ILIR – SHQIPTAR…….....349

X – Kristo Frashëri: E VËRTETA MBI SHQIPTARËT E
MAQEDONISË DHE SHTREMBËRIMET
E ENCIKLOPEDISË SË SHKUPIT.....354

XI – MAQEDONAS TË SLLAVIZUAR APO SLLAVOBULLGAR

1.Konvertimi i Maqedonasve të sllavizuar në Shqiptarë.....370
2.Leka i Madh ka luftuar kundër grekëve.....374

XII – KOMBI SHQIPTAR – THEMELI I KOMBEVE EURO-
AZIATIKE…….....378

- PËRMBLEDHJE.....386
- Fotografi, skica, harta.....392
- Biografia e Autorit…….....436
- Bibliografia /Literatura…….....438
- Përmbajtja…….....441